



ILD

INSPEKTORI I LARTË
I DREJTËSISË

HISTORIK I PËRGJITHSHËM I PROCESIT DISIPLINOR NDAJ MAGJISTRATËVE NË SHQIPËRI (1912 – 2025)



Co-funded by
the European Union

EU4JUSTICE

Implemented by:



ITALIAN AGENCY
FOR DEVELOPMENT
COOPERATION



Consiglio
Superiore
della Magistratura

In partnership with:

**EXPERTISE
FRANCE**
GROUPE AFD



FIIAPP |
COOPERACIÓN ESPAÑOLA



Co-funded by
the European Union

EUIVJUSTICE

Implemented by:



ITALIAN AGENCY
FOR DEVELOPMENT
COOPERATION



Consiglio
Superiore
della Magistratura

In partnership with:



EXPERTISE
FRANCE
GROUPE AFD



FIIAPP
COOPERACIÓN ESPAÑOLA



HISTORIK I PËRGJITHSHËM I PROCESIT DISIPLINOR NDAJ MAGJISTRATËVE NË SHQIPËRI (1912 – 2025)

Përgatitur në kuadër të 5-vjetorit të ngritjes
së Inspektorit të Lartë të Drejtësisë

Nga **Prof. Asoc. Dr. Erind MERKURI**

Konsulente: Mimoza Koçiu

Redaktore: Arianisa Laze

Kërkimi në Arkivin e Shtetit dhe Bibliotekën Kombëtare: Elis Kuçi, Zilije Feçi, Sidora Tyli

Design & Layout: Jonida Hoxha

Shtypur në shtypshkronjën MORAVA

ISBN 9789928314895

Heqje dorë nga përgjegjësia:

Ky publikim është bashkëfinancuar nga Bashkimi Evropian. Përmbajtja e tij është përgjegjësia e vetme e Inspektorit të Lartë të Drejtësisë dhe nuk pasqyron domosdoshmërisht pikëpamjet e Bashkimit Evropian.

EU4JUSTICE

Rruga "Abdi Toptani",
Godina Torre Drin, Kati i 10-të, Tiranë
E-mail: info@eu4justice.al
Web: www.eu4justice.al

Inspektori i Lartë i Drejtësisë

Bulevardi "Dëshmorët e Kombit"
Godina nr. 13, Tiranë, Shqipëri
E-mail: info@ild.al
Web: www.ild.al

Përmbajtje

Hyrje nga Inspektori i Lartë i Drejtësisë	7
---	---

I. INSPEKTIMI DHE DISPLINA

NË PERIU DHËN 1912 – 1992	11
---------------------------------	----

1. Shpallja e Pavarësisë dhe legjislacioni osman mbi inspektimin dhe përgjegjësinë disiplinore në sistemin e drejtësisë (1912-1925).....	11
1.1 <i>Inspektimi disiplinor</i>	13
1.2 <i>Përgjegjësia disiplinore e gjyqtarëve</i>	16
2. Inspektimi dhe përgjegjësia disiplinore sipas “Zgjanimit të Statutit të Lushnjës” (1922).....	28
3. Inspektimi dhe disiplina sipas Statutit Themeltar të vitit 1925 dhe Dekret-ligjit të datës 2 maj 1925 “Mbi organizimin e drejtësisë”	29
3.1 <i>Inspektimi</i>	31
3.2 <i>Përgjegjësia dhe masat disiplinore</i>	31
4. Inspektimi dhe disiplina sipas Statutit Themeltar të vitit 1928 dhe ligjit të datës 2 shkurt 1929, “Mbi organizimin e drejtësisë”	33
4.1 <i>Inspektimi dhe procedura disiplinore e gjyqtarëve</i>	34
4.2 <i>Përgjegjësia dhe masat disiplinore</i>	37
5. Inspektimi dhe disiplina sipas Ligjit nr.275, datë 13.08.1946 “Mbi organizimin gjyqësor”	41
5.1 <i>Inspektimi dhe procedimi disiplinor</i>	41
5.2 <i>Përgjegjësia dhe masat disiplinore</i>	42
6. Inspektimi dhe disiplina sipas ligjit nr. 4406, datë 24.06.1968 “Mbi organizimin gjyqësor”	43
7. Inspektimi dhe disiplina sipas Dekretit nr.7174, datë 20.11.1987 “Për organizimin gjyqësor”	44
8. Sistemi i prokurorisë në vitet 1945-1992	46

II. INSPEKTIMI DHE DISPLINA	
NË PERIUDHËN 1992 – 1998	49
1. Parashikimet kushtetuese sipas ligjit nr. 7561, datë 29.04.1992 “Organizimi i drejtësisë dhe i Gjykatës Kushtetuese”	49
2. Inspektimi dhe përgjegjësia disiplinore e gjyqtarëve dhe prokurorëve, sipas ligjit nr. 7574, datë 24.06.1992 “Për organizimin e drejtësisë dhe disa ndryshime në kodet e procedurave penale e civile”	58
2.1 <i>Inspektimi i gjyqtarëve dhe prokurorëve</i>	59
2.2 <i>Përgjegjësia dhe masat disiplinore</i>	64
3. Inspektimi dhe përgjegjësia disiplinore e gjyqtarëve dhe prokurorëve, sipas ligjit nr. 8265, datë 18.12.1997 “Për organizimin e drejtësisë”	68
3.1 <i>Inspektimi i gjyqtarëve dhe prokurorëve</i>	69
3.2 <i>Përgjegjësia dhe masat disiplinore</i>	71
III. INSPEKTIMI DHE DISIPLINA SIPAS PARASHIKIMEVE KUSHTETUESE NË VITET 1998 – 2016	78
1. Inspektimi dhe disiplina sipas ligjit nr. 8436, datë 28.12.1998 “Për organizimin e pushtetit gjyqësor”	86
1.1. <i>Inspektimi dhe procedimi i gjyqtarëve</i>	86
1.2. <i>Përgjegjësia dhe masat disiplinore ndaj gjyqtarëve</i>	106
2. Inspektimi dhe disiplina sipas ligjit nr. 8737, datë 12.02.2001 “Për organizimin dhe funksionimin e prokurorisë”	171
2.1 <i>Inspektimi dhe procedimi i prokurorëve</i>	172
2.2 <i>Përgjegjësia dhe masat disiplinore</i>	179
3. Inspektimi sipas ligjit nr. 8811, datë 17.05.2001 “Për organizimin dhe funksionimin e Këshillit të Lartë të Drejtësisë”	191
IV. PROCESI DISIPLINOR PAS REFORMËS SË VITIT 2016	221
1. Inspektimi i gjyqtarëve dhe prokurorëve	223

2. Përgjegjësia disiplinore e anëtarëve të Këshillit të Lartë Gjyqësor, të Këshillit të Lartë të Prokurorisë dhe të Prokurorit të Përgjithshëm	228
3. Inspektimi disiplinor sipas ligjit nr. 96/2016	
“Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve”	231
3.1 <i>Hetimi disiplinor</i>	252
3.2 <i>Procedimi disiplinor</i>	270
3.3 <i>E drejta e ankimit për vendimet disiplinore</i>	282
ANEKS	
Dokumente autentike të Arkivit të Shtetit	
mbi procesin disiplinor e organizimin e drejtësisë.....	287
BIBLIOGRAFI	292

HYRJE

Kur me kolegët në Zyrën e Inspektorit të Lartë të Drejtësisë diskutonim idenë e një botimi mbi procesin disiplinor ndaj magjistratëve në Shqipëri, që të niste nga gjurmët ku fillonte ky proces, me kërkime në Arkivin e Shtetit, Bibliotekën Kombëtare, konsulta me studiues të ndryshëm, por edhe aktorë ndër vite të këtij procesi, entuziazmi mbi një sipërmarrje kaq impenjative, shkonte paralel me përgjegjësinë për të pasqyruar gjithë atë punë të madhe të bërë nga aktorë të ndryshëm, institucionale e juridikë për të pasur një sistem drejtësie të përgjegjshëm, edhe kur themelet e shtetit në periudha të ndryshme nuk ishin aq të forta, por kur shteti i së drejtës duhej të mbetej i qëndrueshëm.

Është emocionuese të konstatosh ndërgjegjen e fortë shtetare, që në themelimin e Shtetit Shqiptar në 1912. Qeveria Kombëtare e Vlorës vendosi që krahas ngritjes së gjykatave e prokurorive të shtetit shqiptar, të krijonte edhe një inspektorat drejtësie, që të garantonte përgjegjshmërinë jo vetëm të sistemit, por edhe pavarësinë e tij, pasi inspektorët kishin edhe një kompetencë domethënëse, të verifikonin që administrata shtetërore të mos ndërhynte apo ndikonte në asnjë mënyrë, në veprimtarinë e gjykatave.

Ndër përmirësimet që iu bënë më pas, deri kur vendi u shpall monarki, spikaste fokusi tek profesionalizmi i magjistratëve, përmes ruajtjes nga legjislacioni osman i parashikimit, se kur një gjyqtari i prisheshin më shumë se gjysma e vendimeve nga një gjykatë më e lartë, apo kur më shumë se gjysma e vendimeve që kishte dhënë nuk kishin mundësi ekzekutimi, atëherë Ministria e Drejtësisë vendoste marrjen e masës disiplinore të pushimit nga detyra.

Interesant është të shohësh sesi në vitin 1928, me Statutin Themeltar të Mbretërisë, përcaktohet pavarësia e gjyqtarëve dhe palëvizshmëria e tyre nga detyra. Por krahas këtyre garancive ishte parashikuar edhe përgjegjshmëria e magjistratëve përmes disa institucioneve kontrolluese e vendimmarrëse. Kështu inspektimi i tyre monitorohej nga dy subjekte dhe mbikëqyrej nga ministri i drejtësisë dhe i pari i shtetit. Inspektori i drejtësisë kryente inspektime me urdhër të ministrit të drejtësisë

dhe konstatonte shkelje disiplinore. Subjekti i dytë i kontrollit ishte Kryeprokurori, që konstatonte shkelje disiplinore nga ana e gjyqtarëve, nga raportet që mund t'i vinin nga prokurorët pranë gjykatave më të ulëta, si edhe nga vetë shqyrtimi i çështjeve që ai bënte, si përfaqësues i shtetit në gjykime. Edhe Kryeprokurori njësoj si inspektori, raportonte njësoj tek ministri i drejtësisë, por ky raportim duhej të miratohej edhe nga Këshilli i Epërm Gjyqësor.

Pas një kthimi mbrapa të shtetit të së drejtës në periudhën e monizmit, ku gjykatat e prokuroritë u njësuën me partinë-shtet, pluralizmi riktheu në vëmendje rolin e gjyqësorit, si element kyç i shtetit të së drejtës, duke ligjëruar pavarësinë e gjyqtarëve e prokurorëve. Presidenti i Republikës si kryesues dhe më tej ministri i drejtësisë me rol përherë e më të fortë ishte modeli që Shqipëria provoi me përmirësime deri në vitin 2016. Koha tregoi se nuk mjaftonin për të pasur një sistem të pavarur e garantues të shtetit të së drejtës, përderisa me një konsensus të rrallë politik pozitë-opozitë, Kuvendi i Shqipërisë miratoi në korrik 2016 reformën në drejtësi, e cila riformatoi gjithë sistemin përmes një arkitekture të re, e cila si emërues të përbashkët kishte pavarësinë e gjyqtarëve e prokurorëve, tashmë të sanksionuar qartazi me ligj, njëjtë edhe të institucioneve të reja të drejtësisë. Në këtë arkitekturë të re, procesi disiplinor vjen për herë të parë si kompetencë e një institucioni të vetëm, Inspektorit të Lartë të Drejtësisë, një institucion i pavarur kushtetues, që ka përgjegjësinë e inspektimit disiplinor për gjyqtarët e prokurorët e të gjitha niveleve. Zgjedhja në detyrën e Inspektorit të Lartë të Drejtësisë erdhi me përgjegjësinë e jashtëzakonshme për përballjen me ngritjen e një institucioni të tillë me themele të forta profesionale, me pritshmëritë e publikut dhe aktorëve të tjerë politikë e institucionalë dhe me pritshmëritë e vetë sistemit të drejtësisë. Duke mos pasur model paraardhës, vendosja e standardeve të tilla dhe mbi të gjitha, ruajtja e ekuilibrit mes pavarësisë së magistratëve dhe interesit krejt legjitim të publikut për mënyrën se si administrohet drejtësia ishte dhe mbetet busulla orientuese e Zyrës së Inspektorit të Lartë të Drejtësisë. Kjo mbetet sfida më e madhe profesionale dhe personale e Zyrës së Inspektorit të Lartë të Drejtësisë, jo për stabilitet institucional, por duke e parë këtë balancë interesash, si një parim kushtetues të rëndësishëm për të ardhmen e sistemit të drejtësisë dhe të shtetit të së drejtës. Natyrshëm si çdo proces, edhe testimi i kësaj filozofie pune kërkon periudhën e vet të përballjes me sfidat që kalon sistemi dhe koha do të tregojë qëndrueshmërinë e zbatimit të saj në praktikë, si dhe efektet afatgjata në sistem.

Me falënderim për Erindin, pedagogun e palodhur e këmbëngulës, që e materializoi këtë dokument studimor, por edhe për ekipin e ILD-së, që investoi kohë, energji e përkushtim për të ndihmuar në realizimin e kësaj

pune dokumentare, uroj që ky botim të shërbejë, si për profesionistët e fushës, për studiuesit, studentët apo edhe lexues me interesa të tjera, për ta parë jo thjesht si rrugëtim historikun e procesit disiplinor, por si përpyetje e vazhdueshme e aktorëve e faktorëve shqiptarë e ndërkombëtarë, për t'u përmirësuar, nga arritjet e gabimet, e me një synim të përbashkët, një sistem drejtësie që i shërben gjithë shoqërisë dhe demokratizimit të vendit.

Artur Metani
Inspektori i Lartë i Drejtësisë

KREU I

INSPEKTIMI, PROCEDIMI DHE DISIPLINA E GJYQTARËVE DHE PROKURORËVE NË PERIU DHËN 1912-1992

I. Shpallja e Pavarësisë dhe legjislacioni osman mbi inspektimin dhe përgjegjësinë disiplinore në sistemin e drejtësisë (1912-1925)

Me Kuvendin Kombëtar të Vlorës, më datë 28 nëntor 1912, Shqipëria deklaroi pavarësinë e saj nga Perandoria Osmane. Por shpallja e kësaj pavarësie nuk do të thoshte shpëputjen menjëherë nga e drejta osmane, kjo sepse në radhë të parë ishte totalisht e pamundur që të shfuqizojë menjëherë të gjithë korpusin ligjor osman, që zbatohet në Shqipëri në atë kohë. Një shfuqizim i menjëhershëm i tij do të linte praktikisht një boshllëk total legjislativ, duke zhdukur çdolloj rregull të zbatueshëm deri në atë moment, e duke tronditur në këtë mënyrë të gjitha marrëdhëniet shoqërore. Nga ana tjetër, Shteti Shqiptar në atë moment, për vetë kushtet dhe rrethanat e kohës, nuk kishte kapacitete njerëzore, materiale dhe teknike, për të hartuar menjëherë një legjislacion modern, që do të zëvendësonte legjislacionin osman, që zbatohet në Shqipëri.

Për këtë arsye, vendimi i Qeverisë Kombëtare të Vlorës, që në Shqipëri të vijonte të zbatohet ende legjislacioni osman ishte më se i kuptueshëm dhe e vetmja zgjidhje e natyrshme në atë kohë. Ky legjislacion do të duhej të zbatohet, derisa organet e ndryshme të shtetit shqiptar të miratonin akte të tjera.

Në këtë pikë është e nevojshme të sqarohet, se cilat akte të Perandorisë Osmane u njohën në Shqipëri. Siç dihet, sistemi juridik i një vendi përbëhet nga norma, të cilat mbivendosen ose nën vendosen ndaj njëra-tjetrës, në varësi të organit që i miraton dhe fuqisë së tyre juridike. Në këtë aspekt, edhe e drejta osmane përbëhej nga norma parësore dhe norma dytësore. Pikërisht për sqarimin e këtij momenti dhe duke interpretuar vendimin e Qeverisë së Vlorës, Këshilli i Shtetit ka mbajtur qëndrimin, se *“Prandaj letra e Kryeministrit Ottomanë q’u përmend ma sipër për veç që nuk formon një interpretim të vlefshëm simbas vendimit të marrun prej Qeverisë Shqiptare të Vlorës, qi deri deri sa të promulgohen ligjë të rea kanë vlefte vetëm ligjet e rregulloret, si dhe iradetë para konsitucionit turk, duhet të*

konsiderohen si ligje të aplikueshme, por jo dekretet e Kryeministrit Ottomane".¹ Ky pasazh është mjaft i rëndësishëm, pasi na jep një pasqyrë të qartë, se cilat akte u njohën nga Qeveria e Vlorës dhe për rrjedhojë patën efekt në të drejtën e vendit tonë. Bëhet fjalë për "iradetë" e sulltanit, të cilat janë akte ligjore, që miratoheshin nga kreu i shtetit osman, në kohën e absolutizmit të tij, si edhe ligjet dhe kodet e miratuara nga parlamenti osman, gjatë periudhës kur u rivendos konstitucionalizmi në atë vend. Në këtë rast përjashtoheshin aktet nënligjore.²

Për të identifikuar normat përkatëse në legjislacionin osman, rezulton se referimi bëhej në veprën e një diplomati anglez, George Joung (1872-1952), i cili e kishte përmbledhur të gjithë legjislacionin osman të kohës në një vepër me shtatë vëllime, titulluar *"Korpusi ligjor i së drejtës osmane: Përmbledhje e kodeve, ligjeve, rregulloreve dhe akteve më të rëndësishme të së drejtës së brendshme dhe studimeve të së drejtës zakonore, të Perandorisë Osmane"* (*Corps de droit ottoman; recueil des codes, lois, règlements, ordonnances et actes les plus importants du droit intérieur, et d'études sur le droit coutumier de l'Empire ottoman*).³

Mbështetur në këtë qasje, për të identifikuar legjislacionin osman, që vijoi të zbatohej në Shqipëri pas shpalljes së pavarësisë dhe që rregullonte organizimin dhe funksionimin e pushtetit gjyqësor, si referencë shërben sërish vepra e këtij autori, në të cilën është botuar dhe Ligji i Gjykatave *"Nizamiye"*, i datës 27 Jumada al-Thani 1296 (27 qershor 1879). Ky ligj rregullonte organizimin dhe funksionimin e sistemit gjyqësor të juridiksionit të përgjithshëm të Perandorisë Osmane, që organizohej në gjykatat e shkallës së parë, gjykatat e apelit dhe Gjykatën e Kasacionit. Këto gjykata ishin kompetente për të shqyrtuar të gjitha çështjet me natyrë civile dhe penale. Përjashtim nga juridiksioni i këtyre gjykatave ishin çështjet familjare dhe të trashëgimisë, që rregulloheshin nga e drejta fetare dhe gjykoheshin nga gjykatat fetare. Gjithashtu, përjashtoheshin nga juridiksioni i këtyre gjykatave, çështjet që kishin të bënin me të huajt, që shqyrtoheshin nga juridiksioni konsullor, në bazë të regjimit të kapitulacioneve. Këto gjykata nuk shqyrtonin as mosmarrëveshje administrative, të cilat shqyrtoheshin sipas rastit, nga këshillat e nënprefekturave, prefekturave dhe si shkallë e fundit shërbente Këshilli i Shtetit.

1. Mendimi nr. 58, datë 23.05.1933 i Seksionit të Drejtësisë dhe të Administratës, miratuar me vendimin nr. 162, datë 30.05.1933 të Mbledhjes së Përgjithshme të Këshillit të Shtetit.

2. Kristinka Jançe dhe Ilirjana Nano, *"Jurisprudenca e Këshillit të Shtetit mbi legjislacionin osman"*, botuar në aktet e Konferencës Shkencore Kombëtare, "Këshilli i Shtetit për zhvillimin e së drejtës në Shqipëri (1929-1944)", nën përkujdesjen e Aurela Anastasi dhe Erind Merkuri, organizuar më datë 22.11.2022, nga Fakulteti i Drejtësisë i Universitetit të Tiranës, Tiranë 2024, fq. 194-195.

3. Po aty, fq. 196-197.

Ky ligj rregullonte gjithashtu edhe sistemin e prokurorisë, që varej nga ministri i drejtësisë, i cili i propozonte Kreut të Shtetit, emërimin dhe shkarkimin e prokurorëve.⁴ Prokuroria organizohej në Prokuror të Përgjithshëm pranë Gjykatës së Kasacionit, Prokurorë të Përgjithshëm pranë Gjykatave të Apelit dhe zëvendës prokurorë, pranë çdo Gjykate të Shkallës së Parë.⁵ Në përputhje me ligjet e kohës, prokurorët merrnin pjesë si në gjykime penale, ashtu edhe në disa kategori gjykimesh civile.

1.1. Inspektimi disiplinor

Ligji i Gjykatave “Nizamiye”, i datës 27 Jumada al-Thani 1296 (27 qershor 1879), në nenet e veta, parashikonte gjithashtu edhe krijimin e një Inspektorati të Drejtësisë, në varësi të Ministrit të Drejtësisë. Inspektorët caktoheshin nga Kreu i Shtetit, me propozim të Ministrit të Drejtësisë, për çdo krahinë dhe ngarkoheshin që të shqyrtonin dhe të kontrollonin mënyrën e funksionimit të gjykatave në atë krahinë.⁶

Për të qenë inspektor i drejtësisë, kandidati duhej të kishte njohuri të përkryera mbi legjislacionin civil dhe penal, material dhe procedural, si edhe të ishte i denjë në çdo aspekt, për besimin e Qeverisë.⁷

Ligji përcaktonte se inspektorët e drejtësisë ishin të detyruar të inspektonin rregullisht të gjitha gjykatat që gjendeshin në zonën e tyre të juridiksionit,⁸ ku të verifikonin: i) nëse gjyqtarët vinin në kohën e përcaktuar dhe nëse i përkushtoheshin shqyrtimit të çështjeve, ii) nëse respektoheshin rregullat procedurale në lidhje me debatin gjyqësor, iii) nëse njoftimet dhe aktet e tjera gjyqësore komunikoheshin në përputhje me dispozitat procedurale, iv) për numrin e çështjeve të pazgjidhura, v) për mënyrën se si kryhej shërbimi i zyrave të sekretarisë, vi) nëse tarifat gjyqësore mbledheshin dhe regjistroheshin sipas rregullave përkatëse.⁹

Ligji parashikonte që funksionimi i gjykatave duhej të mbikëqyrej në çdo detaj, duke i dhënë të drejtë inspektorit të drejtësisë, që të shqyrtonte dosjet dhe regjistrat, si edhe të verifikonte nëse sekretarët, punonjësit

4. Ligji i Gjykatave “Nizamiye”, i datës 27 Jumada al-Thani 1296 (27 qershor 1879), neni 57.

5. Ligji i Gjykatave “Nizamiye”, i datës 27 Jumada al-Thani 1296 (27 qershor 1879), neni 59.

6. Ligji i Gjykatave “Nizamiye”, i datës 27 Jumada al-Thani 1296 (27 qershor 1879), neni 74.

7. Ligji i Gjykatave “Nizamiye”, i datës 27 Jumada al-Thani 1296 (27 qershor 1879), neni 75.

8. Ligji i Gjykatave “Nizamiye”, i datës 27 Jumada al-Thani 1296 (27 qershor 1879), neni 76.

9. Ligji i Gjykatave “Nizamiye”, i datës 27 Jumada al-Thani 1296 (27 qershor 1879), neni 77.

përgjegjës për përmbarimin, ndihmësit e tyre dhe gjyqtari, i kryenin funksionet e tyre me saktësi.¹⁰

Nëpërmjet kompetencave të tyre kontrolluese, inspektorët e drejtësisë duhej që të siguroheshin që të gjitha palët, pavarësisht klasës apo cilësive të tyre, të trajtoheshin në mënyrë të barabartë, pa favorizime ose përcmim nga ana e gjyqtarëve. Gjyqtarët nuk duhej të shprehnin asnjë fjalë, që mbështeste pretendimet e një pale ose që miratonte mbrojtjen e tjetrës.¹¹

Në procesin penal inspektorët e drejtësisë verifikonin nëse procesverbalet, që lidheshin me të akuzuarit për krime dorëzoheshin në kohën e duhur në gjykatë, nëse marrja në pyetje e të pandehurve kryhej në mënyrë të rregullt, ose nëse ndiqeshin menjëherë hetimet dhe ekspertizat e kërkuara nga gjykata, përndryshe, inspektorët duhet të njoftonin Ministrin e Drejtësisë.¹²

Inspektorët e drejtësisë raportonin tek ministri i drejtësisë, në rast se kërkesat e tyre nuk merreshin parasysh, ose nëse shkeljet që kishin raportuar përsëriteshin.¹³ Gjithashtu, nëse vendimet dhe urdhrat e gjykatave mbeteshin të pazbatuara, nëse zbatimi i tyre nuk ishte i plotë ose tejkalonte kufijtë e përcaktuar nga ligji, ose nëse ndodhnin veprime apo procedura, që pengonin të dënuarit që të apelonin ose të parashtronin kërkesë në Gjykatën e Lartë, inspektorët duhej të informonin autoritetet lokale dhe ministrin e drejtësisë.¹⁴

Inspektorët kishin detyrë që t'i raportonin ministrit të drejtësisë për gjyqtarët dhe funksionarët gjyqësorë, që nuk ishin të aftë të përmblidhnin funksionet e tyre dhe të sillnin prova që mbështesin nevojën për shkarkimin e tyre.¹⁵

Por inspektorët e drejtësisë kishin edhe një tjetër kompetencë të rëndësishme. Ata verifikonin që administrata shtetërore të mos ndërhynte apo ndikonte në asnjë mënyrë, në veprimtarinë e gjykatave.¹⁶ Në kuadër të këtij kontrolli, inspektorët verifikonin nëse organet e administratës shtetërore dërgonin kërkesa apo ankesa në gjykata apo

10. Ligji i Gjykatave "Nizamiye", i datës 27 Jumada al-Thani 1296 (27 qershor 1879), neni 78.

11. Ligji i Gjykatave "Nizamiye", i datës 27 Jumada al-Thani 1296 (27 qershor 1879), neni 79.

12. Ligji i Gjykatave "Nizamiye", i datës 27 Jumada al-Thani 1296 (27 qershor 1879), neni 85.

13. Ligji i Gjykatave "Nizamiye", i datës 27 Jumada al-Thani 1296 (27 qershor 1879), neni 84.

14. Ligji i Gjykatave "Nizamiye", i datës 27 Jumada al-Thani 1296 (27 qershor 1879), neni 88.

15. Ligji i Gjykatave "Nizamiye", i datës 27 Jumada al-Thani 1296 (27 qershor 1879), neni 90.

16. Ligji i Gjykatave "Nizamiye", i datës 27 Jumada al-Thani 1296 (27 qershor 1879), neni 80.

këshillat jokompetentë, u bënë thirrje subjekteve të ndryshme për t'u paraqitur në gjykim, kur nuk kishte asnjë njoftim, bënë arrestime apo burgime të paautorizuara nga ligji, ushtronin presion në formën e kërkesës për garanci, apo forma të tjera. Nëse verifikoheshin këto situata, inspektori përgjegjës për atë krahinë, u kërkonte autoriteteve lokale që të ndalonin këto parregullsi,¹⁷ përndryshe duhej të njoftonin në mënyrë të menjëhershme Ministrin e Drejtësisë.¹⁸

Këto kompetenca nuk i jepnin të drejtë inspektorit të drejtësisë, që të ndërhynte në debatin gjyqësor, apo të ndikonte tek gjykata. Nga inspektori kërkohej që të raportonte çdo parregullsi që ishte vërejtur.¹⁹

Ligji i jepte të drejtë inspektorëve të drejtësisë që të kontrollonin edhe burgjet për të verifikuar: i) nëse individët mbaheshin përtej afatit të përcaktuar për burgim, ii) nëse kishte persona të ndaluar në kundërshtim me ligjin, iii) nëse rregullat e brendshme të burgjeve dhe sjellja e personelit ndaj të burgosurve ishte siç duhet dhe iv) nëse mjediset e burgjeve përmbushnin standardet e kërkuara nga higjiena.²⁰

Ligji parashikonte që inspektorët nuk duhej të pranonin ankimet apo rekurset, si mjete procedurale ankimi kundër vendimeve të gjykatave më të ulëta. Megjithatë, nëse këto ankesa ishin kundër një vendimi të gjykatës së shkallës së parë, ata pranonin ankesën dhe ia kalonin *valiut* ose *mytesarifit*, për t'ia përcjellë Gjykatës së Apelit, që kishte juridiksion mbi çështjet e gjykatës së shkallës së parë. Nëse ankesa lidhej me një vendim të një gjykate apeli, inspektori ia transmetonte ankesën Ministrisë së Drejtësisë, me qëllim që ky i fundit, t'ia dërgonte Gjykatës së Kasacionit.²¹

Inspektorët kishin akses në dokumentet e depozituara në gjykatë dhe kishin të drejtë që të kërkonin kopje të legalizuara nga kryetari i gjykatës.²²

Çdo tre muaj inspektorët i paraqisnin një raport Ministrisë së Drejtësisë duke përmbledhur rezultatet e inspektimeve të tyre dhe veprimet e kryera, të bazuara në një ditar, ku duhej të ishin shënuara të gjitha këto të dhëna.²³ Inspektorët e drejtësisë duhej gjithashtu të informonin Ministrin

17. Ligji i Gjykatave "Nizamiye", i datës 27 Jumada al-Thani 1296 (27 qershor 1879), neni 87.

18. Ligji i Gjykatave "Nizamiye", i datës 27 Jumada al-Thani 1296 (27 qershor 1879), neni 86.

19. Ligji i Gjykatave "Nizamiye", i datës 27 Jumada al-Thani 1296 (27 qershor 1879), neni 81.

20. Ligji i Gjykatave "Nizamiye", i datës 27 Jumada al-Thani 1296 (27 qershor 1879), neni 83.

21. Ligji i Gjykatave "Nizamiye", i datës 27 Jumada al-Thani 1296 (27 qershor 1879), neni 89.

22. Ligji i Gjykatave "Nizamiye", i datës 27 Jumada al-Thani 1296 (27 qershor 1879), neni 91.

23. Ligji i Gjykatave "Nizamiye", i datës 27 Jumada al-Thani 1296 (27 qershor 1879), neni 92.

e Drejtësisë për çdo rrethanë, që mund të krijonte vështirësi në zbatimin e ligjeve dhe rregullave.²⁴

Inspektime rezultojnë që të jenë bërë në këtë periudhë bazuar në këtë ligj. Ndërkohë në gazetën “Dit’ e Re”, që më vonë do të titullohej *Fletorja Zyrtare e Shqipërisë*, në numrin e datës 5 prill 1922, gjendet shënimi: “Z. Demir Vila erdhi. Sekretar’ i parë i Ministrisë Drejtësisë z. Demir Villa që ‘ish dërguar për hetimet e Prokurorit dhe zv. Nd. gjyqtarit të paqit në Korçë u kthye këtu. Raportin e ankesës ja paraqiti Ministrisë”. Siç rezulton në këtë rast, sekretari i parë i Ministrisë së Drejtësisë në Shqipëri ka kryer rolin e inspektorit të drejtësisë.

1.2. Përgjegjësia disiplinore e gjyqtarëve

Ky ligj parashikonte si garanci për gjyqtarët, palëvizshmërinë e tyre nga detyra, pasi ata nuk mund të transferoheshin pa pëlqimin e tyre.²⁵

Ligji parashikonte se gjyqtarët mbanin përgjegjësi për sjellje ose veprime të papajtueshme me funksionet e një gjyqtari. Pra gjyqtari mbante përgjegjësi disiplinore. Në këtë rast, ligji parashikonte, që në varësi të rëndësisë së kësaj shkeljeje, masat disiplinore që mund të jepeshin ishin: paralajmërim, vërejtje, ose edhe pezullim nga funksioni, duke u ndërprerë në këtë rastin e fundit, edhe paga.²⁶ Siç mund të konstatohet, ligji u linte organeve disiplinore, diskrecionin, që të përcaktonin vetë, nëse, së pari kishte pasur apo jo sjellje apo veprime të papërshtatshme dhe së dyti, nëse provohej ekzistenca e tyre, në varësi të llojit të sjelljes apo veprimit, të përcaktonin edhe llojin e masës disiplinore. Pra, në këtë rast këto organe duhej që të jepnin masën disiplinore në mënyrë proporcionale me rëndësinë e shkeljes.

Masa e rëndë e shkarkimit nga detyra jepej, kur gjyqtari dënohej për një vepër penale, ose me dënime korrektuese, si edhe për një dënim administrativ, që jepte policia, por me burgim.²⁷

Gjithashtu, ligji parashikonte se në rast se brenda një muaji, gjyqtari mungonte tre herë pa justifikim të vlefshëm dhe pa leje, atëherë kjo do të konsiderohej si dorëheqje dhe ai do të zëvendësohej.²⁸ Ky parashikim, megjithëse këtë sjellje e konsideronte si dorëheqje me veprime

24. Ligji i Gjykatave “Nizamiye”, i datës 27 Jumada al-Thani 1296 (27 qershor 1879), neni 93.

25. Ligji i Gjykatave “Nizamiye”, i datës 27 Jumada al-Thani 1296 (27 qershor 1879), neni 48.

26. Ligji i Gjykatave “Nizamiye”, i datës 27 Jumada al-Thani 1296 (27 qershor 1879), neni 49.

27. Ligji i Gjykatave “Nizamiye”, i datës 27 Jumada al-Thani 1296 (27 qershor 1879), neni 49.

28. Ligji i Gjykatave “Nizamiye”, i datës 27 Jumada al-Thani 1296 (27 qershor 1879), neni 50.

konkludente, mund të klasifikohet edhe si një masë disiplinore, që përafrohet me atë të shkarkimit.

Për këtë parashikim, ekziston në dokumente një rast praktik, nga ku ka rezultuar se Trupa Disiplinore e Gjyqit të Diktimit, ka mbajtur kundrejt një gjyqtari, qëndrimin se, *“Krye-prokurorija, në bazë të urdhnit nr. 2115/I, datë 13.12.1924 të Ministriës së Drejtësisë, me komunikatën e sajë nr.13, datë 13/XII/1924 i ka sjellë e Gjyqit të Diktimit aktet e gjyqtarit paqtues të Fierit z. J. S. pa marrë leje dhe pa lajmërue fare Ministriën ka lane detyrën dhe tue tregue si shkak lëngatën, ka vajtë në Elbasan për me merrë fëmijët e tij. Aktet e ksajë çashtje janë protokolue në nr. 1 të radhorit të veçantë e për me ba shqyrtime të duhuna në bazë të nenit 5 të ligjës më datë 22/VIII/1922 mbi përmirsim të Kreut IV të Pr. Nd. Krye-prokurorija me komunikatën e vetë në fjalë ban kët diftim mbi çashtje prej urdhnit të sipërm të Ministriës së Drejtësisë e prej telegramave të Prokurorivët Berat e Elbasan rezulton se gjyqtari paqtues i Fierit pa pasun lejen e pa lajmërue fare Ministriën ka lonë detyrën e ka vojte ne Elbasan, kjo vepër anti-disiplinore sjell dënim mb. art .50 të organizimit të gjyqevet, kërkojme të vendohet nevoja e gjyqimit për J. S.*

*Si u lexuen e u shqyrtuen të gjitha aktet çashtja u kuvendue me konkluzion: Nga korrenspondensa e rrjedhun merret vesht se Gjykatsi i Fierit tue u mbështet rraportit mjekut, pa marrë leje prej Ministriës ka lanë detyrën e shkue në Elbasan 8 ditë; sado qi sëmundja e tij vërtetohet me raportin e mjekut të Fierit, porë largim i tij nga detyra pa marrë leje nga Ministria formon një faj disiplinuer. Prandaj në bazë të nenit 50 të ligjës së organizimit të gjyqevet u vendos prerja e rrogës për 8 (tetë) ditët e mungue në detyrë”.*²⁹

Përsa i përket procedurës që ndiqej pas inspektimit, duke interpretuar bashkërisht, nenet 49 dhe 90 të këtij ligji, rezultonte se rasti për procedimin disiplinor të gjyqtarit, i dërgohej Gjykatës së Kasacionit dhe ishte ajo, që vendoste për dhënien e masës disiplinore.

Një rast tjetër, që lidhet me ndryshimet që i ishin bërë më vonë këtij ligji, por në fuqi, në kohën që Shqipëria shpalli pavarësinë, pra të zbatueshme edhe për ne, vlen të përmendet rasti kur brenda një viti, më shumë se gjysma e vendimeve të dhëna nga një gjykatë e shkallës së parë, ose nga një gjykatë apeli, ndryshoheshin apo prisheshin, sipas llojit të çështjeve. Kryetarët e Gjykatës së Kasacionit duhej t’i kërkonin Ministrisë së Drejtësisë reformimin e gjykatës, dhe gjyqtarët e asaj gjykate do të shkarkoheshin pas autorizimit të dhënë nga kjo ministri.³⁰

Në një rast të evidentuar në burimet arkivore rezulton, se në vitin 1927, në zbatim të kësaj dispozite, Ministria e Drejtësisë i dejtotej Kryeprokurorisë pranë Gjyqit të Diktimit, duke i kërkuar: *“Të na dërgohen*

29. Vendimi nr. 1, datë 11.04.1925 i Trupit Hetimor të Gjykatës së Diktimit, marrë nga *“Vendime të Gjykatës së Lartë – 110 vjet përvojë gjyqësore”*, botim i Gjykatës së Lartë, Tiranë 2023, fq.58.

30. Shtesë e datës 29 Sha’ban 1304 (17 maj 1888).

*listat e atyne gjyqeve të cillve mbrenda vjetit të kaluam i janë prishë ma tepër se gjysa e akt-gjykimeve si të degës civile ashtu edhe të degës penale, dhe në bazë të shtojcës së nenit 42 të ligjs s'organizimit të gjyqeve, d.304 turqisht, të na njoftohet ideja e kryetarve mbi masat qi do të shifen të nevojshme me u marr ndaj atyne gjyqtarve”.*³¹

Pasi u mor informacioni nga *Gjyqi i Diktimit*, rezultojnë si përgjigje dy tabela statistikore, një për gjykatat e shkallës së parë dhe një statistikë për gjykatat e paqit, të cilat ia vlen të analizohen më poshtë.

Statistikë e veprimeve të gjyqtarëve të Gj. Shk. së I-rë.³²

Nr.	Gjyqtari		Gjykata	Prishur	Ligjëruar
1	Haki	Mahmuti	Berat	2	0
			Gjirokastër	0	1
2	Hysejn	Sula	Berat	1	0
3	Kolë	Dhimitri	Berat	1	0
4	Irakli	Noçka	Tiranë	4	0
5	Theodhor	Papamihajli	Tiranë	3	0
6	Ferid	Çene	Vlorë	4	2
7	M.	Sulo	Vlorë	6	3
8	Qazim	Dede	Vlorë	4	1
9	Andrea	Saatçiu	Korçë	2	0
10	Kahreman	Frashëri	Korçë	3	3
11	M.	Boriçi	Vlorë	13	16
12	Vasil	Haxhijani	Shkodër	2	1
			Vlorë	4	12
13	B.	Benussi	Vlorë	8	14
14	Genti	Tafili	Vlorë	0	1
			Korçë	2	0
15	R.	Kopliku	Shkodër	1	2
16	N.	Pepe	Shkodër	1	2
17	Izet	Leskoviku	Shkodër	1	3
18	Mustafa	Qenani	Gjirokastër	1	1
19	Koço	Bisha	Gjirokastër	2	3

31. AQSH, F.156, viti 1926, D.742, datë 01.02.1927, fl.1. Shkresa nr.146, datë 26.1.1927 i Ministrit të Drejtësisë, drejtuar Kryeprokurorisë së Gjyqit të Diktimit.

32. AQSH, F. 156, viti 1926, D. 742, datë 01.02.1927, fl. 2-3.

20	Asim	Borshi	Gjirokaštër	1	5
21	Ylvi	Kadiu	Gjirokaštër	1	1
22	Neki	Delvina	Vlorë	12	21
23	Teofika	Delvina	Elbasan	2	1
24	Enrik	Komasku	Vlorë	7	11
25	Andon	Kosmaçi	Elbasan	0	1
			Korçë	2	2
26	M.	Hoxha	Elbasan	1	1
27	Qazim	Dani	Gjirokaštër	1	1
28	N.	Venediku	Gjirokaštër	6	7
29	Fehim	Qorri	Gjirokaštër	1	1
30	Fuat	Fico	Korçë	3	3
31	F.	Emini	Gjirokaštër	2	1
32	Paolo	Sopiqoti	Vlorë	0	2
			Gjirokaštër	0	1
33	H.	Dervishi	Gjirokaštër	1	0
34	Abdurrahim	Tepelena	Tiranë	9	3
35	Petraq	Pilkati	Korçë	1	1
36	A.	Dino	Tiranë	1	0
37	F.	Bishka	Tiranë	1	1
			Gjirokaštër	1	1
38	Josif Haxhi	Mima	Shkodër	2	0
39	Nazif	Dobi	Shkodër	2	1
40	Spiro	Xhufka	Elbasan	1	0
			Berat	1	0
41	Xhafer	Hysejmi	Berat	1	0
42	Faik	Bregu	Tiranë	6	2
43	Thanas	Noti	Tiranë	6	3
44	Etëhem	Kopliku	Elbasan	1	0
45	R.	Prodani	Vlorë	1	0
46	Ramiz	Shehu	Korçë	2	0

Nga të dhënat e mësipërme rezulton se në vitin 1926, Shqipëria kishte gjithsej shtatë gjykata të shkallës së parë, të vendosura në qytetet kryesore të vendit, përkatësisht në Tiranë, Vlorë, Korçë, Shkodër, Berat, Gjirokaštër dhe Elbasan. Kjo shpërndarje e institucioneve gjyqësore

mbulonte gjeografikisht pjesën më të madhe të vendit, duke mundësuar një akses relativisht të barabartë në drejtësi për popullsinë e asaj kohe, megjithëse distancat dhe infrastruktura e kufizuar e asaj kohe, përbënte pengesa për disa rajone të largëta.

Në total në vitin 1926 u shqyrtuan 277 çështje nga gjykatat e shkallës së parë. Nga këto, 141 vendime u prishën nga gjykata më e lartë, pra 50.9% të rasteve, ndërsa 136 vendime u ligjëruan, që përfaqëson 49.1% të totalit. Ky raport tregon se më shumë se gjysma e vendimeve të marra nga gjykatat e shkallës së parë, nuk i qëndruan shqyrtimit nga ana e gjykatës më të lartë, e dhënë kjo që tregon një nivel të lartë të moszbatimit dhe interpretimit të ligjit në mënyrë korrekte.

Nga analiza e tyre rezultojnë disa të dhëna mbi performancën e gjykatave të shkallës së parë në Shqipërinë e asaj kohe, të cilat pasqyrohen më poshtë, të renditura sipas performancës së tyre:

- Gjykata e Shkallës së Parë Vlorë ka dhënë 142 vendime, që përfaqësojnë 51.2 për qind të totalit të vendimeve. Nga këto rezultojnë që ishin ligjëruar 83 vendime (58.5%) dhe prishur 59 të tilla (41.5%).
- Gjykata e Shkallës së Parë Gjirokastrë ka dhënë 40 vendime, që përfaqësojnë 14.5 për qind të totalit të vendimeve. Nga këto rezultojnë që ishin ligjëruar 23 vendime (57.5%) dhe prishur 17 të tilla (42.5%).
- Gjykata e Shkallës së Parë Shkodër ka dhënë 18 vendime, që përfaqësojnë 6.6 për qind të totalit të vendimeve. Nga këto rezultojnë që ishin ligjëruar 9 vendime (50%) dhe prishur 9 të tilla (50%).
- Gjykata e Shkallës së Parë Korçë ka dhënë 24 vendime, që përfaqësojnë 8.7 për qind të totalit të vendimeve. Nga këto rezultojnë që ishin ligjëruar 9 vendime (37.5%) dhe prishur 15 të tilla (62.5%).
- Gjykata e Shkallës së Parë Elbasan ka dhënë 8 vendime, që përfaqësojnë 2.8 për qind të totalit të vendimeve. Nga këto rezultojnë që ishin ligjëruar 3 vendime (37.5%) dhe prishur 5 të tilla (62.5%).
- Gjykata e Shkallës së Parë Tiranë ka dhënë 39 vendime, që përfaqësojnë 14 për qind të totalit të vendimeve. Nga këto rezultojnë që ishin ligjëruar 9 vendime (23%) dhe prishur 30 të tilla (77%).
- Gjykata e Shkallës së Parë Berat ka dhënë 6 vendime, që përfaqësojnë 2.2 për qind të totalit të vendimeve. Nga këto rezultojnë që nuk ishte ligjëruar asnjë vendim dhe të gjashta (100%) ishin prishur nga gjykata më e lartë.

Ky nivel i lartë i vendimeve të prishura, tregon disa problematika të sistemit gjyqësor të kohës, përfshirë mungesën e përvojës së gjyqtarëve, ndikimin e mundshëm të faktorëve jologjorë në vendimmarrje, apo edhe standardizimin e pamjaftueshëm të praktikave gjyqësore.

Në vijim paraqiten edhe statistikat që lidhen me *gjykatat e paqit*, në Shqipëri në vitin 1926, si më poshtë:

Statistikë e veprimeve të gjyqtarëve paqtues³³

Nr.	Gjyqtari		Gjykata	Prishur	Ligjëruar
1	Asim	Borshi	Përmet	2	2
			Libohovë	5	3
2	Shaqir	Hoxha	Përmet	5	2
			Korçë	1	0
			Bilishtë	8	6
3	Mersin	Lulashi	Tepelenë	0	1
4	Mustafa	Qenani	Elbasan	7	3
			Bilishtë	1	0
			Gjirokastër	10	15
5	Faik	Emini	Përmet	2	2
			Durrës	11	4
			Bilishtë	0	2
6	Tefik	Lamçe	Korçë	8	6
7	Ferdi	Kumbaro	Libohovë	0	1
8	Mehmet	Pajuni	Kavajë	8	3
9	Asaf	Emini	Tepelenë	1	0
			Fieri	1	0
10	Abdurrahim	Tepelena	Shkodër	42	10
11	Avni	Koka	Pogradec	1	0
12	Kolë	Gurakuqi	Pogradec	2	0
			Korçë	2	0
13	Ali	Tabaku	Durrës	1	0
14	Xhevdet	Mehqemeja	Peqin	1	0
15	Fevzi	Kumbaro	Fieri	3	2
16	Ymer	Malile	Delvinë	22	8
17	Namik	Jusufi	Konispol	1	0

33. AQSH, F. 156, viti 1926, D. 742, datë 01.02.1927, fl. 4-6.

18	Hajdar	Verçuni	Lezhë	1	2
			Krujë	2	1
19	Ylvi	Kadiu	Berat	6	5
			Gjirokastër	8	7
20	Jusuf	Skile	Fieri	0	1
			Gramsh	0	2
21	Izet	Leskoviku	Shkodër	1	0
22	Fehmi	Telepena	Tiranë	0	7
23	Abdyl	Mexhiti	Elbasan	21	16
24	Ragip	Konica	Tepelenë	1	2
			Lushnje	4	1
25	Dajlan	Novosela	Përmet	3	0
			Krumë	0	1
26	Myhtar	Zajmi	Dibër	12	3
27	Çile	Vreto	Kolonjë	6	0
28	Etëhem	Kopliku	Shkodër	25	13
29	Selami	Libohova	Pogradec	1	4
			Qukës	0	2
			Dibër	4	0
30	N.	Cico	Pogradec	2	0
			Gjirokastër	1	0
31	Emin	Xhango	Libohovë	4	1
32	Arif	Ahmeti	Pogradec	2	1
33	Hysjen	Topçiu	Lezhë	1	0
34	Sait	Vogli	Durrës	1	0
35	A.	Spahiu	Mallakastër	1	0
36	Tahsin	Dylgjeri	Durrës	0	1
			Bilisht	2	0
37	Vesel	Dobi	Kolonjë	3	1
			Tiranë	4	7
38	Nd.	Stavro	Përmet	2	1
39	Refail	Prodani	Korçë	16	13
40	Mehmet	Pengili	Krujë	3	5
41	S.	Noçka	Tepelenë	1	0
42	M.	Myftiu	Peqin	1	0

43	I.	Doku	Berat	4	3
44	S.	Cani	Dibër	1	0
45	Beqir	Gjergjani	Peqin	4	5
46	Dervish	Gjina	Lushnje	0	5
47	Irfan	Baçi	Fieri	0	1
48	Sh.	Sylejmani	Himarë	0	1
			Delvinë	1	0
49	T.	Lolo	Himarë	4	2
50	V.	Dauti	Dibër	0	1
			Kavajë	1	0
51	Faik	Monopati	Berat	10	7
52	M.	Sako	Libohovë	1	0
53	Salih	Hamzaj	Konispol	4	1
54	A.	Çaushti	Kurvelesh	1	0
			Qukës	2	1
55	Kasem	Bozgo	Shkodër	1	3
56	Selim	Sirri	Tiranë	4	5
			Lezhë	3	4
			Peqin	1	0
57	Leonidha	Kona	Kolonjë	4	1
58	Demir	Sokoli	Krumë	1	1
59	Faik	Vrioni	Skrapar	4	0
60	Gjon	Thaçi	Shkodër	2	2
			Lezhë	1	0
61	Jonuz	Tafaj	Kolonjë	6	3
62	N.	Labinoti	Elbasan	0	1
63	Tefik	Hysa	Libohovë	2	1
64	Fehim	Qorri	Shkodër	7	10
65	F.	Leskoviku	Bilishtë	1	0
66	Kahreman	Frashëri	Pogradec	1	2
67	Qazim	Dede	Bilishtë	1	0
68	Demir	Librazhdi	Korçë	0	2

Nga të dhënat e mësipërme rezulton se në vitin 1926, në Shqipëri funksiononin 32 *gjykata të paqit*, të shpërndara në të gjithë territorin e vendit. Ato ishin vendosur në qendra të rëndësishme administrative si

Shkodra, Tirana, Korça, Elbasani, Durrësi, Gjirokastra dhe Berati, por edhe në qytete më të vogla si Pogradeci, Peqini, Kruma, Libohova dhe Delvina. Kjo shpërndarje synonte të kishte një mbulim sa më të madh të vendit. Megjithatë, duke marrë parasysh infrastrukturën dhe mjetet e komunikimit të kohës, aksesit i qytetarëve në drejtësi, me shumë mundësi, mbetej i kufizuar, veçanërisht për zonat e largëta malore.

Sa i përket numrit të gjyqtarëve të paqit, në vitin 1926, Shqipëria kishte gjithsej 69 të tillë, një shifër relativisht e kufizuar për një vend me popullsinë dhe territorin e asaj kohe. Kjo shpërndarje tregon se në shumë raste, një gjyqtar i vetëm mbulonte disa zona, duke kufizuar më tej të drejtën për një proces gjyqësor të shpejtë dhe efikas.

Në total gjykatat e paqit kishin dhënë 585 vendime, nga të cilat 356 ishin prishur nga gjykata më e lartë (60.85%), ndërsa 229 ishin ligjëruar (39.15%). Një shkallë kaq e lartë e vendimeve të prishura, tregon se cilësia e gjykimit në gjykatat e paqit kishte mangësi të konsiderueshme, duke reflektuar mungesën e përgatitjes juridike të gjyqtarëve të asaj kohe.

Nga analiza e këtyre statistikave, rezultojnë disa të dhëna mbi performancën e gjykatave të paqit në Shqipërinë e asaj kohe, të cilat pasqyrohen më poshtë, të renditura sipas performancës së tyre:

- Gjykata e Paqit Gramsh ka dhënë 2 vendime, që përfaqësojnë 0.3 për qind të totalit të vendimeve, të cilat rezultojnë që të jenë ligjëruar të dyja.
- Gjykata e Paqit Tiranë ka dhënë 27 vendime, që përfaqësojnë 4.6 për qind të totalit të vendimeve. Nga këto rezultojnë që ishin ligjëruar 19 vendime (70.4%) dhe prishur 8 të tilla (29.6%).
- Gjykata e Paqit Krumë ka dhënë 3 vendime, që përfaqësojnë 0.5 për qind të totalit të vendimeve. Nga këto rezultojnë që ishin ligjëruar 2 vendime (66.6%) dhe prishur 1 të tilla (33.4%).
- Gjykata e Paqit, Lushnje, ka dhënë 10 vendime, që përfaqësojnë 1.7 për qind të totalit të vendimeve. Nga këto rezultojnë që ishin ligjëruar 6 vendime (60%) dhe prishur 4 të tilla (40%).
- Gjykata e Paqit, Qukës, ka dhënë 5 vendime, që përfaqësojnë 0.9 për qind të totalit të vendimeve. Nga këto rezultojnë që ishin ligjëruar 3 vendime (60%) dhe prishur 2 të tilla (40%).
- Gjykata e Paqit, Krujë, ka dhënë 11 vendime, që përfaqësojnë 1.9 për qind të totalit të vendimeve. Nga këto rezultojnë që ishin ligjëruar 6 vendime (54.5%) dhe prishur 5 të tilla (45.5%).
- Gjykata e Paqit Gjirokastrë ka dhënë 41 vendime, që përfaqësojnë 7 për qind të totalit të vendimeve. Nga këto rezultojnë që ishin ligjëruar 22 vendime (53.6%) dhe prishur 19 të tilla (46.4%).
- Gjykata e Paqit Lezhë ka dhënë 12 vendime, që përfaqësojnë 2.1 për qind të totalit të vendimeve. Nga këto rezultojnë që ishin

- ligjëruar 6 vendime (50%) dhe prishur 6 të tilla (50%).
- Gjakata e Paqit Fier ka dhënë 8 vendime, që përfaqësojnë 1.3 për qind të totalit të vendimeve. Nga këto rezultojnë që ishin ligjëruar 4 vendime (50%) dhe prishur 4 të tilla (50%).
 - Gjakata e Paqit Tepelenë ka dhënë 6 vendime, që përfaqësojnë 1.1 për qind të totalit të vendimeve. Nga këto rezultojnë që ishin ligjëruar 3 vendime (50%) dhe prishur 3 të tilla (50%).
 - Gjakata e Paqit Pogradec ka dhënë 16 vendime, që përfaqësojnë 2.7 për qind të totalit të vendimeve. Nga këto rezultojnë që ishin ligjëruar 7 vendime (43.8%) dhe prishur 9 të tilla (56.2%).
 - Gjakata e Paqit Korçë ka dhënë 48 vendime, që përfaqësojnë 8.2 për qind të totalit të vendimeve. Nga këto rezultojnë që ishin ligjëruar 21 vendime (43.7%) dhe prishur 27 të tilla (56.3%).
 - Gjakata e Paqit Berat ka dhënë 35 vendime, që përfaqësojnë 6 për qind të totalit të vendimeve. Nga këto rezultojnë që ishin ligjëruar 15 vendime (42.8%) dhe prishur 20 të tilla (57.2%).
 - Gjakata e Paqit Himarë ka dhënë 7 vendime, që përfaqësojnë 1.1 për qind të totalit të vendimeve. Nga këto rezultojnë që ishin ligjëruar 3 vendime (42.8%) dhe prishur 4 të tilla (57.2%).
 - Gjakata e Paqit Elbasan ka dhënë 48 vendime, që përfaqësojnë 8.2 për qind të totalit të vendimeve. Nga këto rezultojnë që ishin ligjëruar 20 vendime (41.6%) dhe prishur 28 të tilla (58.4%).
 - Gjakata e Paqit Bilisht ka dhënë 21 vendime, që përfaqësojnë 3.6 për qind të totalit të vendimeve. Nga këto rezultojnë që ishin ligjëruar 8 vendime (38%) dhe prishur 13 të tilla (62%).
 - Gjakata e Paqit Përmet ka dhënë 21 vendime, që përfaqësojnë 3.6 për qind të totalit të vendimeve. Nga këto rezultojnë që ishin ligjëruar 7 vendime (33.4%) dhe prishur 14 të tilla (66.6%).
 - Gjakata e Paqit Libohovë ka dhënë 18 vendime, që përfaqësojnë 3.1 për qind të totalit të vendimeve. Nga këto rezultojnë që ishin ligjëruar 6 vendime (33.4%) dhe prishur 12 të tilla (66.6%).
 - Gjakata e Paqit Peqin ka dhënë 12 vendime, që përfaqësojnë 2.1 për qind të totalit të vendimeve. Nga këto rezultojnë që ishin ligjëruar 5 vendime (33.4%) dhe prishur 7 të tilla (66.6%).
 - Gjakata e Paqit Shkodër ka dhënë 116 vendime, që përfaqësojnë 19.8 për qind të totalit të vendimeve. Nga këto rezultojnë që ishin ligjëruar 38 vendime (32.7%) dhe prishur 78 të tilla (67.3%).
 - Gjakata e Paqit Durrës ka dhënë 18 vendime, që përfaqësojnë 3.1 për qind të totalit të vendimeve. Nga këto rezultojnë që ishin ligjëruar 5 vendime (27.7%) dhe prishur 13 të tilla (72.3%).
 - Gjakata e Paqit Delvinë ka dhënë 31 vendime, që përfaqësojnë 5.3 për qind të totalit të vendimeve. Nga këto rezultojnë që ishin ligjëruar 8 vendime (25.8%) dhe prishur 23 të tilla (74.2%).

- Gjykata e Paqit Kavajë ka dhënë 12 vendime, që përfaqësojnë 2.1 për qind të totalit të vendimeve. Nga këto rezultojnë që ishin ligjëruar 3 vendime (25%) dhe prishur 9 të tilla (75%).
- Gjykata e Paqit Kolonjë ka dhënë 24 vendime, që përfaqësojnë 4.1 për qind të totalit të vendimeve. Nga këto rezultojnë që ishin ligjëruar 5 vendime (20.8%) dhe prishur 19 të tilla (79.2%).
- Gjykata e Paqit Dibër ka dhënë 21 vendime, që përfaqësojnë 3.6 për qind të totalit të vendimeve. Nga këto rezultojnë që ishin ligjëruar 4 vendime (19%) dhe prishur 17 të tilla (81%).
- Gjykata e Paqit Konispol ka dhënë 6 vendime, që përfaqësojnë 1.1 për qind të totalit të vendimeve. Nga këto rezultojnë që ishte ligjëruar 1 vendim (16.6%) dhe prishur 5 të tjera (83.4%).
- Gjykata e Paqit Skrapar ka dhënë 4 vendime, që përfaqësojnë 0.7 për qind të totalit të vendimeve dhe këto vendime janë prishur nga gjykata më e lartë.
- Gjykata e Paqit Kurvelesh ka dhënë 1 vendim, që përfaqëson 0.1 për qind të totalit të vendimeve dhe ky vendim është prishur nga gjykata më e lartë.
- Gjykata e Paqit Mallakastër ka dhënë 1 vendim, që përfaqëson 0.1 për qind të totalit të vendimeve dhe ky vendim është prishur nga gjykata më e lartë.

Nga të dhënat e mësipërme kuptohet, se aftësitë profesionale të shumicës së gjyqtarëve në atë kohë, nuk mundej që të klasifikoheshin si të kënaqshme. Është e kuptueshme, që pas këtyre të dhënave, pavarësisht parashikimit ligjor në fuqi në atë kohë, nuk u mor asnjë masë kundrejt tyre, pasi kjo do ta linte gjyqësorin pothuaj pa asnjë gjyqtar.

Ligjet e tjera që dolën në Shqipëri pas shpalljes së pavarësisë nuk e ndryshuan këtë pjesë të legjislacionit osman, që kishte të bënte me inspektimin, procedimin, përgjegjësinë dhe masat disiplinore të trajtuara më sipër. I tillë, *“Kanuni i Zhurisë”* (Kanuni i Jurisë) i datës 23 maj 1913,³⁴ miratuar nga Qeveria Kombëtare e Vlorës. Ky ligj, ndërkohë

34. Në mënyrë jo të drejtë, data e hyrjes në fuqi e Kanunit të Jurisë është konsideruar data 10 maj 1913, kur pretendohet që të jetë miratuar nga Qeveria e Vlorës, datë kjo e marrë në konsideratë për caktimin e “Ditës së drejtësisë” në vendin tonë, si edhe si datë për krijimin e Gjykatës së Lartë. Nëse i referohemi dokumenteve arkivore, rezulton një kopje, me shkrim dore e këtij Kanuni, e cila në fund mban datën 10 maj 1913, si edhe nënshkrimin e Ministrit të Drejtësisë të asaj kohe. Po në të njëjtën dosje arkivore ndodhet edhe një tjetër akt i miratuar nga Qeveria e Përkohshme e Vlorës dhe konkretisht *“Kanuni i Dëmeve”*, i cili në faqen e fundit përmban dhe një shënim, se ky akt u diskutua dhe u miratua në mbledhjen e Qeverisë. Ky shënim në fakt mungon për Kanunin e Zhurisë, i cili mund të vendosë në diskutim miratimin e këtij akti me datë 10 maj 1913. E themi këtë, sepse po nga burimet arkivore, në një tjetër dosje rezulton po i njëjti akt *“Kanuni Zhurisë”*,

që trajtonte procedura e gjykimit të veprave penale me juri, si edhe ankimin e këtyre vendimeve, nuk trajtonte aspekte të inspektimit dhe të procedimit disiplinor të gjyqtarëve apo prokurorëve. Njësoj edhe ligji tjetër i mëvonshëm, *“Kanuni i Gjykatave të Drejtësisë të Shqipërisë”*, i datës 4 qershor 1914, dekretuar nga Princ Vilhelm Vidi,³⁵ i cili përbëhej nga 33 nene dhe mund të ndahej në dy pjesë, ku në pjesën e parë (nenet 1-10), trajtohej organizimi gjyqësor dhe kompetencat e gjykatave, ndërsa pjesa e dytë, (nenet 11-31), rregullonte norma procedurale penale. Por ky dekret nuk kishte asnjë parashikim në lidhje me inspektimin, procedimin dhe përgjegjësinë disiplinore të gjyqtarëve dhe prokurorëve. Për më tepër ky ligj në nenin 32 të tij, parashikonte shprehimisht, se për çështje që nuk rregulloheshin prej tij zbatoheshin legjislacioni osman, duke mbetur pra ligji i cituar më sipër, ende në fuqi, edhe në këtë periudhë.

Ligji që u miratua në vitin 1919 nga Qeveria e Durrësit, përsëri merrej me organizimin e pushtetit gjyqësor, por jo me inspektime, procedime dhe përgjegjësi disiplinore të këtyre gjyqtarëve. Ligji i vitit 1921, nga ana e tij, u konceptua si një shtojcë e ligjit osman, ku u bënë rregullime të ndryshme, për organizimin e gjykatave dhe zyrave gjyqësore, por edhe ky ligj nuk kishte asnjë parashikim për aspekte të përgjegjësisë disiplinore.

Megjithëse në vitin 1922 u miratua *“Zgjanimi i Statutit të Lushnjës”*, e më tej në vitin 1923 u miratua ligji i datës 28 janar 1923 *“Mbi organizimin të gjykatave të drejtësisë”*, sërish nuk kishte rregullime në lidhje me statusin e magjistratëve, apo inspektimin dhe përgjegjësinë disiplinore të tyre. Kjo do të thoshte se për këto aspekte, mbeteshin në fuqi normat e vjetra osmane. Gjithashtu, pavarësisht se në vitin 1925 u miratua një tjetër Statut Themeltar, siç do të trajtohet më tej, parashikimet e tij kishin rregullime tranzitore, që penguan hyrjen e tyre në fuqi. Po kështu, Dekret-ligji i datës 2 maj 1925 *“Mbi organizimin e drejtësisë”*, duke mos u pranuar nga Parlamenti i kohës, siç do të trajtohet përsëri më tej, nuk qëndroi në fuqi më shumë se një muaj. Zhvillimet politike dhe juridike të kohës bënë që më pas këto parashikime të mos zbatohen kurrë, duke lënë juridikisht

shkruar me shkrim dore, i cili në fund ka shënimin *“U këndua në Këshillë të Ministrave në 23 maj 1913 dhe u pranua. Vërtetonte dhe nënshkruhet për ta përmbuarë”*. E vetmja mundësi për të përputhur këto dy akte, që ndodhen në Arkivin e Shtetit është që të pranojmë që me datë 10 maj 1913, ministri i drejtësisë i ka paraqitur si propozim Këshillit të Ministrave këtë akt, anëtarët e të cilit do të kenë marrë kohën e tyre për ta studiuar dhe në përfundim Qeveria e Vlorës e ka miratuar në mbledhjen e saj të datës 23 maj 1913. Kjo datë rezulton dhe në gazetën *“Përlindja e Shqipëniës”*, që në numrat e saj 15,16,17 dhe 18, në muajin mars 1914, ka botuar të plotë këtë Kanun. Më konkretisht në numrin 18, të datës 1/14 mars 1914, fq.5, rezulton e botuar data *“23 maj 1913”*, si data e miratimit të këtij akti ligjor. Për rrjedhojë kjo datë do të konsiderohet dhe si dita kur ky akt është miratuar. Shih AQSH, F. 155, V. 1913-1918, D. 37, datë 10.05.1913-13.05.1913, fl. 14 dhe D. 233, datë 23.05.1913, fl.14.

35. AQSH, F. 155, V. 1913-1918, D. 38.

dhe faktikisht në fuqi, legjislacionin osman të sipërcituar. Kjo duket qartë, si nga vendimi i *Gjyqit të Diktimit*, i vitit 1925, ashtu edhe korrespondenca e vitit 1927, që trajtonte vendimmarrjet e gjyqtarëve për vitin 1926. Kjo do të thotë, që ligji osman për gjyqësorin, sa i takon të paktën aspekteve të inspektimit, procedimit dhe përgjegjësisë disiplinore të gjyqtarëve dhe prokurorëve, qëndroi formalisht në fuqi deri në vitin 1929, kur hyri në fuqi ligji i ri i gjyqësorit.

2. Inspektimi dhe përgjegjësia disiplinore sipas “Zgjanimit të Statutit të Lushnjës” (1922)

Në vitin 1920, Kongresi i Lushnjës miratoi një dokument kushtetues, të titulluar “Bazat e Kanunores së Këshillit të Naltë”, por që në histori njihet si “Statuti i Lushnjës”. Ky akt kushtetues kishte vetëm 6 nene dhe nuk rregullonte asnjë aspekt për pushtetin gjyqësor apo sistemin e prokurorisë.

Duke qenë një akt kushtetues i paplotë, parlamenti i kohës në vitin 1922 miratoi një akt kushtetues më të plotë, por që bazohej dhe konsiderohej si vazhdim i “Statutit të Lushnjës”. Për këtë arsye, ai u quajt “Zgjanimi i Statutit të Lushnjës”.

Përsa i përket pushtetit gjyqësor, ky Statut parashikonte ndarjen e tij nga pushtetet e tjera,³⁶ emërimin e gjyqtarëve dhe prokurorëve nga Këshilli i Lartë i regjencës, sipas propozimit që vinte nga Këshilli i Ministrave, në bazë të një zgjedhjeje që bënte një komision i posaçëm. Ky komision përbëhej nga ministri i drejtësisë, që edhe e kryesonte, nga Sekretari i Përgjithshëm i Ministrisë së Drejtësisë, Kryetarët e Gjykatave të Diktimit, Kryeprokurori i Diktimit, si dhe kryetari i gjykatës tjetër më të lartë, që kishte selinë në kryeqytet. Cilësitë që duhej të kishin gjyqtarët dhe prokurorët do të caktoheshin me ligj.³⁷

Përsa i përket përgjegjësisë disiplinore, përcaktohej se një gjyqtar për asnjë arsye nuk mundej që të pushohej nga puna, veçse në bazë të një vendimi që mund të jepte Gjyqi i Diktimit për faje disiplinore.³⁸

Megjithatë, këto parashikime, si dhe të tjerat, që kishin të bënin me patundshmërinë e gjyqtarëve, gjykimin penal të tyre, si edhe papajtueshmërinë në funksionet e tyre do të zbatoheshin vetëm pas hyrjes në fuqi të ligjit të ri, që do të parashikonte cilësitë që duhej të kishin magjistratët dhe zbatoheshin vetëm 3 vjet pas hyrjes në fuqi të ligjit të ri.³⁹

36. Statuti i vitit 1922, neni 80.

37. Statuti i vitit 1922, neni 84.

38. Statuti i vitit 1922, neni 85.

39. Statuti i vitit 1922, neni 89.

Është e kuptueshme, që për vetë zhvillimet e kohës, këto parashikime, për shkak të kësaj norme, nuk hynë kurrë në fuqi. Gjithashtu, siç e përmend më sipër, ligji i datës 28 janar 1923 *“Mbi organizimin të gjykatave të drejtësisë”*, nuk kishte rregullime në lidhje me statusin e magistratëve, apo inspektimin dhe përgjegjësinë disiplinore të tyre.

3. Inspektimi dhe disiplina sipas Statutit Themeltar të vitit 1925 dhe Dekret-ligjit të datës 2 maj 1925 “Mbi organizimin e drejtësisë”

Në vitin 1925, Asambleja Kushtetuese shpalli Republikën dhe hartoi një akt kushtetues tjetër dhe konkretisht atë Statutin Themeltar të Republikës së vitit 1925. Ky Statut parashikonte pavarësinë e gjykatave,⁴⁰ mënyrën e emërimit të tyre, bazuar në propozimin e një komisioni që përbëhej nga Ministri i Drejtësisë, i cili e kryesonte dhe nga anëtarë, Sekretarin e Përgjithshëm të Ministrisë së Drejtësisë, Kryetarët dhe Kryeprokurorin e Gjyqit të Diktimit.⁴¹ Gjithashtu Statuti parashikonte palëvizshmërinë e gjyqtarëve dhe prokurorëve nga detyra,⁴² por garantonte vetëm gjyqtarët nga transferimet pa pëlqim.⁴³ Gjithashtu parashikoheshin edhe papajtueshmëria me funksionin,⁴⁴ si edhe paanshmëria politike.⁴⁵

Përsa i përket përgjegjësisë disiplinore, Statuti i vitit 1925, në nenin 103 të tij parashikonte se *“Nji gjyqtar, për as nji arsye nuk mund të pushohet nga puna kundër dëshirës së tij, veçse në bazë të nji gjykimi të dhanun prej nji gjykate kompetente apo të nji gjykimi të Gjykatës së Diktimit për faje dishiplinore.*

Nji gjyqtar nuk mund të thërritet në gjyq për akte qi i përkasin zyrës së tij pa vendimin e gjykatës së Diktimit. Vendimi i auktoritetit kompetent për të futunit nen akuzim të nji gjyqtari, sjellë me vete pezullimin e tij nga puna në rasat e parapame prej ligjës. Nji gjyqtar nuk mund të shpërngulet veçse në qoftë se dëfton ma parë me shkrim se e pëlqen vendin e ri.

Nji gjyqtar nuk mund të vëhet në pensjon kundër pëlqimit të tij veçse kur të ketë mbushen vjetët e shërbimit, apo të ketë kaptuem moshën e caktueme prej ligjes, ase kur sëmundje fizike a mendore e bajnë të pa zotin për shërbim. Në këtë rasën e mbrame të vomit e tij në pensjon, do të bahet në bazë të nji vendimi të dhanun nga gjykata e Diktimit.

Mënyra për të futunit nen akuzim e për gjykimin për faje dishiplinore të

40. Statuti neni 98.

41. Statuti, neni 102.

42. Statuti, neni 103.

43. Statuti, neni 104.

44. Statuti, neni 105.

45. Statuti, neni 106.

misvet të gjykatës së Diktimit, do të rregullohet me një ligjë të posaçme”.

Siç mund të shihet nga ky parashikim kushtetues, gjyqtari mundej të shkarkohej, ose si rezultat i një dënimi penal, ose si rezultat i një procedimi disiplinor, që vendosej nga Gjyqi i Diktimit. Nuk rezultonte që të kishte parashikime kushtetuese të ngjashme për prokurorët.

Referuar rasteve praktike, duket se këto parashikime nuk kanë gjetur zbatim, fakt ky që duket qartë në ndryshimet që u bënë në Gjyqin e Diktimit, ngjarje e ndodhur në vitin 1925 dhe u justifikua me arsyet e riorganizimit të këtij institucioni. Kështu, Gjykata e Diktimit u shpërbë me shkresë të ministrit të Drejtësisë së kohës, Petro Poga, i cili urdhëronte pushimin nga puna të të gjithë anëtarëve të dhomës së vetme të Gjykatës së Diktimit. Për shkak të riorganizimit të Gjykatës në dy degë, civile e penale (ministri) vendoste “... anulimin e gjyqit të Diktimit dhe formimin e tij në dega (civile e penale) Z. Juej për arsyna administrative pushoheni nga puna”.⁴⁶ Mesa duket, qëndrimi i Ministrit të Drejtësisë në atë kohë, bazohej në faktin, se neni 107 i Statutit të vitit 1925 parashikonte që “Vetëm gjyqtarët qi kanë cilësit e parapame prej ligjës qo do të bahet, gëzojnë të drejtat e caktueme në këtë kaptinë mbas tri vjetësh sherbimi”. Pra mbrojtja kushtetuese mbi gjyqtarët, shtrihej, vetëm mbas tre vjetësh shërbimi, kur gjyqtari ishte konfirmuar në detyrë si i përshtatshëm nga komisioni që parashikonte Statuti. Kjo tregon qartë, se kjo mbrojtje që parashikonte akti kushtetues i kohës në praktike mbeti pa efekt.

Në atë kohë doli edhe Dekret-ligji i datës 2 maj 1925 “Mbi organizimin e drejtësisë”, i cili parashikonte krijimin e gjykatave të shkallës së parë, që ngriheshin në çdo qendër nënprefekturë dhe prefekturë,⁴⁷ gjykatat e apelit, që ngriheshin në çdo qendër prefekturë⁴⁸ dhe Gjyqit i Diktimit, që ngrihej në Kryeqytet.⁴⁹

Sistemi i Prokurorisë nga ana tjetër, ndërtohej mbi bazë hierarkie, duke filluar nga Kryeprokurori që ndodhej pranë Gjyqit të Diktimit⁵⁰ dhe vijonte më tej me prokurorët pranë gjykatave të apelit,⁵¹ ligji nuk parashikonte prokurorë pranë gjykatave të shkallës së parë,⁵² por parashikonte që gjyqtarët e shkallës së parë, të mund të kryenin

46. Aurela Anastasi, “Gjykata e Diktimit në përsiatjet për kontroll kushtetues”, botuar në aktet e Konferencës Kombëtare, me temë “Praktika gjyqësore e Gjykatës së Lartë, nga identiteti kombëtar tek vlerat universale”, organizuar me datë 10.05.2023, me rastin e 110 vjetorit të krijimit të Gjykatës së Lartë, Tiranë 2023, fq. 56. Në këtë rast autorja i referohesh shkresës së Ministrit të Drejtësisë të datës 14.09.1925.

47. Dekret-ligji, i datës 2 maj 1925, nenet 1, 2 dhe 11.

48. Dekret-ligji, i datës 2 maj 1925, nenet 1, 4 dhe 12.

49. Dekret-ligji, i datës 2 maj 1925, nenet 1, 7 dhe 14.

50. Dekret-ligji, i datës 2 maj 1925, neni 8.

51. Dekret-ligji, i datës 2 maj 1925, neni 6.

52. Dekret-ligji, i datës 2 maj 1925, neni 30.

funkSIONET E prokurorit dhe për kryerjen e këtyre funksioneve vareshin administrativisht nga prokurorët e apelit.⁵³

3.1 Inspektimi

Legjislacioni i vitit 1925 i ngarkonte Kryeprokurorit dhe prokurorit pranë gjykatave të apelit detyrën e inspektimit, i cili parashikonte të drejtën e prokurorëve, të kontrollit ndaj gjykatave dhe zyrave përkatëse, që ato kishin në varësi.⁵⁴ Kështu, Kryeprokurori, nëse vërente se një nëpunës i drejtësisë, koncept ky ku përfshiheshin edhe gjykatësit, meritonte lavdërime apo qortime, ose ndëshkim disiplinor, i drejtohej ministrit të drejtësisë, si dhe kryente veprimet sipas ligjit, për fajet ligjore të nëpunësve të drejtësisë.⁵⁵ Gjithashtu edhe prokurorët e apelit, në qarqet e tyre, nëse konstatonin veprime të kundërligjshme, ose të parregullta, pasi të bënin hetimet përkatëse i drejtoheshin ministrit të drejtësisë, për të kryer veprimet dhe marrjen e masave përkatëse.⁵⁶

Legjislacioni i asaj kohe parashikonte që gjyqtarët dhe prokurorët, mund të pushoheshin nga detyra, për faje disiplinore që gjykoreshin nga Gjyqi i Diktimit, përveç pushimit që vendosej nga një komisioni që zgjidhte gjyqtarët dhe që ekzekutohej nëpërmjet Ministrit të Drejtësisë.⁵⁷

Gjithashtu parashikohej më tej, detyrimi që kishin prokurorët për të njoftuar pa vonesë Ministrin e Drejtësisë, për shkeljet që vërenin në veprimtarinë gjyqësore, përndryshe do të mbanin dhe vetë përgjegjësi disiplinore.⁵⁸

3.2 Përgjegjësia dhe masat disiplinore

Siç u evidentua më sipër, Statuti parashikonte se një gjyqtar mund të shkarkohej kur dënohej për vepra penale apo për shkelje disiplinore. Nga ana tjetër ky dekret-ligj, parashikonte shkarkimin e gjyqtarëve dhe prokurorëve, kur kryenin vepra penale që lidheshin më detyrën, si dhe vepra të tjera të zakonshme.⁵⁹

Më tej, vetëm për gjyqtarët parashikohej, që nga ana e tyre nuk duhej të cenohej detyra, në asnjë mënyrë, si edhe detyrimi i tyre për të ruajtur dhe mos cenuar dinjitetin gjyqësor, brenda dhe jashtë orarit zyrtar.⁶⁰ Disa prej këtyre veprimeve parashikoheshin nga vetë dekret-ligji, si pranimi i

53. Dekret-ligji, i datës 2 maj 1925, neni 21.

54. Dekret-ligji, i datës 2 maj 1925, neni 25.

55. Dekret-ligji, i datës 2 maj 1925, neni 22.

56. Dekret-ligji, i datës 2 maj 1925, neni 23.

57. Dekret-ligji, i datës 2 maj 1925, neni 51.

58. Dekret-ligji, i datës 2 maj 1925, neni 65.

59. Dekret-ligji, i datës 2 maj 1925, neni 51.

60. Dekret-ligji, i datës 2 maj 1925, neni 59.

miqve në zyre, i cili ishte i ndaluar,⁶¹ si edhe detyrimi për mbajtjen sekret të veprimeve të brendshme të zyrës që drejtonin.⁶² Këto dy raste, që mund të klasifikoheshin si cenim i dinjitetit gjyqësor dhe mospërmbushje e rregullt e detyrës nuk ishin shteruese, por tregonin një aspekt të veçantë, që ligjvënësi i kohës ka dashur ta nxjerrë në dukje.

Një tjetër rast, që duket se rrjedh nga legjislacioni osman ishte edhe parashikimi, që kur një gjyqtari i prisheshin më shumë se gjysma e vendimeve nga një gjykatë më e lartë, apo kur më shumë se gjysma e vendimeve që kishte dhënë nuk kishin mundësi ekzekutimi, atëherë Ministria e Drejtësisë vendoste marrjen e masës disiplinore të pushimit nga detyra.⁶³

Nga burimet arkivore rezulton, që nga ana e Ministrisë së Drejtësisë, e vënë në lëvizje me ankesa nga persona të ndryshëm janë bërë inspektime në këtë kohë, për sjellje të pahijshme të gjyqtarëve, moszgjidhje të drejtë të çështjeve, si edhe ishte vënë në lëvizje Kreu i Shtetit.⁶⁴

Masat disiplinore që parashikoheshin nga ligji ishin: i) *qortim më shkrim, të premit e një sasi të rrogës deri në dy muaj*, iii) *të zbriturit e gradës dhe iv) pushimi definitiv nga puna*.⁶⁵ Dekreti-ligji parashikonte që këto masa duhej që të jepeshin në mënyrë proporcionale, sipas rëndësisë së veprave të gjyqtarëve.⁶⁶ Gjithashtu, për atë që ulej në detyrë, pra ulej në gradë, ligji parashikonte, si dënim plotësues, mosdhënien e shpenzimeve të udhëtimit.⁶⁷

Megjithatë këto parashikime nuk u bënë me ligj të miratuar nga Parlamenti i kohës, por me Dekret-Ligj, për të cilin Statuti në nenin 88 të tij parashikonte, se *“Kur trupat legjislative ndodhen në pushim, Qeverija ka të drejtë me bamë dekret ligjë; por këto do t’i parashtrohen pushtetit legjislativ në fillim të sesjonit t’afërmë për shqyrtim e pranim. Në qoftë se nuk paraqiten ose nuk pranohen, quhen vetiu të rrëxueme.”*

Ndodhur në këto kushte, ky akt do të duhej që të miratohej edhe nga Parlamenti i kohës, por këtu procesi nuk u finalizua. Kështu, ky Dekret-ligj, sipas disa deputetëve, paska sjellë probleme të shumta në administrimin e drejtësisë dhe ministri i drejtësisë ka dashur ta pezullojë zbatimin e tij, nëpërmjet një qarkoreje, por që u refuzua nga ana e gjykatave. Ndodhur përballë kësaj situatë, në Dhomën e Deputetëve, u paraqit nga një grup deputetësh,⁶⁸ një projekt-ligj, titulluar *“Mbi rivumjen*

61. Dekret-ligji, i datës 2 maj 1925, neni 62.

62. Dekret-ligji, i datës 2 maj 1925, neni 66.

63. Dekret-ligji, i datës 2 maj 1925, neni 67.

64. AQSH, F. 155, D. I-131, datë 03.03.1925-15.12.1925.

65. Dekret-ligji, i datës 2 maj 1925, neni 60.

66. Dekret-ligji, i datës 2 maj 1925, neni 61.

67. Dekret-ligji, i datës 2 maj 1925, neni 64.

68. Deputetët që e propozuan ishin M. Tutulani, R. Matja, H. Vroni, H. Muftiu, Xh. Ypi, K. Radovicka, Q. Dëshnica, H. Biçaku, H. Toska, V. Bamiha dhe Dr. Gjini.

në zbatim të organizimit të mëparshëm të gjykatave", në bazë të të cilit rivendoseshin organizimi i vjetër gjyqësor në Shqipëri, pra rregullimet ligjore, përpara Dekret-Ligjit të datës 2 maj 1925. Me paraqitjen e raportit nga Komisioni i Drejtësisë, Dhoma e Deputetëve e miratoi atë, po në të njëjtën mbledhje,⁶⁹ ndërsa Senati e miratoi atë dy ditë më vonë.⁷⁰

Nga sa më sipër, rezulton se ky Dekret-ligj mbeti më shumë një tentativë, duke qëndruar në fuqi legjislacioni i vitit 1923, si edhe aktet e tjera të periudhës osmane, që u trajtuan më sipër në këtë punim.

4. Inspektimi dhe disiplina sipas Statutit Themeltar të vitit 1928 dhe ligjit të datës 2 shkurt 1929, "Mbi Organizimin e Drejtësisë"

Në vitin 1928, u shpall në atë kohë e ashtuquajtura monarki dhe për këtë arsye u hartua Statuti Themeltar i Mbretërisë i vitit 1928, i cili parashikonte pavarësinë e gjyqtarëve,⁷¹ si edhe parashikohej palëvizshmërinë e tyre nga detyra.⁷² Megjithatë, ndryshe nga Statuti i mëparshëm, ky Statut, çështjet e disiplinës ia delegonte rregullimeve ligjore.

Bazuar në këto parashikime, si edhe në kuadër të reformave të ndryshme që po bëheshin në legjislacinin shqiptar, ku spikatën hartimi dhe miratimi i Kodit Penal, Kodit Civil dhe shtojcës së dytë të Procedurës Civile, u pa i nevojshëm edhe hartimi i një ligji të ri të organizimit të sistemit të drejtësisë, i cili u miratua nga Parlamenti i kohës me datë 02.02.1929.⁷³

Ligji i datës 02.02.1929, "Mbi organizimin e Drejtësisë", parashikonte sistemin e gjykatave të zakonshme, që përbëheshin nga Gjykata e Paqit, që vendosej në qendrat e çdo prefekturë dhe nënprefekturë dhe që gjykonte kundërvajtjet penale dhe delikte për të cilat parashikohej dënim me gjobë, deri në 4 000 franga ari. Në fushën civile shqyrtonin paditë me objekt me vlerë deri në 2 000 franga ari, si edhe paditë për detyrimin për ushqim, paditë posedimore etj. Gjykata e shkallës së parë gjykonte çështjet civile me vlerë nga 2 000 deri në 6 000 franga ari, ndërsa në fushën penale gjykohehin të gjitha fajet, që nuk përbënin delikte të rënda. Gjykatat kolegjiale gjykonin çështje penale për të cilat ligji parashikonte

69. Procesverbal i seancës parlamentare të Dhomës së Deputetëve, të datës 13 qershor 1925, botuar nga Kuvendi i Shqipërisë, në Bisedime Parlamentare, nr. 1 i vitit 1925, Tiranë 2015, fq. 413 dhe 415.

70. Procesverbal i seancës parlamentare të Senatit, të datës 15 qershor 1925, botuar nga Kuvendi i Shqipërisë, në Bisedime Parlamentare, nr. 2 vitit 1925, Tiranë 2015, fq. 325.

71. Statuti i vitit 1928, neni 118.

72. Statuti i vitit 1928, neni 120.

73. Fletorja Zyrtare nr. 6, datë 13 shkurt 1929, fq. 1-11.

dënim me gjobë mbi 4 000 franga ari, si edhe çështje civile me objekt të pavlerësuar apo me vlerë mbi 6 000 franga ai, shumë e cila më vonë u ul në 2 500 franga ari. Në majë të këtij sistemi ishte Gjyqi i Diktimit, i cili ndahej në degën civile dhe në degën penale, por mund të gjykonte edhe në Këshillin e Përgjithshëm.⁷⁴

Përsa i përket sistemit të prokurorisë, ai organizohej në varësi të Ministrit të Drejtësisë, dhe kishte një Kryeprokuror pranë gjyqit të diktimit, i cili kishte në varësi edhe të gjithë prokurorët e tjerë, që organizoheshin pranë gjykatave më të ulëta.⁷⁵ Ky ligj nuk kishte parashikime për procedimin disiplinor të prokurorëve dhe për rrjedhojë ata i nënshtroheshin rregullave që ekzistonin për punonjësit e tjerë të administratës.

Ligji parashikonte si një organ të rëndësishëm për menaxhimin e sistemit gjyqësor, Këshillin e Epërm Gjyqësor, i cili përbëhej nga Ministri i Drejtësisë, kryetarët e Degës Civile dhe Penale të Gjyqit të Diktimit, Kryeprokurori i Shtetit, Sekretari i Përgjithshëm i Ministrisë së Drejtësisë dhe kryesohej prej Ministrit të Drejtësisë.⁷⁶ Siç do të trajtohet dhe më tej, në rastin kur një gjyqtar procedohej për t'u "pushuar", këtij organi i shtoheshin dhe dy anëtarë të Gjyqit të Diktimit, që zgjidheshin nga Ministri i Drejtësisë.⁷⁷ Vendimet merreshin me shumicë relative të votave dhe në rast barazie votash, vendoste ajo e Ministrit.⁷⁸

4.1 Inspektimi dhe procedura disiplinore e gjyqtarëve

Ky ligj, që në nenin 1 të tij, parashikonte si pjesë e organikës së Ministrisë të Drejtësisë, edhe "inspektorin", i cili kishte detyrë që të inspektonte sipas urdhrit të Ministrit, të gjitha gjykatat, prokuroritë, si edhe zyrat e tjera që lidheshin me to dhe të raportonte përfundimet. Ligji kërkonte që mënyra e inspektimit duhej të përcaktohej me një rregullore të posaçme dhe deri sa të hynte në fuqi kjo rregullore, inspektimi do të realizohej sipas udhëzimeve të Ministrit të Drejtësisë.⁷⁹ Raporti i inspektorit i dorëzohej Sekretarit të Përgjithshëm të Ministrisë dhe ky i fundit ia paraqiste atë Ministrit të Drejtësisë.⁸⁰

Për të qenë inspektor i drejtësisë, një person duhej që të ishte shtetas shqiptar, të gëzonte të drejtat civile dhe politike, të dinte shkrim dhe lexim të gjuhës zyrtare, të mos kishte qenë i dënuar më heqje lirie më

74. Aurela Anastasi, *Historia e të drejtës kushtetuese në Shqipëri, 1912 – 1939*, Shtëpia botuese "Dajti 2000", Tiranë 2018, fq. 178-179.

75. Neni 44.

76. Neni 63

77. Neni 90.

78. Neni 63.

79. Neni 3.

80. Neni 2.

shumë se një vit, për falsifikim, vjedhje, mashtrim, keqpërdorim besimi, ose për fajë kundër zakoneve të mira, të kishte sjellje morale të mire,⁸¹ të ishte paktën 30 vjeç, i diplomuar në drejtësi, të kishte aftësi profesionale të provuara, si edhe të zotëronte një prej katër gjuhëve të huaja, anglisht, frëngjisht, italisht dhe gjermanisht.⁸²

Inspektori merrte pjesë gjithashtu në Mbledhjen e Këshillit të Përgjithshëm të Gjyqit të Diktimit, kur shqyrtoheshin kandidaturat për gjyqtarë.⁸³ Inspektori ishte edhe anëtar i Këshillit të Epërm Gjyqësor, i cili merrej me statusin e gjyqtarëve, si dhe me çështje të administrimit të shërbimeve gjyqësore dhe të prokurorisë.⁸⁴

Ligji parashikonte që inspektimi mbi gjyqtarët, të realizohej nga Ministri i Drejtësisë (përmes inspektorit) dhe nga Kryeprokurori, në mënyrë të pavarur nga njëri tjetri.⁸⁵ Gjithashtu, ligji parashikonte, që nëse një gjyqtar procedohej penalisht dhe në fund rezultonte i pafajshëm ose çështja pushohej, atëherë ishte e nevojshme fillimi i një procedimi disiplinor për të verifikuar deri në fund faktet konkrete, nëse mund të sillnin apo jo përgjegjësi disiplinore.⁸⁶

Nëse gjatë procedimit disiplinor gjyqtari jepte dorëheqjen, pushohej edhe procedimi disiplinor, por në rast se ky person kërkonte që të rrimërohej në të ardhmen, kjo nuk mundej të bëhej pa rifilluar dhe shqyrtuar procedimi i mëparshëm disiplinor.⁸⁷

Ligji parashikonte disa organe që mund të jepnin masa disiplinore dhe të drejtën e ankimit në disa raste. Kështu masa disiplinore e “*vërejtjes*”, “*qortimit*” apo “*mbajtjes së pagës deri në 5 ditë*”, jepej nga ana e Ministrit të Drejtësisë. Për masën *vërejtje*, ligji parashikonte një procedurë, e cila realizohej me shkrim, ku Ministri i Drejtësisë, e njoftonte gjyqtarin për shkeljet e pretenduara dhe ky i fundit duhej që të përgjigjej me shkrim.⁸⁸ Për rastet e tjera nuk parashikohej një procedurë e tillë. Për këto masa, gjyqtari kishte të drejtë që të ankohej brenda 10 ditëve, në Këshillin e Epërm Gjyqësor, i cili vendoste përfundimisht.⁸⁹

Për të vërtetuar shkeljet disiplinore që sillnin si pasojë “degradimin” e gjyqtarëve, ligji parashikonte, që duhej të dorëzohej një raport ose nga inspektori i drejtësisë, ose nga Kryeprokurori. Pra vërehet se inspektimi i gjyqtarëve realizohej nga dy subjekte. Inspektori, shkeljet disiplinore, mund t’i vërente gjatë inspektimeve, që kryente me urdhër të Ministrit të

81. Neni 33.

82. Neni 10.

83. Neni 31.

84. Neni 63.

85. Neni 95.

86. Neni 96.

87. Neni 95.

88. Neni 80.

89. Neni 90.

Drejtësisë. Kurse Kryeprokurori, mund të konstatonte shkelje disiplinore nga ana e gjyqtarëve, nga raportet që mund t'i vinin nga prokurorët pranë gjykatave më të ulëta, si edhe nga vetë shqyrtimi i çështjeve që ai bënte, si përfaqësues i shtetit në gjykimet, që bëheshin në Gjyqin e Diktimit. Në këtë rast ishte detyrim i tij, që të raportonte tek Ministri i Drejtësisë. Megjithatë, në këto raste, kërkohej edhe një shkresë, sipas rastit, nga kryetarët e degëve të Gjyqit të Diktimit. Sidoqoftë dispozita kërkonte që ky raportim të miratohej nga Këshilli i Epërm Gjyqësor.⁹⁰

Masa disiplinore e "*pezullimit nga detyra apo e pagës*", si edhe "*pushimi*" kur ishte i detyrueshëm, jepej nga Këshilli i Epërm Gjyqësor, vendimi i së cilit ishte i pakundërshtueshëm. Përsa i përket rasteve të tjera të pushimit, ato vendoseshin nga Këshilli i Epërm Gjyqësor, por në këtë rast, këtij Këshilli i shtoheshin dhe nga një anëtar i degës civile dhe penale të Gjyqit të Diktimit, që zgjidheshin prej Ministrit.⁹¹

Pra siç mund të konstatohej, Këshilli i Epërm Gjyqësor ⁹² kishte juridiksion disiplinor për të gjithë gjyqtarët, me përjashtim të atyre të gjyqit të Diktimit.

Sa i takonte gjyqtarëve të Gjyqit të Diktimit, përsëri kompetent ishte Këshilli i Epërm Gjyqësor, por me disa dallime. Për tre masat disiplinore të para dhe konkretisht i) *vërejtje*, ii) *qortim*, iii) *humbja e së drejtës së gradimit*, kompetent ishte vetë Këshilli i Epërm Gjyqësor. Ndërsa për tre masat e tjera dhe konkretisht iv) *pezullimi nga detyra ose paga*, v) *degradimi*, vi) *pushimi*, ato merreshin nga Këshilli i Epërm Gjyqësor, por vetë gjyqtari, që i ishte dhënë një masë të tillë apo Ministri i Drejtësisë, kishin të drejtë që të ankoheshin në Këshillin e Ministrave. Ky i fundit duhej të merrte vendim brenda një jave nga momenti që i përcilleshin aktet, përndryshe vendimi i Këshillit të Epërm Gjyqësor bëhej i formës së prerë.⁹³

Përsa i përket procedurës që ndiqte Këshilli i Epërm Gjyqësor, parashikohej se prej tij, në vlerësimin e fakteve që mund të sillnin përgjegjësinë disiplinore, nuk ishte i lidhur me rregullat ligjore, por ndiqte ndërgjegjen dhe merrte parasysh detyrën e kujdesin që duhej treguar për prestigjin dhe dinjitetin e trupës gjyqësore. Edhe në rast se nuk kishte prova të mjaftueshme që vërtetonin fajësinë e gjyqtarit, por gjithsesi rezultonte se ai kishte humbur në opinionin publik, nderimin, besimin dhe konsideratat që kërkonte pozicioni i tij, Këshilli i Epërm mundej t'i propozonte Ministrit të Drejtësisë, pushimin e tij nga detyra.⁹⁴

90. Neni 85.

91. Neni 90.

92. Neni 91.

93. Neni 92.

94. Neni 93.

4.2 Përgjegjësia dhe masat disiplinore

Ky ligj, në mënyrë të përgjithshme parashikonte, që gjyqtarët mbanin përgjegjësi disiplinore, i) *për mospërbushje të rregullt të detyrave*, ii) *kryerjen e veprimeve të tilla, brenda ose jashtë detyrës që cenojnë besimin apo kompromentonin prestigjin e pushtetit gjyqësor*.⁹⁵

Masat disiplinore, që u përmendën edhe më sipër, që parashikonte ligji ishin i) *vërejtje*, ii) *qortim*, iii) *humbja e së drejtës së gradimit*, iv) *pezullimi nga detyra ose paga*, v) *degradimi*, vi) *pushimi*.⁹⁶

“Vërejtja” jepej si masë disiplinore, kur gjyqtari kishte mungesa të lehta në detyrë dhe i vihej në dukje kjo “mangësi”, me porosinë që të mos e përsëriste më.⁹⁷

“Qortimi” jepej kur gjyqtari tregonte në detyrën e tij neglizhencë, parregullsi, pakujdesi, sjellje të ashpër ose mangësi të tjera, që nuk klasifikohen si të lehta, ose kur i ishte dhënë dy herë masa “vërejtje”.⁹⁸

“Humbja e së drejtës së gradimit”, i jepej gjyqtarit, nëse ai kishte marrë dy herën masën disiplinore “qortim”, ose për një faj disiplinor të rëndë, që çmohej prej Këshillit të Epërm Gjyqësor. Kjo masë hiqej nëse gjyqtari kishte sjellje të lavdërueshme për të paktën tre vjet.⁹⁹

“Pezullimi nga detyra ose paga”, jepej për një kohë nga 5 ditë deri në një vit, duke sjellë pezullimin të detyrës dhe të pagës. Megjithatë, kjo masë mund të jepej vetëm pjesërisht, duke mbajtur deri në gjysmën e pagës, por duke vijuar gjyqtari që të mbetej në detyrë.¹⁰⁰

Gjyqtarit, përveç dhënies së këtyre tre masave të mësipërme, me vendim të Këshillit të Epërm Gjyqësor, mund t’i shtohej edhe masa plotësuese, e transferimit.¹⁰¹

“Degradi” ose ulja në detyrë, jepej në rast se gjyqtarit i vërtetohej për herë të parë një paaftësi në përmbushjen e detyrave, ose sjellje që nuk përputhej me famën, nderin, dinjitetin dhe prestigjin gjyqësor, ku përfshiheshin prija e alkoolit në vende publike, sjellje kundër zakoneve të mira, luajtja e bixhozit, qoftë edhe për zbavitje.¹⁰²

Masa e fundit dhe me e rënda, ajo e “pushimit”, jepej sipas rastit në mënyrë detyruese, ose në bazë diskrecioni. Kështu, kjo masë jepej në mënyrë detyruese, nëse gjyqtari ishte dënuar për një vepër penale me burgim më shumë se tre vjet, si edhe nëse gjyqtari dënohej me burgim të rëndë, burgim, internim, ose për vepra penale që kishin të bënin me falsifikimin, vjedhjen,

95. Neni 78.

96. Neni 79.

97. Neni 80.

98. Neni 81.

99. Neni 82.

100. Neni 83.

101. Neni 84.

102. Neni 86.

keqpërdorimin e besimit, apo atentat kundër zakoneve të mira.¹⁰³ Kjo masë mund të jepej gjithashtu, nëse gjyqtari dënohej për vepra të tjera penale, kur ky dënim cenonte dinjitetin e detyrës së gjyqtarit, kur me sjelljen e tij ai ka komprometuar prestigjin e tij apo të trupës gjyqësore ku merrte pjesë, kur është dënuar tri herë me masën e “qortimit” apo të “humbjes së të drejtës së gradimit”, dy herë për masën disiplinore të “pezullimit nga detyra apo paga”, ose kur ka përsëritur të njëjtën shkelje për të cilën ishte ndëshkuar më parë, masa e “degradimit”.¹⁰⁴

Rast tjetër kur vendosej masa e “pushimit” ishte kur gjyqtari njihej botërisht në vendin ku ushtronte detyrën, se ishte pijanec, lojtar bixhozi, kryente sjellje kundër zakoneve të mira, si edhe kur provohej se kishte vepruar qëllimisht për të shtyrë dhe vonuar çështjet, që gjykonte.¹⁰⁵

Ligji parashikonte në disa dispozita të tjera, veprimet që nuk duhej të kryente gjyqtari dhe masën disiplinore konkrete që jepej në atë rast. Duke analizuar këto dispozita të tjera ligjore, veçanërisht ato me papajtueshmërinë e gjyqtarit, rezultonte se konsiderohej shkelje disiplinore, nxjerrja e sekretit hetimor dhe gjyqësor,¹⁰⁶ si edhe parashikohej gjithashtu si sjellje e dëmshme, marrja e informative private për çështjet që gjykonin ose t’u kërkohej personave të tjerë që të hartonin akte gjyqësore. Në këtë rast masa disiplinore jepej sipas rëndësisë së fajit.¹⁰⁷

Një tjetër shkelje disiplinore për gjyqtarët ishte edhe marrja me çështje gjyqësore, që nuk ishte pjesë e çështjeve të tij, ndikimi për to, ose ofrimi i konsulencave juridike me apo pa shpërblim. Në këtë rast, ligji shprehej se gjyqtarit i jepej masa disiplinore e *pezullimit të pagës ose detyrës*.¹⁰⁸

Sipas ligjit, marrja e dhuratave të jashtëzakonshme, që nuk përputheshin me prestigjin e detyrës, ose nga persona me interesa në çështjet gjyqësore pranë këtij gjyqtari, parashikohej dhënia e masës disiplinore të “degradimit”, pra e uljes në detyrë.¹⁰⁹

Gjyqtarët nuk duhej që të përfshiheshin në situata, që sot do të klasifikoheshin si “konflikt interesi”. Ky parashikim ndalonte dhënien e rekomandimeve apo të kërkesave ku kërkoheshin favore nga ministrat apo personat, që vareshin prej tyre. Po kështu, për interesa të këtyre personave, gjyqtarëve u ndalohej që të ndërhyjnë në sistemin gjyqësor me qëllim mbrojtjen e interesave të tyre. Masa disiplinore që parashikohej në këtë rast ishte ajo e mbajtjes së rrogës dhe publikimi i emrit në një qarkore.¹¹⁰

103. Neni 87.

104. Neni 88.

105. Neni 89.

106. Neni 70.

107. Neni 71.

108. Neni 72.

109. Neni 73.

110. Neni 74.

Në rastet kur gjyqtari gjykohej për vepra penale, ose ndaj tij caktohej një masë sigurimi, atëherë ai pezullohej nga detyra dhe nuk merrte pagë. Megjithatë Ministri i Drejtësisë për nevojat familjare, në diskrecionin e tij, mund të vendoste që në këtë periudhë gjyqtari të merrte një shumë deri në gjysmën e pagës. Nëse shpallej i pafajshëm, atëherë ai përfitonte pagat e pa marra, me përjashtim nëse ishte vendosur pezullimi nga Këshilli i Epërm Gjyqësor.¹¹¹

Duke iu referuar rasteve praktike, në këtë periudhë rasti më rëndështë ai i vitit 1932, kur me dekretin e 4 marsit të këtij viti, u shkarkuan thuajse të gjithë anëtarët e saj. Shkarkimi u bë me dekret të Këshillit Ministrues me arsyetimin se të gjithë gjyqtarët e të dyja degëve civile e penale “...janë tue marrë pjesë aktive ndër korrentet politike, sjellje qi pengojnë kryemjen e misionit të lartë me ndërgjegje të lirë e të pastër”. Me këtë dekret u pushuan nga puna, z. Agjah Libohova, Kryetar i degës penale të Diktimit, si dhe anëtarët: Baltazar Benusi, Salim Luniku, Kol Dhimitri, Neki Delvina, Vasil Bidoshi, Dervish Sula dhe Avni Dabulla. Gjykata e Diktimit përbëhej nga 12 anëtarë, kurse nga shkresa rezulton se janë shkarkuar 8 gjyqtarë dhe një ndihmës gjyqtar, z. Hasan Dosti. Ndërkohë, nga burime të tjera rezulton, se anëtari i fundit i mbetur, Harilla Theodhori dha dorëheqjen. Nga të dhënat e siguruara, rezulton se nga Gjykata e Diktimit janë larguar 9 gjyqtarë dhe një ndihmës. Por shtypi i kohës raportonte se u hoqën të gjithë anëtarët e Gjykatës së Diktimit. Mundet që përbërja në këtë kohë të ketë qenë e paplotë, ose shtypi ka referuar një numër të gabuar shkarkimesh.¹¹²

Në Shqipërinë e asaj kohe, ka funksionuar gjithashtu edhe një tjetër gjykatë e lartë dhe ky ka qenë Këshilli i Shtetit, i cili përveç funksioneve këshillimore në fushën ligjvënëse dhe në atë të interpretimit të normave të ndryshme të ligjeve dhe rregulloreve, që i përkisnin të drejtës publike, parashikohej nga ligji i vetë organik si Gjykata e Lartë Administrative në Shqipërinë e asaj kohe. Referuar ligjit organik të këtij institucioni rezulton se ai parashikonte, që “Masat disiplinore të Këshillit të Shtetit merren me vendim të Këshillit të Ministrave, mbi propozimin e Ministrisë së Drejtësisë”.¹¹³ Nga burimet arkivore rezulton vetëm një rast, kur kjo procedurë të jetë vënë në lëvizje. Kështu, rezulton se kryetari i këtij këshilli, Mehdi Frashëri, gjatë një fjalimi që kishte mbajtur në qytetin e Elbasanit, kishte folur me terma negative për fenë islame. Kjo kishte sjellë paraqitjen e një ankese nga ana e Komunitetit Mysliman, drejtuar

111. Nenet 75-77.

112. Aurela Anastasi, “Gjykata e Diktimit në përsiatjet për kontroll kushtetues”, botuar në aktet e Konferencës Kombëtare, me temë “Praktika gjyqësore e Gjykatës së Lartë, nga identiteti kombëtar tek vlerat universale”, organizuar me datë 10.05.2023, me rastin e 110 vjetorit të krijimit të Gjykatës së Lartë, Tiranë 2023, fq. 56 dhe 58.

113. Ligji i datës 19.03.1929 “Mbi organizimin e Këshillit të Shtetit”, neni 20.

Ministrit të Drejtësisë, në të cilën ndër të tjera shkruhej, se “Mbi raportimin që na bën Muftinija e Elbasanit me letrën Nr.2 res.dt.22/7/1935 merret vesht se Z.Mehdi Frashëri, me cilësin e tij si Kryetari Këshillit të Shtetit, me rastin e inaugurimit të Biblotekës “Qemal Beholli” në Elbasan dhe të Shonis jashtë-shkollore “Bashkimi Elbasanas”, me dt.21.7.1935 ka mbajtur një fjalë ku mest të tjerave, tue dashtë me diftue randësiën e veprës, [ka përmend ...paska ndejë Zot e Tij, që kur ka vdekë nuk ka lanë asnjë vepër këso-dore mbas vehtes, por pasunija e tij ka shkue hallvë për hoxhallarët. Kto fjalë i ka përsëritë në mënyrë diskredituese shpesh herë, dhe në këtë rast ka guxue t’a cilësojë Shqipniën si Buharan, Semerkandin, Meqen e Jerusalemin.

Sjellja e Z. Frashëri na] uditë përsëtepri kur marrim parasyshtë se ky okupon ma të naltë të Shtetit, që si i këtillë, duhet t’a kuptojë ma mirë se gjithkush randësin e fjalëve që përdoren si] ka ba n’Elbasan për diskreditim e disarmoni në mes t’elementavet dhe urrejtjen e klerit mysliman pa përjashtim, kundrejt Zot. së Tij që guxon të poshtnojë këtë e Shqipniën.

Tue pasë rekomandimet e klerit dhe të Këshillit të përgjithshëm të Komunitetit Mysliman, kjo Kryesië protesoton në mënyrën ma kategorike thanjet e Zotni Mehdi frashërit, Kryetar’ i Këshillit të Shtetit, tue lutë atë P. T., Ministrië me pasë mirësin që] ashtjen t’ia parashtrojë të Shkëlqyeshmes Kryeministrië për të marrë masat e duhuna për evitimin e sjelljeve të tilla damtuese.

Shtojmë tue il faqë saj P.T. Ministrië dëshirën e klerit Mysliman dhe të Këshillit të Përgjithëshëm që kjo jashtë t’i parashtrohet shkoqitërisht për dijeni Nalt-Madhnis së tij Mbretit tek i cili ky element që përmban shumicën e popullit Shqiptarë ka varë shpresat e vetë”.¹¹⁴

Ministri i Drejtësisë, këtë kërkesë, pa kryer veprime të mëtjeshme, ia referoi Këshillit të Ministrave për vendimmarrje.¹¹⁵ Në këtë dosje arkivore nuk gjendet ndonjë vendim i Këshillit të Ministrave, apo ndonjë akt tjetër që të tregojë ecurinë e këtij procedimi. Me shumë mundësi Këshilli i Ministrave nuk do të këtë vepruar në këtë rast, megjithëse ky konkluzion nuk mundet që të konsiderohet kategorik, në mungesë të burimeve të tjera arkivore.

Me pushtimin e Shqipërisë nga Italia Fashiste, me vendim të Asamblesë Kushtetuese të datës 12 prill 1939, u vendos Bashkimi i kurorës së Shqipërisë me atë të Italisë. Në këtë rast, duke qenë se Mbreti i Italisë, u konsiderua si Mbreti i Shqipërisë, ai vendosi që t’i “dhurojë” Shqipërisë, një akt kushtetues, i quajtur “Statuti Themeltar i Mbretërisë”. Ky akt kushtetues, kishte parashikime shumë të pakta në lidhje me organizimin gjyqësor dhe shumicën e rregullimeve ia delegonte ligjeve të zakonshme,

114 AQSH, F. 149, Viti 1935, D. VI-520, fl. 2. Letra nr. 19 res, datë 30.07.1935, e Kryesisë së Komunitetit Mysliman drejtuar Ministrisë së Drejtësisë.

115. AQSH, F. 149, Viti 1935, D. VI-520, fl. 1. Shkresa nr. 60 res, datë 18.08.1935 e Ministrit të Drejtësisë drejtuar Kryeministrisë.

përfshirë edhe çështje të disiplinës së gjyqtarëve dhe prokurorëve.¹¹⁶ Ky akt formal i vendosur nga pushtuesi, pushoi së ekzistuari me kapitullimin e Italisë.

Përsa i përket kohës së pushtimit gjerman të vendit, në atë kohë, Asambleja Kushtetuese e tetorit të vitit 1943 vendosi që të risjellë në fuqi parashikimet kushtetuese të vitit 1928, që gjenin zbatim për aq sa nuk përputheshin me vendimet e kësaj asambleje. Edhe në këtë rast nuk pati ndryshime ligjore përsa i përket organizimit gjyqësor.

5. Inspektimi dhe disiplina sipas ligjit nr. 275, datë 13.08.1946 “Mbi organizimin gjyqësor”

Me miratimin e Statutit të vitit 1946, u pa e nevojshme edhe miratimi i një ligji të ri për organizimin e pushtetit gjyqësor, gjë që u realizua me ligjin nr. 275, datë 13.08.1946 “Mbi organizimin gjyqësor”. Ky ligj e organizonte sistemin gjyqësor në tre shkallë, ku kishin gjykatat e nënprefekturave, ku gjyqtarët zgjidheshin nga këshilli popullor i nënprefekturës, gjykatat e prefekturave, ku gjyqtarët zgjidheshin nga këshilli popullor i prefekturës, si dhe Gjykata e Lartë, e cila zgjidhej Kuvendi Popullor.¹¹⁷ Në përputhje me mendësinë e kohës, ligji parashikonte që gjyqtarët ishin përgjegjës për veprimet e tyre përpara trupit përfaqësues që i kishte zgjedhur.¹¹⁸

5.1 Inspektimi dhe procedimi disiplinor

Duke analizuar në tërësi parashikimet e këtij ligji, rezulton se organet që zgjidhnin gjyqtarët ishin përgjegjës për inspektimin dhe procedimin e tyre. Kështu, këshillat popullorë të nënprefekturave, inspektonin dhe procedonin gjyqtarët e gjykatave të nënprefekturave. Njësoj, këshillat popullorë të prefekturave inspektonin dhe procedonin gjyqtarët e gjykatave të nënprefekturave. Përsa i përket anëtarëve të Gjykatës së Lartë, ata procedoheshin disiplinarisht nga ana e Kuvendit Popullor.

Procedimi disiplinor mund të fillonte nga vetë organi procedues, i cili mund të vihej në lëvizje vetë, ose mbi bazën e ankesave që vinin pranë tij. Ligji parashikonte edhe që këshilli popullor më i ulët, të fillonte procedimin disiplinor me kërkesë të këshillit popullor më të lartë, ose me kërkesë të ministrit të drejtësisë.¹¹⁹

Pasi vihej në lëvizje, organi procedues krijonte një komision hetimor,

116. Statuti i vitit 1939, nenet 40-44.

117. Ligji nr. 275/1946, nenet 1 dhe 21.

118. Ligji nr. 275/1946, neni 28.

119. Ligji nr. 275/1946, neni 28.

që kishte në përbërje anëtarë të vetë këtij organi.¹²⁰ Pra, duhej të ishin anëtarë të këshillit popullor dhe jo pjesë e personelit administrativ.

Ligji kërkonte, që për shkarkimin e gjyqtarit të jepte qëndrimin e tij, edhe vetë ministri i drejtësisë. Ky qëndrim jepej me shkrim, nga vetë ministri ose një i deleguar i tij.¹²¹ Në përfundim të hetimeve paraprahe, komisioni i dorëzonte një raport këshillit popullor, ku pasqyroheshin gjetjet e konstatuara.¹²²

Ligji kërkonte në mënyrë detyruese, që gjyqtari para se të shkarkohej, duhej që të dëgjohej.¹²³

5.2 Përgjegjësia dhe masat disiplinore

Ky ligj parashikonte që gjyqtari mund të shkarkohej në disa raste. Rasti i parë ishte mos kryerja e detyrave që parashikonte ky ligj.¹²⁴ Këto detyra, që duhej të realizoheshin në mënyrë të rregullt ishin i) mbrojtja e organizimin shtetëror dhe shoqëror të Shqipërisë së asaj kohe, mbrojtja e të drejtave dhe interesave të garantuara me ligj të instituteve, ndërmarrjeve dhe organizatave; të mbronte të drejtat personale dhe pronësinë private, si edhe të drejtat dhe interesat e privatëve të garantuara me ligj; ii) të siguronte zbatimin e përpiktë të ligjeve dhe të dispozitave me fuqi ligjore nga ana e instituteve, ndërmarrjeve, organizatave, nëpunësve publikë dhe privatë; iii) të edukonte shtetasit në frymën e besnikërisë ndaj atdheut dhe respektimin e ligjeve, të drejtësisë dhe të detyrave qytetare.¹²⁵ Siç mund të konstatohet, detyrat që duhej të realizonin gjyqtarët, sipas këtyre parashikimeve ishin shumë të gjëra dhe të natyrave të ndryshme.

Si rast të dytë, ky ligj, konsideronte shkelje disiplinore, edhe kryerjen e këtyre detyrave, por në mënyrë të gabuar.

Rasti tjetër ishte kur gjyqtari rezultonte i paaftë në punë. Duke e parë ligjin në tërësi, nuk rezultonte që të ishte parashikuar një metodë për vlerësimin e veprimtarisë profesionale të gjyqtarëve, për rrjedhojë mungesa e aftësisë në punë, sillte përgjegjësinë disiplinore të gjyqtarit.

Duke vijuar me rastet e përgjegjësisë disiplinore të gjyqtarit, rezulton se shkak tjetër që sillte përgjegjësinë disiplinore ishte kur sjelljet e gjyqtarit cenonin rëndë shërbimin e zyrës. Kjo për rastet, kur me veprimet apo mos veprimet e tij, gjyqtari cenonte veprimtarinë gjyqësore. Këtu mund të përfshiheshin humbja apo shkatërrimi i materialeve gjyqësore, zvarritja e çështjeve etj.

120. Ligji nr. 275/1946, neni 29.

121. Ligji nr. 275/1946, neni 30.

122. Ligji nr. 275/1946, neni 31.

123. Ligji nr. 275/1946, neni 32.

124. Ligji nr. 275/1946, neni 28.

125. Ligji nr. 275/1946, neni 2.

Si rast i fundit, ky ligj parashikonte situatën, kur sjellja e gjyqtarit, cenonte prestigjin e gjykatës. Ky parashikim ishte shumë i gjerë dhe në të mund të përfshihejshin të gjitha veprimet ose mos veprimet, brenda apo jashtë orarit zyrtar, që ulnin dinjitetin dhe figurën, si të gjyqtarit ashtu edhe të vetë institucionit.

Ligji parashikonte si rast shkarkimi, edhe largimin e gjyqtarit me dëshirë të tij.¹²⁶ Është e kuptueshme që në këtë rast, nuk jemi përballë përgjegjësisë disiplinore të gjyqtarit, megjithëse terminologjia e kohës e konsideronte përsëri shkarkim edhe këtë situatë.

6. Inspektimi dhe disiplina sipas ligji nr. 4406, datë 24.06.1968 “Mbi organizimin gjyqësor”

Në vitin 1968, pas ndryshimeve kushtetuese u bë një riorganizim i gjykatave, duke u vendosur, që tashmë do të funksiononin gjykatat e fshatrave, të qyteteve dhe të lagjeve të qyteteve. Këto gjykonin krime me rrezikshmëri shoqërore të vogël, çështje civile të thjeshta, si edhe kundërvajtje, sipas përcaktimeve me ligj.¹²⁷

Gjithashtu, ligji parashikonte edhe gjykatat e rretheve, të cilat gjykonin ankimet kundër gjykatave të fshatrave, qyteteve dhe lagjeve të qyteteve, si edhe shërbenin si gjykatë e shkallës së parë, për të gjitha rastet e tjera. Pranë kësaj gjykate krijohej edhe kolegji ushtarak.¹²⁸

Në majë të këtij sistemi ishte Gjykata e Lartë, e cila organizohej në kolegjin civil, penal dhe ushtarak, si edhe në plenumin, me pjesëmarrjen e gjithë gjyqtarëve.¹²⁹

Sipas parashikimeve të kohës, gjyqtarët e të gjitha niveleve zgjidheshin. Kështu, gjyqtarët e rretheve zgjidheshin me votim popullor. Nëse pozicioni mbetej vakant dhe nuk mund të zihej përkohësisht nga ndonjë ndihmësgjyqtar, atëherë ishte këshilli i rrethit, që caktonte një gjyqtar, deri sa të bëheshin zgjedhjet e reja.¹³⁰ Përsa i përket anëtarëve të Gjykatës së Lartë, ata zgjidheshin nga Presidiumi i Kuvendit Popullor.

Përsa i përket përgjegjësisë së gjyqtarëve, ligji parashikonte se gjyqtarët, në veprimtarinë e tyre i nënshtroheshin kritikës dhe kontrollit nga masat e punonjësve,¹³¹ jepnin llogari përpara zgjedhësve të tyre, ndërsa Gjykata e Lartë jepte llogari përpara Kuvendit Popullor dhe Presidiumit të tij.¹³² Ky parashikim është i kuptueshëm që nuk ofronte

126. Ligji nr. 275/1946, neni 28.

127. Ligji nr. 4406/1968, neni 9.

128. Ligji nr. 4406/1968, nenet 10 dhe 11.

129. Ligji nr. 4406/1968, nenet 12 dhe 13.

130. Ligji nr. 4406/1968, neni 20.

131. Ligji nr. 4406/1968, neni 4.

132. Ligji nr. 4406/1968, neni 21.

asnjë lloj garancie, megjithëse vetë ligji shprehej për palëvizshmërinë e gjyqtarëve dhe gëzimin prej tyre të imunitetit.¹³³

Ky ligj nuk kishte asnjë parashikim për inspektimin e gjykatave, mënyrën e zhvillimit të tij, apo garantimin e të drejtave procedurale për gjyqtarët në këto lloje procedimesh.

Përsa i përket përgjegjësisë disiplinore të gjyqtarëve, ligji kufizohej në vetëm një dispozitë, duke parashikuar që *“Gjyqtari dhe ndihmës gjyqtari mund të shkarkohen nga detyra, vetëm kur e vendosin zgjedhësit, ose organi që i ka zgjedhur, kur dënohen penalisht, ose kur e kërkojnë vetë për shkaqe të arsyeshme”*.¹³⁴

Kjo dispozitë parashikon tre situata të largimit të gjyqtarit nga detyra. Situata e parë, është edhe më abuzivja, pasi gjyqtarët mund të shkarkoheshin në çdo kohë nga zgjedhësit, pra trupa elektorale që i kishte zgjedhur. Në këtë rast, vetë zgjedhësit mund të revokonin në çdo kohë gjyqtarin që kishin zgjedhur dhe ligji këtë revokim, nuk e lidhte më asnjë arsye apo kriter ligjor. Nëse ndodheshim përballë një gjyqtari të zgjedhur në mënyrë të përkohshme nga ana e këshillit të rrethit, atëherë ishte ky organ që mund ta shkarkonte atë. Kurse anëtarët e Gjykatës së lartë shkarkoheshin nga Presidiumi i Kuvendit Popullor në çdo kohë, pasi edhe për këta gjyqtarë, nuk parashikoheshin kushte apo kritere ligjore mbi të cilat mund të veprimej. Pra zgjedhësit apo organet e tjera, kishin diskrecion të gjerë për të vendosur shkarkimin e gjyqtarëve.

Rasti i dytë ishte i vetmi rast objektiv, pasi kërkonte ekzistencën e dënimi penal, që mund të jepej vetëm nga gjykatat. Kurse rasti i tretë është në thelb largim më dorëheqje nga sistemi dhe nuk lidhej më ndonjë përgjegjësi disiplinore të gjyqtarit, megjithëse terminologjia e kohës, e konsideronte edhe këtë rast si “shkarkim”.

7. Inspektimi dhe disiplina sipas Dekretit nr. 7174, datë 20.11.1987 “Për organizimin gjyqësor”

Ky akt përbën tentativën e radhës së regjimit komunist për të reformuar sistemin gjyqësor. Sipas këtij dekreti, sistemi gjyqësor në Shqipëri ishte organizuar në tre shkallë, me gjykatat e rretheve, ku gjyqtarët zgjidheshin nga populli¹³⁵; gjykatat e zonave, si gjykatë e shkallës së dytë,¹³⁶ ku gjyqtarët zgjidheshin nga këshilli i rrethit, në territorin e së cilës ato vepronin; ndërsa anëtarët e Gjykatës së Lartë

133. Ligji nr. 4406/1968, neni 22.

134. Ligji nr. 4406/1968, neni 23.

135. Dekreti nr. 7174/1987, neni 15.

136. Dekreti nr. 7174/1987, neni 16.

zgjidheshin nga Kuvendi Popullor.¹³⁷ Gjykata e Lartë organizohej në Plenumin e saj, Kolegjin Civil, Penal dhe Ushtarak.¹³⁸ Pavarësisht këtij organizimi ekzistonin edhe gjykatat e fshatrave, qyteteve dhe lagjeve të qyteteve, që shqyrtonin çështje penale me rrezikshmëri të ulët, çështje civile të thjeshta, si edhe kundërvajtjet, sipas përcaktimeve të bëra me ligj.¹³⁹

Dekreti përcaktonte se gjykatat në veprimtarinë e tyre udhëhiqeshin nga politika e Partisë së Punës,¹⁴⁰ si dhe gjyqtarët duhej që të jepnin llogari përpara atyre që i kishin zgjedhur.¹⁴¹

Edhe ky ligj nuk parashikonte asnjë rregull për mënyrën e procedimit të gjyqtarëve, por parashikonte vetëm, se *“Gjyqtari dhe ndihmësgjyqtari mund të hiqen nga detyra vetëm kur e vendosin zgjedhësit, ose organi që i ka zgjedhur, kur transferohen, kur e kërkojnë vetë për shkaqe të arsyeshme, ose kur dënohen penalisht”*.¹⁴²

Kjo dispozitë parashikon tre situata të largimit të gjyqtarit nga detyra. Situata e parë, ishte edhe më abuzivja, pasi gjyqtarët mund të shkarkoheshin në çdo kohë, nga zgjedhësit, pra trupa elektorale që i kishte zgjedhur. Në këtë rast, vetë zgjedhësit mund të revokonin në çdo kohë gjyqtarin që kishin zgjedhur dhe ligji këtë revokim, nuk e lidhte më asnjë arsye apo kriter ligjor. E njëjta gjë vlente edhe për gjyqtarët e gjykatave të zonave, që mund të shkarkoheshin në çdo kohë, pa u bazuar në një kriter ligjor. Kurse anëtarët e Gjykatës së lartë shkarkoheshin nga Kuvendi Popullor, edhe këta në çdo kohë, pasi edhe për këta gjyqtarë nuk parashikoheshin kushte apo kritere ligjore mbi të cilat mund të veprohej.

Rasti i dytë, transferimi, mbetej një rregull i paqartë. Kjo sepse duke qenë se gjyqtarët zgjidheshin ishte e paqartë se si mund të bëhej transferimi. Për më tepër, nga vendosja në këtë dispozitë, duket se transferimi konceptohej si masë disiplinore, por ishte e paqartë se kush e vendoste.

Kurse rasti i tretë është në thelb largim më dorëheqje nga sistemi dhe nuk lidhej më ndonjë përgjegjësi disiplinore të gjyqtarit, megjithëse terminologjia e kohës e konsideronte edhe këtë rast, si *“heqje nga detyra”*. Ajo që vërehet është se gjyqtari duhej të jepte arsye, se përse po largohej, parashikim ky që e kufizonte edhe këtë mundësi.

Rasti i fundit, ishte i vetmi rast objektiv, pasi kërkonte ekzistencën e dënimi penal, që mund të jepej vetëm nga gjykatat.

Duhet theksuar, se si rezultat i ndryshimeve politike në vendin tonë,

137. Dekreti nr. 7174/1987, neni 7.

138. Dekreti nr. 7174/1987, neni 19.

139. Dekreti nr. 7174/1987, neni 13.

140. Dekreti nr. 7174/1987, neni 2.

141. Dekreti nr. 7174/1987, neni 8.

142. Dekreti nr. 7174/1987, neni 9.

në vitin 1991, kohë në të cilën u miratua edhe ligji nr. 7491, datë 29.04.1991 “Për dispozitat kryesore kushtetuese”, u bënë edhe ndryshime në këtë Dekret, konkretisht me ligjin nr. 7535, datë 17.12.1991, ku neni 3, duke ndryshuar nenin 7 të këtij dekreti, ndër të tjera parashikonte tashmë, se *“Gjyqtarët e ndihmësgjyqtarët e gjykatave të rretheve dhe të zonave, si dhe ato ushtarake emërohen e shkarkohen nga Presidenti i Republikës, me propozim të Ministrit të Drejtësisë”*. Pra në këtë rast, iu hoq zgjedhësve, organeve lokale dhe Kuvendit mundësia për të shkarkuar gjyqtarët, kompetencë që i kaloi Presidentit, por vetëm pasi i vinte propozimi nga Ministri i Drejtësisë. Siç mund të shihet, në këtë rast kemi një rikthim në traditën e dikurshme, duke i njohur Ministrit të Drejtësisë mundësinë e kontrollit dhe inspektimit mbi gjykatat.

8. Sistemi i prokurorisë, në vitet 1945-1992

Përsa i përket sistemit të prokurorisë gjatë regjimit komunist, Statuti i Republikës Popullore të Shqipërisë, i vitit 1946, titulluar me ndryshimet e vitit 1950, si Kushtetuta e Republikës Popullore të Shqipërisë, për Prokurorinë parashikonte se ky institucion ishte një organ i Kuvendit Popullor, që kishte për mision të kontrollonte zbatimin e përpiktë të ligjës prej ministrave dhe organeve të tjera administrative, si dhe prej nëpunësve publikë dhe prej gjithë shtetasve.¹⁴³ Ky institucion drejtohej nga Prokurori i Përgjithshëm, i cili, së bashku me ndihmësit e tij emërohej nga Kuvendit Popullor. Ndërsa në lidhje me prokurorët e tjerë, parashikohej se ata emëroheshin prej Prokurorit të Përgjithshëm.¹⁴⁴ Statuti parashikonte, se të gjithë prokurorët publikë ishin të pavarur kundrejt të gjitha organeve lokale dhe vareshin vetëm prej Prokurorit të Përgjithshëm, nga i cili merrnin urdhra dhe udhëzime.¹⁴⁵

Siç mund të shihet, në këtë moment fillon ndarja e prokurorisë, si një entitet i veçantë nga sistemi gjyqësor dhe organizimi i tij në formë më të centralizuar, model që më disa ndryshime do të ndiqet në Shqipëri, deri në reformën e vitit 2016.

Legjislacioni që u miratua në këtë kohë, përfshinte ligjin nr. 107, datë 1945 “Mbi Prokurorinë”, ligji nr. 279, datë 09.08.1946 “Mbi Prokurorinë”, Dekreti nr. 1790, datë 28.12.1953 “Mbi Prokurorinë”. Këto akte zbërthenin parashikimet statutore/kushtetuese dhe i ngarkonin Prokurorisë, kontroll mbi ligjshmërinë e akteve nënligjore normative mbi veprimtarinë administrative të organeve qendrore dhe vendore, mbi veprimtarinë gjyqësore, sipas kodeve të procedurave civile dhe

143. Statuti i vitit 1946, neni 88.

144. Statuti i vitit 1946, neni 89.

145. Statuti i vitit 1946, neni 90.

penale, mbi hetimin, si edhe mbi ekzekutimin e vendimeve. Siç mund të konstatohet kompetencat e Prokurorisë ishin shume të gjera.

Përsa i përket emërimit dhe shkarkimit të prokurorëve, këto akte ligjore vetëm përsërisnin dispozitën kushtetuese, ku përcaktohej se Prokurori i Përgjithshëm dhe ndihmësit e tij, emëroheshin dhe shkarkoheshin nga Kuvendi Popullor, kurse prokurorët e tjerë, emëroheshin dhe shkarkoheshin nga Prokurori i Përgjithshëm. Këto parashikime ishin shumë lakonike dhe nuk rregullonin asnjë aspekt të inspektimit, kontrollit, procedimit dhe përgjegjësisë disiplinore të prokurorëve.

Në burimet arkivore gjenden edhe referime të bëra nga komitetet e partisë në rrethe dhe që i janë drejtuar si Ministrisë së Drejtësisë, ashtu edhe Komitetit Qendror të Partisë. Në to trajtohen sjellje të dobëta të prokurorëve dhe propozohen edhe masa shkarkimi për disa prej tyre.¹⁴⁶

Nga sa më sipër, rezulton se ankesat kundër prokurorëve mund të vinin edhe nga subjekte të ndryshme, mbi të gjitha, nga organet partiake, të cilat vinin në lëvizje sistemin për marrjen e këtyre prokurorëve në përgjegjësi disiplinore.

Në vitin 1976 hyri në fuqi edhe Kushtetuta e Republikës Popullore Socialiste të Shqipërisë, e cila për sistemin e prokurorisë parashikonte, se Prokuroria kishte për detyrë të kontrollonte zbatimin e përpiktë dhe të njëjtë të ligjeve nga ministritë dhe nga organet e tjera qendrore e lokale, nga gjykatat, organet e hetimit, ndërmarrjet, institucionet, organizatat, nëpunësit dhe shtetasit. Prokuroria kishte të drejtën e protestës kundër çdo akti të paligjshëm dhe mund të kërkonte nga organet përkatëse shfuqizimin ose ndryshimin e tij. Kërkesa e prokurorit duhej të shqyrtohej brenda afatit të caktuar me ligj, ndryshe pezullohej zbatimi i aktit.¹⁴⁷ Prokurori i Përgjithshëm parashtronte në Kuvendin Popullor dhe në Presidiumin e Kuvendit Popullor rastet kur ligjet dhe dekretet nuk pajtoheshin me Kushtetutën, si dhe në Këshillin e Ministrave rastet kur vendimet e urdhëresat e tij nuk pajtoheshin me ligjet.¹⁴⁸ Prokurori i Përgjithshëm dhe zëvendësit e tij emëroheshin në sesionin e parë të Kuvendit Popullor, ndërsa prokurorët e tjerë emëroheshin nga Presidiumi i Kuvendit Popullor.¹⁴⁹

Siç mund të shihet, Prokuroria e asaj kohe ruante përsëri të njëjtën sferë të kompetencave të saj, të cilat u detajuan më tej në ligjin nr. 6298,

146. Nr. 326, 01.02.1950-27.12.1950

DO Relacione të ardhura nga komitetet e Partisë të rretheve dhe Ministrinë e Drejtësisë në Komitetin Qendror të Partisë së Punës së Shqipërisë, mbi gjendjen e Prokurorisë e gjykatave dhe disa sjellje të dobëta të prokurorëve dhe gjyqtarëve. Propozime për shkarkime.

147. Kushtetuta e vitit 1976, neni 104.

148. Kushtetuta e vitit 1976, neni 105.

149. Kushtetuta e vitit 1976, neni 106.

datë 27.03.1981 “Për prokurorinë”, i cili përsa i përket emërimit dhe shkarkimit të prokurorëve parashikonte se “Prokurori i Përgjithshëm dhe zëvendësit e tij emërohen e shkarkohen nga Kuvendi Popullor. Midis sesioneve të Kuvendit Popullor, zëvendësprokurorët e Përgjithshëm emërohen ose shkarkohen nga Presidiumi i Kuvendit Popullor. Prokurori i rrethit emërohet e shkarkohet nga Presidiumi i Kuvendit Popullor. Prokurorët e tjerë emërohen e shkarkohen nga Prokurori i Përgjithshëm”.¹⁵⁰

Siç mund të konstatohet dispozita ka tejkaluar rregullimin kushtetues, duke përcaktuar ende që Prokurori i Përgjithshëm emëronte dhe shkarkonte prokurorët e tjerë, ndërkohë që dispozita kushtetuese, pa bërë dallim, ia ngarkonte këtë kompetencë vetëm Presidiumit të Kuvendit Popullor. Gjithashtu kjo dispozitë, por edhe ligji në tërësi, nuk kishin asnjë parashikim për procedurat e inspektimit, procedimin disiplinor, përgjegjësinë disiplinore dhe të drejtat e prokurorit në këto faza. Edhe ky legjislacion i ri u linte diskrecion të gjerë organeve të emërtesës për të bërë shkarkimin e prokurorëve sipas gjykimit të tyre.

Në këtë kohë burimet arkivore flasin për emërim dhe shkarkim prokurorësh në vitin 1979,¹⁵¹ 1980,¹⁵² 1985,¹⁵³ 1986,¹⁵⁴ etj.

150. Ligji nr. 6298/1981, neni 8.

151. Nr. 1-3, 27.07.1979-15.09.1979 SK Vendim i Sekretariatit të Komitetit Qendror të Partisë së Punës së Shqipërisë dhe dekret i Presidiumit të Kuvendit Popullor, mbi emërim e shkarkim prokurorësh në rrethin e Matit.

152. Nr. 1-8, 29.09.1980 SK Dekreti i Presidiumit të Kuvendit Popullor, dhe propozim i Prokurorisë së Përgjithshme mbi shkarkime dhe emërim prokurorësh në rrethin e Kolonjës.

153. Nr. 287, 06.01.1985-27.02.1986

DO Dekrete të Presidiumit të Kuvendit Popullor, vendime dhe korrespondencë për emërim, lëvizje e shkarkime të kuadrit të Prokurorisë.

154. Nr. 1-10, 10.01.1986-20.12.1986 SK Vendime të organit kolegjial të Prokurorisë së Përgjithshme, korrespondencë me institucione dhe prokuroritë e rretheve mbi emërim, lëvizje e shkarkime të kuadrit të organit të prokurorisë.

KREU II

INSPEKTIMI DHE DISIPLINA NË PERIUDHËN 1992 – 1998

1. Parashikimet kushtetuese sipas ligjit nr. 7561, datë 29.04.1992 “Organizimi i drejtësisë dhe i Gjykatës Kushtetuese”

Ndryshimet politike, ekonomike dhe sociale u shoqëruan edhe me ndryshime juridike. Kështu fillimisht nga organi legjislativ, Kuvendi Popullor, u miratua ligji nr. 7491, datë 29.04.1991 “Për dispozitat kryesore kushtetuese”, i cili ndër të tjera parashikonte pavarësinë e pushtetit gjyqësor¹⁵⁵ dhe depolitizimin e sistemit gjyqësor dhe të prokurorisë,¹⁵⁶

Megjithatë ky ligj kushtetues nuk ishte i plotë, përsa i përket sistemit të drejtësisë, mangësi kjo, që u plotësua me miratimin e ligjit kushtetues nr. 7561, datë 29.04.1992, i cili shtoi një kre të ri në ligjin për Dispozitat Kryesore Kushtetuese, titulluar “Organizimi i drejtësisë dhe i Gjykatës Kushtetuese”. Ky ligj parashikonte krijimin e një sistemi gjyqësor, që përbëhej nga Gjykata e Kasacionit, gjykatat e apelit, gjykatat e shkallës së parë dhe nga gjykatat ushtarake.¹⁵⁷

Për Gjykatën e Kasacionit, që përcaktohej si autoriteti më i lartë gjyqësor në vend, ligji kushtetues përcaktonte, se gjyqtari i kësaj gjykate mund të lëvizet nga detyra vetëm mbi bazën e një vendimi të arsyetuar të Kuvendit Popullor, kur vërtetohet se kishte kryer një nga veprat e rënda penale të parashikuara posaçërisht me ligj, ose kur rezultonte i paaftë mendërisht.¹⁵⁸

Ky parashikim u interpretua fillimisht, në mënyrë abstrakte nga ana e Gjykatës Kushtetuese, e cila u shpreh se “Paragrafi i fundit i nenit 6 të ligjit kushtetues nr. 7561, datë 29.04.1992 “Për disa ndryshime e plotësime në ligjin nr. 7491, datë 29.04.1991 “Për dispozitat kryesore kushtetuese”, përcakton se “Gjyqtari i Gjykatës së Kasacionit mund të lëvizet nga detyra vetëm mbi bazën e një vendimi të arsyetuar të Kuvendit Popullor kur vërtetohet se ka kryer një nga veprat e rënda penale të parashikuara shprehimisht me ligj ose kur është i paaftë mendërisht”. Me këtë dispozitë sanksionohet parimi juridik i patundshmërisë

155. Ligji nr. 7491/1991, neni 5.

156. Ligji nr. 7491/1991, neni 6.

157. Ligji nr. 7561/1992, neni 5.

158. Ligji nr. 7561/1992, neni 6.

(palëvizshmërisë) së gjyqtarëve të Gjykatës së Kasacionit, me përjashtimet që ka përcaktuar vetë ligji kushtetues.

Duke interpretuar këtë dispozitë, Gjykata konkludon se Kuvendi Popullor me vendim të arsyetuar mund të lëvizë nga detyra gjyqtarin e Gjykatës së Kasacionit kur gjyqtari me vendim të formës së prerë të një gjykate kompetente është dënuar me heqje të lirisë për kryerjen e një vepre penale të parashikuar si të tillë nga ligji. Gjyqtari nuk mund të vazhdojë të kryejë detyrën e tij kur ai është dënuar me heqje të lirisë, sepse kjo nuk pajtohet me funksionin dhe figurën morale të gjyqtarit”.¹⁵⁹

Nëpërmjet interpretimit të mësipërm, Gjykata Kushtetuese, duke dhënë kuptimin e kësaj norme kushtetuese, që garantonte paprekshmërinë e gjyqtarëve të Gjykatës së Kasacionit, sqaroi se kjo mbrojtje nuk ishte absolute, por përjashtohej në rastet kur gjyqtari dënohej me vendim të formës së prerë për kryerjen e një vepre të rëndë penale. Sipas interpretimit të Gjykatës, patundshmëria e gjyqtarit, si një garanci për pavarësinë e tij, mund të kufizohej në rrethana dhe të përcaktuara qartë, përkatësisht kur cenohej integriteti moral dhe aftësia për të përmbushur funksionin gjyqësor. Kjo qasje synonte që të ruante balancën midis pavarësisë së gjyqtarëve dhe nevojës për të mbrojtur figurën e sistemit të drejtësisë nga individë të papërshtatshëm për shkak të sjelljeve kriminale ose paaftësisë mendore.

Në këtë periudhë, kemi vetëm një rast të shkarkimit të një anëtarit të Gjykatës së Kasacionit, i cili ishte dhe njëkohësisht edhe kryetar i këtij institucioni. Shkarkimi që realizoi Kuvendi Popullor, u bazua në një vendimmarrje të mëparshme të Gjykatës Kushtetuese, që kishte konstatuar paligjshmërinë e veprimeve të Kryetarit të Gjykatës së Kasacionit në pezullimin e vendimeve gjyqësore të formës së prerë.¹⁶⁰ Vendimi i Kuvendit Popullor për shkarkimin e Kryetarit të Gjykatës së Kasacionit, u kundërshtua në Gjykatën Kushtetuese, jo nga vetë personi i prekur nga kjo masë, por nga një grup parlamentar. Në këtë rast Gjykata Kushtetuese u shpreh, se “Sipas paragrafit të fundit të nenit 6 të ligjit nr. 7561, datë 29.04.1992 “Gjyqtari i Gjykatës së Kasacionit mund të lëvizet nga detyra vetëm mbi bazën e një vendimi të arsyetuar të Kuvendit Popullor kur vërtetohet se ka kryer një nga veprat e rënda penale të parashikuara posaçërisht me ligj ose kur është i paaftë mendërisht”.

Nga përmbajtja e kësaj dispozite, duke pasur parasysh parimin e njohur të prezumimit të pafajësisë të konsakruar edhe në nenin 7 të ligjit “Për të drejtat dhe liritë themelore të njeriut”, del se dy janë kushtet e nevojshme dhe të mjaftueshme për lëvizjen e detyrueshme të një gjyqtari të Gjykatës së Kasacionit, pa përjashtuar kryetarin dhe zëvendëskryetaret e kësaj Gjykate: kryerja e një vepre penale të rëndë të parashikuar në ligj e vërtetuar kjo me vendim të formës së prerë dhe paaftësia mendore.

159. Vendimi nr. 1, datë 19.01.1995 i Gjykatës Kushtetuese.

160. Vendimi nr. 12, datë 21.09.1995 i Gjykatës Kushtetuese.

Gjykata Kushtetuese kësaj teze i është përmbajtur edhe në vendimin e saj nr. 1, datë 19.01.1995, ku, midis të tjerash, thuhet: “Kuvendi Popullor me vendim të arsyetuar mund të lëvizë nga detyra gjyqtarin e Gjykatës së Kasacionit kur ai është dënuar me heqje të lirisë për kryerjen e një vepre penale me vendim të formës së prerë”.

Të dy kushtet e sipërme lidhen me parimin e patundshmërisë së gjyqtarit dhe përbëjnë një garanci për kryerjen e detyrës së tij në mënyrë të pavarur, por nuk e përjashtojnë atë nga disa detyrime të rëndësishme dhe të caktuara, të respektojë ligjin kushtetues dhe ligjin në përgjithësi. Gjyqtari nuk mund t'i shmanget këtij detyrimi duke u mbrojtur me parimin e pavarësisë së tij objektive dhe personale.

Prandaj gjykata çmon se është objektivist e nevojshme shqyrtimi i legjitimitetit të vendimit të Kuvendit Popullor nr. 269, datë 21.09.1995 për shkarkimin e kryetarit të Gjykatës së Kasacionit, Z. B., nën prizmën e detyrës dhe të përgjegjësisë që ka gjyqtari i Gjykatës së Kasacionit të respektojë ligjin kushtetues, gjë që nuk vjen aspak ndesh dhe nuk është në kundërvënje me përmbajtjen e nenit 6 paragrafi i katërt të ligjit nr. 7561, datë 29.04.1992.

Respektimi i Kushtetutës qëndron në bazë të veprimtarisë së të gjitha organeve shtetërore. Gjykata Kushtetuese, ka parasysht këtu nenin 2 paragrafi i dytë të ligjit “Për dispozitat kryesore kushtetuese”. Në bazë të këtij neni, i cili përcakton karakteristikat esenciale të shtetit demokratik, të gjitha pushtetet publike (shteti) kanë për detyrë të respektojnë dhe të mbrojnë kushtetutën (rendin kushtetues). S’ka asnjë dyshim se shkelja e kësaj detyre sjell pasoja (largimin nga detyra), sepse përmbajtja e kësaj dispozite ka karakter konstitutiv dhe jo deklarativ; ajo është precize dhe imperative. Këtu është e udhës të shtohet se marrja e masës për largimin nga detyra, kushtëzohet - në ndryshim me nenin 6 paragrafi i katërt i ligjit nr. 7561, datë 29.04.1992 - nga një seri faktorësh: rëndësia e shkeljes së ligjit, kryerja me paramendim ose në mënyrë të përsëritur etj.

Organi që i ka zgjedhur, nuk mund të qëndrojë indiferent dhe nuk mund të mos reagojë në rastet kur veprimtaria e këtyre përfaqësuesve më të lartë të pushtetit gjyqësor, shpallet antikushtetuese dhe antiligjore nga një organ i ngarkuar me kontrollin konstitucional.

Gjykata e gjen të nevojshme të përmendë një dispozitë të veçantë të ligjit “Për dispozitat kryesore kushtetuese” dhe konkretisht nenin 27 shkronja “a”. Përmbajtja e kësaj dispozite - shkarkimi i Kryetarit të Shtetit kur ka shkelur ligjin kushtetues - nuk mund të shërbejë, siç mund të duket në pamje të parë, si një argument “a contrario”, nuk provon të kundërtën e pikëpamjes së shprehur më sipër dhe të konkluzioneve që ka nxjerrë kjo Gjykatë, por i përforcon ato.

Parashikimi me normë të posaçme i kësaj përgjegjësie për Kryetarin e Shtetit dhe e diktuar për arsye të veçanta, tregon rëndësinë e madhe që ka detyra e respektimit të kushtetutës dhe vendin që zë në një shtet demokratik ruajtja dhe mbrojtja e saj. Kjo përgjegjësi vepron ndaj të gjithëve dhe, sidomos, ndaj atyre që janë të ngarkuar me funksione të rëndësishme shtetërore.

Gjykata Kushtetuese me vendimin e saj nr. 12, datë 21.09.1995, ka shpallur

veprimtarinë e kryetarit të Gjykatës së Kasacionit, Z. B., antikushtetues dhe antiligjore. Ky vendim shërbeu si bazë për Kuvendin Popullor për shkarkimin e tij nga të gjitha funksionet në Gjykatën e Kasacionit.

Pretendimi i Grupit Parlamentar të Partisë Socialiste, se ky vendim i Gjykatës Kushtetuese, nuk mund të zëvendësojë vendimin penal të formës së prerë dhe nuk mund të shërbejë për vërtetimin e kryerjes së një vepre penale nga kryetari i Gjykatës së Kasacionit është pa baza për arsye se mbahet parasysh vetëm kuptimi i nenit 6 dhe jo edhe përmbajtja substanciale e nenit 2 paragrafi i dytë i ligjit "Për dispozitat kryesore kushtetuese".

Nga shqyrtimi i dokumenteve, i të dhënave kompjuterike dhe i procesverbaleve, që përmbajnë këto të dhëna, rezulton se në kohën e hapjes të mbledhjes së Kuvendit Popullor, para se të vihej në rendin e ditës çështja B., kanë qenë të pranishëm 73 deputetë. Sipas pretendimeve të Grupit Parlamentar të Partisë Socialiste, deputetët G. P., A. I., dhe Sh. C., në kundërshtim me përmbajtjen e dokumenteve dhe të dhënave kompjuterike, nuk kanë marrë pjesë në mbledhjen plenare, në zhvillimin e punimeve dhe në votimin e vendimit.

Gjithashtu, nga shqyrtimi i këtyre dokumenteve, rezulton se si në votimin për vënien e çështjes në rendin e ditës ashtu dhe në votimin për miratimin ose jo të propozimit për shkarkimin e kryetarit të Gjykatës së Kasacionit, kanë marrë pjesë 73 deputetë, duke përfshirë edhe dy nga tre deputetët që përmenden më sipër. Kjo provon se, në kohën e votimit, në mbledhje kanë qenë të pranishëm jo më pak se 71 deputetë, d.m.th., më shumë se gjysma e numrit të përgjithshëm, duke përfshirë deputetët G. P., e A. I. Dihet se gjatë mbledhjes përbërja e saj numerike ndryshohet vazhdimisht dhe është për këtë arsye që ligji kërkon që në kohën e votimit të jetë patjetër e pranishme shumica e deputetëve (nenet 43 e 44 të Rregullores së Kuvendit Popullor).

Pra edhe duke e pranuar të mirëqenë pretendimin e palës kërkuese se në kohën e hapjes së mbledhjes nuk ka qenë e pranishme shumica e deputetëve, nga rezultatet e votimit del se kanë votuar në favor të shkarkimit të kryetarit të Gjykatës së Kasacionit, Z. Z. B., 71 deputetë, pa përfshirë këtu deputetët G. P., dhe A. I., d.m.th., se në kohën e votimit ka qenë prezent shumica e kërkuar prej ligjit.

Gjykata Kushtetuese, e mbështetur në rrethanat e sipërme, arrin në konkluzionin se nuk ndodhemi përpara shkeljesh të kërkesave substanciale të procedurës legjislative, të cilat e bëjnë të nevojshme shpalljen e nulitetit të kësaj procedure".¹⁶¹

Ky vendim i Gjykatës Kushtetuese, që shqyrtoi kushtetutshmërinë e shkarkimit të Kryetarit të Gjykatës së Kasacionit nga Kuvendi Popullor, përmban një arsyetim të komplikuar përsa i përket interpretimit dhe zbatimit të dispozitave kushtetuese në lidhje me largimin e gjyqtarëve të Gjykatës së Kasacionit nga detyra. Ky vendim, ndonëse tenton të ruajë qëndrimin e mëparshëm për respektimin e palëvizshmërisë së gjyqtarëve, krijoi gjithashtu një hapësirë të re, përsa i përket shkaqeve të shkarkimit, duke

161. Vendimi nr. 2, datë 14.02.1996 i Gjykatës Kushtetuese.

u bazuar jo vetëm në vendimet penale të formës së prerë, por edhe në shkeljen e dispozitave kushtetuese të konstatuara nga vetë Gjykata Kushtetuese.

Në analizën e saj, Gjykata Kushtetuese theksoi se paragrafi katër i nenit 6 të ligjit nr. 7561, datë 29.04.1992, përmbante dy kushte specifike për largimin nga detyra të një gjyqtari të Gjykatës së Kasacionit dhe konkretisht, kryerjen e një vepre të rëndë penale të parashikuar nga ligji dhe paaftësinë mendore, të cilat duhet të jenë të vërtetuara të dyja me vendim gjyqësor të formës së prerë. Megjithatë, në rastin konkret, rezultoi se Kuvendi Popullor e kishte bazuar shkarkimin, jo në një vendim penal të formës së prerë, por në një vendim të Gjykatës Kushtetuese, *që ka shpallur veprimtarinë e Kryetarit të Gjykatës së Kasacionit antikushtetuese dhe antiligjore. Duke ndjekur këtë logjikë, Gjykata Kushtetuese theksoi se respektimi i Kushtetutës përfaqëson një detyrim për të gjitha organet shtetërore, përfshirë edhe gjyqtarët dhe shkelja e saj, pavarësisht mungesës së një vendimi penal, mund të përbëjë një shkak të ligjshëm për largimin nga detyra.*

Ky interpretim dukshëm paraqiti një zgjerim të shkaqeve për largimin e gjyqtarëve të Gjykatës së Kasacionit nga detyra, pasi vendimi i Gjykatës Kushtetuese krijoi praktikisht një normë të re kushtetuese, sipas së cilës shkelja e dispozitave kushtetuese mund të sillte largimin nga detyra të një gjyqtari edhe pa ekzistencën e një vendimi penal të formës së prerë.

Për sa i përket procedurës së ndjekur nga Kuvendi Popullor, Gjykata Kushtetuese, shqyrtoi me kujdes pretendimet e paraqitura nga kërkuesi, lidhur me ligjshmërinë e procedurës së ndjekur, duke konkluduar se në kohën e votimit ka qenë i pranishëm numri i nevojshëm i deputetëve, siç e parashikon rregullorja e Kuvendit Popullor. Gjykata, gjithashtu vlerësoi se nuk pati shkelje substanciale të procedurës parlamentare, *që të justifikonte shpalljen si të pavlefshme të vendimit të Kuvendit. Ajo theksoi se prania e 71 deputetëve në kohën e votimit, ishte më se e mjaftueshme për të plotësuar kriterin e kuorumit të nevojshëm për marrjen e vendimit.*

Përsa i përket sistemit të prokurorisë, ky ligj kushtetues parashikonte se Prokuroria ishte autoriteti, që ushtron ndjekjen penale, si në fazën hetimore, ashtu edhe në fazën gjyqësore. Ajo organizohej dhe funksiononte brenda pushtetit gjyqësor, si organ unik dhe i centralizuar.¹⁶²

Më tej ligji kushtetues parashikonte se Prokurori i Përgjithshëm dhe zëvendësimi i tij zgjidheshin nga Kuvendi Popullor, me propozim të Presidentit. Ata gëzonin imunitetin dhe të drejtat e parashikuara nga neni 6 i këtij ligji kushtetues për gjyqtarët e Gjykatës së Kasacionit.¹⁶³

Në zbatim të këtij parashikimi ka pasur edhe procedim disiplinor ndaj Prokurorit të Përgjithshëm, nga ana e Kuvendit Popullor, që përfundoi me shkarkimin e tij. Duhet theksuar, se megjithëse ligji kushtetues nuk

162. Neni 13.

163. Neni 14.

parashikonte ankim në këtë rast në Gjykatën Kushtetuese, kjo Gjykatë e konsideroi veten kompetente, që të shqyrtonte edhe ankime të tilla. Në lidhje me rastin konkret, Gjykata Kushtetuese u shpreh se *“Ish-Prokurori i Përgjithshëm, M. H., në kërkesën që i ka drejtuar kësaj Gjykate pretendon se Vendimi i Kuvendit Popullor për shkarkimin e tij nga detyra është në kundërshtim flagrant me nenet 6 e 14 të ligjit nr. 7561, datë 29.04.1992, “Për disa ndryshime e plotësime në ligjin nr. 7491, datë 29.04.1991, “Për dispozitat kryesore kushtetuese”.*

Kuvendi Popullor, me vendimin nr. 231, datë 17.09.1992, ka shkarkuar nga detyra e Prokurorit të Përgjithshëm M. H., për dobësi të theksuara në punë, për mungesë objektiviteti dhe zvarritje në hetimin e disa çështjeve penale të rëndësishme, për emërimin e një prokurori në rrethin e Vlorës, pa marrë miratimin e Këshillit të Lartë të Drejtësisë dhe në kundërshtim me nenin 15 të ligjit nr. 7561, datë 29.04.1992. Të gjitha këto të meta dhe veprime, pa bërë cilësimin e tyre ligjor dhe pavarësisht nga pasojat penale janë konsideruar shkelje të rënda në kryerjen e detyrës.

Në këto rrethana, Vendimi i Kuvendit Popullor për shkarkimin e Prokurorit të Përgjithshëm, nuk mund të shqyrtohet vetëm nën prizmin e dispozitës së nenit 6 (lidhur me atë të nenit 14) të ligjit nr. 7561, datë 29.04.1992, që parashikon mundësinë e shkarkimit nga detyra të Prokurorit të Përgjithshëm dhe të zëvendësve të tij në dy raste të kufizuara: kryerja e një vepre penale të rëndë të parashikuar shprehimisht nga ligji dhe paaftësia mendore, por dhe sidomos në lidhje me normën e pikës 10, të nenit 16 të ligjit nr. 7491, datë 29.04.1991 dhe në frymën e saj, duke pasur parasysht, si mbrojtjen e të drejtave të një personi në krye të një institucioni shtetëror me rëndësi, siç është Prokuroria e Përgjithshme, ashtu dhe sigurimin e funksionimit të rregullt e normal të shërbimit të këtij institucioni, në të gjitha hallkat e tij. Në këtë aspekt, problemi që shtrohet për shqyrtim përpara kësaj Gjykate dhe zgjidhja e tij ka një rëndësi themelore, përveç të tjerash edhe për faktin se ndodhemi përpara dy dispozitave të një rangui, kushtetuese si njëra dhe tjetra, por jo në raport ndërvarësie. Parimet që shprehin këto dy norma kushtetuese, nuk vijnë në kundërshtim, as përjashtojnë njëra-tjetrën. Ato kanë përmbajtje të ndryshme. Në bazë të nenit 6 të ligjit nr. 7561, datë 29.04.1992, shkarkimi nga detyra i Prokurorit të Përgjithshëm dhe i zëvendësve të tij, kur vërtetohet ligjërisht se kanë kryer një vepër penale të rëndë ose janë të paaftë mendërisht, është i detyrueshëm, ndërsa në rastin e parashikuar prej nenit 16, pika 10 të ligjit nr. 7491, datë 29.04.1991, organi që ushtron kontrollin, Kuvendi Popullor, çmon nëse ka ose jo shkelje dhe nëse për shkak të këtyre shkeljeve legjitimohet marrja e sanksioneve.

Sipas nenit 16, pika 10 të ligjit nr. 7491, datë 29.04.1991, Kuvendi Popullor ka të drejtën të kontrollojë veprimtarinë e Prokurorisë së Përgjithshme, të prokurorit dhe të zëvendësve të tij, kontroll ky që ka një karakter të detyrueshëm, të vazhdueshëm dhe rigoroz.

E drejta e kontrollit, që i njihet Kuvendit Popullor me një dispozitë të shprehur kushtetuese, parakupton si kusht *“sine qua non”* për realizimin efektiv të

këtij kontrolli, edhe të drejtën e marrjes së sanksioneve, duke mos përjashtuar edhe shkarkimin nga detyra, jashtë rasteve të caktuara në mënyrë të kufizuar nga neni 6 i ligjit nr. 7561, datë 29.04.1992. Të tilla janë p.sh., mos përmbushja në rregull e detyrës, paaftësia profesionale, paaftësia fizike etj.

Është e qartë se e drejta e marrjes së sanksioneve në këto raste, si pasojë e domosdoshme e së drejtës së kontrollit që ushtron Kuvendi Popullor mbi veprimtarinë e Prokurorisë së Përgjithshme, ka të njëjtën vlerë kushtetuese që ka norma e nenit 16, pika 10. Në të kundërtën, norma e pikës 10, të nenit 16, që parashikon kontrollin mbi veprimtarinë e Prokurorisë së Përgjithshme, do të mbetej një normë me vlerë thjeshtë deklarative dhe logjika e thjeshtë do të shpinte në këtë përfundim paradoksal: E drejta e Kuvendit Popullor, organ i vetëm ligjvënës dhe mbajtës i sovranitetit, do të humbiste çdo fuqi dhe roli i tij do të ishte ai i një vëzhguesi përpara një gjendje të krijuar, me pasojë të rënda për shtetin dhe shoqërinë. Nga ana tjetër, kjo do të përjashtonte Prokurorin e Përgjithshëm dhe zëvendësit e tij nga çdolloj përgjegjësie, për çfarëdo shkelje të detyrës, me përjashtim, natyrisht, të rastit unik të kryerjes së një vepre penale të rëndë të parashikuar shprehimisht nga ligji.

Përgjegjësia e Prokurorit të Përgjithshëm dhe e zëvendësve të tij, kurrsesi nuk mund të kufizohet vetëm në rastin e parë të nenit 6 të ligjit nr. 7561, datë 29.04.1992, pse kështu ata, jashtë çdo parimi dhe logjike, do të gëzonin një mbrojtje krejt të veçantë të pajustificuar dhe do të vihehin në një pozitë të privilegjuar ndaj të gjitha organeve të tjera shtetërore, që zënë një pozitë të lartë në organizimin shtetëror. Një gjë e tillë nuk gjen bazë në asnjë normë kushtetuese ose në ndonjë normë me vlerë të atillë.

Për arsytet e parashtruara më sipër, Gjykata kushtetuese, arrin në përfundimin se Kuvendi Popullor, duke pasur të drejtën të ushtrojë kontroll mbi veprimtarinë e Prokurorisë së Përgjithshme në bazë të nenit 16, pika 10 të ligjit nr. 7491, datë 29.04.1991 "Për dispozitat kryesore kushtetuese", ka edhe të drejtën e marrjes së sanksioneve, kur gjatë kontrollit konstatohet se janë kryer shkelje të rënda në përmbushjen e detyrës ose janë vërtetuar shkaqe që pengojnë ecjen normale të punës".¹⁶⁴

Ky vendim megjithëse është më i hershëm se ato për gjyqtarët e Gjykatës së Kasacionit, tregon pikërisht të njëjtën qasje zgjeruese të Gjykatës Kushtetuese që nëpërmjet veprimtarisë së saj interpretuese, krijoi norma të reja duke zgjeruar shkaqet e largimit të Prokurorit të Përgjithshëm. Kështu Gjykata Kushtetuese, interpretoi nenin 6 të ligjit nr. 7561, datë 29.04.1992 dhe nenin 16, pika 10 të ligjit nr. 7491, datë 29.04.1991 "Për dispozitat kryesore kushtetuese". Në këtë mënyrë, Gjykata Kushtetuese barazoi rastet e shkarkimit të Prokurorit të Përgjithshëm me të drejtën që kishte Kuvendi Popullor për të kontrolluar veprimtarinë e Prokurorisë së Përgjithshme.

Sipas nenit 6 të ligjit nr. 7561, shkarkimi i Prokurorit të Përgjithshëm

164. Vendimi nr. 12, datë 28.10.1992 i Gjykatës Kushtetuese.

dhe zëvendësve të tij, mund të bëhej vetëm në dy raste të kufizuara dhe të parashikuara qartë, konkretisht, kur ata kryenin një vepër të rëndë penale të parashikuar shprehimisht nga ligji, ose kur shpallehin të paafte mendërisht për të ushtruar detyrën. Kjo normë synon të vendosë standarde të qarta dhe të ngushta për shkarkimin e këtyre funksionarëve të lartë, duke garantuar një mbrojtje të veçantë për pozitën institucionale të Prokurorit të Përgjithshëm dhe për pavarësinë e institucionit të prokurorisë nga ndërhyrjet politike.

Nga ana tjetër, neni 16, pika 10 të ligjit nr. 7491, datë 29.04.1991 “Për dispozitat kryesore kushtetuese”, i jepte Kuvendit Popullor të drejtën e kontrollit mbi Prokurorinë e Përgjithshme dhe drejtuesit e saj. Sipas Gjykatës Kushtetuese, ky kontroll nuk ishte thjesht formal apo deklarativ, por mbarte me vete të drejtën për të marrë masa ndaj drejtuesve të prokurorisë në rast të zbulimit të shkeljeve ose paafësive që ndiknin në funksionimin e institucionit.

Në këtë kontekst, Kuvendi Popullor, në vendimin e tij për shkarkimin e Prokurorit të Përgjithshëm M. H., përmendte disa arsye, si dobësi të theksuara në punë, mungesë objektiviteti, zvarritje të çështjeve penale dhe një emërim të paligjshëm në kundërshtim me rregullat. Megjithatë këto arsye nuk përfshiheshin në mënyrë të shprehur në dy rastet e parashikuara nga neni 6 i ligjit nr. 7561/1992, Kuvendi mesa duket u mbështet në të drejtën e tij për të ushtruar kontroll dhe për të marrë sanksione bazuar në nenin 16, pika 10 të ligjit nr. 7491/1991. Kjo e drejtë u interpretua nga Gjykata Kushtetuese, si një normë me po aq vlerë kushtetuese sa ajo e parashikuar nga neni 6 i ligjit kushtetues të vitit 1992, duke arritur në përfundimin se Kuvendi mund të merrte masa edhe për shkelje të tjera të detyrës, përveç rasteve të kufizuara të parashikuara në nenin 6 të ligjit nr. 7561/1992.

Në këtë mënyrë, Gjykata Kushtetuese bëri një interpretim zgjerues të kompetencave të Kuvendit Popullor, duke mos e kufizuar të drejtën e këtij organi vetëm në dy rastet e parashikuara shprehimisht për shkarkimin e Prokurorit të Përgjithshëm. Argumenti kryesor i Gjykatës ishte se kufizimi i kontrollit të Kuvendit vetëm në këto dy raste do të bënte parashikimin e nenit 16, një dispozitë pa vlerë juridike në praktikë dhe kjo do të krijonte një mbrojtje të pashpjegueshme për Prokurorin e Përgjithshëm, duke e vendosur atë në një pozitë të privilegjuar, në raport me të gjitha institucionet e tjera shtetërore. Në këtë mënyrë, ky vendim krijonte një normë të re juridike, që zgjeronte kuptimin e shkarkimit përtej kufijve të parashikuar nga neni 6 i ligjit nr. 7561/1992.

Qëndrimi i mësipërm u plotësua më tej nga Gjykata Kushtetuese, e cila mbajti qëndrimin se “Gjykata Kushtetuese me Vendimin e saj nr. 12, datë 28.10.1992, ka pranuar se Kuvendi Popullor duke pasur të drejtën të kontrollojë veprimtarinë e Prokurorit të Përgjithshëm, që parashikohet me dispozitë

të shprehur kushtetuese (neni 16, pika 10 i ligjit “Për dispozitat kryesore kushtetuese”) ka edhe të drejtën e marrjes së masave deri në largimin e tij nga detyra. Në atë vendim nuk kanë qenë objekt shqyrtimi format e atij kontrolli. Një nga mënyrat e ushtrimit të kontrollit është edhe pyetja e Prokurorit të Përgjithshëm në seancë plenare, në lidhje me aspekte të veprimtarisë së tij, e parashikuar në nenin 82 të Rregullores së Kuvendit Popullor. Pretendimi i ngritur prej tij, se paraqitja vjen në kundërshtim me nenin 1 të ligjit nr.7561, datë 29.04.1992 “Për disa ndryshime e plotësime në ligjin nr. 7491, datë 29.04.1991 “Për dispozitat kryesore kushtetuese”, që parashikon pavarësinë e pushtetit gjyqësor dhe nenit 13 të atij ligji që parashikon se Prokuroria organizohet e funksionon brenda sistemit gjyqësor nuk qëndron. Kjo për faktin se sipas nenit 5 të të njëjtit ligj, Prokuroria nuk përfshihet në pushtetin gjyqësor, por vetëm se organizohet e funksionon brenda atij pushteti, si organ unik dhe i centralizuar d.m.th., që ka varësi hierarkike”.¹⁶⁵

Ky vendim përfaqëson një zhvillim të mëtijshëm të jurisprudencës kushtetuese, në lidhje me raportin ndërmjet Kuvendit Popullor dhe Prokurorisë së Përgjithshme, duke konsoliduar qëndrimin e mëparshëm të shprehur në vendimin e sipërcituar për shkarkimin e Prokurorit të Përgjithshëm. Siç e trajtuam, në atë vendim, Gjykata kishte njohur të drejtën e Kuvendit për të kontrolluar veprimtarinë e Prokurorisë së Përgjithshme dhe për të marrë masa deri në shkarkimin e titullarit, duke interpretuar në mënyrë zgjeruese (gati normë-krijuese), nenin 16, pika 10 i ligjit “Për dispozitat kryesore kushtetuese”. Megjithatë, në vendimin e parë, nuk ishin trajtuar format konkrete të ushtrimit të këtij kontrolli, çështje që u bë objekt shqyrtimi në këtë vendim.

Tashmë, Gjykata Kushtetuese plotësoi më tej jurisprudencën e saj, duke pranuar se pyetja e Prokurorit të Përgjithshëm në seancë plenare nga Kuvendi Popullor ishte një formë legjitime e ushtrimit të kontrollit parlamentar mbi veprimtarinë e Prokurorisë. Ky qëndrim, ndonëse dukej si një ndërhyrje në pavarësinë e organit të akuzës, u argumentua, si e lejueshme nga gjykata, duke qenë se prokuroria, sipas kuadrit kushtetues të asaj kohe, nuk bënte pjesë në mënyrë të mirëfilltë në pushtetin gjyqësor, por funksiononte pranë tij, si organ unik dhe i centralizuar, me varësi hierarkike. Duke u mbështetur në nenin 5 të ligjit kushtetues nr. 7561/1992, Gjykata theksoi se kuptimi i pavarësisë së pushtetit gjyqësor nuk mund të shtrihej në të njëjtën mënyrë mbi Prokurorinë, pasi kjo e fundit kishte një natyrë të ndryshme nga gjykatat dhe i nënshtrohej një kontrolli të vazhdueshëm nga Kuvendi Popullor.

Për menaxhimin e sistemit të drejtësisë, ligji kushtetues parashikonte krijimin e Këshillit të Lartë të Drejtësisë, që kryesohej nga Presidenti i Republikës dhe kishte në përbërjen e tij Kryetarin e Gjykatës së Kasacionit, Ministrin e Drejtësisë, Prokurorin e Përgjithshëm, si dhe 9 juristë të njohur për aftësitë e tyre, që zgjidheshin një herë në pesë vjet në

165. Vendimi nr. 2, datë 25.02.1994 i Gjykatës Kushtetuese.

mbledhjen e përbashkët të Gjykatës së Kasacionit dhe të Prokurorisë së Përgjithshme, pa të drejtë rizgjedhjeje të menjëhershme. Këshilli i Lartë i Drejtësisë përcaktohej si i vetmi autoritet, që vendoste për emërimin, lëvizjen dhe përgjegjësinë disiplinore të gjyqtarëve të shkallës së parë, të apelit, si dhe të prokurorëve.¹⁶⁶

Krijimi i këtij institucioni përbënte një hap të rëndësishëm drejt ndërtimit të një sistemi të pavarur dhe të balancuar të drejtësisë, duke reflektuar nevojën e domosdoshme për të distancuar pushtetin gjyqësor nga ndikimi politik dhe autoritar, që kishte karakterizuar periudhën komuniste. Deri në atë kohë, sistemi i drejtësisë në Shqipëri ishte organizuar mbi parimin e centralizimit të skajshëm dhe nën kontrollin e plotë të partisë-shtet, çka e kishte zhveshur atë nga çdo pavarësi funksionale. Risia që solli krijimi i këtij organi, qëndronte pikërisht në rolin e tij, si një garant institucional për mbrojtjen e pavarësisë së gjyqtarëve dhe prokurorëve, duke i mbrojtur ata nga ndërhyrjet arbitrare të pushtetit ekzekutiv dhe legjislativ. Përbërja e tij heterogjene dhe fakti që kryesohej nga Presidenti i Republikës, si një figurë mbi-partiake, së bashku me përfshirjen e juristëve të njohur dhe të institucioneve kyçe të drejtësisë, përfaqësonte një përpjekje për të krijuar një strukturë gjithëpërfshirëse dhe të qëndrueshme. Nëpërmjet krijimit të këtij Këshilli synohej krijimi i një kulturë të re, të përgjegjshmërisë dhe integritetit në sistemin gjyqësor dhe atë prokurorial, duke sjellë një standard të ri në administrimin e këtij sistemi, të domosdoshëm për një shtet të së drejtës në fillimet e tij demokratike.

Legjislacioni kushtetues i kësaj kohe, trajtonte vetëm përgjegjësinë disiplinore të gjyqtarëve të Gjykatës së Kasacionit dhe të Prokurorit të Përgjithshëm e zëvendësve të tij, por nuk kishte parashikime për mënyrën e inspektimit dhe përgjegjësisë disiplinore të gjyqtarëve dhe prokurorëve të tjerë. Kjo u mundua që të rregullohej nëpërmjet legjislacionit të zakonshëm, i cili u miratua në bazë dhe për zbatim të këtyre parashikimeve kushtetuese.

2. Inspektimi dhe përgjegjësia disiplinore e gjyqtarëve dhe prokurorëve, sipas ligjit nr. 7574, datë 24.06.1992 “Për organizimin e drejtësisë dhe disa ndryshime në kodet e procedurave penale e civile”

Ligji kushtetues nr. 7561, datë 29.04.1992 “Për organizimin e drejtësisë dhe Gjykatës Kushtetuese”, në nenin 10 të tij, parashikonte se “Gjyqtarët e shkallës së parë dhe të apelit kanë imunitet dhe nuk mund të lëvizin nga detyra gjatë ushtrimit të funksioneve të tyre. Heqja e imunitetit dhe

166. Ligji nr. 7561/1992, neni 15.

lëvizja e tyre mund të bëhet vetëm nga organi kompetent, në rastet dhe sipas procedurës së caktuar me ligj". Ndërsa më tej, në nenin 15 parashikohej që lëvizja e tyre, si edhe përgjegjësia disiplinore vendosej nga Këshilli i Lartë i Drejtësisë. Siç rezulton nga përmbajtja e kësaj dispozite, parashikohej, në nivel kushtetues, mundësia që gjyqtarët të lëvizin nga detyra vetëm nga organi kompetent, në këtë rast vetë KLD-ja, në rastet dhe sipas procedurës së caktuar me ligj. Përsa i përket prokurorëve, *vlenin* dispozitat që parashikonin organizimin dhe funksionimin e sistemit të prokurorisë vetëm me ligj, imunitetin e prokurorëve, mundësinë e lëvizjes së tyre si dhe marrjen në përgjegjësi disiplinore, po nga ana e Këshillit të Lartë të Drejtësisë.

Bazuar në këto rregullime të reja kushtetuese, ligji i parë që doli në sistemin demokratik me qëllim reflektimin e këtyre parashikimeve, ishte ligji nr. 7574, datë 24.06.1992 "Për organizimin e drejtësisë dhe disa ndryshime në kodet e procedurave penale e civile".

Ky ligj përfaqësonte një moment kyç në reformimin e sistemit të drejtësisë shqiptare, pas rënies së regjimit komunist. Ai rregullonte strukturën dhe funksionimin e gjykatave, prokurorisë dhe hetuesisë, duke përcaktuar rolin dhe kompetencat e secilës hallkë në sistemin e ri të drejtësisë. Gjykatat u organizuan në tri nivele: gjykatat e rretheve si hallka themelore, gjykatat e apelit dhe Gjykata e Kasacionit, e cila shqyrtonte ligjshmërinë e vendimeve të formës së prerë dhe ankesat për dënime me vdekje.

Një risi e rëndësishme ishte përcaktimi i rolit të prokurorisë, si organ i pavarur, që ushtronte ndjekjen penale dhe drejtonte hetimin. Prokurorët dhe hetuesit kishin kompetenca të qarta për nisjen dhe mbylljen e çështjeve penale, ndërsa policia hetimore vepronte nën mbikëqyrjen e tyre. Një tjetër element thelbësor ishte krijimi i një mekanizmi disiplinor për gjyqtarët, prokurorët dhe hetuesit, si dhe masat disiplinore përkatëse, të cilat jepeshin nga Këshilli i Lartë i Drejtësisë.

Gjithashtu, ligji siguronte imunitetin për gjyqtarët, prokurorët dhe hetuesit, duke ndaluar arrestimin ose ndjekjen e tyre penale, pa miratimin e organit që i kishte emëruar, përveç rasteve kur kapeshin në flagrancë duke kryer një krim të rëndë. Përmes këtij rregullimi synohej mbrojtja e pavarësisë së sistemit gjyqësor nga ndërhyrjet e mundshme të ekzekutivit dhe legjislativit.

2.1 Inspektimi i gjyqtarëve dhe prokurorëve

Shkëputja nga mendësia dhe kultura juridike e kaluar, nuk mund të bëhej lehtë. Kjo duket qartë në mënyrën se si ishte formuluar ligji nr. 7574, datë 24.06.1992 "Për organizimin e drejtësisë dhe disa ndryshime në kodet e procedurave penale e civile", i cili nuk kishte asnjë parashikim

për mënyrën e inspektimit kundrejt gjyqtarëve dhe prokurorëve.

Të vetmet rregullime ishin ato me karakter të përgjithshëm, të parashikuara nga Ligji kushtetues nr. 7561, datë 29.04.1992 "Për organizimin e drejtësisë dhe Gjykatës Kushtetuese", të cituara dhe më sipër. Për të kuptuar më mirë boshllëkun legjislativ që ekzistonte në këtë fushë, i referohemi jurisprudencës së kohës, ku ndër të tjera, është konstatuar se "Zoti U. B., deri në marrjen e vendimeve të Këshillit të Lartë të Drejtësisë të kundërshtuara prej tij në këtë Gjykatë, ka punuar si gjyqtar pranë Gjykatës së Rrethit Tiranë. Në datë 21.10.1993, i është komunikuar verbalisht vendimi datë 20.10.1993 i Këshillit të Lartë të Drejtësisë për transferimin e tij si kryetar në Gjykatën e Rrethit Laç. Kjo provohet edhe me shkresën nr. 353/2, datë 03.03.1994 të Ministrisë së Drejtësisë bashkëngjitur me materialet e dosjes ku thuhet shprehimisht:

"Në zbatim të vendimit të Këshillit të Lartë të Drejtësisë nr. 10, datë 20.10.1993, në kuadrin e riorganizimit dhe të përmirësimit të funksioneve të organeve të drejtësisë, z. U. B., është transferuar nga Gjykata e Tiranës në detyrën e kryetarit të Gjykatës së Rrethit Laç".

Për të kërkuar sqarime rreth vendimit të marrë në mungesë Z. B., i është drejtuar Ministrit të Drejtësisë dhe Kryetarit të Këshillit të Lartë të Drejtësisë, por nuk ka marrë përgjigje.

Në datë 25.11.1993 ka marrë dijeni për vendimin tjetër, nr. 12, datë 12.11.1993 me të cilin urdhërohej kalimi i tij në asistencë.

Sa më lart provohet edhe me shkresën me nr. 353/2, datë 03.03.1994 të Ministrisë së Drejtësisë me këtë përmbajtje: "Në zbatim të vendimit të Këshillit të Lartë të Drejtësisë nr. 12, datë 12.11.1993, në kuadrin e riorganizimit dhe të përmirësimit të funksioneve të organeve të drejtësisë, z. U. B., meqenëse nuk është paraqitur në detyrën e Kryetarit të Gjykatës së Rrethit të Laçit, kalon në asistencë".

Për të pasur prova më të plota për gjykimin e kësaj çështjeje, Gjykata Kushtetuese ka kërkuar nga Ministria e Drejtësisë, që në bazë të nenit 20 paragrafi i fundit të ligjit nr. 7574, datë 24.06.1992, si organ që i paraqet materialet përkatëse për gjyqtarët, Këshillit të Lartë të Drejtësisë, si dhe nga vetë Këshilli i Lartë i Drejtësisë, rregulloren e punës të këshillit, procesverbalin e gjykimit të çështjes dhe vendimet e dhëna prej atij këshilli, si dhe është kërkuar që një anëtar i këshillit, ose një përfaqësues i tij, të japë shpjegimet e nevojshme para kësaj Gjykate.

Duke qenë se Rregullorja e Këshillit të Lartë të Drejtësisë nuk rezulton të jetë botuar për t'iu bërë e njohur masës së gjyqtarëve e prokurorëve, dhe as iu vu në dispozicion Gjykatës Kushtetuese, me gjithë insistimin e saj, kjo Gjykatë krijon bindjen se Këshilli i Lartë i Drejtësisë e ka gjykuar çështjen pa pasur rregulloren përkatëse. Kjo bie në kundërshtim me nenin 10 të ligjit kushtetues nr. 7561, datë 29.04.1992 të vënë në mbrojtje të gjyqtarëve, sipas të cilit, "Gjyqtarët e shkallës së parë dhe të apelit kanë imunitet dhe nuk mund të lëvozen nga detyra gjatë ushtrimit

të funksioneve të tyre. Heqja e imunitetit dhe lëvizja e tyre mund të bëhet vetëm nga organi kompetent në rastet dhe sipas procedurës së caktuar me ligj”.

...
Gjithashtu, nga shqyrtimi në tërësi i çështjes, rezultojnë të provuara pretendimet e kërkuarit, sipas të cilave, atij as i është bërë e ditur më parë se përse do të gjykohej, as është thirrur e as ka marrë pjesë në gjykimin e çështjes së tij, d.m.th., nuk i është dhënë mundësia për të dhënë shpjegime e për t’iu dëgjuar arsyet që mund të parashtronte.

Gjithashtu atij nuk i është dhënë ndonjë vendim i arsyetuar në fakte e në ligj, si dhe mundësia për t’u ankuar në një organ kompetent shtetëror.

Për të arritur në përfundime të plota e objektive Gjykata Kushtetuese insistoi në kërkimin e procesverbalit të gjykimit të shqyrtimit të çështjes, por fakti që ky procesverbal nuk u paraqit, të çon në përfundimin që ky procesverbal ose nuk është i rregullt, ose nuk është mbajtur fare. I pajustificueshëm e i papajustificueshëm me standardet e një shteti juridik është edhe refuzimi për të dërguar në gjyq një përfaqësues të Këshillit të Lartë të Drejtësisë, për të dhënë shpjegimet e nevojshme rreth procedurës së ndjekur për gjykimin e kësaj çështjeje.

Duke u nisur nga të dhënat për mënyrën e gjykimit të çështjes së gjyqtarit U. B., nga fakti i mungesës së një rregulloreje të Këshillit të Lartë të Drejtësisë të miratuar e të botuar rregullisht, Gjykata Kushtetuese arrin në përfundimin se në rastin konkret është shkelur edhe e drejta kushtetuese për një proces të rregullt ligjor, e parashikuar në nenin 38 të ligjit kushtetues “Për të Drejtat dhe Liritë Themelore të Njeriut” nr. 7692, datë 31.03.1993. Kur dispozita kushtetuese e lartpërmendur, parashikon se “Liria, prona ose të drejtat e pranuar me ligj nuk mund të cenohen pa një proces të rregullt ligjor”, ajo nuk ka parasysh vetëm qytetarët e thjeshtë, por edhe ata që gjykojnë të tjerët, d.m.th., gjyqtarët. Gjyqtarët kanë një status të përcaktuar në dispozita kushtetuese, në ligjin mbi organizimin gjyqësor, si dhe në dispozita të akteve ndërkombëtare të gjithë pranuar në shtetet demokratike e juridike. Të drejtat që ata gëzojnë në bazë të dispozitave të lartpërmendura, nuk mund të preken, veçse në rastet e parashikuara shprehimisht në këto dispozita dhe sipas procedurave të pranuar po në to”.¹⁶⁷

Nga pasazhet e mësipërme kuptohet, se kishte disa problematika serioze, që lidhnin me inspektimin dhe disiplinën e gjyqtarëve dhe prokurorëve në atë kohë. E para dhe më e rëndësishmja, ishte mungesa e një rregulloreje të miratuar dhe të botuar në mënyrë të rregullt nga Këshilli i Lartë i Drejtësisë, e cila do të përcaktonte qartë procedurat që duhet të ndiqeshin gjatë gjykimit të çështjeve disiplinore. Kjo mungesë krijonte një boshllëk të madh ligjor dhe hapte rrugën për vendimmarrje të njëanshme dhe të paargumentuara. Rasti konkret tregoi se gjyqtari nuk ishte informuar për procesin kundrejt tij, nuk ishte thirrur për të dhënë shpjegime dhe nuk i ishte dorëzuar një

167. Vendimi nr. 8, datë 03.11.1994 i Gjykatës Kushtetuese.

vendim i arsyetuar, duke u privuar kështu nga e drejta për një proces të rregullt ligjor.

Gjykata Kushtetuese, në vendimmarrjen e saj, theksoi rëndësinë e respektimit të të drejtave kushtetuese të gjyqtarëve, duke vënë në dukje se ata, si garantë të drejtësisë, gëzonin një status të veçantë ligjor dhe kushtetues, i cili nuk mund të cenohej përveçse në rastet dhe sipas procedurave të përcaktuara qartë në ligj. Refuzimi i Këshillit të Lartë të Drejtësisë për të dërguar një përfaqësues dhe për të ofruar dokumentacionin e nevojshëm për shqyrtimin e çështjes, tregonte mungesën e transparencës dhe profesionalizmit në menaxhimin e procedurave disiplinore. Kjo situatë tregonte edhe për nevojën urgjente për një kuadër ligjor më të qartë dhe të plotë për inspektimin dhe disiplinën e gjyqtarëve, si dhe për forcimin e garancive të pavarësisë së tyre.

Nga ky rast mund të kuptohet, se ndonëse ishte bërë një hap drejt reformimit të sistemit të drejtësisë, mangësitë e konstatuara tregojnë se shkëputja nga kultura juridike e së kaluarës dhe ndërtimi i një drejtësie të pavarur dhe të drejtë kërkonte një rregullim më të mirë dhe më të plotë të mekanizmave disiplinorë. Vetëm përmes respektimit të procesit të rregullt ligjor dhe krijimit të një sistemi të drejtë inspektimi, mund të sigurohej një sistem drejtësie funksional dhe i besueshëm.

Këshilli i Lartë i Drejtësisë mesa duket, reagoi më vonë duke miratuar një “rregullore”, por edhe ky akt, *përveçse nuk u publikua në Fletoren Zyrtare, krijonte vetëm të drejta për këtë institucion dhe jo për gjyqtarët, siç rezulton nga arsyetimi vijues i Gjykatës Kushtetuese, se “Kërkuesit Xh. B., I. T., K. B., E. V., A. G., K. K., Gj. D., Gj. L. dhe B. L., kanë qenë gjyqtarë në gjykatat e rretheve Kukës, Tiranë, Mat, Vlorë, Kurbin dhe Shkodër dhe me vendimet nr. 1, datë 30.03.1995; nr. 7, datë 06.02.1996 dhe nr. 8, datë 23.08.1996 të Këshillit të Lartë të Drejtësisë, janë liruar nga detyra e gjyqtarit, sipas rastit, me motivacionet “për shkelje të rëndë të disiplinës në punë”, “për shkelje të etikës së gjyqtarit”, “për shkelje të ligjit dhe paaftësi në detyrë”.*

Gjatë gjykimit të çështjes rezultoi se në të gjitha këto raste Këshilli i Lartë i Drejtësisë i ka marrë vendimet pa i thirrur kërkuesit dhe pa iu dhënë atyre asnjë mundësi të mbrohen duke parashtruar pretendimet dhe arsyet e tyre.

Marrjen e masave ndaj kërkuesve nga ana e Këshillit të Lartë të Drejtësisë, pa iu dhënë mundësi të mbrohen, Gjykata e çmon cenim të procesit të rregullt ligjor, të sanksionuar si parim kushtetues në nenin 38 të ligjit nr. 7692, datë 31.03.1993 “Të Drejtat dhe Liritë Themelore të Njeriut”.

Parimi i domosdoshmërisë së dëgjimit të gjyqtarit prej organit që shqyrton marrjen e masave disiplinore ndaj tij parashikohet edhe në “Parimet themelore në lidhje me pavarësinë e drejtësisë”, të miratuara nga Asambleja e Përgjithshme e Kombeve të Bashkuara me rezolutat e saj 40/32 të 29 nëntorit 1985 dhe 40/146 të 13 dhjetorit 1985, ku në pikën 17 thuhet: “Çdo akuzë ose ankesë kundrejt një gjyqtari në ushtrimin e funksioneve të tij gjyqësore dhe profesionale duhet

të shqyrtohet sipas procedurës më të përshtatshme. gjyqtari ka të drejtë të përgjigjet”.

Rrjedhimisht, vendimet e sipërpërmendura të Këshillit të Lartë të Drejtësisë, për lirimin e kërkuesve Xh. B., I. T., K. B., A. G., E. V., K. K., Gj. D., Gj. L., dhe B. L., nga detyra e gjyqtarit, duhet të shfuqizohen dhe Këshilli i Lartë i Drejtësisë të rishqyrtojë çështjet e secilit kërkues duke i dhënë atyre mundësi të mbrohen. Pretendimet e tyre lidhur me akuzën që u bëhet duhet të verifikohen në mënyrë të hollësishme e të detajuar. Vetëm pas një procedure të tillë të rregullt ligjore, Këshilli i Lartë i Drejtësisë do të mund të japë vendime të arsyetuara e të bazuara në ligj.

Gjatë shqyrtimit të çështjes u konstatua gjithashtu, se në fjalinë e dytë të nenit 11 të Rregullores nr. 1/1, datë 30.03.1995 “Për mënyrën e funksionimit e të ushtrimit të veprimtarisë së Këshillit të Lartë të Drejtësisë” thuhet: “Kur e gjykon të nevojshme, Këshilli i Lartë i Drejtësisë mund të thërrasë në mbledhje, t’i drejtojë pyetje e të kërkojë shpjegime drejtpërdrejt nga punonjësi ndaj të cilit është kërkuar marrja e masës disiplinore”. Gjykata çmon se kjo vjen në kundërshtim me nenin 38 të ligjit nr. 7692, datë 31.03.1993 “Të Drejtat dhe Liritë Themelore të Njeriut”, sepse lihet në diskrecionin e Këshillit të Lartë të Drejtësisë, të thërrasë ose jo personin ndaj të cilit merret masa disiplinore ose transferohet”.¹⁶⁸

Gjykata Kushtetuese, në shqyrtimin e kësaj situate të re, ku Këshilli i Lartë i Drejtësisë kishte miratuar një rregullore, por nuk e kishte publikuar dhe kishte liruar disa gjyqtarë nga detyra pa iu dhënë mundësinë për t’u mbrojtur, e konsideroi cenim të së drejtës për një proces të rregullt ligjor, mbrojtjeje, e cila shtrihej edhe për këta funksionarë. Gjykata konstatoi se rregullorja e KLD-së, jo vetëm që nuk ishte bërë publike për të qenë e njohur nga gjyqtarët, por në përmbajtjen e saj krijonte një situatë të papranueshme, duke e vendosur në diskrecionin e Këshillit, thirrjen ose jo të gjyqtarit për të dhënë shpjegime gjatë shqyrtimit të masës disiplinore ndaj tij. Kjo përbënte një cenim të drejtpërdrejtë të parimit të të drejtave procedurale të gjyqtarëve, megjithëse ishin të njohura nga aktet kushtetuese dhe ndërkombëtare.

Gjykata Kushtetuese theksoi se çdo masë disiplinore ndaj gjyqtarëve, duhej të bazohej në një procedurë të drejtë, transparente dhe të argumentuar ligjërisht. Në këtë rast, mungesa e thirrjes së gjyqtarëve për t’u dëgjuar dhe dhënia e vendimeve, pa u bazuar në një proces të plotë shqyrtimi e bënte të paligjshme dhe të pabazuar procedurën e ndjekur nga KLD-ja. Për këtë arsye, Gjykata vendosi shfuqizimin e vendimeve të KLD-së dhe urdhëroi rishqyrtimin e çështjeve, duke kërkuar që gjyqtarëve t’u jepej mundësia të parashtronin pretendimet e tyre dhe t’u garantoheshin të gjitha të drejtat për një proces të drejtë.

Ky vendim i Gjykatës Kushtetuese përforcoi qasjen e saj të mëparshme, sipas së cilës inspektimi dhe përgjegjësia disiplinore e

168. Vendimi nr. 15, datë 03.06.1997 i Gjykatës Kushtetuese.

gjyqtarëve duhej të kryheshin në përputhje të plotë me standardet kushtetuese dhe ndërkombëtare. Në këtë rast u evidentua, se edhe pas miratimit të rregullores nga KLD-ja, procedurat e ndjekura nga ky organ vazhdonin të ishin të paplota dhe të njëanshme, duke rrezikuar jo vetëm pavarësinë e gjyqtarëve, por edhe integritetin e sistemit të drejtësisë në tërësinë e tij. Në këtë mënyrë, Gjykata Kushtetuese, mbajti qëndrimin e prerë se respektimi i procedurave të rregullta dhe garantimi i të drejtave të mbrojtjes përbënin shtylla të të rëndësishme për funksionimin e drejtësisë në një shtet demokratik.

2.2 Përgjegjësia dhe masat disiplinore

Përsa i përket rasteve dhe shkaqeve, se kur gjyqtarët dhe prokurorët mbanin përgjegjësi disiplinore, ky ligj parashikonte që gjyqtarët, ndihmësgjyqtarët, prokurorët dhe hetuesit mund të largoheshin nga detyra me vendim të Këshillit të Lartë të Drejtësisë kur kryenin një veprë penale, bëheshin të paaftë nga ana shëndetësore, nuk fitonin provimin periodik profesional, për shkelje të rëndë të disiplinës në punë, si dhe për cenim të figurës morale.¹⁶⁹

Siç mund të konstatohet nga ky parashikim, dispozita trajtonte në mënyrë të përgjithshme rastet e largimit të gjyqtarëve dhe prokurorëve nga sistemi i drejtësisë. Nga tërësia e këtyre rasteve, vetëm tre prej tyre dhe konkretisht kryerja e një veprë penale, shkelje e rëndë e disiplinës në punë, si edhe cenimi i figurës morale, ishin raste që mund të klasifikohen si shkaqe disiplinore.

Në një nga rastet e para të vlerësimit të këtyre parashikimeve, e lidhur me një mosmarrëveshje konkrete, Gjykata Kushtetuese ka mbajtur qëndrimin, se *“Rastet e largimit nga puna të gjyqtarëve parashikohen në nenin 19 të ligjit nr. 7574, datë 24.06.1992. Ndër to nuk përfshihet “riorganizimi e përmirësimi i funksioneve të organeve të drejtësisë”. Gjithashtu, nga materialet e çështjes nuk rezulton që zoti U.B. të ketë kryer ndonjë shkelje disiplinore, por, edhe sikur të pranohej ekzistenca e një shkeljeje të tillë, atëherë Këshilli i Lartë i Drejtësisë, do të kishte të drejtë të merrte njërën nga masat disiplinore të parashikuara në nenin 20 të këtij ligji. As në këtë nen, as në ndonjë dispozitë tjetër ligjore, që ka të bëjë me statusin dhe garancitë e gjyqtarit, nuk përfshihet një masë e tillë.*

Duke qenë se gjyqtari U. B., është transferuar pa iu marrë pëlqimi dhe më vonë është hequr nga detyra, në të dy rastet, pa një shkak të parashikuar në dispozitat kushtetuese ose në dispozita të tjera ligjore të nxjerra në pajtim me ato kushtetuese, arrijmë në përfundimin se në rastin konkret është shkelur parimi kushtetues i patundshmërisë së gjyqtarëve gjatë mandatit përkatës të ushtrimit të detyrës së tyre.

169. Ligji nr. 7574/1992, neni 19.

Si rrjedhojë është cenuar edhe parimi tjetër kushtetues i pavarësisë së pushtetit gjyqësor, pasi gjyqtari mbetet kësisoj, pa iu garantuar mbrojtje përkatëse”.¹⁷⁰

Qasja e Gjykatës Kushtetuese në rastin e mësipërm, tregon për një respektim të fortë të parimit të patundshmërisë dhe pavarësisë së pushtetit gjyqësor. Në rastin konkret, Gjykata Kushtetuese arriti në përfundimin se vendimi i Këshillit të Lartë të Drejtësisë për transferimin dhe më pas largimin e tij nga detyra nuk kishte asnjë bazë ligjore, pasi në dispozitat ekzistuese të ligjit nuk parashikohej si masë ndëshkuese, largimi apo transferimi për arsye të “riorganizimit ose përmirësimit të funksioneve” të organeve të drejtësisë. Duke mos pasur një shkeljeje disiplinore konkrete veprimi i KLD-së, kishte cenuar rëndë parimin e patundshmërisë së gjyqtarëve, një element themelor për garantimin e pavarësisë së tyre në ushtrimin e funksioneve. Kjo qasje e Gjykatës tregoi një qëndrim të qartë për të mbrojtur statusin dhe garancitë e gjyqtarëve, duke theksuar se çdo ndërhyrje në detyrën e tyre duhej të ishte e justifikuar, bazuar në shkaqe konkrete dhe me bazë të qartë kushtetuese dhe ligjore.

Pavarësisht qëndrimit të mësipërm, KLD-ja e përsëriti sërish të njëjtën situatë me vonë dhe përsëri Gjykata Kushtetuese u detyrua që të shprehej, se “Ndërsa kërkuesi S. S., ka qenë gjyqtar në Gjykatën e Rrethit Vlorë dhe me vendimin nr. 7, datë 06.02.1996 të Këshillit të Lartë të Drejtësisë, është transferuar në Gjykatën e Rrethit Delvinë “për 2 vjet për riorganizimin e asaj gjykate” dhe më pas me vendimin nr. 8, datë 23.08.1996 të Këshillit të Lartë të Drejtësisë është liruar nga detyra e gjyqtarit, për shkak se nuk ka zbatuar vendimin e parë.

Gjykata çmon se të dy këto vendime duhen shfuqizuar, jo vetëm se cenojnë parimin kushtetues të procesit të rregullt ligjor të sanksionuar në nenin 38 të ligjit nr. 7692, datë 31.03.1993 për “Të Drejtat dhe Liritë Themelore të Njeriut” (sepse janë marrë pa u thirrur kërkuesi dhe pa iu dhënë atij mundësi të mbrohet), por edhe vijnë në kundërshtim me nenin 10 të ligjit kushtetues nr. 7561, datë 29.04.1992, sipas të cilit lëvizja e gjyqtarëve mund të bëhet vetëm nga organi kompetent dhe sipas procedurës së caktuar me ligj. Në asnjë dispozitë ligjore nuk parashikohet marrja e masës së largimit nga detyra të gjyqtarit kur ai nuk pranon “transferimin në një gjykatë tjetër për shkak riorganizimi”.

Në këtë drejtim kjo Gjykatë është shprehur edhe në vendimin e saj të mëparshëm nr. 7, datë 03.11.1994”.¹⁷¹

Ndoshta me qëllim për ta përmirësuar, ligjvënësi, me reformën e vitit 1995, parashikoi se gjyqtarët, ndihmësgjyqtarët, prokurorët dhe hetuesit largoheshin nga detyra me vendim të Këshillit të Lartë të Drejtësisë kur kryenin një vepër penale, bëheshin të paaftë nga ana shëndetësore, nuk fitonin provimin periodik profesional, si dhe kur ishin të paaftë nga ana

170. Vendimi nr. 8, datë 03.11.1994 i Gjykatës Kushtetuese.

171. Vendimi nr. 15, datë 03.06.1997 i Gjykatës Kushtetuese.

profesionale lidhur me bazueshmërinë e vendimeve të dhëna, ose kur për shkak të sjelljes së tyre, bëheshin të papërshtatshëm për të kryer detyrën.¹⁷²

Ndryshimet e bëra me reformën e vitit 1995 në lidhje me përgjegjësinë disiplinore të gjyqtarëve dhe prokurorëve përfaqësonin një përpjekje për të qartësuar dhe zgjeruar kuadrin normativ, duke adresuar disa boshllëqe që ekzistojnin në formulimin e mëparshëm të vitit 1992. Në formatin e saj fillestar, dispozita përkatëse trajtonte përgjegjësinë disiplinore në mënyrë të kufizuar, duke përmendur si shkaqe për largimin nga detyra, vetëm kryerjen e një veprë penale, shkeljen e rëndë të disiplinës në punë dhe cenimin e figurës morale. Megjithatë këto parashikime përfshinin elementë bazë të disiplinës, ato linin jashtë rregullimit situata të tjera, si paaftësia profesionale dhe sjellja e papërshtatshme në raport me funksionin e gjyqtarit apo prokurorit.

Për këtë arsye, reforma e vitit 1995 përfaqëson një përpjekje nga ana e ligjvënësit, për të shtuar edhe paaftësinë profesionale, si shkak për largimin nga detyra dhe duke futur një kriter më të qartë, në lidhje me bazueshmërinë e vendimeve të dhëna nga gjyqtarët. Ky ndryshim e zgjeronte konceptin e përgjegjësisë, duke e kaluar përtej thjesht sjelljes disiplinore apo morale dhe duke përfshirë elementë që lidhen me aftësinë dhe cilësinë profesionale të veprimtarisë së gjyqtarëve dhe prokurorëve. Gjithashtu, u parashikua largimi nga detyra për shkak të sjelljes së papërshtatshme, një formulim më i gjerë, që synonte të rregullonte çdo veprim që mund të minonte besimin e publikut tek drejtësia. Këto ndryshime shënuan një lloj përparimi drejt standardizimit të përgjegjësisë së gjyqtarëve dhe prokurorëve, duke rritur ndjeshëm kërkesat për etikë dhe kompetencë profesionale, në përputhje me pritshmëritë e një sistemi gjyqësor të besueshëm.

Nga praktika gjyqësore, si shkelje të rëndë të disiplinës në punë, sipas parashikimit të parë, apo si papërshtatshmëri për të kryer detyrën është vlerësuar rasti vijues, për të cilin Gjykata e Lartë, mbajti qëndrimin se *“Pas ngjarjeve të muajit mars 1997 paditësi R. D., është larguar nga detyra e gjyqtarit dhe deri në fund të muajit shtator 1997 nuk ka bërë asnjë njoftim për shkaqet e largimit dhe vendndodhjen e tij. Është e vërtetë që trazirat e kësaj periudhe shkaktuan dhe djegien e gjykatës dhe penguan funksionimin e rregullt të saj, por ndërsa punonjësit e tjerë në pritje për të rifilluar punën kanë mbajtur kontakte të vazhdueshme me njëri-tjetrin dhe organet e pushtetit në rreth, paditësi nuk është interesuar dhe paraqitur as edhe për të tërhequr pagën sa është detyruar punonjësjë e llogarisë me mandat arkëtimi nr. 556977 datë 7.9.1997 të arkëtojë në Buxhetin e Shtetit pagën për periudhën nga marsi-shtator 1997.*

Më datë 29.09.1997 me telegram nga Tirana paditësi ka njoftuar pranë

172. Ligji nr. 7919, datë 19.04.1995, neni 1.

Gjykatës së Rrethit Sarandë se është i sëmure, duke paraqitur për periudhën 15.09.-15.10.1997 dy raporte mjekësore për paaftësi të përkohshme, të cilat me të drejtë janë gjetur të pavlefshme dhe nuk janë marrë në konsideratë për të justifikuar mosparaqitjen në punë të paditësit për periudhën 1-mujore. Ato ndonëse janë lëshuar nga komisioni mjekësor i përberë nga tre vetë një prej tyre është nënshkruar nga dy mjekë dhe tjetri vetëm nga një mjek. Të dyja raportet i përkasin Poliklinikës Memaliaj, ndërsa telegrami për Gjykatën e Rrethit Sarandë është bërë me datë 29.09.1997 nga qyteti i Tiranës, veprime të cilat gjithashtu vënë në dyshim sinqeritetin dhe vërtetësinë e pretendimeve të paditësit për shkaqet e mosparaqitjes në punë.

Pretendimi i paditësit se në muajin nëntor 1997 është paraqitur në punë dhe ka gjykuar çështje penale dhe civile nuk ka rëndësi dhe nuk ndikon për të konkluduar lidhur me ligjshmërinë ose paligjshmërinë e vendimit të KLD-së sepse datat e gjykimit 09.11.1997 dhe 13.11.1997 i përkasin periudhës pas marrjes së vendimit të Këshillit të Lartë të Drejtësisë, organ i cili ka analizuar dhe shqyrtuar shkaqet e mosparaqitjes në punë të paditësit deri me datë 04.11.1997.

Përfundimisht për paditësin vërtetohet, se për një periudhë 8 muaj, jo vetëm nuk është paraqitur, por as është interesuar, si gjithë punonjësit e tjerë për mundësinë e rifillimit të punës çka tregon për mungesë serioziteti, përgjegjësie dhe përkushtimi, sjellje e cila me të drejtë është çmuar, se e bën paditësin të papërshtatshëm për të kryer detyrën e gjyqtarit. Kështu për këto shkelje disipline të konstatuara në punën e paditësit, largimi i tij nga detyra e gjyqtarit gjen mbështetje edhe në nenin 19 të ligjit nr. 7574 datë 24.06.1992 të ndryshuar me ligjin nr. 7119 datë 19.04.1995.

Fakti që deri në datën kur KLD ka marrë vendim për largim nga puna të paditësit nuk ka ndërprerje financiare, nuk tregon që ky i fundit ka qenë i lidhur me detyrën. Për shkak të situatës së krijuar, të gjithë punonjësit janë shpërblyer edhe pa punuar, por ndërsa të tjerët janë interesuar dhe paraqitur herë pas here për një periudhë 6 mujore, paditësi nuk ka treguar asnjë interesim për punën, sa është detyruar punonjësja e llogarisë me mandat arkëtimi të veçantë të kalojë në Buxhetin e Shtetit vetëm pagën e paditësit, çka gjithashtu tregon, se ai ishte larguar për një kohë të gjatë nga detyra.

Qëndrimi në drejtim të paditur, larg qendrës së punës dhe asaj të banimit ka vështirësuar edhe vënien në dijeni të paditësit për masën disiplinore që Ministri i Drejtësisë i propozon Këshillit të Lartë të Drejtësisë. Megjithatë mungesa e paditësit për t'u dëgjuar paraprakisht dhe për të parashtruar qëndrimin e tij para Këshillit të Lartë të Drejtësisë lidhur me masën disiplinore, që propozohet vërehet se nuk ka ndikuar në marrjen e një vendimi të pabazuar.

Në gjykimin e çështjes në Kolegje të Bashkuara paditësit i është krijuar mundësia të përfaqësohet me avokat, të japë shpjegime, të ngrejë pretendime dhe të paraqesë prova, pra i është krijuar mundësia për një proces të rregullt ligjor, por që në përfundim pas analizës dhe vlerësimit të të gjitha provave në punën e paditësit, konstatohen shkelje të tilla disiplinore, që përligjin plotësisht

edhe masën e marrë nga Këshilli i Lartë i Drejtësisë, për largim të paditësit nga detyra".¹⁷³

Ky arsyetim i Gjykatës së Lartë duket që pasqyron mjaft mirë, arsyet e reformës së vitit 1995, që zgjeronte përgjegjësinë e gjyqtarëve dhe prokurorëve, jo vetëm në shkeljet e rënda të disiplinës, ose kryerjen e veprave penale, por edhe sjelljen e papërshtatshme profesionale. Në rastin konkret, qëndrimi i gjyqtarit për një periudhë të gjatë jashtë detyrës dhe mungesa e interesit për të kryer funksionin për të cilin ishte emëruar, u interpretuan si sjellje që cenonte seriozisht figurën morale dhe përkushtimin profesional, duke përbërë shkak të mjaftueshëm për largimin e tij nga detyra.

Përsa i përket masave disiplinore, ligji parashikonte, që për shkelje të disiplinës në punë ndaj gjyqtarëve, prokurorëve dhe hetuesve, mund të merreshin masat disiplinore të vërejtjes, vërejtjes me paralajmërim për largim nga detyra, pezullimit nga puna deri në gjashtë muaj, transferimi, si edhe si masë ekstreme largimi nga detyra.¹⁷⁴

3. Inspektimi dhe përgjegjësia disiplinore e gjyqtarëve dhe prokurorëve, sipas ligjit nr. 8265, datë 18.12.1997 "Për organizimin e drejtësisë"

Duke qenë se ligji nr. 7574, datë 24.06.1992 "Për organizimin e drejtësisë dhe disa ndryshime në kodet e procedurave penale e civile", kishte mangësi të shumta në ligje me mënyrën e inspektimit të gjyqtarëve dhe prokurorëve, mënyrën e procedimit ndaj tyre, shkaqet që mund të sillnin përgjegjësinë disiplinore, si dhe për llojet dhe masat disiplinore që mund të merreshin, ligjvënësi e pa të nevojshme që të ndërhynte, duke miratuar ligjin nr. 8265, datë 18.12.1997, "Për organizimin e drejtësisë", i cili, ndryshe nga legjislacioni i mëparshëm, përfaqësonte një rregullim më të detajuar të sistemit të drejtësisë. Sistemi gjyqësor u organizua në tre nivele: gjykatat e shkallës së parë, gjykatat e apelit dhe Gjykata e Kasacionit, e cila, në përputhje me parashikimet kushtetuese, konsiderohej si autoriteti më i lartë për shqyrtimin e ligjshmërisë së vendimeve gjyqësore. Ligji përcaktoi kushtet për pranimin dhe emërimin e gjyqtarëve dhe prokurorëve, duke kërkuar përfundimin e Shkollës së Magjistraturës dhe përvojën profesionale për kandidatët. Ai vendosi gjithashtu ndalime të qarta për gjyqtarët dhe prokurorët, duke përfshirë ndalimin e pjesëmarrjes në veprimtari politike dhe të ushtrimit të aktiviteteve tregtare, me qëllim ruajtjen e pavarësisë dhe integritetit të tyre.

173. Vendimi nr. 1054, datë 28.09.1999 i Kolegjeve të Bashkuara të Gjykatës së Lartë.

174. Ligji nr. 7574/1992, neni 20.

Një nga risitë më të rëndësishme të këtij ligji ishte krijimi i Inspektoratit pranë Këshillit të Lartë të Drejtësisë, i cili do të kishte për detyrë të inspektonte gjykatat dhe prokuroritë, të verifikonte ankesat dhe të vlerësonte aftësitë profesionale të gjyqtarëve dhe prokurorëve. Kjo risi kishte për qëllim përmirësimin e disiplinës dhe eficiencës në sistemin gjyqësor. Ligji përcaktoi gjithashtu procedura më të qarta për vlerësimin e aftësive profesionale të gjyqtarëve dhe prokurorëve, ku vlerësimi “i paaftë”, përbënte shkak për largimin nga sistemi, ndërkohë që çdo vendim që mund të merrte Këshilli i Lartë i Drejtësisë, ndaj një gjyqtari apo prokurori mund të ankimohej në Gjykatën e Kasacionit, duke garantuar të drejtën për një proces të drejtë dhe të pavarur.

Ligji parashikonte përgjegjësi disiplinore të detajuar për gjyqtarët dhe prokurorët, duke specifikuar një gamë të gjerë shkeljesh, si zvarritjet e punës, mungesat pa arsye dhe sjelljet e pahijshme, të cilat mund të çonin në masa disiplinore, që varionin nga vërejtja, deri në largimin nga detyra. Në çdo rast ishte e detyrueshme, dëgjimi i gjyqtarit ose prokurorit, si dhe garantimi i një procesi të rregullt ligjor.

Në tërësinë e tij, ky ligj shënoi një përmirësim cilësor, në krahasim me legjislacionin e mëparshëm, për forcimin e sistemit me drejtësinë.

3.1 Inspektimi i gjyqtarëve dhe prokurorëve

Siç u përmend më sipër, pranë Këshillit të Lartë të Drejtësisë, ligji parashikonte krijimin e një inspektorati. Inspektorët do të vinin nga radhët e gjyqtarëve dhe prokurorëve që emëroheshin nga KLD-ja, të cilët ngarkoheshin që të inspektonin gjykatat e shkallës së parë dhe të apelit, si dhe prokuroritë pranë tyre, të verifikonin ankesat e shtetasve dhe të institucioneve, të inspektonin organizimet e shërbimeve gjyqësore, të bënë evidentimin e aftësive profesionale të gjyqtarëve dhe të prokurorëve, ngarkesën e tyre në punë, si dhe në tërësi eficiencën e gjykatave dhe të prokurorive. Ligji parashikonte më tej, që Ministri i Drejtësisë vinte në dispozicion të grupeve të inspektimit specialistët e tij, për të ndihmuar në kryerjen e këtyre detyrave. Megjithatë kjo ndihmë nuk shtrihej në rastin e vlerësimit të gjyqtarëve. Për detajet e mëtejshme, ligji ngarkonte KLD-në, që nëpërmjet një rregulloreje, të përcaktonte organizimin dhe funksionin e këtij inspektorati.¹⁷⁵

Ky parashikim plotësohej më tej, nga një tjetër dispozitë, e cila parashikonte që procedimi disiplinor për gjyqtarët, vihej në lëvizje nga ministri i Drejtësisë, ndërsa për prokurorët nga Prokurori i Përgjithshëm. Këto dy subjekte, mund të nisnin procedimin disiplinor, vetëm nëse ishin brenda tre viteve, nga data e kryerjes të shkeljes. Gjatë verifikimit, që bëhej nga inspektorët gjyqtarë ose prokurorë, duhej të përcaktohej,

175. Ligji nr. 8265/1997, neni 17.

nëse ishte kryer ndonjë shkelje e disiplinës nga ato të përcaktuara në ligj, lloji dhe rëndësia e shkeljes, fajësia e personit, si dhe të dhëna, mbi të cilat mbështeteshin përfundimet e nxjerra. Që në këtë fazë të inspektimit përcaktohej, se në çdo rast duhej të dëgjohej edhe gjyqtari apo prokurori, që kishte kryer shkeljen e pretenduar. Dispozita përcaktonte që inspektorët, në mënyrë të detyrueshme, duhej të verifikonin pretendimet e ngritura sipas rastit nga gjyqtari apo prokurori. Më pas, rezultatet e verifikimeve të bëra, si dhe të dhënat shkresore rreth tyre, inspektorët duhej t'i pasqyronin në një akt përfundimtar, i cili i bëhej i njohur gjyqtarit apo prokurorit, që pretendonte se kishte kryer shkeljen. Materialet e përfutuara nga inspektimi, i dërgoheshin sipas rastit, ministrit të Drejtësisë ose Prokurorit të Përgjithshëm dhe Këshillit të Lartë të Drejtësisë. Këshilli i Lartë i Drejtësisë para se të merrte vendimin, duhej të dëgjonte pretendimet e palëve në një seancë tjetër. Materialet e plota i viheshin në dispozicion gjyqtarit ose prokurorit, 10 ditë përpara zhvillimit të seancës. Magjistratët kishin të drejtë që të mbroheshin vetë ose me avokat gjatë seancës.¹⁷⁶

Ky lloj inspektimi i gjykatave dhe prokurorive, synonte të krijonte një mekanizëm formal për mbikëqyrjen dhe garantimin e disiplinës në sistemin e drejtësisë. Inspektorati që krijohej pranë KLD-së, kishte kompetenca të gjera për të shqyrtuar shkeljet disiplinore dhe për të përcaktuar fajësinë, rëndësinë e shkeljes dhe llojin e masës disiplinore, që mund të merrej.

Një aspekt pozitiv i këtij inspektimi ishte parashikimi i një procedure të detajuar dhe të dokumentuar, e cila kërkonte jo vetëm verifikimin e pretendimeve, por edhe dëgjimin e gjyqtarëve dhe prokurorëve të akuzuar për shkelje. Parashikimi i të drejtës për mbrojtje dhe përfaqësim me avokat gjatë seancës dëgjimore para Këshillit të Lartë të Drejtësisë, përfaqësonte një garanci të rëndësishme për të drejtat e gjyqtarëve dhe prokurorëve. Po ashtu, fakti që inspektorët ishin të zgjedhur nga radhët e profesionistëve të drejtësisë krijonte një bazë për një proces inspektimi më të informuar dhe të bazuar në njohjen e brendshme të sistemit.

Në këtë ligj, shohim për herë të parë mundësinë e përfshirjes së administratës së ministrisë së drejtësisë në inspektimin gjyqtarëve dhe prokurorëve, përmes specialistëve të saj. Siç do të trajtohet më tej, këtu gjendet edhe fillesa, që do të krijonte më vonë inspektoratin pranë ministrisë së drejtësisë, duke krijuar atë lloj dualizmi në inspektim, që do të karakterizojë periudhën e mëpasshme të inspektimeve në sistemin e drejtësisë.

Nga sa më sipër, ky lloj inspektimi dhe procedimi disiplinor në Shqipëri përfaqësonte një përpjekje për të rritur përgjegjshmërinë dhe llogaridhënien në sistemin e drejtësisë.

176. Ligji nr. 8265/1997, neni 44.

3.2 Përgjegjësia dhe masat disiplinore

Ligji i vitit 1997, kishte disa parashikime për raste e largimit të gjyqtarëve nga detyra. Kështu në këtë ligj parashikohej se gjyqtarët dhe prokurorët nuk mund të lëvizeshin nga detyra, me përjashtim të rasteve kur jepnin dorëheqjen, mbushnin moshën për pension, dënoheshin me heqje lirie me vendim të formës së prerë, konkludohej se ishin të paaftë për të kryer detyrën, nuk fitonin provimin periodik profesional të organizuar nga Këshilli i Lartë i Drejtësisë, merrnin masa disiplinore, kryenin veprime që lidheshin me pjesëmarrjen në parti politike, ose merrnin pjesë në veprimtari me karakter politik, si mandate zgjedhore, funksione publike apo private, si edhe, nëse ushtronin veprimtari tregtare dhe administrimi të shoqërive civile ose tregtare.

Më tej ligji parashikonte se kur ndaj gjyqtarit ose prokurorit vendosej fillimi i çështjes penale, ai mund të pezullohej nga detyra, derisa vendimi gjyqësor të merrte formë të prerë. Nëse në fund të procesit, rezultonte i pafajshëm, gjyqtari ose prokurori kishte të drejtë të rikthehej në punën e mëparshme, duke marrë edhe pagën, për të gjithë kohën që kishte qenë i pezulluar.¹⁷⁷

Për të përforcuar këtë moment, ky ligj parashikonte se të gjithë gjyqtarët dhe prokurorët kishin përgjegjësi për shkeljet e disiplinës, si dhe për kryerjen e veprimeve që mund të cenonin figurën e tyre dhe autoritetin e drejtësisë.¹⁷⁸

Duke detajuar më tej këtë parashikim, ligji përcaktonte si shkelje disiplinore, tetë rastet e mëposhtme:¹⁷⁹

1. *Kryerja e veprimeve që sipas ligjit janë të papajtueshme me funksionin e gjyqtarit dhe prokurorit*; Ky lloj parashikimi përfaqësonte një nga shkeljet më serioze disiplinore, pasi cenonte drejtpërdrejt parimin e pavarësisë, integritetit dhe paanshmërisë së sistemit të drejtësisë. Ligjvënësi e kishte parë të domosdoshme të ndalonte çdo veprim apo përfshirje të gjyqtarëve dhe prokurorëve në aktivitete politike, tregtare apo veprimtari të tjera, të cilat mund të komprometonin figurën e tyre, si garantë të sistemit të drejtësisë dhe si përfaqësues të një pushteti të pavarur nga ndikimet e jashtme. Kjo shkelje disiplinore nuk përfshinte vetëm përfshirjen direkt në veprimtari të ndaluara, por edhe çdo veprim, që mund të krijonte dyshime për ndërhyrje të jashtme në ushtrimin e detyrës së gjyqtarit apo prokurorit. Kryerja e kësaj shkeljeje krijonte jo vetëm një konflikt të mundshëm interesi, por ulte edhe besimin e publikut në sistemin e drejtësisë.

177. Ligji nr. 8265/1997, neni 27.

178. Ligji nr. 8265/1997, neni 40.

179. Ligji nr. 8265/1997, neni 41.

2. *Nxjerrja e sekretit të hetimit, të dhomës së këshillimit ose të të dhënave të tjera, me karakter intim*; Edhe kjo shkelje, nëse kryhej nga gjyqtarë dhe prokurorë, cenonte rëndë besimin e publikut tek sistemi i drejtësisë. Ky veprim, rrezikonte të dëmtonte rëndë jo vetëm interesat e palëve të përfshira në çështjen përkatëse, por edhe vetë dinjitetin dhe sigurinë e individëve. Sekreti hetimor dhe gjyqësor ishte një garanci themelore për zhvillimin e një procesi të drejtë dhe të paanshëm, ndërsa mbrojtja e të dhënave me karakter intim, kishte për qëllim ruajtjen e privatësisë dhe të jetës personale të individëve. Për rrjedhojë, një shkelje e tillë, jo vetëm që dëmtonte procesin konkret, por krijonte një klimë mosbesimi të përgjithshme ndaj institucioneve të drejtësisë dhe profesionalizmit së atyre, që kishin për detyrë ta zbatonin atë.

3. *Zvarritje të rënda ose sistematike në kryerjen e detyrës*; Kjo shkelje, që lidhej kryesisht me vonesat e pajustificuara në hetimin e veprave penale, apo në shqyrtimin dhe zgjidhjen e çështjeve gjyqësore, kishte pasoja të rënda për qytetarët, të cilët prisnin drejtësi, sa më shpejt që të ishte e mundur. Në parim, zvarritjet e vazhdueshme dhe të përsëritura, dëmtojnë parimin e aksesit të shpejtë në drejtësi, duke krijuar një ndjenjë mosbesimi tek qytetarët ndaj institucioneve të sistemit të drejtësisë. Përveçse krijonte një barrë të panevojshme mbi palët në proces, kjo sjellje ndikonte negativisht në imazhin e gjyqtarëve dhe prokurorëve si figura publike që përfaqësonin këtë sistem.

4. *Mosrespektimi i rregullave të solemnitetit*; Kjo shkelje disiplinore cenonte dinjitetin dhe seriozitetin e veprimtarisë hetimore dhe gjyqësore, duke minuar autoritetin e funksionarëve të ngarkuar më realizimin e këtyre detyrave. Rregullat e solemnitetit, që përfshinin sjelljen, veshjen dhe mënyrën e komunikimit në sallën e gjyqit, ishin të domosdoshme për të ruajtur prestigjin dhe rëndësinë e procesit gjyqësor. Shkelja e këtyre rregullave krijonte një atmosferë të papërshtatshme për një institucion të sistemit të drejtësisë, ku ruajtja e solemnitetit kishte një rol thelbësor në forcimin e autoritetit të gjykatave dhe prokurorive, si dhe në ndërtimin e një sistemi gjyqësor, që frymëzonte respekt dhe besim tek qytetarët. Mosrespektimi i këtyre rregullave, përveçse tregonte mungesë serioziteti në ushtrimin e detyrës, dëmtonte imazhin e të gjithë sistemit të drejtësisë dhe krijonte përshtypjen, se ata që duhej të garantonin zbatimin e ligjit nuk e respektonin vetë solemnitetin që kërkonte ky funksion i lartë.

5. *Mungesat pa arsye në punë*; Kjo lloj shkelje për gjyqtarët dhe prokurorët, nëse kryhej prej tyre, tregonte mungesën e përgjegjësisë dhe përkushtimit ndaj detyrës, përkushtim që ishte dhe mbetet i rëndësishëm për funksionimin e sistemit të drejtësisë. Prania dhe angazhimi i tyre i vazhdueshëm ishte i domosdoshëm për garantimin e zhvillimit të rregullt të proceseve gjyqësore dhe realizimin e hetimeve të plota dhe të gjithanshme. Mungesat e pajustificuara shkaktonin vonesa në shqyrtimin

e çështjeve, krijonin pengesa për palët dhe rrisnin barrën mbi kolegët e tyre, duke dëmtuar kështu efikasitetin e gjykatave dhe prokurorive. Kjo shkelje disiplinore përbënte një tregues të papranueshëm, të neglizhencës profesionale dhe binte në kundërshtim të hapur me standardet e larta, që duhej të karakterizonin sistemin e drejtësisë.

6. *Kryerja e veprimeve të pahijshme ose amorale brenda dhe jashtë kohës së punës*; Ky rast, përfaqësonte një shkelje disiplinore, që prekte drejtpërdrejt figurën morale dhe dinjitetin e gjyqtarëve dhe prokurorëve, prej të cilëve kërkohej që të ruanin integritetin e tyre, në çdo rrethanë. Kjo shkelje nuk kufizohej vetëm në ushtrimin e funksionit të tyre gjatë orarit zyrtar, por shtrihej edhe në sjelljen personale dhe shoqërore, duke synuar të garantonte, që ata të dukeshin dhe të ishin shembull për shoqërinë. Si përfaqësues të sistemit të drejtësisë, çdo veprim i tyre, i realizuar qoftë edhe në jetën e tyre private, kishte një ndikim të drejtpërdrejtë në besimin që publiku kishte tek sistemi tek ky sistem, duke krijuar përshtypjen, se këta funksionarë, nuk ishin të denjë për të ushtruar një detyrë kaq të lartë. Kjo shkelje disiplinore tregonte se ligjvënësi kërkonte prej gjyqtarëve dhe prokurorëve, jo vetëm profesionalizëm në ushtrimin e detyrës, por edhe një sjellje dinjitoze në çdo aspekt të jetës, si një garanci për pavarësinë dhe integritetin e sistemit të drejtësisë.

7. *Kryerja e veprimeve në kundërshtim me përmbushjen e rregullt të detyrës ose moskryerja e veprimeve të detyrueshme procedurale, kur nuk përbën veprë penale*; Kjo lloj shkelje, përfaqësonte një shkelje disiplinore të rëndë, e cila cenonte parimet kryesore, mbi të cilat mbështetej sistemi i drejtësisë. Gjyqtarët dhe prokurorët, si figura të rëndësishme, kishin detyrimin që të ndiqnin në mënyrë rigoroze rregullat procedurale dhe të kryenin të gjitha veprimet e nevojshme, për të siguruar një proces të rregullt ligjor, por edhe një zbatim korrekt të normave ligjore. Shkelje të tilla, të kryera qëllimisht, apo për shkak të neglizhencës, mund të dëmtonin rëndë, jo vetëm interesat e palëve në proces, por edhe vetë funksionimin e institucioneve të sistemit të drejtësisë. Mosrespektimi i detyrave procedurale tregonte mungesë profesionalizmi dhe ndershmërie, duke krijuar perceptimin, se gjyqtarët dhe prokurorët mund të vepronin në mënyrë arbitrare. Edhe pse bëhej fjalë për raste, kur këto shkelje nuk përbënin vepra penale, ato ishin të papranueshme. Ligjvënësi, përmes sanksionimit të kësaj shkeljeje, synonte të ruante standardet më të larta të korrektësisë dhe përgjegjësisë, në ushtrimin e funksioneve të gjyqtarëve dhe prokurorëve, duke parandaluar çdo devijim, që mund të komprometonte të drejtën e qytetarëve për një proces të rregullt ligjor.

Ky ligj qëndroi për pak kohë në fuqi, por për këtë lloj shkeljeje ekzistojnë disa raste nga praktika gjyqësore. Kështu, Gjykata e Lartë, është shprehur se:

“Kështu, në çështjen civile me paditës shoqëria “F” SHPK., e të paditur AKP,

është vendosur rrëzimi i kërkesëpadisë për deklarimin pjesërisht të pavlefshëm të aktit të marrjes në dorëzim si dhe të rivlerësimit të objektit Fabrika e Tullave Vorë. - "Të ulet vlera e objektit të dalë në ankand vetëm për shumën 292.526.710 lekë që përfaqëson.....". Në këtë çështje, kërkesëpadia është bërë me objekt zbritjen e amortizimit kontabël e fizik pa saktësuar në çfarë mase do të bëhet ajo; është pranuar pala paditëse të ngrejë padi me cilësinë e pronarit, kur nuk ka qenë e tillë, sepse nuk ka paguar të gjithë vlerën e objektit të fituar në ankand në afatin e caktuar, por vetëm 10% të vlerës dhe nuk ka lidhur as kontratën e shitblerjes me shtetin. Arsyetimi dhe dispozitivi i vendimit përmbajnë fjalë të cilat shprehin përmbajtje të kundërt me njëri-tjetrin dhe është i pamundur të ekzekutohet.

Në vendimin gjyqësor nr. 5820, datë 14.11.1997, vërtetimi i faktit të ndërtimit, vjen në kundërshtim me ligjin, sepse toka dhe objekti i ndërtimit janë pronë e shtetit dhe jo e këtyre dy instancave. Dhënia e këtij vendimi është bërë shkak që të abuzohet, duke u shitur apartamente nga një person me cilësinë e përfaqësueses së dy institucioneve.

Në çështjen civile nr. s'ka, datë 03.12.1997, janë njohur trashëgimtarë ligjorë të trashëgimlënësit, persona të cilët nuk janë paditës në kërkesëpadinë objekt gjykimi, vendimi i dhënë vjen në kundërshtim me provat që ndodhen në dosje nga të cilat rezulton se trashëgimtar i vetëm është i padituri.

Shkelje të rënda procedurale janë bërë dhe në gjykimin e tre çështjeve të tjera, si në çështjen me nr. 3800 të vendimit, nr. 8568 dhe nr. 9311.

Të gjashtë çështjet civile të mësipërme, mbi bazën e ankimit janë prishur nga gjykata e apelit dhe Kasacionit, dhe çështjet janë dërguar për rishqyrtim.

Kolegjet e Bashkuara të Gjykatës së Lartë, mbasi dëgjuan në seancë gjyqësore pretendimet e ankueses për secilën nga çështjet, dhe shqyrtuan materialet verifikuese të inspektorëve të KLD në lidhje me ato, vendimet përkatëse të gjykatës së apelit dhe të Kasacionit, procesverbalin e mbledhjes së KLD-së, - duke marrë parasysh natyrën e shkeljeve të lejuara, çmon se vendimi i KLD për largimin e M. D., si gjyqtare, për veprim që vjen në kundërshtim me përmbushjen e rregullt të detyrës, është i drejtë dhe i bazuar në ligjin nr. 8265, datë 18.12.1997".¹⁸⁰

Referuar këtij arsyetimi, shkeljet e konstatuara, që përfshinin mangësi të rënda në arsyetimin e vendimeve, pranimin e kërkesëpadive të pabazuara dhe dhënien e vendimeve të pazbatueshme, tregonin një mungesë profesionalizmi, si dhe neglizhencë në përmbushjen e detyrës. Duke marrë në konsideratë faktin, se të gjitha çështjet e shqyrtuara nga gjyqtarja ishin prishur në shkallët më të larta të gjyqësorit dhe ishin dërguar për rishqyrtim për shkak të shkeljeve të saj, ky vendim i largimit nga detyra, shfaqej si i drejtë dhe i domosdoshëm për të mbrojtur besueshmërinë e sistemit gjyqësor.

Ndërsa rasti i mësipërm ka të bëjë me gjyqtare, nga jurisprudenca e Gjykatës së Lartë, rezulton se kanë qenë edhe të paktën dy raste të tjera, kur kjo shkelje ishte konsumuar nga prokurorë. Konkretisht në rastin e

180. Vendimi nr. 729, datë 29.06.1999 i Kolegjeve të Bashkuara të Gjykatës së Lartë.

parë, Gjykata e Lartë u shpreh se “Më 14.07.1997 Prokuroria e Rrethit Lezhë, ka filluar procedimin penal në ngarkim të tre të pandehurve Gj. L., Ç. Gj., e P. P., për veprën penale të kontrabandës të parashikuar nga neni 172 e 25 të Kodit Penal. Për verifikimin e detyrave të lëna nga Prokuroria e Përgjithshme, nga ana e F. M., është ngarkuar oficeri i policisë gjyqësore V. M. Nga verifikimet e mëvonshme ka rezultuar që të gjitha veprimet e kryera nga oficeri i policisë gjyqësore dhe dokumentet e marra prej tij, janë të falsifikuara.

Sipas pretendimit të ankuesit, bazuar në këtë dokumentacion është vendosur pushimi i çështjes penale nr. 87 datë 12.09.1997 për mungesë të elementeve të figurës së veprës penale të kontrabandës.

Nga procesverbali i mbledhjes nr. 16 të KLD-së, mbajtur në datën 20.06.1998, nga thëniet e përfaqësuesit të KLD-së, nga akti i ekspertimit nr. 1801 dhe nga materialet e tjera të administruara në dosje ka rezultuar se ankuesi F. Muça ka vepruar në kundërshtim me përmbushjen e rregullt të detyrës për arsyet e mëposhtme:

Marrja e 5 faturave me nr. 234, 286, 51, 52, 53, ku dy të parat janë të vitit 1995 dhe tre të fundit të vitit 1997 rezulton të jenë marrë në kundërshtim me nenin 188 dhe 191 të Kodit Pr. Penal, ku marrja e provës të bëhej me procesverbal dhe të fiksohej nga kush është marrë.

Pavarësisht se hetimin e çështjes e ka bërë oficeri i policisë gjyqësore, kontrolli i tij bëhet nga prokurori i çështjes, i cili nuk mund të shmanget nga përgjegjësia, ndërkohë që merr përsipër përgjegjësinë e verifikimit të faturave.

Përsa i përket pyetjes së shtetasit L. K., rezulton, sipas procesverbalit të pyetjes që të mos jetë pyetur L. K. ose në vend të tij të jetë pyetur një person tjetër.

Nga akti i ekspertimit ka rezultuar se nënshkrimi në procesverbal nuk është i shtetasit L. K., dhe dokumenti i ndodhur në dosje, si i vetmi dokument identifikimi, që është një certifikatë regjistrimi në organin tatimor, rezulton të mos jetë i L.K.

Me të drejtë Këshilli i Lartë i Drejtësisë ka arritur në konkluzionin se ankuesi F. Muça ka vepruar në kundërshtim me përmbushjen e rregullt të detyrës sepse nuk ka bërë identifikimin e personit sipas kërkesave të K. Pr. Penale për identifikimin dhe mënyrën e marrjes së të dhënave (neni 312 i K. Pr. Penale).

Përsa i përket vendimit civil nr. 268 datë 03.11.1997 të Gjykatës së Rrethit Lezhë, me objekt shfuqizimin e vendimit të sekuestros datë 14.7.1997 të marrë nga prokuroria, veprimi i ankuesit F. Muça, me të drejtë është konsideruar si veprim që vjen në kundërshtim me përmbushjen e rregullt të detyrës. Në këtë procesverbal, megjithëse malli i sekuestruar ka qenë pa pullë, ankuesi, i cili përfaqësonte prokurorinë me cilësinë e të paditurit, nuk ka shprehur mendimin e tij për zgjidhjen e çështjes, por është shprehur në seancë se “...e lë në çmim të gjykatës”. Kjo mënyrë veprimi vjen në kundërshtim me nenet 303, 462 dhe 483 të K. Pr. Civile ku në të gjitha shkallët e gjykimit kërkohet shprehja e mendimit të prokurorit që merr pjesë në procesin civil”.¹⁸¹

181. Vendimi nr. 1291, datë 23.03.1999 i Kolegjeve të Bashkuara të Gjykatës së Lartë.

Nga pasazhet e mësipërme, rezulton se shkeljet e konstatuara, që përfshinin marrjen e provave në kundërshtim me rregullat procedurale, mungesën e identifikimit të saktë të dëshmitarëve dhe dështimin për të mbrojtur interesat e shtetit në një proces civil, tregonin një mungesë të thellë përkushtimi dhe profesionalizmi në kryerjen e detyrës. Duke vlerësuar se këto shkelje kishin cenuar integritetin e hetimeve dhe drejtësinë e proceseve gjyqësore, organet kompetente arritën në përfundimin se largimi i prokurorit nga detyra ishte një masë e drejtë dhe e domosdoshme.

Në rastin tjetër, që kishte të bënte po me prokurorë, Gjykata e Lartë, duke mos gjetur shkelje, mbajti qëndrimin se, *“Gjatë shqyrtimit gjyqësor të çështjes penale në ngarkim të pandehurit L. L., për të cilën pretendohet përmbushje jo e rregullt e detyrës, dolën prova dhe rrethana të reja që më çuan në konkluzionin përfundimtar se vepra penale duhet cilësuar si vrasje në kapërcim të kufijve të mbrojtjes së nevojshme.*

Nga gjykata e rrethit u pranua ky konkluzion si i drejtë, duke u vendosur ndryshimi i kualifikimit ligjor të veprës penale dhe në përfundim, çështja u pushua si e amnistuar.

Kundër këtij vendimi nuk është bërë ankim nga Prokurori i Rrethit Vlorë, as nga Prokurori i Apelit Vlorë, duke e çmuar vendimin të drejtë. Unë kam zbatuar kompetencën që më jep neni 25/3 i Kodit të Procedurës Penale sipas të cilit, “Në gjykim prokurori ushtron kompetencat e tij në pavarësi të plotë”.

Sipas relacionit të paraqitur nga Këshilli i Lartë i Drejtësisë, prokurori duhej të kërkonte në gjykatë administrimin e provave, që janë grumbulluar në hetim dhe vërtetojnë akuzën e vrasjes me paramendim, çka parashikohet në nenin 369 të Kodit të Procedurës Penale.

Në gjykim rezultoi se A. K., me detyrën e prokurorit të çështjes penale ka kërkuar disa herë që të shtyhej seanca gjyqësore, me qëllimin e vetëm që të thirren disa dëshmitarë të akuzës. Kjo kërkesë është marrë në konsideratë nga gjykata, por nuk është bërë e mundur, që të paraqiten në gjykim, as forcërisht, nga Komisariati i Policisë.

Gjithashtu rezulton nga procesverbali, që gjykata e ka administruar në tërësi dosjen hetimore dhe në përfundim ka konkluduar të ndryshojë kualifikimin e veprës penale, nga neni 76 në nenin 83 të Kodit Penal, vendim i cili nuk është ankimuar. Në këto rrethana çmohet, që paditësi nuk ka kryer veprime, që janë në kundërshtim me përmbushjen e rregullt të detyrës, dhe për rrjedhojë vendimi i Këshillit të Lartë të Drejtësisë nr. 22/1, datë 31.10.1998 duhet të anulohet”.¹⁸²

Ky vendim tregon përpjekjen e Gjykatës së Lartë për të balancuar të drejtën e prokurorit për të ushtruar detyrën e tij në pavarësi të plotë, me përgjegjësinë që ai duhej të kishte për respektimin e procedurave ligjore. Qëndrimi për të mos e ankimuar vendimmarrjen e gjykatës së shkallës së parë, pas administrimit të plotë të dosjes hetimore dhe pamundësisë për të siguruar prova të reja, tregon një qasje realiste të prokurorit ndaj

182. Vendimi nr. 959, datë 29.07.1999 i Kolegjeve të Bashkuara të Gjykatës së Lartë.

çështjes, duke shmangur një proces, që do të kishte zgjatur në kohë dhe që dukshëm nuk do të sillte asnjë rezultat të pritshëm. Rezultoi që prokurori kishte ndjekur me korrektësi të gjitha hapat e nevojshëm dhe kishte ushtruar kompetencat e tij në përputhje me ligjin.

8. *Moszbatimi pa arsye i masës disiplinore të dhënë.* Kjo lloj shkelje disiplinore, mund të konsumohej nga ana e gjyqtarëve apo prokurorëve, nëse më parë ishte marrë një masë tjetër disiplinore, të cilën ata refuzonin të zbatonin. Nga tërësia e masave disiplinore që parashikonte ky ligj, për vetë natyrën e tyre, masat që mund të merreshin dhe që nuk zbatoheshin, mund të ishin vetëm, pezullimi nga detyra dhe kalim në një detyrë tjetër më të ulët brenda gjykatës ose prokurorisë, për një periudhë nga gjashtë muaj deri në një vit, ose masa tjetër ajo e transferimit në një gjykatë ose prokurori tjetër. Moszbatimi pa arsye i këtyre masave disiplinore të marra nga KLD-ja përfaqësonte një shkelje disiplinore që cenonte autoritetin dhe funksionimin e këtij organi, duke minuar rëndësinë e mekanizmave të llogaridhënies. Gjyqtarët dhe prokurorët, si figura të rëndësishme në administrimin e drejtësisë, kishin detyrimin jo vetëm të respektonin rregullat dhe detyrimet profesionale, por edhe të zbatonin masat disiplinore të vendosura ndaj tyre. Moszbatimi i këtyre masave tregonte një mungesë përgjegjshmërie dhe krijonte një precedent të rrezikshëm për autoritetet e administrimit të sistemit të drejtësisë.

Përsa i përket, masave disiplinore, ky ligj parashikonte gjashtë të tilla dhe ato ishin:

1. Vërejtje;
2. Vërejtje me paralajmërim;
3. Ulje në pagë deri në masën 25% për një periudhë nga tre deri në gjashtë muaj;
4. Pezullim nga detyra dhe kalim në një detyrë tjetër më të ulët brenda gjykatës ose prokurorisë për një periudhë nga gjashtë muaj deri në një vit;
5. Transferim në një gjykatë ose prokurori tjetër;
6. Largim nga detyra.¹⁸³

Këto masa mund të merreshin nga Këshilli i Lartë i Drejtësisë, në bazë të vlerësimit të llojit dhe të karakterit të shkeljes së kryer.¹⁸⁴

Përsa i përket ankimit, ligji parashikonte që gjyqtari ose prokurori, ndaj të cilit merret çdo masë disiplinore, si dhe kur shkarkohet nga detyra, kishte të drejtën që të ankohej në Gjykatën e Kasacionit, e cila e shqyrtonte çështjen në kolegjet e bashkuara.¹⁸⁵

183. Ligji nr. 8265/1997, neni 42.

184. Ligji nr. 8265/1997, neni 43.

185. Ligji nr. 8265/1997, neni 46.

KREU III

INSPEKTIMI DHE DISIPLINA SIPAS PARASHIKIMEVE KUSHTETUESE NË VITET 1998 – 2016

Paketa e vjetër kushtetuese, u shfuqizua, me hyrjen në fuqi, me datë 28.11.1998, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, veprim ky që përfaqësonte një hap të rëndësishëm në procesin e konsolidimit të shtetit të së drejtës dhe sistemit demokratik në Shqipëri. Duke i dhënë fund një periudhe të gjatë, ku vendi ishte drejtuar nga ligje kushtetuese të përkohshme, Kushtetuta e re përfaqësonte një përpjekje për të krijuar një bazë të qëndrueshme juridike, që do të garantonte ndarjen e pushteteve, pavarësinë e gjyqësorit dhe të drejtën e çdo qytetari për një proces të drejtë ligjor. Në krahasim me ligjin kushtetues nr. 7491, datë 29.04.1991 “Ligji për dispozitat kryesore kushtetuese” dhe ligjin kushtetuese nr. 7561, datë 29.04.1992 “Organizimi i drejtësisë dhe Gjykata Kushtetuese”, Kushtetuta e vitit 1998, solli disa risi dhe avancime të rëndësishme në organizimin dhe funksionimin e sistemit të drejtësisë.

Një nga aspektet kryesore, që e diferenconte Kushtetutën e re, ishte sanksionimi i qartë dhe i detajuar i parimeve të pavarësisë së gjyqësorit. Ndryshe nga parashikimet më të përgjithshme dhe shpesh të pamjaftueshme të ligjeve kushtetuese të mëparshme, Kushtetuta e vitit 1998 përcaktonte në mënyrë rigorozë ndarjen midis pushtetit gjyqësor dhe ekzekutiv, duke garantuar, që gjyqtarët dhe prokurorët të ishin të pavarur në ushtrimin e detyrave të tyre dhe t’i nënshtroheshin vetëm Kushtetutës dhe ligjeve. Kjo pavarësi u mbështet edhe nga dispozita që ndalonin ndërhyrjen në veprimtarinë e gjykatave dhe garantonin mos kufizimin e qëndrimit të gjyqtarëve në detyrë dhe ruajtjen e përfitimeve të tyre.

Një tjetër risi e rëndësishme ishte përforcimi i mekanizmave të llogaridhënies për gjyqtarët. Kushtetuta e vitit 1998 parashikonte rregulla më të qarta për përgjegjësinë disiplinore të gjyqtarëve, Gjithashtu u përcaktuan më qartë rastet e shkarkimit të gjyqtarëve të Gjykatës së Lartë, të Prokurorit të Përgjithshëm dhe të gjyqtarëve të zakonshëm, duke vendosur standarde më të larta për sjelljen e tyre profesionale dhe integritetin që duhej të tregonin. Kjo tregonte një përpjekje për të balancuar pavarësinë e gjyqtarëve me llogaridhënien e tyre, duke ndërtuar kështu një sistem drejtësie më të besueshëm.

Në aspektin institucional, Kushtetuta e re përmirësoi organizimin

dhe funksionimin e Këshillit të Lartë të Drejtësisë (KLD), duke i dhënë një rol më të fortë në mbikëqyrjen e gjyqtarëve. Ky zhvillim ishte i rëndësishëm për të krijuar një strukturë më të qëndrueshme dhe funksionale të menaxhimit të sistemit gjyqësor, duke shmangur paqartësitë dhe praktikat e diskutueshme, që kishin ekzistuar më parë.

Kushtetuta e vitit 1998 paraqiti një vizion më modern dhe të përparuar për rolin e prokurorisë, duke e përcaktuar atë si një organ të centralizuar, që vepron pranë sistemit gjyqësor, por gjithashtu duke garantuar që prokurorët të jenë të pavarur në ushtrimin e kompetencave të tyre. Rregullimet për emërimin dhe shkarkimin e Prokurorit të Përgjithshëm, si dhe për detyrimin e tij për të informuar Kuvendin për gjendjen e kriminalitetit, krijuan një sistem kontrolli dhe ekuilibri të nevojshëm për të parandaluar abuzimet me pushtetin.

Këto konstatime janë baza e analizës së mënyrës së inspektimit të gjyqtarëve dhe prokurorëve, si edhe përgjegjësive të tyre disiplinore në Shqipëri, përpara reformës së vitit 2016.

Në lidhje me shkaqet e shkarkimit dhe mënyra se si duhen kuptuar ato, Gjykata Kushtetuese dha një vendim, që shërbeu si orientim dhe bazë interpretimi, për të gjitha rastet e tjera të mëvonshme. Kështu, Gjykata Kushtetuese arsyetoi se *“Nenet 128 dhe 140 të Kushtetutës kanë formulime të njëjta, sepse përmbajnë katër shkaqe kushtetuese, në të cilat duhet të bazohet Kuvendi, për të motivuar vendimin për shkarkimin e gjyqtarëve të Gjykatës Kushtetuese dhe të Gjykatës së Lartë, ndërsa neni 149, pika 2 parashikon rastet për shkarkimin e Prokurorit të Përgjithshëm, nga të cilat vetëm njëri prej tyre është i ndryshëm nga të parat.*

Nga të gjitha shkaqet për shkarkim të këtyre funksionarëve të lartë që parashikohen në këto nene kushtetuese, dy prej tyre dhe konkretisht “kryerja e një krimi” dhe “paaftësia mendore a fizike”, janë të tilla, që nuk mund të vërtetohen drejtpërdrejt nga Kuvendi, pasi ato kërkojnë që paraprakisht të konstatohen dhe të vërtetohen nga organe kompetente.

Çështja paraqitet më e vështirë në aspektin e interpretimit të koncepteve kushtetuese, si akte e sjellje që diskreditojnë rëndë pozitën dhe figurën e gjyqtarit e të prokurorit, si dhe shkelje të rënda të ligjit, gjatë ushtrimit të funksioneve nga Prokurori i Përgjithshëm.

Për interpretimin e këtyre normave, Gjykata Kushtetuese nuk merr përsipër të kryejë rolin e legjislatorit pozitiv, duke parashikuar një për një të gjitha rastet, që mund të përfshihen në këto shkaqe kushtetuese, sepse një gjë e tillë do të ishte e pamundur, ndërkohë që Kushtetuta, ligjet, apo edhe vendimet gjyqësore, nuk mund të kodifikojnë me saktësi aktet e sjelljet që diskreditojnë rëndë pozitën dhe figurën e gjyqtarit a prokurorit, apo rastet se kur ligji është shkelur rëndë.

Interpretimi që Gjykata Kushtetuese i bën dispozitave apo termave konkrete të Kushtetutës ka për qëllim që në mënyrë analitike të jap dhe të përcaktojë kriteret, konceptet bazë si dhe parimet mbi të cilat duhet të mbështetet organi kompetent

për të konkluduar lidhur me aplikimin e shkakut të përshtatshëm kushtetues për shkarkimin e gjyqtarit të Gjykatës Kushtetuese, të gjyqtarit të Gjykatës së Lartë si dhe të Prokurorit të Përgjithshëm.

Veprimet apo mosveprimet e këtyre funksionarëve të lartë të shtetit, të cilat mund të përfshihen në shkaqet kushtetuese, që shërbejnë për shkarkimin e tyre janë të tilla, që mund të vlerësohen rast pas rasti, nga vetë organi që kryen këtë procedurë shkarkimi. Megjithatë, në çdo rast, ato janë të lidhura me sjelljet e parregullta e të padenja, që këta funksionarë të lartë kryejnë, jo vetëm gjatë ushtrimit të detyrës dhe për shkak të saj, por edhe jashtë detyrës, me abuzimin apo dhunimin, që i bëjnë besimit publik dhe që lidhet kryesisht me dëmet, që ata i sjellin shoqërisë dhe shtetit. Aktet dhe sjelljet e padenja, që ata kryejnë duhet të jenë aq serioze, të kenë diskredituar aq rëndë figurën dhe pozitën e gjyqtarit apo prokurorit dhe të kenë ulur dinjitetin e organit që përfaqësojnë, sa të detyrojnë organin kompetent për të marrë masën e largimit nga detyra.

Nisur nga përmbajtja e nenit 149, pika 2 të Kushtetutës, që parashikon ndërmjet shkaqeve të tjera për shkarkimin e Prokurorit të Përgjithshëm, edhe shprehjen “shkelje të rënda të ligjit gjatë ushtrimit të funksioneve të tij”, Gjykata Kushtetuese arsyeton, se kuptimi i saktë dhe i drejtë i saj i përdorur në këtë dispozitë kushtetuese, por edhe në të tjera, duhet të analizohet dhe vlerësohet në tërësi nga disa faktorë, që kanë të bëjnë me rëndësinë e shkeljes së ligjit, pasojat e ardhura apo që mund të vinin nga kjo shkelje, kohë vazhdimin e këtyre pasojave dhe të vështirësive për riparimin e tyre, si dhe vetë qëndrimin subjektiv që mban personi konkret, ndaj shkeljes së kryer dhe pasojës së ardhur. Gjithashtu, cilësimi “rëndë”, i përdorur, si për rastin e diskreditimit të pozitës dhe figurës së gjyqtarit e të prokurorit, ashtu dhe të shkeljes së ligjit, i shërben njëkohësisht organit kompetent, që fillon procedurat e shkarkimit për të dalluar këto veprime nga sjelljet e një kategorie më të lehtë, të cilat nuk mund të përdoren për të motivuar shkakun e shkarkimit.

Mënyra e formulimit në Kushtetutë të shkaqeve për shkarkim, duket sikur e lë të hapur dhe të diskutueshme bërjen e interpretimeve pa fund, të rasteve që mund të klasifikohen nga praktika parlamentare, si shkelje e rëndë e ligjit, apo akte e sjellje që diskreditojnë rëndë pozitën e figurën e gjyqtarit e prokurorit. Megjithatë, jurisprudenca gjyqësore dhe veçanërisht shqyrtimi i deritanishëm apo edhe në të ardhmen nga Gjykata Kushtetuese i rasteve konkretë, të cilat lidhen me këto koncepte kushtetuese, sigurisht që do t'i japin një kuptim më të plotë dhe më të qartë këtyre shkaqeve kushtetuese.

Gjykata Kushtetuese, në analizë të mëtejshme të këtyre koncepteve kushtetuese, çmon të nevojshme të argumentojë, se kuptimi i termave kushtetues, që lidhen me shkaqet e shkarkimit duhet parë i lidhur ngushtë me gjithë procesin ligjor që ndjek Kuvendi, në rastet kur inicion procedurat për shkarkim të gjyqtarëve të Gjykatës Kushtetuese, të gjyqtarëve të Gjykatës së Lartë dhe të Prokurorit të Përgjithshëm.

Nëse gjyqtari i Gjykatës Kushtetuese, i Gjykatës së Lartë, apo Prokurori i

Përgjithshëm rezulton se ka shkelur Kushtetutën, ka kryer akte që diskreditojnë rëndë pozitën dhe figurën e tij, apo ka shkelur rëndë ligjin, marrja e masës së shkarkimit nga Kuvendi është e lidhur domosdoshmërisht me kryerjen e procedurave përkatëse. Funkzioni që kryen Kuvendi në këtë rast është i një natyre të veçantë. Procesi i realizuar prej Kuvendit ndryshon nga gjithë veprimtaria e tij e zakonshme si një organ që miraton ligje. Ky proces ligjor, që është një proces gjyqimi disiplinor dhe i ngjashëm me procedurat hetimore administrative ka parimet e veta, të cilat lidhen me verifikimin, analizën dhe vërtetimin e atyre shkaqeve konkrete, që kanë shërbyer për organin kompetent për të marrë masën e shkarkimit nga detyra të gjyqtarit apo prokurorit.

Dispozitat kushtetuese objekt interpretimi, janë materiale procedurale dhe kanë për qëllim të përcaktojnë në mënyrë taksative rastet klasike, se kur mund të shkarkohen gjyqtarët apo Prokurori i Përgjithshëm. Ekzistenca e këtyre shkaqeve kushtetuese për shkarkim përbën një garanci më shumë për funksionet që ata kryejnë, por edhe për vetë institucionet kushtetuese, që ata përfaqësojnë.

Këto nene kushtetuese kanë lënë në vlerësimin e Kuvendit, si karakterin dhe rëndësinë e shkeljes së kryer, ashtu edhe faktin, nëse akti apo veprimi është i asaj natyre, që mund të diskreditojë figurën e gjyqtarit apo të prokurorit. Ajo që nënkupton dispozita kushtetuese është që rasti konkret për shkarkim, duhet të ketë ndodhur dhe të jetë i vërtetuar si i tillë.

Pikërisht ky konkluzion del nga interpretimi, që i bëhet fjalisë së dytë, në nenet 128 e 140. Gjykata Kushtetuese duke shqyrtuar vendimin e Kuvendit që ka shkarkuar gjyqtarin, vërteton nëse ekziston shkaku i shkarkimit. Pra, ajo vërteton, nëse Kuvendi ka vepruar në përputhje me Kushtetutën, rregulloren dhe me ligjet përkatëse dhe nëse ai i ka respektuar të gjitha procedurat për ta motivuar, argumentuar dhe arsyetuar plotësisht vendimin e shkarkimit.

Nëpërmjet këtij kontrolli konstitucional që kryhet mbi vendimin e Kuvendit, Gjykata Kushtetuese shqyrtton jo vetëm procedurën e shkarkimit, por edhe thelbin e çështjes. Prandaj, me qëllim që vendimi i Kuvendit të jetë sa më i bazuar dhe të mos rrëzohet si antikushtetues, ai duhet të ketë plotësuar të gjitha elementet e domosdoshëm të një procedure korrekte, sepse mjafton mosrespektimi i procedurës dhe i formës së nxjerrjes së një akti, që ai të konsiderohet i pavlefshëm.

Përsa i përket nenit 149, pika 2 të Kushtetutës, Gjykata Kushtetuese çmon se është Presidenti i Republikës organi kompetent i ngarkuar nga Kushtetuta për të kryer një verifikim nga pikëpamja kushtetuese, të shkaqeve si dhe të procedurave të ndjekura nga Kuvendi për shkarkimin e Prokurorit të Përgjithshëm. Ky konkluzion del nga mënyra e formulimit të këtij neni kushtetues, në të cilin, përdorimi i shprehjes “mund të shkarkohet”, do të thotë se vendimi i Kuvendit për propozimin e shkarkimit të Prokurorit të Përgjithshëm nuk është përfundimtar, por është vetëm inicimi i një procedure shkarkimi, bazueshmëria në ligj dhe në Kushtetutë e të cilës, vlerësohet në këtë rast nga Presidenti i Republikës.

Nisur nga sa u parashtrua më lart, Gjykata Kushtetuese e sheh të nevojshme të verë në dukje se elementet bazë të një procedure ligjore, që lidhen me mënyrën e

inicimit të procedurës për shkarkim, kuorum-in e nevojshëm për vendimmarrjen, shkaqet ligjore për shkarkim, si dhe organin që vendos përfundimisht për to, janë të parashikuara përgjithësisht në Kushtetutë. Megjithatë një rregullim të mëtejshëm, gjendet në ligjet bazë, siç është rasti i kuorumit të domosdoshëm, që nevojitet për iniciimin e procedurave për shkarkim të gjyqtarëve të Gjykatës Kushtetuese. Përsa i përket anëtarëve të Gjykatës së Lartë nuk ka ndonjë rregullim ligjor për iniciimin e procedurës për shkarkimin e tyre. Gjithashtu edhe për propozimin për shkarkim të Prokurorit të Përgjithshëm, ligji “Për organizimin dhe funksionimin e Prokurorisë në Republikën e Shqipërisë”, nuk parashikon elementet bazë të procedurave. E vetmja referencë kushtetuese, që mund të bëhet për këtë rast është neni 78 pika 1 e Kushtetutës, ku parashikohet rregulli i përgjithshëm (me përjashtim të rasteve kur Kushtetuta parashikon një shumicë të cilësuar), lidhur me votat e nevojshme që i duhen Kuvendit për të marrë vendim.

Në kushtet kur në Kushtetutë, apo edhe në ligjet e tjera, elementet thelbësorë të një procedure nuk gjejnë rregullim të hollësishëm, atëherë Gjykata Kushtetuese çmon të nevojshme të theksojë, se këto rregulla procedurale nuk mund të plotësohen nëpërmjet vendimit të saj interpretues. Interpretimi si funksion dhe metodë, ka vend për një normë ekzistuese kur ka paqartësi në kuptimin e saj dhe jo për të plotësuar boshllëkun, sepse përndryshe Gjykata Kushtetuese do të vihej në pozicionin e gabuar të krijuesit të normës juridike, funksion, që siç dihet, i përket ligjvënësit.

Megjithatë, Gjykata Kushtetuese nënvizon se pavarësisht nga kjo mënyrë rregullimi në Kushtetutë apo në ligj, të procedurave të shkarkimit të gjyqtarit apo prokurorit, kjo nuk e pengon Kuvendin të adoptojë rregulla të veçanta për çdo rast konkret, apo për të gjitha rastet në tërësi, por gjithmonë duke respektuar parimin kushtetues, atë të një procesi të rregullt ligjor.

Standardet e gjithë pranuar demokratike, të cilat kanë gjetur vendin e tyre në Kushtetutë si dhe një sërë vendimesh të Gjykatës Kushtetuese, kanë përcaktuar dhe konsoliduar një sërë elementesh të procesit të rregullt ligjor, mungesa e të cilave, zhvlerësojnë si procedurat, ashtu edhe vendimet e marra nga cilido organ. Argumentimi i shkeljeve që atribuohen, respektimi gjatë shqyrtimit i parimit të ndarjes së pushteteve, njohja paraprake e personit ndaj të cilit kërkohet të merret masa e shkarkimit me materialet që e ngarkojnë atë me përgjegjësi, respektimi i të drejtës për t’u dëgjuar dhe mbrojtur si me anën e dhënies së sqarimeve paraprake, ashtu dhe gjatë shqyrtimit të çështjes, janë disa nga elementet bazë, që garantojnë të drejtën kushtetuese të cilitdo për një proces të rregullt, si një e drejtë themelore, cenimin e së cilës, jurisprudenca e Gjykatës Kushtetuese e ka identifikuar në çdo rast, si shkelje të Kushtetutës.

Nga e gjithë kjo analizë kushtetuese, e cila nuk krijon ndonjë normë të re juridike, por që përbën veçse një arsyetim logjik dhe interpretativ të neneve 128, 140 dhe 149, pika 2 në vështrim dhe me dispozitat e tjera të Kushtetutës, Gjykata Kushtetuese arrin në përfundimin se kërkesa është e drejtë dhe duhet pranuar”.

Në përfundim Gjykata Kushtetuese, vendosi “Interpretimin brenda kufijve të objektit të kërkesës të neneve 128, 140 dhe 149 pika 2 të Kushtetutës” në këtë mënyrë:

1. Shprehja “akte e sjellje që diskreditojnë rëndë pozitën dhe figurën...”, parashikuar nga nenet 128, 140 dhe 149, pika 2 të Kushtetutës, përmbledh në vetvete një sërë elementesh, të cilët mund dhe duhet të identifikohen rast pas rasti nga organi përkatës, që merr vendimin për shkarkimin e gjyqtarit të Gjykatës Kushtetuese, të gjyqtarit të Gjykatës së Lartë dhe Prokurorit të Përgjithshëm. Ato janë të lidhura me aktet dhe sjelljet e parregullta e të padenja që këta funksionarë të lartë kryejnë gjatë ushtrimit të detyrës, për shkak të saj, por edhe jashtë detyrës. Këto veprime apo mosveprime që analizohen në bazë të rrethanave të kryerjes së tyre, momentit subjektiv si dhe nga dëmet që ato i sjellin shoqërisë e shtetit, janë të asaj natyre që e bëjnë të pamundur kryerjen e mëtejshme të funksioneve kushtetuese nga këto subjekte.

2. Shprehja “shkelje e rëndë e ligjit gjatë ushtrimit të funksioneve” nga Prokurori i Përgjithshëm, parashikuar nga neni 149, pika 2 të Kushtetutës lidhet me një sërë elementesh që kanë të bëjnë me ato shkelje të dispozitave ligjore të kryera gjatë ushtrimit të detyrës dhe për shkak të saj. Këto shkelje marrin karakterin e rëndë të tyre lidhur ngushtë me rëndësinë e ligjit të shkelur, me pasojat e ardhura, apo që mund të vinin nga shkelja, me frekuencën e shkeljes, kohë vazhdimin e pasojave dhe të vështirësive për riparimin e tyre, si dhe me qëndrimin subjektiv që mban autori i shkeljes kundrejt saj dhe pasojës së ardhur.

3. Në përcaktimin e procedurave të shkarkimit të gjyqtarit të Gjykatës Kushtetuese, të gjyqtarit të Gjykatës së Lartë dhe të Prokurorit të Përgjithshëm, organet përkatëse duhet të respektojnë rregullat, për aq sa parashikohet në Kushtetutë, në ligjet organike të tyre, si dhe në aktet e tjera ligjore. Në ndërmarrjen e procedurave për shkarkimin e këtyre funksionarëve, kusht thelbësor mbetet respektimi i të drejtës kushtetuese për një proces të rregullt ligjor, parashikuar nga neni 42/1 i Kushtetutës.

Ky vendim është përfundimtar, i formës së prerë dhe ka fuqi prapavepruese”.¹⁸⁶

Vendimarrja e mësipërme e Gjykatës Kushtetuese, trajton aspekte materiale dhe procedurale për shkarkimin e anëtarëve të Gjykatës Kushtetuese, të Gjykatës së Lartë dhe të Prokurorit të Përgjithshëm. Duke mbetur tek pjesa procedurale, rezulton se “Inspektorat” në këto raste, del Kuvendi i Shqipërisë. Për këtë arsye, Gjykata Kushtetuese, në vendimin e saj trajton gjerësisht procedurën e ndjekur nga Kuvendi, në lidhje me procedimin e gjyqtarëve të Gjykatës së Lartë dhe të Prokurorit të Përgjithshëm, për të përcaktuar kufijtë kushtetues dhe rregullat ligjore në lidhje me këto procedura. Gjykata Kushtetuese nënvizoi qartë, se procedimi për shkarkimin e këtyre funksionarëve të lartë nuk është një veprim i zakonshëm parlamentar, por një proces me natyrë disiplinore dhe juridike, i cili kërkon respektimin e disa parimeve dhe elementeve

186. Vendimi nr. 75, datë 19.04.2002 i Gjykatës Kushtetuese.

thelbësorë të procesit të rregullt ligjor.

Gjykata Kushtetuese theksoi, se funksioni i Kuvendit në këto raste është i një natyre të veçantë dhe ndryshon nga funksioni i tij tradicional, si organ legjislativ. Në procedurat e shkarkimit, Kuvendi jo vetëm që vepron si një organ hetimor-administrativ, por merr përsipër edhe elemente të gjykimit, pasi duhet të analizojë dhe të verifikojë faktet dhe shkaqet e pretenduara për shkarkim. Ky funksion i veçantë i Kuvendit kërkonte, që procedura e ndjekur të mbështetej në parimet e ndarjes së pushteteve, në të drejtën për një proces të rregullt ligjor me qëllim respektimin e të drejtave themelore të funksionarëve, që po procedoheshin prej tij.

Për të garantuar legjitimitetin e këtij procesi, Gjykata Kushtetuese kërkoi që Kuvendi të mbështesë vendimet e tij, në fakte të qarta dhe të provuara, të ndjekë një procedurë të mbështetur në Kushtetutë, si dhe të garantojë, që personat e përfshirë, të kenë të gjitha mundësitë për t'u mbrojtur dhe për të paraqitur qëndrimet e tyre. Këto kërkesa kishin për qëllim të shmangnin procedimet arbitrare dhe të siguronin që Kuvendi të vepronte në mënyrë objektive dhe të paanshme.

Për më tepër, Gjykata Kushtetuese vendosi një theks të veçantë në rolin e saj, si një organ kontrolli ndaj vendimeve të Kuvendit në këto raste. Ajo e konsideroi të detyrueshëm shqyrtimin e vendimit të Kuvendit për shkarkimin e gjyqtarëve të Gjykatës së Lartë, jo vetëm nga këndvështrimi procedural, por edhe nga ai substancial. Ky kontroll i dyfishtë garantonte që Kuvendi, jo vetëm të respektonte rregullat formale, por gjithashtu të mos abuzonte me diskrecionin e tij, duke marrë vendime që mund të cenonin rëndë integritetin e sistemit të drejtësisë.

Në lidhje me procedurat për shkarkimin e Prokurorit të Përgjithshëm, Gjykata theksoi rolin e Presidentit të Republikës, si një organ verifikues shtesë, që garantonte kushtetutshmërinë e vendimit të Kuvendit. Përcaktimi i Presidentit, si organi përfundimtar që vlerësonte bazueshmërinë e vendimit të Kuvendit, shtonte një nivel sigurie ndaj çdo vendimi të marrë. Ky rol i Presidentit, dilte qartë edhe nga përdorimi i shprehjes “mund të shkarkohet”, në nenin 149, pika 2 të Kushtetutës, term që tregonte se vendimi i Kuvendit nuk kishte karakter përfundimtar, por kërkonte një verifikim të mëtejshëm nga Presidenti, për të siguruar përputhjen e tij me Kushtetutën.

Përsa i përket shkaqeve të largimit të gjyqtarëve dhe të Prokurorit të Përgjithshëm, Gjykata Kushtetuese, arsyetoi në drejtim të krijimit të një standardi më të qartë dhe më të lartë, për rastet kur mund të ndërpritet mandati i këtyre funksionarëve të lartë. Gjykata Kushtetuese sqaroi se shkaqet për shkarkim, siç janë parashikuar në nenet 128, 140 dhe 149 të Kushtetutës, përfshijnë koncepte të gjera, si “akte e sjellje që diskreditojnë rëndë pozitën dhe figurën” dhe “shkelje të rënda të ligjit gjatë ushtrimit të funksioneve”. Këto formulime janë qëllimisht të përgjithshme, pasi

qëllimi i hartuesve të Kushtetutës, nuk ishte që të përcaktonte hollësisht çdo rast të mundshëm, por të krijonte një kornizë të përgjithshme, që mund të aplikohet në varësi të rrethanave specifike të secilit rast.

Gjykata Kushtetuese vlerësoi se shprehja, “akte e sjellje që diskreditojnë rëndë pozitën dhe figurën”, nuk lidhet vetëm me veprimet ose mosveprimet, që kryhen në kuadër të ushtrimit të funksioneve zyrtare, por edhe me sjelljet, që ndodhnin jashtë ushtrimit të detyrës, kur ato ndikojnë drejtpërdrejt në besimin e publikut ndaj sistemit të drejtësisë. Pra, sipas Gjykatës Kushtetuese, integriteti i këtyre funksionarëve tyre nuk mund të ndahet nga detyra që ata kryejnë. Çdo veprim që dëmtonte këtë integritet dhe cenonte besimin e publikut tek institucionet që ata përfaqësonin, mund të justifikonte procedurën e shkarkimit.

Përsa i përket rastit tjetër të shkarkimit, atë të “shkeljeve të rënda të ligjit gjatë ushtrimit të funksioneve”, ky term kërkonte një vlerësim të thelluar të disa elementeve, duke përfshirë rëndësinë e ligjit të shkelur, pasojat konkrete ose të mundshme të shkeljes, shpeshtësinë e shkeljes, dhe qëndrimin e subjektit ndaj shkeljes dhe pasojave të saj. Me këtë interpretim, Gjykata vendosi një standard të qartë për të dalluar shkeljet e rënda nga ato më të lehta dhe për të garantuar që procedura e shkarkimit të përdorej vetëm në raste kur shkeljet kishin një ndikim të madh negativ në funksionimin e institucioneve të sistemit të drejtësisë dhe në besimin e publikut.

Analiza në arsyetimin e vendimit të Gjykatës Kushtetuese, tregon për rëndësinë e lidhjes së shkaqeve të shkarkimit me pasojat konkrete dhe serioze për shoqërinë dhe shtetin. Shkeljet dhe sjelljet e përmendura në këto dispozita kushtetuese, nuk duhej të ishin të natyrës rutinë apo të zakonshme, por duhej të ishin raste dhe situata të jashtëzakonshme, që kërkonin një ndërhyrje serioze dhe të arsyetuar të Kuvendit dhe më pas, sipas Rastit të Gjykatës Kushtetuese apo të Presidentit. Kjo qasje siguroi një balancë midis ruajtjes së pavarësisë dhe funksionimit të këtyre institucioneve dhe nevojës për të pasur një sistem drejtësie të përgjegjshëm.

Megjithatë vendimi i Gjykatës Kushtetuese, nuk interpretoi nenin 147, pika 6, që trajtonte rastet e shkarkimit të gjyqtarëve të zakonshëm, siç do të trajtohet edhe në vijim, jurisprudenca e mëvonshme e Gjykatës së Lartë dhe e vetë Gjykatës Kushtetuese, duke marrë në konsideratë, që këto raste ishin të njëjta me ato që parashikoheshin për shkarkimin e anëtarëve të Gjykatës së Lartë, duke zbatuar rregullimin e “prezumimit të përdorimit të qëndrueshëm të normave” (*presumption of consistent usage canon*),¹⁸⁷ përcaktoi me të drejtë, që të njëjtat konkluzionet interpretuese vlejnë edhe në këto raste.

187. Antonin Scalia dhe Bryan A. Garner, “Reading law – The interpretation of the legal texts”, Thomson/west, 2012, fq. 170-173.

Në këtë periudhë të fundit, ka pasur disa ligje që kanë rregulluar organizimin dhe funksionimin e pushtetit gjyqësor, të prokurorisë të Këshillit të Lartë të Drejtësisë dhe të Ministrisë së Drejtësisë, të cilat, duke i parë nga pikëpamja e procesit disiplinor, do t'i shohim sipas radhës së miratimit të tyre.

1. Inspektimi dhe disiplina sipas ligjit nr. 8436, datë 28.12.1998 "Për organizimin e pushtetit gjyqësor"

Në zbatim të detyrimeve kushtetuese, brenda një muaji nga hyrja në fuqi e Kushtetutës së re, u miratua dhe ligji nr. 8436, datë 28.12.1998 "Për organizimin e pushtetit gjyqësor". Ky ligj, sa i takonte gjyqtarëve, nuk kishte ndryshime thelbësore nga ligji i mëparshëm nr. 8265, datë 18.12.1997 "Për organizimin e drejtësisë".

Përsa i përket inspektimit dhe përgjegjësisë disiplinore të gjyqtarëve, ky ligj kopjonte në mënyrë pothuaj identike, parashikimet e ligjit të vitit 1997, ku ndryshimi kryesor ishte vetëm heqja e parashikimeve dhe referimeve për prokurorët, të cilët tashmë, sipas formulimeve të reja kushtetuese, mbeteshin një pushtet i pavarur. Normat përkatëse kishin disa ndryshime stilistike, por mbeteshin parashikimet, që ligjvënësi kishte miratuar më parë në vitin 1997. Pra, mund të themi, se ligji i vitit 1998, ishte vijim i ligjit të vitit 1997, por i përshtatur vetëm për gjyqtarët.

1.1 Inspektimi dhe procedimi i gjyqtarëve

Ky ligj përsa i përket inspektimit dhe përgjegjësisë disiplinore në pushtetin gjyqësor, duke ruajtur formulimet e mëparshme, parashikonte se pranë Këshillit të Lartë të Drejtësisë krijohet Inspektorati dhe ky Këshill emëronte inspektorët, të cilët ngarkoheshin të inspektonin gjykatat e shkallës së parë dhe të apelit, për të verifikuar ankesat e shtetasve dhe të institucioneve, organizimet e shërbimeve gjyqësore, bënë evidentimin e aftësive profesionale të gjyqtarëve, vlerësonin ngarkesën në punë dhe në tërësi eficiencën e gjykatave. Ligji parashikonte që këta inspektorë të ndihmoheshin nga personeli i ministrisë së drejtësisë, i cili duhej t'i ndihmonte në kryerjen e detyrave të mësipërme, me përjashtim të atyre që kishin të bënë me aftësitë profesionale të gjyqtarëve. Inspektorë mund të emëroheshin personat që kishin profesionin e juristit dhe që plotësonin kushtet për të qenë gjyqtarë apeli. Për efekt të këtyre kriterëve, inspektorët barazoheshin në pagë dhe në të drejta të tjera me gjyqtarët e apelit.¹⁸⁸

Më reformën e vitit 1999, u përcaktua se inspektorët do të emëroheshin dhe shkarkoheshin nga Presidenti i Republikës, me propozim të Ministrit

188. Ligji nr. 8436, datë 28.12.1998, neni 17.

të Drejtësisë. Ky ndryshim mesa duket, u bë që të barazohej plotësisht statusi i inspektorëve me atë të gjyqtarëve të apelit, duke përfshirë kështu dhe mënyrën e emërimit të tyre. Kjo mund të shërbente, që edhe inspektorët të ushtronin në mënyrë të pavarur funksionet e tyre dhe të mos ndikoheshin nga “kërkesa”, që mund të kishin anëtarët e KLD-së. Por duke hequr të drejtën e emërimit nga Këshilli, për tek institucione të tjera, dukej se cenohej pavarësia organizative e vetë Këshillit të Lartë të Drejtësisë.

Gjithashtu, po me këtë reformë, u përcaktua se inspektorët kishin për detyrë të inspektonin gjykatat e shkallës së parë dhe të apelit, të verifikonin ankesat e shtetasve dhe të subjekteve të tjera për gjyqtarët, të kontrollonin organizimin dhe punën e shërbimeve gjyqësore, të bënë evidentimin e aftësive profesionale të gjyqtarëve, ngarkesën në punë dhe në tërësi eficiencën e gjykatave.¹⁸⁹ Më tej me reformën e vitit 2000, këtij inspektorati iu shtua edhe detyra, që të merrej me verifikimin dhe evidentimin e pasurive të deklaruara, të çështjeve të pajtueshmërisë së veprimtarisë dhe sjelljes së gjyqtarëve.¹⁹⁰

Të gjitha këto parashikime u shfuqizuan me miratimi nga Kuvendi të ligjit organik të Këshillit të Lartë të Drejtësisë, në vitin 2002,¹⁹¹ duke u rregulluar tashmë çështja e inspektimit nga ky Këshill, me atë ligj, që do e shohim në vijim.

Përsa i përket vetë procedimit disiplinor, ai vihej në lëvizje, në mënyrë ekskluzive nga ministri i Drejtësisë.¹⁹² Kjo e drejtë e Ministrisë të Drejtësisë, u parashikua edhe në ligjin nr. 8678, datë 14.05.2001 “Për organizimin dhe funksionimin e Ministrisë së Drejtësisë”, i cili ndër të tjera, parashikonte se “*Ministria e Drejtësisë, në përputhje me drejtimit kryesore të politikës së përgjithshme shtetërore dhe me programin e Qeverisë, ushtron veprimtarinë e saj në fushat si vijon: ... 9. Kryen inspektime dhe bën procedimin disiplinor të gjyqtarëve të gjykatave të shkallës së parë dhe të apelit sipas ligjit*”,¹⁹³ si edhe se “*Drejtoria e Inspektimit ushtron veprimtaritë si vijon: a) kryen inspektimin e gjykatave të shkallës së parë dhe të apelit lidhur me organizimin dhe punën e shërbimeve gjyqësore dhe administrimin gjyqësor në përgjithësi, si dhe përgatit rekomandime për ministrin e drejtësisë lidhur me marrjen e masave të nevojshme për zgjidhjen e problemeve dhe për shkeljet e konstatuara; b) kryen inspektime në gjykata dhe gjyqtarë të veçantë, sipas ligjit dhe përgatit rekomandime për ministrin e drejtësisë lidhur me marrjen e masave të nevojshme për zgjidhjen e problemeve dhe për shkeljet e konstatuara;*”.¹⁹⁴

189. Ligji nr. 8546, datë 05.11.1999, neni 4.

190. Ligji nr. 8656, datë 31.07.2000, neni 7.

191. Ligji nr. 8811, datë 17.05.2002, neni 39.

192. Ligji nr. 8436, datë 28.12.1998, neni 44.

193. Ligji nr. 8678, datë 14.05.2001, neni 6.

194. Ligji nr. 8678, datë 14.05.2001, neni 11.

Ky tagër i Ministrisë së Drejtësisë ishte konsideruar si kushtetues nga ana e Gjykatës së Lartë, e cila fillimisht mbajti qëndrimin se “Në ankimin e paraqitur nga ankuesi, veç problemeve që lidhen me shkeljet në çështjen konkrete, është pretenduar se procedura e shkarkimit të tij vjen në kundërshtim me nenin 147 të Kushtetutës, për faktin se materiali për në KLD është miratuar prej inspektorëve të Ministrisë së Drejtësisë dhe jo prej inspektorëve të KLD.

Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë në nenin 147 të saj ka përcaktuar përbërjen, organizimin dhe kompetencat e KLD., por ajo nuk ka përcaktuar dhe as mund të përcaktojë në mënyrë të hollësishme mënyrën e funksionimit të këtij organi për ushtrimin e kompetencave të mësipërme. Një gjë e tillë realizohet me ligjin organik nr. 8811, datë 17.05.2001 “Për organizimin dhe funksionimin e KLD”. Në këtë ligj, në nenin 31, është parashikuar e drejta e ministrit të drejtësisë për të kryer inspektime sipas programeve të hartuara kryesisht ose në zbatim të detyrave të caktuara nga KLD., në vijim të procesit të verifikimit të ankesave të shtetasve si dhe sipas të dhënave për të cilat vihet në dijeni kryesisht ose nëpërmjet Inspektoratit të KLD dhe pikërisht është ministri i drejtësisë, i cili po sipas kësaj dispozite, bën propozimin për procedim disiplinor të gjyqtarit para KLD.

Sa më sipër nuk shkel parimin kushtetues të pavarësisë së pushteteve sepse ekzekutivi (në rastin konkret Ministria e Drejtësisë) kryen vetëm procedurat paraprake (deri tek propozimi për procedim) të përcaktuara shprehimisht në ligjin që cituam më lart, si dhe në ligjin nr. 8436, datë 28.12.1998 “Për organizimin e funksionimin e pushtetit gjyqësor”. Është Këshilli i Lartë i Drejtësisë ai që vlerëson kërkesën për procedim disiplinor dhe vendos, në përputhje me nenin 147 të Kushtetutës dhe me ligjet e mësipërme, shkarkimin nga detyra të gjyqtarit”.¹⁹⁵

Pra, duke qenë se vendimmarrja përfundimtare i mbetëj KLD-së, zhvillimi i hetimit disiplinor nga ana e Ministrit të Drejtësisë nuk paraqiste problematika të ndarjes së pushteteve dhe kushtetuese për Gjykatën e Lartë.

Megjithatë pas këtij qëndrimi, Gjykata e Lartë ndryshoi qëndrim dhe i kërkoi Gjykatës Kushtetuese, shfuqizimin e këtyre dispozitave. Gjykata Kushtetuese, nuk i konsideroi të bazuara pretendimet e ngritura, duke arsyetuar se “Kushtetuta përcakton se pushteti gjyqësor ushtrohet vetëm nga gjykatat; nga Gjykata e Lartë, gjykatat e apelit dhe gjykatat e shkallës së parë. Krahës kësaj, standardet e tjera kushtetuese lidhur me pavarësinë e pushtetit kanë të bëjnë me garancitë, që gjyqtarët gëzojnë lidhur me emërimin, paprekshmërinë e palëvizshmërinë e tyre nga detyra pa shkaqe të përligjura, që kanë të bëjnë me mos ndjekjen e tyre penalisht dhe disiplinarisht, pa vendim të motivuar të KLD-së. Ndër këto standarde, Kushtetuta, në nenin 147, pika 4, ka përcaktuar se KLD-ja, vendos për transferimin e gjyqtarëve, si dhe për përgjegjësinë e tyre disiplinore sipas ligjit. Nga përmbajtja e fryma e kësaj dispozite del se Kushtetuta nuk i ka parashikuar shprehimisht si standarde të tilla, problemet që kanë të bëjnë me inspektimet, apo me fillimin e procedimit disiplinor.

195. Vendimi nr. 30, datë 31.03.2003 i Kolegjeve të Bashkuara të Gjykatës së Lartë.

Sa sipër, me rëndësi është fakti se KLD-ja, është organi i vetëm që vendos për përgjegjësinë disiplinore të gjyqtarëve. Këto aspekte kushtetuese ligjvënësi i ka zbërthyer në dy ligjet, dispozitat e të cilave janë objekt gjykimi si dhe në ligjin "Për organizimin e pushtetit gjyqësor në Republikën e Shqipërisë", i cili, në nenin 11 ka përcaktuar se, "...vendimet gjyqësore mund të jenë objekt shqyrtimi vetëm mbi bazën e ankimeve ose rekurseve në rrugë gjyqësore, sipas përcaktimeve në kodet e procedurave ose në ligje të veçanta". Pra, meqenëse ky pushtet ushtrohet i shkallëzuar, sipas parimit të kontrollit të vendimeve gjyqësore të gjykatave më të ulëta nga gjykatat më të larta, asnjë organ tjetër, qoftë KLD-ja apo ministri i drejtësisë nuk kanë të drejtë të kontrollojnë e vlerësojnë bazueshmërinë në ligj të vendimeve gjyqësore të formës së prerë, të mospërfillin përmbajtjen e tyre e të ngarkojnë me përgjegjësi gjyqtarin e çështjes. Duke iu referuar edhe praktikës së saj, Gjykata Kushtetuese çmon të nevojshme të rikonfirmojë qëndrimin, se vendimet gjyqësore kontrollohen vetëm nga gjykata më e lartë, e se asnjë organ tjetër nuk mund të vlerësojë ligjshmërinë dhe bazueshmërinë e vendimeve gjyqësore, për sa kohë, ato nuk janë ndryshuar ose prishur nga një gjykatë më e lartë.

KLD-ja mund të marrë masa disiplinore ndaj gjyqtarëve, pa e kushtëzuar atë me faktin nëse ky vendim ka marrë formë të prerë, vetëm për raste kur vendimet shoqërohen me akte dhe sjellje, që diskreditojnë rëndë pozitën dhe figurën e gjyqtarit dhe cenojnë në përgjithësi prestigjin dhe autoritetin e pushtetit gjyqësor.

Ky qëndrim është pranuar edhe në Rezolutën nr. (94)12, sipas të cilës: "...vendimet e një gjyqtari nuk mund të bëhen objekt rishikimi jashtë sistemit të apelimit siç parashikon ligji".

Duke ballafaquar dispozitat e kontestuara me konceptet e kushtetutës, Gjykata Kushtetuese konstaton se në këto dispozita nuk bëhet fjalë për kontroll mbi vendimmarrjen (mbi mënyrën e zgjidhjes së çështjes, administrimit e vlerësimit të provave), por për inspektime në lidhje me administrimin e drejtësisë e me shërbimet gjyqësore.

Parashtrimi në vendimin e kolegjeve të bashkuara, se e drejta e ministrit të drejtësisë për të kryer inspektime të gjykatave dhe të gjyqtarëve, si dhe e drejta e tij për të propozuar pranë KLD-së marrjen e masave disiplinore, përfshi dhe shkarkimin e gjyqtarëve, përbëjnë kompetenca që cenojnë parimin e ndarjes së pushteteve dhe parimin e pavarësisë së gjyqtarëve, përkatësisht të sanksionuara në nenet 7 dhe 145 të Kushtetutës, nuk është i saktë.

Sipas nenit 7 të Kushtetutës: "Sistemi i qeverisjes në Republikën e Shqipërisë bazohet në ndarjen dhe balancimin ndërmjet pushteteve ligjvënës, ekzekutiv dhe gjyqësor". Ky parim mund të kuptohet saktësisht, në qoftë se formulimi kushtetues studiohet në plotësinë dhe tërësinë e tij, nga ku evidentohet qartë, jo vetëm ndarja e tre pushteteve, por dhe balancimi i tyre. Nëse Kushtetuta do të kishte pasur parasysh sanksionimin vetëm të ndarjes së tre pushteteve, nuk do të ishte e nevojshme, madje do dukej fare pa kuptim togfjalësh "dhe balancimin ndërmjet pushteteve". Megjithëse këto pushtete janë të ndara në aspektin e autonomisë funksionale dhe në pavarësinë e ushtrimit të detyrave të

ngarkuara nga Kushtetuta, ato balancojnë njëri tjetrin nëpërmjet bashkëveprimit ndërmjet tyre për ushtrimin e detyrave, duke respektuar, nxitur, mbështetur dhe kontrolluar njëri-tjetrin.

Parimi i ndarjes së pushteteve nuk do kuptuar, që çdo pushtet është i mbyllur dhe i pakontrolluar nga askush. Ndarja e pushteteve midis tri degëve të qeverisjes, garantohet vetëm nëpërmjet sistemit të kontrolleve dhe ekuilibrave. Në këtë mënyrë, sipas Kushtetutës, aq sa flitet për ndarje, aq bëhet fjalë edhe për ekuilibër të pushteteve. Qëllimi i një koncepti të tillë kushtetues siguron, që të parandalohet çdo degë të qeverisjes, për të ushtruar një pushtet të pakufizuar. Kontrollat dhe ekuilibrat që njeh Kushtetuta, i japin secilës degë, pushtete që kompensojnë apo zbusin ato të degëve të tjera. Ekzistojnë mjete apo mekanizma që balancojnë pushtetet, sepse në analizë të fundit, asnjë pushtet në vete nuk është në gjendje të përmbushë misionin, nëse veprimtaria e tij nuk harmonizohet me veprimtarinë e pushteteve të tjera dhe nëse nuk sigurohet një ekuilibër, bashkërendim dhe kontroll reciprok, që natyrisht nuk ndërhyt, në atë masë, sa të dëmtojnë misionet e tyre kushtetuese.

Në nenin 145 të Kushtetutës sanksionohet, se gjyqtarët janë të pavarur dhe i nënshtrohen vetëm Kushtetutës dhe ligjeve. Me këtë kuptohet pavarësia, përgjegjësia dhe kompetenca e veçantë e gjyqtarëve në dhënien e drejtësisë, nëpërmjet zgjidhjes së çështjeve konkrete. Asnjë pushtet tjetër nuk mund të funksionojë si gjykatë dhe të ushtrojë detyrën e gjyqtarit. Askush nuk mund të ndërhyjë në dhënien e drejtësisë apo në dhënien e vendimit për çështje të caktuara. Askujt nuk i lejohej të vërë në diskutim njohjen dhe vlerën e vendimeve apo të refuzojë zbatimin e tyre, pasi ato kanë marrë formë të prerë. Këto koncepte, mbi pavarësinë e gjyqësorit dhe e gjyqtarëve gjejnë pasqyrim dhe në deklaratën e Këshillit konsultativ të gjyqtarëve Evropianë, sipas të cilës "... principet themelore të statusit të gjyqtarit të jenë të përcaktuara në normat e brendshme të nivelit më të lartë dhe në rregulla të nivelit legjislativ".

Gjyqtarët kanë detyrim të japin vendime në përputhje me Kushtetutën dhe ligjet, prandaj janë vendosur mekanizma apo rregulla që sigurojnë shmangien nga presionet, që mund të vijnë edhe nga funksionarë apo struktura të tjera, apo edhe nga brenda gjyqësorit nëpërmjet gjyqtarëve të niveleve më të larta, ose që bëjnë pjesë në organizma vendimmarrëse për karrierën dhe statusin e gjyqtarit.

Në kuptim të nenit 147, pika 4 të Kushtetutës dhe ligjeve të lartpërmendura, KLD-ja është i vetmi organ, që ka kompetencë të marrë masën disiplinore të shkarkimit nga detyra të gjyqtarëve të shkallës së parë dhe të apelit, pavarësisht se kush ka bërë verifikimin e shkeljes dhe kush bën propozimin për masën disiplinore.

Këtë kompetencë KLD-ja e zbaton duke vepruar, si organ që dëgjon "palët" dhe administron provat e nevojshme rreth pretendimeve të parashtruara.

KLD-ja është e lirë, që të mos pranojë asnjë kërkesë apo propozim, që vjen për masa disiplinore, kur nuk krijon bindjen se shkelja ekziston dhe nëse është e tillë, që justifikon masën. KLD-ja vepron si një organizëm demokratik sepse

gjyqtari, jo vetëm që njihet paraprakisht me gjithë materialet në ngarkim të tij, por merr pjesë në mbledhje të KLD-së, mund të përfaqësohet edhe nga avokati, ka të drejtë të bëjë çdo sqarim apo të kundërshtojë çdo akuzë, duke paraqitur edhe prova, që i çmon të nevojshme.

Nga njëra anë përbërja e KLD-së, ku 2/3 janë përfaqësues të gjyqësorit dhe nga ana tjetër, funksionimi mbi baza demokratike, e bëjnë këtë organ që të jetë objektiv dhe të marrë masa të drejta kur vërtetohen shkelje, si dhe të vihet në mbrojtje të gjyqtarëve ndaj akuzave të padrejta. Pra për këtë organ, pak rëndësi ka se kush bën propozimin. Jo vetëm kaq. Sipas nenit 16 shkronjës “ç” të ligjit për KLD-në, ky organ ka të drejtë dhe detyrë, që të kryejë verifikime për procedimin disiplinor të propozuar nga ministri i drejtësisë, në rastet kur çmohet dhe kërkohet nga KLD-ja. Në këto kushte, KLD-ja ka dhe instrumentet e duhura, Inspektoratin e tij, që të verifikojë çdo propozim që i vjen për procedimin disiplinor. Duke qenë kështu, fakti që sipas ligjit, Ministri ka të drejtë të kryejë inspektime dhe në përfundim, kur vërteton shkelje që passjellin përgjegjësi disiplinore, të nisë procedimin disiplinor, nuk përbën ndonjë zgjidhje me karakter antikushtetues, sepse nuk vjen në kundërshtim me nenet 7 e 145 të Kushtetutës.

Veç sa më lart, kjo Gjykatë çmon se për të dy ligjet, si dhe për ligjin “Për organizimin e pushtetit gjyqësor në Republikën e Shqipërisë”, ekziston nevoja për një përmirësim të tyre. Ekzistenca e dy inspektorateve, që duket se dublojnë njëri-tjetrin, përkufizimi dhe përcaktimi i qartë i nocioneve inspektim, kontroll, verifikim, evitimi i ndërthurjes së kompetencave midis dy inspektorateve dhe dy institucioneve (Ministrisë së Drejtësisë dhe KLD-së), lidhur me administrimin e drejtësisë e të shërbimeve, si dhe të vendosjes së kufijve të qartë mbi kontrollin në gjykatat dhe gjyqtarët, janë disa nga çështjet, që në kuadrin e përgjithshëm të përmirësimit të legjislacionit kanë nevojë për studim dhe rishikim nga organet përkatëse.

Nga sa u parashtrua, Gjykata Kushtetuese arrin në përfundimin se kërkesa e Kolegjeve të Bashkuara të Gjykatës së Lartë, duhet të rrëzohet si e pabazuar”.¹⁹⁶

Siç mund të vërehet nga arsyetimi i mësipërm, Gjykata Kushtetuese arriti në përfundimin se të gjitha dispozitat ligjore, që përcaktonin të drejtën e Ministrit të Drejtësisë për të kryer inspektime dhe për të nisur procedime disiplinore ndaj gjyqtarëve ishin në përputhje me Kushtetutën. Ajo argumentoi se këto dispozita nuk cenonin parimin e ndarjes së pushteteve apo pavarësinë e gjyqësorit, duke qenë se kompetenca e vendimmarrjes përfundimtare mbetej ekskluzivisht në duart e Këshillit të Lartë të Drejtësisë. Në këtë rast, për herë të parë, Gjykata Kushtetuese, nuk i referohet parimit të ndarjes së pushteteve, por parimit të “balancimit” të tyre, duke theksuar se balancimi i pushteteve ishte një element themelor i qeverisjes demokratike, përderisa roli i Ministrit të Drejtësisë si inspektues dhe propozues, nuk përbënte një ndërhyrje në pavarësinë e gjyqtarëve. Duke ruajtur një dallim të qartë midis funksionit të inspektimit dhe

196. Vendimi nr. 11, datë 11.05.2004 i Gjykatës Kushtetuese.

atij të vendimmarrjes, Gjykata Kushtetuese konsideroi se ligjet në fjalë respektonin standardet kushtetuese dhe ndërkombëtare. Megjithatë, Gjykata vuri në dukje nevojën për përmirësimin e kornizës ligjore, në drejtim të harmonizimit më të mirë të kompetencave ndërmjet Ministrisë së Drejtësisë dhe Këshillit të Lartë të Drejtësisë, për të shmangur çdo mbivendosje ose paqartësi në zbatimin e ligjit. Në këtë kuadër, kërkesa e Gjykatës së Lartë për shfuqizimin e dispozitave, u rrëzua, si e pabazuar.

Ligji parashikonte gjithashtu, se mundësia e Ministrit të Drejtësisë, për të nisur një procedim disiplinor ishte e kufizuar në kohë, ku fillimi i procedimit disiplinor mund të bëhej vetëm brenda tre viteve, nga data e kryerjes së shkeljes. Gjatë verifikimit, që bëhej nga inspektorët, duhej të përcaktohej nëse ishte kryer ndonjë shkelje e disiplinës, nga ato të përcaktuara në ligj, lloji dhe rëndësia e kësaj shkeljeje, fajësia e personit, si dhe të dhëna mbi të cilat mbështeteshin përfundimet e nxjerra. Në çdo rast duhet të dëgjohej edhe gjyqtari që kishte kryer shkeljen dhe inspektorët ishin të detyruar që të verifikonin të gjitha pretendimet, që ishin ngritur nga ana e gjyqtarit. Rezultatet e verifikimeve të bëra, si dhe të dhënat shkresore rreth tyre, do të duhej të pasqyroheshin në një akt përfundimtar, i cili i komunikohet gjyqtarit që pretendohet se kishte kryer shkeljen.¹⁹⁷ Materialet më pas i dërgoheshin i Ministrit të Drejtësisë dhe Këshillit të Lartë të Drejtësisë.¹⁹⁸

Këto parashikim, u shfuqizua, me miratimin e ligjit organik të KLD-së,¹⁹⁹ duke u rregulluar këto çështje nga legjislacioni i ri dhe që do të trajtohet në vijim.

Përsa i përket procedurave të inspektimit, duke iu referuar praktikës gjyqësore, rezulton një rast i shqyrtuar, nga ku procedura e ndjekur nga KLD është konsideruar e rregullt, pasi në një tjetër rast, Gjykata Kushtetuese ka mbajtur qëndrimin se, *“Gjykata Kushtetuese çmon se rezultojnë të pabazuara pretendimet e kërkuases, se nuk janë respektuar e drejta për t’u njohur me të dhënat e mbledhura rreth saj si dhe e drejta për t’u dëgjuar, të parashikuara respektivisht nga nenet 35 e 33 të Kushtetutës.*

Nga tërë materialet që disponon dosja, rezulton se kërkuësja është njohur më parë nga Inspektorati pranë Këshillit të Lartë të Drejtësisë, me shkaqet e shkeljet për të cilat është nisur procedimi disiplinor, është njoftuar dhe ka marrë pjesë në mbledhjen e Këshillit të Lartë të Drejtësisë së bashku me avokatët ku është dëgjuar, ka dhënë sqarime, ka kundërshtuar akuzat dhe u është përgjigjur pyetjeve të drejtuara asaj. Pasi i është komunikuar vendimi i Këshillit të Lartë të Drejtësisë, ka paraqitur ankim në Gjykatën e Lartë, është njoftuar dhe ka marrë pjesë në seancën e zhvilluar nga Kolegjet e Bashkuara dhe nëpërmjet përfaqësuesit ka parashtruar argumentet që sipas saj e bëjnë vendimin e Këshillit të Lartë të

197. Ligji nr. 8436, datë 28.12.1998, neni 44.

198. Ligji nr. 8436, datë 28.12.1998, neni 44.

199. Ligji nr. 8811, date 17.05.2002, neni 39.

Drejtësisë, të pabazuar. Në këtë aspekt, nuk qëndron as pretendimi i ngritur në seancë për shkelje të parimit të kontradiktoritetit, sepse nga mënyra se si është proceduar jo vetëm në Këshillin e Lartë të Drejtësisë, por edhe nga Kolegjet e Bashkuara të Gjykatës së Lartë, vendimi i të cilit kërkohet të shfuqizohet, ky parim është respektuar, konform neneve 18, 19 e 20 të Kodit të Procedurës Civile.²⁰⁰

Nga arsyetimi i mësipërm, rezulton qartësisht se procedurat disiplinore ishte respektuar nga ana e inspektoratit dhe vetë KLD-së, i cili kishte bërë të gjitha njoftimet e nevojshme.

Në një tjetër rast, që kishte të bënte me procedurat e inspektimit, gjejmë arsyetimin vijues, se "Ankuesi pretendon se vendimi i KLD është pasojë e një procesi jo të rregullt ligjor, i është mohuar e drejta për të qenë subjekt i barabartë para ligjit në një proces të rregullt ligjor. Nuk janë respektuar procedurat e njoftimit për fillimin e procedimit disiplinor nga ana e KLD, njohjes me relacionet e Inspektoratit pranë KLD dhe dokumentacionit përkatës, të provohen shkeljet e kryera nga gjyqtari mbi bazën e të cilave është filluar procedimi dhe mos njoftimi i datës së mbledhjes së KLD.

- Nga gjykimi i çështjes rezulton se pretendimi i ankuesit për moszbatim të kërkesave ligjore për një proces të rregullt ligjor nuk është i drejtë.

Nga aktet e ndodhura në dosje rezulton se, paditësit A. H., i janë bërë të ditura materialet e procedimit nga inspektorët e KLD-së, e ka njoftime të rregullta për procedurat e ndjekura nga KLD për procedimin disiplinor.

Kështu, më datën 22.11.2001, paditësit A.H. i është dorëzuar relacioni i inspektorëve të KLD, A. K., dhe M. P., për shkeljet ligjore të konstatuara të kryera nga ana e tij, për çfarë ka nënshkruar aktin.

Më datë 04.01.2002 i është dorëzuar nga Kryesekretarja e gjykatës T. M., relacioni i KLD lidhur me verifikimin e çështjes së V. Q., kundrejt nënshkrimit të tij.

Më datë 06.02.2002 i është dorëzuar kërkesa për fillimin e procedimit disiplinor e Ministrit të Drejtësisë, ndaj paditësit A. H., kundrejt nënshkrimit të tij.

Më datë 28.02.2002 është njoftuar për t'u paraqitur më datë 04.03.2002, ora 15.00 pranë Presidencës, për të marrë pjesë në mbledhjen e KLD, në të cilën do të shqyrtohet edhe kërkesa e Ministrit të Drejtësisë për «Procedim disiplinor» në ngarkim të tij. Njoftimi i është bërë nëpërmjet bashkëshortes A. H., e cila ka nënshkruar marrjen e njoftimit në prani të ftuesit të gjykatës dhe të një dëshmitari.

Më datë 23.04.2002 i është njoftuar kopja e relacionit të Inspektoratit të KLD, datë 25.03.2002 për procedimin disiplinor në ngarkim të tij bashkëshortes A. H., kundrejt nënshkrimit në prani të ftuesit të gjykatës dhe të një dëshmitari.

Më datë 04.05.2002 ka marrë dijeni personalisht për kopjen e kërkesës shtesë për procedim disiplinor me nr. 96/5 prot., datë 02.05.2002 dhënë nga ministri i drejtësisë, por ka refuzuar të firmosë dhe të marrë dokumentet nga KLD, ky fakt konfirmohet nga ftuesi i gjykatës dhe një dëshmitar i pranishëm.

Më datë 21.05.2002 është njoftuar personalisht A. H., se më datë 27.05.2002,

200. Vendimi nr. 18, datë 18.04.2000 i Gjykatës Kushtetuese.

*ora 14.00 në ambientet e Presidencës do të zhvillohet mbledhja e KLD, në të cilën do të shqyrtohet kërkesa e ministrit të drejtësisë për procedimin e tij, por ai ka refuzuar të nënshkruajë njoftimin në prani të ftuesit të gjykatës dhe të një dëshmitari. Sa më sipër, nuk rezultojnë shkelje të ligjit në lidhje me njoftimet”.*²⁰¹

Nga arsyetimi i mësipërm, rezulton se procedura e inspektimit dhe ajo e njoftimit në lidhje me procedimin disiplinor të gjyqtarit që po procedohej ishte ndjekur në përputhje të plotë me kërkesat ligjore. Procesi i inspektimit, i kryer nga inspektorët e KLD-së ishte dokumentuar me kujdes, duke përfshirë relacionet e detajuara mbi shkeljet e pretenduara dhe njoftimin e këtyre konkluzioneve gjyqtarit në çdo hap të procedurës. Relacionet e inspektorëve, të shoqëruara me firmën e gjyqtarit ose të bashkëshortes së tij ishin prova të qarta, që dëshmonin se subjekti që po procedohej ishte njohur me përmbajtjen dhe arsyet, që mbështesnin këtë procedim disiplinor. Fakti që gjyqtari refuzoi të firmoste ose të merrte dokumentet në disa raste, nuk e bëri të pavlefshme procedurën, përkundrazi, ajo tregonte mungesën e gatishmërisë së tij për të bashkëpunuar me KLD-në.

Në këtë rast, inspektorët e KLD-së kishin kryer detyrën e tyre në mënyrë të përpiktë, duke përpiluar raporte të qarta dhe duke respektuar afatet dhe kërkesat e procedurës. Kjo tregonte se procesi ishte ndjekur me përpikmëri dhe përjashtonte mundësinë e cenimit të të drejtave procedurale të gjyqtarit.

Ligji parashikonte që Këshilli i Lartë i Drejtësisë, përpara se të merrte vendimin, duhej të dëgjonte në një seancë pretendimet e palëve. Materialet e plota i viheshin në dispozicion gjyqtarit 10 ditë përpara zhvillimit të seancës. Ai kishte të drejtë që të mbrohej vetë ose me avokatë gjatë seancës.²⁰²

Këto rregulla dhe afate procedurale ishin vendosur me qëllim garantimin e së drejtës së mbrojtjes së gjyqtarit që po procedohej. Është e kuptueshme që mosrespektimi i së drejtës për t’u dëgjuar, sillte si pasojë pavlefshmërinë e vendimmarrjes së Këshillit të Lartë të Drejtësisë, siç ka arsyetuar Gjykata e Lartë në një rast, se “Por KLD në marrjen e këtij vendimi nuk ka respektuar një proces të rregullt ligjor, sepse ka vendosur largimin e ankueses nga detyra e gjyqtares pa e dëgjuar më parë atë, siç parashikon ligji nr. 8436, datë 28.12.1998 “Për Organizimin e Pushtetit Gjyqësor në Republikën e Shqipërisë” (i ndryshuar), neni 44, i cili ka dalë në zbatim të Kushtetutës së Shqipërisë.

Sipas asaj dispozite, në çdo rast procedimi disiplinor duhet të dëgjohet edhe gjyqtari që ka kryer shkeljen. Verifikimi i pretendimeve është i detyrueshëm.

KLD, përpara se të marrë vendimin, duhet të dëgjojë në një seancë pretendimet e palëve. Materialet e plota i vihen në dispozicion gjyqtarit 10 ditë përpara zhvillimit

201. Vendimi nr. 88, datë 18.11.2002 i Kolegjeve të Bashkuara të Gjykatës së Lartë.

202. Ligji nr. 8436, datë 28.12.1998, neni 44.

të seancës. Ai ka të drejtë të mbrohet vetë ose me avokatë gjatë seancës.

Në këtë mënyrë, ankuesja, jo për faj të saj, nuk ka pasur mundësi të dëgjohet dhe të mbrohet përpara KLD, për shkak se kjo e fundit nuk e ka njoftuar rregullisht dhe nuk i ka vënë në dispozicion materialet përpara zhvillimit të seancës.

Rezulton se, ankuesja, në kohën e largimit me leje për një vit për të vazhduar studimet pasuniversitare për "Master" në Universitetin Komplutense të Madridit, në tetor 1998, ka lënë adresë, e cila i është bërë e njohur Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, ku ajo punonte si gjyqtare, nëpërmjet shkresës së ministrit të drejtësisë nr. 3148, datë 17.09.1998. Pra, ajo nuk është larguar në drejtim të paditur. Në këto rrethana KLD-ja, nëpërmjet kryetarit të gjykatës së mësipërme, prezumohet të ishte në dijeni për vendndodhjen e saj, ku ajo vazhdonte e kryente studimet tashmë për një gradë më të lartë shkencore, "Doktoraturë".

Për rrjedhojë, KLD-ja duhej ta bënte komunikimin me ankuesen, nëpërmjet kryetarit të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, sipas adresës që ajo kishte lënë dhe t'i dërgonte brenda afatit që parashikon ligji i mësipërm, materialin që bënte fjalë për largimin e saj nga detyra.

Në të kundërtën, KLD, nëpërmjet inspektorëve të saj është mjaftuar me kërkimin dhe marrjen e një deklarate të atit të ankueses, me datën 08.10.2000, në të cilën thuhet se, ai nuk dinte nëse ankuesja kishte marrë leje të dytë për vazhdimin e mëtejshëm të studimeve dhe se nuk kishte dijeni, nëse do të kthehej në Shqipëri kur të mbaronte studimet.

Kështu, më 15.11.2000 ministri i drejtësisë i ka kërkuar KLD-së fillimin e procedimit disiplinor ndaj ankueses dhe shkarkimin e saj nga detyra e gjyqtares për shkakun e lartpërmendur.

Në këto rrethana, KLD i kishte të gjitha mundësitë, që përpara se të merrte vendimin për largimin e ankueses nga detyra e gjyqtarit, të respektonte të drejtën e saj për t'u dëgjuar dhe mbrojtur, në mënyrën që parashikon ligji i mësipërm "Për Organizimin e Pushtetit Gjyqësor në Republikën e Shqipërisë" (i ndryshuar).

Mosrespektimi i kësaj të drejte nga ana e KLD-së, e bën të paligjshëm vendimin e saj nr. 97/2, datë 25.11.2000, në pjesën që bën fjalë për shkarkimin e ankueses nga detyra e gjyqtares, prandaj ky vendim duhet të shfuqizohet në këtë pjesë".²⁰³

Në këtë vendimmarrje, Gjykata e Lartë, vuri theksin në respektimin e procedurave, që kanë pasur të bëjnë me njoftimin e subjektit, që po procedohej dhe realizimin e të drejtave të tij të mbrojtjes. Pikërisht cenimi i këtyre parashikimeve, solli si pasojë shfuqizimin e vendimmarrjes së KLD-së.

Në një tjetër rast, në lidhje me procedurat që ka ndjekur KLD-ja, nga Gjykata Kushtetuese është arsyetuar, se "Gjatë shqyrtimit të çështjes nga Gjykata Kushtetuese, rezultoi se Këshilli i Lartë i Drejtësisë, në marrjen e vendimit për shkarkimin e kërkuesit nga detyra, ka zhvilluar një proces jo të rregullt ligjor, në kundërshtim me nenin 42/1 të Kushtetutës. Ai nuk i ka

203. Vendimi nr. 1, datë 16.01.2002 i Kolegjeve të Bashkuara të Gjykatës së Lartë.

siguruar kërkuesit mundësinë për t'u dëgjuar e mbrojtur në seancën e shqyrtimit të çështjes, gjë që ka prekur të drejtat e tij, të njohura nga Kushtetuta dhe ligji "Për organizimin e pushtetit gjyqësor në Republikën e Shqipërisë".

Gjykata Kushtetuese konstatoi se kërkuesi A. A., nuk është njoftuar për të marrë pjesë në mbledhjen e datës 20.12.2000 të Këshillit të Lartë të Drejtësisë, as nëpërmjet shpalljes së vendosur në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Tiranë, as nëpërmjet avokatit të tij, ose ftuesit të gjykatës.

Nga provat e administruara në seancë gjyqësore, rezultoi se kërkuesi, me shpalljen e vendosur në gjykatë në datën 30.11.2000, njoftohej për t'u paraqitur pranë Inspektoratit të Këshillit të Lartë të Drejtësisë për komunikimin e materialeve të procedimit disiplinor të filluar nga Ministri i Drejtësisë dhe jo për datën e shqyrtimit të çështjes.

Nga deklarata e lëshuar prej ftuesit gjyqësor, rezultoi se kërkuesi nuk është njoftuar për datën e shqyrtimit të çështjes sepse në deklaratë thuhet që ftuesi kishte marrë përsipër t'i dorëzonte kërkuesit vetëm materialet e Inspektoratit të Këshillit të Lartë të Drejtësisë.

Njoftimi i kërkuesit për datën e shqyrtimit të çështjes nuk është bërë as nëpërmjet avokatit. Gjatë gjykimit rezultoi se kërkuesi nuk kishte caktuar avokat për ta përfaqësuar. Nuk u tregua emri i avokatit që pretendonte se kishte marrë përsipër të bënte njoftimin dhe nuk u shfaq ndonjë dyshim që kërkuesi, largimin nga Shqipëria, ta kishte bërë për t'iu fshehur shqyrtimit të çështjes.

Në kushtet e mësipërme, Këshilli i Lartë i Drejtësisë ka vepruar në kundërshtim me nenin 33/1 të Kushtetutës dhe me nenin 6 të Konventës Evropiane të të Drejtave të Njeriut, në të cilat është sanksionuar parimi i të drejtës që ka çdo person që të dëgjohet përpara se të gjykohet. Ai ka vepruar në kundërshtim edhe me nenin 44 të ligjit "Për organizimin e pushtetit gjyqësor në Republikën e Shqipërisë" që parashikon, detyrimin e Këshillit të Lartë të Drejtësisë që në çdo rast të procedimit disiplinor, të dëgjojë në seancë pretendimet e gjyqtarit, i cili ka të drejtë të mbrohet vetë apo me avokat".²⁰⁴

Nga arsyetimi i mësipërm, duket se janë ngatërruar procedurat e njoftimeve, që ndiqen në faza të ndryshme të procedimit disiplinor. Kështu, njoftimi i fillimit të procedimit disiplinor, nuk duhej të ngatërrohej me datën e shqyrtimit të çështjes në KLD.

Zbatimi i rregullave procedurale disiplinore, me qëllim respektimin e mbrojtjes përpara KLD-së është bërë pjesë e një debati të midis Gjykatës së Lartë dhe Gjykatës Kushtetuese, nëse ishte respektuar apo jo e drejta për t'u dëgjuar, kur gjyqtarja që po procedohej kërkonte shtyrjen e seancës dëgjimore, duke sjellë në mënyrë të vazhdueshme raporte mjekësore. Gjykata e Lartë në këtë rast, e konsideroi si një lloj shmangie nga detyrimi i gjyqtarës për t'u paraqitur para Këshillit të Lartë të Drejtësisë dhe më konkretisht arsyetoi se: "Në ankesën kundër vendimit të KLD-së, M. M., parashtron disa probleme që, (sipas saj) kanë të bëjnë me shkelje të procedurave

204. Vendimi nr. 11, datë 02.04.2003 i Gjykatës Kushtetuese.

të shqyrtimit të çështjes nga KLD-ja dhe me konkluzione të padrejta në trajtimin e problemeve të zbatimit të ligjit material nga gjykata”.

Kështu, ankuesja M. M., pretendon se vendimi i KLD-së është haptazi i kundërligjshëm sepse shqyrtimi i procedimit disiplinor dhe vendimi i marrë janë rrjedhojë e një procesi jo të rregullt ligjor, pasi është bërë në mungesën e saj duke i mohuar të drejtën kushtetuese për t’u mbrojtur.

Në drejtimin që e trajton problemin ankuesja, kemi të bëjmë me një nga të drejtat kryesore të çdo shtetasi në rastin e gjykimit të një çështjeje, në rrugë administrative apo gjyqësore. Në konventat e ndryshme të pranuara edhe nga shteti ynë theksohet, se çdo person ka të drejtë të jetë i pranishëm gjatë një procesi gjykimi dhe të mbrohet vetë, ose të ketë ndihmën e një mbrojtësi të caktuar prej tij. Edhe në nenin 33 të Kushtetutës së Shqipërisë theksohet se “Kushdo ka të drejtë të dëgjohet para se të gjykohet” dhe në nenin 42/1 thuhet se “... dhe të drejtat e njohura me Kushtetutë dhe me ligj nuk mund të cenohen pa një proces të rregullt ligjor”.

Duke iu referuar materialeve të çështjes rezulton se, pretendimi i ankueses për moszbatimin e kërkesave ligjore për një proces të rregullt ligjor është i padrejtë. Rezulton se që më datë 04.01.2002 ankueses i është dorëzuar materiali me konkluzionet e nxjerra nga kontrolli i ushtruar nga inspektorët e KLD-së, dërguar me shkresën nr. 513, datë 03.01.2002 të KLD-së. Po kështu në dosje ndodhet një shkresë e datës 27.02.2002, që i drejtohet ankueses, ku thuhet “njoftoheni të paraqiteni me datën 04.03.2002 për të marrë pjesë në mbledhjen e KLD-së, në të cilën do të shqyrtohet edhe kërkesa e Ministrit të Drejtësisë për procedimin disiplinor në ngarkimin tuaj” dhe në të është shënimi i ankueses “mora njoftim më 28.02.2002”.

Më datë 23.04.2002 ka shënim të ankueses M. M., ku thuhet “sot më datë 23.04.2002, unë gjyqtare M. M., mora kopjen e relacionit për shkelje në gjykimin e çështjeve penale e civile” dhe po në datën e sipërme, ka një shkresë me nënshkrimin e ankueses ku thuhet “ju dorëzohet kopja e relacionit të inspektoratit të KLD-së për procedimin disiplinor në ngarkimin tuaj”.

Sikurse shihet, ankueses M. M., i janë paraqitur në kohë të gjitha materialet që kanë të bëjnë me konkluzionet e kontrollit të ushtruar nga inspektorati i KLD-së dhe materialet për procedimin disiplinor të saj, drejtuar KLD-së nga ministri i drejtësisë.

Pas përfundimit të procedurave ligjore paraprahe, rezulton se nga KLD-ja, në vazhdimësi janë realizuar detyrimet për njoftimin e kërkeses, shqyrtimin e çështjes në bazë të procedurave ligjore dhe me pjesëmarrjen e ankueses. Më datë 17.05.2002, ankueses M. M., i është dërguar telegram nga KLD-ja, ku njoftohet se “ditën e hënë më datë 27.05.2002, të jeni prezente në mbledhjen e KLD-së, pasi do të shqyrtohet kërkesa e ministrit të drejtësisë për procedim disiplinor”. Në këtë datë ankuesja nuk ka marrë pjesë, pasi ka dërguar një raport të datës 24.05.2002, nga del se për shkak të gjendjes me neurozë depresive, i jepej pushim 15 ditë, gjë që e detyroi KLD-në të shtynte shqyrtimin e çështjes.

Më datë 10.6.2002, ankuesja është njoftuar se më datën 15.06.2002 do të zhvillohej mbledhja e KLD-së, por përsëri ajo ka dërguar një telegram ku thotë “në pamundësi për shkak shëndetësor të paraqitem. Bashkëlidhur ju dërgoj raportin mjekësor”. Nga raporti mjekësor i dërguar, që mban datën 08.06.2002, del se ankueses i është dhënë një pushim prej 15 ditësh me diagnozën “syndrom depresiv”, gjë që ka detyruar KLD-në të shtyjë përsëri shqyrtimin e çështjes për më datën 15.7.2002. Më datë 08.07.2002 me shkresën nr. 127 prot., KLD-ja njofton ankuesen M. M., se “në mbledhjen e datës 15.06.2002, KLD-ja vendosi ta shqyrtojë këtë kërkesë të ministrit të drejtësisë, në mbledhjen e tij të ardhshme dhe në qoftë se ju nuk do të paraqiteni si herët e kaluara, të caktoni avokat për t’u përfaqësuar, në të kundërtën procedimi disiplinor do të zhvillohet në mungesën tuaj”.

Por edhe pas kësaj, ankuesja ka mbajtur të njëjtin qëndrim. Më datë 14.07.2002, ajo i dërgon një shkresë KLD-së ku shprehet: “më 13.07.2002 mora dijeni për shqyrtimin e procedimit disiplinor më datën 15.07.2002. Për shkak të gjendjes shëndetësore, sikurse dhe në mbledhjen e mëparshme, nuk mund të jem e pranishme në mbledhje” dhe ka dërguar raportin mjekësor të datës 13.07.2002, me të cilin i jepej pushim deri më datën 16.07.2002.

I ndodhur përpara këtij qëndrimi, që sa herë që ankuesja merrte njoftim për datën e mbledhjes së KLD-së ajo paraqiste raport, pa iu përgjigjur faktit, që nëse nuk ishte në gjendje vetë, të përfaqësohej me avokat, KLD-ja ka shqyrtuar çështjen dhe vendosi shkarkimin e saj nga detyra unanimisht.

Duke ju referuar fakteve të mësipërme, mbetet i papranueshëm pretendimi i ankueses M. M., se ndodhemi para një procesi të parregullt ligjor, sepse ajo nuk është dëgjuar para se të vendosej marrja e masës disiplinore. Konkretisht procesi i zgjidhjes së çështjes është bërë në pajtim me kërkesat ligjore. Është e qartë se KLD-ja duhet të marrë vendimet pasi të ketë dëgjuar personin, pretendimet e tij e t’i verifikojë ato. Por është e kuptueshme se këto kërkesa zbatohen kur gjyqtari për të cilin pretendohet se ka kryer shkeljen, është edhe vetë i interesuar për të realizuar të drejtat e tij e jo t’u shmanget atyre në mënyra të ndryshme. KLD-ja ka zbatuar të gjitha kërkesat ligjore dhe për disa muaj, pasi ka respektuar procedurat e njoftimit, i ka kërkuar ankueses që të paraqitej për shqyrtimin e çështjes, por ajo, duke gjetur rrugën e marrjes së raporteve mjekësore, nuk i ka dhënë mundësinë KLD-së që ta dëgjonte para se të merrte vendimin për shkarkimin e saj nga detyra e gjyqtares.

Në rastin në shqyrtim duhet të mbahet parasysh, se kërkueses i janë krijuar të gjitha mundësitë për t’u paraqitur vetë apo me përfaqësues në KLD. Sipas ligjit, çdo personi që për arsye të ndryshme ka pretendime për mospjesëmarrje në shqyrtimin e një çështjeje në ngarkim të tij, i krijohet mundësi e plotë që të paraqesë pretendimet nëpërmjet mbrojtësit të caktuar prej tij, dhe këtë të drejtë mund ta ushtronte realisht edhe kërkuesja. M.,M., e ka pasur mundësinë të caktonte një mbrojtës, i cili, qoftë edhe formalisht, mund të paraqitej në mbledhjen e KLD-së, të deklaronte përfaqësimin dhe të shprehej se nuk kishte tagër për ta

mbrojtur të përfaqësuarën në mungesë të saj. Sikurse shihet, vetë kërkuesja nuk ka marrë masa për paraqitjen e pretendimeve të saj para KLD-së, nuk ka treguar interesim për të realizuar mbrojtjen dhe duke mos zbatuar prej saj rregullat ligjore, pranohet se ka dashur që të mos zbatohet ligji dhe i është shmangur atij. Gjithashtu, nga letra dërguar KLD-së nuk del, që ajo të ketë kërkuar shtyrjen e shqyrtimit të çështjes për të marrë pjesë vetë apo me përfaqësues, duke lënë të kuptohet për vazhdimin e shqyrtimit të çështjes pa pjesëmarrjen e saj apo të mbrojtësit të caktuar prej saj”.²⁰⁵

Pra, siç mund të konstatohet Gjykata e Lartë e konsideroi të pajustificuar qëndrimin e gjyqtarës, e cila kërkonte vazhdimisht shtyrjen e seancave dëgjimore, me justifikimin se ndodhej në pamundësi për të qenë e pranishme. Megjithatë, pavarësisht kësaj analize, e vënë në lëvizje mbi bazën e ankimit kushtetues individual, Gjykata Kushtetuese u shpreh se “Nga ana e Ministrit të Drejtësisë është kërkuar fillimi i procedimit disiplinor për marrjen e masës, vërejtje me paralajmërim ndaj gjyqtarës M. M., për arsye se ka shkelur kërkesat e nenit 387 të Kodit të Procedurës Penale. Nga ana e Inspektoratit pranë Këshillit të Lartë të Drejtësisë, është përpiluar një tjetër relacion për shkelje të ligjit në gjykimin e disa çështjeve penale dhe civile nga ana e gjyqtarës. Mbi këtë bazë, Ministri i Drejtësisë ka paraqitur një kërkesë shtesë për procedimin disiplinor të gjyqtarës për shkarkim nga detyra. Njoftimi për kërkesën shtesë të procedimit disiplinor të gjyqtarës nuk rezulton t’i jetë njoftuar sipas rregullave që parashikon Kodi i Procedurave Administrative, sepse në këtë kohë kërkuesja ka qenë e pezulluar nga detyra.

Këshilli i Lartë i Drejtësisë, nuk ka mundur të shqyrtojë kërkesën për procedim disiplinor në datat 27.05.2002 dhe 15.06.2002 për arsye, se kërkuesja ka paraqitur dy raporte mjekësore afatgjatë me diagnozë neurozë depresive dhe sindromë depresive. Mbledhja e Këshillit të Lartë të Drejtësisë është shtyrë për në datën 15.07.2002. Kërkuesja ka njoftuar me telegram subjektin e interesuar, se për shkak të gjendjes së rëndë shendetësore, nuk mund të ishte e pranishme në këtë mbledhje, duke paraqitur dhe një raport mjekësor. Këshilli i Lartë i Drejtësisë, në mungesë të kërkueses, ka vendosur zhvillimin e seancës dhe shkarkimin e saj nga detyra. Mbi këtë veprim të kryer nga subjekti i interesuar është përqendruar Gjykata Kushtetuese për t’i dhënë zgjidhje pretendimit të kërkueses për shkelje të të drejtës për një proces të rregullt ligjor.

Kërkuesja pretendon se nuk është dëgjuar në një seancë të rregullt ligjore nga Këshilli i Lartë i Drejtësisë. Rregulli i njohur dhe i sanksionuar në legjislacionin tonë është se gjyqtari nuk mund të shkarkohet pa u dëgjuar. Sipas nenit 44 të ligjit “Për Organizimin e Pushtetit Gjyqësor në Republikën e Shqipërisë”, në çdo rast duhet të dëgjohet edhe gjyqtari që ka kryer shkeljen dhe verifikimi i pretendimeve të tij është i detyrueshëm. Në nenin 33 të ligjit “Për Organizimin dhe funksionimin e Këshillit të Lartë të Drejtësisë”, parashikohet mënyra e thirrjes së gjyqtarit konform rregullave të Kodit të Procedurave Administrative.

205. Vendimi nr. 83, datë 18.12.2002 i Kolegjeve të Bashkuara të Gjykatës së Lartë.

Në nenin 7, pika 4 të Rregullores “Për procedimin disiplinor të gjyqtarëve”, të miratuar nga Këshilli i Lartë i Drejtësisë, parashikohet se kur mosparaqitja e gjyqtarit bëhet për shkaqe të arsyeshme, Këshilli i Lartë i Drejtësisë duhet të shtyjë shqyrtimin e procedimit disiplinor për në mbledhjen më të afërt, pasi të jetë shuar shkaku i mosparaqitjes.

Gjykata Kushtetuese çmon, se këto rregulla procedurale, që lidhen me të drejtën për t’u dëgjuar dhe për t’u mbrojtur nuk rezultojnë të jenë respektuar nga Këshilli i Lartë i Drejtësisë. Kërkesja nuk është paraqitur në mbledhjen e Këshillit të Lartë të Drejtësisë, ku do të shqyrtohej kërkesa për procedim disiplinor duke pretenduar, se ka qenë me paaftësi të përkohshme për punë. Këtë mungesë e ka justifikuar me paraqitjen e disa raporteve mjekësore, diagnoza e të cilës, rezulton të ketë qenë serioze. Mungesën e kërkeses, si dhe paraqitjen e raportit mjekësor, subjekti i interesuar nuk e ka konsideruar si shkak të arsyeshëm për të shtyrë zhvillimin e seancës dëgjimore.

Gjykata Kushtetuese vlerëson, se në procesin disiplinor që kishte të bënte me elemente esenciale të të drejtës së individit për të pasur një proces të rregullt ligjor ishte detyrë e Këshillit të Lartë të Drejtësisë të evidentonte dhe argumentonte shkaku i mosparaqitjes së kërkeses. Raporti mjekësor i paraqitur nga kërkesja përbën një akt zyrtar me vlerën e provës dhe që konsiderohet i vlefshëm, derisa nuk provohet falsiteti i tij. Ky është kuptimi i dhënë aktit zyrtar që merr vlerën e provës në Kodin e Procedurës Civile. Paraqitja e raportit mjekësor nga kërkesja përbënte një shkak të përligjur dhe të arsyeshëm, që Këshilli i Lartë i Drejtësisë të mos e shqyrtonte kërkesën për procedimin disiplinor ndaj saj, por të shtynte mbledhjen. Përsa kohë që shkaku i mosparaqitjes së kërkeses konsiderohej i ligjshëm dhe i arsyeshëm, nuk mund të zhvillohej seanca dhe të merrej masa e shkarkimit të saj nga detyra, pa i krijuar mundësinë për t’u dëgjuar dhe për të zbatuar rregullat e kontradiktoritetit në gjykim.

Rregullat procedurale që duhet të zbatohen gjatë procedimit disiplinor të gjyqtarëve i referohen sipas nenit 33 të ligjit “Për Organizimin dhe funksionimin e Këshillit të Lartë të Drejtësisë” edhe dispozitave të Kodit të Procedurave Administrative. Në nenin 96 të këtij Kodi, janë sanksionuar rastet, se kur përjashtohet mundësia e palëve për t’u dëgjuar dhe shprehur pranë organit procedues. Në rastet që lidhen me marrjen e vendimeve urgjente apo kur është e qartë se një masë e tillë mund të kompromentojë ekzekutimin e vendimit, organi procedues mund ta zhvillojë gjykimin pa e dëgjuar palën. Gjithashtu lejohet zhvillimi i gjykimit në mungesë të palës së interesuar edhe kur ato kanë pasur rast të japin mendimin e tyre për çështjen gjatë zhvillimit të procedimit si dhe kur informacioni i paraqitur gjatë procedimit të çon drejt një vendimi në favor të palës së interesuar. Në çështjen në shqyrtim nuk rezulton të ketë ekzistuar ndonjë nga rastet e sipërcituara që të ligjëronte zhvillimin e procedimit disiplinor në mungesë të gjyqtarës.

Në shqyrtimin dhe zgjidhjen e kësaj çështjeje, Gjykata Kushtetuese niset nga kuptimi kushtetues, që i është dhënë të drejtës për një proces të rregullt

ligjor. Jurisprudenca e Gjykatës Evropiane të të Drejtave të Njeriut dhe në veçanti ajo shqiptare, kanë pranuar se elementet thelbësore të kësaj të drejte zbatohen si për procedurat gjyqësore, ashtu edhe për procedurat parlamentare dhe ato administrative. Vlera të tilla si pavarësia e gjyqësorit, paprekshmëria dhe palëvizshmëria e gjyqtarit, që lidhet me statusin dhe mbrojtjen e tyre brenda kuadrit kushtetues, kontrolli mbi vendimmarrjen, paanësia në gjykim, e drejta për t'u dëgjuar dhe mbrojtur etj., janë trajtuar si elemente thelbësore të të drejtës për një proces të rregullt ligjor në jurisprudencën kushtetuese. Mosrespektimi i procedurës për realizimin e këtyre standardeve në një proces ligjor është konsideruar si cenim i vetë thelbit të tij.

Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë, aktet ndërkombëtare, si dhe jurisprudenca e Gjykatës Kushtetuese kanë pranuar, se e drejta për një proces të rregullt ligjor përbën një nga të drejtat e pakufizueshme të individit. Ajo është një e drejtë nëpërmjet së cilës individët kërkojnë realizimin e procedurave të rregullta dhe të ndershme ligjore. E drejta për një proces të rregullt ligjor paraqitet si një garanci për shtetasin kundër veprimeve të padrejta të organeve të pushtetit, si dhe përbën njëkohësisht një detyrim për këto të që të mos cenojnë të drejtat dhe liritë e shtetasve pa u siguruar respektimin e procedurave të rregullta ligjore. Çdo organ i pushtetit publik gjatë ushtrimit të funksionit të tij kushtetues e ligjor është i detyruar të respektojë standardet e gjithëpranuara demokratike, të cilat kanë gjetur pasqyrimin e tyre në Kushtetutë. "Argumentimi i shkeljeve që atribuohen, respektimi gjatë shqyrtimit i parimit të ndarjes së pushteteve, njohja paraprake e personit ndaj të cilit kërkohet të merret masa e shkarkimit me materialet që e ngarkojnë me përgjegjësi, respektimi i të drejtës për t'u dëgjuar dhe mbrojtur si me anën e dhënies së sqarimeve paraprake ashtu dhe gjatë shqyrtimit të çështjes, janë disa nga elementet bazë që garantojnë të drejtën kushtetuese të cilitdo për një proces të rregullt ligjor, si një e drejtë themelore, cenimin e së cilës, jurisprudenca e Gjykatës Kushtetuese e ka identifikuar në çdo rast, si shkelje të Kushtetutës.

Mbi bazën e kësaj analize të hollësishme, në referencë të rregullave procedurale që parashikohen për zhvillimin e procedimit disiplinor ndaj gjyqtarit si dhe konceptit kushtetues të së drejtës së individit për gëzuar një proces të rregullt ligjor, Gjykata Kushtetuese konkludon, se në rastin konkret, Këshilli i Lartë i Drejtësisë ka shkelur të drejtën e kërkuar për t'u dëgjuar dhe mbrojtur në kuptim të nenit 42 të Kushtetutës, si dhe të nenit 6 të KEDNJ".²⁰⁶

Siç mund të konstatohet, vendimi i Gjykatës së Lartë dhe ai i Gjykatës Kushtetuese përbënin dy qasje diametralisht të kundërta lidhur me respektimin e të drejtave procedurale të gjyqtarës, që po procedohej dhe kuptimin e të drejtës për një proces të rregullt ligjor. Në thelb, çështja përqendrohej në faktin, nëse refuzimi i vazhdueshëm i gjyqtarës për t'u paraqitur në seancat e Këshillit të Lartë të Drejtësisë, i justifikuar nga raporte mjekësore, përbënte një shmangie të qëllimshme nga procedura,

206. Vendimi nr. 17, datë 12.11.2004 i Gjykatës Kushtetuese.

apo një situatë, të cilës KLD-ja duhej t'i përgjigjej me shtyrje dhe garantim të plotë të së drejtës për t'u dëgjuar.

Gjykata e Lartë arsyetoi se sjellja e gjyqtarës që po procedohej përbënte një mënyrë për të shmangur pjesëmarrjen në procedimin disiplinor. Përmes analizës së dokumenteve dhe raporteve të paraqitura, ajo argumentoi se KLD-ja kishte zbatuar të gjitha detyrimet ligjore për njoftimin dhe sigurimin e mundësive që gjyqtarja të shprehej, qoftë personalisht, qoftë përmes një përfaqësuesi. Duke marrë në konsideratë faktin se gjyqtarja kishte pasur raste të shumta për të dhënë shpjegime, por kishte preferuar të qëndronte pasive në mbrojtjen e saj, duke paraqitur raporte mjekësore, Gjykata e Lartë e konsideroi të drejtë vendimin e KLD-së për të vazhduar procedimin dhe për të marrë vendimin për shkarkim. Për Gjykatën e Lartë, përgjegjësia për mosrealizimin e të drejtave mbrojtëse bie mbi individin që shmangej nga procesi, duke mos ushtruar të drejtat e veta brenda parashikimeve ligjore.

Në të kundërt, Gjykata Kushtetuese e shqyrtoi çështjen nga këndvështrimi i gjerë i të drejtës për një proces të rregullt ligjor, duke vendosur theksin te garancitë kushtetuese dhe procedurale të një individi, në një procedim disiplinor. Ajo theksoi se raportet e rregullta mjekësore, të cilat justifikonin mungesën e përkohshme të gjyqtarës për shkak të gjendjes shëndetësore, përbënin akte zyrtare me vlerë të plotë provuese, të cilat KLD-ja nuk kishte të drejtë t'i injoronte pa një hetim të thelluar për vërtetësinë e tyre. Gjykata Kushtetuese arriti në përfundimin se mosparaqitja e gjyqtarës, për shkak të gjendjes së dokumentuar shëndetësore, nuk përbënte një shmangie të qëllimshme nga procedura, por një pengesë objektive që kërkonte një respektim më rigoroz të të drejtës për t'u dëgjuar dhe mbrojtur. Duke vlerësuar rrethanat, Gjykata Kushtetuese arriti në përfundimin se zhvillimi i procedimit disiplinor në mungesë të gjyqtarës, përbënte një shkelje të nenit 42 të Kushtetutës dhe nenit 6 të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut, pasi nuk i ishin garantuar elementet minimalë të së drejtës për një procesi të rregullt ligjor.

Pra, ndërsa Gjykata e Lartë fokusohej te përgjegjësia individuale për të bashkëpunuar në një procedim disiplinor, Gjykata Kushtetuese e shihte çështjen në këndvështrimin e garancive themelore të procesit dhe rolit të institucioneve për të siguruar mbrojtjen e plotë të individit. Vendimi i Gjykatës Kushtetuese reflektonte një standard më të lartë të drejtësisë, duke kërkuar që organet shtetërore të marrin masa të veçanta, kur rrethanat e një rasti e bëjnë të pamundur realizimin e plotë të të drejtave nga një individ.

Pavarësisht shkeljeve të mësipërme, në jurisprudencën gjyqësore, ka pasur edhe raste, kur sjellja e KLD-së, nuk është konsideruar se kishte cenuar të drejtat procedurale të gjyqtarëve që po procedoheshin. Kështu, mosrespektimi i tyre, nuk sillte pavlefshmërinë e procedurës, nëse vetë

gjyqtari nuk kërkonte respektimin e tyre. Kështu, në një rast, Gjykata e Lartë, arsyetoi se *“I pabazuar konsiderohet edhe pretendimi i ankuesit se atij nuk i është vënë në dispozicion koha e mjaftueshme për t’u mbrojtur para KLD-së. Nga procesverbali i mbajtur në mbledhjen e KLD-së, rezulton se ankuesi ka dhënë shpjegime të plota lidhur me shkaqet, për të cilat ai nuk ka marrë pjesë në provimin e organizuar dhe nuk ka parashtruar mungesën e kohës së mjaftueshme për t’u mbrojtur para atij organi. Nëse ky organ nuk kishte respektuar afatin e përcaktuar në ligj, për njoftimin paraprak të ankuesit është detyrim i këtij të fundit që të kërkonte shtyrjen e shqyrtimit të procedimit disiplinor, nëse nuk ka qenë në gjendje të përgatitej. Mungesa e një kërkesë të tillë dhe dhënia e shpjegimeve tregon se ankuesi ka pasur kohë të mjaftueshme të përgatitej”*.²⁰⁷

Siç mund të konstatohet, mbrojtja e të drejtave procedurale, kërkon një aktivizim nga vetë subjekti, që po procedohej. Qëndrimi i tij pasiv, nuk mundet që ta justifikojë po vetë atë në të ardhmen, kur ka kërkuar pavlefshmërinë e këtyre procedurave.

Ndjekja e kësaj procedure nuk kërkohej, nëse mbarimi i statusit si gjyqtare, nuk bëhej për shkaqe disiplinore, por për arsye të tjera, siç rezulton nga arsyetimi vijues i Gjykatës së Lartë se *“Detyrimi i Këshillit të Lartë të Drejtësisë për të dëgjuar gjyqtarin paraprakisht është i lidhur me rastin, kur ndaj gjyqtarit ka filluar një procedim disiplinor nga ministri i drejtësisë dhe lidhur me shkeljet disiplinore të konstatuara prej tij, gjyqtari ka të drejtë të mbrohet dhe të ngrejë pretendimet e tij përpara KLD. Në rastin konkret nuk ka pasur një iniciativë të tillë nga Ministri dhe as nuk është ndjekur një procedurë për masë disiplinore ndaj paditëses nga ana e Këshillit të Lartë të Drejtësisë. Kërkesa e saj, për të cilën kërkon leje për të vazhduar specializimin e formuluar vetëm në datën 13.10.1999, nuk mund të përligjë dhe të justifikojë kohëzgjatjen e saj pa u paraqitur në punë, kohë për të cilën edhe nuk është paguar, duke përcaktuar vetë në këtë mënyrë zgjidhjen vullnetare të marrëdhënieve të punës.*

Kolegjet e Bashkuara duke vlerësuar mosparaqitjen në punë të të paditurës në rastin konkret, si dorëheqje vullnetare të saj me veprime konkludente, çmon se procedura e ndjekur nga ana e palës së paditur, nuk mund të jetë ajo e pretenduar prej paditëses, por ajo e ndjekur nga KLD., duke dhënë kështu një vendim të drejtë dhe të mbështetur në ligj”.²⁰⁸

Jurisprudenca nuk ka konsideruar cenim të të drejtave procedurale, në rastet kur personi, nëpërmjet sjelljes së tij, synon pikërisht cenimin e kësaj procedure, siç rezulton edhe nga arsyetimi vijues i Gjykatës së Lartë se *“Prej KLD-së janë marrë të gjitha masat e mundshme për ta njoftuar kërkuesin për ditën e zhvillimit të seancës gjyqësore me qëllim që t’i viheshin në dispozicion materialet e plota, 10 ditë përpara zhvillimit të seancës gjyqësore, si dhe të ushtronte të drejtën për t’u mbrojtur gjatë seancës vetë, ose me avokat.*

Ankuesi ka qenë i pezulluar nga detyra e gjyqtarit. Në datën 23.06.1999

207. Vendimi nr.438, date 21.2.2000 i Kolegjeve të Bashkuara të Gjykatës së Lartë.

208. Vendimi nr. 627, datë 06.04.2000 i Kolegjeve të Bashkuara të Gjykatës së Lartë.

është vënë në dijeni, në lidhje me shkeljet e konstatuara nga ana e inspektorëve pranë Inspektoratit të KLD-së dhe me një relacion ka parashtruar vlerësimet e tij, në lidhje me shkeljet që pretendoheshin.

Pas kësaj date, siç pranohet dhe nga përfaqësuesi i tij është larguar jashtë shtetit.

Për mbledhjen e Këshillit të Lartë të Drejtësisë është njoftuar prej ftuesit pranë Gjykatës së Rrethit Tiranë në banesë, sipas adresës së njohur, por nuk ka pasur asnjë person. Mandej është shkuar te banesa e motrës së tij për t'i komunikuar datën e seancës dhe materialet përkatëse, por ajo nuk ka pranuar. Në këto rrethana, duke mos përcaktuar dot vendqëndrimin e tij, është bërë shpallje pranë Gjykatës së Rrethit Tiranë.

Procedura e ndjekur për njoftim prej Kolegjeve të Bashkuara u konsiderua e ligjshme, pasi dhe vetë refuzimi i bërë prej motrës së tij për marrjen në dorëzim të njoftimit mund të quhej se njoftimi ishte kryer”.²⁰⁹

Një tjetër rast interesant ka qenë kur nga ana e Këshillit të Lartë të Drejtësisë është votuar dy herë për të njëjtin subjekt, kjo për shkak se në votimin e parë nuk u arrit shumica e kërkuar dhe për këtë arsye u kalua në votimin e dytë. Gjyqtari i shkarkuar në këtë rast, u ankua për shkeljen e parimit të “gjësë së gjykuar”, por Gjykata e Lartë, duke mbajtur një tjetër qëndrim, argumentoi se “Pretendimi i ankuesit se vendimi i shkarkimit të tij nga detyra e gjyqtarit është marrë sipas një procesi jo të rregullt ligjor nga Këshilli i Lartë i Drejtësisë dhe se me këtë rast është shkelur parimi i “gjësë së gjykuar” është i pabazuar. Këshilli i Lartë i Drejtësisë ka zhvilluar rregullisht procedimin disiplinor dhe më pas seancën e dëgjimit më 27.04.2001, në zbatim të kërkesave të ligjit nr. 8436, datë 28.12.1998 “Për organizimin e pushtetit gjyqësor” i ndryshuar dhe pas kësaj ka zhvilluar rregullisht procedurën e votimit për shkarkimin e ankuesit nga detyra e gjyqtarit. Për shkak të mosmarrjes së asnjë vendimi me këtë datë për mungesë të shumicës së kërkuar, votimi është përsëritur më datën 11.05.2001. Në këto rrethana, Këshilli i Lartë i Drejtësisë nuk ka pasur pengesë në përsëritjen e votimit, pasi është vetë ky autoritet, që çmon nëse do t'i hyjë ose jo rivotimit, kur, mbështetur në rregullin e ndjekur, nuk arrihet të merret vendimi përkatës, për shkak të mungesës së shumicës së kërkuar. Siç del, votimi është përsëritur jo kundër vullnetit të anëtarëve të tij.

Në këtë rast nuk mund të bëhet fjalë për “gjë të gjykuar”, përderisa nuk ishte marrë asnjë vendim i mëparshëm nga Këshilli i Lartë i Drejtësisë, pavarësisht nga zhvillimi i votimit”.²¹⁰

Gjithashtu, një tjetër rast ka qenë, kur zëvendëskryetarit të KLD-së i kishte mbaruar mandati dhe në procedurat ankimore u debatua nëse procedurat e ndjekura prej tij ishin apo jo të vlefshme. Sipas Gjykatës së Lartë, ky pretendim nuk mundej që të qëndronte, bazuar në arsyetimin vijues, se “Së fundi, i papranueshëm është edhe pretendimi se përfaqësuesit e

209. Vendimi nr. 25, datë 04.04.2001 i Kolegjeve të Bashkuara të Gjykatës së Lartë.

210. Vendimi nr. 73, datë 27.06.2001 i Kolegjeve të Bashkuara të Gjykatës së Lartë.

KLD në gjykim nuk kanë akt përfaqësimi të rregullt nga ana ligjore. Duke parë akt përfaqësimin në fjalë, rezulton se ai është marrë në përputhje me kërkesat e nenit 35 të ligjit nr. 881, datë 17.05.2001 "Për Organizimin dhe funksionimin e Këshillit të Lartë të Drejtësisë". Vetë brendia e aktit dhe ajo çfarë shprehet në të, vërtetojnë se ai është lëshuar pikërisht nga ana e Këshillit. Është e vërtetë se Akti në fjalë është firmosur nga ana e një anëtari të Këshillit të Lartë të Drejtësisë, i cili në kohën e firmosjes, nuk ishte më zëvendëskryetar, por një gjë e tillë nuk do të thotë se akti është i pavlefshëm. Anëtari në fjalë i KLD-së, deri në hyrjen në fuqi të ligjit të cituar, kryente funksionin e zëvendëskryetarit dhe efektivisht, ai vazhdon ta kryejë këtë funksion deri në zgjedhjen e zëvendëskryetarit të ri, i cili aktualisht nuk është zgjedhur. Si përfundim, Kolegjet e Bashkuara të Gjykatës së Lartë çmojnë se akti i përfaqësimit është i rregullt nga ana ligjore".²¹¹

Në këtë rast, Gjykata e Lartë e konsideronte se ky funksionar do të duhej të qëndronte në detyrë, deri në ardhjen e pasardhësit të tij, me qëllim që të mos cenohej funksionaliteti i këtij institucioni, për më tepër kur aktet e nënshkruara nga ana e tij, përfaqësonin vullnetin e gjithë KLD-së dhe jo vullnetin individual të tij.

Nuk është konsideruar shkelje e kësaj procedure, kur gjyqtari ishte larguar jashtë shtetit, pa njoftuar asnjë person dhe nuk mundej që të gjendej, siç rezulton nga arsyetimi vijues i Gjykatës së Lartë, se "I pabazuar gjendet edhe pretendimi i paraqitur nga ankuesi dhe mbrojtësi i tij se, në shqyrtimin e çështjes nga KLD., janë shkelur të drejtat e tij të parashikuara në nenin 44 të ligjit "Për organizimin e pushtetit gjyqësor në Republikën e Shqipërisë". Sipas këtij neni, në çdo rast duhet të dëgjohet edhe gjyqtari që ka kryer shkeljen, duhet të verifikohen pretendimet e tij, e se gjyqtari i vihen në dispozicion materialet e plota 10 ditë para zhvillimit të seancës në KLD., ku duhet të dëgjohen pretendimet e palëve. Këto përcaktime ligjore janë të detyrueshme për t'u zbatuar nga inspektorati dhe KLD., por në rastin në shqyrtim ato nuk janë realizuar, jo se nga KLD., nuk janë pasur parasysh, por sepse, me gjithë kërkimet e bëra nga inspektorët e KLD., nuk është bërë e mundur gjetja e asnjë adrese apo të dhëne, se ku ndodhej ankuesi. Sikurse u përmend dhe siç rezulton nga aktet, se ku dhe përse ishte larguar ankuesi, nuk e ka ditur dhe asnjë nga kolegët apo punonjësit e Gjykatës së Apelit Ushtarak.

Kolegjet e Bashkuara gjejnë të pabazuar edhe pretendimin tjetër se, ndaj ankuesit nuk mund të merrej masa disiplinore e shkarkimit nga detyra, sepse në muajin tetor të vitit 2000 ka kërkuar nga KLD., dorëheqjen nga detyra e kryetarit të gjykatës dhe e gjyqtarit. Nga aktet e paraqitura dhe të administruara, nuk rezulton të jetë paraqitur një kërkesë e tillë, përveç faktit që paraqitja e një kërkesë të tillë nuk mund të justifikojë largimin për një kohë aq të gjatë nga detyra, pa u shprehur organi kompetent për të".²¹²

Duke parë rastet e mësipërme, që lidhen me procedurat e inspektimit

211. Vendimi nr. 85, datë 20.11.2002 i Kolegjeve të Bashkuara të Gjykatës së Lartë.

212. Vendimi nr. 9, datë 11.09.2007 i Kolegjeve të Bashkuara të Gjykatës së Lartë.

dhe procedimin disiplinor ndaj gjyqtarëve, konstatohet një qëndrim i qartë për detyrimin e respektimit të tyre nga organet proceduese. Elementi thelbësor në këto raste ishte respektimi i të drejtave themelore të gjykatësve për t'u dëgjuar dhe për t'u mbrojtur gjatë procesit disiplinor.

Shkelje e këtyre procedurave konsiderohej çdo rast, kur gjyqtarit nuk i vihej në dispozicion materiali i plotë i çështjes brenda afateve të përcaktuara ligjërish, ose kur ai nuk njoftohej për zhvillimin e seancës në KLD. Në rastet kur inspektorët ose KLD-ja nuk arrinin të njoftonin rregullisht gjyqtarin, kjo konsiderohej një cenim i të drejtave procedurale, që shpesh çonte në shfuqizimin e vendimmarrjes. Në disa raste, gjykatat theksonin se njoftimi i vonuar apo mungesa e njoftimeve të rregullta përfaqësonte një shkelje të parimeve të procesit të rregullt ligjor, duke cenuar të drejtën e gjyqtarit për t'u përgatitur dhe për të dhënë shpjegime.

Një tjetër shkelje e rëndë konsiderohej mosrespektimi i raporteve mjekësore të paraqitura nga gjyqtari që justifikonin mungesën e tij për arsye shëndetësore. Në këto raste, kur raportet ishin të dokumentuara dhe nuk ishin kontestuar nga organet përkatëse, Gjykata Kushtetuese arsyetonte se ato duhet të përbënin një arsye të vlefshme për shtyrjen e seancës dhe se zhvillimi i procedimit në mungesë të gjyqtarit përbënte një cenim serioz të të drejtave të tij. Raportet mjekësore, sipas jurisprudencës, duke qenë akte zyrtare, përbënin provë të plotë dhe mosmarrja në konsideratë e tyre përbënte shkelje të rregullave procedurale.

Megjithatë, jo çdo pretendim për shkelje të procedurave u konsiderua si i bazuar. Në rastet kur gjyqtari vetë nuk tregonte interes për të ushtruar të drejtat e tij, si për shembull duke refuzuar të paraqitej, të bashkëpunonte me inspektorët apo të caktonte një përfaqësues, procedurat e ndjekura nga KLD-ja konsideroheshin të rregullta. Kjo qasje bazohej në argumentin se pasiviteti i gjyqtarit nuk mund të justifikonte pavlefshmërinë e vendimmarrjes së KLD-së. Në raste të tilla, refuzimi i gjyqtarit për të marrë njoftimet ose për të bashkëpunuar, konsiderohej një përpjekje për të shmangur procedurat dhe për të bllokuar procesin disiplinor.

Në disa raste specifike, kur gjyqtari qëllimisht kishte braktisur detyrën dhe ishte larguar jashtë shtetit pa njoftuar rregullisht, procedurat e ndjekura nga KLD-ja konsideroheshin të ligjshme, edhe kur njoftimet ishin shpallur publikisht ose dorëzuar përmes familjarëve të tij. Në situata të tilla, organet disiplinore nuk kishin asnjë mundësi tjetër për të respektuar formalisht procedurat e njoftimit, për shkak të vetë sjelljes së gjyqtarit.

1.2 Përgjegjësia dhe masat disiplinore ndaj gjyqtarëve

Përsa i përket përgjegjësisë disiplinore të gjyqtarëve, ajo rregullohej nga Kreu V, nenet 40 – 46. Ligji parashikonte se gjyqtarët mbanin

përgjegjësi për shkeljet e disiplinës, si dhe për kryerjen e akteve e të sjelljeve që diskreditojnë rëndë figurën e tyre dhe autoritetin e drejtësisë.²¹³

Duke ruajtur të njëjtin formulim, si ligji i mëparshëm, edhe në këtë rast përcaktoheshin, si shkelje disiplinore tetë rastet e mëposhtme:²¹⁴

1. *Kryerja e veprimeve, që sipas ligjit janë të papajtueshme me funksionin e gjyqtarit.* Ky lloj parashikimi përfaqësonte një nga shkeljet më serioze disiplinore, pasi cenonte drejtpërdrejt parimin e pavarësisë, integritetit dhe paanshmërisë së sistemit të drejtësisë. Ligjvënësi e kishte parë të domosdoshme të ndalonte çdo veprim apo përfshirje të gjyqtarëve në aktivitete politike, tregtare apo veprimtari të tjera, të cilat mund të komprometonin figurën e tyre si garantë të sistemit të drejtësisë dhe si përfaqësues të një pushteti të pavarur nga ndikimet e jashtme. Kjo shkelje disiplinore nuk përfshinte vetëm përfshirjen direkt në veprimtari të ndaluara, por edhe çdo veprim që mund të krijonte dyshime për ndërhyrje të jashtme në ushtrimin e detyrës së gjyqtarit. Kryerja e kësaj shkeljeje krijonte jo vetëm një konflikt të mundshëm interesi, por ulte edhe besimin e publikut në sistemin e drejtësisë.

2. *Nxjerrja e sekretit të hetimit, të dhomës së këshillimit ose të të dhënave të tjera me karakter intim.* Edhe kjo shkelje, nëse kryhej nga gjyqtarë, cenonte rëndë besimin e publikut tek sistemi i drejtësisë. Ky veprim rrezikonte të dëmtonte rëndë, jo vetëm interesat e palëve të përfshira në çështjen përkatëse, por edhe vetë dinjitetin dhe sigurinë e individëve. Sekreti hetimor dhe gjyqësor ishte një garanci themelore për zhvillimin e një procesi të drejtë dhe të paanshëm, ndërsa mbrojtja e të dhënave me karakter intim kishte për qëllim ruajtjen e privatësisë dhe të jetës personale të individëve. Për rrjedhojë, një shkelje e tillë jo vetëm që dëmtonte procesin konkret, por krijonte një klimë mosbesimi të përgjithshme ndaj institucioneve të drejtësisë dhe profesionalizmit së atyre që kishin për detyrë ta zbatonin atë.

3. *Zvarritje të rënda ose sistematike në kryerjen e detyrës.* Kjo shkelje, që lidhej kryesisht me vonesat e pajustificuara në shqyrtimin dhe zgjidhjen e çështjeve gjyqësore, kishte pasoja të rënda për qytetarët, të cilët prisnin zgjidhjen e çështjeve të tyre sa më shpejt që të ishte e mundur. Në parim, zvarritjet e vazhdueshme dhe të përsëritura cenonin parimin e aksesit të shpejtë në drejtësi, duke krijuar një ndjenjë mosbesimi tek qytetarët ndaj institucioneve të sistemit të drejtësisë. Përveçse krijonte një barrë të panevojshme mbi palët në proces, kjo sjellje ndikonte negativisht në imazhin e gjyqtarëve, si figura kryesore publike që përfaqëson sistemin e drejtësisë.

4. *Mosrespektimi i rregullave të solemnitetit.* Kjo shkelje disiplinore cenonte dinjitetin dhe seriozitetin e veprimtarisë gjyqësore, duke minuar

213. Ligji nr. 8436, datë 28.12.1998, neni 40.

214. Ligji nr. 8436, datë 28.12.1998, neni 41.

autoritetin e funksionarëve të ngarkuar më realizimin e këtyre detyrave. Rregullat e solemnitetit, që përfshinin sjelljen, veshjen dhe mënyrën e komunikimit në sallën e gjyqit, ishin të domosdoshme për të ruajtur prestigjin dhe rëndësinë e procesit gjyqësor. Shkelja e këtyre rregullave krijonte një atmosferë të papërshtatshme për një institucion të sistemit të drejtësisë, ku ruajtja e solemnitetit kishte një rol thelbësor në forcimin e autoritetit të gjykatave, si dhe në ndërtimin e një sistemi gjyqësor që frymëzonte respekt dhe besim tek qytetarët. Mosrespektimi i këtyre rregullave, përveçse tregonte mungesë serioziteti në ushtrimin e detyrës, dëmtonte imazhin e të gjithë sistemit të drejtësisë dhe krijonte përshtypjen, se ata që duhej të garantonin zbatimin e ligjit nuk e respektonin vetë solemnitetin, që kërkonte ky funksion i lartë.

5. *Mungesat pa arsye në punë.* Kjo lloj shkelje, nëse kryhej prej gjyqtarëve, tregonte mungesën e përgjegjësisë dhe përkushtimit ndaj detyrës, përkushtim që ishte dhe mbetet i rëndësishëm për funksionimin e sistemit të drejtësisë. Prania dhe angazhimi i tyre i vazhdueshëm ishte i domosdoshëm për garantimin e zhvillimit të rregullt të proceseve gjyqësore. Mungesat e pajustificuara shkaktonin vonesa në shqyrtimin e çështjeve, krijonin pengesa për palët dhe rriste barrën mbi kolegët e tyre, duke dëmtuar kështu efikasitetin e gjykatave. Kjo shkelje disiplinore përbënte një tregues të papranueshëm të neglizhencës profesionale dhe binte në kundërshtim të hapur me standardet e larta që duhej të karakterizonin sistemin e drejtësisë.

Në lidhje me këtë shkelje, kemi edhe disa raste praktikë, që kanë sjellë edhe zhvillimin e jurisprudencës. Si rast i parë është konsideruar largimi pa arsye nga zhvillimi i një gjykimi që po zhvillohej, siç rezulton nga arsyetimi vijues se “V. K., ka qenë me detyrën e ndihmës gjyqtare në Gjykatën e Shkallës së Parë Tiranë.

Me vendimin nr. 44/2, datë 26.06.1999 të Këshillit të Lartë të Drejtësisë është shkarkuar nga detyra e ndihmës-gjyqtare për shkelje të disiplinës në punë. Padiësja në datën 11.06.1999 ka qenë në përbërje të trupit gjykues që shqyrtonte çështjen civile me palë B.L., dhe S. S. Në seancë, me kërkesë të vetë ndihmës gjyqtare V. K., është kërkuar të administrohej një dosje gjyqësore, që ndodhej në arkivin e asaj gjykate dhe për këtë fakt është vendosur, që seanca gjyqësore të shtyhej po atë ditë në orën 14:00. Ndihmës gjyqtarja nuk është paraqitur në atë seancë. Nga gjyqtarja M. F., është kërkuar ndihmës gjyqtarja edhe te nënkryetari i gjykatës z. F. L., si dhe te përgjegjësi i ndihmës gjyqtarëve, B. K., dhe e kanë pritur padiësen deri në orën 15:00. Duke qenë se për shkak të mungesës së saj nuk u formua trupi gjykues, është shtyrë seanca për një datë tjetër gjykimi.

Këshilli i Lartë i Drejtësisë, me kërkesë për procedim disiplinor të ministrit të drejtësisë, e ka shqyrtuar atë në përputhje me kërkesat e ligjit nr. 8436, datë 28.12.1998 dhe ka arritur në konkluzionin se mungesa pa arsye në punë e

*ndihmës gjyqtares është një veprim që bie ndesh me përmbushjen e rregullt të detyrës prej saj”.*²¹⁵

Mënyra e sjelljes së mësipërme nga subjekti që u procedua, e cila kërkoi vetë një material gjyqësor dhe për këtë qëllim u shty seanca gjyqësore dhe më pas nuk u paraqit po vetë, tregon pikërisht një sjellje të parregullt dhe shkelje të disiplinës në punë, që klasifikohet në këtë lloj shkelje.

Në një tjetër rast, u konsiderua shkelje, largimi nga vendi i punës dhe mosinteresimi më për atë pozicion, pavarësisht se qyteti ku ndodhej selia e gjykatës që ushtronte funksionet e tij gjyqtari, ishte përfshirë në trazira civile. Më konkretisht, Gjykata e Lartë, mbajti qëndrimin, se “*Paditësi R. D., ka qenë emëruar me detyrën e gjyqtarit pranë Gjykatës së Rrethit Sarandë.*

Këshilli i Lartë i Drejtësisë me vendimin nr. 4, datë 10.11.1997 ka vendosur largimin e tij nga detyra e gjyqtarit me motivacionin se është larguar për një kohë të gjatë nga detyra.

Mbi ankimin e paditësit R. D., Kolegjet e Bashkuara të Gjykatës së Kasacionit me vendim nr. 1462, datë 03.11.1998 kanë vendosur lënien në fuqi të vendimit nr. 4, datë 10.11.1997 të Këshillit të Lartë të Drejtësisë.

Gjykata Kushtetuese me vendimin nr. 43, datë 04.06.1999 ka vendosur shfuqizimin si antikushtetues të vendimit të lartpërmendur të Kolegjeve të Bashkuara të ish-Gjykatës së Kasacionit, me qëllim që çështja të shqyrtohet përsëri prej tyre, si organ tashmë i Gjykatës së Lartë.

Nga shpjegimet e dy palëve pjesëmarrëse në proces dhe administrimi i një sërë provash në gjykim, konkludohet se vendimi i KLD-së është i drejtë dhe i bazuar në ligj, prandaj padia e ngritur nga R. D., për anulimin e tij, duhet të rrëzohet si e pabazuar.

Pas ngjarjeve të muajit mars 1997 paditësi R. D., është larguar nga detyra e gjyqtarit dhe deri në fund të muajit shtator 1997 nuk ka bërë asnjë njoftim për shkaqet e largimit dhe vendndodhjen e tij. Është e vërtetë që trazirat e kësaj periudhe shkaktuan dhe djegien e gjykatës dhe penguan funksionimin e rregullt të saj, por ndërsa punonjësit e tjerë, në pritje për të rifilluar punën, kanë mbajtur kontakte të vazhdueshme me njëri-tjetrin dhe organet e pushtetit në rreth, paditësi nuk është interesuar dhe paraqitur as edhe për të tërhequr pagën, sa është detyruar punonjësjë e llogarisë me mandat arkëtimi nr. 556977, datë 07.09.1997 ta arkëtojë në Buxhetin e Shtetit pagën për periudhën mars-shtator 1997.

Më datë 29.09.1997, me telegram nga Tirana, paditësi ka njoftuar pranë Gjykatës së Rrethit Sarandë se është i sëmurë, duke paraqitur për periudhën 15.9.-15.10.1997 dy raporte mjekësore për paaftësi të përkohshme, të cilat me të drejtë janë gjetur të pavlefshme dhe nuk janë marrë në konsideratë për të justifikuar mosparaqitjen në punë të paditësit për periudhën 1-mujore. Ato, ndonëse janë lëshuar nga komisioni mjekësor i përbërë nga tre veta, një prej tyre

215. Vendimi nr. 690, datë 29.07.1999 i Kolegjeve të Bashkuara të Gjykatës së Lartë.

është nënshkruar nga dy mjekë dhe tjetri vetëm nga një mjek. Të dyja raportet i përkasin poliklinikës Memaliaj, ndërsa telegrami për Gjykatën e Rrethit Sarandë është bërë më datë 29.09.1997 nga qyteti i Tiranës, veprime të cilat gjithashtu vënë në dyshim sinqeritetin dhe vërtetësinë e pretendimeve të paditësit për shkaqet e mosparaqitjes në punë.

Pretendimi i paditësit se në muajin nëntor 1997 është paraqitur në punë dhe ka gjykuar çështje penale dhe civile nuk ka rëndësi dhe nuk ndikon për të konkluduar lidhur me ligjshmërinë ose paligjshmërinë e vendimit të KLD., sepse datat e gjykimit 09.11.1997 dhe 13.11.1997 i përkasin periudhës pas marrjes së vendimit të Këshillit të Lartë të Drejtësisë, organ i cili ka analizuar dhe shqyrtuar shkaqet e mosparaqitjes në punë të paditësit deri më datë 04.11.1997.

Përfundimisht, për paditësin vërtetohet se për një periudhë 8 muaj jo vetëm nuk është paraqitur, por as është interesuar si gjithë punonjësit e tjerë për mundësinë e rifillimit të punës, çka tregon për mungesë serioziteti, përgjegjësie dhe përkushtimi, sjellje e cila me të drejtë është çmuar se e bën paditësin të papërshtatshëm për të kryer detyrën e gjyqtarit. Kështu, për këto shkelje disipline të konstatuara në punën e paditësit, largimi i tij nga detyra e gjyqtarit gjen mbështetje edhe në nenin 19 të ligjit nr. 7574, datë 24.06.1992, të ndryshuar me ligjin nr. 7119 datë 19.04.1995.

Fakti që deri në datën kur KLD., ka marrë vendim për largim nga puna të paditësit nuk ka ndërprerje financiare, nuk tregon që ky i fundit ka qenë i lidhur me detyrën. Për shkak të situatës së krijuar, të gjithë punonjësit janë shpërblyer edhe pa punuar, por ndërsa të tjerët janë interesuar dhe paraqitur herë pas here për një periudhë 6-mujore, paditësi nuk ka treguar asnjë interesim për punën, sa është detyruar punonjësja e llogarisë me mandat arkëtimi të veçantë ta kalojë në Buxhetin e Shtetit vetëm pagën e paditësit, çka gjithashtu tregon se ai ishte larguar për një kohë të gjatë nga detyra.

Qëndrimi në drejtim të paditur, larg qendrës së punës dhe asaj të banimit, ka vështirësuar edhe vënien në dijeni të paditësit për masën disiplinore që ministri i drejtësisë i propozonte Këshillit të Lartë të Drejtësisë”.²¹⁶

Siç konstatohet nga arsyetimi i mësipërm, pavarësisht se largimi i tij fillestar mund të konsiderohej si i justifikuar, mungesa e tij totale e interesit, mosinformimi si kolegët e tjerë dhe mosparaqitja e mëvonshme, tregon për një qëndrim të vullnetshëm për të mos u paraqitur në punë dhe për rrjedhojë shkelje disipline.

Në një tjetër rast që është konsideruar si largim nga detyra, emigrimi familjarisht i një gjyqtari që ushtronte edhe funksionin e kryetarit të gjykatës, rast për të cilin Gjykata e Lartë arsyetoi se “Nga aktet e administruara dhe shpjegimet e palëve në proces rezulton se, ankuesi A. H., ka qenë gjyqtar dhe në vitin 1995 është emëruar Kryetar i Gjykatës së Apelit Ushtarak në Tiranë. Në muajin shtator të vitit 2000, pa vënë në dijeni organet përkatëse dhe pa arsye, ai, bashkë me familjen, është larguar nga Shqipëria duke

216. Vendimi nr. 1054, datë 28.09.1999 i Kolegjeve të Bashkuara të Gjykatës së Lartë.

u vendosur në Kanada, nga është kthyer në muajin korrik të vitit 2006.

Mbas largimit nga detyra, mbi bazën e kërkesës së ministrit të drejtësisë, është ushtruar kontroll nga inspektorati i KLD në Gjykatën e Apelit Ushtarak, ku sipas relacioneve të paraqitura, përveç çrregullimeve e mungesave në punën e gjykatës, askush nuk dinte gjë për largimin e ankuesit. Mbi këtë bazë më datë 22.11.2000, ministri i drejtësisë ka kërkuar procedimin disiplinor ndaj Kryetarit të Gjykatës së Apelit Ushtarak Tiranë z. A. H., duke marrë ndaj tij masën disiplinore të shkarkimit nga detyra.

Këshilli i Lartë i Drejtësisë, pas verifikimeve të bëra nga inspektorati, nuk ka mundur të njoftojë ankuesin për shqyrtimin e kërkesës së ministrit dhe, si ka analizuar gjerësisht çështjen, me vendimin nr. 97/2, datë 25.11.2000, vendosi miratimin e masës disiplinore të propozuar nga Ministria e Drejtësisë dhe ka shkarkuar atë nga detyra e kryetarit të gjykatës dhe detyra e gjyqtarit.

Në ankimin e paraqitur më datë 25.07.2006, A. H., ka pretenduar se vendimi i marrë nga KLD për shkarkimin nga detyra e gjyqtarit është i pabazuar. Në ankim dhe gjatë shqyrtimit gjyqësor në Kolegjet e Bashkuara të Gjykatës së Lartë, ankuesi pretendon se largimi i tij nga Shqipëria dhe shkuarja në Kanada ka qenë për shkaqe të arsyeshme, sepse ishte kërcënuar e vënë në rrezik jeta e tij dhe e fëmijëve nga persona të interesuar për një çështje penale dhe se nga KLD janë shkelur kërkesat ligjore, duke mos u respektuar e drejta e tij për t'u njohur me materialet e procedimit, njoftimin dhe dëgjimin e tij.

Nga analiza tërësore e materialeve, pretendimeve dhe shpjegimeve përkatëse, Kolegjet e Bashkuara të Gjykatës së Lartë çmojnë të pabazuara pretendimet e paraqitura nga ankuesi. Vetë ai nuk mohon faktin e largimit nga detyra pa lejen e organeve përkatëse. Në çdo rast, pavarësisht rrethanave e shkaqeve, gjyqtari nuk mund të largohet nga detyra nëse nuk njofton e merr lejen përkatëse dhe ky detyrim është i domosdoshëm, në mënyrë të veçantë sidomos për personat drejtues në gjykatë. Largimi i tyre pa u marrë masat përkatëse për veprimtarinë normale të gjykatave sjell çrregullime (sikurse ka ndodhur në rastin në shqyrtim), në hedhjen e shortit për ndarjen e çështjeve, në gjykimin e tyre e në gjithë veprimtarinë gjyqësore e administrative.

Largimi i një gjyqtari për disa muaj nga detyra pa njoftuar e pa marrë lejen përkatëse, Kolegjet e Bashkuara arrijnë në përfundimin, se përbën akt që diskrediton rëndë pozitën e figurën e gjyqtarit dhe që në bazë të nenit 147/6 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, përbën shkak për shkarkimin nga detyra. Po kështu në nenin 40 të ligjit "Për organizimin e pushtetit gjyqësor në Republikën e Shqipërisë", gjyqtarët kanë përgjegjësi për shkeljet e disiplinës, si dhe për kryerjen e akteve e të sjelljeve që diskreditojnë rëndë figurën e tyre dhe autoritetin e drejtësisë. Neni 41 konsideron shkelje të disiplinës, në pikën 5 mungesat pa arsye në punë, në pikën 7 kryerja e veprimeve në kundërshtim me përbushjen e rregullt të detyrës dhe që, sipas nenit 42, mund të merret masa e shkarkimit nga detyra.

Ky arsyetim i Kolegjeve të Bashkuara mbështet ligjshmërinë e vendimit të

marrë nga KLD për shkarkimin nga detyra e gjyqtarit të ankuesit A. H., por duhet theksuar gjithashtu se, me qëndrimin e tij, ankuesi është larguar në mënyrë të njëanshme nga detyra, pra është vetë shkarkuar, pasi nuk është paraqitur për disa muaj në detyrë dhe është kthyer nga Kanada mbas rreth gjashtë vjetësh (shtator 2000-korrik 2006), kohë në të cilën është ankimuar kundër vendimit të KLD.

Duhet pasur parasysh gjithashtu fakti që ankuesi, në sajë të detyrës së tij, si Kryetar i Gjykatës së Apelit Ushtarak, ka qenë oficer me gradën Kolonel dhe për largimin e tij nuk rezulton të ketë marrë leje nga Ministria e Mbrojtjes”.²¹⁷

Në këtë rast, konkludohet se ndodhemi përsëri përballë situatës, kur subjekti ka munguar pa arsye në punë dhe pa njoftuar rregullisht për këtë veprim të tij. Gjykata e Lartë arsyeton në këtë rast, se vetë personi, nëpërmjet veprimeve të tij konkludente është “vetë shkarkuar”, megjithëse nuk argumenton, se përse kjo sjellje e tij nuk konsiderohet dorëheqje, por duhet të klasifikohet si shkarkim nga detyra. Në këtë rast, duket se qasja e Gjykatës së Lartë ka qenë e tillë, për shkak se ministri i drejtësisë, gjykoi se ndodhej përpara rasteve kur personi do të duhej të mbante përgjegjësi disiplinore.

Rastet e mësipërme, duket se nuk janë në përputhje me një tjetër situatë të trajtuar nga jurisprudenca gjyqësore, ku rezulton se Gjykata e Lartë, ka tentuar që të bëjë dallimin midis largimit vullnetar nga puna, nëpërmjet veprimeve konkludente (pra dorëheqje faktike), me shkeljen disiplinore të mosparaqitjes në punë. Kështu, në praktikën e saj Gjykata e Lartë, ndër të tjera, ka arsyetuar edhe se “Gjatë gjykimit rezulton e provuar se paditësja M. B., ka qenë ndihmësgjyqtare në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Lezhë që nga viti 1993. Në datën 13.12.1998 paditësja është larguar nga puna për një specializim jashtë shtetit dhe nuk është paraqitur më, deri në momentin e lirimit nga detyra me vendimin nr. 56, datë 16.10.1999 të Këshillit të Lartë të Drejtësisë. Për periudhën 13.12.1998 deri më 17.03.1999 paditësja ka justifikuar mungesën e saj me raport mjekësor, gjë të cilën nuk e ka bërë për periudhën e mbetur më pas. Për këtë periudhë, paditësja duke bërë tashmë zgjedhjen e saj midis punës dhe specializimit, nuk ka marrë as leje nga organi kompetent dhe as ka treguar interes të mëtijshëm për marrëdhëniet e punës. Ky fakt u provua me njoftimin e bërë nga Kryetari i Gjykatës së Shkallës së Parë Lezhë, z. J. N., me shkresën nr. 7/4, të datës 07.04.1999 drejtuar ministrit të drejtësisë, nga relacioni i Inspektoratit të KLD-së i datës 11.05.1999, ndërkohë që nuk u kundërshtua dot me prova të tjera nga paditësja në seancë gjyqësore.

Kolegjet e Bashkuara çmojnë se largimi i paditëses nga detyra me të drejtë është konsideruar nga KLD-ja, si largim vullnetar i saj nga puna, i bërë jo me akt të shkruar, por me veprime konkludente, duke munguar për mbi 6 muaj në punë dhe për një shkak të vlerësuar prej saj, më të rëndësishëm se sa detyra.

Duke pasur parasysh faktin e mësipërm, me të drejtë largimi nga detyra

217. Vendimi nr. 9, datë 11.09.2007 i Kolegjeve të Bashkuara të Gjykatës së Lartë.

është mbështetur në nenin 27/1 të ligjit nr. 8436 të datës 28.12.1998 "Për organizimin e pushtetit gjyqësor në Republikën e Shqipërisë" dhe jo si shkelje e disiplinës në punë, sikurse parashikon neni 41/5 i po këtij ligji".²¹⁸

Në këtë rast, subjekti që u procedua, përveçse largimit nga vendi i punës dhe mungesës së interesit, nuk tregoi asnjë përpjekje për të filluar marrëdhënien e punës dhe për rrjedhojë kjo u konsiderua si dorëheqje dhe jo mungesë pa arsye në punë.

Megjithëse ky rast ka dallim nga rasti i parë, ku personi tentoi të ushtrojë funksionet e gjyqtarit, madje zhvilloi edhe ndonjë seancë gjyqësore, në lidhje me rastin e dytë, ky vendim duket se ka shumë ngjashmëri, pasi edhe në atë rast, Gjykata ka pranuar që subjekti është "vetë shkarkuar" me veprime konkludente. I vetmi dallim që ka midis rastit të dytë dhe të tretë, qëndron në faktin se tek rasti i dytë Ministri vlerësoi të nisë një procedim disiplinor, kurse në rastin e tretë, të cituar më sipër, veprimi vetë Këshilli i Lartë i Drejtësisë. Megjithatë ky dallim është më shumë formal dhe Gjykata e Lartë vetë, nuk tentoi që të bënte një dallim midis dy vendimmarrjeve të veta në arsyetimin e saj.

Në një tjetër rast, që lidhet me mungesën pa arsye në punë, Gjykata e Lartë, arsyetoi se "Me vendimin nr. 56, datë 16.10.1999, të Këshillit të Lartë të Drejtësisë, është vendosur shkarkimi nga detyra e ndihmës gjyqtarit N. Gj., pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Krujë.

Sipas Vendimit të sipërpërmendur, kontrolli i zhvilluar nga ana e Inspektoratit pranë këtij Këshilli me sinjalizimin e bërë nga ana e Kryetares së Gjykatës së shkallës së parë Krujë, ka vërtetuar se paditësi gjatë vitit 1999, ka bërë shkelje të disiplinës, duke munguar pa arsye për 35 ditë, shkelje kjo e parashikuar nga neni 41, pika "5" i ligjit nr. 8436, datë 28.12.1998, "Për organizimin e Pushtetit gjyqësor në Republikën e Shqipërisë".

Nga ana tjetër, paditësi e pranon faktin se i ka bërë mungesat si më sipër, por ka pretenduar se ato përgjithësisht kanë qenë të justifikuara dhe me dijeninë e plotë të Kryetares së Gjykatës së shkallës së parë Krujë.

Kështu ai ka argumentuar, se shkak i këtyre mungesave ka qenë gjendja tepër e rëndë shëndetësore e vëllait të tij, i cili duke qenë i paralizuar, ka pasur nevojë të përditshme për ndihmë dhe përkujdesje. Po ashtu, gjatë kësaj periudhe, ka pasur në gjendje të rëndë shëndetësore edhe nënën e tij, e cila duke qenë e shtruar në spital dhe e operuar, gjithashtu ka pasur nevojë për ndihmë të përditshme. Në këto kushte, sipas tij, e ka pasur objektivisht të pamundur paraqitjen në punë në orarin e caktuar.

Gjatë gjyqimit edhe përfaqësuesi i Këshillit të Lartë të Drejtësisë, i ka konfirmuar pretendimet e paditësit, përse i përket problemeve dhe shqetësimeve të rënda e të vazhdueshme që ai ka pasur në familje gjatë kësaj periudhe.

Duke parë shkeljen e disiplinës në punë, në vështrim të kërkesave të parashikuara nga neni 41, pika 5, në raport me masën e marrë sipas nenit 42,

218. Vendimi nr. 627, datë 06.04.2000 i Kolegjeve të Bashkuara të Gjykatës së Lartë.

pika 6 të ligjit të cituar më sipër, rezulton se kjo e fundit, është tepër e rëndë dhe nuk justifikon shkëlqen e bërë. Në rastin konkret, vendimi i marrë nga Këshilli i Lartë i Drejtësisë, çmohet se është marrë në kundërshtim me kërkesat ligjore”.²¹⁹

Në rastin e mësipërm, mund të thuhet plotësisht se mungesa e gjyqtarit, megjithëse e provuar, ishte e justifikuar duke qenë se familjarët e tij ndodheshin në një situatë të vështirë shëndetësore. Megjithatë në këtë rast, nga arsyetimi i vendimit të Gjykatës së Lartë, për shkak të sjelljes së këtij gjyqtari, duket se nuk përjashtohet mundësia për caktimin e një mase disiplinore, por vetëm që masa e shkarkimit ishte jo proporcionale në këtë rast.

Gjithashtu, nuk është konsideruar mosparaqitje në punë, rasti kur gjyqtari, që sapo ka përfunduar Shkollën e Magjistraturës, nuk kishte pranuar emërimin përfundimtar. Në këtë rast, Gjykata e Lartë ka arsyetuar se “Kolegjet e Bashkuara, mbasi e diskutuan çështjen në tërësi, arrijnë në përfundimin se KLD ka gabuar kur ka aplikuar nenin 41/5 të ligjit “Për Organizimin e Pushtetit Gjyqësor në Republikën e Shqipërisë”, duke shkarkuar nga detyra e gjyqtarit kërkuesin E. H., Në gjykim rezultoi se në përputhje me ligjin për shkollën e magjistraturës, kërkuesi në fillimin e vitit shkollor ka lidhur kontratë me Shkollën e Magjistraturës duke përcaktuar edhe detyrimet reciproke për ndjekjen e kësaj shkolle. Sipas nenit 22 të këtij ligji, gjë që është materializuar dhe në marrëveshjen e mësipërme, thuhet se, magjistratët e emëruar, që pa shkaqe të përligjura heqin dorë apo kërkojnë largimin nga detyra pa kaluar 5 vjet nga emërimi, detyrohen t’i paguajnë Shkollës së Magjistraturës një shumë të hollash sipas përcaktimeve të bëra në këtë dispozitë. Sipas ligjit “Për Shkollën e Magjistraturës së Republikës së Shqipërisë”, studentët që përfundojnë këtë shkollë, pa iu nënshtruar konkurrencës, emërohen nga Presidenti i Republikës, respektivisht në detyrat e gjyqtarëve e prokurorëve. Po sipas këtij ligji, që nga momenti që ata fillojnë shkollën, përfitojnë edhe 50% të pagës së gjyqtarit apo prokurorit, sipas emërimeve që do të marrin. Në kuptim të dispozitave të analizuara, Kolegjet mendojnë, se megjithëse ligji vë detyrime reciproke, pranon gjithashtu edhe të drejtën e magjistratit të emëruar, që të heqë dorë nga detyra dhe kur ai e bën një gjë të tillë brenda një afati kohor të caktuar, ka si pasojë dëmshpërblimin e shpenzimeve që ka bërë Shkolla e Magjistraturës për edukimin e tij. Me rastin e shqyrtimit të dorëheqjes së kërkuesit E. H., Këshilli i Lartë i Drejtësisë nuk duhet të diskutonte pranimin ose jo të saj, por duhet të zgjidhte pasojat që vinin në bazë të ligjit, nga kjo dorëheqje. Mospranimi i dorëheqjes, sipas Kolegjeve të Bashkuara, gjithsesi nuk e detyronte kërkuesin, që të paraqitej në detyrën ku ishte emëruar, pasi vullnetarisht kishte hequr dorë më parë prej saj. Rregullimi i nenit 22 të ligjit për shkollën e magjistraturës, vjen në harmoni me nenin 27/1 të ligjit për organizimin e pushtetit gjyqësor dhe për pasojë, nuk ka qenë vendi që ndaj kërkuesit E. H., të aplikohet shkarkimi nga detyra si masë disiplinore. Në frymën e Kushtetutës, Konventës Evropiane për të Drejtat dhe

219. Vendimi nr. 1095, datë 08.12.1999 i Kolegjeve të Bashkuara të Gjykatës së Lartë.

*Liritë Themelore të Njeriut dhe të ligjeve në fjalë, kërkuesi nuk detyrohet të pranojë pa vullnetin e tij emërimin nga organi i emërtesës”.*²²⁰

Sipas këtij vendimi të Gjykatës së Lartë, rezulton që kandidatët magjistratë, nuk mund të quheshin “gjyqtarë”, pa u emëruar në mënyrë përfundimtare, emërim që duhej të pranohej prej tyre. Për këtë arsye, mbi këto subjekte, që nuk kishin pranuar emërimin përfundimtar, nuk gjenin zbatim parashikimet ligjore, që rregullonin përgjegjësinë disiplinore të gjyqtarëve, por parashikimet e tjera ligjore, që rregullonin statusin e këtij subjekti si kandidat për magjistrat.

Nga trajtimi i mësipërm, rezulton se mungesat pa arsye në punë, përfaqësonin një shkelje serioze disiplinore për gjyqtarët, duke reflektuar mungesë përgjegjësie dhe përkushtimi ndaj detyrës së tyre, e cila është thelbësore për funksionimin e rregullt të sistemit të drejtësisë. Kjo del qartë edhe nga fakti që nga ana e KLD-së, ishte marrë gjithmonë masa ekstreme e shkarkimit nga detyra.

Jurisprudenca gjyqësore ka trajtuar një sërë rastesh që lidhen me këtë shkelje, duke theksuar rëndësinë e pranisë dhe angazhimit të gjyqtarëve për të garantuar zhvillimin e drejtë dhe efikas të proceseve gjyqësore. Në rastet e shqyrtuara nga Gjykata e Lartë, janë analizuar situata të ndryshme, si largimi i gjyqtarëve pa njoftuar apo pa marrë lejen përkatëse, mungesa e interesit për detyrën pas largimeve të papritura, si dhe rasti i mospranimit të emërimeve nga kandidatët për magjistratë. Në këto vendime, duket një lloj qasjeje për të bërë dallimin midis shkeljeve të disiplinës dhe veprimeve që përbënin dorëheqje faktike apo largime të vullnetshme, por kjo jo gjithmonë rezultoi, që të ishte e qartë. Përmes këtyre rasteve, jurisprudenca vendosi disa standarde të rëndësishme për trajtimin e përgjegjësisë disiplinore që lidhej me mungesat pa arsye në vendin e punës, më qëllim ruajtjen e një balance sa më të drejtë, midis përgjegjësisë disiplinore dhe të drejtave të gjyqtarëve, me qëllim mbrojtjen e integritetit dhe autoritetit në sistemin gjyqësor.

6. *Kryerja e veprimeve të pahijshme ose amorale brenda dhe jashtë kohës së punës.* Kjo shkelje disiplinore prekte drejtpërdrejt figurën morale dhe dinjitetin e gjyqtarëve prej të cilëve kërkohet që të ruanin integritetin e tyre në çdo rrethanë. Kjo shkelje nuk kufizohej vetëm në ushtrimin e funksionit të tyre gjatë orarit zyrtar, por shtrihej edhe në sjelljen personale dhe shoqërore, duke synuar të garantonte që ata të dukeshin dhe të ishin shembull për shoqërinë. Si përfaqësues të sistemit të drejtësisë, çdo veprim i tyre, i realizuar qoftë edhe në jetën e tyre private, kishte një ndikim të drejtpërdrejtë në besimin që publiku kishte tek ky sistem, duke krijuar përshtypjen se këto funksionarë nuk ishin të denjë për të ushtruar një detyrë kaq të lartë. Kjo shkelje disiplinore tregonte se ligjvënësi kërkonte

220. Vendimi nr. 16, datë 13.02.2000 i Kolegjeve të Bashkuara të Gjykatës së Lartë. Shih edhe vendimin nr. 19, datë 13.02.2001 të Kolegjeve të Bashkuara të Gjykatës së Lartë.

prej gjyqtarëve, jo vetëm profesionalizëm në ushtrimin e detyrës, por edhe një sjellje dinjitoze në çdo aspekt të jetës, si një garanci për pavarësinë dhe integritetin e sistemit të drejtësisë.

Jurisprudenca e asaj kohe tregon për raste, kur nga gjyqtarë të ndryshëm, është konsumuar kjo shkelje disiplinore, siç rezulton në arsyetimin vijues se *“Këshilli i Lartë i Drejtësisë, me kërkesë për procedim disiplinor të Ministrit të Drejtësisë, e ka shqyrtuar atë, në përputhje me kërkesat e ligjit nr. 8436 dhe ka arritur në konkluzionin se veprimet e ndihmës gjyqtarit D.G., duke fyer e goditur gjyqtaren e gjykatës së rrethit A. B., në ambientet e gjykatës, cenojnë rëndë figurën e gjyqtarit, e njëkohësisht cenojnë rëndë organin e dhënies së drejtësisë, gjykatën. Në këtë kontekst, drejt ka vepruar Këshilli i Lartë i Drejtësisë, që veprimet e tij i ka konsideruar “të pahijshme e morale”, brenda dhe jashtë kohës së punës.*

Pretendimi i paditësit, se ndaj tij nuk mund të merrej një masë e dytë (ajo e shkarkimit nga detyra), pa përfunduar çështja penale, është i pabazuar sepse veprimet e tij cenojnë rëndë figurën e gjyqtarit, e për rrjedhojë organi kompetent (KLD), në dhënien e masës disiplinore nuk mund të varet nga fillimi apo përfundimi i çështjes penale. Ndjekja penale në rastin konkret është vullnet i palës ndaj të cilës paditësi ka kryer fyerjen e goditjen, por kryerja e këtij veprimi në ambientet e gjykatës dhe ndaj një gjyqtareje bën që organit kompetent t'i lindë e drejta ligjore për procedim disiplinor. Veprimet e paditësit janë flagrante e hapur në kundërshtim me normat e vendosura për punën në organet gjyqësore”.²²¹

Në këtë rast është konsideruar e patolerueshme dhe e justifikuar dhënia e masës disiplinore “shkarkim nga detyra”, kur një gjyqtar fyen dhe godet fizikisht kolegen e tij. Kjo mënyrë sjelljeje, dukshëm, nuk pajtohet me figurën e gjyqtarit dhe për rrjedhojë e ligjëron marrjen e një mase të tillë. Në këtë vendim gjejmë gjithashtu referimin, se ndjekja penale nuk pezullon apo ndikon në një procedim administrativ, sidomos kur në këtë rast, ndjekja penale, ndiqej me ankim, pra nëpërmjet të ashtuquajturës “akuzë private”.

Një tjetër rast interesant, që ka të bëjmë me sjellje të pahijshme gjejmë në arsyetimin vijues të Gjykatës së Lartë, e cila ka argumentuar se *“Rezulton e provuar se gjyqtari S. S., me datë 03.02.2002, duke qenë pjesëmarrës në një seminar trajnimi, i cili zhvillohej në ambientet e Hotel “Pameba” në qytetin e Kavajës, për nevoja të tij ka shkuar në qytetin e Tiranës, ku në rrethana të rastit është takuar me qytetarin A. L., me të cilin nuk njihej më parë. Në këto rrethana njohjeje, S. S., është shoqëruar me të, madje kanë pirë pije alkoolike dhe më pas kanë udhëtuar drejt qytetit të Kavajës për tek hotel “Pameba”. Punonjësve të hotelit, qytetarin A. L., S. S., e ka paraqitur si një mikun e tij, mandej së bashku kanë shkuar në dhomën ku ai rrinte. Pas një kohe të shkurtër është dëgjuar zhurmë dhe personat, të cilët ndodheshin në afërsi të saj kanë shkuar dhe janë futur në dhomë ku kanë konstatuar se S. S., dhe qytetari A. L., ishin goditur me*

221. Vendimi nr. 656, datë 17.02.2000 i Kolegjeve të Bashkuara të Gjykatës së Lartë.

njëri-tjetrin. Secili prej tyre i është drejtuar organeve përkatëse duke pretenduar për njëri-tjetrin veprë penale.

Kolegjet e Bashkuara të Gjykatës së Lartë çmojnë, se fakti i shoqërimit të S. S., me një njeri të panjohur, duke qenë me detyrën e gjyqtarit të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Sarandë, përfundimi me të në grindje e dhunë reciproke, përbëjnë shkak për ta shkarkuar atë nga kjo detyrë.

Veprimet e mësipërme, në vështrim të nenit 147, pika 6 të Kushtetutës të Republikës së Shqipërisë dhe neneve 34 dhe 41, pika 6 të ligjit nr. 8436, datë 28.12.1998 “Për organizimin e Pushtetit Gjyqësor”, janë akte që diskreditojnë rëndë pozicionin dhe figurën e gjyqtarit, për pasojë shkarkimi i S. S., nga detyra është i drejtë.

Nga sa parashtruam më lart, rezulton se shkak për largimin nga detyra janë aktet që diskreditojnë rëndë pozicionin dhe figurën e gjyqtarit dhe jo fakti, nëse ankuesi do të përgjigjet penalisht ose jo. Për sa parashtruam, nuk ndikon në arsyen e shkarkimit fakti i pretenduar prej tij se është deklaruar i pafajshëm”.²²²

Ky rast, tregon për një tjetër mënyrë të vepruari të gjyqtarëve, në mënyrë jo të rregullt. Kështu takimi me persona të rastësishëm, lejimi i futjes së këtij personi, në ambient hotelerie të rezervuar vetëm për gjyqtarin dhe sjellja e dhunshme e mëpasshme, nuk përputhet aspak me rregullat e sjelljes, që duhet të ketë një gjyqtar, për me tepër që ky gjyqtar, duke qenë në periudhë trajnimit, duhej që të reflektonte pikërisht një sjellje korrekte.

Në një tjetër rast, është konsideruar si sjellje e pamoralshme, veprime të ndryshme të një gjyqtari, ndaj një personi privat, me qëllim që nga ana e saj, të vijohej lidhja intime mes tyre. Sipas Gjykatës së Lartë, “Inspektorati i Këshillit të Lartë të Drejtësisë mbi ankesën e shtetases O. P., për sjellje të papajtueshme me ligjin nga gjyqtari jashtë ushtrimit të detyrës, duke kryer sipas saj, veprime që komprometojnë profesionin, organet e drejtësisë dhe figurën e gjyqtarit në shoqëri, bazuar në ligjin nr. 8811, datë 17.05.2001 “Për organizimin e funksionimin e KLD-së”, neni 16, pika 1, ka kryer verifikimet përkatëse, lidhur me këtë ankesë.

Në përfundim, nga Inspektorati është konkluduar se gjyqtari L. D., në veprimtarinë jashtë gjyqësore ka manifestuar sjellje të papajtueshme me ligjin, që kanë kompromentuar profesionin, organet e drejtësisë dhe figurën e gjyqtarit, duke i dërguar aktet përkatëse Ministrit të Drejtësisë, i cili i ka propozuar KLD-së, marrjen e masës disiplinore “shkarkimin nga detyra”, me motivacion kryerjen e akteve e sjelljeve që diskreditojnë rëndë figurën e gjyqtarit dhe organet e drejtësisë.

Nga Inspektorati i KLD-së, në bazë të rregullores “Për procedimin disiplinor të gjyqtarit” rezulton, se është zbatuar procedura ligjore për njoftimin e gjyqtarit për fillimin e procedimit disiplinor dhe më datë 28.03.2006, në mbledhjen e KLD-së, ku është shqyrtuar kërkesa e ministrit të drejtësisë për shkarkimin e

²²². Vendimi nr. 13, datë 27.01.2003 i Kolegjeve të Bashkuara të Gjykatës së Lartë.

tij nga detyra, ka rezultuar se ankuesi D., ka marrë pjesë dhe ka parashtruar pretendimet e tij.

Gjithashtu KLD, mbi bazën e kërkesës së bërë nga Prokuroria pranë Gjykatës së Rrethit Berat për dhënien e miratimit për ndjekje penale për gjyqtarin D., mbi bazën e kallëzimit, për ndjekje penale të paraqitur nga shtetasja O. P., më datë 11.11.2004, ka dhënë autorizimin për ndjekje penale ndaj gjyqtarit dhe njëkohësisht ka urdhëruar pezullimin nga detyra, duke i kërkuar Inspektoratit të kryejë verifikime për këtë çështje.

Nga verifikimet e bëra nga ky organ dhe aktet shkresore të paraqitura e të marra në shqyrtim gjatë procedimit disiplinor të kryer nga KLD-ja, ka rezultuar e provuar si më poshtë:

Gjyqtari L. D., prej disa vitesh ushtron detyrën e gjyqtarit në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Skrapar është i martuar që nga viti 1989 dhe nga martesa ka një fëmijë të mitur.

Në vitin 2002, duke qenë gjyqtar pranë kësaj gjykate, rezulton se ka shqyrtuar çështjen civile me objekt zgjidhje martese, ku shtetasja O. P., ka qenë me cilësinë e palës paditëse në këtë çështje dhe me vendimin e datës 14.04.2002 është vendosur zgjidhja e martesës së saj me ish-bashkëshortin.

Në këtë vit, sikurse është pohuar edhe nga shtetasja O. P., dhe vetë gjyqtari, mes tyre janë krijuar marrëdhënie intime, të cilat rezulton se kanë vazhduar normalisht deri në vitin 2004-2005, kur shtetasja O. P., ka vendosur të ndërpresë lidhjen intime me gjyqtarin, është përpjekur ta mënjanojë nga jeta e saj, pasi ai kishte filluar t'i imponohej me dhunë fizike e psikike, duke i kërkuar të vazhdonte lidhjen, ishte bërë objekt fyerjesh dhe kërcënimesh të bëra shpeshherë edhe në publik, si ajo, ashtu edhe familja e saj, që banon në qytetin e Skraparit. Faktet e deklaruara nga ankuesja O. P., rezulton se janë verifikuar nga Inspektorati i KLD-së, nga i cili janë mbledhur deklarata nga qytetarë të ndryshëm, që kanë dëshmuar për shqetësimet e ankuses dhe familjes së saj, nga veprimet e sjelljet shqetësuese të vazhdueshme nga gjyqtari.

Kështu, nga drejtuesi i një autoshkolle në qytetin e Çorovodës, konfirmohet fakti, se në muajin gusht 2004 gjatë kohës, që ai u bënte guidë me makinën e tij shtetaseve O. P., e D. P., (motra), ishte ndaluar duke iu bllokuar rruga nga shtetasi D., që njihej si gjyqtar në atë qytet dhe ishte tentuar ta merrte me forcë nga makina shtetasen O. P., duke e fyer dhe vetë drejtuesin e makinës "autoshkolles", që nuk kishte lejuar të kryente atë veprim.

Pikërisht në këtë vit, shtetasja ka bërë edhe kallëzim për ndjekje penale në organin e prokurorisë për gjyqtarin dhe po në këtë vit, sikurse u citua më sipër, KLD ka dhënë miratimin për ndjekje penale dhe ka urdhëruar pezullimin e tij nga detyra.

Nga informacioni i marrë me shkrim nga Inspektorati i KLD autoritetit policor të "Qytetit Studenti" Tiranë, ka rezultuar se, në periudhën maj-qershor të vitit 2005, shtetasja O. P., studente dhe banuese në një nga godinat e këtij qyteti, ishte paraqitur disa herë në rajonin e policisë, ku ishte ankuar për

fyerjet dhe shqetësimet e vazhdueshme të bëra nga shtetasi L. D., i cili sipas saj insistonte, që ajo të vazhdonte lidhjen intime dhe të martohej me të. I njëjti fakt është konfirmuar edhe nga deklaratimet e administratores dhe sportelistit të godinës ku banonte studentja, materiale shkresore, që i janë paraqitur KLD-së.

Gjithashtu, nga informacioni i marrë nga autoriteti policor Borsh-Sarandë, ka rezultuar se në muajin korrik 2007, kur familja e O. P., ishte me pushime së bashku me vajzën, është paraqitur ankesë nga kjo familje (prindërit e vajzës) në rajonin e policisë, pasi ishin shqetësuar nga veprimet e sjelljes fyese e kërcënuese të gjyqtarit, i cili në po atë periudhë ndodhej në Borsh, duke u vendosur në një banesë afër banesës ku pushonte familja P. Në këtë rast, rezultoi se nga autoritet policor është konfirmuar se, shtetasi D., ka prishur qetësinë publike dhe është këshilluar nga patrulla e policisë.

Këto akte shkresore u paraqitën nga përfaqësuesi i KLD-së në seancë gjyqësore si prova, duke i bashkëngjitur me vendimin e KLD-së për shkarkimin nga detyra të gjyqtarit.

Krahas fyerjeve, shqetësimeve të tjera të herë pas herë të bëra edhe në publik, shtetasja O. është ankuar se edhe familja e saj, babai është shqetësuar po nga gjyqtari D., sipas tyre gjatë periudhës 2004-2005 edhe nga sms-të e dërguara në telefonin celular që mbante babai i saj, nga numra të ndryshëm telefoni në orë të ndryshme të ditës e natës, për të cilat është bërë kallëzim penal në organin e ndjekjes penale, si të kryera nga gjyqtari, i cili sipas ankueses përdorte të njëjtat shprehje fyese por nga aparate celulare të ndryshëm që të mos identifikohesh.

Gjyqtari D., si gjatë procedurës së verifikimit të ankesës dhe gjatë shqyrtimit të procedimit disiplinor në KLD, nuk ka mohuar lidhjen intime me shtetasen ankuese dhe as ndërprerjen e kësaj lidhje, por mohon fyerjet, kërcënimet, a veprime të tjera si këto, të bëra në publik ndaj shtetases dhe familjarëve të saj, duke pretenduar se:

- Shkaqet e parashtruara për shkarkimin e tij nga shtetasja nuk janë të tilla, por për shkak se ajo i kishte marrë atij një sasi të hollash, që nuk pranonte t'ia kthente prej kohësh.
- KLD, në kundërshtim me Kushtetutën dhe ligjin që burojnë prej saj është nxituar në dhënien e vendimit.
- Ndaj tij janë kryer hetime të kundërligjshme nga SHISH dhe Inspektorati i KLD-së, pasi janë tejkalim i kompetencave që u ka dhënë ligji.
- Ndaj tij janë bërë ndërhyrje në jetën private nga Inspektorati i KLD-së, pretendime këto që nuk u provuan gjatë gjykimit të çështjes.

Kolegjet e Bashkuara të Gjykatës së Lartë gjykojnë se:

Sikurse rezultoi nga rrethanat e faktet e parashtruara në gjykimin e çështjes, nga aktet shkresore që mbështesin vendimin e KLD-së, të analizuara më sipër, vërtetohet se veprimet e sjelljet e kryera nga gjyqtari jashtë detyrës, nuk janë të lidhura me jetën private të tij. Ato janë të tilla, që duke u analizuar nga mënyra e kryerjes së tyre, momenti subjektiv dhe dëmet që i kanë sjellë shoqërisë

dhe shtetit, me abuzimin dhe dhunimin që ato i bëjnë besimit të publikut, çmohen serioze, të një natyre të tillë, që e bëjnë të pamundur kryerjen e mëtejshme të funksionit të tij si gjyqtar, kanë diskredituar rëndë figurën e gjyqtarit dhe organin që përfaqësojnë dhe me të drejtë e kanë detyruar organin kompetent të marrë masë disiplinore, shkarkimin nga detyra bazuar në nenin 147/6 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë.

Në qëndrimin dhe konkluzionet e tyre, Kolegjet e Bashkuara të Gjykatës së Lartë bazohen në vendimin nr. 75, datë 19.04.2000 të Gjykatës Kushtetuese, me të cilin interpretohet neni 128 dhe 140 i Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, që parashikojnë rastet për shkarkimin nga detyra të gjyqtarit të Gjykatës Kushtetuese dhe të gjyqtarit të Gjykatës së Lartë, për të përcaktuar kriteret, konceptet bazë, si dhe parimet ku mbështetemi për të konkluduar lidhur me aplikimin e shkakt të shkarkimit edhe për gjyqtarin e gjykatës së shkallës së parë.

Interpretimi nga ajo gjykatë, i konceptit kushtetues “sjellje që diskreditojnë rëndë pozitën e figurën e gjyqtarit”, korrespondon me rastin e parashikuar nga neni 147/6, për të cilin gjyqtari D. është shkarkuar nga detyra.

Krahas sa sipër, me të drejtë nga KLD veprimet e sjellja të gjyqtarit janë cilësuar se vijnë në kundërshtim edhe me nenin 34 të ligjit nr. 8436, datë 28.12.1998 “Për organizimin e pushtetit gjyqësor në Republikën e Shqipërisë”, sipas të cilit:

“Gjyqtarët duhet të ruajnë autoritetin e tyre duke mos lejuar veprime që komprometojnë profesionin, organet e drejtësisë dhe figurën e tyre në shoqëri”.

Duke vepruar në kundërshtim me normën ligjore të sipërme, të detyrueshme për t’u zbatuar në ushtrimin e funksionit të tij, duke manifestuar në mënyrë publike sjellje e veprime të parregullta ndaj shtetases dhe familjarëve të saj, jo vetëm nuk është në kufijtë e jetës private sikurse ka pretenduar, por ka kompromentuar profesionin, besueshmërinë e gjyqtarit në publik, ka përdorur autoritetin e të qenit gjyqtar për të përmbushur interesat e tij, duke i krijuar dhe të tjerëve përshtypjen se po vepron në mënyrë të tillë për shkak të autoritetit që ka funksioni që kryen, duke vepruar në kundërshtim edhe me rregullat e etikës gjyqësore, siç me të drejtë citohen në vendimin e KLD., rregullin 3, 4, 15, etj., të Kodit të Etikës Gjyqësore.

Në lidhje me kërkesën e bërë prej tij për mos shqyrtimin e çështjes, pa u administruar një vendim gjyqësor që lidhet me gjykim të filluar, me akuzën ndaj tij për veprën penale të “përdorimit me keqdashje, thirrjeve telefonike”, parashikuar nga neni 275, veprë kjo e amnistuar me ligjin nr. 9678, datë 13.01.2007, nuk gjendet i bazuar.

Kolegjet e Bashkuara të Gjykatës së Lartë shqyrtojnë çështjen mbi bazën e ankimit të paraqitur nga ankuesi, ndaj një akti administrativ me të cilën është marrë masë disiplinore për gjyqtarin, shkarkimi nga detyra, siç është vendimi i KLD, i cili nuk ka mbështetur shkarkimin nga detyra në vendimin penal të cituar nga ankuesi, por në disa akte e prova që u paraqitën gjatë shqyrtimit gjyqësor të mbledhura gjatë procedurës së verifikimit në rrugë administrative të ankesës nga

Inspektorati i KLD, akte këto mbi të cilat është bazuar vendimi shkarkimit".²²³

Vendimi i mësipërm, konfirmoi parimin, se një gjyqtar nuk është vetëm një përfaqësues i drejtësisë në sallën e gjyqit, por është gjithashtu një figurë, që duhet të mbajë një standard të lartë sjelljeje edhe jashtë detyrës zyrtare. Duhet theksuar se shkaku i shkarkimit, nuk ishte krijimi i një lidhje intime jashtëmartesore, por sjellja e tij për të detyruar një tjetër person që të vijonte këtë lidhje. Diskreditimi i rëndë i figurës së tij nga sjelljet e dokumentuara e bëri të pamundur vijimin e tij në detyrë, duke e shndërruar këtë rast, në një precedent të rëndësishëm për respektimin e normave etike dhe disiplinore nga gjyqtarët.

Nga analiza e dispozitës dhe e jurisprudencës, rezulton se kjo lloj shkelje, që lidhet me kryerjen e veprimeve të pahijshme ose amorale, si brenda ashtu edhe jashtë kohës së punës, përfaqëson një aspekt themelor të etikës dhe përgjegjshmërisë së një gjyqtari, i cili kërkohet të ruajë integritetin moral dhe profesional në çdo rrethanë. Raste të tilla, si fyerjet apo goditjet ndaj kolegëve, sjelljet e papërshtatshme gjatë detyrave zyrtare, apo abuzimi me autoritetin në marrëdhënie personale janë konsideruar shkelje të papranueshme, duke çuar në masa disiplinore ekstreme, përfshirë shkarkimin nga detyra. Në jurisprudencë është theksuar, se sjelljet e tilla nuk kufizohen brenda kufijve të jetës private, por ndikojnë drejtpërdrejt në figurën publike të një gjyqtari dhe në autoritetin e sistemit gjyqësor. Ruajtja dhe mbajtja e një standardi të lartë etik dhe sjellja dinjitoze ishin të domosdoshme për të ruajtur integritetin e drejtësisë dhe besimin e publikut në të.

7. *Kryerja e veprimeve në kundërshtim me përmbushjen e rregullt të detyrës ose moskryerja e veprimeve të detyrueshme procedurale, kur nuk përbën veprë penale.* Kjo lloj shkelje, përfaqëson një shkelje disiplinore të rëndë, e cila cenonte parimet kryesore mbi të cilat mbështetej sistemi i drejtësisë. Gjyqtarët, si figura të rëndësishme, kishin detyrimin që të ndiqnin në mënyrë të saktë parashikimet procedurale dhe të kryenin të gjitha veprimet e nevojshme për të siguruar një proces të rregullt ligjor. Shkelje të tilla, të kryera qëllimisht apo për shkak të neglizhencës, mund të dëmtonin rëndë jo vetëm interesat e palëve në proces, por edhe vetë funksionimin e institucioneve të sistemit të drejtësisë. Mosrespektimi i detyrave procedurale tregonte mungesë profesionalizmi dhe ndershmërie, duke krijuar perceptimin se gjyqtarët mund të vepronin në mënyrë arbitrare. Edhe pse ndodheshim përpara rasteve kur këto shkelje nuk përbënin vepra penale, ato ishin të papranueshme. Ligjvënësi, përmes sanksionimit të kësaj shkeljeje, synonte të ruante standardet më të larta të korrektësisë dhe përgjegjësisë në ushtrimin e funksioneve të gjyqtarëve, duke parandaluar çdo devijim që mund të komprometonte të drejtën e qytetarëve për një proces të rregullt ligjor.

223. Vendimi nr. 7, datë 11.09.2007 i Kolegjeve të Bashkuara të Gjykatës së Lartë.

Në lidhje me këtë parashikim si shkelje disiplinore, rezulton se janë pranuar si të tilla, kryerja e veprimeve, që kanë të bëjnë me mënyrën e pranimi të kërkesave për lirim para kohe me kusht, apo dhënia e dënimeve më pak se minimumi i parashikuar nga normat përkatëse penale, siç rezulton nga arsyetimi vijues i Gjykatës së Lartë se “Nga shqyrtimi gjyqësor i çështjes rezulton se kërkuesi R. Sh., ka qenë me detyrën gjyqtar ushtarak në Gjykatën e Rrethit Tiranë dhe duke qenë në këtë detyrë, në disa raste, sikurse del nga dokumentet e administruara dhe vendimet gjyqësore, në cilësinë e gjyqtarit apo të kryesuesit ka kryer veprime, që vijnë ndesh me kërkesat ligjore dhe përmbushjen e rregullt të detyrës. Me vendimin nr. 61, datë 13.10.1999, Gjykata e Rrethit Tiranë në përbërjen e së cilës ka qenë kërkuesi R. Sh., ka pranuar kërkesën e të dënuarit A. L., për lirim para kohe me kusht për pjesën e pavuajtur të dënimit prej 3 vjet, 5 muaj e 23 ditë, ka urdhëruar lirim të tij të menjëhershëm nga vendi i riedukimit, duke pezulluar ekzekutimin e atij dënimi për një kohë prej dy vjetësh.

Gjatë gjykimit të çështjes së sipërme, rezulton se A. L., me vendimin nr. 93, datë 12.08.1992 të Gjykatës së Rrethit Berat ka qenë dënuar me 14 vjet burgim për krimin e marrëdhënieve seksuale me dhunë dhe se deri më 13 mars të vitit 1997 ka qenë duke vuajtur dënimin dhe në këtë datë është larguar nga vendi i vuajtjes së dënimit dhe nuk është paraqitur më për të vazhduar vuajtjen e tij. Në gjykimin e kësaj çështjeje janë shkelur rëndë kërkesat ligjore, si ato procedurale penale edhe ato të parashikuara nga ligji material. Nuk janë respektuar afatet procedurale për zhvillimin e gjykimit të parashikuara nga neni 333 i K. Pr. Penale, duke mos bërë njoftimet përkatëse për pjesëmarrjen e palëve në proces dhe janë kaluar pa iu nënshtruar vlerësimit dokumentet e paraqitura nga avokati i të pandehurit, Drejtoria e Përgjithshme e Burgjeve dhe Institucioni i Riedukimit Vaqar për të arritur në konkluzione, nëse kërkuesi A. L., plotësonte kriteret e përcaktuara në nenin 64 të Kodit Penal për lirim para kohe me kusht. Pavarësisht se veprimet paraprake ishin kryer nga ish gjyqtari Sh. D., kërkuesi R. Sh., si anëtar i trupit gjykues, ishte i detyruar të shqyrtonte dokumentet dhe provat shkresore, që u paraqitën ditën e gjykimit, si dhe të vlerësonte të dhënat, që dolën në gjykim për personalitetin e të pandehurit, kohën e vuajtjes së dënimit, ditën e paraqitjes për të vazhduar vuajtjen e dënimit dhe rrethanat që lidheshin me faktin, nëse i ishte arritur qëllimit të riedukimit, si një ndër kërkesat kryesore për të arritur në përfundimin nëse duhej vendosur liri para kohe me kusht.

Duke iu referuar dokumentacionit që përmban dosja gjyqësore dhe verifikimeve të bëra më pas, ka dalë se A. L., nuk ishte paraqitur në Burgun e Vaqarit për të vazhduar vuajtjen e dënimit të mbetur dhe në vend të tij, dy ditë para gjykimit ishte paraqitur vëllai i tij, por si pasojë e mospërmbushjes së rregullt të detyrës nga ana e gjyqtarëve në gjykimin e çështjes dhe e lejimit të mjaft shkeljeve procedurale nuk u zhvillua një gjykim i rregullt dhe në përputhje me kërkesat e ligjit material e procedural. Aktet e administruara nuk iu nënshtruan vlerësimit të vërtetësisë e saktësisë së tyre dhe për pasojë

janë pranuar akte të pavërteta, duke mos i trajtuar të tilla në kohën e dorëzimit për t'ju bashkëngjitur dosjes, si p.sh., dëshmia e lëshuar nga Zyra e Gjendjes Gjyqësore pranë Ministrisë së Drejtësisë me nr. 3/77, datë 17.05.1999 për të dënuarin A. L., ku thuhej se “me këtë identitet nuk kemi të dënuar” (kur në fakt A. L., kërkonte lirim para kohe me kusht nga vuajtja e mëtejshme e dënimit) apo deklarata noteriale e datës 20.06.1998 e paraqitur si provë në gjykim sipas së cilës, e dëmtuara deklaronte para noterit se e kishte falur kërkuesin, që me një kujdes minimal do të konstatohej se nuk duhej pranuar si provë nga gjykata pasi ishte e parregullt, i mungojnë numrat e regjistrimit tek noteri, gjë që e bën atë të pavlefshme.

Sikurse me të drejtë ka arritur në përfundimin KLD, gjykata në rastin e gjykimit të kërkesës së A. L., ka zbatuar gabim edhe nenin 64 të K. Penal. Në pikën 2 të këtij neni, parashikohet si kriter për lirim para kohe me kusht, që me të dënuarin të jetë realizuar edukimi i tij nëpërmjet sjelljes dhe punës gjatë vuajtjes së dënimit. Nga dokumentet që ndodhen në dosje del se në rastin konkret kemi të bëjmë me një person, që është larguar nga vendi i vuajtjes së dënimit në muajin mars të vitit 1997 dhe nuk ishte kthyer më për vazhdimin e vuajtjes së dënimit, me gjithë thirrjet dhe kushtet lehtësuese ligjore, që u krijuan për ata që paraqiteshin vullnetarisht për të vazhduar vuajtjen e dënimit, fakt ky që krijon bindjen se nuk i ishte arritur qëllimit të riedukimit të tij gjatë kohës që vuajti një pjesë të dënimit. Për më tepër sipas akteve që ndodhen në dosje, dilte se A. L., kishte 3 ditë që ishte paraqitur për të vazhduar vuajtjen e dënimit, gjë që del nga shkresa e Drejtorisë së Përgjithshme të Burgjeve e datës 12.07.1999 dhe ajo e Institucionit të Riedukimit të Vaqarrit datë 13.10.1999 nga del se i dënuari ishte paraqitur aty më 11.10.1999, dokumente këto që nuk iu nënshtruan vlerësimit nga gjykata.

Duke analizuar sa më sipër, Kolegjet e Bashkuara arrijnë në përfundimin se në gjykimin e kësaj çështjeje, ku gjyqtar ka qenë edhe kërkuesi R. Sh., janë lejuar veprime që në kuptim të nenit 41/7 dhe 44 të ligjit nr. 8436, datë 28.12.1998 “Për organizimin e pushtetit gjyqësor në Republikën e Shqipërisë” përbëjnë mospërbushje të rregullt të detyrës dhe që shërben si shkak për shkarkimin nga detyra.

Përveç qëndrimit të parregullt në gjykimin e çështjes me kërkues A. L., me të drejtë nga KLD është arritur në konkluzionin se veprime e qëndrime që vijnë në kundërshtim me përmbushjen e rregullt të detyrës së gjyqtarit janë lejuar edhe në disa çështje të tjera, ku ai ka qenë si kryesues apo anëtar i trupit gjykues, që kanë të bëjnë me dhënien e dënimeve nën minimumin e parashikuar nga ligji, në kundërshtim me kërkesat e nenit 53 të Kodit Penal, e me lirimet para kohe me kusht. Si raste të tilla trajtohen vendimi nr. 734, datë 16.11.1999, me të cilin i pandehuri A. H., për krimin e vjedhjes me dhunë të parashikuar nga nenet 139 e 25 të Kodit Penal, është dënuar me 10 muaj burgim, kur ligji parashikon në minimum 10 vjet burgim; vendimi nr. 255, datë 23.04.1999, me të cilin i pandehuri L. Ç., është dënuar me dy vjet e gjashtë muaj burgim për krimet e

mashttrimi e të falsifikimit të monedhave, parashikuar nga nenet 143 e 183 të Kodit Penal masë dënimi kjo që është ndryshuar nga gjykata e apelit duke e bërë 5 vjet; me vendimin nr. 174, datë 23.03.1999 është dënuar i pandehuri G. M., për veprën penale të mbajtjes së lëndëve narkotike parashikuar nga neni 283/1 i Kodit Penal me pesë muaj burgim në një kohë që kjo dispozitë parashikon dënimin me 3 vjet burgim.

Edhe në rastet e lirimeve para kohe me kusht nuk janë trajtuar me kujdes kërkesat e nenit 64 të Kodit Penal dhe janë dhënë vendime lirimi me kusht edhe në raste që kërkuesit nuk plotësonin kushtet ligjore. Kështu me vendimin nr. 32, datë 24.05.1999 është vendosur lirimi para kohe me kusht i të dënuarit Sitki Nuri dënuar me 4 vjet burgim për krimin e vrasjes me dashje dhe armëmbajtje pa leje, ndonëse nga materialet dhe dokumentet e administruara në gjykim dilte se për periudhën e qëndrimit të tij në vendin e vuajtjes së dënimit nuk i ishte arritur qëllimit të edukimit, kërkesë kjo esenciale e nenit 64 të Kodit Penal dhe e dënimit në përgjithësi.

Të tilla qëndrime janë mbajtur nga gjykata e gjyqtari R. Sh., edhe në rastet e gjykimit të çështjeve me objekt lirin para kohe me kusht për të pandehurit I. K., E. R., e A. H., persona këta të dënuar për krime të rënda, si vjedhje me armë, vjedhje me dhunë, në të cilat nuk janë marrë në analizë tërësore gjithë rrethanat për të arritur në konkluzionin, nëse duheshin pranuar apo jo kërkesat e tyre për lirin para kohe me kusht. Pretendimi i kërkuesit se arsyetimet e KLD nuk janë të drejta, pasi në rastet e gjykuara kanë pasur parasysh tri kërkesat e nenit 64 të Kodit Penal (të ketë vuajtur gjysmën e dënimit, të mos jetë përsëritës e me kohën e vuajtjes së dënimit i është arritur qëllimit të riedukimit) nuk mund të pranohet si i bazuar pasi plotësimi i këtyre kushteve nuk e vë gjykatën përballë faktit të pranimit të kërkesës për lirim para kohe me kusht. Tri kërkesat që u parashtruan duke u plotësuar, i japin të drejtën të dënuarit, që të realizojë kërkesën për lirim para kohe me kusht, por nuk e detyrojnë gjykatën që të pranojë kërkesën, pasi vetë ligji thekson se i dënuari me burgim mund të lirohet para kohe nga vuajtja e mëtejshme e dënimit dhe i lë të drejtën e detyrën gjykatës, që nëpërmjet një gjykimi të drejtë e objektiv duke qartësuar të gjitha problemet që lidhen me kërkesat e nenit 64 të Kodit Penal, me të pandehurin, rrezikshmërinë e tij dhe të veprës duke i trajtuar me kujdes, sidomos faktin nëse i është arritur qëllimit të riedukimit të vlerësojë nëse duhet të pranojë kërkesën për lirim para kohe me kusht.

Në kundërshtim me sa pretendoi kërkuesi R. Sh., këto raste edhe se ai vetëm në një çështje ka qenë kryesues, e ngarkojnë me përgjegjësinë e shkëljes së disiplinës në punë në formën e veprimeve të kryera në kundërshtim me përmbushjen e rregullt të detyrës. Sigurisht, në çdo gjykim kryesuesi apo relatori ka përgjegjësinë e tij për drejtimin e seancës, zbatimin e gjithë kërkesave procedurale, kujdesit në marrjen e trajtimin e provave, por këto detyrime janë edhe për anëtarët e tjerë të trupit gjykues e sidomos kjo përgjegjësi bëhet më e dukshme në gjykimin e çështjeve në shkallë të parë.

I pabazuar është edhe pretendimi se duke marrë masë ndaj tij KLD ka vepruar në kundërshtim me konventën “Për parimet themelore në lidhje me pavarësinë e drejtësisë”, pasi duke vënë në dukje shkeljet e ligjit e të metat e tjera të lejuara në gjykimin e çështjeve, e duke marrë masa ndaj gjyqtarëve, që kanë lejuar shkelje nuk mund të pranohet se KLD ndërhyr në zgjidhjen e çështjeve dhe cenon pavarësinë e gjykatës, pasi është detyrë ligjore e saj të vërë para përgjegjësisë gjyqtarët, që veprojnë në kundërshtim me ligjin e me përmbushjen e rregullt të detyrës së tyre, pa ndikuar në gjykimin apo zgjidhjen nga gjykata të një çështjeje konkrete.

Me vendimin nr. 73, datë 04.03.2000 KLD ka vendosur miratimin e kërkesës së prokurorit për ndjekje penale ndaj kërkuarit R. Sh., dhe e ka pezulluar atë nga detyra, por ky vendim nuk e pengon atë që të marrë në tërësi në analizë shkeljen për të cilën u vendos pezullimi nga detyra e gjyqtarit bashkë me shkeljet e tjera që janë konstatuar e për të dalë me një masë disiplinore, që e çmon të arsyeshme.

I pabazuar është edhe pretendimi i kërkuarit, se KLD ka dhënë vendim disiplinor ndaj tij për vendime të formës së prerë për të cilat asnjë organ nuk ka të drejtë t’i shqyrtojë në themel pasi nuk ka ankime. Së pari duhet theksuar se për asnjë nga vendimet që janë analizuar KLD nuk ka hyrë në themelin e çështjes, por ka evidentuar shkeljet ligjore të kryera në gjykimin e tyre dhe së dyti fakti që vendimet kanë marrë formë të prerë pa u ankimuar nuk do të thotë se vendimet kanë qenë të bazuara në ligj për efekt të shkeljeve ligjore që përbëjnë shkak për procedim disiplinor ndaj gjyqtarit.

*Në kushtet e sipërme, Kolegjet e Bashkuara të Gjykatës së Lartë e konsiderojnë të drejtë e të bazuar vendimin nr. 99, datë 20.12.2000 të Këshillit të Lartë të Drejtësisë për shkarkimin nga detyra të kërkuarit R. Sh”.*²²⁴

Vendimmarrja e gjyqtarit në rastet e sipërcituara ishte karakterizuar nga devijime të qarta nga standardet procedurale dhe ligjore. Shkeljet përfshinin ndër të tjera, miratimin e lirimeve para kohe me kusht në mënyrë të papërshtatshme dhe dhënien e dënimeve nën minimumin e parashikuar nga ligji. Vendimet gjyqësore të shqyrtuara treguan një mungesë të kujdesit në shqyrtimin dhe vlerësimin e provave, mosrespektimin e rregullave procedurale dhe një mos vlerësim të plotë të rrethanave në përputhshmëri me normat penale. Interesant është fakti që veprimet dhe qëndrimet e gjyqtarit, u konsideruan shkelje, në formën e mospërmbushjes së rregullt të detyrës, pavarësisht nëse ai ishte kryesues apo anëtar i trupit gjykues. Kjo qasje tregon që të gjithë anëtarët e një trupi gjykues, mbajnë përgjegjësi të njëjtë në ushtrimin e detyrës së tyre.

Në një tjetër rast Gjykata e Lartë e ka konsideruar të konsumuar këtë shkelje, duke arsyetuar se “Ankuesi B. M., në datën 23.06.1998 ka gjykuar çështjen për vlerësim mase arresti në flagrancë të shtetasit L. M., duke vendosur

224. Vendimi nr. 10, datë 13.02.2001 i Kolegjeve të Bashkuara të Gjykatës së Lartë. Shih edhe vendimin nr. 25, datë 04.04.2001 të Kolegjeve të Bashkuara të Gjykatës së Lartë.

olerësimin e arrestimit si të ligjshëm dhe duke caktuar masë sigurimi “arrest në burg”. I pandehuri akuzohej për krimin e vjedhjes në bashkëpunim në dëm të shtetasit A. Ago në banesë në shumën 6.600 lekë dhe 20.000 dhrahmi. Në vendim është arsyetuar se i pandehuri e ka pranuar vjedhjen duke treguar dhe bashkëpunëtorin e larguar.

Kundër këtij vendimi i arrestuari ka bërë ankim në Gjykatën e Apelit Vlorë e cila me vendimin nr. 13, datë 20.07.1998 ka lënë në fuqi vendimin e Gjykatës së Rrethit Fier.

Në datën 02.07.1998 i pandehuri ka bërë kërkesë për revokim të masës së sigurimit dhe zëvendësimit të saj. Po ky gjyqtar me vendimin e datës 09.07.1998 ka vendosur rrëzimin e kërkesës si të pabazuar në ligj. Në këtë gjykim ka rezultuar se i pandehuri do të akuzohej dhe për një vjedhje tjetër për shumën 48.000 lekë të kryer me armë.

Ky vendim nuk është ankimuar. Në datën 21.08.1998 është paraqitur përsëri kërkesë për revokim të masës së “arrestit në burg” dhe zëvendësimi saj me një masë tjetër. Kjo kërkesë është shqyrtuar përsëri nga ky gjyqtar, duke vendosur me vendimin nr. 222, datë 26.08.1998: “Pranimin e kërkesës së të arrestuarit L. M., duke zëvendësuar masën e sigurimit të “arrestit në burg” me “arrest në shtëpi”.

Në vendim është arsyetuar se nevojat e sigurimit janë zbutur, masa e sigurimit nuk i përgjigjet rëndësisë së faktit dhe dënimit që mund t’i caktohet të arrestuarit etj.

Kundër këtij vendimi ka bërë ankim prokurori dhe Gjykata e Apelit Vlorë me vendimin nr. 18, datë 02.10.1998 ka vendosur ndryshimin e vendimit duke caktuar për të arrestuarin masë sigurimi arrest në burg. Edhe Gjykata e Kasacionit me vendimin nr. 219, datë 12.11.1998 ka vendosur mospranimin e rekursit të paraqitur nga i pandehuri.

Nga sa u parashtua dhe nga sa rezulton nga përmbajtja e vendimeve megjithëse kanë konkurruar të njëjtat rrethana në të tri gjykimet, gjyqtari në kundërshtim me kërkesat e nenit 260 të K. Pr. Civile, ka ndryshuar masën e sigurimit.

Pikërisht qëndrimi i mbajtur në kundërshtim me ligjin me të drejtë është konsideruar si kryerje e veprimeve në kundërshtim me përmbushjen e rregullt të detyrës.

Kolegjet e Bashkuara duke konstatuar faktin se ka shkelje të ligjit procedural çmojnë se vendimi i shkarkimit nga detyra është i drejtë, pasi masa e caktuar për shkeljen e disiplinës vlerësohet prej vetë atij organi”.²²⁵

Në këtë rast, shkelja ishte e lidhur me mënyrën e trajtimit të kërkesave për masat e sigurimit, ku gjyqtari kishte ndryshuar masën e sigurimit nga “arrest në burg” në “arrest në shtëpi,” pavarësisht se rrethanat e çështjes nuk kishin ndryshuar dhe veprimet e tij binin në kundërshtim me kërkesat e ligjit procedural dhe material. Pavarësisht se vendimet e

225. Vendimi nr. 572, datë 29.06.1999 i Kolegjeve të Bashkuara të Gjykatës së Lartë.

mëparshme të Gjykatës së Rrethit Fier dhe Gjykatës së Apelit Vlorë e kishin konsideruar të ligjshëm vlerësimin e masës së arrestit në burg, gjyqtari mori një vendim të ndryshëm, duke arsyetuar se nevojat e sigurimit ishin zbutur dhe se masa e mëparshme nuk i përkonte rëndësisë së faktit dhe dënimit të mundshëm. Kjo arsyetim u konsiderua i pabazuar nga Gjykata e Apelit dhe Gjykata e Kasacionit, të cilat ndryshuan vendimin duke rikthyer masën e arrestit në burg.

Duke konstatuar përsëri përgjegjësi disiplinore sipas këtij parashikimi, në një tjetër rast, Gjykata e Lartë, ka arsyetuar se “Me vendimin nr. 27/3, datë 06.03.1999 të Këshillit të Lartë të Drejtësisë ajo është shkarkuar nga detyra me motivacionin “Për kryerjen e veprimeve në kundërshtim me përmbushjen e rregullt të detyrës”. Vendimi i është komunikuar paditëses më datën 12.03.1999 nga Ministri i Drejtësisë me shkresën, që mban po këtë datë dhe nr. 899/1 protokolli. Brenda afatit ligjor paditësja ka paraqitur ankimin me objekt, anulimin e vendimit të mësipërm, duke parashtruar si shkak se procedimi disiplinor është shumë i nxituar, pa u pritur vendimi i Gjykatës së Lartë mbi ligjshmërinë e vendimit (çështja gjyqësore në të cilën janë konstatuar shkeljet). Lidhur me këtë pretendim u konkludua se Gjykata e Apelit e ka shqyrtuar vendimin me paditësi R. N., dhe e ka prishur atë duke pushuar gjykimin me arsyetimin që paditësi R., më parë duhej t’i drejtohej K. K. Pronave, pasi nuk dispononte titull të kthimit të pronës dhe as vendim negativ nga ky komision dhe në këto rrethana paditësi nuk legjitimohej të ngrinte padinë e kërkit të sendit. Dhe në kolegjin civil kjo çështje është pushuar sepse paditësi hoqi dorë nga rekursi. Në këto rrethana pretendimi i paditëses, se gjykimi në shkallë më të lartë do të sillte ndryshime në vendimin, i cili ka prishur vendimin e gjykuar prej saj, mbetet i pabazuar.

Nga ligji dhe praktika gjyqësore e këtyre viteve është e qartë dhe s’ka vend për interpretime të ndryshme që për pronat që nuk i ka kthyer K. K. Pronave, pavarësisht nëse janë marrë pa titull, nuk kthehen ipso jure apo vetiu, në favor të ish-pronarit. Në këto kushte paditësit, duke mos qenë pronarë, nuk mund të pranohet padia e rivendikimit. Dhënia e një vendimi në kundërshtim të hapur me ligjin dhe praktikën tregon që paditësja D., nuk ka përmbushur në rregull detyrën.

Duke pranuar shkeljen e konstatuar nga Këshilli i Lartë i Drejtësisë, çmohet që vendimi duhet të lihet në fuqi”.²²⁶

Në këtë rast del se është konsideruar si një shkelje e tillë, mosrespektimi i normave, që kanë të bëjnë me legjitimitimin e paditësit, norma këto që do të duhej të zbatoheshin sipas interpretimeve që kishte dhënë praktika gjyqësore, e cila në këtë lloj çështjesh ishte shfaqur e konsoliduar.

Një tjetër rast i konsumimit të kësaj shkeljeje disiplinore, Gjykata e Lartë ka arsyetuar se “Kërkuesi B. Xh., ka kryer detyrën e gjyqtarit pranë Gjykatës së Rrethit Gjirokastër.

226. Vendimi nr. 672, datë 29.06.1999 i Kolegjeve të Bashkuara të Gjykatës së Lartë.

Me vendimin nr. 23, datë 14.11.1998 të Këshillit të Lartë të Drejtësisë është larguar nga detyra për “kryerjen e veprimeve në kundërshtim me përmbushjen e detyrës” sipas nenit 41/7 të ligjit nr. 8436, datë 28.12.1998 “Për organizimin e pushtetit gjyqësor në Republikën e Shqipërisë”.

Nga aktet rezulton se këto veprime e mosveprime të rregullta në përmbushjen e detyrës, KLD i ka konstatuar në veprimet që lidhen me paraqitjen me vonesë të kërkesës për heqjen dorë nga gjykimi i masës së sigurimit (kërkesës për revokim) ndaj të pandehurit A. A., dhe në vendimin civil për sigurim të padisë nr. 482, datë 15.06.1998 që i përket palëve “AAM” kundër “A. G.” dhe F. D., me objekt “pjesëtim detyrimi”.

Duke i analizuar këto pretendime rezulton se:

Kërkesa për të vlerësuar arrestimin ndaj të pandehurit A. A., ka filluar procedurat e gjykimit që më datë 15.07.1998, duke pasur afat maksimal të gjykimit deri më datë 25.07.1998. Kjo kërkesë, pas disa refuzimeve të gjyqtarëve të tjerë për ta gjykuar, më datë 22.07.1998 i është dorëzuar gjyqtarit B. Xh., për ta gjykuar. Ky i fundit i ka paraqitur kryetarit të gjykatës kërkesë për heqjen dorë nga gjykimi i kësaj kërkesë. Kjo kërkesë e gjyqtarit është miratuar nga kryetari më datë 24.07.1998, ndërsa kërkesa e vetë përjashtimit mban datën 22.07.1998. Diferenca e dy ditëve nuk bën të pranueshme pretendimin e kërkuësit B., se është rrjedhojë e pushimit të fundjavës, ndërmjet momentit të paraqitjes së kërkesës për heqjen dorë dhe miratimit prej kryetarit. Për më tepër është jo logjike lidhja që bëhet ndërmjet këtij veprimi të kërkuësit dhe kalimit të afatit të gjykimit të çështjes.

Lidhur me çështjen civile nr. 482, vërehen një sërë veprimesh të parregullta procedurale të kryera prej gjyqtarit B. Xh.

Kërkesë padia që i është bashkëlidhur dosjes nuk ka shënimin e kryetarit të gjykatës apo qoftë edhe të vetë gjyqtarit për kohën e paraqitjes. Evidentimi i kësaj date është element tepër i rëndësishëm veçanërisht në këtë gjykim, pasi prej gjyqtarit më datë 15.06.1998 është marrë vendim për sigurimin e padisë. Për rrjedhojë data e paraqitjes së padisë duhet të evidentohet për të verifikuar pasojat e vendimit të marrjes së masës së sigurimit të padisë të cilat sipas nenit 204/2 të K. Pr. Civile pushojnë së vepruari pas kalimit të afatit të përcaktuar në këtë dispozitë.

Nga ana tjetër vetë masa provizore nuk është marrë në përputhje me kërkesat e nenit 202/2 të K. Procedurës Civile. Nga materialet e çështjes rezulton se nëpërmjet vendimit “masë provizore”, realisht është pezulluar ekzekutimi i një vendimi gjyqësor të formës së prerë.

Në rrethanat e mësipërme, Kolegjet e Bashkuara të Gjykatës së Lartë arrijnë në konkluzionin, se në veprimet e kërkuësit B. Xh., të lidhura me dosjen civile të sipërpërmendur janë të pranishme “veprimet e kryera në kundërshtim me përmbushjen e rregullt të detyrës si dhe moskryerja e veprimeve të detyrueshme procedurale” të cilat sipas nenit 41/7 të ligjit nr. 8436, datë 28.12.1998 “Për organizimin e pushtetit gjyqësor në Republikën e Shqipërisë” kualifikohen si

“shkelje të disiplinës”. Edhe çmimi i KLD në vështrim të nenit 43 të ligjit të mësipërm, duke marrë masën e “shkarkimit nga detyra” konsiderohet i bazuar në ligj.”.²²⁷

Veprimet e gjyqtarit që u procedua në këtë rast, kishin të bënin me mënyrën e dokumentimit të veprimeve në dosjen gjyqësore, por mbi të gjitha për mënyrën e pezullimit të një vendimi gjyqësor të formës së prerë, masë e cila mund të merret nga gjykatat më të larta dhe vetëm brenda rasteve të përcaktuara qartësisht nga legjislacioni procedural. Pikërisht këto veprime të parregullta më dosjen gjyqësore, sollën edhe procedimin e këtij gjyqtari për këtë lloj shkeljeje.

Shkelje e tillë është konsideruar edhe largimi i një gjyqtari nga procesi, kur trupa gjyqësore ishte mbledhur për të marrë vendimin përfundimtar, siç rezulton nga arsyetimi vijues se *“Me sjelljen e tij ankuesi ka diskredituar rëndë pozitën e gjyqtarit.*

Konkretisht, në kohën që trupi gjykues është tërhequr për të marrë dhe shpallur vendimin përfundimtar, më datën 20.10.2000, ora 14.00, në një çështje civile me palë B. D., paditës dhe K. Z., etj., të paditur, me objekt njohje pronësie, ai ka penguar arbitrarisht dhënien e këtij vendimi.

Fillimisht ai ka këmbëngulur që dy gjyqtarët e tjerë të trupit gjykues të largoheshin nga gjykimi i kësaj çështjeje, megjithëse trupi gjykues ishte tërhequr për dhënien dhe shpalljen e vendimit përfundimtar. Pas refuzimit të tyre, ai është larguar vetë.

Vërtet gjyqtari ka të drejtë të mos marrë pjesë në shqyrtimin e një çështjeje kur ka shkaqe të arsyeshme, por jo kur trupi gjykues është tërhequr për shpalljen e vendimit përfundimtar. Prandaj, me të drejtë kryetarja e Gjykatës së Apelit Korçë, ku ai bënte pjesë si gjyqtar, nuk e ka shqyrtuar kërkesën për dorëheqjen e tij nga gjykimi i çështjes, paraqitur në bazë të neneve 72, pika 6 e paragrafi i fundit dhe 73 të Kodit të Procedurës Civile, të cilat bëjnë fjalë përkatësisht për rastet e përjashtimit të gjyqtarit ose heqjen dorë prej tij nga gjykimi i çështjes, pasi në këtë rast gjykimi ose shqyrtimi i çështjes në kuptim të dispozitave të mësipërme kishte përfunduar, për aq sa ishte mbyllur hetimi gjyqësor e ishin marrë pretendimet e fundit të palëve dhe trupi gjykues ishte shprehur për shpalljen e vendimit më datën dhe orën e caktuar.

Pra, heqja dorë e gjyqtarit nga gjykimi ose shqyrtimi i një çështjeje kërkohet derisa trupi gjykues nuk është tërhequr për marrjen dhe shpalljen e vendimit përfundimtar. Në këtë fazë të fundit gjyqtari është i detyruar të respektojë pozitën e tij si gjyqtar dhe interesin e drejtësisë dhe jo të largohet nga trupi gjykues për shpalljen e vendimit.

Siç del, përveç prezumimit të njohjes së një situatë të tillë si gjyqtar i apelit, ankuesit i është bërë e qartë pse kërkesa e tij për dorëheqje në atë fazë nuk mund të shqyrtohej. Por, megjithatë ai është larguar nga trupi gjykues në kohën kur ky i fundit ishte tërhequr për marrjen dhe shpalljen e vendimit.

227. Vendimi nr. 793, datë 14.07.1999 i Kolegjeve të Bashkuara të Gjykatës së Lartë.

Për shkak të largimit arbitrar të ankuesit, trupi gjykues nuk mundi të merrte dhe shpallte vendimin, gjë që nuk mund ta justifikonte atë përpara palëve ndërgjyqëse dhe opinionit publik që e mori vesh këtë ngjarje. U desh ndërhyrja e Inspektoratit të Këshillit të Lartë të Drejtësisë pas disa ditësh që ankuesi të kthehej dhe të merrte pjesë në trupin gjykues.

Në këto kushte, ai me sjelljen e tij ka diskredituar rëndë pozitën e gjyqtarit.

Përsa i përket pretendimit të ankuesit, se arsyeja kryesore që e detyroi atë të paraqiste kërkesën për dorëheqje ka qenë përpjekja e një personi për ta korruptuar në zyrën e gjykatës, nuk justifikon tërheqjen e tij nga trupi gjykues. Siç del, megjithëse në pozitën e gjyqtarit, ai çuditërisht nuk ka ndjekur rrugën e rregullt ligjore për denoncimin e kësaj vepre dhe të autorit të saj në kohën që pretendohet se ka ndodhur kjo ngjarje dhe të paktën, as nuk ia ka bërë menjëherë prezent këtë ngjarje dy gjyqtarëve të tjerë të trupit gjykues. Vetëm kur i është kërkuar t'i jepte me shkrim shkaqet e largimit nga trupi gjykues, ai, veç qëndrimit të dy gjyqtarëve të mësipërm për mospranimin e kërkesës së të paditurve të paraqitur në kancelarinë e gjykatës pasi trupi gjykues ishte tërhequr për dhënien dhe shpalljen e vendimit përfundimtar, ka përmendur si shkak edhe se atij i ishte bërë një ofertë për t'i dhënë para.

Konstatohet se Këshilli i Lartë i Drejtësisë në këtë rast ka zbatuar një proces të rregullt ligjor, sipas nenit 44 të ligjit nr. 8436, datë 28.12.1998, "Për Organizimin e Pushtetit Gjyqësor në Republikën e Shqipërisë", amenduar me ligjin nr. 8546, datë 05.11.1999 dhe me atë nr. 8656, datë 31.07.2000, duke i vënë në dispozicion ankuesit materialet e plota në afatin e duhur përpara zhvillimit të seancës dhe duke i dëgjuar pretendimet e tij para marrjes së vendimit të mësipërm. Njëkohësisht atij i është respektuar e drejta e ankimit përpara Gjykatës së Lartë kundër vendimit të Këshillit të Lartë të Drejtësisë.

Por, Këshilli i Lartë i Drejtësisë duhej ta kualifikonte sjelljen e ankuesit jo si shkelje e rëndë e disiplinës në punë, por si sjellje që diskrediton rëndë pozitën e gjyqtarit, sipas nenit 147, pika 6 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë.

Megjithatë, vendimi i Këshillit të Lartë të Drejtësisë në themel konsiderohet i drejtë, prandaj duhet të lihet në fuqi".²²⁸

Shkelje në këtë rast është më se e dukshme, për shkak se gjyqtari si pjesë e trupit gjykues, vendosi të largohej në mënyrë të njëanshme në momentin kur u vendos që kjo trupë të tërhiqej për marrjen e vendimit. Në këtë fazë të procesit ajo që pritet nga të gjithë palët dhe publiku është që gjykata të dalë me një vendim. Në këtë fazë tashmë, asnjë nga anëtarët e trupit gjykues individualisht, nga trupa në mënyrë kolektive, si dhe nga palët, nuk mundet që të bëhen më veprime të tjera procedurale. Për këtë arsye, largimi i këtij gjyqtari dhe kërkesa për heqje dorë e tij, me qëllim që të justifikojë këtë veprim, ishin pa asnjë bazë ligjore. Për këtë arsye vendimmarrja e KLD u konsiderua e rregullt.

Një tjetër mënyrë veprimi, që lidhet më këtë lloj shkelje është

228. Vendimi nr. 27, datë 04.04.2001 i Kolegjeve të Bashkuara të Gjykatës së Lartë.

konsideruar edhe mënyra e caktimit të masës së dënimit për të miturit, gjykimin e shkurtuar, masave të sigurimit, mungesës së arsyetimit etj., siç del dhe nga arsyetimi vijues se “Konkretisht, në veprimtarinë e tij si gjyqtar pranë Gjykatës së Apelit Gjirokastrë janë konstatuar shkelje të kërkesave të nenit 51 të K. Penal lidhur me caktimin e masave të dënimit për të mitur. Megjithëse nga ana e Gjykatës së Shkallës së Parë, në vendimin e saj është zbatuar neni 51 i K. Penal, Gjykata e Apelit, në të cilën bënte pjesë si anëtar, kërkuesi K. I., e ka zbatuar atë për herë të dytë. Kështu, me vendimin nr. 12, datë 16.02.2000 të Gjykatës së Apelit Gjirokastrë, ndryshohet vendimi nr. 42, datë 13.12.1999 i Gjykatës së Shkallës së Parë Tepelenë. Për më tepër, kryesuesi i trupit gjykues, duke mos qenë i këtij mendimi, ka dalë në pakicë.

Së dyti, në disa vendime të Gjykatës së Apelit, ku kërkuesi ka qenë relator ose anëtar, janë shkëlur kërkesat e nenit 406 të K. Pr. Penale, duke aplikuar gjykimin e shkurtuar, në një kohë që zbatimi i tij mund të bëhet vetëm nga Gjykata e Shkallës së Parë.

Kështu, me vendimin nr. 68, datë 27.07.2000 të Gjykatës së Apelit Gjirokastrë, ndryshohet vendimi nr. 40, datë 26.06.2000 i Gjykatës së Shkallës së Parë Sarandë, duke aplikuar nenin 406 të K. Pr. Penale, në një kohë që kjo e fundit nuk kishte pranuar kërkesën për gjykim të shkurtuar. Të kësaj natyre janë edhe vendimi nr. 30, datë 02.12.1998, i cili ka ndryshuar vendimin nr. 24, datë 15.10.1998 të Gjykatës së Shkallës së Parë Sarandë, si dhe vendimi nr. 19, datë 14.04.1999 i Gjykatës së Apelit Gjirokastrë, që ka ndryshuar vendimin nr. 2, datë 16.02.1999 të Gjykatës së Shkallës së Parë Përmet, duke aplikuar në mënyrë të gabuar nenin 406 të K. Pr. Penale.

Së treti, në disa vendime të Gjykatës së Apelit, ku kërkuesi ka qenë relator ose anëtar, është bërë zbatim i gabuar i ligjit procedural penal në caktimin dhe zëvendësimin e masës së sigurimit, duke vepruar në kundërshtim me kërkesat e parashikuara në nenet 228 e vijues dhe 260 e vijues të K. Pr. Penale.

Kështu, me vendimin nr. 3, datë 22.04.1998, Gjykata e Apelit Gjirokastrë, ku relator ka qenë kërkuesi, është ndryshuar vendimi i Gjykatës së Shkallës së Parë Tepelenë, me të pandehur V. S., akuzuar për armëmbajtje pa leje, duke caktuar masë sigurimi “arrest në burg” me afat 2-mujor, nga “arrest në burg”. Në këtë rast arsyetohet se... “organi i prokurorisë, pavarësisht nga shpjegimet e dhëna nga i pandehuri, të cilat nuk mund të ndryshohen, duhet të ketë parasysh se kryefamiljar e pjesëtarë të tjerë ekzistojnë në banesë, prandaj dhe arresti duhet dhënë me afat”. Siç shihet, nuk ka asnjë argumentim ligjor se përse bëhet ndryshimi i vendimit.

Me vendimin nr. 11, datë 24.06.1998, Gjykata e Apelit Gjirokastrë, ku relator ka qenë kërkuesi, është ndryshuar vendimi i Gjykatës së Shkallës së Parë Sarandë, me të pandehur R. L., akuzuar për plagosje të rëndë me dashje dhe shkatërrim të pronës me eksploziv, duke caktuar masë sigurimi “arrest në shtëpi”, nga “arrest në burg”. Edhe në këtë rast arsyetimi nuk gjen mbështetje ligjore: “... megjithatë, duke pasur parasysh faktin që i pandehuri ka shkuar

paraprakisht në Manastir së bashku me të tjerë, duhet që t'i lihet në dispozicion të organit procedural për zbardhjen e çështjes, duke caktuar si masë sigurimi më të butë, atë të arrestit në shtëpi”.

Me vendimin nr. 19, datë 14.08.1998, Gjykata e Apelit Gjirokastrë, ku anëtar ka qenë kërkuesi, është ndryshuar vendimi i Gjykatës së Shkallës së Parë Sarandë, me të pandehur O. L., akuzuar për plagosje të rëndë me dashje dhe shkatërrim prone me eksploziv, duke caktuar masë sigurimi “detyrim për paraqitje në policinë gjyqësore”, nga “arrest në shtëpi”. Arsyetim, përsëri pa bazë ligjore. Nga njëra anë thuhet se nuk ekziston asnjë provë e re dhe nga ana tjetër konkludon se i pandehuri është i vetmi person në familje në marrëdhënie pune.

I kësaj natyre është edhe vendimi nr. 5, datë 20.05.1998.

Së katërti, në gjykimin e çështjes civile në shkallë të dytë, duke qenë relator apo anëtar i trupit gjykues, ka lejuar të merren vendime alogjike dhe në shkelje të ligjit material e procedural, të cilat me të drejtë janë prishur nga Kolegji Civil i Gjykatës së Lartë.

Kështu, vendimi nr. 12, datë 20.01.1999 i Gjykatës së Apelit Gjirokastrë, ku relator ka qenë kërkuesi, është prishur me Vendimin nr. 56, datë 26.01.2000 i Kolegjit Civil të Gjykatës së Lartë, me arsyetimin, se është haptazi alogjik. Të tillë janë edhe vendimet nr. 28, datë 27.10.1999, ku kërkuesi ka qenë relator. Ky vendim është prishur me vendimin nr. 1129, datë 14.12.2000 të Kolegjit Civil të Gjykatës së Lartë, me arsyetimin, se është haptazi jologjik dhe është marrë në kundërshtim me ligjin, duke mos u zbatuar orientimet e Gjykatës së Lartë. Po ashtu është vendimi nr. 246, datë 16.10.1998, ku relator ka qenë kërkuesi, i cili ka prishur me vendimin nr. 1133, datë 18.06.1999 i Kolegjit Civil të Gjykatës së Lartë, me arsyetimin, se në gjykim është vepruar në kundërshtim të hapur me përmbajtjen e nenit 75 të K. Pr. Civile, ku përcaktohen procedurat e përjashtimit të gjyqtarëve. Më tej mund të përmendet vendimi nr. 210, datë 09.06.1999, ku relator ka qenë kërkuesi, prishur me Vendimin nr. 729, datë 07.06.1999 të Kolegjit Civil të Gjykatës së Lartë, me arsyetimin, se nuk është bërë analiza e provave, nuk është përcaktuar baza ligjore, nuk ka marrë prova vendimtare, si dhe janë administruar akte pa fuqi provuese. Të tillë janë edhe vendimet nr. 139, datë 29.07.1998, prishur me vendimin nr. 736, datë 03.06.1999 të Kolegjit Civil të Gjykatës së Lartë, Vendimi nr. 159, datë 05.05.1999, prishur me vendimin nr. 484, datë 15.03.2000 i Kolegjit Civil të Gjykatës së Lartë, vendimi nr. 374, datë 03.11.1998, etj.

Duke i parë në tërësi të gjitha këto raste, Kolegjet e Bashkuara të Gjykatës së Lartë arrijnë në përfundimin se në veprimet e kërkuesit K. I., në vështrim të kërkesave të nenit 41/7 të ligjit nr. 8436, datë 28.12.1998 “Për organizimin e Pushtetit Gjyqësor në Republikën e Shqipërisë”, vërehen shkelje të disiplinës në punë, në formën e veprimeve të kryera në kundërshtim me përmbushjen e rregullt të detyrës, si dhe mungesë profesionalizmi. Këto veprime janë të papajftueshme me funksionin e gjyqtarit, si dhe përbëjnë shkelje sistematike në ushtrimin e detyrës”.²²⁹

229. Vendimi nr. 61, datë 27.06.2001 i Kolegjeve të Bashkuara të Gjykatës së Lartë.

Nga analiza e mësipërme, vihen në dukje një seri shkeljesh të rënda në ushtrimin e detyrës nga gjyqtari që po procedohej, duke treguar mangësi të theksuara në respektimin e ligjit dhe në zbatimin e procedurave të parashikuara. Në veprimtarinë e tij si gjyqtar i Gjykatës së Apelit Gjirokastrë, ky gjyqtar kishte kryer veprime që bien ndesh me kërkesat ligjore, duke shfaqur një mungesë të dukshme profesionalizmi.

Shkeljet e tij përfshinin aplikimin e gabuar të dispozitave të Kodit Penal dhe Procedurës Penale, sidomos në lidhje me gjykimin e të miturve, me zbatimin e dispozitave të Kodit Penal në mënyrë të paarsyetuar dhe pa bazë ligjore. Në disa raste, masa e sigurimit ishte caktuar apo zëvendësuar në kundërshtim me parashikimet e Kodit të Procedurës Penale, duke shfaqur një vullnet për të keqinterpretuar ligjin. Edhe në fushën civile shkeljet ishin aq të rënda, sa që shumë prej këtyre vendimeve u prishën nga Kolegji Civil i Gjykatës së Lartë, duke theksuar mangësinë e argumentimit dhe zbatimin e ligjit. Sjellja e tij tregoi një mungesë të theksuar të profesionalizmit dhe një paaftësi për të përmbushur detyrat, që lidhen me funksionin e lartë të një gjyqtari. Në tërësi veprimet dhe qëndrimi i këtij gjyqtari u konsideruan të papajtueshme me standardet që kërkoheshin nga një përfaqësues i sistemit gjyqësor, duke sjellë edhe largimin e tij nga detyra.

Raste të tjera, ku nga një gjyqtar janë cenuar në mënyrë të vazhdueshme normat procedurale, në disa lloje të ndryshme çështjes, janë konstatuar përsëri në praktikën gjyqësore, siç mund të shihet në rastin vijues se *“Këshilli i Lartë i Drejtësisë e ka marrë vendimin e mësipërm, për shkak se gjyqtari B. Ç., në periudhën 1998-2000 ka kryer veprime që diskreditojnë rëndë pozitën e gjyqtarit. Në gjykimin e shumë çështjeve civile ka dhënë vendime haptazi në kundërshtim me ligjin, alogjike dhe të pazbatueshme. Konkretisht:*

- *Me vendimin nr. 1129, datë 14.12.1999, Gjykata e Lartë ka prishur vendimin nr. 28, datë 27.10.1999 të Gjykatës së Apelit Gjirokastrë, sepse ky vendim ishte dhënë në kundërshtim me ligjin dhe ishte haptazi alogjik. Në marrjen e këtij vendimi nuk janë zbatuar udhëzimet e Gjykatës së Lartë.*
- *Me vendimin nr. 56, datë 26.01.2000 Gjykata e Lartë ka prishur vendimin nr. 12, datë 20.01.1999 të Gjykatës së Apelit Gjirokastrë, për shkak se ishte haptazi alogjik, në kundërshtim me provat e administruara në dosje.*
- *Me vendimin nr. 1133, datë 18.06.1999 Gjykata e Lartë ka prishur vendimin nr. 246, datë 16.10.1998 të Gjykatës së Apelit Gjirokastrë, sepse në gjykim është vepruar në kundërshtim të hapur me procedurat e përjashtimit të gjyqtarëve. Nga ana e paditësit është kërkuar përjashtimi i dy gjyqtarëve, ankuesit B. Ç., dhe K. I. Nga gjyqtarja e tretë M. H., dhe gjyqtari K. I., është shqyrtuar në fillim kërkesa*

për përjashtimin e ankuesit, gjyqtarit B. Ç., dhe është vendosur mos përjashtimi i këtij të fundit. Më pas, gjyqtari B.Ç. dhe gjyqtarja M. H., kanë vendosur mospërjashtimin e gjyqtarit K. I., duke vepruar në kundërshtim të hapur me nenin 75 të Kodit të Procedurës Civile.

- Me vendimin nr. 729, datë 07.06.2000 Gjykata e Lartë ka prishur vendimin nr. 210, datë 09.06.1999 të Gjykatës së Apelit Gjirokastrë, sepse kjo e fundit nuk ka bërë analizën e provave, nuk ka marrë prova vendimtare të kërkuara nga palët për zgjidhjen e çështjes, si dhe ka administruar akte pa fuqi provuese, të pavërtetuara sipas kërkesave të nenit 255 të Kodit të Procedurës Civile.
- Me vendimin nr. 736, datë 03.06.1999 Gjykata e Lartë ka prishur vendimin nr. 139, datë 29.07.1998 të Gjykatës së Apelit Gjirokastrë, për shkak se ishte alogjik dhe i pazbatueshëm.
- Me vendimin nr. 47, datë 27.01.2000 Gjykata e Lartë ka prishur vendimin nr. 389, datë 09.12.1998 të Gjykatës së Apelit Gjirokastrë, për shkak se ky vendim ishte haptazi i kundërligjshëm dhe arsyetimi i tij haptazi jologjik. Kështu, paditësi ka paditur Bankën e Kursimeve Sarandë ku punonte si shofer për t'i kthyer 585.000 lekë, me pretendimin se kishte riparuar automjetin pas një përplasje që kishte bërë në vitin 1996. Kërkimet e tij jo vetëm që ishin të pabazuara në ligj, por ai nuk kishte paraqitur asnjë lloj dokumenti për t'i provuar ato. Në këto rrethana gjykata e faktit ia kishte rrëzuar atij padinë, ndërsa Gjykata e Apelit Gjirokastrë ka ndryshuar vendimin dhe ka pranuar padinë, duke shkelur haptazi ligjin. Gjykata e Lartë ka prishur vendimin e Gjykatës së Apelit dhe ka lënë në fuqi vendimin e gjykatës së faktit.

Ankuesi ka dhënë edhe vendime të tjera civile në kundërshtim të hapur me ligjin dhe haptazi alogjike.

Edhe në gjykimin e çështjeve penale ai ka dhënë vendime haptazi në kundërshtim me ligjin.

Kështu, me vendimin nr. 12, datë 16.02.2000 Gjykata e Apelit Gjirokastrë ka vendosur ndryshimin e vendimit nr. 42, datë 13.02.2000 të Gjykatës së Rrethit Tepelenë, duke aplikuar për të dytën herë nenin 51 të Kodit Penal, në favor të të pandehurve të akuzuar për vjedhje me dhunë në bashkëpunim e armëmbajtje pa leje. Megjithatë Gjykata e Rrethit Tepelenë ka përmendur si në arsyetim, ashtu edhe në dispozitiv zbatimin e nenit 51 të Kodit Penal, duke i ulur të pandehurve të mitur gjysmën e masës së dënimit, Gjykata e Apelit Gjirokastrë në kundërshtim të hapur me ligjin ka përgjysmuar padrejtësisht masën e dënimit të dhënë ndaj tyre. Në këtë rast veprimet e ankuesit, gjyqtarit B. Ç., janë komprometuese për drejtësinë, edhe për faktin, sepse atij i është bërë e qartë nga kryesuesi i seancës që ka dalë në pakicë, se përgjysmimi i masës së dënimit ishte bërë një herë nga gjykata e shkallës së parë, prandaj nuk mund të zbatohet për të dytën herë.

Ankuesi në disa raste ka vepruar në kundërshtim të hapur me ligjin për

kaktimin dhe zëvendësimin e masave të sigurimit.

Pretendimi i tij se Këshilli i Lartë i Drejtësisë ka tejkaluar kompetencat e veta, duke i hyrë vlerësimit të ligjshmërisë dhe besueshmërisë së këtyre vendimeve të formës së prerë dhe të pacenuara nga një instancë më e lartë gjyqësore, është i pabazuar sepse:

Këto vendime, pavarësisht se kanë marrë formë të prerë për çështje konkrete, janë shoqëruar me shkelje që diskreditojnë rëndë pozitën e gjyqtarit dhe autoritetin e pushtetit gjyqësor në tërësi. Ato kanë cenuar gjithashtu edhe kredibilitetin e pushtetit gjyqësor në dhënien e drejtësisë. Në këto raste Këshilli i Lartë i Drejtësisë nuk ka pengesë të marrë çdolloj mase disiplinore ndaj gjyqtarëve, pa e kushtëzuar atë me faktin nëse këto vendime kanë marrë formë të prerë. Nga ana tjetër, përderisa shkeljet e konstatuara në këto vendime shqyrtohen, mbi ankimin e gjyqtarit të shkarkuar, nga Kolegjet e Bashkuara të Gjykatës së Lartë, si autoriteti më i lartë i pushtetit gjyqësor në dhënien e drejtësisë në Shqipëri, kjo është një garanci për të shmangur çdo vlerësim të gabuar të këtyre shkeljeve nga Këshilli i Lartë i Drejtësisë.

Këshilli i Lartë i Drejtësisë, ndryshe nga sa pretendon ankuesi, me të drejtë i ka vlerësuar veprimet e mësipërme jo si gabime të zakonshme, që kanë ardhur nga mungesa e përvojës së tij në detyrën e gjyqtarit, por si shkelje me dashje, që diskreditojnë rëndë pozitën e gjyqtarit. Ankuesi ka pasur një përvojë jo të paktë si gjyqtar i Gjykatës së Apelit, gjë që nuk e justifikon në kryerjen e shkeljeve të mësipërme.

Pretendimi i ankuesit se vendimi që përmendet për zbatim të gabuar të nenit 51 të Kodit Penal është lënë në fuqi nga Gjykata e Lartë, nuk ka lidhje me vendimin nr. 12, datë 16.02.2000 të Gjykatës e Apelit Gjirokastër, i përmendur si vendim haptazi në kundërshtim me ligjin. Ky pretendim i referohet një vendimi tjetër të asaj gjykate, me nr. 53, datë 20.06.2000, të lënë në fuqi me vendimin nr. 520, datë 14.12.2000 të Gjykatës së Lartë dhe nuk përmendet në vendimin nr. 109/1, datë 11.05.2001 të Këshillit të Lartë të Drejtësisë.

...

Vendimi lidhur me zbatimin e nenit 406/1 të Kodit të Procedurës Penale, mbi gjykimin të shkurtuar, nuk duhet t'i shtohet listës së vendimeve që përmbajnë shkeljet e bëra nga ankuesi, përderisa ky vendim është lënë në fuqi sepse nuk është pranuar rekursi i prokurorit nga Gjykata e Lartë. Megjithatë, ky rast nuk ndikon në masën e shkarkimit nga detyra të ankuesit në e gjyqtarit, si dhe përbëjnë shkelje sistematike në ushtrimin e detyrës”²³⁰

Siç rezulton nga arsyetimi i mësipërm, shkeljet e konstatuara, përfshirë rastet e përsëritura të mosrespektimit normave procedurale, janë të ngjashme me raste të tjera, të cituara më sipër, ku gjyqtarët janë përballur me masa disiplinore për sjellje të ngjashme. Këto mangësi nuk mund të justifikoheshin si pasojë e mungesës së përvojës, duke qenë subjekti që po procedohet gjyqtar në gjykatën e apelit, por u cilësuan si veprime të

230. Vendimi nr. 73, datë 27.06.2001 i Kolegjeve të Bashkuara të Gjykatës së Lartë.

qëllimshme që dëmtonin rëndë autoritetin e pushtetit gjyqësor.

Në një tjetër rast, Gjykata e Lartë ka konsideruar shkelje zëvendësimit e masës së sigurisë, nga “arrest me burg”, në një masë shumë më të lehtë, “detyrim paraqitje”, nga gjyqtarja e shkallës së parë, kur ky vendim u dha disa ditë, pasi Gjykata e Lartë kishte miratuar vendimin e gjykatave më të ulëta, për të caktuar masën e sigurisë “arrest me burg” pa afat. Më konkretisht, Gjykata e Lartë ka arsyetuar se “Gjyqtarja A. D., me vendimin nr. 59, datë 15.02.2001 ka vendosur zëvendësimit e masës së sigurimit për të pandehurin K. H., në një masë më të lehtë, nga arrest në burg në detyrimin për t’u paraqitur në policinë gjyqësore një herë në çdo dy javë, si dhe ka urdhëruar lirimin e menjëhershëm të tij.

Gjykata e Lartë, me vendimin nr. 63, datë 02.02.2001, po për këtë të pandehur kishte vendosur miratimin e vendimit nr. 23, datë 21.02.2001 të Gjykatës së Rrethit Fier, me të cilin ishte caktuar si masë sigurimi “arrest në burg” pa afat.

Kështu gjyqtarja A. D., vetëm pas disa ditësh nga dhënia e vendimit të sipërm të Gjykatës së Lartë, në kundërshtim të hapur me kërkesat e nenit 260 të K. Pr. Penale, ka zëvendësuar masën e sigurimit, në një kohë që asnjë nga rrethanat për zbutjen e masës së sigurimit, nuk kishte ndryshuar.

Duke pasur parasysh rrezikshmërinë e madhe shoqërore të pandehurit, i cili ndërkohë akuzohej edhe për vepra të tjera penale të rënda, si mbajtje të lëndëve narkotike, parashikuar nga neni 283 të K. Penal dhe armëmbajtje pa leje parashikuar nga neni 278 i K. Penal, del që kjo gjyqtare të ketë vepruar me dashje në kundërshtim me ligjin.

Pavarësisht se KLD e ka shkarkuar gjyqtaren vetëm për dhënien e këtij vendimi, vlerësohet se ky rast është më se i mjaftueshëm, që tregon për një qëndrim jo serioz në kryerjen e detyrës së gjyqtarit dhe që diskrediton rëndë këtë pozitë.

Fakti që vendimi i mësipërm, datë 15.02.2001 ka marrë formë të prerë nuk do të thotë, që shkeljet haptazi në kundërshtim me ligjin, që shoqërojnë këtë vendim, të mos përbëjnë shkak për shkarkim nga detyra.

Është e vërtetë që vendimet gjyqësore të formës së prerë kanë fuqinë e ligjit, përse kohë që nuk janë prishur ose ndryshuar nga gjykata më e lartë. Por, në rastet kur këto vendime janë shoqëruar me shkelje ligjore, që diskreditojnë rëndë figurën e gjyqtarit dhe cenojnë prestigjin e pushtetit gjyqësor, KLD ka kompetenca të plota të marrë çdolloj mase disiplinore, pa e kushtëzuar atë me faktin se, këto vendime kanë marrë formë të prerë.

Prandaj, vendimi i sipërm i KLD konsiderohet konform nenit 147/6, të Kushtetutës, dhe masa disiplinore e zgjedhur është e drejtë”.²³¹

Në një tjetër rast janë konsideruar shkelje të këtij lloji, mbajtja dhe zvarritja e çështjeve të ndryshme, veçanërisht duke i lënë ato pa veprime për një kohë tepër të gjatë. Kështu sipas arsyetimit të Gjykatës së Lartë,

231. Vendimi nr. 77, datë 27.06.2001 i Kolegjeve të Bashkuara të Gjykatës së Lartë.

në këtë rast ka rezultuar se “Nga inspektorë të KLD-së në muajin dhjetor 2000 është ushtruar kontroll në Gjykatën e Rrethit Fier dhe për paditësin është konstatuar, se kishte në gjykim një numër të konsiderueshëm çështje civile, shumë prej të cilave mbaheshin pa asnjë veprim nga viti 1999. Kështu, nga 104 çështje, 12 të tilla i përkisnin vitit 1999 dhe të tjera vitit 2000. Përveç zvarritjeve të kësaj natyre, ka pasur edhe shumë çështje të tjera po brenda kësaj periudhe, për të cilat janë kryer vetëm veprimet përgatitore dhe nuk janë vënë më në lëvizje për një kohë të gjatë prej afro 1 vit e gjysmë. Shkeljet e konstatuara janë pranuar edhe nga vetë paditësi pa asnjë kontestim, por ky i fundit është përpjekur t’i justifikojë ato me mbingarkesën në punë, apo natyrën e komplikuar të çështjeve. Mbajtja dhe zvarritja e çështjeve për gjykim, sikundër paraqitet për një kohë tepër të gjatë, është e pajustificuar dhe tregon se paditësi nuk ka ndjerë përgjegjësinë e detyrës që kryente. Ai nuk ka ndjekur ecurinë e proceseve gjyqësore për t’i përballuar ato në kohë normale dhe, sipas konstatimeve të grupit të inspektorëve, rezulton që zvarritje të tilla nuk kanë qenë për raste të veçanta dhe të shkëputura, por vazhde e gjithë punës së tij, çka tregon për neglizhencë dhe veprime me dashje të gjyqtarit që vijnë në kundërshtim me përmbushjen e rregullt të detyrës dhe diskreditojnë pozitën e tij.

Ndryshe nga sa kërkon paditësi, puna e tij nuk do të vlerësohet e krahasuar me rezultatet e gjyqtarëve të tjerë të po asaj gjykate. Puna e secilit gjyqtar, në vetvete, do të vlerësohet me kërkesat e ligjit dhe pajtueshmërinë e saj me funksionin e gjyqtarit, dhe nëse nuk rezulton e tillë, ajo përbën edhe shkak për lirim nga detyra të gjyqtarit, sikundër është vepruar edhe për rastin konkret për paditësin.

Lidhur me dy vendime penale për vlerësim të arrestit në flagrancë dhe caktimin e masës së sigurimit, nuk kanë qenë të vetmet që përmenden për shkelje dhe veprime në kundërshtim me përmbushjen e rregullt të detyrës. Prandaj, ndryshe nga sa pretendon paditësi, pa hyrë në besueshmërinë e tyre, sido që të kenë qenë, ndikimi i tyre nuk ka qenë vendimtar, sepse largimi nga detyra i paditësit mbështetet kryesisht në zvarritje të theksuara në gjykim, që në kushtet që paraqiten, diskreditojnë rëndë figurën e gjyqtarit dhe përligjin masën e marrë edhe sipas nenit 147, pika 6 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë”.²³²

Rasti i mësipërm është ai tipik, që tregon për mospërmbushje të rregullt të detyrës, nga ana e gjyqtarit. Interesante është edhe qasja që veprimet e këtij gjyqtari nuk do të krahasohen me ato të kolegëve të tij të tjerë, por nëse kjo sjellje ishte apo jo në përputhje me funksionet gjyqësore. Duke pasur në konsideratë zvarritjen e jashtëzakonshme të shumë çështjeve gjyqësore, që ishin lënë pa veprime, atëherë masa e shkarkimit nga detyra ishte më se e përligjur.

Mospërmbushje e detyrës është konsideruar edhe mosrespektimi i rregullave për pushimin e çështjeve apo rikualifikimin e veprave penale, caktimin e masave të sigurimit, siç arsyetohet në rastin vijues se

232. Vendimi nr. 86, datë 27.06.2001 i Kolegjeve të Bashkuara të Gjykatës së Lartë.

“Konkretisht, në veprimtarinë e saj si gjyqtare pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Vlorë, janë konstatuar shkelje të dukshme të kërkesave të parashikuara në nenin 387 të K. Pr. Penale, ku përcaktohen rastet e vendosjes së pushimit të çështjes penale.

Kështu, me vendimin nr. 163, datë 20.07.2001 të Gjykatës së Shkallës së Parë Vlorë, ku anëtare e trupit gjykues ishte edhe kërkuesja A. F., është pushuar çështja penale me të pandehur V. Q. Ky i fundit akuzohej për veprën penale të vjedhjes me armë, kryer në bashkëpunim, parashikuar nga nenet 140 të 25 i K. Penal. Duke parë këtë vendim, rezulton se në rastin konkret nuk ka qenë asnjë nga kushtet e parashikuara nga neni 387 i K. Pr. Penale, të cilat lidhen me mos fillimin ose mos vazhdimin e ndjekjeve penale, si dhe kur vepra penale është shuar. I gjithë «arsyetimi», që mundohet të bëjë gjykata, nuk lidhet dhe nuk përlligj marrjen e vendimit për pushimin e çështjes. Për më tepër, përfundimet që jepen në atë vendim, mund dhe duhet të nxirren vetëm pas shqyrtimit gjyqësor të saj. Me të drejtë më pas, mbi ankimin e paraqitur nga ana e prokurorit, Gjykata e Apelit Vlorë, në përputhje me kërkesat e nenit 428/ç të K. Pr. Penale, ka vendosur prishjen e vendimit dhe kthimin e akteve për vazhdimin e gjykimit.

Më tej, në një sërë vendimesh të tjera gjyqësore, ku kërkuesja ka qenë kryesuese ose anëtare, janë bërë përcaktime juridike haptazi të gabuara, duke vepruar në kundërshtim me kërkesat e nenit 375 të K. Pr. Penale.

Kështu, në disa gjykime që lidhen me bimën narkotike të njohur me emrin “Canabis sativa”, është vendosur ndryshimi i përcaktimit juridik të veprës penale, nga ajo e parashikuar nga neni 283/1 në atë të parashikuar nga neni 285 të K. Penal. Në këto raste nuk është pasur parasysh ligji nr. 7975, datë 26.07.1995 “Për Barnat narkotike dhe lëndët psikotrope”, si dhe Konventa Evropiane për Barnat narkotike, nga ku del qartë se bima e përmendur përfshihet në listën e lëndëve narkotike. Për më tepër, nuk është mbajtur parasysh qëndrimi i praktikës së Kolegjit Penal të Gjykatës së Lartë përsa i përket cilësimit juridik të veprës penale.

Duke parë gjykimet që lidhen me këtë bimë narkotike, vihet re se në çdo rast është kërkuar kryerja e ekspertimit, i cili ka arritur në përfundimin e drejtë se bëhet fjalë për “Canabis sativa”, bimë kjo, që në përputhje me Ligjin dhe Konventën e cituar më sipër, klasifikohet në kategorinë e «Barnave narkotike». Megjithëse administrohet një akt ekspertimi i tillë, gjykata nuk mbështetet në konkluzionet e tij, por vendos ndryshe, pa kërkuar një ri ekspertim apo pa argumentuar se përse nuk i pranon përfundimet e tij.

Aplikimi i një mase dënimi që nuk i përgjigjet rëndësisë e rrezikshmërisë shoqërore të veprës dhe autorit të saj, është një tjetër veprim i papranueshëm nga ana ligjore. Kjo ka sjellë që të jepen dënime minimale, të cilat më pas janë ndryshuar thuajse të gjitha nga ana e gjykatës së apelit.

Të tilla vendime kanë qenë ato me nr. 171, datë 26.07.2001, nr. 120, datë 30.05.2001, nr. 138, datë 26.06.2001, nr. 151, datë 06.07.2001, nr. 173, datë 13.09.2001, nr. 174, datë 14.09.2001, nr. 176, datë 17.09.2001 dhe nr. 201, datë 22.10.2001, të gjitha të ndryshuara nga Gjykata e Apelit Vlorë.

Përafërsisht e njëjta gjë, por në një këndvështrim tjetër, ka ndodhur edhe me vendimin nr.1, datë 5 janar 2001 të Gjykatës së shkallës së parë Vlorë, ku bëhet ndryshimi i cilësimit juridik të veprës, në kundërshtim me kërkesat e parashikuara nga neni 375 i K. Pr. Penale.

Kështu, gjatë gjykimit të çështjes me të pandehur A. Sh., akuzuar për veprën penale të vrasjes me paramendim, mbetur në fazën e tentativës, parashikuar nga nenet 78 e 22 të K. Penal, pa shkaqe të motivuara, kërkohet kryerja e ri ekspertimit mjekoligjor, rrjedhojë e të cilit ishte ndryshimi i akuzës në plagosje të lehtë me dashje. Edhe ky vendim, si dhe të parët është cenuar nga Gjykata e Apelit Vlorë.

Së fundi, janë vërejtur raste të shkeljes së kërkesave të parashikuara nga nenet 228, 229 dhe 230 të K. Pr. Penale, që kanë të bëjnë me kushtet, kriteret dhe kriteret e veçanta për caktimin e masave të sigurimit.

Evidente këto shkelje vërehen në vendimin nr. 266, datë 30 dhjetor 2000, ku kërkuesja, në cilësinë e gjyqtarës së vetme, cakton masë sigurimi "arrest në shtëpi", ndaj të pandehurve F. dhe A. L. Dy të pandehurit, të kërkuar nga ana e prokurorisë italiane, akuzoheshin për trafik lëndësh narkotike. Megjithëse nga shqyrtimi i çështjes, rezultonin dyshime të arsyeshme të bazuara në prova, në vendimin e cituar më sipër të marrë nga kërkuesja, «arsyetohet» e kundërta, pramungesa e dyshimit të arsyeshëm dhe aplikohet masë sigurimi ajo e «arrestit në shtëpi». Edhe ky vendim është cenuar nga ana e Gjykatës së Apelit, duke u aplikuar masa e sigurimit "arrest në burg".

Duke i parë në tërësi të gjitha këto raste, Kolegjet e Bashkuara të Gjykatës së Lartë, arrijnë në përfundimin se në veprimet e kërkueses A. F., në vështrim të kërkesave të nenit 47/1 të ligjit nr. 8436, datë 28.12.1998 "Për organizimin e Pushtetit Gjyqësor në Republikën e Shqipërisë", vërehen shkelje të disiplinës në punë, në formën e veprimeve të kryera në kundërshtim me përmbushjen e rregullt të detyrës, si dhe mungesë e theksuar profesionalizmi. Këto veprime janë të papajtueshme me funksionin e gjyqtarit, si dhe përbëjnë shkelje sistematike në ushtrimin e detyrës.

...

Së dyti, pretendohet se shkeljet e parashtruara në materialin e KLD-së, kanë të bëjnë me bindjen e brendshme të gjyqtarit dhe se jo çdo vendim i prishur nga gjykata më e lartë mund të shërbejë si shkak për largim nga detyra.

Edhe ky pretendim është i pambështetur dhe nuk mund të pranohet. Siç u analizua, të gjitha rastet e përmendura më sipër, bëjnë fjalë për veprime haptazi në kundërshtim me ligjin. Kur kjo e fundit është e qartë dhe nuk respektohet e zbatohet, kur në mënyrë të vazhdueshme vendimet përsa i përket cilësimit juridik për një kategori vepre penale, të cenohen nga ana e Gjykatës së Apelit, kur praktika e Gjykatës së Lartë është e qartë dhe e ndryshme, atëherë nuk ka vend për përfundimin se kemi të bëjmë vetëm me bindje të brendshme të gjyqtarit. I njëjti konkluzion vlen edhe për pretendimin tjetër që bën fjalë për periudhën e shkurtër kohore në detyrë".²³³

233. Vendimi nr. 85, datë 20.11.2002 i Kolegjeve të Bashkuara të Gjykatës së Lartë.

Nga pasazhet e mësipërme, kuptohet që, gjyqtarja që po procedohej, ka shfaqur problematika të shumta në veprimtarinë e saj profesionale, të cilat kanë sjellë jo vetëm cenimin e standardeve ligjore, por edhe diskreditimin e funksionit të saj si gjyqtare. Në aktivitetin e saj gjyqësor janë konstatuar shkelje të dukshme të parimeve dhe dispozitave ligjore, duke përfshirë vendime, të cilat kanë anashkaluar ose keqinterpretuar qartësisht normat e Kodit të Procedurës Penale dhe të Kodit Penal. Kjo duket qartë, në mënyrën e pushimit të një çështjeje penale, në mënyrën e ndryshimit të cilësimit juridik të veprave penale, sidomos ato të lidhura me trafikimin e lëndëve narkotike, ku nuk u morën në konsideratë aktet ndërkombëtare dhe kombëtare për klasifikimin e tyre. Qasja e gjyqtarës në këto raste ishte edhe kundër jurisprudencës së konsoliduar të Gjykatës së Lartë. Qëndrimi i saj joprofesional dukej, edhe në mënyrën e caktimit të masave të sigurimit, që ishin shfuqizuar nga gjykata e apelit, pasi nuk ishte arsyetuar siç duhet, “dyshimi i arsyeshëm i bazuar në prova”. Këto praktika tregojnë për një vijimësi shkeljesh, mungesë të theksuar profesionalizmi dhe një qëndrim të papajtueshëm me standardet e kërkuara për një funksionar të tillë.

E njëjta qasje u ruajt nga KLD dhe më pas Gjykata e Lartë, edhe për anëtarët e tjerë të trupit gjykues.²³⁴

Në një tjetër rast, Gjykata e Lartë ka arsyetuar se “Siç del nga shqyrtimi i materialeve të ndodhura në dosjen civile, paditësja i është nënshtruar procedimit disiplinor me pretendimin se ajo në veprimtarinë e saj si gjyqtare e Gjykatës së Apelit ka shkelur kërkesat ligjore procedurale-materiale penale dhe civile dhe konkretisht:

1. Që kanë të bëjnë me gjykimin e shkurtuar;
2. mbi caktimin e masave të sigurimit;
3. mbi caktimin e dënimit;
4. lidhur me lirimin para kohe me kusht;
5. në argumentimin dhe analizën e fakteve për dhënien e vendimit gjyqësor; pretendime të cilat ana e paditur (si bartëse e provës) u përpoq t’i provonte gjatë gjykimit të çështjes.

Në mbështetje të pretendimeve të mësipërme gjatë gjykimit u paraqitën edhe mjaft vendime gjyqësore që i referohen, d.m.th. provojnë shkeljet e përmendura më sipër. Kështu, me vendimin nr. 30, datë 21.07.1998 të Gjykatës së Apelit Gjrokastër është ulur 1/3 e masës së dënimit për të pandehurin V. B., pasi këtij të fundit i ishte refuzuar kërkesa për pranimin e gjykimit të shkurtuar. Ose më tej me vendimin nr. 19, datë 14.04.1999 të po asaj gjykate është aplikuar neni 406 i K. Pr. Penale dhe është ulur 1/3 e masës së dënimit për të pandehurin K. A., i dënuar me 20 vjet burgim për veprën penale të vrasjes.

Paditësja ka pretenduar se ajo ka qenë anëtare e trupit gjykues, pra se nuk ka ndonjë përgjegjësi.

234. Vendimi nr. 88, datë 18.11.2002 i Kolegjeve të Bashkuara të Gjykatës së Lartë.

Duke parë konkretisht vendimet e mësipërme konstatohet se aplikimi i Nenit 406 të K. Pr. Penale ka qenë në kundërshtim me përmbajtjen e tij. Pavarësisht se paditësja ka qenë anëtare e trupit gjykues, përsëri ajo është përgjegjëse për dhënien e vendimit gjyqësor, vendim i cili përmban edhe dëshirën dhe vullnetin e paditëses.

Edhe duke parë praktikën lidhur me zbatimin e dispozitave për lirimin para kohe me kusht, konstatohen shkelje dhe zbatim i gabuar i ligjit. Kështu, me vendimin nr. 63, datë 15.02.1999 është zbatuar lirimi para kohe me kusht i një të pandehuri, i cili ishte dënuar për veprën penale të vjedhjes me dhunë në bashkëpunim.

Shkelje dhe të meta konstatohen edhe në çështjet civile. Në këtë rast, të metat janë konstatuar nga Gjykata e Lartë (ish-Kasacionit), e cila ka mbajtur qëndrim ndaj këtyre shkeljeve duke e konsideruar arsyetimin e vendimit në mjaft raste si alogjik, kontradiktor e për rrjedhojë të pa ekzekutueshëm.

Duke i parë në tërësinë e tyre rastet e paraqitura, Kolegjet e Bashkuara të Gjykatës së Lartë arrijnë në përfundimin se në veprimet e paditëses, në vështrim të kërkesave të nenit 47/1 të ligjit nr. 8436, datë 28.12.1998 "Për organizimin e pushtetit gjyqësor në RSH" vërehen shkelje të disiplinës në punë, në formën e veprimeve në kundërshtim me përmbushjen e rregullt të detyrës, si edhe një mungesë e theksuar profesionalizmi, veprime të cilat bien ndesh me funksionin e gjyqtarit dhe që përbëjnë shkak të fillimit të procedimit disiplinor.

Në rrethanat e mësipërme, edhe masa e marrë nga ana e paditur është e drejtë dhe e ligjshme.

Paditësja pretendoi se ajo ka qenë thjesht anëtare e trupit gjykues.

Një pretendim i tillë nuk e shkarkon atë nga përgjegjësia, pasi siç analizuam edhe më sipër, ajo është pjesëmarrëse në dhënien e vendimit dhe ka pasur po atë bindje dhe ndërgjegje juridike, si anëtarët e tjerë në dhënien e vendimit. Në rastin konkret mund të flitet për një qëndrim jo në konformitet me ligjin nga gjithë trupi gjykues. Por, përsëri kjo nuk e shkarkon paditësen nga përgjegjësia, pasi ajo është personale.

Po ashtu, pretendimi se disa vendime pas prishjes, d.m.th. kthimit për rigjykim, nga Gjykata e Lartë kanë pasur të njëjtën zgjidhje, përsëri nuk e mënjanon paditësen nga përgjegjësia. Mund të jetë e vërtetë që mosmarrëveshja objekt gjykimi të ketë pasur të njëjtën zgjidhje, porse gjykata ka ndryshuar dhe është dhënë një tjetër vendim, pasi vendimi i parë është pranuar se ka qenë i gabuar".²³⁵

Nga arsyetimi i mësipërm, reflektohen qartazi problematikat në ushtrimin e detyrës nga gjyqtarja që po procedohej, duke evidentuar shkelje të shumta në zbatimin e ligjit dhe një mungesë të theksuar profesionalizmi. Veprimet e saj si anëtare e trupave gjykues tregojnë për vendime të dhëna në kundërshtim me dispozitat ligjore, si në çështjet penale ashtu edhe në ato civile. Shkeljet përfshijnë zbatimin e gabuar të

²³⁵. Vendimi nr. 89, datë 11.11.2002 i Kolegjeve të Bashkuara të Gjykatës së Lartë.

gjykimit të shkurtuar, caktimin e masave të sigurimit dhe lirimin para kohe me kusht, ku në disa raste dënimet u ulën padrejtësisht për të pandehurit e akuzuar për vepra të rënda, si vrasja dhe vjedhja me dhunë. Këto vendime, janë rishqyrtuar, prishur ose ndryshuar nga gjykatat më të larta. E rëndësishme në këtë vendim është pohimi që një gjyqtar nuk mundet që të justifikohet me faktin se ajo ishte vetëm një anëtare e trupit gjykues, pasi si gjyqtare ajo mbante përgjegjësi individuale për pjesëmarrjen në vendimet përfundimtare.

Në një tjetër rast, janë konstatuar shkelje në kundërshtim me përmbushjen e rregullt të detyrës, marrja e vendimeve haptazi në kundërshtim me ligjin, kur pezullimi i ekzekutimit ishte bazuar në një akt ekzaminimi, të kërkuar në rrugë private dhe të lëshuar shumë kohë përpara se të jepej vendimi gjyqësor, siç rezulton nga arsyetimi vijues se *“Si shkak për marrjen e masës së mësipërme është dhënia e një vendimi haptazi në kundërshtim me ligjin. Konkretisht, me vendimin nr. 297, datë 09.12.2002 të Gjykatës së Rrethit Fier, të dhënë nga ankuesi si gjyqtar i vetëm, është bërë njohja e vendimit penal nr. 26/99, datë 25.10.1999 të Gjykatës Penale të Milanos - Itali për të dënuarin A. K., duke e konvertuar dënimin me burgim të përjetshëm të dhënë nga kjo gjykatë me 21 vjet heqje lirie. Në datën 23.12.2002, nga ana e mbrojtësit të të dënuarit është kërkuar pezullimi i ekzekutimit të vendimit të mësipërm për shkak të gjendjes shëndetësore të të dënuarit. Kërkesa shoqërohej nga një akt ekzaminimi psikiatriko-ligjor, datë 27.12.2001, i lëshuar nga ekspertë psikiatër ligjorë të njohur, mbi bazën e kërkesës së një avokati. Konkluzioni i aktit ishte se i dënuari vuante nga një sëmundje psikike, e cila përsëritet në mënyrë ciklike dhe që në periudhat e përsëritjes duhet të trajtohet në kushte spitalore. Sipas tij, personi i ekzaminuar nuk mban përgjegjësi para ligjit.*

Nisur nga konkluzionet e këtij ekspertimi dhe duke pyetur në seancë gjyqësore, me cilësinë e dëshmitarit, njërin prej specialistëve që kanë lëshuar atë, në datën 26 dhjetor 2002, gjykata ka vendosur pezullimin e ekzekutimit të vendimit të dhënë në ngarkim të A. K. Këtë vendim gjykata e ka marrë duke u bazuar në nenin 476 të K. Pr. Penale. Organet e policisë, të cilat kanë bërë ndalimin e personit të mësipërm, që ishte gjykuar në mungesë, duke pasur si bazë këtë vendim, e kanë liruar menjëherë atë. Që nga ai moment nuk është bërë dot i mundur ndalimi i të dënuarit A. K., pasi ai është larguar dhe në këtë mënyrë ka mbetur i paekzekutuar vendimi i dënimit të tij me burgim.

Sipas vendimit të KLD-së dhe nga administrimi i materialeve të çështjes, rezulton se veprimet e ankuesit kanë qenë jo të rregullta. Kolegjet e Bashkuara çmojnë se kryerja nga ana e tij e veprimeve që përmenden në vendimin e KLD-së tregon për pamjaftueshmëri profesionale në kryerjen e detyrës së gjyqtarit.

Kështu, gjendja e papërgjegjshmërisë së të pandehurit, ose në rastin konkret të të dënuarit, sipas ligjit, është e lidhur ngushtësisht me momentin e ekzaminimit mjekoligjor të tij, çka do të thotë që gjykata, në rast se do të kishte dyshime për gjendjen e të dënuarit në momentin e gjykimit, duhet të thërriste

ekspertë për të përcaktuar këtë gjendje. Në fakt, gjykata ka marrë për bazë një akt ekspertimi të kryer para një viti nga momenti i gjykimit të çështjes dhe mbi një ekspertim të kërkuar jo prej saj.

Nga ana tjetër, neni 476 i K. Pr. Penale, përcakton rastet kur mund të shtyhet ekzekutimi i vendimit. Ai parashikon marrjen e masës së pezullimit të ekzekutimit të vendimit, si alternativë të mundshme, deri në përfundimin e shqyrtimit të çështjes për shtyrje të ekzekutimit të vendimit. Kjo dispozitë e lidh pezullimin me një afat, i cili maksimalisht do të jetë deri në shqyrtimin e çështjes. Veç sa sipër, pika 1, germa "a" e kësaj dispozite parashikon një afat, i cili mund të zgjasë deri në shërimin e të dënuarit. Kjo për shkak se lidhet me ekzistencën e një sëmundjeje që do të pengonte ekzekutimin e vendimit. Gjykata ka konfunduar termin "sëmundje", të parashikuar nga dispozita e mësipërme, me "sëmundjen psikike", për të cilën Kodi Penal ka parashikuar dispozita të veçanta që bëjnë fjalë për caktimin e masave mjekësore dhe që duhej të aplikoheshin në rast se vërtet i dënuari do të rezultonte i tillë.

Aq më shumë, gjykata nuk ka qenë para nevojës së shtyrjes së ekzekutimit të vendimit, sepse vendimi nuk ka qenë i vënë në ekzekutim. Të gjitha gjykimet janë zhvilluar në mungesë të të dënuarit, duke përfshirë këtu dhe gjykimin për njohjen e vendimit penal të dhënë nga Gjykata e Milanos.

Është pikërisht kjo pamjaftueshmëri e dukshme profesionale, që e bën të bazuar shkarkimin e paditësit nga KLD-ja, në bazë të nenit 147/6 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, e cila është shoqëruar me pasojat.²³⁶

Qëndrimi i mësipërm i Gjykatës së Lartë është konfirmuar edhe nga Gjykata Kushtetuese, e cila arsyetoi se "Këshilli i Lartë i Drejtësisë shqyrtoi çështjen pas procedimit disiplinor të Ministrit të Drejtësisë, i cili kishte verifikuar veprimet e parregullta të kërkuarit si gjyqtar në çështjen me vendimi penal nr. 297, datë 09.12.2002. Me këtë vendim është njohur dënimi që Gjykata Penale e Milanos, Itali, i ka dhënë shtetasit shqiptar A. K., për vepra të rënda penale.

Këshilli i Lartë i Drejtësisë është organi i ngarkuar nga Kushtetuta për të vendosur për emërimin e për masat disiplinore ndaj gjyqtarëve duke përcaktuar dhe motivacionin përkatës për këtë shkarkim, siç ka vepruar dhe në rastin konkret. Ai ka analizuar veprimet e kryera nga kërkuari dhe ka arritur në përfundimin, se ato jo vetëm vinë në kundërshtim me përmbushjen e rregullt të detyrës, por kanë sjellë pasojat të rënda për autoritetin e organeve të drejtësisë, sepse i dënuari është liruar nga burgu për shkak të këtij vendimi.

Nuk është në kompetencën e Gjykatës Kushtetuese të vlerësojë nëse faktet e pranuar nga Këshilli i Lartë i Drejtësisë e Gjykata e Lartë përbëjnë shkelje dhe nëse këto shkelje janë apo jo të rënda. Vlerësimi i veprimeve të gjyqtarit, pasojat e ardhur dhe masa disiplinore që duhet marrë ndaj tij janë në kompetencën e vetë atyre organeve, prandaj, pretendimet e kërkuarit për interpretim të gabuar të ligjit e provave nga organet e lartpërmendura, nuk përbëjnë objekt shqyrtimi për Gjykatën Kushtetuese. Si të tilla nuk mund të shërbejnë si shkak për shfuqizimin

236. Vendimi nr. 30, datë 31.03.2003 i Kolegjeve të Bashkuara të Gjykatës së Lartë.

si antikushtetues të vendimeve të Këshillit të Lartë të Drejtësisë e të Kolegjeve të Bashkuara të Gjykatës së Lartë.

Sipas nenit 135 të Kushtetutës, pushteti gjyqësor ushtrohet nga gjykatat në bazë të parimit të kontrollit të shkallëzuar të vendimeve të gjykatave më të ulëta nga gjykatat më të larta, gjë që do të thotë se përderisa ato janë në fuqi, asnjë organ tjetër shtetëror, duke përfshirë edhe Këshillin e Lartë të Drejtësisë, nuk mund t'i prekë. Por nga ana tjetër, Kushtetuta ka parashikuar në disa norma detyrimin e gjyqtarëve për të respektuar me përpikëri Kushtetutën, ligjet dhe për të ruajtur paanësinë e figurën e pastër në funksion të dhënies së një drejtësie më bindëse. Nëse konstatohen raste të inkriminimit të gjyqtarëve, akte e sjellje që diskreditojnë rëndë pozitën e figurën e gjyqtarit ose pamjaftueshmëri profesionale, neni 147/6 i Kushtetutës ka ngarkuar Këshillin e Lartë të Drejtësisë të mbajë qëndrimet e duhura deri në shkarkimin nga detyra të gjyqtarit.

Në çështjen në shqyrtim, Këshilli i Lartë i Drejtësisë, nuk ka cenuar parimin e mosdërhurjes në dhënien e drejtësisë dhe as atë të fuqisë detyruese të vendimeve të formës së prerë. Ai ka konstatuar veprime në kundërshtim me përmbushjen e rregullt të detyrës dhe pasojat e rënda të ardhura nga këto veprime duke përcaktuar sipas kompetencës masën disiplinore që duhet marrë.

I papranueshëm është edhe pretendimi se kontrolli nga Inspektorati i Ministrisë të Drejtësisë vjen në kundërshtim me parimin e ndarjes së pushteteve. Për këtë, Gjykata Kushtetuese rikonfirmon qëndrimin e saj të mëparshëm të shprehur në vendimin nr.11, datë 27.05.2004".²³⁷

Nga arsyetimet e vendimeve të Gjykatës së Lartë dhe të Gjykatës Kushtetuese, del qartë se pezullimi i një dënimi që ende nuk kishte vijuar të ekzekutohej, si edhe konfondimi i termave "sëmundje" me sëmundje psikike", kur legjislacioni parashikon rregullime të posaçme për këto raste, tregojnë për një mungesë profesionalizmi të theksuar në vendimarrjen e gjyqtarit për këtë çështje dhe për rrjedhojë duhej të mbante përgjegjësi disiplinore.

Në një tjetër rast, ndryshimi i dispozitivit të vendimit gjyqësor, nën justifikimin e korrigjimit të gabimeve materiale është konsideruar shkelje, me pasojë sjelljen e përgjegjësisë disiplinore, siç rezulton nga arsyetimi vijues se "Kolegjet e Bashkuara të Gjykatës së Lartë pasi shqyrtuan çështjen në tërësi konkluduan se nga ana e gjyqtarit E. K., janë lejuar dhe për rrjedhojë janë konstatuar shkeljet e evidentuara prej KLD-së në shqyrtimin e dy çështjeve. Këto shkelje cenojnë rëndë autoritetin e figurën e gjyqtarit e duhet të konsiderohen veprime që vijnë në kundërshtim me përmbushjen e rregullt të detyrës së gjyqtarit.

Në çështjen që i përket të pandehurit A. B., është pranuar kërkesa për ndreqje gabimi material në një kohë kur vendimi ishte apeluar dhe çdo parregullsi apo zbatim të gabuar të ligjit do të zgjidhej prej gjykatës së shkallës së dytë.

Në bazë të nenit 385 të Kodit të Procedurës Penale, gjykata procedon për

237. Vendimi nr. 12, datë 17.06.2004 i Gjykatës Kushtetuese.

ndreqjen e gabimit material, por në rastin konkret, sikurse u parashtrua më sipër, gjykata nuk ka bërë ndreqje të gabimeve materiale, porse ka ndryshuar dispozitivin e vendimit. Në rast se do të bëhej vetëm llogaritje sipas masave të dënimit të caktuara për të pandehurin A. B., rezultonte se dënimi përfundimtar i tij do të ishte 3 vjet, 8 muaj e 20 ditë burg dhe jo 3 vjet, 2 muaj e 10 ditë burg, sikurse ka pranuar gjykata pasi ka ndryshuar masën e dënimit të caktuar ndaj këtij të pandehuri prej 5 vjet burg për veprën penale të parashikuar nga neni 283/1 e 25 i Kodit Penal.

Duke cenuar dispozitivin e vendimit, gjyqtari ka zbritur nën minimumin e dënimit për këtë veprë, i cili është 5 vjet dhe për zbritjen nën minimumin e dënimit, gjykata në vendimin e themelit nuk kishte arsyetuar dhe për rrjedhojë nuk e kishte zbatuar.

Po ashtu, sipas neneve 333/2 e 471 të K. Pr. Penale, në të dy çështjet e gjykuara për të pandehurin A. B., atë të ndreqjes së gabimit material dhe në çështjen e B. D., pjesëmarrja e prokurorit ka qenë e detyrueshme, e për rrjedhojë duhet të ishin kryer prej gjykatës të gjitha veprimet e nevojshme procedurale për pjesëmarrjen e tij.

Problemet e trajtuara në lidhje me zbatimin e kërkesave ligjore lidhen me ekzekutimin e vendimeve, pasi janë ekzekutuar vendime jo të ligjshme e për rrjedhojë kanë përfutur padrejtësisht personat e marrë të pandehur. Sipas nenit 471/4 të Kodit të Procedurës Penale, seanca për këto gjykime zhvillohet me pjesëmarrjen e detyrueshme të prokurorit dhe mbrojtësve.

Në këto rrethana konstatohet se shkeljet janë evidente, kanë përcaktim të qartë ligjor dhe për rrjedhojë me të drejtë janë konstatuar si të tilla që pas sjellin shkarkimin e gjyqtarit. Rëndësinë e natyrës së shkeljeve e çmon organi që shqyrton çështjen, por në rastin konkret shkeljet kanë qenë të dukshme dhe kanë sjellë si pasojë që të zhvillohet një proces jo i rregullt ligjor.

Në këto rrethana, Kolegjet e Bashkuara çmojnë se ankimi nuk gjen mbështetje ligjore e për rrjedhojë vendimi i KLD-së duhet të lihet në fuqi”.²³⁸

Më sipër, trajtuam rastet kur janë konstatuar shkelje disiplinore sjelljet e caktuara nga gjyqtarët. megjithatë jurisprudenca na jep edhe raste kur gjyqtarët janë proceduar me pa të drejtë dhe procedimi i tyre disiplinore nuk duhej që të kishte ndodhur.

Kështu, duke qenë se gjatë procedurave disiplinore shpesh herë vlerësohej mënyra e vendimmarrjes së gjyqtarit, Gjykata Kushtetuese, rezulton që të ketë mbajtur qëndrimin se “Vendimi i Këshillit të Lartë të Drejtësisë për shkarkimin e kërkuesit nga detyra, është mbështetur në vlerësimin negativ që i ka bërë grupi i inspektorëve 11 vendimeve gjyqësore të dhëna prej tij. Në këtë mënyrë, ky Këshill, ka hyrë në vlerësimin e ligjshmërisë dhe bazueshmërisë të vendimeve gjyqësore të dhëna prej kërkuesit, sepse këto vlerësime, kryesisht, janë bërë për zbatim të gabuar të ligjit, për caktimin e masave të buta të dënimit, për mosvlerësim të drejtë të rrezikshmërisë shoqërore të veprës si dhe për

238. Vendimi nr. 33, datë 26.09.2003 i Kolegjeve të Bashkuara të Gjykatës së Lartë.

mosolerësim të drejtë të personalitetit të autorit të veprës.

Sipas nenit 135 të Kushtetutës, pushteti gjyqësor ushtrohet nga Gjykata e Lartë, nga gjykata e apelit dhe gjykata e shkallës së parë. Ky pushtet ushtrohet i shkallëzuar sipas parimit të kontrollit të vendimeve të gjykatave më të ulëta nga gjykatat më të larta. Kjo do të thotë se përderisa vendimet nuk janë prishur ose ndryshuar nga një gjykatë më e lartë, asnjë organ tjetër shtetëror, qoftë edhe Këshilli i Lartë i Drejtësisë, nuk ka të drejtë t'i prekë ato dhe as të ngarkojë me përgjegjësi disiplinore gjyqtarin e çështjes për këto vendime.

Përfundim nga rregulli i mësipërm, bëhet vetëm për rastet kur vendimet janë rrjedhojë e shkeljeve që diskreditojnë rëndë pozitën ose figurën e gjyqtarit. Në këto raste, shkeljet duhet të evidentohen dhe argumentohen para se të merret masa disiplinore e largimit të gjyqtarit nga detyra. Këshilli i Lartë i Drejtësisë, kur vërtetohen shkelje të natyrës së mësipërme, mund të veprojë në çdo kohë për shkarkimin nga detyra të gjyqtarit, pavarësisht nëse çështja ka përfunduar ose jo. Këto konkluzione Gjykata Kushtetuese i ka nxjerrë edhe në vendimin e saj nr. 29, datë 30.04.2001, që i përket kërkuarit A. K.

Gjykata Kushtetuese, për çështjen në gjykim, vëren se Këshilli i Lartë i Drejtësisë dhe Kolegjet e Bashkuara të Gjykatës së Lartë nuk kanë argumentuar, se cilat janë shkaqet e shkeljeve disiplinore që i atribuohen kërkuarit. Ato nuk janë shprehur nëse këto akte ose shkelje, janë kryer si rezultat i veprimeve me dashje që diskreditojnë rëndë pozitën ose figurën e tij si gjyqtar, apo janë shkelje e gabime të një natyre më të lehtë që mund të kenë ardhur nga neglizhenca, paaftësia profesionale ose nga mungesa e përvojës në detyrë.

Qartësimi i këtyre rrethanave që përbën një detyrim kushtetues për Këshillin e Lartë të Drejtësisë në kuptim edhe të nenit 147 të Kushtetutës, ka qenë tepër i nevojshëm sepse kërkuari është ngarkuar me përgjegjësi nga Këshilli i Lartë i Drejtësisë për shkelje të tilla që kanë të bëjnë kryesisht me zbatimin e gabuar të ligjit ose me dhënien e dënimeve të buta”.²³⁹

Kjo qasje e Gjykatës Kushtetuese, është konfirmuar edhe me një tjetër vendimmarrje të po kësaj Gjykate, ku përsëri është arsyetuar se “Këshilli i Lartë i Drejtësisë, vendimin e tij për shkarkimin nga detyra të kërkuarit, e ka mbështetur në vlerësimet negative që i ka bërë grupi i inspektorëve vetëm gjashtë vendimeve gjyqësore të dhëna nga kërkuari, ose si gjyqtar i vetëm, ose si anëtar i trupit gjykues me gjyqtarë të tjerë. Del se nga këto vendime, katër prej tyre kanë marrë formën e prerë, tre që nuk janë ankimuar dhe një tjetër që është lënë në fuqi nga instancat gjyqësore më të larta; ndërsa dy vendime të tjera janë ndryshuar nga Gjykata e Apelit, por vetëm për masën dhe jo për llojin e dënimit.

Në përgjithësi, vërejtjet për këto vendime nuk kanë të bëjnë me shkelje të karakterit procedural, por vetëm me zbatim të gabuar të ligjit material, i cili sipas konkluzioneve të Këshillit të Lartë të Drejtësisë është reflektuar kryesisht, në caktimin e masave të buta të dënimit me burgim, në një rast në cilësimin ligjor jo të drejtë të veprës penale; ndërsa në një rast tjetër, në zgjidhjen e gabuar

239. Vendimi nr. 11, datë 02.04.2003 i Gjykatës Kushtetuese.

të një çështje civile. Del se evidentimi i këtyre shkeljeve është realizuar jo në rrugën e verifikimit të ankesave të shtetasve, siç parashikon neni 17 i ligjit "Për organizimin e pushtetit gjyqësor", por nëpërmjet kontrollit të përgjithshëm që ka ushtruar Inspektorati pranë Këshillit të Lartë të Drejtësisë, mbi veprimtarinë njëvjeçare të gjyqtarëve të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë dhe këto, janë konsideruar si shkelje të disiplinës në punë të kryera në formën e veprimeve që vijnë në kundërshtim me përmbushjen e rregullt të detyrës nga ana e kërkuesit.

Këshilli i Lartë i Drejtësisë, duke i hyrë vlerësimit të ligjshmërisë dhe bazueshmërisë të këtyre vendimeve gjyqësore të dhëna nga kërkuesi në një kohë që këto kishin marrë formë të prerë, ka vepruar në kundërshtim me përmbajtjen e nenit 135, pika 1 të Kushtetutës.

Kjo dispozitë, e cila bën dallimin midis gjyqtarëve sipas funksioneve, ka për qëllim t'i shkëpusë ata nga varësia hierarkike dhe t'ia nënshtrojë veprimtarinë e tyre në dhënien e drejtësisë, vetëm kontrollit të instancave më të larta gjyqësore, sipas rregullave të përcaktuara në Kodet e Procedurave.

Vendimet gjyqësore të formës së prerë, për çështjen konkrete që zgjidhin, kanë fuqinë e ligjit. Kjo do të thotë se përsa kohë ato nuk janë prishur ose ndryshuar nga një gjykatë më e lartë, asnjë organ tjetër shtetëror nuk mund të mos përfillë përmbajtjen e tyre dhe të ngarkojë me përgjegjësi gjyqtarin e çështjes.

Megjithatë, problemi ndryshon në rastet kur këto vendime janë shoqëruar me shkelje që diskreditojnë rëndë pozitën ose figurën e gjyqtarit dhe që cenojnë në përgjithësi prestigjin dhe autoritetin e pushtetit gjyqësor.

Në raste të tilla, Këshilli i Lartë i Drejtësisë, ka kompetenca të plota të marrë çdo lloj mase disiplinore ndaj gjyqtarëve, pa e kondicionuar atë, me faktin nëse kjo kategori vendimesh kanë marrë formë të prerë dhe kanë fituar kështu autoritetin e gjësë së gjykuar. Madje, ndaj akteve të kësaj natyre të kryera gjatë ushtrimit të detyrës, ai mund të reagojë në çdo kohë edhe kur nuk ka përfunduar shqyrtimi i çështjes.

Por, në për zgjedhjen e masës disiplinore të zbatuar ndaj kërkuesit, Këshilli i Lartë i Drejtësisë, nuk ka pasur sa duhet parasysh edhe kërkesat e nenit 147, pika 6 të Kushtetutës.

Sipas kësaj dispozite, shkarkimi nga detyra i gjyqtarit vendoset vetëm në raste të caktuara, midis të tjerash edhe për shkelje të ndryshme të disiplinës në punë, të kryera këto në ndonjë nga format e parashikuara në ligjin nr. 8436, datë 28.12.1998 "Për organizimin e pushtetit gjyqësor".

Megjithatë, jo çdo shkelje, qoftë kjo e kryer edhe në formën e veprimeve në kundërshtim me përmbushjen e rregullt të detyrës, për ligj marrjen e kësaj mase ekstreme.

Zbatimi i saj, në vështirësi të dispozitës kushtetuese të lartpërmendur, është e lidhur vetëm me kryerjen e akteve që diskreditojnë rëndë pozitën dhe figurën e gjyqtarit.

Gjykata Kushtetuese, duke iu referuar çështjes në shqyrtim, konstaton se Këshilli i Lartë i Drejtësisë, ashtu si edhe Kolegjet e Bashkuara të Gjykatës së

Lartë, nuk kanë argumentuar se cilat janë shkaqet e vërteta të shkeljeve që i atribuohen kërkuarit. Me fjalë të tjera, ata nuk janë shprehur, nëse këto mangësi në punën e kërkuarit janë rezultat i veprimeve me dashje që diskreditojnë pozitën e tij si gjyqtar, apo janë gabime të zakonshme që mund të kenë ardhur nga mungesa e përvojës së tij në këtë detyrë.

Sqarimi i këtyre rrethanave në këtë rast ishte i domosdoshëm për shkak se kërkuari është ngarkuar me përgjegjësi, kryesisht për dhënien e dënimeve të buta, ose për zbatim të gabuar të ligjit material në çështje që pjesa më e madhe e tyre kanë përfunduar me vendime të formës së prerë, pasi nuk dihet me siguri, nëse këto shkelje do të vlerësoheshin të tilla edhe nga instancat gjyqësore më të larta, në rast se këto vendime do t'i nënshtroheshin kontrollit të tyre të zakonshëm gjyqësor.

Në këto rrethana, përveç vendimit të Këshillit të Lartë të Drejtësisë, duhet të shfuqizohet edhe vendimi i Kolegjeve të Bashkuara të Gjykatës së Lartë, me të cilin është përligjur rezultati i këtij procesi të parregullt disiplinor të zhvilluar kundër kërkuarit”.²⁴⁰

Vendimet e mësipërme, ishin mjaft të rëndësishme, pasi tregonin që për vendime gjyqësore të formës së prerë që nuk ishin cenuar nga gjykatat më të larta, nuk mundej që të bëheshin objekt shqyrtimi dhe vlerësimi nga organet proceduese, apo edhe nga Gjykata e Lartë, kur shqyrtonte ankimet kundër masave disiplinore të gjyqtarëve. Bazuar në këto konkluzione, pati edhe reagim nga Gjykata e Lartë, ku siç vërehet në vendimmarrjet e saj të sipërcituara, jo shpesh herë bëhej dallimi midis rasteve kur vlerësonte vendime gjyqësore të formës së prerë dhe rasteve, kur vendimet për të cilat procedohej gjyqtari ishin cenuar nga gjykatat më të larta.

Rastet që kanë të bëjnë ekskluzivisht me bindjen e brendshme të gjyqtarit, nuk janë trajtuar si shkelje disiplinore nga ana e praktikës gjyqësore, siç e tregon dhe rasti vijues se “Duke analizuar disa vendime gjyqësore nga Inspektorati pranë Këshillit të Lartë të Drejtësisë, Ministri i Drejtësisë dhe Këshilli i Lartë i Drejtësisë është arritur në përfundimin, se ato janë marrë në shkelje të kërkesave ligjore. Kolegjet e Bashkuara çmojnë në përgjithësi, se në rastet e trajtuara janë respektuar kërkesat ligjore dhe nga ana e organeve të sipërme nuk është analizuar shkelja e ligjit, por bindja e brendshme e gjykatës në zgjidhjen e çështjeve në gjykim dhe për pasojë nuk mund të pranohet që ndodhemi para kryerjes së veprimeve, në kundërshtim me përmbushjen e rregullt të detyrës nga ana e gjyqtarit A. K.

Gjatë diskutimit të çështjes në Kolegjet e Bashkuara, në shpjegimet e tij, përfaqësuesi i Këshillit të Lartë të Drejtësisë pranoi se në çështjet e gjykuara e që trajtohen se janë marrë vendime në kundërshtim me përmbushjen e rregullt të detyrës nga ana e A. K., nuk ka pasur shkelje ligjore, fakt ky që rrëzon arsyetimin se ndodhemi para shkeljes së disiplinës.

240. Vendimi nr. 29, datë 30.04.2001 i Gjykatës Kushtetuese.

Lidhur me shkelje në drejtim të caktimit dhe zëvendësimin e masave të sigurimit, në vendimin e Këshillit të Lartë të Drejtësisë janë trajtuar vendimi nr. 10, datë 07.01.1999, me të cilin për të pandehurin A. K., akuzuar për veprën penale të vjedhjes me dhunë, është caktuar si masë sigurimi arrest me afat 15-ditor, dhe vendimi nr. b75, datë 30.12.1999, me të cilin është vendosur zëvendësimi i masës së sigurimit për të pandehurin S. K., nga arrest me burg në arrest shtëpie.

Duke analizuar dokumentet që lidhen me të pandehurit e sipërpërmendur, del se të pandehurit A. K., i është caktuar masë sigurimi arrest me afat 15-ditor, mbasi nuk kishte prova të plota për të arritur në përfundimin se autori i krimit ishte ky i pandehur. Përveç të tjerash, edhe për faktin se nuk ishte bërë paraqitja për njohje me të dëmtuarin dhe pas disa ditësh, kur është kryer ky veprim hetimor, i dëmtuari ka sqaruar se nuk ishte A., personi që kishte kryer krimin dhe përfundimisht, me vendimin e datës 10.05.1999 nga prokurori është pushuar çështja penale në ngarkim të të pandehurit A. K., dhe është urdhëruar lirimi i tij, mbasi nuk u provua që ishte ai autori i krimit.

Vendimi për zëvendësimin e masës së arrestit për të pandehurin S. K., është marrë mbi bazën e një epikrizë mjekësore, që u vlerësua nga gjykata si shkak për heqjen e masës së arrestit me burg dhe ky rast nga ana e inspektorëve të Këshillit të Lartë të Drejtësisë është trajtuar si shkelje ligji me arsyetimin se epikrizë duhet të administrohet nga organi i procedurës, e jo nga gjykata, konkluzion ky i pabazuar në ligj, pasi gjykata është e detyruar të vlerësojë çdo provë e çdo material, që i paraqitet gjatë gjykimit të çështjes.

Të pabazuara janë përfundimet e nxjerra edhe për paligjshmërinë e vendimeve, me të cilat janë pranuar kërkesat e të dënuarve për lirim para kohe me kusht. Është arsyetuar në vendimin e Këshillit të Lartë të Drejtësisë, se janë marrë pesë vendime për lirim para kohe me kusht, në kundërshtim me kërkesat ligjore të parashikuara nga neni 64 i K. Penal, pasi nuk është pasur parasysh rrezikshmëria e veprës, e autorit dhe masa e dënimit dhënë nga gjykata. Por nga analiza e materialeve, që ndodhen në dosje del se vendimet për lirim para kohe me kusht, i janë nënshtruar vlerësimit të bindjes së krijuar nga gjykata në zgjidhjen e çështjeve, e për asnjë rast nuk ka analizë të marrjes së vendimeve në kundërshtim me kërkesat ligjore. Në vetë këto materiale pranohet se gjykata ka marrë vendime në kundërshtim me ligjin, se megjithëse është arritur në përfundimin, se janë pasur parasysh kërkesat e nenit 64 të K. Pr. Penale, ndodhemi para shkeljeve të ligjit, pasi gjykata në disa raste nuk ka pasur parasysh, që masa e dënimit ka qenë e butë, se të dënuarit kanë qenë për krime të rënda dhe është arritur në përfundimin se i është arritur qëllimit të riedukimit, kur koha e qëndrimit në kampet e riedukimit ka qenë e shkurtër.

Këto konkluzione janë të pabazuara dhe përfaqësuesi i Këshillit të Lartë të Drejtësisë, pranoi se në lirimet me kusht nuk ka raste që të mungojë ndonjë nga kërkesat e parashikuara nga neni 64 i K. Penal, gjë që do të thotë se vendimet janë marrë në përputhje me ligjin.

Përfundimet e arritura për paligjshmërinë e vendimeve për lirime para kohe me kusht, janë jashtë kriterëve ligjore, sepse në bazë të nenit 64 të K. Penal, i dënuari me burgim mund të lirohet para kohe nga vuajtja e mëtejshme e dënimit kur ka vuajtur jo më pak se ½ e dënimit të dhënë, me sjelljen e tij tregon se me dënimin e vuajtur i është arritur qëllimit për edukimin e tij dhe të mos jetë përsëritës në krim. Sikurse u përmend, në asnjë nga rastet e lirimit para kohe me kusht, nuk është konstatuar mungesa e ndonjëres prej këtyre kërkesave, e për pasojë ato vendime nuk mund të trajtohen si të marra në kundërshtim me ligjin dhe me përmbushjen e rregullt të detyrës.

Edhe çështja me të dënuarin Sh. M., ndonëse trajtohet si një rast i zgjidhur nga gjyqtari A. K., në kundërshtim me përmbushjen e rregullt të detyrës, nuk mund të pranohet si i tillë, pasi, sikurse e pranoi edhe përfaqësuesi i Këshillit të Lartë të Drejtësisë, kjo çështje i është dhënë për gjykim mbi bazën e shortit të hedhur sipas rregullave të përcaktuara dhe jo me kërkesën e tij.

Me vendimin nr. 148, datë 12.03.1999, janë deklaruar fajtorë të pandehurit I. K., e D. R., dhe masa e dënimit ndaj tyre prej 2 vjet e 6 muaj është konsideruar e butë dhe e dhënë në kundërshtim me ligjin. Edhe ky vlerësim nuk është i bazuar, pasi është subjektiv dhe nuk është pasur parasysh që të pandehurit janë dënuar me nga 5 vjet burgim, por meqenëse ishin të mitur, në zbatim të nenit 51 të K. Penal përfundimisht u është dhënë gjysma e dënimit dhe Gjykata e Apelit Tiranë, që gjykoi çështjen mbi apelimin e prokurorit e la në fuqi vendimin. Në këto kushte, një vendim gjyqësor i gjykatës së rrethit, i apeluar nga prokurori për masë të butë dënimi dhe i lënë në fuqi nga gjykata e apelit, nuk mund të konsiderohet se vendimi është dhënë në kundërshtim me ligjin, mbasi i është nënshtruar kontrollit më të lartë gjyqësor në përputhje me kërkesat e K. Pr. Penale dhe është gjetur i bazuar në ligj.

Si vendim i dhënë në kundërshtim me ligjin është trajtuar edhe vendimi nr. 10, datë 20.01.1999, me të cilin është dënuar i pandehuri P. K., për krimin e parashikuar nga neni 283/1 i K. Penal (shitjes dhe prodhimit të lëndëve narkotike) me dy vjet burg, duke e pezulluar ekzekutimin. Për kohën që është dhënë ky vendim, praktika gjyqësore e gjykatave të rrethëve e të apelit ka qenë e ndryshme për dënimin e atyre të pandehurve që vërtetohej se ishin përdorues të drogës e u gjendej drogë në sasinë më pak se 1 gram. Këta persona ose janë deklaruar të pafajshëm ose u është dhënë dënim minimal, nën atë të parashikuar nga ligji, dhe është urdhëruar pezullimi i ekzekutimit të vendimit, praktikë kjo e ndjekur deri sa me vendim të Kolegjit Penal të Gjykatës së Lartë u pranua se duhej të dënoheshin edhe personat që mbanin lëndë narkotike për t'i përdorur për vete, vendim që ndryshoi edhe gjithë praktikën gjyqësore.

Nga sa më sipër, Kolegjet e Bashkuara të Gjykatës së Lartë arrijnë në përfundimin se në gjykimin e çështjeve dhe dhënien e vendimeve nga ana e gjyqtarit A. K., nuk janë kryer veprime në kundërshtim me përmbushjen e rregullt të detyrës dhe për pasojë masa e marrë ndaj tij nuk është e bazuar. Në këtë drejtim, Kolegjet e Bashkuara kanë parasysh edhe faktin, që për kërkesin, gjatë

*kohës që ka punuar si gjyqtar, nuk është konstatuar ndonjë shkelje e disiplinës në punë dhe nuk është marrë masë disiplinore”.*²⁴¹

Nga pasazhet e mësipërme, rezulton se ky gjyqtar që ishte proceduar, nuk kishte kryer veprime që bien ndesh me përmbushjen e rregullt të detyrës. Vendimet e tij ishin brenda kuadrit ligjor dhe bazoheshin në interpretimin dhe bindjen e tij të brendshme, të cilat janë pjesë integrale e punës së një gjyqtari. Për më tepër, gjatë karrierës së tij si gjyqtar nuk janë evidentuar shkelje disiplinore, ose precedentë që do të justifikonin masën e shkarkimit nga detyra. Interesant është fakti, që nuk quhej shkelje për këtë gjyqtar, që kishte vendosur në përputhje me praktikën e kohës, pavarësisht se më vonë ishte ndryshuar nga Gjykata e Lartë. E rëndësishme që kur vendimet ishin marrë, në atë kohë, përputheshin me praktikën gjyqësore të kohës.

Nëse sjellja e caktuar e një gjyqtareje, përbënte apo jo shkelje të rëndë, solli edhe arsyetime diametralisht të kundërta midis Gjykatës së Lartë dhe Gjykatës Kushtetuese. Kështu fillimisht Gjykata e Lartë, mbajti qëndrimin, se *“Sipas vendimit, të tilla veprime janë kryer në gjykimin e çështjes civile me palë paditëse Ministrinë e Arsimit dhe Shkençës, palë të paditur Komisionin e Kthimit dhe Kompensimit të Pronave ish-Pronarëve Tiranë dhe ndërhyrës dytësor familjen S.*

Janë zhvilluar seanca gjyqësore, duke qenë ankuesja A. Ç., gjyqtare e vetme, ndërkohë që bëhej fjalë për gjykim që, në përputhje me kërkesat e parashikuara nga neni 35/b i Kodit të Procedurës Civile, duhej zhvilluar me trup gjykues të përbërë nga tre gjyqtarë. Gjithashtu, vendimi përfundimtar për çështjen civile në fjalë është i nënshkruar nga tre gjyqtarë, në një kohë që sipas procesverbalit përkatës, rezulton se dy prej tyre nuk kanë marrë pjesë në gjykim.

Duke analizuar më konkretisht veprimet e përmendura të kryera prej ankueses A. Ç., në cilësinë e gjyqtares, rezulton ndër të tjera se në procesverbalin e seancës gjyqësore të datës 28 qershor 2002, trupi gjykues përbëhej vetëm nga A. Ç., dhe R. P., Kjo e fundit, duke parë aktet e dosjes gjyqësore, nuk del të ketë marrë pjesë në asnjë seancë tjetër të mëparshme gjyqësore. Më tej akoma, duke “arsyetuar” se pala paditëse nuk është paraqitur në gjykim pa shkaqe të arsyeshme, vendoset pushimi i gjykimit dhe në vendim firmosin tre gjyqtarë, e konkretisht A. Ç., A. C., dhe F. O., Siç shihet, ndërkohë që në procesverbal pasqyrohen dy gjyqtarë, në vendim firmosin tre të tillë, apo ndërsa në procesverbal pasqyrohet gjyqtarja R. P., në vendim ajo nuk figuron.

Veprimet në kundërshtim flagrant me përmbushjen e rregullt të detyrës, të kryera nga ana e ankueses A. Ç., lidhen edhe me faktin, se ajo ka pranuar të gjykojë si relatore një çështjeje civile, kur në përputhje me kërkesat e nenit 73 të Kodit të Procedurës Civile, duhet të kërkonte heqjen dorë nga gjykimi, për shkak se ka pasur arsye serioze për njëanshmëri. Një përfundim i tillë rrjedh nga fakti, se ka pasur marrëdhënie të posaçme ndërmjet saj dhe blerësit të pronës dhënë

241. Vendimi nr. 15, datë 13.02.2001 i Kolegjeve të Bashkuara të Gjykatës së Lartë.

me vendim të K. K. K. Pronave në favor të një pale në gjyq, ndërhyrësit dytësor, familja S., i cili ishte bashkëshorti i saj. Në këtë rast ankuesja ka vepruar edhe në kundërshtim me kërkesat e nenit 709 të Kodit Civil, të Ligjit të përmendur “Për organizimin e pushtetit gjyqësor në Republikën e Shqipërisë”, si dhe Kodit të Etikës së gjyqtarit.

Kështu, ndërkohë që ndërmjet ndërhyrësit kryesor familja S., dhe bashkëshortit të ankueses S. Z., kishin kohë që bëheshin tratativa për blerjen e truallit nën shkollën “K.”, kthyer me vendim të K. K. K. Pronave, për ndërtim pallat banimi, tratativa të cilat finalizohen me kontratën datë 20.9.2002, ankuesja merr për gjykim çështjen në fjalë. Sikundër u tha më lart, pikërisht trualli i përmendur ishte objekt mosmarrëveshjeje në atë çështje. Një veprim i tillë, siç dihet, bie ndesh me kërkesat e nenit 709/c të Kodit Civil. Sipas kësaj dispozite, ... “nuk mund të blejnë drejtpërdrejt, me anë të një tjetri ose në ankand... gjyqtarët, prokurorët, përmbaruesit, noterët dhe avokatët, sendet për të cilat ka grindje përpara gjykatës në të cilën bëjnë pjesë ose ushtrojnë funksionet e tyre, përveç kur këta janë bashkëpronarë mbi to”.

Po ashtu, në vështrim të kërkesave të ligjit nr. 8436, datë 28.12.1998 “Për organizimin e Pushtetit gjyqësor në Republikën e Shqipërisë” ... “gjyqtarët duhet të ruajnë dinjitetin e tyre duke mos lejuar veprime që komprometojnë profesionin, organet e drejtësisë dhe figurën e tyre në shoqëri...”. Në një shoqëri demokratike, figura e gjyqtarit është tepër e rëndësishme, ndaj është e domosdoshme, që ai të ruajë një pozicion objektiv, i cili të përcjellë paanësi e drejtësi dhe jo veprime që komprometojnë. Sikurse pranohet në vendimin e Këshillit të Lartë të Drejtësisë, ankuesja A. Ç., ka qenë në dijeni të veprimeve, që bënte bashkëshorti i saj për blerjen e truallit objekt gjykimi dhe me ndërgjegje të plotë, nuk i ka penguar këto veprime, bile ka shkuar më tej, duke marrë për gjykim në cilësinë e gjyqtares relatores gjykimin e çështjes. Një qëndrim i tillë është në kundërshtim, edhe me Kodin e Etikës gjyqësore.

Kështu, në vështrim të kërkesave të neneve 3,4 dhe 24 të këtij Kodi,... “gjyqtari nuk duhet të lejojë që familja e tij, të afërmit apo persona të tjerë të influencojnë në punën e tij, të mos cenojë prestigjin e detyrës gjyqësore, për hir të interesave private dhe nuk duhet t’u krijojë të tjerëve përshtypjen se vepron në mënyrë të tillë...”. Po ashtu, “gjyqtari duhet të shmangë çdo sjellje të papërshtatshme dhe që bie në kundërshtim me ligjin, Kodin e Etikës, veprime që mund të dëmtojnë ose të hedhin dyshime mbi figurën e tij normale, si dhe nuk duhet të përfshihet në marrëdhënie financiare ose pune që mund të kuptohen si shfrytëzim i funksionit gjyqësor...”.

Ankuesja A. Ç., jo vetëm që nuk i ka mbajtur parasysh këto kërkesa, por ka vepruar në kundërshtim me to, duke lënë shteg për dyshime e komprometime të figurës së gjyqtarit. Sa sipër, Kolegjet e Bashkuara të Gjykatës së Lartë, e gjejnë të pabazuar pretendimin e saj për paligjshmërinë e vendimit të Këshillit të Lartë të Drejtësisë.

Përveç sa sipër, vendimi në fjalë, për shkarkimin nga detyra e gjyqtarit

të ankueses A. Ç., gjen mbështetje edhe në kërkesat e pikës 6 të nenit 147 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, sipas të cilave, Këshilli i Lartë i Drejtësisë, mund të shkarkojë nga detyra gjyqtarin, për akte e sjellje që diskreditojnë rëndë pozitën dhe figurën e tij.

Në analizë nga sa u përmend më lart, Kolegjet e Bashkuara të Gjykatës së Lartë, arrijnë në përfundimin se ankuesja ka vepruar në kundërshtim me kërkesat ligjore, si dhe ka kryer veprime që diskreditojnë figurën e gjyqtarit”.²⁴²

Gjykata e Lartë, në këtë rast konsideroi si shkelje profesionale, mënyrën e dokumentit të përbërjes së trupit gjykues gjatë një procesi civil, ku nuk kuptohej, se cilët kishin qenë anëtarët e tjerë dhe çfarë aktesh gjyqësore kishin nënshkruar, si edhe në pjesëmarrjen e saj në këtë proces, kur duhej të hiqte dorë. Por ndryshe nga kjo instancë gjyqësore, qasja e mësipërme, nuk u pranua nga Gjykata Kushtetuese, e cila arsyetoi se “Nga materialet e çështjes rezulton se kërkueses i atribuohen shkelje, që sipas Këshillit të Lartë të Drejtësisë kanë të bëjnë me kryerjen e veprimeve, që vijnë në kundërshtim me përmbushjen e rregullt të detyrës, e që janë të papajtueshme me funksionet e gjyqtarit, si dhe në kundërshtim me moralin shoqëror. Për këtë qëllim, në vendimin përkatës janë evidentuar një seri faktesh që kanë për qëllim të argumentojnë shkeljen e disiplinës në punë nga ana e kërkueses dhe konkretisht, të neneve 34; 41, pikat 1, 6 e 7 të ligjit nr. 8436, datë 28.12.1998 “Për organizimin e pushtetit gjyqësor në Republikën e Shqipërisë”. Mbi këtë argumentim mbështetet edhe pjesa urdhëruese e vendimit, ku përfundimisht përcaktohet dhënia ndaj kërkueses e masës disiplinore “largim nga detyra”, me motivacionin e kryerjes së veprimeve në kundërshtim me përmbushjen e rregullt të detyrës.

Në pjesën arsyetuese të vendimit të Këshillit të Lartë të Drejtësisë, objekt shqyrtimi, ekziston edhe një referim në dispozitat kushtetuese, në të cilin thuhet konkretisht se “Gjithashtu, ajo sjellje dhe veprimtari e gjyqtarës A. Ç., përbëjnë sjellje që diskrediton rëndë pozitën dhe figurën e gjyqtarit, në kuptim të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, neni 147, pika 6”. Gjatë gjykimit, përfaqësuesit e subjektit të interesuar, Këshilli i Lartë i Drejtësisë, e përdorën këtë referim si argument për të rrëzuar pretendimet e kërkueses. Lidhur me këtë çështje, jurisprudenca e krijuar nga vendimet e Gjykatës Kushtetuese ka theksuar se aktet e sjelljet që diskreditojnë rëndë pozitën dhe figurën e gjyqtarit janë elementë kushtetues të domosdoshëm për rastet e ndëshkimit me largim nga detyra të gjyqtarit. Kështu është e nevojshme një analizë e hollësishme rreth këtyre elementëve nga organi që procedon disiplinarisht gjyqtarin, i cili rast pas rasti, vlerëson ekzistencën e tyre. Është nënvizuar se është detyrë e organit procedues të vlerësojë e analizojë shkallën e rëndësisë së diskreditimit të pozitës dhe figurës së gjyqtarit, sepse dispozita kushtetuese, pranon si shkak për largimin e gjyqtarit nga detyra vetëm diskreditimin “e rëndë” të pozitës dhe figurës.

Në rastin në shqyrtim, Gjykata Kushtetuese vëren se vetëm referimi në

242. Vendimi nr. 15, datë 29.06.2004 i Kolegjeve të Bashkuara të Gjykatës së Lartë.

dispozitën kushtetuese nuk është i mjaftueshëm për të treguar dhe argumentuar lidhjen midis shkeljeve të disiplinës të kryera nga kërkuesja dhe shkakut të rëndë të kërkuar nga Kushtetuta për largimin nga detyra.

Nga materialet e çështjes rezultoi se Kolegjet e Bashkuara të Gjykatës së Lartë kanë shqyrtuar ankimin e kërkueses ndaj vendimit të Këshillit të Lartë të Drejtësisë dhe përfundimisht kanë vendosur mospranimin e kërkesës. Gjykata Kushtetuese vëren se edhe ky organ nuk ka mbajtur parasysh përcaktimin kushtetues për largimin nga detyra të gjyqtarit. Ashtu sikundër Këshilli i Lartë i Drejtësisë, edhe Kolegjet e Bashkuara të Gjykatës së Lartë, justifikojnë masën disiplinore të dhënë vetëm me shkeljet e disiplinës në punë, pa argumentuar se si këto shkelje kanë pasjellë diskreditimin e rëndë të pozitës dhe figurës së gjyqtarit.

Gjykata Kushtetuese çmon, se sa më sipër është e mjaftueshëm për të vlerësuar, se kërkueses i është shkelur e drejta për proces të rregullt ligjor nga të dy organet proceduese, Këshilli i Lartë i Drejtësisë dhe Kolegjet e Bashkuara të Gjykatës së Lartë”.²⁴³

Gjykata Kushtetuese në këtë rast, shprehet vetëm se si KLD, ashtu edhe Gjykata e Lartë, nuk kanë arritur të argumentojnë apo të lidhin shkeljet e konstatuara, me normën kushtetuese, për më tepër kur ky parashikim flet vetëm për sjellje që diskreditojnë “rëndë” figurën e gjyqtarit. Pra, mesa duket në këtë rast, Gjykata Kushtetuese shprehet, se vendimmarrja e këtyre dy organeve nuk është e arsyetuar, por këtë nuk e thotë shprehimisht, në asnjë pjesë të vendimit të saj.

Duke reflektuar qasjen e Gjykatës Kushtetuese, Gjykata e Lartë, filloi të analizojë natyrën e vendimeve gjyqësore që kishte marrë gjyqtari, që po procedohej dhe faktin nëse kishin marrë apo jo formë të prerë, këto vendime. Më pas, në varësi të rezultatit që dilte, mund të konkludohej nëse gjyqtari mbante apo jo përgjegjësi disiplinore, siç rezulton nga arsyetimi vijues se “Në vendimin e Këshillit të Lartë të Drejtësisë, si shkelje që konsistojnë në veprime që vijnë në kundërshtim me përmbushjen e rregullt të detyrës dhe që, sipas tij, në vetvete përbëjnë akte e sjellje që diskreditojnë rëndë pozitën dhe figurën e gjyqtarit, përmenden 10 vendime gjyqësore me shkelje të ligjit material apo procedural të nxjerra nga periudha e kontrolluar 2001 - 2004. Në këto vendime, në dy raste gjyqtari D. B., ka qenë relator i çështjes, ndërsa në rastet e tjera kryesues apo anëtar i trupit gjykues. Në 8 raste vendimet janë të formës së prerë për shkak se nuk janë ankimuar nga palët dhe në 2 raste vendimet janë prishur nga Gjykata e Lartë dhe çështjet janë kthyer për rishqyrtim po pranë Gjykatës së Apelit Tiranë.

Në marrjen e masës disiplinore për shkarkim nga detyra, Këshilli i Lartë i Drejtësisë kryesisht është bazuar në vlerësimin negativ që ka bërë grupi i inspektorëve për zbatim të gabuar të ligjit material apo procedural, për mos vlerësim të drejtë nga gjykata e apelit të rrethanave të çështjes në caktimin e masës së sigurimit si masë shtrënguese, për ndryshimin pa të drejtë të saj nga

243. Vendimi nr. 16, datë 27.04.2007 i Gjykatës Kushtetuese.

arrest në burg në arrest në shtëpi, për pushim të padrejtë të çështjes në gjykatën e apelit në kundërshtim me nenin 201 të K. Pr. Civile, për pezullim të padrejtë të çështjes nga ana e saj dhe shkaqe të tjera që kanë të bëjnë me vendimet e lartpërmendura.

Pa marrë për sipër të trajtohen në veçanti të gjitha vendimet gjyqësore, Kolegjet e Bashkuara të Gjykatës së Lartë konstatojnë se, në përgjithësi dhe në veçanti në vendimet e formës së prerë, Këshilli i Lartë i Drejtësisë ka hyrë në vlerësimin e ligjshmërisë së vendimeve gjyqësore të dhëna nga gjykata e apelit.

Sipas nenit 135 të Kushtetutës, pushteti gjyqësor ushtrohet nga Gjykata e Lartë, nga gjykatat e apelit dhe gjykatat e shkallës së parë dhe ushtrohet i shkallëzuar sipas parimit të kontrollit të vendimeve të gjykatave më të ulëta nga gjykatat më të larta. Në rrethana të tilla, asnjë organ tjetër shtetëror, qoftë edhe Këshilli i Lartë i Drejtësisë, nuk ka të drejtë t'i interpretojë ato në mënyrë negative për të ngarkuar me përgjegjësi disiplinore gjyqtarin, që ka qenë në përbërje të trupit gjyqësor. Këto vendime, qoftë edhe të formës së prerë, mund të jenë shkak për shkarkim nga detyra, vetëm nëse shoqërohen me akte e sjellje që diskreditojnë figurën e gjyqtarit.

Këto konkluzione janë nxjerrë dhe pranuar nga Gjykata Kushtetuese, në vendimet e saj nr. 29, datë 30.04.2001, që i përkiste kërkuarit A. K., dhe në vendimin nr. 11, datë 02.04.2003, që i përkete kërkuarit A. A., në të cilat ka vendosur shfuqizimin si antikushtetues të vendimeve të Këshillit të Lartë të Drejtësisë, si dhe atë të Kolegjeve të Bashkuara të Gjykatës së Lartë me arsyetimin se – “Përderisa vendimet nuk janë prishur ose ndryshuar nga një gjykatë më e lartë, asnjë organ tjetër shtetëror, qoftë edhe Këshilli i Lartë i Drejtësisë, nuk ka të drejtë t'i prekë ato dhe as të ngarkojë me përgjegjësi disiplinore gjyqtarin e çështjes për këto vendime”. Në vazhdim, në konkluzionet e Gjykatës Kushtetuese pranohet gjithashtu se – “përjashtim nga rregulli i mësipërm bëhet vetëm për rastet kur vendimet janë rrjedhojë e shkeljeve që diskreditojnë rëndë pozitën ose figurën e gjyqtarit ... shkelje që duhet të evidentohen dhe argumentohen para se të merret masa disiplinore e largimit të gjyqtarit nga detyra”.

Përveç vendimeve, si kundër analizohen më lart, Këshilli i Lartë i Drejtësisë, në vendimin e tij nuk evidenton raste që këto vendime të jenë rrjedhojë e shkeljeve, që diskreditojnë rëndë pozitën ose figurën e gjyqtarit.

Këshilli i Lartë i Drejtësisë nuk ka përmendur dhe argumentuar në ngarkim të gjyqtarit D. B., shkelje si rezultat i veprimeve me dashje që diskreditojnë rëndë pozitën ose figurën e tij si gjyqtar. Prandaj, çmohet se nuk ka përmbushur edhe detyrimin Kushtetues në kuptim të nenit 147/6 të Kushtetutës.

Detyra e gjyqtarit është funksion kushtetues dhe shkarkimi i gjyqtarit duhet të mbështetet vetëm në dispozitën kushtetuese. Ai duhet të bazohet vetëm në nenin 147/6 të Kushtetutës, si përmendet më lart, në të kundërt, në çdo rast ai konsiderohet antikushtetues. Në shqyrtimin e çështjes në rastin konkret, Këshilli i Lartë i Drejtësisë nuk parashtrroi shkaqe për akte apo sjellje të padenja për funksionin e gjyqtarit, të kryera gjatë ushtrimit të detyrës apo

jashtë saj dhe që të kenë ndikuar në humbjen e besimit publik, në dhënien e drejtësisë dhe t'i kenë sjellë dëm shtetit dhe shoqërisë. Sidoqoftë, këto sjellje që diskreditojnë rëndë pozitën dhe figurën e gjyqtarit duhet të jenë aq serioze sa të ulin dinjitetin e organit që përfaqësojnë dhe të tilla, sa të bëjnë të pamundur vazhdimin e detyrës nga ana e gjyqtarit dhe detyrimin e organit kompetent të marrë masën e shkarkimit nga detyra, veprime të cilat gjithashtu nuk rezultojnë të jenë përmendur dhe provuar.

Në qëndrimin dhe konkluzionin e tyre, Kolegjet e Bashkuara të Gjykatës së Lartë i referohen edhe vendimit të Gjykatës Kushtetuese nr. 75, datë 19.04.2002, që bën interpretimin e neneve 128 dhe 140 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, që parashikojnë raste të shkarkimit të gjyqtarit të Gjykatës Kushtetuese dhe të gjyqtarit të Gjykatës së Lartë për kuptimin e shkaqeve dhe motiveve të shkarkimit nga detyra të gjyqtarit.

Interpretimi bëhet për shprehjen kushtetuese – “akte e sjellje që diskreditojnë rëndë pozitën e gjyqtarit” dhe kihet parasysht nga Kolegjet e Bashkuara të Gjykatës së Lartë për shkak se si funksion kushtetues korrespondon edhe me rastet e parashikuara në nenin 147/6 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë për shkarkimin e gjyqtarit të gjykatës së shkallës së parë dhe atë të apelit.

Në vendimin nr. 75, datë 19.04.2002, Gjykata Kushtetuese, mbi kërkesën e një grupi deputetësh të Kuvendit të Shqipërisë, ka bërë interpretimin e neneve 128 dhe 140 të Kushtetutës dhe në konkluzionet e saj, pranon se veprimet apo mosveprimet e funksionarit të lartë të shtetit, që shërbejnë për shkarkimin e tyre, – “në çdo rast, janë të lidhura me sjelljet e parregullta e të padenja që këta funksionarë të lartë kryejnë jo vetëm gjatë ushtrimit të detyrës dhe për shkak të saj, por edhe jashtë detyrës, me abuzimin apo dhunimin që ata i bëjnë besimit publik dhe lidhen kryesisht me dëmet që ata i sjellin shoqërisë dhe shtetit. Aktet e sjelljet e padenja që ata kryejnë, duhet të jenë aq serioze, të kenë diskredituar aq rëndë figurën dhe pozitën e gjyqtarit dhe të kenë ulur dinjitetin e organit që përfaqësojnë, sa të detyrojnë organin kompetent për të marrë masën e largimit nga detyra”.

Duke bërë interpretimin e neneve 128 dhe 140 të Kushtetutës, për shprehjen – “akte e sjellje që diskreditojnë rëndë pozitën dhe figurën...”, Gjykata Kushtetuese ka vendosur se – “ajo përmbledh në vetvete një sërë elementësh, të cilët mund dhe duhet të identifikohen rast pas rasti nga organi që merr vendimin për shkarkimin e gjyqtarit. Ato janë të lidhura, me akte e sjellje të parregullta dhe të padenja që këta funksionarë kryejnë gjatë ushtrimit të detyrës, për shkak të saj, por edhe jashtë detyrës. Këto veprime apo mosveprime që analizohen në bazë të rrethanave të kryerjes së tyre, momentit subjektiv, si dhe nga dëmet që ata i sjellin shoqërisë e shtetit, janë të asaj natyre që e bëjnë të pamundur kryerjen e mëtejshme të funksioneve kushtetuese nga këto subjekte”.

Mbi analizën e sipërme, Kolegjet e Bashkuara të Gjykatës së Lartë konkludojnë për shfuqizimin e vendimit të Këshillit të Lartë të Drejtësisë, si i pambështetur në nenin 147/6 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë”.²⁴⁴

244. Vendimi nr. 7, datë 07.03.2006 i Kolegjeve të Bashkuara të Gjykatës së Lartë.

Nga ky arsyetim kuptohet që shumica e vendimeve gjyqësore, për të cilat ishte proceduar gjyqtari ishin të formës së prerë dhe për rrjedhojë bazueshmëria e tyre nuk mundej që të vlerësohej nga ana e KLD-së. Edhe në rastet e tjera, kur vendimet ishin prishur, nuk vëreheshin shkelje të tilla të legjislacionit procedural dhe material, që të sillnin si pasojë përgjegjësinë e tij disiplinore dhe shkarkimin e këtij gjyqtari.

Duke ruajtur qasjen e mësipërme, në një tjetër rast, Gjykata e Lartë, mbajti qëndrimin, se *“Nisur nga formulimi dhe përmbajtja e motivacionit, rezulton se vendimi i Këshillit të Lartë të Drejtësisë për shkarkimin nga detyra të gjyqtarit P. A., është mbështetur kryesisht në nenin 42/6 të ligjit nr. 8436, datë 28.12.1998 “Për organizimin e pushtetit gjyqësor në R. Shqipërisë”.*

Neni 42 i ligjit të sipërcituar parashikon se: *“Për shkelje të disiplinës, si dhe akte e sjellje të tjera diskredituese, merren masa duke filluar nga vërejtje, etj. në vazhdim. Në pikën 6 të tij, parashikon edhe shkarkimin nga detyra. Duke marrë shkas nga një çështje tjetër në shqyrtim që i përkiste ankuesit Th. N., dhe K. L. Drejtësisë për anulimin e masës për shkarkimin nga detyra të gjyqtarit, Kolegjet e Bashkuara të Gjykatës së Lartë kanë vendosur pezullimin e gjykimit të kësaj çështje dhe dërgimin e saj pranë Gjykatës Kushtetuese për t’u shprehur mbi pajtueshmërinë me Kushtetutën të kreut të V të ligjit nr. 8436, datë 28.12.1998 “Për organizimin e pushtetit gjyqësor” dhe që bën fjalë për përgjegjësinë disiplinore të gjyqtarëve.*

Gjykata Kushtetuese me vendimin nr. 3, datë 20.02.2006 ka vendosur shfuqizimin e pikës 6, të nenit 42 të ligjit nr. 8436, datë 28.12.1998 *“Për organizimin e pushtetit gjyqësor në Republikën e Shqipërisë”* si të papajtueshme me Kushtetutën me arsyetimin, se për shkak të funksionit që ka dhe mbrojtjes së posaçme që gëzon, funksioni i gjyqtarit trajtohet nga Kushtetuta si funksion kushtetues dhe shkarkimi nga detyra i gjyqtarit, e drejta e ankimit ndaj këtij vendimi, si dhe organi që duhet të marrë atë në shqyrtim rregullohen drejtpërdrejt nga Kushtetuta dhe jo nga ligje të tjera të veçanta.

Në nenin 147/6 të Kushtetutës parashikohen rastet e shkarkimit të gjyqtarit nga detyra dhe sipas saj, gjyqtari mund të shkarkohet nga Këshilli i Lartë i Drejtësisë për kryerjen e një krimi, për paaftësi mendore e fizike, për akte e sjellje që diskreditojnë rëndë pozitën dhe figurën e gjyqtarit, ose për pamjaftueshmëri profesionale.

Në rrethanat si më sipër për shqyrtimin e çështjes në rastin konkret, Kolegjet e Bashkuara të Gjykatës së Lartë i referohen drejtpërdrejt dhe vetëm dispozitës kushtetuese dhe konkludojnë se vendimi i Këshillit të Lartë të Drejtësisë për shkarkimin nga detyra të gjyqtarit P. A., nuk gjen mbështetje në asnjë nga rastet e parashikuara në nenin 147/6 të Kushtetutës së R. Shqipërisë.

Në vendimin e Këshillit të Lartë të Drejtësisë si shkelje që vijnë në kundërshtim me përmbushjen e rregullt të detyrës përmenden dy vendime gjyqësore, prej të cilave një i formës së prerë dhe mos deklarimi i saktë i pasurisë, shkelje që sipas anës paditur vijnë në kundërshtim me përmbushjen e rregullt

të detyrës dhe bazohen në nenin 42/6 të ligjit nr. 8436, datë 28.12.1998 “Për organizimin e pushtetit gjyqësor në R. Shqipërisë”, tashmë të shfuqizuar nga Gjykata Kushtetuese dhe nuk i referohet aspak rasteve të përmendura në nenin 147/6 të Kushtetutës dhe që përbëjnë shkaqet kryesore kur gjyqtari mund të shkarkohet nga detyra.

Megjithatë, Kolegjet e Bashkuara shqyrtojnë çështjen dhe analizojnë shkeljet në aspektin kushtetues dhe konstatojnë se ato nuk gjejnë mbështetje në asnjë nga rastet e parashikuara në nenin 147/6 të Kushtetutës. Pavarësisht nëse vendimet janë ose jo të formës së prerë nuk rezulton që ato të jenë shoqëruar me akte e sjellje që diskreditojnë rëndë pozitën dhe figurën e gjyqtarit, prandaj çmohet se K. L. Drejtësisë në shkarkimin e gjyqtarit nuk ka përmbushur detyrimin kushtetues”.²⁴⁵

Siç rezulton nga arsyetimi i mësipërm, Gjykata e Lartë e shqyrtoi çështjen pas shfuqizimit të një parashikimi ligjor nga ana e Gjykatës Kushtetuese, fakt ky, që ri dimensionoi edhe këtë çështje. Duke ruajtur standardin e vendosur më parë, rezultoi se përsëri, nga dy vendimet gjyqësore që ishin verifikuar, njëri prej tyre kishte marrë formë të prerë. Për rrjedhojë një gjyqtar nuk mundej që të shkarkohej, vetëm se i ishte prishur një vendim gjyqësor nga një gjykatë më e lartë. Gjithashtu edhe çështja e verifikimit të pasurisë së këtij gjyqtari nuk rezultoi bindëse, në atë shkallë, sa që të legjitimonte shkarkimin e tij.

Qasja e mësipërme u përforcua edhe me një vendimmarrje tjetër, ku arsyetohet se “1. Në funksion të detyrës së tij, Drejtoria e Inspektimit e Ministrisë së Drejtësisë, gjatë vitit 2003 ka ushtruar kontroll në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Vlorë, me objekt ligjshmërinë e gjykimeve të çështjeve penale lidhur me trafiqet e paligjshme dhe ato, vendimet e të cilave janë cenuar nga Gjykata e Apelit Vlorë ose Gjykata e Lartë.

Në përfundim të kontrollit është arritur në bindjen se ankuesi, në veprimtarinë e tij gjyqësore, ka lejuar shkelje të ligjit material dhe procedural, që konsistojnë në drejtimet e mëposhtme:

A. Shkelje e dispozitave materiale neni 53 i K. P. (2 vendime);

B. Shkelje e dispozitave materiale neni 59 i K. P. (7 vendime);

C. Shkelje e dispozitave ligjore mbi kualifikimin e veprës penale (1 vendim).

Si bazë ligjore KLD është mbështetur në Kushtetutën e RSH., neni 147§6, ligjin nr. 8436, datë 28.12.1998, nenet 40, 41, 42; ligjin për organizimin dhe funksionimin e KLD dhe rregulloren për procedimin disiplinor të gjyqtarëve.

2. Kolegjet e Bashkuara të Gjykatës së Lartë me vendimin datë 23.03.2005, i janë drejtuar Gjykatës Kushtetuese për t’u shprehur mbi pajtueshmërinë e ligjit nr. 8436, datë 28.12.1998 “Për organizimin e pushtetit gjyqësor në RSH” dhe konkretisht Kreu V (përgjegjësia disiplinore e gjyqtarëve) me nenin 147 të Kushtetutës.

3. Gjykata Kushtetuese në pranimin e kërkesës së Kolegjeve të Bashkuara,

245. Vendimi nr. 12, datë 08.03.2006 i Kolegjeve të Bashkuara të Gjykatës së Lartë.

d.m.th., në shfuqizimin e pikës 6, të nenit 42, të ligjit nr. 8436, datë 28.12.1998 "Për organizimin e pushtetit gjyqësor në RSH." ka arsyetuar se gjyqtari gëzon një mbrojtje të posaçme kushtetuese, d.m.th., mund t'i nënshtrohet vetëm masave disiplinore të parashikuara në Kushtetutë (Neni 147§6 Kushtetues).

4. Duke iu referuar ligjit nr. 8436, datë 28.12.1998 "Për organizimin e pushtetit gjyqësor në RSH.", Kreut V, përgjegjësia disiplinore e gjyqtarëve shihet se rregullimi i marrëdhënieve shoqërore në këtë fushë është bërë në disa nene të saj dhe konkretisht në nenin 40 ku janë përcaktuar rastet e përgjegjësisë disiplinore, nenin 41 që përmban shkeljet e disiplinës dhe në vazhdim nenin 42 që përmban masat kundër shkeljeve të konstatuara. Një ndër këto masa është edhe pika 6, shkarkimi i gjyqtarit nga detyra. Siç u arsyetua më lart kjo pikë është antikushtetuese, d.m.th., se ndaj gjyqtarit do të zbatohen vetëm rastet e përcaktuara shprehimisht në Kushtetutë si masë disiplinore. Veprimi i KLD në këtë rast nuk është në zbatim të kësaj kërkesë.

5. Ankuesi në mbrojtjen e tij ka pretenduar se disa nga vendimet objekt i procedimit disiplinor janë vendime të formës së prerë, për pasojë nuk mund të jenë objekt i procedimit.

6. KLD lidhur me këtë pretendim i referohet praktikës së Gjykatës Kushtetuese. Në vazhdim të qëndrimit të saj Gjykata Kushtetuese shprehet se si masë disiplinore ndaj gjyqtarit do të jenë ato të parashikuara në Kushtetutë dhe konkretisht kur vendimet shoqërohen me akte e sjellje që diskreditojnë rëndë pozitën dhe figurën e gjyqtarit. Në rastin objekt shqyrtimi pretendimi është vetëm për vendime gjyqësore, një pjesë e të cilave kanë marrë formë të prerë dhe jo për sjellje ose veprime që diskreditojnë rëndë pozitën dhe figurën e gjyqtarit. Shqyrtimi i përmbajtjes së vendimit i nënshtrohet vetëm rrugës ligjore, d.m.th. kontrollit gjyqësor sipas hierarkisë në sistemin gjyqësor. Vetëm organi gjyqësor ka të drejtën kushtetuese të vlerësojë ligjërisht përmbajtjen e një vendimi gjyqësor të dhënë nga gjyqtari. Pra pretendimi i KLD nuk është provuar dhe për pasojë pretendimi i parashtruar nga ankuesi është i drejtë dhe duhet të pranohet.

7. Ankuesi ka pretenduar se në dhënien e vendimeve ai ka qenë përgjithësisht anëtar i trupit gjykues dhe jo kryesues.

Masa disiplinore është një masë individuale dhe për pasojë, edhe përcaktimi i shkeljes duhet të ketë si qëllim të individualizojë drejt tërësinë e rregullave që janë shkelur dhe njëkohësisht edhe fajësinë e personit konkret në shkeljen e konstatuar. Përgjegjësia individuale për dhënien e një vendimi kolektiv, d.m.th. kur gjyqtari vepron në përbërje të trupit gjykues nuk është rast, që lejon individualizimin e saktë të shkeljes, për sa kohë që masa nuk merret edhe ndaj anëtarëve të tjerë të trupit gjykues. Gjyqtari si individ, nuk mund të veçohet nga përbërja e trupës për efekt të procedimit disiplinor. Në këtë rast merret në konsideratë edhe përvoja e personit, si dhe qëndrimi i tij profesional.

8. Kolegjet e Bashkuara të Gjykatës së Lartë, në zbatim edhe të praktikës së Gjykatës Kushtetuese, krijojnë bindjen se organi disiplinor ka tejkaluar kompetencat e tij ligjore. Shkarkimi i gjyqtarit mund të zbatohet vetëm në rastet

e parashikuara shprehimisht në Kushtetutë, Neni 147§6 i saj. KLD ka të drejtë të përcaktojë shkeljet e ndryshme disiplinore por nuk ka të drejtë të marrë si masë disiplinore shkarkimin e gjyqtarit nga detyra, për shkak të mbrojtjes së tij të veçantë kushtetuese.

Pra pretendimet e parashtruara nga ankuesi janë të drejta dhe duhet të pranohen. Edhe në aspektin e shkeljes tjetër disiplinore (akte e sjellje që diskreditojnë rëndë pozitën dhe figurën e gjyqtarit), pretendimet e parashtruara në vendimin e saj nga KLD nuk arritën të provohen dhe për pasojë duhet të rrëzohen".²⁴⁶

Siç mund të konstatohet në këto raste, përsëri Gjykata e Lartë ka refuzuar, që të konstatojë shkelje nga ana e gjyqtarit për vendime që kanë marrë formë të prerë, nëse ato nuk janë shoqëruar me sjellje që kanë diskretituar figurën dhe pozitën e gjyqtarit. Për këtë element të fundit, nga ana e KLD-së nuk kishte argumente, apo prova që ta mbështeste këtë pretendim. Duke ndryshuar qasjen e saj të mëparshme, Gjykata e Lartë gjithashtu përcaktoi, se nuk mundet që të pretendohet shkelje nga vetëm një anëtar i trupës gjyqësore, kur e gjitha trupa ka mbajtur të njëjtin qëndrim. Në këto raste, nëse ka pasur vend për konstatimin e përgjegjësisë disiplinore atëherë ajo duhej të ishte e përbashkët.

Nga analiza e kësaj përgjegjësie disiplinore mund të konkludohet, se vendimmarrja e gjyqtarëve duhet të bazohet në normat kushtetuese, ligjin material, atë procedural, provat e administruara me qëllim që të krijohet bindja e brendshme e gjyqtarit, në mënyrë të pavarur dhe objektive. Kjo qasje përbën bazën e një sistemi gjyqësor të drejtë dhe të paanshëm. Për pasojë, masat disiplinore ndaj gjyqtarëve nuk duhet të përdoren si mjet penalizues, për shkak të interpretimit juridik të kryer në përmbushje të detyrës së tyre, përveç rasteve kur vërtetohet qartazi, se ka nga ana e tyre ka pasur një qëllim për keqinterpretim të ligjit apo veprime në kundërshtim të hapur me standardet etike dhe profesionale.

Për më tepër, procedimi disiplinor kërkon që organet përgjegjëse për procedimin disiplinor të bëjnë dallimin mes shkeljeve teknike apo gabimeve në ushtrimin e detyrës dhe atyre shkeljeve që cenojnë rëndë figurën dhe besueshmërinë e gjyqtarit. Kjo ndarje është thelbësore për të shmangur penalizimin e padrejtë të gjyqtarëve për dobësi, që nuk cenojnë integritetin apo funksionin e tyre, duke u përqendruar në ato raste ku vërtetë rrezikohet funksionimi i sistemit të drejtësisë.

Gjithashtu, duhet theksuar se vendimmarrja gjyqësore nuk mundet që të vlerësohet nga organet që realizojnë procedimin disiplinor, por vetëm nga gjykatat më të larta. Ndërhyrja nëpërmjet procedimit disiplinor, mbi mënyrën e zgjidhjes së çështjes, përbën një shkelje të rëndë të pavarësisë së sistemit gjyqësor dhe cenon autoritetin e vendimeve gjyqësore.

8. *Moszbatimi pa arsye i masës së dhënë disiplinore.* Kjo lloj shkelje disiplinore, mund të konsumohej nga ana e gjyqtarëve, vetëm nëse më

246. Vendimi nr. 11, datë 11.09.2007 i Kolegjeve të Bashkuara të Gjykatës së Lartë.

parë ishte marrë një masë tjetër disiplinore të cilët ato e refuzonin të zbatonin. Nga tërësia e masave disiplinore që parashikonte ky ligj, për vetë natyrën e tyre, masat që mund të merreshin dhe që nuk zbatoheshin mund të ishin, pezullimi nga detyra dhe kalim në një detyrë tjetër më të ulët brenda gjykatës për një periudhë nga gjashtë muaj deri në një vit, ose masa tjetër ajo e transferimit në një gjykatë tjetër. Moszbatimi pa arsye i këtyre masave disiplinore të marra nga KLD-ja përfaqësonte një shkelje disiplinore tjetër që cenonte autoritetin dhe funksionimin e këtij organi, duke minuar rëndësinë e mekanizmave kontrollues. Gjyqtarët, si figura të rëndësishme në administrimin e drejtësisë, kishin detyrimin jo vetëm të respektonin rregullat dhe detyrimet profesionale, por edhe të zbatonin masat disiplinore të vendosura ndaj tyre. Moszbatimi i këtyre masave tregonte një mungesë përgjegjshmërie dhe krijonte një precedent të rrezikshëm për autoritetet e administrimit të sistemit të drejtësisë.

Përsa i përket masave disiplinore që mund të merreshin, ligji i vitit 1998, duke kopjuar parashikimet e ligjit të vitit 1998, parashikonte gjashtë të tilla dhe konkretisht ²⁴⁷ 1. Vërejtje; 2. Vërejtje me paralajmërim; 3. Ulje në pagë deri në masën 25 për qind, për një periudhë nga 3-6 muaj; 4. Pezullim nga detyra dhe kalim në një detyrë tjetër më të ulët brenda gjykatës për një periudhë nga gjashtë muaj deri në një vit; 5. Transferim në një gjykatë tjetër dhe 6. Shkarkim nga detyra.

Gjykata Kushtetuese, shqyrtoi kushtetutshmërinë e këtyre masave në tërësinë e tyre dhe mbajti qëndrimin, se *“Teoria normativiste e së drejtës ka në thelb të saj idenë se marrëdhëniet midis normave juridike bazohen mbi raportin e mbi/nën vendosjes së tyre. Rendi juridik nuk është një radhitje e barasvlershme normash, por një sistem hierarkik, i cili përbëhet nga nivele të ndryshme vlefshmërie, dhe në secilin prej këtyre niveleve qëndron një normë ose grup normash, duke përfshirë kështu edhe fuqinë e caktuar juridike. Kjo piramidë aktesh normative ka në majë të saj Kushtetutën, e cila shërben si burim për aktet e tjera juridike.*

Kushtetuta, si akt themelor i një shteti, parashikon organet dhe kushtet në të cilat duhet të nxirren aktet normative, duke synuar qëndrueshmërinë e tyre. Kushtetuta, mbi bazën e së cilës miratohen të gjitha aktet e tjera normative, mund të ndërmarrë si mision të saj edhe përcaktimin e përmbajtjes së ligjeve që duhet të miratohen në të ardhmen nga ligjvënësi. Kështu, konsiderohet si karakteristikë e kushtetutave të shkruara përcaktimi konkret i disa parimeve kryesore ose përfshirja absolute i disa rrethanave që konsiderohen si të papranueshme për të.

Rregullimet që bën Kushtetuta nuk mund të jenë gjithmonë të plota ose shteruese. Megjithatë disa çështje lidhur me rendin shtetëror mund të parashikohen në mënyrë të hollësishme prej saj, gjithsesi mbeten mjaft aspekte të organizimit të jetës institucionale për t’u parashikuar nga ligje ose akte të tjera normative, sipas rastit. Pra Kushtetuta nuk ka për qëllim të rregullojë

²⁴⁷ Ligji nr. 8436, datë 28.12.1998, neni 42.

hollësisht çdo çështje të organizimit të jetës shoqërore politike të një vendi, por vetëm të parimeve dhe kriterëve bazë mbi të cilat duhet të mbështetet ajo. Shpesh Kushtetuta qëllimisht lë hapësira rregullimi nga ligjvënësi i zakonshëm, në mënyrë që të mos pengojë marrjen e nismave politike, ekonomike, sociale e kulturore nga partitë politike ose qeveria. Por Kushtetuta, përveç kësaj mund të parashikojë hollësisht dhe shprehimisht rastet, për të cilat nuk mund t'i lërë hapësira rregullimi ligjvënësit të zakonshëm.

Nisur nga sa më sipër, Gjykata Kushtetuese rithekson se për çdo rast, kur rregullimi kushtetues parashikohet shprehimisht prej saj, ai detyrimisht do të zbatohet drejtpërdrejt. Përmbajtja e dispozitës kushtetuese nuk mund të mënjanohet ose të tejkalohet, duke i dhënë përparësi akteve juridike që dalin në bazë dhe për zbatim të Kushtetutës. Ky detyrim rrjedh nga përmbajtja e nenit 4/3 të Kushtetutës. Në rastet kur Kushtetuta lë hapësira me qëllim delegimin e kompetencës ligjvënësit të zakonshëm, atëherë nuk është e nevojshme referimi te kjo dispozitë, pra e zbatimit të drejtpërdrejt të saj. Nëse ndodhemi para kësaj situate është e pritshme, që aktet normative që do të dalin për këtë qëllim, të respektojnë hierarkinë e akteve normative.

Në vijim të logjikës juridike të përdorur më sipër dhe duke u kthyer konkretisht tek objekti i çështjes, Gjykata Kushtetuese vlerëson se gjyqtari, për shkak të funksionit që ka, trajtohet nga Kushtetuta si funksion kushtetues. Si i tillë, ai gëzon, përveç të tjerave, mbrojtje të posaçme nga Kushtetuta. Kjo del qartë nga përmbajtja e dispozitës, që parashikon shkarkimin e gjyqtarit, e cila është e ngjashme me atë të shkarkimit të zyrtarëve që ushtrojnë funksione të rëndësishme, duke përdorur të njëjtat standarde për këtë kategori funksionarësh shtetërorë. Megjithëse Kushtetuta ka parashikuar të njëjtin trajtim për këta funksionarë, një gjë të tillë nuk e kanë bërë ligjet për organizimin dhe funksionimin e institucioneve përkatëse. Konkretisht, për zyrtarët e parashikuar nga nenet 128 (gjyqtarët e Gjykatës Kushtetuese), 140 (gjyqtarët e Gjykatës së Lartë) dhe 149 (Prokurori i Përgjithshëm) të Kushtetutës, nuk është bërë asnjë formulim tjetër në ligjet organike të tyre. E kundërta ka ndodhur për gjyqtarët e nivelit të parë dhe të dytë në ligjin "Për organizimin dhe funksionimin e Këshillit të Lartë të Drejtësisë".

Nisur nga këto arsye, Gjykata Kushtetuese konstaton se Kushtetuta nuk ka pasur për qëllim, që të autorizojë ligjvënësin të parashikojë rastet e shkarkimit, pasi këtë ajo e ka bërë nëpërmjet nenit 147/6 të saj, sipas të cilit gjyqtari mund të shkarkohet nga Këshilli i Lartë i Drejtësisë për kryerjen e një krimi, për paafësi mendore a fizike, për akte a sjellje që diskreditojnë rëndë pozitën dhe figurën e gjyqtarit ose për pamjaftueshmëri profesionale. Ndërsa, sa i përket dhënies së masave të tjera disiplinore, neni 147/4 i Kushtetutës ia ka deleguar kompetencat ligjvënësit të zakonshëm, për të parashikuar rastet dhe kriteret e zbatimit konkret të tyre. Në favor të këtij përfundimi flet edhe dispozita e nenit 46 të ligjit për pushtetin gjyqësor, e cila parashikon rastin e ankimit në Gjykatën e Lartë kundër vendimit të shkarkimit nga detyra për një nga arsyet e parashikuara në

Kushtetutë. Ky togfjalësh i përdorur nga ligjvënësi, përforcon edhe më shumë qëndrimin e mbajtur nga kjo Gjykatë.

Nga ky këndvështrim, Gjykata Kushtetuese çmon se pika 6, i nenit 42 të ligjit për pushtetin gjyqësor, që parashikon shkarkimin e gjyqtarit për shkelje të disiplinës, është e papajtueshme me pikën 6 të nenit 147 të Kushtetutës dhe për këtë arsye, ajo duhet të shfuqizohet. Shkarkimi nga detyra i gjyqtarit, e drejta e ankimit ndaj këtij vendimi, si dhe organi që duhet ta marrë atë në shqyrtim, rregullohen drejtpërdrejt nga Kushtetuta. Kjo përbën një garanci më shumë për gjyqtarët për shkak të funksionit që ata kryejnë dhe misionin që u ka ngarkuar shteti dhe shoqëria.

Shkarkimi i gjyqtarit nga detyra sipas nenit 46/6 të ligjit, në referim të nenit 41, nuk përputhet me rastet konkrete të parashikuara nga neni 147/6. Parashikimi i shkarkimit nga detyra në të njëjtën dispozitë ligjore ku listohen edhe masat e tjera disiplinore, mënjanon aplikimin e nenit 147/6 të Kushtetutës, si dhe shkakton antikushtetutshmëri në procedimin e gjyqtarëve.

Shfuqizimi i kësaj dispozite nuk krijon boshllëk ligjor, sepse mund të zbatohet direkt rregullimi i nenit 147/6 të Kushtetutës. Në ndihmë të interpretimit të kësaj dispozite vjen edhe vendimi i Gjykatës Kushtetuese për interpretimin e neneve 128, 140 e 149/2 të Kushtetutës, konkretisht i shprehjes “akte e sjellje që diskreditojnë rëndë figurën. Gjykata Kushtetuese ka mbajtur qëndrimin, se kjo shprehje përmbledh në vetvete një sërë elementesh, të cilat mund të identifikohen rast pas rasti nga organi përkatës që merr vendimin për shkarkimin e gjyqtarëve të Gjykatës Kushtetuese, të Gjykatës së Lartë dhe të Prokurorit të Përgjithshëm. Më tej, Gjykata Kushtetuese vazhdon me arsyetimin, se ato janë të lidhura me akte e sjellje të parregullta e të padenja që këta funksionarë të lartë kryejnë gjatë ushtrimit të detyrës, për shkak të saj, si dhe jashtë detyrës. Këto veprime apo mosveprime që analizohen në bazë të rrethanave të kryerjes së tyre, momenti subjektiv, si dhe dëmet që i sjellin shoqërisë dhe shtetit duhet të jenë të asaj natyre që e bëjnë të pamundur kryerjen e mëtejshme të funksioneve kushtetuese nga këto subjekte”.²⁴⁸

Nga arsyetimi i mësipërm, rezulton se Gjykata Kushtetuese konstatoi problematika antikushtetuese, vetëm për një masë disiplinore, e cila tejkallonte rastet e shkarkimit të gjyqtarëve, që parashikoheshin në Kushtetutë. Nëpërmjet këtij arsyetimi, Gjykata Kushtetuese zgjodhi një qasje tekstualiste, duke mos dalë jashtë parashikimeve të hartuara nga ligjvënësi kushtetues dhe duke mos pranuar që të shtohen raste të tjera. Ky qëndrim tregon edhe një shkelje nga qëndrimi, që po kjo Gjykatë, kishte mbajtur në rastet e largimit të gjyqtarëve të Gjykatës së Kasacionit dhe të prokurorit të Përgjithshëm, ku nëpërmjet një qasje evolutive ishte pranuar zgjerimi i rasteve të shkarkimit të këtyre funksionarëve.

Përsa i përket masës së pestë, asaj të transferimit në një gjykatë tjetër, ky parashikim u riformulua me reformën e vitit 1999, duke u përcaktuar

248. Vendimi nr. 3, datë 20.02.2006 i Gjykatës Kushtetuese

transferimin në një gjykatë tjetër të të njëjtit nivel, ose të një niveli më të ulët.²⁴⁹ Pra në këtë rast, u përcaktua jo vetëm zhvendosja nga një gjykatë në një gjykatë tjetër, por dhe ulja nga një gjykatë më e lartë, në një gjykatë më të ulët. Duke qenë se Këshilli i Lartë i Drejtësisë ishte kompetent vetëm për trajtimin e përgjegjësisë disiplinore për gjyqtarët e gjykatave të apelit dhe të gjykatës së shkallës së parë, atëherë, ky parashikim i ri, zbatohet vetëm për gjyqtarët e Gjykatës së Apelit, të cilët mund të uleshin, si “ndëshkim” për shkeljet e tyre, që të ushtronin detyrën në një gjykatë të nivelit më të ulët.

Megjithatë, ky parashikim u kundërshtua, më vonë si antikushtetues dhe Gjykata Kushtetuese, duke pranuar pretendimet e ngritura, arsyetoi se “Gjykata Kushtetuese e sheh me vend që t’i referohet praktikës së saj të mëparshme në lidhje me funksionin kushtetues që përmbushin gjyqtarët, të cilët nga Kushtetuta dhe ligji janë të ngarkuar me dhënien e drejtësisë. Kushtetuta, duke parashikuar një standard të rëndësishëm për mbrojtjen e statusit të gjyqtarëve është përqendruar vetëm në trajtimin e transferimit e të shkarkimit të tyre nga detyra, pa bërë fjalë edhe për masat e tjera disiplinore. Për këto raste, norma kushtetuese zbatohet drejtpërsëdrejti.

Përgjashtimi kushtetues i parashikuar në nenin 4, pika 3 të Kushtetutës, nënkupton se normat kushtetuese mund të mos gjejnë zbatim drejtpërsëdrejti, kur Kushtetuta ka ngarkuar organet shtetërore për të nxjerrë ligjet dhe aktet e tjera nënligjore, me qëllim rregullimin e marrëdhënieve në fusha të ndryshme.

Gjykata Kushtetuese, veç kësaj, e çmon të nevojshme të përqendrohet në mënyrën e formulimit të nenit 147, pikat 4, 5, të Kushtetutës. Sipas pikës 4 të këtij neni: “Këshilli i Lartë i Drejtësisë vendos për transferimin e gjyqtarëve, si dhe për përgjegjësinë e tyre disiplinore, sipas ligjit”; ndërsa sipas pikës 5 “Transferimi i gjyqtarëve nuk mund të bëhet pa pëlqimin e gjyqtarëve, përveçse kur këtë e diktojnë nevojat e riorganizimit të sistemit gjyqësor. Siç shihet, kjo dispozitë përcakton dy nga kompetencat e rëndësishme (përgjashtuar kompetencën për të vendosur për shkarkimin e tyre nga detyra) që ka Këshilli i Lartë i Drejtësisë, që janë: transferimi i gjyqtarëve dhe marrja e masave disiplinore.

Kushtetuta e ka trajtuar transferimin, si një mjet të nevojshëm, që mund të përdoret vetëm me pëlqimin e gjyqtarit ose për nevojat e riorganizimit të sistemit gjyqësor (për të cilin nuk është e domosdoshme marrja e pëlqimit të tij).

Por, veç këtyre, pika 4 ka zgjidhur dhe një problem tjetër të rëndësishëm, duke ngarkuar Këshillin e Lartë të Drejtësisë për të vendosur edhe për masat disiplinore.

Gjykata Kushtetuese është shprehur se kjo dispozitë kushtetuese përmban elementet e një norme referuese, për shkak se mënyrën e transferimit të gjyqtarëve dhe përgjegjësinë e tyre disiplinore ia ka deleguar ligjvënësit, duke pranuar se ligjvënësit i është dhënë e drejta që nëpërmjet ligjeve të rregullojë në mënyrë të hollësishme çështjet që përfshihen vetëm në këto dy drejtime të specifikuar.

249. Ligji nr. 8546, datë 05.11.1999, neni 12.

Është e vërtetë se në rastin e parashikuar pika 4 e nenit 147 të Kushtetutës, nuk shprehet drejtpërdrejt për transferimin edhe si masë disiplinore, por për këtë problem të rëndësishëm ajo referon te ligji konkret; ndërsa në nenin 42 të ligjit nr. 8436, datë 28.12.1998 "Për organizimin e pushtetit gjyqësor në Republikën e Shqipërisë", parashikohen masat që mund të merren nga Këshilli i Lartë i Drejtësisë në rast se vërtetohen rrethanat e përgjegjesisë disiplinore po sipas këtij ligji.

Pavarësisht se përdoret i njëjti term, transferim, ai në përmbajtjen e tij nuk nënkupton të njëjtën gjë, pasi nuk bëhet fjalë për transferim me pëlqimin e gjyqtarit dhe as për transferim për nevojat e riorganizimit të sistemit gjyqësor, por për një lloj transferimi që përdoret si një masë disiplinore ndaj gjyqtarit. Për këtë ligjvënësi mund të kishte përdorur edhe një term tjetër, siç mund të ishte dërgimi në një gjykatë tjetër ose lëvizja në një gjykatë tjetër etj. Me qëndrimet që mban Kushtetuta për transferimin, që si rregull, kërkon pëlqimin e gjyqtarit, ajo indirekt siguron, jep garanci për pavarësinë e tij. Duke bërë një përjashtim për rastet kur bëhet fjalë për riorganizimin e sistemit gjyqësor, ajo vë në balancë interesat e tij vetjake me ato publike, që lidhen drejtpërsëdrejti me mosfunksionimin e një gjykate konkrete të këtij sistemi.

Por, pavarësisht nga fakti se Kushtetuta nuk e ndalon transferimin, edhe si masë disiplinore, që mund të kishte edhe me një emërtim tjetër; për çështjen në shqyrtim, merr rëndësi fakti tjetër që ka të bëjë me mënyrën, se si ligji i ka konceptuar masat disiplinore për gjyqtarët.

Masat disiplinore që merr Këshilli i Lartë i Drejtësisë kanë karakter të përkohshëm, por i shërbejnë funksionimit normal të veprimtarisë së gjykatave. Si të tilla ato i shërbejnë edhe rehabilitimit të gjyqtarit të ndëshkuar.

Gjykata Kushtetuese është e detyruar ta ballafaqojë këtë koncept, me atë që ka transferimi, sipas doktrinës e sipas legjislacionit të kohës, edhe në vendet e tjera. Në këtë proces, kjo gjykatë vëren se në dispozitën e kundërshtuar, transferimi është parashikuar si një masë disiplinore me karakter të përhershëm, njësoj sikur të ishte një marrëdhënie e re pune me afat të pacaktuar. Ky qëndrim bie ndesh me konceptin që ka transferimi që karakterin e përkohshmërisë e ka si një ndër elementet e domosdoshme të tij. Kjo kërkesë është shumë e rëndësishme sepse edhe nga ekzistenca ose jo e saj, kjo masë dallon nga largimi nga puna.

Veç kësaj, ligji nuk ka parashikuar as mundësinë që kjo masë të parashkruhet me kalimin e një afati të caktuar. Ndryshe nga sa konstatohet në legjislacionin e vendeve të ndryshme, në përgjithësi janë vendosur afate me kalimin e të cilave masat disiplinore në përgjithësi dhe transferimi në veçanti, parashkruhen dhe gjyqtarët ndaj të cilëve merren ato, nuk konsiderohen si të ndëshkuar.

Gjykata Kushtetuese konstaton se edhe vetëm fakti, që transferimi nuk është konceptuar konform standardeve të duhura kushtetuese, e bën këtë dispozitë si të papajtueshme me Kushtetutën, prandaj për këto arsye duhet shfuqizuar".²⁵⁰

Ligjvënësi, në hartimin e ligjit organik për gjyqësorin në vitin 1998, u kufizua vetëm në kopjimin me disa ndryshime stilistike të parashikimeve,

250. Vendimi nr. 21, datë 07.06.2007 i Gjykatës Kushtetuese.

që kishte ligji i vitit 1997 dhe që është trajtuar më sipër. Por ky ligj kishte dalë në bazë të baze tjetër kushtetuese, që nuk kishte qenë e plotë në këtë drejtim. Është e vërtetë që Kushtetuta e vitit 1998, parashikonte që KLD-ja vendoste për transferimin e gjyqtarëve, por ky rregullim trajtonte lëvizjet e gjyqtarëve për nevoja riorganizimi të sistemit të drejtësisë dhe nuk kishte si qëllim njohjen e këtij instituti, si masë disiplinore. Gjithashtu, mungesa e përkohshmërisë së kësaj mase, sillte pasoja për respektimin e parimit të palëvizshmërisë së gjyqtarëve, duke qenë se në zbatim të një mase të tillë, këta gjyqtarë mund të uleshin në hierarkinë gjyqësore ose të transferoheshin në vende të largëta në mënyrë të përhershme. Për këtë arsye, nga ana e Gjykatës Kushtetuese ky parashikim me të drejtë, u konsiderua si antikushtetues.

Duke vijuar me parashikimet ligjore, parashikohej se masat disiplinore ndaj gjyqtarëve merreshin nga Këshilli i Lartë i Drejtësisë, në bazë të vlerësimit të llojit dhe të karakterit të shkeljes së kryer.²⁵¹

Ligji duke respektuar parimet kushtetuese dhe standardet ndërkombëtare parashikonte, se gjyqtari kur shkarkohet nga detyra për një nga arsyet e parashikuara në Kushtetutë, kishte të drejtë të ankohej në Gjykatën e Lartë brenda 10 ditëve nga njoftimi i vendimit të Këshillit të Lartë të Drejtësisë, e cila vendoste në kolegjet e bashkuara.²⁵²

Përsa i përket natyrës së afatit ankimor, që parashikohej të ishte 10-ditor, jurisprudenca e ka vlerësuar si afat të prerë, tejkalimi i të cilit, sillte si pasojë mospranimin e kërkesëpadisë së paraqitur. Kjo qasje ka qenë e qëndrueshme në kohë, ku fillimisht Gjykata e Lartë është shprehur, se *“Pavarësisht nga shkaqet e parashtruara nga paditësi P. T., kundër vendimit të K. L. Drejtësisë, padia e tij është paraqitur tej afatit të parashikuar në ligj, prandaj vetëm për këtë shkak ajo nuk duhet të pranohet.*

Nga materialet e çështjes rezulton se për vendimin e Këshillit të Lartë të Drejtësisë, paditësi ka marrë dijeni më datë 02.11.2000, ndërsa padia për anulimin e këtij vendimi është paraqitur pranë Gjykatës së Lartë më datë 23.11.2000.

Në bazë të nenit 46 të ligjit nr. 8436, datë 28.12.1998 gjyqtari kur shkarkohet nga detyra për një nga arsyet e parashikuara në Kushtetutë ka të drejtë të ankohet në Gjykatën e Lartë brenda 10 ditëve nga njoftimi i vendimit të Këshillit të Lartë të Drejtësisë dhe duke pasur parasysh sa më sipër, konstatohet se padia e ngritur nga P. T., është paraqitur jashtë afatit të parashikuar në ligj.

Ndodhur në këto rrethana, Kolegjet e Bashkuara çmojnë se nuk mund të investohen për shqyrtimin e çështjes në themel për ligjshmërinë e vendimit të Këshillit të Lartë të Drejtësisë, por duhet të rrëzojnë padinë vetëm pse ajo është paraqitur tej afateve të parashikuara në ligj.”²⁵³

Ky lloj afati, lidhet me qëndrueshmërinë e marrëdhënieve juridike, përfshirë edhe ato që kanë të bëjnë me statusin e gjyqtarit. Një gjyqtar

251. Ligji nr. 8436, datë 28.12.1998, neni 43.

252. Ligji nr. 8436, datë 28.12.1998, neni 46.

253. Vendimi nr. 17, datë 13.02.2001 i Kolegjeve të Bashkuara të Gjykatës së Lartë.

që shkarkohet nga organi kompetent, nëse nuk është dakord, duhet të reagojë sa më shpejt dhe të kundërshtojë këtë vendimmarrje. Kjo është edhe arsye, që ligjvënësi kishte parashikuar një afat të tillë 10 ditor, i cili nuk mundet që të tejkalohet.

E njëjta qasje dhe kuptim i kësaj norme u mbajt edhe më tej, nga organe të tjera kushtetuese, të krijuara më vonë, ku Kolegji i Posaçëm i Apelimit, ka arsyetuar se “31. Në shqyrtim të pretendimeve të paraqitura nga ankuesja, Kolegji vëren se afati i ankimit ndaj vendimeve të KLD-së, ka qenë i parashikuar në nenin 46 të ligjit nr. 8436/1998, në fuqi në kohën kur është dhënë vendimi objekt shqyrtimi. Sipas kësaj dispozite, gjyqtari kur shkarkohet nga detyra për një nga arsyet e parashikuara në Kushtetutë, ka të drejtë të ankohet në Gjykatën e Lartë brenda 10 ditëve nga njoftimi i vendimit të Këshillit të Lartë të Drejtësisë. Afati 10-ditor për ushtrimin e ankimit ka qenë afat prekluziv dhe i detyrueshëm për zbatim për të kundërshtuar vendimet e KLD-së për çfarëdo shkak. Parashikimi i nenit 117 të Kodit të Procedurave Administrative, i cituar nga ankuesja, i referohet të drejtës për paraqitjen e ankimit në organin administrativ epror dhe jo të drejtës për t’iu drejtuar gjykatës, për të cilën ligji ka parashikuar një rregullim të posaçëm.

32. Ankuesja pretendon se nuk ka ushtruar të drejtën e ankimit ndaj vendimit nr. 117, datë 17.09.2001, pasi nuk ka marrë njoftim lidhur me këtë vendim. Ankuesja pretendon se i është njoftuar vendimmarrja, por jo vendimi dhe se ky ka qenë shkak që nuk ka ushtruar të drejtën e ankimit. Sipas saj, nuk është realizuar njoftimi për sa kohë që nuk i është komunikuar një akt në kuptimin formal. Gjithashtu, ankuesja pretendon se njoftimi /komunikimi i vendimit nga ministri i drejtësisë nuk i është bërë në mënyrë individuale. Në shqyrtim të këtyre pretendimeve, nga verifikimi i akteve që ka paraqitur KLGj-ja, Kolegji konstaton se ministri i drejtësisë, me të njëjtën shkresë me nr. {***} prot., datë 26.9.2001, i është drejtuar njëkohësisht Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Pogradec dhe ankuses (Gjykata e Rrethit Gjyqësor Pogradec, znj. M.M.), duke njoftuar se: “Me vendimin nr. 117, datë 17.9.2001, të Këshillit të Lartë të Drejtësisë, znj. M.M., gjyqtare në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Pogradec, për kryerjen e veprimeve në kundërshtim me përmbushjen e rregullt të detyrës, shkarkohet nga detyra e gjyqtares”. Kjo shkresë është regjistruar në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Pogradec me nr. {***} prot., datë 28.9.2001. Në këtë shkresë vihet re dhe shënimi i drejtuesit të gjykatës, i datës 3.10.2001, drejtuar kancelarit të kësaj gjykate për kryerjen e veprimeve. Nga analizimi i saj, Kolegji konstaton se shkresa, që përmban edhe emrin e gjyqtares M. M., e protokolluar në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Pogradec, është kaluar për veprim. Si rrjedhojë logjike, veprimet që kushtëzonte kjo shkresë ishin ato financiare për ndërprerjen e marrëdhënieve të punës, si dhe për detyrimin e gjyqtares për kryerjen e dorëzimeve të dosjeve dhe dokumentacionit që kishte në ngarkim. Për sa më lart, Kolegji vlerëson se shkresa me nr. {***} prot., datë 26.9.2001, e ministrit të drejtësisë, regjistruar në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Pogradec me nr. {***} prot., datë 28.9.2001,

sjellë nga KLGJ-ja së bashku me parashtrimet dhe përcjellë edhe ankueses [1ç, përbën një provë që njoftimi është kryer dhe ankuesja nuk e ka kundërshtuar me parashtrimet e saj. Pra, rezulton se ankuesja ka marrë dijeni për vendimmarrjen e KLD-së në muajin tetor 2001[2ç, ashtu si dhe ka pranuar vetë në ankimin drejtuar Kolegjit. Referuar përmbajtjes së shkresës së mësipërme, si dhe ndërprerjes së marrëdhënieve të punës të ankueses, Kolegji çmon se këto janë fakte të mjaftueshme për të konkluduar se ankuesja efektivisht ka pasur dijeni për vendimin e KLD-së për shkarkimin e saj nga detyra, dhe se janë të pabazuara pretendimet e saj se nuk ka marrë njoftim.

33. Për sa më sipër, Kolegji konstaton se ankuesja, megjithëse ka pasur dijeni për vendimmarrjen e KLD-së për dhënien e masës disiplinore të shkarkimit nga detyra, nuk ka paraqitur ankim ndaj këtij vendimi brenda 10 ditësh, menjëherë sapo ka ndërprerë marrëdhëniet financiare me Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Pogradec. Shkelja e afatit prekluziv 10-ditor të ankimit që parashikon neni 46 i ligjit të posaçëm nr. 8436/1998, ka sjellë si pasojë humbjen e të drejtës së ankueses për t'iu drejtuar Gjykatës së Lartë. Kolegji vëren se ankuesja, duke ngritur pretendimin se vendimi i KLD-së është akt administrativ absolutisht i pavlefshëm, kërkon që të bazojë dhe të rivendosë në afat kërkesën e saj, me arsyetimin se në rastin e një vendimi absolutisht të pavlefshëm, sipas nenit 117 të Kodit të Procedurave Administrative, kundërshtimi i vendimit mund të bëhet në çdo kohë.

34. Gjithashtu, Kolegji vëren se ankuesja nuk sjell asnjë provë për të provuar se menjëherë pas daljes së vendimit të KLD-së, ajo të ketë bërë qoftë edhe një përpjekje të vetme, për t'u njohur dhe për të marrë një kopje të tij me qëllimin për ta kundërshtuar shkarkimin në Gjykatën e Lartë. Rezulton nga aktet se vetëm në datën 19.5.2016, pas gati 15 vitesh nga vendimmarrja e KLD-së, ankuesja ka depozituar në Gjykatën e Lartë kërkesën për pavlefshmëri absolute të vendimit nr. 117, datë 17.9.2001, të KLD-së. Kolegji konstaton se edhe në momentin e paraqitjes së kërkesës në Gjykatën e Lartë, sërish ankuesja nuk ka pasur kopje të vendimit të KLD-së, të cilin e ka marrë vetëm pas kërkesës së saj të datës 28.6.2016 (një muaj pasi kishte depozituar kërkesën në Gjykatën e Lartë, me shkresën kthim përgjigje nr. {***} prot., datë 11.7.2016, të KLD-së). Këto dy akte, ankuesja edhe pse i ka marrë në vitin 2016, në mënyrë të pashpjegueshme i ka paraqitur në Gjykatën e Lartë në datën 07.10.2022, pas më shumë se 6 (gjashtë) vitesh nga regjistrimi i kërkesës në këtë gjykatë dhe nga disponimi i këtyre akteve.

35. Kolegji vëren se ankuesja nuk jep asnjë arsye objektive për të argumentuar dhe justifikuar faktin se përse vetëm pas gati 15 viteve, në datën 28.06.2016, i është drejtuar për herë të parë KLD-së me kërkesën për të marrë një kopje të vendimit nr. 117/2001 të këtij organi, si dhe përse edhe pas marrjes së këtij vendimi e ka depozituar atë në Gjykatën e Lartë me 6 (gjashtë) vite vonesë. Këto veprime/mosveprime të ankueses, si dhe sjellja e pashpjegueshme dhe e pakuptueshme e saj krijojnë bindjen e Kolegjit se ankuesja për vite të tëra nuk ka treguar asnjë interes për masën disiplinore të vendosur ndaj saj nga KLD-ja dhe demonstrojnë një qëndrim neglizhues dhe indiferent nga ana e saj për

të realizuar ushtrimin e të drejtës së ankimit dhe për të përmbushur kriteret formale që ligji i posaçëm nr. 8436/1998 parashikonte për ushtrimin e tij.

36. Kolegji çmon të theksojë se vërtet e drejta e ankimit, si e drejtë themelore e garantuar nga nenet 6 dhe 13 të Konventës Evropiane të të Drejtave të Njeriut, si dhe neni 43 i Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, në interpretim të parimeve juridike dhe frymës së legjislacionit procedural, është garanci për një proces të rregullt ligjor, por nga ana tjetër, individit duke mos e ushtruar këtë të drejtë brenda afateve të përcaktuara ligjore, me vullnetin dhe me sjelljen e vet, në kushtet e mungesës së pengesave objektive, humbet mundësinë për të kërkuar realizimin e saj në çdo kohë dhe me çfarëdo mjeti ligjor apo procedural.

37. Gjykata Kushtetuese në jurisprudencën e saj ka pohuar se shteti i së drejtës nuk mund të konceptohet, pa u njohur individëve të drejtën për t'iu drejtuar gjykatës, e cila nuk përfshin vetëm të drejtën për të filluar një proces, por edhe të drejtën për të pasur një zgjidhje gjyqësore përfundimtare për mosmarrëveshjen. Nëse mohohet kjo e drejtë, procesi konsiderohet i parregullt, sepse aksesit në gjykatë është, para së gjithash, kusht kryesor për të realizuar mbrojtjen e të drejtave të tjera të individit. Megjithatë e drejta e aksesit mund të kufizohet, kur bëhet fjalë për kushtet e pranueshmërisë së një ankimi, siç janë afatet e përcaktuara në Kushtetutë dhe ligje. Gjykata ka pranuar se mbrojtja kushtetuese dhe ligjore e të drejtave dhe lirive të individit mund të realizohet vetëm kur ushtrohet brenda afateve të përcaktuara në Kushtetutë dhe ligje. Përcaktimi i këtyre afateve nuk përbën qëllim në vetvete, por është në funksion të parimit të sigurisë juridike, si një nga parimet themelore të shtetit të së drejtës. Mos përcaktimi i këtyre afateve do të çonte në një situatë të tillë, ku konfliktet gjyqësore asnjëherë nuk do të zgjidheshin përfundimisht mes palëve dhe situata e tyre do të ishte e pasigurt, pasi në çdo moment një e drejtë e fituar me një vendim gjyqësor, potencialisht do të mund të cenohej apo prekej me një vendim të dhënë nga një gjykatë më e lartë [3ç.

38. Në përfundim të shqyrtimit të këtij ankimi, Kolegji vlerëson se ankuesja me vullnetin e saj nuk ka shfrytëzuar afatin ligjor të ankimit të parashikuar në ligjin e posaçëm, e për rrjedhojë, ka humbur të drejtën për të paraqitur ankim ndaj vendimit nr. 117, datë 17.09.2001, të KLD-së".²⁵⁴

Nga këto raste, rezulton se jemi përpara një jurisprudence të konsoliduar, që thekson se afatet për ushtrimin e ankimit kundër vendimeve të Këshillit të Lartë të Drejtësisë ishin prekluzive dhe të detyrueshme për respektim, duke garantuar parimin e sigurisë juridike. Rregullimi i këtyre afateve shërben për të siguruar një balancë midis të drejtës së aksesit në gjykatë dhe nevojës për një zgjidhje përfundimtare të mosmarrëveshjeve, në respekt të parimeve kushtetuese dhe të standardeve ndërkombëtare. Mosrespektimi i këtyre afateve nga gjyqtarët, siç konstatohet në rastin konkret, i privon ata nga mundësia për të kërkuar rivlerësimin e një vendimmarrije dhe shmang mbajtjen e

254. Vendimi nr. 3, datë 15.12.2023 i Kolegjit të Posaçëm të Apelimit.

hapur të konflikteve gjyqësore në kohë të pacaktuar.

Normalisht vendimi i Gjykatës së Lartë, konsiderohej i formës së prerë dhe përfundimtar, por edhe gjyqtarët, si çdo individ, gëzonin edhe mundësinë për të ushtruar ankimin kushtetues individual, i cili në atë kohë ishte kufizuar, vetëm përsa i përket të drejtës për një proces të rregullt ligjor. Për të kuptuar deri ku shtrihej kontrolli kushtetues në këtë rast, po i referohemi praktikës së Gjykatës Kushtetuese, e cila ka mbajtur qëndrimin, se *“Në vështrim të kësaj dispozite, Gjykata Kushtetuese merr në konsideratë vetëm ato pretendime, që lidhen me procesin e rregullt ligjor dhe jo çdo pretendim të parashtruar nga individit për parregullsi në gjykimin e çështjes. Për rrjedhojë, nuk është detyrë e Gjykatës Kushtetuese të vlerësojë nëse Gjykata e Lartë, si instancë që gjykon ankimet ndaj vendimeve të Këshillit të Lartë të Drejtësisë, i ka mbledhur ose jo të gjitha provat e propozuara nga palët për të konkluduar mbi vërtetësinë e faktit që i atribuohet ankuesit. Në të njëjtën kohë nuk është e drejtë e Gjykatës Kushtetuese të vlerësojë vendimin e Gjykatës së Lartë, nëse fakti i pranuar si i vërtetë prej saj përbën shkelje dhe nëse kjo shkelje është ose jo e rëndë. Këto çështje i takojnë për zgjidhje Gjykatës së Lartë, e cila, në përputhje me procedurën dhe brenda pretendimeve të ngritura nga palët, mbledh ato prova që ajo i vlerëson të mjaftueshme për të, për të konkluduar mbi ankimin e paraqitur dhe ligjshmërinë e vendimit të ankimit të Këshillit të Lartë të Drejtësisë. Në rastin konkret të kërkuës S. Zh., Kolegjet e Bashkuara të Gjykatës së Lartë, duke vlerësuar pretendimet e parashtruara në ankimin e kërkuës si dhe duke shqyrtuar materialet që përmban çështja, kanë arritur në përfundimin se veprimet e kërkuës të kryera më datën 14 shtator 1998, në vështrim të neneve 29, 34, 40 e 41, pikat 1 e 6 të ligjit nr. 8436, datë 28.12.1998 “Për organizimin e pushtetit gjyqësor në Republikën e Shqipërisë”, përbëjnë shkelje disiplinore që justifikojnë masën disiplinore të aplikuar ndaj saj. Duke u parë problemi në këtë këndvështrim, pretendimet e ngritura nga kërkuësja para Gjykatës Kushtetuese, për hetim jo të plotë të çështjes si dhe për mos marrjen nga Gjykata e Lartë e të gjitha provave të kërkuara nga palët, përfshi këtu edhe mos administrimin e kasetës filmike, apo pretendimet në lidhje me natyrën e shkeljes dhe vlerësimin e saj, nuk kanë lidhje me procesin e rregullt ligjor, prandaj nuk mund të shërbejnë si shkak për shfuqizimin si antikushtetues të vendimit të Kolegjeve të Bashkuara të Gjykatës së Lartë”*.²⁵⁵

Siç mund të konstatohet, kontrolli kushtetues ishte i kufizuar vetëm në pretendimet me natyrë kushtetuese, që preknin elementët e së drejtës për një proces të rregullt ligjor dhe nuk mund të konsiderohej si një instancë apelimi, mbi vendimarrjen e Gjykatës së Lartë.

255. Vendimi nr. 18, datë 18.04.2000 i Gjykatës Kushtetuese.

2. Inspektimi dhe disiplina sipas ligjit nr. 8737, datë 12.02.2001 “Për organizimin dhe funksionimin e prokurorisë”

Siç u trajtua më sipër, Kushtetuta e vitit 1998, solli ndarjen e Prokurorisë, si organ kushtetues, nga pushteti gjyqësor. Për këtë arsye, organizimi dhe funksionimi i Prokurorisë, duhej të bëhej mbi baza të tjera ligjore. Megjithatë, për shkak se ligjvënësi i dha përparësi organizimit dhe funksionimit të pushtetit gjyqësor, duke miratuar në vitin 1998, ligjin organik vetëm për këtë pushtet, me shfuqizimin e ligjit nr. 8265, datë 18.12.1997 “Për organizimin e drejtësisë” organizimi dhe funksionimi i Prokurorisë, përfshirë edhe situatën e inspektimit dhe përgjegjësisë disiplinore mbeti në një boshllëk legjislativ, i cili u plotësua vetëm me miratimin nga Kuvendi i ligjit nr. 8737, datë 12.02.2001 “Për organizimin dhe funksionimin e prokurorisë”, akt i cili në kohë të ndryshme, pësoi amendime të shumta.

Fillimisht në momentin e miratimit, ky ligj parashikonte si shkak për shkarkimin e prokurorëve, tri situata të ndryshme dhe konkretisht a) kur dënohej me vendim gjykate të formës së prerë për kryerjen e një vepre penale; b) kur merrte masë disiplinore për kryerjen e veprimeve që diskreditonin rëndë figurën e prokurorit, si edhe c) kur ishte i vlerësuar i paaftë, gjatë procedurës së vlerësimit në punë.²⁵⁶

Me reformën e vitit 2003, u saktësua më mirë situata e mbarimit të statusit të prokurorit, duke përcaktuar si rast shkarkimi, situatën kur ndaj tij jepej masa e shkarkimit nga Presidenti.²⁵⁷ Më tej, ligjvënësi vendosi të ndërhyjë përsëri dhe me reformën e vitit 2008, u zgjeruan rastet e përfundimit të statusit të prokurorit, duke përcaktuar si raste, kur prej tij kryheshin shkelje disiplinore, që kishin të bënin me nxjerrjen e sekretit të hetimit ose të dhënave të tjera me karakter konfidencial, me kryerjen e veprimeve që diskreditonin rëndë figurën e prokurorit, si edhe me kryerjen e veprimeve, që sipas ligjit, ishin të papajtueshme me funksionet e prokurorit.²⁵⁸

Rastet e mësipërme, që rregullojnë mbarimin e statusit të prokurorit, nuk lidhen të gjitha me përgjegjësinë disiplinore të prokurorit. Për këtë arsye, nëpërmjet jurisprudencës së saj, Gjykata e Lartë bëri edhe dallimin midis mbarimit të statusit të prokurorit, për shkak të shkarkimit të tij nga detyra, si edhe mbarimi i statusit të prokurorit për shkak të vlerësimit të tij si të paaftë në kryerjen e detyrave të tij funksionale. Kështu, Gjykata e Lartë për këtë rast ka arsyetuar, se “*Nisur nga funksioni i prokurorit që sipas*

256. Nenet 27, 32, germa “d” dhe 42, pikat 3 dhe 4 të ligjit nr. 8737, datë 12.02.2001 “Për organizimin dhe funksionimin e prokurorisë”.

257 Ligji nr. 9102, datë 10.07.2003, neni 11.

258 Ligji nr. 10 051, datë 19.12.2008, neni 14.

dispozitës së nenit 148/2 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, si dhe nga pasojat që mund t'i sjellin shoqërisë prokurorët me veprimet e tyre diskredituese e në kundërshtim me ligjin, Kolegji Civil çmon se diskreditimi i figurës së gjyqtarit dhe prokurorit kanë të njëjtin trajtim.

Gjykata Kushtetuese në vendimin e saj nr. 75, datë 10.04.2002, duke interpretuar shprehjen kushtetuese "akte e sjellje që diskreditojnë rëndë pozitën e gjyqtarit", në konkluzionet e saj pranon se: "në çdo rast janë të lidhura sjelljet e parregullta e të padenja që këta gjyqtarë kryejnë jo vetëm gjatë detyrës dhe për shkak të saj, por edhe jashtë detyrës me abuzim apo dhunim që ata i bëjnë besimit publik dhe lidhen kryesisht me dëmet, që ata i sjellin shoqërisë dhe shtetit. Aktet e sjelljet e padenja duhet të jenë aq serioze, të kenë diskredituar aq rëndë figurën dhe pozitën e gjyqtarit dhe të kenë ulur dinjitetin e organit që përfaqësojnë, aq sa ta detyrojnë organin kompetent që të marrë masën e largimit nga detyra".

Të njëjtin qëndrim mbajnë edhe Kolegjet e Bashkuara të Gjykatës së Lartë në vendimin nr. 4, datë 07.01.2009 ku ndër të tjera theksohet se "... këto vendime, qoftë të formës së prerë, mund të jenë shkak për shkarkim nga detyra, vetëm nëse shoqërohen me akte e sjellje, që diskreditojnë rëndë figurën e gjyqtarit".

Ndryshe nga sa arsyetohet Gjykata e Apelit Tiranë, nga akti i kontrollit të veprimtarisë së prokurorit T.D., edhe pse janë rreshtuar një seri rastesh, mos fillimi i procedimit penal, pushimit të hetimit, ndryshime të kualifikimit ligjor të veprës apo zvarritje të hetimit për të cilat kontrolli ka vlerësuar se vijnë ndesh me ligjin procedural, nuk ka asnjë element, që një vendimmarrje e tillë të jetë e shoqëruar me veprime të prokurorit të lidhura me diskreditimin e figurës së tij, apo që të kenë cenuar rëndë interesat e shtetit. Të gjitha rastet për të cilat bëhet fjalë në akt kontroll sipas të cilit: "... në vështirësi të treguesve dhe arritjeve në punën e prokurorit T. D., vërehet se në punën e tij për periudhën objekt kontrolli, konstatohen të meta e dobësi, si në mosfillimet e procedimeve në proceset penale të pushuara dhe kryesisht në procedimet e dërguara në gjykim" janë pjesë e vendimmarrjes së përditshme nga prokurori, të kontrolluara në pjesën dërmuese të tyre nga gjykata gjatë gjykimit dhe që nuk jepet asnjë lloj argumenti lidhur me pasojat e rënda që ato të kenë sjellë në atë masë që ndaj këtij prokurori, organi kompetent të merrte masën disiplinore shkarkim nga detyra.

Shkeljet e përmendura në aktin e kontrollit dhe propozimi i bërë nga Prokurori i Përgjithshëm për shkarkim nga detyra të paditësit mund të përbënin shkak për shkarkimin e tij nga detyra vetëm në rast se në zbatim të rregullimeve që parashikon dispozita e nenit 42 të ligjit organik të prokurorisë, ky prokuror do të ishte vlerësuar "i paafte"²⁵⁹.

2.1 Inspektimi dhe procedimi i prokurorëve

Ligji parashikonte që fillimi i procedimit disiplinor mund të bëhej

259. Vendimi nr. 00-2011-2060 (495), datë 03.11.2011 i Kolegjit Civil të Gjykatës së Lartë.

nga Prokurori i Përgjithshëm, kryesisht ose me rekomandimin e Këshillit të Prokurorisë.²⁶⁰ Me reformën e vitit 2003, u përcaktua që procedimi disiplinor fillonte vetëm nga Prokurori i Përgjithshëm, duke ia hequr të drejtën e rekomandimit Këshillit të Prokurorisë.²⁶¹

Procedimi mbështetej në të dhënat e nxjerra nga inspektimi, për të cilin prokurori që procedohej duhej të ishte njoftuar paraprakisht.²⁶² Praktika gjyqësore ka mbajtur qëndrimin, se mënyra si ishte formuluar kjo dispozitë, detyrimisht përcakton, që më parë duhet që të ketë një inspektim të realizuar, në mënyrë që të fillohet procedimi disiplinor. Ngjarjet, informacionet apo të dhënat e tjera, që edhe pse mund të kishin të bënin më rastin konkret, nëse nuk kishin rezultuar në një inspektim të mëvonshëm, nuk mundet që të shërbenin si shkak për fillimin e procedimit disiplinor, siç rezulton nga arsyetimi vijues, se *“Në interpretim dhe zbatim të drejtë të këtyre dispozitave, Kolegji Administrativ vëren se me të drejtë Gjykata e Apelit Tiranë kanë arsyetuar, që nga ana e Prokurorit të Përgjithshëm është shkelur procedura e parashikuar nga ligji nr. 8737/2001 (i ndryshuar), sepse në rastin e procedimit disiplinor ndaj paditësit Xh. S., ndaj tij nuk rezulton që të ketë filluar ndonjë inspektim, për të cilin, ai të jetë njoftuar paraprakisht, për rrjedhojë ky procedim disiplinor nuk është mbështetur në të dhënat e nxjerra nga inspektimi, sikurse parashikon neni 28 i këtij ligji.*

Nga ana tjetër, duke qenë se procedimi disiplinor bëhej për shkelje të etikës në kryerjen e detyrës, pala e paditur Prokuroria e Përgjithshme duhet të respektonte edhe nenet 10 dhe 11 të Kodit të Etikës Profesionale të Prokurorëve, ku është parashikuar se Komisioni i Etikës ka kompetencë ekskluzive për të proceduar për shkeljet etike. Për shkelje të tilla është ky Komision që merr masat përkatëse dhe nëse ai vlerëson se shkelja mund të përbëjë objekt për procedim disiplinor, Komisioni e paraqet çështjen para Prokurorit të Përgjithshëm për të proceduar me rastin konkret. Edhe kjo procedurë nuk është respektuar nga pala e paditur Prokurori i Përgjithshëm.

...

Kështu Gjykata e Apelit ka arsyetuar dhe pranuar të vërtetuar, që pretendimi për shkeljen e etikës nga paditësi Xh. S., gjatë komunikimit me telefon me prokurorin më të lartë A. D., nuk mund të konfirmohet në mënyrë të pakundërshtueshme, se ka ndodhur dhe që thëniet e pretenduara të jenë deklaruar paditësi Xh. S. Nga ana tjetër, gjykata e apelit ka pranuar të vërtetuar se pjesëmarrja e paditësit në takimin e zhvilluar në Ministrinë e Drejtësisë, padrejtësisht është konsideruar shkelje nga pala e paditur, Prokuroria e Përgjithshme sepse gjatë gjykimit është provuar, që në datën 11.04.2012, në orën 10 në Ministrinë e Drejtësisë është zhvilluar një veprimtari profesionale, ku paditësi ka marrë pjesë, jo si përfaqësues i prokurorisë, por në bazë të ftesës së

260. Organ këshillimor pranë Prokurorit të Përgjithshëm.

261. Ligji nr. 9102, datë 10.07.2003, neni 12.

262. Ligji nr. 8737, datë 12.02.2001, neni 28.

bërë nga organizatorët dhe në përmbushje të detyrimit ligjor për pjesëmarrjen në trajnime periodike për ngritjen e nivelit të tij profesional si prokuror.

Për rrjedhojë, Kolegji Administrativojën në përfundimin që Gjykata e Apelit Tiranë ka zbatuar drejt ligjin kur ka vlerësuar, si të bazuar në prova dhe në ligj kërkesëpadinë lidhur me disa kërtime të saj, duke e pranuar pjesërisht atë”.²⁶³

Nga arsyetimi i mësipërm, rezulton që pretendimet e ngritura, nga një prokuror në Prokurorinë e Përgjithshme, për veprime në kundërshtim me ligjin për një drejtues prokurorie, nuk mundej që të merreshin në konsideratë, nëse nuk kishte pasur një inspektim për verifikimin e tyre.

Gjithashtu, siç u përmend më sipër, legjislacioni për prokurorinë kërkonte ndjekjen e disa hapave proceduralë, në mënyrë të detyrueshme, me qëllim që të garantohej e drejta për një proces të rregullt ligjor për prokurorët. Në këtë këndvështrim, inspektimi që ishte urdhëruar, duhej që të mbetej brenda objektit të tij dhe të mos zgjerohej nga ana e inspektorëve. Mosrespektimi i këtyre rregullave është konsideruar problematik për të gjithë procesin disiplinor, siç rezulton nga arsyetimi vijues, se “Kolegji Civil i Gjykatës së Lartë arrin në përfundimin e mësipërm pasi, nga aktet e administruara në dosje rezulton se për procedimin disiplinor të paditësit nuk është zbatuar kërkesa e nenit 28 të ligjit nr. 8737, datë 12.02.2001 “Për organizimin dhe funksionimin e Prokurorisë në Republikën e Shqipërisë”, e cila parashikon se, “... Procedimi mbështetet në të dhënat e nxjerra nga inspektimi, për të cilën prokurori që procedohet është njoftuar paraprakisht”. Në rastin konkret urdhri i Prokurorit të Përgjithshëm “Për fillimin e procedimit disiplinor të ...”, përmban vetëm çështjen penale me nr. 1126, ndërsa për çështjen tjetër me nr. 1187, datë 01.12.2003, nuk rezulton që paditësi të jetë njoftuar apo t’i jetë komunikuar dokumentacioni i procedimit, i nisur në ngarkim të tij, sikurse parashikon neni 29 i ligjit nr. 8737, datë 12.02.2001. ... Duke qenë se pretendimet e paditësit në rekurs janë të drejta dhe të bazuara në ligjin nr. 8737, datë 12.02.2001, Kolegji Civil çmon se është gabuar nga ana e punonjësve të Prokurorisë se Përgjithshme (por jo Prokurori i Përgjithshëm), që kanë shtuar në çështjet e diskutuara si shkelje, edhe një rast tjetër për të cilin nuk kishin asnjë inspektim të komunikuar më parë paditësit dhe as urdhër të Prokurorit të Përgjithshëm për të përfshirë edhe këtë rast në procedimin disiplinor. Në këto rrethana Kolegji Civil i Gjykatës së Lartë konstaton se paditësit nuk i është respektuar e drejta për t’u dëgjuar dhe mbrojtur në lidhje me çështjen nr. 1187, si elementë bazë që garantojnë të drejtën kushtetuese të cilitdo për një proces të rregullt ligjor e për pasojë, kjo çështje duhet të përjashtohet nga çështjet e pretenduara me shkelje”.²⁶⁴

Në këtë rast, siç del nga arsyetimi i mësipërm, nga ana e gjykatave është vendosur që të mos përfshiheshin si gjetje, shkeljet e pretenduara

263 Vendimi nr. 00-2017-2277 (799), datë 17.10.2017 i Kolegjit Administrativ të Gjykatës së Lartë.

264. Vendimi nr. 668, datë 01.06.2006 i Kolegjit Civil të Gjykatës së Lartë.

në një procedim penal, për të cilin nuk ishte urdhëruar inspektim. Në këtë rast, praktika gjyqësore konstatoi cenimin e së drejtës për një proces të rregullt ligjor për prokurorët.

Gjykata e Lartë nuk ka konsideruar shkelje të rregullave procedurale, rastet kur materiali i përfutur që ka shërbyer për fillimin e procedimit disiplinor, ka ardhur si rezultat i kontrolleve tematike të realizuara në atë kohë nga Prokurori i Përgjithshëm. Kështu sipas Gjykatës së Lartë, *“Siç ka rezultuar e provuar në gjykim nga ana e Prokurorisë së Përgjithshme është ushtruar një kontroll (inspektim) në Prokurorinë e Rrethit Kurbin për periudhën 2006-2008, bazuar në Urdhrin nr. 281, datë 28.10.2008 të Prokurorit të Përgjithshëm “Për kontrollin e veprimtarisë së Prokurorëve në Prokurorinë e Rrethit Kurbin”.*

Në përfundim të këtij inspektimi, nga ana e Drejtorisë së Inspektimit dhe Burimeve Njerëzore është hartuar në datën 29.01.2009 raporti i quajtur “Akt-kontrolli” (faqja 58 e dosjes gjyqësore).

Në këtë akt-kontrolli thuhet shprehimisht se: “në veprimtarinë e prokurorit T. D., për periudhën objekt kontrolli, konstatohen të meta e dobësi veçanërisht në procedimet e dërguara për gjykim. Vlen të theksohet, se ndaj këtij prokurori edhe në vitin 2006 është filluar procedim disiplinor për shkelje të konstatuara gjatë kontrollit të kryer gjatë vitit 2005. Në këtë rast nga ana e Prokurorit të Përgjithshëm është marrë masë disiplinore, vërejtje me paralajmërim për shkarkim nga detyra.

Për sa më sipër jemi të mendimit se ka vend, që ndaj këtij prokurori të fillohet procedim disiplinor për marrje mase disiplinore”.

Në vijim të propozimit të Drejtorisë së Inspektimit dhe Burimeve Njerëzore parashtruar në akt-kontroll, bazuar në nenin 28, të ligjit nr. 8737, datë 12.02.2001 “Për organizimin dhe funksionimin e Prokurorisë”, Prokurori i Përgjithshëm, me Urdhrin nr. 111, datë 15.05.2009, vendosi:

Fillimin e procedimit disiplinor ndaj prokurorit T. D., për marrje mase disiplinore.

Urdhri i mësipërm t’i komunikohet menjëherë prokurorit T. D., i cili brenda 10 ditëve ka të drejtë të paraqesë me shkrim pretendimet e tij pranë Drejtorisë së Inspektimit dhe Burimeve Njerëzore”.

...

Drejtoria e Inspektimit dhe Burimeve Njerëzore, bazuar në Urdhrin nr. 111, datë 15.05.2009, ka përpiluar një relacion “Për procedimin disiplinor në ngarkim të Prokurorit T. D.”.

Duke vlerësuar se shkeljet e konstatuara nga akt kontrolli në veprimtarinë e prokurorit T. D., ishin të natyrës, ndaj të cilave ligji organik parashikonte marrjen e masës disiplinore “Shkarkim nga Detyra”, Prokurori i Përgjithshëm, me propozimin e datës 31.07.2009, ka kërkuar nga Presidenti i Republikës, që ndaj prokurorit T. D., të merrej masa e shkarkimit nga detyra.

Mbi bazën e këtij propozimi, Presidenti i Republikës, me Dekretin

nr. 6227, datë 02.09.2009 ka dekretuar se: “Z. T. D., me detyrë Prokuror në Prokurorinë e Rrethit Gjyqësor Kurbin, shkarkohet nga detyra”.

...

Për sa i përket pretendimit të paditësit, lidhur me zhvillimin ndaj tij të një procesi ligjor jo të rregullt, Kolegji Civil i Gjykatës së Lartë çmon se nuk qëndron dhe i është dhënë përgjigje e drejtë dhe ligjore nga Gjykata e Apelit Tiranë.

Ka rezultuar se nga ana e organit të Prokurorisë së Përgjithshme, konform të drejtës që ky organ ka sipas dispozitave të ligjit organik, pasi është organizuar një kontroll tematik i punës së prokurorëve të Rrethit Kurbin, është çmuar se në veprimtarinë e tij i padituri ka kryer veprime, që në çmim të titullarit të atij organi janë cilësuar si shkelje të ligjit. E gjithë procedura që lidhet me fillimin e procedimit disiplinor, verifikimin e pretendimeve të paditësit, të drejtën e tij për t’u njohur me materialin dhe për t’u dëgjuar, janë kryer konform kërkesave të ligjit nr. 8737 datë 12.02.2001 “Për organizimin dhe funksionimin e prokurorisë në Republikën e Shqipërisë”²⁶⁵.

Nga pasazhet e këtij vendimi kuptohet, që edhe kontrolli tematik konsiderohet “inspektim” dhe për rrjedhojë, edhe në kuadër të këtij kontrolli, nëse konstatohen gjetje, që mund të shërbejnë si shkak për fillimin e një procedimi disiplinor, ato janë të vlefshme për t’u përdorur.

Ligji parashikonte edhe afate parashkrimi, sipas të cilit procedimi nuk mundej që të fillonte, kur nga çasti i vënies re të shkeljes kishin kaluar më shumë se gjashtë muaj dhe nga çasti i kryerjes së shkeljes kishin kaluar më shumë se tri vjet.²⁶⁶ Në lidhje me natyrën dhe rëndësinë e këtyre afateve, Gjykata e Lartë ka arsyetuar se “22. Nga interpretimi literal i nenit 28, pika 2 të ligjit nr. 9737 rezulton se nisja e afatit gjashtë mujor për fillimin e procedurës disiplinore kushtëzohet nga: a) një periudhë 6 mujore nga momenti i konstatimit të shkeljes nga grupi i inspektimit; b) nga një periudhë 3 vjeçare nga momenti i kryerjes së shkeljes nga prokurori. Kolegji vlerëson se këto afate kanë karakter prekluziv dhe tejkalimi i tyre shuan të drejtën e nisjes së një hetimi administrativ disiplinor në ngarkim të prokurorit. Sa i përket natyrës së afateve të parashikuara në neni 28, të ligjit nr. 9737/2001, rezulton se i njëjti qëndrim është mbajtur edhe në çështje të ngjashme nga jurisprudenca e Gjykatës së Lartë. (Shih vendimin nr. 341, datë 28.06.2012 të Kolegjit Civil të Gjykatës së Lartë.)

23. Kolegji vlerëson se ratio e kufizimit kohor, të përcaktuar me ligjin nr. 9737/2001 për fillimin e procedimit disiplinor, në ngarkim të prokurorëve, përligjet nga nevoja e garantimit të pavarësisë së prokurorëve gjatë ushtrimit të detyrës. Çmohet se këto afate kanë natyrë urdhëruese dhe prekluzive, e si të tilla, sipas parimit të ligjshmërisë janë të detyrueshme për zbatim nga organi publik, që kryen procedurën disiplinore. Tejkalimi i tyre shuan të drejtën e nisjes së procedimit disiplinor.

24. Përpos interpretimit të qartë literal të nenit 28 të ligjit nr. 9731/2001,

265. Vendimi nr. 00-2011-2060 (495), datë 03.11.2011 i Kolegjit Civil të Gjykatës së Lartë.

266. Ligji nr. 8737, datë 12.02.2001, neni 28.

edhe interpretimi teleologjik i kësaj dispozite dikton, se momenti i fillimit të afatit gjashtë mujor është çasti fillestar i konstatimit të shkeljes administrative përgjatë procedurës së kontrollit dhe jo momenti i hartimit raportit mbi konstatimet e evidentuara gjatë kontrollit. Nëse do pranohej e kundërta, prokurori do mbetej i lidhur pafundësisht me fillimin eventual të një procedure disiplinore, gjendje kjo që krijon premisa serioze të cenimit të pavarësisë së prokurorit gjatë ushtrimit të detyrës. Afati gjashtë mujor i parashikuar në nenin 28 të ligjit nr.9731/2001 është një garanci, që rezultatet e kontrollit të ushtruar ndaj prokurorit të mos përdoren për një kohë të pakufizuar kundër tij.

25. Kolegji çmon të nevojshme të theksojë, se nxjerrja e një akti administrativ në tejkalim të afatit 6-mujor, që parashikohet nga neni 28 i ligjit nr. 9737/2001 për nisjen e procedurës administrative të procedimit disiplinor është në kundërshtim të hapur me rregullin e sanksionuar në nenin 116, pika "c" të ligjit nr. 8485/1999. Për rrjedhojë, konstatimi i një shkelje të tillë, sjell edhe pavlefshmërinë absolute të dekretit të Presidentit të Republikës.

26. Kolegji vlerëson gjithashtu se edhe shkaku i pretenduar në rekurs nga pala e paditur, Prokuroria e Përgjithshme, sa i përket zbatimit të rregullores, konkretisht nenit 13 pika 3, të rregullores nr. 78, datë 16.04.2010 të Prokurorisë së Përgjithshme është i pabazuar në ligj. Sipas rregullit të parashikuar në dispozitën e sipërcituar, "Momenti i konstatimit të shkeljes konsiderohet, data e përpilimit të raportit të inspektimit përfundimtar nga prokurorët e Drejtorisë së Inspektimit dhe Burimeve Njerëzore, në të cilin trajtohet shkelja".

27. Kolegji thekson se Rregullorja nr. 78, datë 16.04.2010 "Për kryerjen e inspektimit dhe fillimin e procedimit disiplinor" është një akt nënligjor me karakter të brendshëm dhe i detyrueshëm për zbatim ndaj subjekteve, që u drejtohet, që nga koha e hyrjes së saj në fuqi. Rezulton se rregullorja ka hyrë në fuqi, pasi ka nisur procedimi disiplinor në ngarkim të paditësit. Konkretisht, rregullorja ka hyrë në fuqi në datë 16.04.2010 (referuar nenit 23 të saj) ndërsa procedimi disiplinor ndaj paditësit, ka nisur me urdhrin nr. 242, datë 19.11.2009. Pra në kohën e nisjes së procedimit disiplinor, rregullorja nuk ka qenë në fuqi, e për rrjedhojë, nuk mund të zbatohet, për rastin në shqyrtim".²⁶⁷

Siç rezulton nga arsyetimi i mësipërm, qëllimi i afateve të parashkrimit, është që të garantojë pavarësinë e prokurorëve, duke mos i bërë të cenusshëm për hetime disiplinore, që mund të shtrihen në një kohë të gjatë. Pra, një prokuror nuk duhet të ndihet i shqetësuar, se një mënyrë veprimi e tij, mund të ketë si reagim, fillimin e një procedimi disiplinor për veprime, që mund të jenë bërë shumë kohë përpara. Nga ana tjetër, këto afate kërkojnë që edhe organi që ka autoritetin për të filluar këtë procedim disiplinor të veprojë shpejt në kohë dhe jo ta lejë atë në harresë, pra këto afate kërkojnë që Prokurori i Përgjithshëm të ishte aktiv në veprimet e tij.

Me qëllim garantimin e së drejtës për një proces të rregullt ligjor,

267. Vendimi nr. 00-2021-3, datë 11.01.2021 i Kolegjit Administrativ të Gjykatës së Lartë.

prokurorit të proceduar, në përfundim të procesit të inspektimit i jepej paraprakisht dokumentacioni i procedimit të nisur në ngarkim të tij, si dhe një afat, jo më pak se 10 ditë për të përgatitur mbrojtjen. Gjithashtu prokurorit i bëhej e ditur dita e shqyrtimit të materialeve, pra momenti se kur do zhvillohej seanca dëgjimore.²⁶⁸

Duke respektuar garancitë kushtetuese, ligji njihte shprehimisht edhe të drejtën e prokurorit për t'u dëgjuar, si edhe për t'u mbrojtur, duke u paraqitur vetë para Këshillit të Prokurorisë, i cili kishte detyrimin ligjor që ta dëgjonte dhe të verifikonte pretendimet e ngritura nga ana e këtij prokurori.²⁶⁹ Për rolin e kësaj strukture, jurisprudenca ka mbajtur qëndrimin, se *"25. ... Kolegji vlerëson se Këshilli i Prokurorisë është organi kompetent ndihmës në vlerësimin e punës së prokurorëve, si dhe për analizimin e shkeljeve disiplinore të kryera prej tyre. Këshilli jep mendime në lidhje me masat disiplinore që duhet të aplikohen, por gjithmonë pas zbatimit me përpikëri të një procedure disiplinore ku prokurori i proceduar njoftohet në lidhje me shkeljet e konstatuar dhe ka të drejtën të dëgjohet e të japë mendimin në lidhje me to. (nenet 33/3 dhe 42 të ligjit nr. 8737, datë 12.02.2001)".²⁷⁰ Nga ky pasazh del qartë roli i rëndësishëm i këtij organi, i cili pasi të kishte respektuar me përpikëri procedurën e kërkuar nga ligji, jepte mendimin e tij profesional mbi faktin nëse kishte pasur gjetje, që sillnin përgjegjësinë disiplinore të prokurorit dhe nëse po, çfarë masë disiplinore mund të jepej, duke pasur në konsideratë, edhe respektimin e parimit të proporcionalitetit.*

Kjo dispozitë në mënyrën si ishte formuluar, tregonte se prokurori mund të mbrohej vetëm vetë përpara Këshillit të Prokurorisë, bazuar ndoshta në argumentimin, që duke qenë një jurist me formim të spikatur kishte të gjitha aftësitë e duhura për të mbrojtur veten e tij. Megjithatë, me reformën e vitit 2008 ligjvënësi krijoi mundësinë, që prokurori në këtë lloj procedimi të mbrohej edhe nëpërmjet një avokati.²⁷¹ Kjo krijonte një mundësi më shumë mbrojtjeje, duke marrë në konsideratë faktin, që procedurat disiplinore bien në fushëveprimin e së drejtës administrative, ndërkohë që normalisht prokurorët janë të specializuar në fushën e së drejtës penale dhe të procedurës penale.

Përsa i përket detyrimit të Këshillit të Prokurorisë, që të verifikonte pretendimet e ngritura nga ana e prokurorit, që po procedohej disiplinarisht, praktika gjyqësore ka përcaktuar se ky detyrim nuk duhej që të mbetej formal, por ishte një detyrë thelbësore e vetë Këshillit, me pasojë pavlefshmërinë e procedurës disiplinore.²⁷²

268. Ligji nr. 8737, datë 12.02.2001, neni 29.

269. Ligji nr. 8737, datë 12.02.2001, neni 30.

270. Vendimi nr. 00-2024-1235 (74), datë 26.02.2024 i Kolegjit Administrativ të Gjykatës së Lartë.

271. Ligji nr. 10051, datë 19.12.2008, neni 16.

272. Vendimi nr. 668, datë 01.06.2006 i Kolegjit Civil të Gjykatës së Lartë.

Me qëllim që të mos abuzojë, ligji parashikonte gjithashtu se mosparaqitja pa shkaqe të arsyeshme, nuk e pengonte Këshillin e Prokurorisë që ta shqyrtonte çështjen dhe të nxirrte përfundimet përkatëse.²⁷³

Këshilli, mbasi realizonte procedurën e tij, i paraqiste rekomandimin Prokurorit të Përgjithshëm, i cili vendoste brenda 15 ditëve, duke arsyetuar dhe qëndrimin e tij.²⁷⁴ Vendimi i Prokurorit të Përgjithshëm ishte përfundimtar për dhënies të masës disiplinore, me përjashtim të masës së shkarkimit, që siç do të trajtohet në vijim, bazuar edhe në parashikimet kushtetuese, mbetet si kompetencë e Presidentit. Në këtë rast, Prokurori i Përgjithshëm i dërgonte Kreut të Shtetit, vendimarrjen e tij të arsyetuar së bashku me kundërshtimet e prokurorit, që po procedohej.²⁷⁵ Kjo mënyrë formulimi tregon që pranë Presidentit nuk zhvillohej ndonjë seancë dëgjimore, por kjo e drejtë, ushtrohej vetëm mbi bazë dokumentesh, mundësi kjo që njihej nga Kodi i Procedurave Administrative, që ka qenë në fuqi në atë kohë.²⁷⁶

2.2 Përgjegjësia dhe masat disiplinore

Ligji organik i prokurorisë kishte edhe parashikimet e tij, që rregullonin veprimet apo mosveprimet, që konsideroheshin si shkelje disiplinore dhe masat disiplinore, që mund të merreshin. Kështu quheshin shkelje disiplinore a) mospranimi i bërjes së betimit ose shkelja e tij; b) zvarritjet e rënda ose sistematike të procedimeve, ose të detyrave të tjera të ngarkuara, ose mos përmbushja e detyrave; c) nxjerrja e sekretit të hetimit, ose e të dhënave të tjera me karakter konfidencial; ç) mungesa për më shumë se pesë ditë pa arsye në punë; d) kryerja e veprimeve që diskreditojnë rëndë figurën e prokurorit; dh) kryerja e veprimeve, që sipas ligjit, janë të papajtueshme me funksionet e prokurorit.²⁷⁷

Në lidhje, meshkeljen disiplinore, që konsiderohej si “mospërmbushje e detyrave” Gjykata e Lartë, në një rast është shprehur se “Lidhur me largimin e paditësit nga detyra e Prokurorit, në Dekretin e Presidentit të Republikës është përcaktuar vetëm referenca ligjore, neni 32 “b” i ligjit nr. 8737, datë 12.02.2001. Nga materialet e ndodhura në dosje del se paditësi është larguar me motivacionin “Mospërmbushje e detyrave”. Duke ju referuar akteve

273. Ligji nr. 8737, datë 12.02.2001, neni 30.

274. Ligji nr. 8737, datë 12.02.2001, neni 31.

275. Ligji nr. 8737, datë 12.02.2001, neni 33.

276. Ligji nr. 8485, datë 12.05.1999 “Kodi i Procedurave Administrative”, neni 96, pika 2, germa “a”: 2. Organi që zhvillon procedurën hetimore mund, gjithashtu, të mos i lejojë palët e interesuara të shprehen në rastet e mëposhtme:

a) në qoftë se palët e interesuara kanë pasur rast t’i japin mendimet e tyre për çështjet që kanë rëndësi për marrjen e vendimit gjatë zhvillimit të procedimit dhe mbi bazën e provave ekzistuese;

277. Ligji nr. 8737, datë 12.02.2001, neni 32.

në dosjen gjyqësore nuk del, se cila është shkelja e dukshme e kryer nga paditësi, që përbën “mospërmbushje detyre” në çështjen penale nr. 1126.

Në këtë çështje, paditësi ka qenë prokuror në gjykimin “Për caktimin e masave të sigurimit” dhe ka zbatuar dispozitat e K. Pr. Penale që kanë të bëjnë, me “kriteret e veçanta për caktimin e masës së arrestit në burg”. Në bazë të kësaj dispozite, “arresti në burg mund të vendoset, vetëm kur çdo masë tjetër është e papërshtatshme për shkak të rrezikshmërisë së veçantë të veprës dhe të pandehurit”. Sipas nenit 25 pika 3 të K. Pr. Penale, prokurori i seancës gjyqësore është i pavarur në gjykimin e kërkimit të tij sipas vlerësimit, që u bën fakteve dhe përputhjes së tyre me kërkesat e ligjit.

Referuar akteve të ndodhura në dosje rezulton se çështja penale në ngarkim të gjykuarit E. Xh., dhe të gjykuarve të tjerë ka përfunduar me deklarimin e tyre fajtor, e dënimin e tyre me gjobë. Në këtë vështrim masa e sigurimit “arrest në burg” nuk është në proporcion me këtë dënim, e nuk rezulton të këtë sjellë pasoja të renda, as për çështjen dhe as pasoja të tjera jashtë saj”.²⁷⁸

Në praktikë është shtruar për diskutim çështja, nëse i njëjti fakt, pra e njëjta gjetje duhet të klasifikohet vetëm si një shkelje disiplinore, apo mund të klasifikohet në shumë të tilla. Gjykata e Lartë në këtë rast, arsyetoi se “29. Gjykata më e ulët gabon kur arrin në përfundimin, se i njëjti fakt nuk mund të jetë manifestim i disa shkeljeve disiplinore. Kjo pasi, p.sh. mjafton të shihet përmbajtja e formulës së betimit, sipas nenit 22(1) të ligjit nr. 8737/2001, e të krahasohet me parashikimin e nenit 32(a)(d) të këtij ligji, për të kuptuar se p.sh., shkelja e betimit për të ruajtur të pastër figurën e prokurorit përbën shkelje, sipas germës (a), ashtu edhe sipas germës (d), të nenit 32 të ligjit nr.8737/2001. Thënë kjo, Kolegji vëren se neni 32 i ligjit nr. 8737/2001, nuk ka synuar të ndajë në mënyrë sterile sjelljet e prokurorit, që quhen shkelje disiplinore, por ka dhënë disa orientime bazë, që organet disiplinore duhet t’i kenë parasysht kur vlerësojnë faktet e ndryshme, nëse përbëjnë shkelje disiplinore apo jo. Në parim një sjellje e prokurorit (si gjatë ushtrimit të detyrës ashtu edhe jashtë saj), mund të kualifikohet në më shumë se një shkelje disiplinore, sipas nenit 32 të ligjit nr. 8737/2001, ndaj ky argument i Gjykatës Administrative të Apelit nuk qëndron, e nuk mund të përbëjë shkak të mjaftueshëm për shfuqizimin e masës disiplinore të shkarkimit kundrejt paditësit. Ndaj argumenti se “zvarritjet e rënda ose sistematike të procedimeve ose të detyrave të tjera të ngarkuara, ose mos përmbushja e detyrave” (32(b) nuk mund të jenë njëkohësisht, edhe “veprime që diskreditojnë rëndë figurën e prokurorit” (32(d)), nuk është i bazuar në kuptimin e normës në fjalë.

30. Nëse do të pranohej interpretimi i mësipërm i Gjykatës Administrative të Apelit, në vështrim edhe të nenit 27(3)(b) të ligjit nr.8737/2001, atëherë praktikisht prokurori mund të zvarriste vazhdimisht rëndë procedimet, me “garancinë”, se kjo nuk do të përbënte kurrë shkak për shkarkim të tij nga detyra, por organi procedues do i kishte “duart e lidhura”, tek dhënia e masave të tjera

278. Vendimi nr. 668, datë 01.06.2006 i Kolegjit Civil të Gjykatës së Lartë.

më të lehta disiplinore, sipas neneve 33(1), “a”, “b”, “c”, pa mundur asnjëherë të zbatojë nenin 33(1), “ç” të ligjit nr. 8737/2001. Paditësit i janë dhënë edhe më parë masa disiplinore (ndonëse të shuara) në lidhje me shkeljet gjatë detyrës, e megjithatë ai ka vijuar po njësoj. Është i gabuar arsyetimi i Gjykatës Administrative të Apelit se të paditurit kanë gabuar, që kanë përmendur dy masat e mëparshme disiplinore të dhëna në vitet 2012 e 2014 ndaj paditësit, pasi ato si të shuara nuk duhet të ishin fare në dosje. Gjykata në këtë rast nuk ka kuptuar thelbin e qëndrimit të të paditurit, që lidhet pikërisht me sa u arsyetua më sipër, që prokurori nuk ka imunitet “nga zvarritja e rëndë e procedimeve”, e kryer në vijimësi, në mënyrë të përsëritur dhe pa reflektim. Nëse për zvarritjet e rënda i është dhënë më parë (në një kohë të shkurtër), vërejtje prokurorit (pavarësisht se ajo masë është shuar), e megjithëkëtë, ai vijon njësoj apo më keq, atëherë kjo me të drejtë është vlerësuar prej të paditurve, se diskrediton rëndë figurën e prokurorit, në kuptim edhe të shkeljes së parimit të ligjshmërisë së veprimtarisë, sipas nenit 4 të ligjit nr. 8737/2001 (i ndryshuar).

31. Kolegji vlerëson se është e gabuar edhe analiza e Gjykatës Administrative të Apelit në lidhje me dallimin midis shkeljes sipas germës (b) të nenit 32, me atë sipas germës “d” të këtij neni, referuar standardit “syri i publikut”. Kjo së pari, sepse neni 32(d) i ligjit nr. 8737/2001 nuk shprehet për kryerje të veprimeve, që diskreditojnë rëndë në publik figurën e prokurorit, pasi shprehja “në publik” mungon në dispozitën në fjalë. Së dyti, zvarritja e 118 procedimeve penale përgjatë viteve 2012-2014, që ka pasjellë mos procedimin e të kallëzuarve apo të proceduarve kryesisht penalisht, edhe nëse i referohet standardit të perceptimit të publikut, dështon të mos përbëjë shkak për shkarkim nga detyra, për sa kohë që zvarritjet janë të rënda, sistematike dhe mbi të gjitha, që vareshin drejtpërdrejtë nga mosveprimi i paditësit, e jo nga faktorë të jashtëm tej kontrollit të tij. P.sh., sipas raportit të procedimit disiplinor paditësi kishte deleguar veprimet për një numër të konsiderueshëm dosjesh penale tek OPGJ përkatës, por ndonëse e kishte përpiluar urdhrin, nuk ia jepte atë OPGJ-së, por e mbante në zyrën e tij me muaj të tërë. Kjo nxjerr në pah sjellje të paligjshme, të parregullt dhe të pajustificueshme, pasi mos kalimi i dosjes tek OPGJ nuk mund të justifikohet prej paditësit. Fakti që këto dosje nuk kanë qenë me të arrestuar, nuk lehtëson apriori pozitën disiplinore të paditësit.

32. Kolegji vëren se organet proceduese kanë argumentuar bindshëm nevojën për kalimin në dhënien e masës ekstreme disiplinore për paditësin, ndërsa ky i fundit i ka pranuar shkeljet, porse është përpjekur të justifikojë qëndrimin e tij. Argumentet e Gjykatës Administrative të Apelit nuk nxjerrin në pah asnjë element që të justifikojë vendimmarrjen e vet, për sa kohë që shkeljet ekzistojnë, janë të rënda dhe sistematike, si dhe njëkohësisht mund të përbëjnë shkelje sipas nenit 33, “b”, “d” të ligjit nr. 8737/2001, pasi sjellja e mbajtur prej paditësit në vijimësi, duke mos kryer veprimet bazë procedurale për menaxhimin e çështjeve, diskrediton rëndë figurën e prokurorit në të gjitha dimensionet e këtij koncepti. Gjykata Administrative e Apelit nuk ka argumentuar, se shkarkimi nga detyra

i paditësit është bërë për të njëjtat shkelje e për të njëjtat dosje, për të cilat i është dhënë më parë masa disiplinore e vërejtjes, ndaj ky nuk mund të përbëjë motiv për shfuqizimin e masës disiplinore të shkarkimit, në zbatim të parimit të mos ndëshkimit dy herë për të njëjtin fakt. Nga ana tjetër, arsyetimi në lidhje me vlerësimin profesional ndër vite të paditësit, me “mirë” apo “mjaftueshëm” është i parëndësishëm për zgjidhjen në themel të kësaj çështje, pasi nuk nxjerr në pah ndonjë përkushtim maksimal të paditësit në ushtrimin e detyrës, por që me gjithë këtë përkushtim, ai ka zvarritur rëndë procedimet për shkaqe të pavarura prej tij”.²⁷⁹

Nga tërësia e këtij arsyetimi, kuptohet që e njëjta gjetje mundet të klasifikohet, si një apo më shumë shkelje disiplinore, në varësi të rrethanave dhe rastit. Duke qenë se kjo nuk ishte e ndaluar nga vetë ligjvënësi në mënyrë të shprehur, këtu nuk mundet që të gjente zbatim parimi i “mos gjykit dy herë”. Për rrjedhojë, mundet që e njëjta gjetje të klasifikohet, kur ekzistonin kushtet, në dy apo më shumë shkelje disiplinore.

Përsa i përket llojeve të masave disiplinore, rezulton se ato ishin katër të tilla. Konkretisht a) vërejtje; b) vërejtje me paralajmërim për shkarkim nga detyra; c) pezullim nga detyra dhe kalim në një detyrë tjetër, më të ulët, brenda organit, për një periudhë nga gjashtë muaj deri në një vit. Këto masa mund të jepeshin, në përfundim të procedimit disiplinor nga Prokurori i Përgjithshëm. Ndërsa masa e katërt, ajo e shkarkimit nga detyra, mund të jepej vetëm nga Presidenti.²⁸⁰

Parashikimi i gjithë këtyre llojeve të ndryshme të shkeljeve disiplinore, ndryshimi i organeve sipas llojit të masës, që mund të jepej, si edhe mundësisë se kur mund të jepej apo jo masa disiplinore e shkarkimit me pasojë humbjen e statusit të prokurorit, ka krijuar një lloj konfuzioni, që është analizuar edhe nga praktika gjyqësore, e cila ka mbajtur qëndrimin, se “Siç rezulton nga aktet e administruara në gjykim, pas përfundimit të kontrollit për veprimtarinë e prokurorit T. D., nga ana e Prokurorit të Përgjithshëm, me shkresën nr. 2336, datë 31.07.2009 i është dërguar Presidentit të Republikës propozimi për shkarkim nga detyra e prokurorit T. D.

Edhe pse nga ana e Këshillit të Prokurorëve, në materialin e dërguar Prokurorit të Përgjithshëm, shkeljet e konstatuara ishin vlerësuar sipas germës “d” të ligjit, pra si veprime që diskreditojnë rëndë figurën e prokurorit, në relacionin shoqërues me shkresën për propozim për shkarkim nga detyra, Prokurori i Përgjithshëm shprehet se, “Nga sa parashtruan më sipër, në mbështetje të nenit 149/3 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, të nenit 32, germa “b” dhe nenit 33, pika 1, germa “ç”, pika 3 të ligjit nr. 8737, datë 12.02.2001 “Për organizimin dhe funksionimin e Prokurorisë së Republikës së

279. Vendimi nr. 00-2024-1235 (74), datë 26.02.2024 i Kolegjit Administrativ të Gjykatës së Lartë.

280. Ligji nr. 8737, datë 12.02.2001, neni 33.

Shqipërisë” propozoj shkarkimin nga detyra të prokurorit T. D.”.

Kjo kërkesë e Prokurorit të Përgjithshëm duhet të mos ishte pranuar nga Presidenti i Republikës, pasi vinte në kundërshtim të hapur me dispozitën e nenit 27, pika 3, germa “b” të ligjit nr. 8737, datë 12.02.2001 sipas të cilës:

“Prokurori shkarkohet nga detyra... kur merret masë disiplinore sipas shkronjave “c”, “d” dhe “dh”, të nenit 32 të këtij ligji”.

Por rezulton, se me Dekretin nr. 6227, datë 02.09.2009, Presidenti i Republikës ka dekretuar shkarkimin e prokurorit T. D., duke gjetur si bazë ligjore nenin 32, germa “b” të ligjit organik nr. 8737, datë 12.02.2001, dispozitë sipas të cilës, nuk parashikohet si masë disiplinore ajo e “shkarkimit nga detyra”.

Shkarkimi i prokurorit nga detyra për një shkak të paparashikuar në ligj, çon Kolegjin Civil të Gjykatës së Lartë në përfundimin, se akti me të cilin është vendosur shkarkimi i tij, pra Dekreti nr.6227, datë 02.09.2009 i Presidentit të Republikës, duhet të shfuqizohet, konform detyrimeve të parashikuara në nenin 118/1 të Kodit të Procedurave Administrative”.²⁸¹

Në këtë rast, rezulton se megjithëse propozimi ishte për shkarkimin e këtij prokurori, arsyeja pse kërkohej ky shkarkim, nuk ishte e njëjtë me vetë shkakun e shkarkimit, që u miratua në fund nga Presidenti, me dekretin e tij. Referenca ligjore që kishte dekreti i kreut të Shtetit, ishte për një tjetër shkak disiplinor për të cilin, ligji organik nuk parashikonte mundësinë e marrjes së kësaj mase.

Me reformën e vitit 2003, masa disiplinore e pezullimit nga detyra dhe e kalimit në një detyrë më të ulët, u ndryshua duke u përcaktuar tashmë, se si masë disiplinore mund të jepej “kalim në një detyrë tjetër më të ulët brenda sistemit të prokurorisë”.²⁸²

Ky parashikim ka qenë pjesë e debatit gjyqësor, lidhur më një rast, ku Prokurori i Përgjithshëm kishte dhënë masën disiplinore, “Kalim në një detyrë tjetër më të ulët brenda sistemit të prokurorisë”, konkretisht Oficer i Policisë Gjyqësore në Prokurorinë e Rrethit Gjyqësor Berat për një periudhë 18-mujore. Kjo periudhë do jetë nga data 15.10.2012 deri më datën 15.04.2014”. Pra në këtë rast, duke i konsideruar seksionet e policisë gjyqësore pranë prokurorive të gjykatave të shkallës së parë, si pjesë e sistemit të prokurorisë, Prokurori i Përgjithshëm vendosi ta kalojë një prokuror, në detyrat e oficerit të Policisë gjyqësore. Në shqyrtimin e kësaj çështjeje, shumica e trupës gjyqësore të Gjykatës së Lartë u kufizua vetëm në trajtimin e shkeljeve procedurale, që kishin ndodhur në këtë rast, duke mos u shprehur në lidhje me këtë situatë. Por dy gjyqtarë të tjerë, pjesë e trupës gjyqësore, mbajtën qëndrimin, se “Por, nga ana tjetër, shumica e Kolegjit Administrativ nuk ka vlerësuar të pranojë pretendimin e ngritur në padi dhe më pas në rekurs nga paditësi Xh. S., lidhur me mungesën e mbështetjes

281. Vendimi nr. 00-2011-2060 (495), datë 03.11.2011 i Kolegjit Civil të Gjykatës së Lartë.

282. Ligji nr. 9102, datë 10.07.2003, neni 13.

në ligj të llojit të masës disiplinore të dhënë ndaj tij nga pala e paditur Prokuroria e Përgjithshme për kalimin në një detyrë tjetër më të ulët brenda sistemit të prokurorisë, konkretisht të oficerit të policisë gjyqësore në Prokurorin e Rrethit Gjyqësor Berat për një periudhë 18-mujore. Kjo masë disiplinore bazohej në interpretimin, se policia gjyqësore dhe seksionet e ngritura pranë prokurorive janë pjesë e “sistemit të prokurorisë”, prandaj një prokuror mund të ndëshkohet disiplinarisht, duke u caktuar përkohësisht të punojë si oficer policie pranë prokurorive sepse jemi brenda sistemit të prokurorisë, që kërkon ligji.

Ndryshe nga pjesa tjetër e Kolegjit Administrativ, jemi të mendimit se, nisur nga interpretimi i neneve 148 dhe 149 të Kushtetutës, dispozitave të ligjit nr. 8737/2001 “Për organizimin dhe funksionimin e Prokurorisë në Republikën e Shqipërisë” dhe të ligjit nr. 8677/2000 “Për organizimin dhe funksionimin e policisë gjyqësore”, pretendimi i ngritur nga paditësi Xh. S., në padi, por edhe si shkak në rekurs për të kundërshtuar vendimin e Gjykatës së Apelit për paligjshmërinë e vetë llojit të masës disiplinore ndaj tij është i mbështetur në Kushtetutë dhe në ligj. Prandaj, për të ardhur në përfundimin se padia duhet të pranohet pjesërisht, ashtu sikurse ka disponuar gjykata e apelit dhe ka konfirmuar ky Kolegj Administrativ i Gjykatës së Lartë, ato duhet të ndaleshin dhe të mjaftoheshin vetëm në këtë motiv ligjor.

Lidhur me vendin e Prokurorisë në organizimin tonë shtetëror dhe për statusin e posaçëm kushtetues e ligjor të prokurorëve në sistemin tonë kushtetues, në nenet 148 dhe 149 të Kushtetutës përcaktohet qartë dhe pa ndonjë hapësirë për të pasur interpretim tjetër se:

“Neni 148

1. Prokuroria ushtron ndjekjen penale, si dhe përfaqëson akuzën në gjyq në emër të shtetit.....

2. Prokurorët janë të organizuar dhe funksionojnë pranë sistemit gjyqësor

.....

Neni 149

.....

3. Prokurorët e tjerë emërohen dhe shkarkohen nga Presidenti i Republikës me propozim të Prokurorit të Përgjithshëm.....”

Këto dispozita kushtetuese përcaktojnë, se cili është misioni kushtetues dhe kompetenca thelbësore e prokurorisë dhe e prokurorëve. Pra ai i ushtrimit të ndjekjes penale dhe përfaqësimit të akuzës në gjyq, mision e funksion, që nuk mund ta ushtrojë askush tjetër përveç atyre funksionarëve kushtetues që plotësojnë kushtet, janë emëruar dhe ushtrojnë funksionet e prokurorit. Për këtë arsye, përveç me ndonjë elementi specifik ose përjashtimor, Kushtetuta autorizon ligjvënësin të rregullojë më hollësisht statusin dhe karrierën e prokurorëve, si funksionarë kushtetues, të njëjtë me atë të gjyqtarëve.

Së pari, në ndryshim nga qëndrimi i mbajtur nga gjykata e apelit dhe pjesa tjetër e gjyqtarëve në përbërje të Kolegjit Administrativ kemi qëndrimin, se Kushtetuta nuk parashikon ndonjë rezervë ligjore thelbësore lidhur me

statusin e prokurorëve. Prokurorët kanë detyrimin por njëkohësisht edhe të drejtën kushtetuese, që të ushtrojnë në mënyrë të pavarur dhe të pacenueshme, funksionin e tyre kushtetues të ushtrimit të ndjekjes penale dhe përfaqësimit të akuzës në gjyq, kjo vetëm pas fillimit të karrierës prokuroriale dhe deri në kohën kur ushtrimi i këtij funksioni mbaron, apo prokurori të jetë shkarkuar nga ushtrimi i këtij funksioni. Kjo do të thotë se prokurorit nuk mund t'i mohohet dhe as nuk mund të pengohet në ushtrimin e funksionit të prokurorit pranë njëres prej hallkave të organizimit të Prokurorisë, pasi ai/ajo është emëruar prokuror (ka filluar karrierën e prokurorit) dhe deri kur ai largohet nga ky funksion ose shkarkohet sipas ligjit. Po kështu, përjashtimisht, prokurori mund të pengohet përkohësisht në ushtrimin e funksionit të tij kushtetues, vetëm kur ndaj tij merret masa e pezullimit nga ushtrimi i detyrës, por edhe kjo masë e ndërmjetme ka natyrë të përkohshme dhe për rrethana specifike.

Së dyti, ushtrimi i funksionit kushtetues të prokurorit realizohet prej tij, vetëm brenda dhe në njërën prej hallkave të organizimit të Prokurorisë, të cilat janë Prokuroria e Përgjithshme, Prokuroria pranë Gjykatës së Apelit për Krime të Rënda, Prokuroritë pranë Gjykatave të Apelit, Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë për Krimet e Rënda dhe Prokuroritë pranë Gjykatave të Shkallës së Parë (neni 3/a, 13-15 të ligjit nr. 8737/2001). Pikërisht këto janë hallkat e "sistemit të prokurorisë". Edhe shkalla e hierarkisë në prokurori, përcaktohet nga hallka e prokurorisë, pranë së cilës prokurori është caktuar për të ushtruar funksionin e tij kushtetues (neni 3/b i ligjit nr. 8737/2001). Edhe ngritja në detyrë apo ulja në detyrë e prokurorit (nenet 24, 25 e vijues) lidhet pashmangshmërisht me caktimin e prokurorit për të ushtruar funksionin e prokurorit, pranë njëres prej strukturave të prokurorisë të parashikuara nga neni 3/a, 13-15 të ligjit nr. 8737/2001.

Natyrisht që pranë secilës prej strukturave të Prokurorisë mund të ngrihen dhe të funksionojnë edhe seksione të policisë gjyqësore, por pa asnjë lloj vendi për interpretime të tjera, ato kanë në përbërje të tyre oficerë të policisë gjyqësore, që vijnë nga radhët e forcave policore të parashikuara nga ligji ose janë juristë të caktuar në këtë detyrë ligjore nga Prokurori i Përgjithshëm. Prandaj, nuk ka asnjë kuptim juridik, kushtetues dhe ligjor, që oficerë të policisë gjyqësore, për të një kohë të caktuar ose të pacaktuar, të jenë ose emërohen, komandohen ose detyrohen të punojnë edhe prokurorët. Karriera dhe statusi i prokurorit burojnë dhe janë të garantuara nga Kushtetuta dhe ligjet e nxjerra në pajtim me të. Karriera dhe statusi i prokurorit nuk mund të cenohet e të ndërpritet në çfarëdo mënyrë tjetër, përveçse në raste kur prokurori shkarkohet nga kjo detyrë (neni 27, pika 2) ose largohet nga karriera e prokurorit (neni 27 pika 1), apo përkohësisht pezullohet nga detyra në rastet e treguara shprehimisht nga ligji (neni 26). Ndërsa seksionet e policisë gjyqësore dhe oficerët e policisë gjyqësore janë struktura dhe funksionarë, që ushtrojnë detyrat e caktuara nga ligji pranë hallkave të prokurorisë dhe që nuk kanë asnjë lidhje me karrierën e prokurorit.

Së treti, nisur nga arsyetimi si më sipër, masa disiplinore e parashikuar

nga shkronja “c” e pikës 1 të nenit 33 të ligjit nr. 8737/2001 mund të jepet ndaj prokurorëve, vetëm duke i caktuar ata të ushtrojnë funksionin e prokurorit, në një hallkë (strukturë) më të ulët të prokurorisë, apo nga prokuroria e posaçme në prokurorinë e juridiksionit të përgjithshëm të së njëjtës shkalle.

Në shkronjën “c” të pikës 1 të nenit 33 të ligjit nr. 8737/2001 parashikohet si masë disiplinore, “c) kalimi në një detyrë tjetër më të ulët brenda sistemit të prokurorisë;”. Pra, me “sistem të prokurorisë” në kuptim të kësaj dispozite, mund dhe duhet të kuptohen vetëm hallkat (strukturat) e Prokurorisë, të cilat janë Prokuroria e Përgjithshme, Prokuroria pranë Gjykatës së Apelit për Krime të Rënda, prokuroritë pranë gjykatave të apelit, Prokuroria pranë Gjykatës së Shkallës së Parë për Krimet e Rënda dhe prokuroritë pranë gjykatave të shkallës së parë. Po kështu kjo dispozitë përcakton pa asnjë vend për interpretim tjetër, ndëshkimin e prokurorit me masë disiplinore në “një detyrë më të ulët”, por jo në ndonjë “detyrë tjetër”, të ndryshme nga ajo e prokurorit, si p.sh., ajo e oficerit të policisë gjyqësore, që janë persona që ushtrojnë attribute të policisë gjyqësore në procedimin penal, krejt të ndryshme nga ajo e funksionit kushtetues të prokurorit.

Nëse do të pranohej interpretim dhe qëndrim tjetër, sikurse janë ato të pranuar nga Gjykata e Apelit Tiranë dhe pjesa tjetër e anëtarëve të Kolegjit Administrativ, kjo do të cenonte në thelb statusin kushtetues dhe ligjor të Prokurorisë dhe prokurorit. Do të ishte njësoj sikur, gjyqtari të ndëshkohej disiplinarisht për të ushtruar, qoftë edhe për një kohë të kufizuar, funksione të administratës gjyqësore, sekretarit gjyqësor etj. Po kështu, ndëshkime të tilla disiplinore të gjyqtarit ose prokurorit për të kryer, si sanksion disiplinor, detyra jashtë funksionit të tyre kushtetues nuk kanë asnjë lidhje me ekzistencën dhe funksionimin e sistemit demokratik dhe shtetit të së drejtës, ndëshkime të cilat kanë qenë të zbatuara në kohën e regjimit të mëparshëm kushtetues tashmë të përmbysur në Republikën e Shqipërisë”.²⁸³

Kjo qasje e këtyre gjyqtarëve ngjan më e drejtë, pasi ruan statusin, dinjitetin dhe prestigjin e funksionit të prokurorit, i cili në asnjë rast, nuk mundet që të ulet dhe të konsiderohet oficer i policisë gjyqësore, por duke ruajtur përsëri statusin e magjistratit.

Përcaktimi i këtyre masave dhe renditja e tyre nga më e lehta tek më e rënda nga ana e ligjvënësit, nuk do të thoshte detyrimisht që zbatimi i tyre duhet të ishte i shkallëzuar, siç me të drejtë ka konstatuar Gjykata e Lartë, kur ka arsyetuar, se “28. Referuar argumenteve mbi të cilat gjykata më e ulët ka vendosur pranimin e padisë së paditësit, Kolegji vlerëson se nuk qëndron këndvështrimi i kësaj gjykate se neni 33(1) ka parashikuar rendin e dhënies së masave disiplinore për prokurorët, në kuptimin që ecja nga masa më e lehtë tek ajo më e rëndë është rrugë e detyrueshme për Prokurorin e Përgjithshëm dhe Presidentin e Republikës. Kjo, jo vetëm sepse nuk është e parashikuar

283. Mendimi paralel i gjyqtarëve Artan Zeneli dhe Ardian Dvorani në vendimin nr. 00-2017-2277 (799), datë 17.10.2017 të Kolegjit Administrativ të Gjykatës së Lartë.

*shprehimisht në ligj, por edhe sepse nuk do të kishte kuptim një rregull i tillë i zbatuar në mënyrë mekanike. Kjo pasi, në raste të caktuara mund të mjaftojë edhe një shkelje e vetme tejet e rëndë, që prokurori të shkarkohet nga detyra, ashtu siç mundet, që prokurori të kryejë disa shkelje të lehta, e të marrë masën disiplinore më të lehtë që është vërejtja. Ligji e ka lënë në vlerësim dhe gjykim të kujdesshëm fillimisht të Këshillit të Prokurorisë e më pas të Prokurorit të Përgjithshëm dhe Presidentit të Republikës, që të vlerësojnë rëndësinë e shkeljeve, nëse është e tillë që justifikon masën e shkarkimit nga detyra”.*²⁸⁴

Pra, në varësi të llojit të shkeljes së konstatuar dhe të provuar, organi procedues, nuk duhet të ndjekë sipas radhës dhënien e masave disiplinore, por mund të japë direkt, edhe masën më të rëndë, atë të shkarkimit nga detyra, mjafton që arsyetimi dhe gjykimi tij të jetë i arsyetuar mjaftueshëm dhe jo haptazi abuziv.

Përsa i përket së drejtës për ankim, Ligji parashikonte, që kundër masave disiplinore që jepte Prokurori i Përgjithshëm, lejohej kundërshtimi gjyqësor pranë Gjykatës së Apelit Tiranë, por ndalohej në mënyrë kategorike ankimimi në gjykatë të dekretit të Presidentit për shkarkimin e prokurorit nga detyra.²⁸⁵ Kjo qasje e ligjit me dy standarde, kur për më tepër nuk lejohej të kundërshtohej masa më e rëndë, ajo e shkarkimit dhe që ndikonte në mbarimin e statusit të prokurorit, dukej se bazohej në teorinë e ruajtjes së integritetit të akteve të Kreut të Shtetit. Pra, që vendimmarrja e tij të mos vihej në diskutim në rrugë gjyqësore.

Ky parashikim ligjor u kundërshtua në Gjykatën Kushtetuese, e cila, ndër të tjera, arsyetoi se “Gjykata Kushtetuese çmon se dispozita e atakuar nuk është në përputhje me përmbajtjen dhe frymën e Kushtetutës dhe të dokumenteve ndërkombëtare të ratifikuara nga shteti shqiptar. Në arritjen e një konkluzioni të tillë, Gjykata ka parasysh arsyet e parashtruara më poshtë:

Kushtetuta, mundësinë e individit për t’iu drejtuar gjykatave për mbrojtjen e të drejtave kushtetuese e atyre ligjore për shkak të rëndësisë së posaçme, e ka parashikuar shprehimisht, si të drejtë themelore vetjake në nenin 42 të saj. E drejta e ankimit pranohet si e drejtë themelore, edhe nga Konventa Evropiane e të Drejtave të Njeriut (neni 13) dhe se ushtrimi i kësaj të drejte është i pakufizuar.

Gjykata Kushtetuese çmon se e drejta e prokurorëve për t’u ankuar buron nga Kushtetuta, e si e tillë ajo duhet të konkretizohet me ligjin “Për Prokurorinë”. Kufizimi që i bën kësaj të drejte dispozita e ligjit, lidhur me masat që merr ndaj tyre Presidenti i Republikës, nuk gjen mbështetje edhe tek neni 17 i Kushtetutës. Sipas kësaj dispozite kufizime mund të vendosen vetëm kur ka interes publik dhe kur mbrohen të drejtat e subjekteve të tjera. Në këtë dispozitë kushtetuese, veç sa më sipër, vihen si kushte, që kufizimi të jetë në përpjesëtim me gjendjen që e ka diktuar, të mos cenojë thelbin e lirive dhe të drejtave dhe të mos tejkalojë në asnjë

284. Vendimi nr. 00-2024-1235 (74), datë 26.02.2024 i Kolegjit Administrativ të Gjykatës së Lartë.

285. Ligji nr. 8737, datë 12.02.2001, neni 34.

rast kufizimet e parashikuara në Konventën Evropiane për të Drejtat e Njeriut.

Duke iu referuar në tërësi dispozitës së kontestuar nenit 34 të ligjit “Për Prokurorinë”, është e nevojshme të theksohet, se lidhur me të drejtën e ankimit ndaj masave disiplinore ajo përmban dy standarde. Ndërsa për masat “vërejtje me paralajmërim” e “pezullim nga detyra”, të cilat merren nga Prokurori i Përgjithshëm, ligji parashikon ankim në Gjykatën e Apelit (pika 1 e nenit 34) për masën e shkarkimit nga detyra, e cila merret me dekret të Presidentit të Republikës, prokurorët nuk kanë të drejtën e ankimit.

Tek dispozita në shqyrtim dallohen tre karakteristika:

Së pari, e drejta kushtetuese e ankimit nuk mohohet tërësisht, por ajo për të njëjtin subjekt parcelizohet pa pasur asnjë bazë kushtetuese.

Së dyti, ligji përmban një parregullsi, duke pranuar ankimin për masat më të lehta e duke e mohuar për ato më të rënda.

Së treti dhe më e rëndësishmja, të drejtën e ankimit ligji e lidh me cilësitë e subjektit, që merr masën.

Përsa i përket karakteristikës së fundit, Gjykata Kushtetuese e sheh të arsyeshme të ndalet shkurtimisht, te natyra e akteve që nxjerr në këto raste Presidenti i Republikës.

Nga përmbajtja dhe fryma e Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, del qartë se Presidenti i Republikës, si kryetar i shtetit, edhe pse është i ndarë nga organet kryesore, që realizojnë pushtetet, kryen disa funksione që kanë natyrën e këtyre pushteteve. Është kjo arsyeja që Presidenti i Republikës, në ushtrimin e funksioneve të tij krahas akteve, që janë rezultat dhe shprehje e drejtimit politik, nxjerr akte individuale me karakter administrativ. Në aktet me karakter administrativ përfshihen edhe dekretet për shkarkimin nga detyra të prokurorëve, si masë me karakter disiplinor. Duke pasur të tilla cilësi, dekreti, në bazë të dispozitave kushtetuese të përmendura më lart dhe në harmoni me frymën e përmbajtjen e legjislacionit e të praktikës së mirëfilltë gjyqësore, duhet të jetë objekt i ankimit dhe i shqyrtimit gjyqësor.

Në argument të antikushtetutshmërisë së dispozitës së kontestuar mund të shërbente edhe dallimi që kanë prokurorët, në raport me subjekte të tjerë. Kështu, edhe pse prokuroria organizohet e funksionon pranë sistemit gjyqësor, prokurorët nuk gëzojnë të drejtën e ankimit ndaj shkarkimit nga detyra, të drejtë që gjyqtarëve u njihet nga Kushtetuta (neni 147). Prokurorët dallojnë edhe nga nëpunësit e tjerë civilë, përse i përket të drejtës së ankimit. Dallimet si më sipër, cenojnë frymën e përmbajtjen e Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë”.²⁸⁶

Vendimi i mësipërm, i Gjykatës Kushtetuese, solli si pasojë, që me reformën e vitit 2003, ligjvënësi të parashikonte dy situata. Kështu, kundër dhënies së masave disiplinore, që nuk kishin të bënin me shkarkimin nga detyra, prokurori mund të bënte ankim në Gjykatën e Apelit Tiranë, ndërsa prokurorët pranë kësaj gjykate në Gjykatën e Apelit më të afërt. Përsa i përkiste masës disiplinore të shkarkimit nga detyra, dispozita

286. Vendimi nr. 25, datë 13.02.2002 i Gjykatës Kushtetuese.

parashikonte që prokurori mund të bënte ankim në Gjykatën e Apelit Tiranë, ndërsa prokurorët pranë këtij niveli gjykate në gjykatën e apelit më të afërt. Kur gjykata çmonte se shkarkimi nga detyra ishte i pabazuar në ligj, prokurori përfiton pagën deri në një vit pune, e cila paguhej nga Prokuroria.²⁸⁷ Ky parashikim i fundit, e barazonte statusin e prokurorit me atë të punëmarrësve, që rregulloheshin nga Kodi i Punës, duke qenë se nuk parashikohej mundësia e rikthimit në punë, por përfitimi i një dëmshpërblimi, deri në një vit pagë.

Situata e vazhdueshme e ndryshimit të legjislacionit, ku në fillim kishte mungesë të parashikimeve ligjore, se cila gjykatë do të ishte kompetente për shqyrtimin e kundërshtimeve të prokurorëve për largimin e tyre nga detyra, si dhe më pas, përcaktimi me ligj të posaçëm i Gjykatës së Apelit Tiranë, solli edhe një çoroditje në praktikën gjyqësore në lidhje me shqyrtimin e këtyre kërkesave, si edhe vlerën e kërkesave të ndryshme procedurale të bëra fillimisht në gjykatën e shkallës së parë. Për ta ilustruar këtë situatë, vjen si referencë një vendimmarrje e Gjykatës së Lartë, në të cilën gjendet arsyetimin vijues, *“Paditësi A. C., ka ngritur padi në gjykatën e shkallës së parë, me objekt kundërshtim Dekreti të Presidentit të Republikës, nr. 2318, datë 19.02.1999, për largimin e tij nga detyra e prokurorit dhe pagim page për periudhën e qëndrimit pa punë.*

Në gjykimin në shkallë të parë, kërkuesi ka hequr dorë nga kërkitimi i pagës dhe gjykata ka pushuar gjykimin për këtë pjesë dhe ka pranuar padinë për pjesën tjetër, duke u shprehur për anulimin e Dekretit.

Mbi ankimin përkatës, Gjykata e Apelit Tiranë ka shqyrtuar çështjen me datë 23.10.2003, kur hyri në fuqi ligji nr. 9102, datë 10.07.2003 “Për disa shtesa e ndryshime në ligjin nr. 8757, datë 12.11.2001 “Për organizimin e funksionimin e prokurorisë, i cili parashikon të drejtën e ankimit të prokurorit, që shkarkohet në Gjykatën e Apelit”.

Gjykata e Apelit Tiranë, pasi ka shqyrtuar kërkimin në lidhje me anulimin e Dekretit, drejt ka analizuar se paditësi nuk mund të kërkojë në gjykatë anulimin e Dekretit të Presidentit të Republikës, duke iu referuar vendimit përkatës të Kolegjeve të Bashkuara të Gjykatës së Lartë dhe ka vendosur pushimin e gjykimit.

Përsa i përket kërkitimit në lidhje me pagën, gjykata e apelit, duke arsyetuar heqjen dorë nga gjykimi i padisë nga pala për këtë pjesë, pa e shqyrtuar ose dëgjuar përsëri palën në lidhje me këtë kërkim, përfshi edhe heqjen dorë nga gjykimi, ka pushuar gjykimin në tërësi, duke e përfshirë edhe këtë kërkim.

Sipas ligjit të ri specifik të sipërcituar, neni 34/2 parashikon, se ankuesi mund të realizojë gjyqësisht në të njëjtën shkallë gjykimi, edhe të drejtën e shpërblimit të dëmeve, që kanë ardhur si rrjedhojë e humbjes së pagës, apo përfitimeve të tjera.

Sa më sipër, gjykata e apelit, e cila shqyrton drejtpërdrejtë ankimin e paraqitur, ka detyrim ligjor të dëgjojë palët në lidhje me kërkimet, duke u shprehur

287. Ligji nr. 9102, datë 10.07.2003, neni 14.

mbi gjithçka që kërkohet dhe vetëm për atë që kërkohet, nenet 6, 18 i K. Pr. Civile.

Sipas nenit 17 të K. Pr. Civile, gjykata fton palët që të japin shpjegime nga pikëpamja e të drejtës, që ajo çmon të nevojshme për zgjidhjen e mosmarrëveshjes.

Ndonëse gjykata ka dëgjuar pretendimet e palës ankimmuese, në lidhje me kërkimin për anulim Dekreti, nga përmbajtja e procesverbalit gjyqësor dhe nga vendimi i arsyetuar, nuk rezulton, që pala paditëse të jetë dëgjuar nga gjykata kompetente lidhur me kërkimin tjetër, për pagën, qoftë edhe pasqyrimi i heqjes dorë nga gjykimi, nëse kërkohet nga pala, por është mjaftuar me deklarinimin e bërë në një gjykatë, që nuk është me kompetente për gjykimin e kësaj çështje.

Në rishqyrtim, pasi të zbatohet sa sipër dhe konkludohet pas hetimit gjyqësor, se shkarkimi nga detyra është i pabazuar, prokurori nëse e kërkon, ka të drejtën e dëmshpërblimit të pagës, deri në një vit pune”.²⁸⁸

Kjo situatë ndryshoi me reformën e vitit 2008, ku tashmë ligjvënësi parashikoi, që kundër masës disiplinore “Shkarkim nga detyra”, kur gjykata çmonte, se ishte e pabazuar në ligj, ajo vendoste kthimin e prokurorit në detyrë në prokurorinë pranë gjykatës ku kishte qenë, në momentin e fillimit të procedimit disiplinor dhe nëse e çmonte të nevojshme mund t’i jepte prokurorit, një shpërblim të drejtë.²⁸⁹

Parashikimet e mësipërme ligjore, ku përcaktoheshin tri organe, që vendosnin për masën disiplinore “shkarkim nga detyra” dhe me parashikimin e mundësisë për t’u ankuar gjyqësisht, ka shtruar shpeshherë në praktikë, debatin se deri në çfarë pike, gjykata mund të vlerësonte gjykimin e këtyre tri organeve. Sipas Gjykatës së Lartë në këtë rast, “26. Kolegji vlerëson se në shqyrtimin e akteve administrative të kësaj natyre gjykata në shqyrtimin e themelësisë së aktit administrativ, duhet të fokusohet tek garancitë procedurale të procesit, e jo të synojë të marrë rolin e organit disiplinor, pasi në të kundërt do të kishim cenim të veprimtarisë dhe diskrecionit të organit kompetent shtetëror që ka të bëjë me shkarkimin nga detyra të prokurorëve.

27. Kolegji vlerëson se nenet 28, 29 e 30 të ligjit nr. 8737, datë 12.02.2001, i ndryshuar, i japin diskrecion në vlerësimin e shkeljeve disiplinore të prokurorëve, Prokurorit të Përgjithshëm, pasi të ketë marrë mendimin e Këshillit të Prokurorisë. Në nenin 7 të Kodit të Procedurave Administrative (ligji i zbatueshëm nr.8485/1999) i titulluar “Pushteti diskrecial (diskrecioni)” parashikohet se “me pushtet diskrecial të administratës publike do të kuptohet e drejta e kësaj të fundit, që të ushtrojë autoritet publik për realizimin e një qëllimi të ligjshëm, qoftë edhe pa autorizim të shprehur të ligjit.” Në respektim të neneve 149 e 150 të Kodit të Procedurave Administrative, edhe aktet apo vlerësimet me natyrë diskrecionare i nënshtrohen shqyrtimit gjyqësor, porse në këto raste, gjykata duhet të mbajë gjithnjë parasysht standardin e abuzimit apo jo me juridiksionin nga ana e organit shtetëror të pajisur me mundësinë për të vlerësuar dhe peshuar rëndësinë e një fakti të caktuar në një

288. Vendimi nr. 214, datë 08.02.2005 i Kolegjit Civil të Gjykatës së Lartë.

289. Ligji nr. 10051, datë 19.12.2008, neni 17.

procedurë disiplinore. Kjo pasi, vërtetë ushtrimi i veprimtarisë administrative diskrecionale (p.sh: vlerësimi i rëndësisë së një shkelje disiplinore) nuk është i pakontrollueshëm, porse gjykata nuk mund të zëvendësojë gjykimin e organit disiplinor me të vetin, bazuar vetëm në mundësinë ligjore për të anuluar apo shfuqizuar këtë vendimmarrje administrative. Gjykata ka detyrimin, që kur hedh poshtë vlerësimin e rëndësisë së fakteve nga ana e organit disiplinor, të analizojë një për një, se përse ky vlerësim nga ana e organit disiplinor është i paligjshëm apo arbitrar. Në mungesë të një vlerësimi arbitrar të fakteve nga ana e organit disiplinor, gjykata nuk mund të zëvendësojë atë vlerësim me një tjetër, që mund t'i duket më i arsyeshëm, pasi në këtë mënyrë rrezikon të marrë një rol që nuk i takon. Nëse vendimmarrja e organit administrativ nuk është arbitrare, jo proporcionale apo e pambështetur në frymën e ligjit, atëherë ajo nuk mund të cenohet gjyqësisht, bazuar vetëm mbi gjykime përshtatshmërie nga ana e gjykatës. Marrjen e masës së përshtatshme disiplinore në rastin e prokurorëve sipas ligjit nr. 8737/2001, e kishte për kompetencë ta vlerësonte Presidenti i Republikës, Prokurori i Përgjithshëm dhe Këshilli i Prokurorisë. Në rastin e shkarkimit të prokurorit, të tri këto subjekte ndërvepronin dhe nxirrnin akte zinxhir, duke vlerësuar me diskrecion rëndësinë e shkeljeve të konstatuara, në raport me llojet e masave disiplinore që parashikonte neni 33(1) i ligjit nr. 8737/2001".²⁹⁰

Vendimmarrja e mësipërme, megjithëse e shumë e vonë në kohë, tregon se gjyqtarët nuk mundet që të vendosin gjykimin e tyre, mbi gjykimin e organeve disiplinore. Në këto raste, gjykatat verifikojnë vetëm procedurën e ndjekur dhe nëse ka pasur shkelje të kësaj procedure, që kanë cenuar të drejtat procedurale të prokurorit. Përsa i përket anës substanciale, gjykatat mund të analizojnë nëse ka pasur shkelje apo jo, por nëse vërtetohet që ka pasur shkelje, aftësia e tyre për të vendosur në lidhje me llojin e masës disiplinore nuk është e pakufizuar. Ato mund të ndërhyjnë vetëm nëse masa disiplinore dukshëm nuk është proporcionale, por jo të vlerësonin në mënyrë të plotë proporcionalitetin.

3. Inspektimi sipas ligjit nr. 8811, datë 17.05.2001 "Për organizimin dhe funksionimin e Këshillit të Lartë të Drejtësisë"

Sipas Kushtetutës së Shqipërisë, hyrë në fuqi më datë 28.11.1998, Këshilli i Lartë i Drejtësisë konsiderohej si organi përgjegjës për përgjegjësinë disiplinore të gjyqtarëve. Me qëllim detajimin edhe të kësaj kompetence, nga ana e ligjvënësit, u miratua Ligji nr. 8811, datë 17.5.2001, "Për organizimin dhe funksionimin e Këshillit të Lartë të Drejtësisë", i cili përfaqësonte një rregullim të rëndësishëm në strukturimin dhe funksionimin e pushtetit gjyqësor në Shqipëri. Në thelbin e tij, ky ligj

290. Vendimi nr. 00-2024-1235 (74), datë 26.02.2024 i Kolegjit Administrativ të Gjykatës së Lartë.

kishte për qëllim të rregullonte detyrat, kompetencat dhe organizimin e Këshillit të Lartë të Drejtësisë (KLD), i cili kishte përgjegjësi për emërimin, transferimin, vlerësimin dhe procedimin disiplinor të gjyqtarëve.

Ligji parashikonte një strukturë të qartë të KLD-së, duke përcaktuar përbërjen e tij, si edhe rregullonte mandatin dhe statusin e anëtarëve të KLD-së, duke përcaktuar kritere për përzgjedhjen, papajtueshmërinë dhe kohëzgjatjen në detyrë.

Një nga aspektet më të rëndësishme të këtij ligji ishte trajtimi i procedurave disiplinore ndaj gjyqtarëve. Ligji përcaktonte kompetencat e Ministrit të Drejtësisë dhe Inspektoratit të KLD-së për të hetuar dhe ndjekur shkeljet e mundshme disiplinore të gjyqtarëve, duke vendosur një sistem për verifikimin, shqyrtimin dhe vendimmarrjen mbi masat disiplinore.

Ligji gjithashtu adresonte organizimin e brendshëm dhe funksionimin e KLD-së, duke përfshirë administratën e tij dhe proceset kolegjiale të marrjes së vendimeve.

Si një rregullim parësor, ky ligj parashikonte ngritjen e një inspektorati pranë KLD-së që do të përbëhej nga Kryeinspektori dhe inspektorët. Ata emëroheshin dhe shkarkoheshin nga KLD-ja, me propozimin e Zëvendëskryetarit të KLD-së. Inspektorët përzgjidheshin pas një shpallje publike, ndërmjet gjyqtarëve, që përmbushnin kushtet për t'u emëruar gjyqtarë në Gjykatat e Apelit dhe në mungesë të tyre, ndërmjet juristëve, që kishin shërbyer si gjyqtarë jo më pak se 5 vjet. Veprimtaria e Inspektoratit drejtohej nga Zëvendëskryetari i Këshillit të Lartë të Drejtësisë, ndërsa Kryeinspektori organizonte dhe përgjigjej për veprimtarinë e përditshme të Inspektoratit.²⁹¹

Me reformën e vitit 2014, u vendos që për Kryeinspektorin dhe inspektorët, jo më pak se një herë në 2 vjet, do të duhej të kryhej vlerësimi profesional dhe etik, sipas kriterëve dhe procedurave të përcaktuara nga vetë KLD-ja. Gjithashtu, me qëllim rritjen e përgjegjësisë, u parashikua që brenda tremujorit të parë të çdo viti, Inspektorati, nëpërmjet Kryeinspektorit, duhej t'i paraqiste Këshillit të Lartë të Drejtësisë një raport mbi veprimtarinë e tij në vitin paraardhës, në të cilin duhet të gjenin pasqyrim problematikat e trajtuara dhe rezultatet e punës.²⁹²

Inspektorët emëroheshin në këtë detyrë për një afat 5-vjeçar, me të drejtë riemërimi dhe kjo periudhë njihej, si periudhë vjetërsie në punë si gjyqtar për efekt të kërkesave të karrierës profesionale. Gjyqtarët që shërbenin si inspektorë me kërkesë të tyre, riemëroheshin gjyqtarë pa konkurs.²⁹³

Neni 16 i këtij ligji parashikonte detyrat e këtij inspektorati, duke përcaktuar se kishte disa kompetenca, ku parësorja ishte, që të verifikonte

291. Ligji nr. 8811/2001, neni 14.

292. Ligj nr. 101/2014, neni 8.

293. Ligji nr. 8811/2001, neni 15.

dhe t'i dërgonte Ministrit të Drejtësisë për trajtim, ankesat e shtetasve dhe të subjekteve të tjera, që i drejtoheshin Këshillit të Lartë të Drejtësisë për veprime të gjyqtarëve, të vlerësuara në kundërshtim me përmbushjen e rregullt të detyrës. Inspektorati verifikonte vetëm ato ankesa, të cilat nuk mund të zgjidheshin nëpërmjet apelimit gjyqësor, ose për përjashtimin e anëtarëve të trupit gjykues. Gjithashtu, Inspektorati verifikonte ankesat e shtetasve dhe të subjekteve të tjera drejtuar Ministrit të Drejtësisë, të cilat gjykoreshin prej tij për t'u ndjekur nga ky Inspektorat.

Ligji parashikonte që verifikimi kryhej, vetëm pasi gjyqtari të ishte vënë në dijeni paraprakisht. Inspektorati verifikonte nëse ankesat përmbanin fakte dhe rrethana, që mund të përbënin shkak ligjor për procedimin disiplinor, si dhe për vlerësimin moral e profesional të gjyqtarëve. Nëse vëreheshin shkaqe ligjore për procedimin disiplinor, relacioni shpjegues dhe dokumentacioni përkatës, nëpërmjet Zëvendëskryetarit të Këshillit të Lartë të Drejtësisë, i dërgohej menjëherë ministrit të drejtësisë për të gjykuar mbi procedimin disiplinor. Inspektorati kryente edhe verifikime për procedimin disiplinor të propozuara nga ministri i drejtësisë, në rastet kur çmohej dhe kërkohej nga Këshilli i Lartë i Drejtësisë. Raporti i përgatitur nga Inspektorati i paraqitej KLD-së, nga Zëvendëskryetari.

Gjithashtu, ky Inspektorat grumbullonte dhe përpunonte, në përputhje me kriteret e caktuara sipas ligjit, të dhënat e nevojshme për vlerësimin profesional të gjyqtarëve, si edhe përgatiste vlerësimin për aftësinë profesionale të gjyqtarit. Përpara shqyrtimit të tij nga Këshilli i Lartë i Drejtësisë, dokumentacioni i vlerësimit profesional të gjyqtarit, i njoftohej paraprakisht atij, i cili kishte të drejtë që të paraqiste me shkrim opinionin e tij, së bashku me argumentet përkatëse.

Një kompetencë e veçantë e këtij Inspektorati ishte edhe verifikimi dhe evidentimi i çështjeve mbi pasuritë e deklaruara nga gjyqtarët, si dhe pajtueshmërinë e veprimtarisë dhe të sjelljes së tyre, me kërkesat e përcaktuara në ligj.

Ligji parashikonte më tej, se në zbatim të detyrave të tij, inspektorati kërkonte dhe bashkëpunonte me Ministrinë e Drejtësisë për verifikimin e problemeve të veçanta, në zbatim të detyrave të tij. Ky inspektorat gjithashtu mund të kryente edhe detyra të tjera të caktuara nga KLD-ja.

Në zbatim të parashikimeve ligjore, nga KLD-ja u hartua dhe u miratua dhe Rregullorja për organizimin dhe funksionimin e Inspektoratit të Këshillit të Lartë të Drejtësisë. Rregullorja përcaktonte si objekt të veprimtarisë së Inspektoratit, mbledhjen e të dhënave rreth veprimtarisë së gjykatave dhe gjyqtarëve, nëpërmjet verifikimit të ankesave, inspektimit të gjykatave, inspektimit të gjyqtarëve dhe vlerësimit të aftësive të tyre profesionale, mbi të cilat Këshilli i Lartë i Drejtësisë zhvillon përgjegjësitë ligjore të tij, si edhe konstatimin e ekzistencës së shkeljeve disiplinore apo të rasteve të shkakimit të gjyqtarëve dhe dokumentimin e tyre, nëpërmjet

verifikimeve dhe inspektimeve, mbi të cilat nga autoriteti përgjegjës mund të fillohej procedimi disiplinor i gjyqtarëve.²⁹⁴

Inspektorati organizohej dhe funksiononte pranë Këshillit të Lartë të Drejtësisë dhe varej drejtpërdrejtë nga ai. Veprimtaria e Inspektoratit organizohej dhe drejtohej nga Zëvendëskryetari i Këshillit të Lartë të Drejtësisë, i cili në përmbushje të kësaj detyre nxirrte urdhra dhe udhëzime. Përsa i përket kryeinspektorit, i cili mund të nxirrte urdhra, ai organizonte dhe përgjigjej për veprimtarinë e përditshme të Inspektoratit, lidhur me planifikimin dhe ndarjen optimale të punës, si dhe marrjen e masave për pasjen në dispozicion të mjeteve logjistike të nevojshme për përmbushjen e detyrave.

Numri total i inspektorëve përcaktohej nga KLD-ja, me propozimin e Zëvendëskryetarit të KLD-së.²⁹⁵ Inspektorati ndahej në tre seksione, në atë të inspektimit, të ankesave dhe të vlerësimit profesional dhe etik. Ndarja e inspektorëve nëpër seksione bëhej nga zëvendëskryetari i KLD-së, me propozimin e Kryeinspektorit.²⁹⁶

Ndërkohë që për emërimin e inspektorëve, rregullorja përsëriste në thelb parashikimet ligjore,²⁹⁷ përsa i përket zgjedhjes së kryeinspektorit, parashikohej që ishte zëvendëskryetari, ai që vlerësonte kandidaturat, duke pasur edhe të drejtën të bënte një seancë dëgjimore më to. Për secilin kandidat, që çmohet se plotëson kriteret ligjore, Zëvendëskryetari evidentonte këto tregues: a) Rezultatet e studimeve universitare apo pasuniversitare, b) vjetërsinë në punë si jurist dhe si gjyqtar, c) treguesit dhe vlerësimet e punës, ç) trajnimet apo specializimet e ndryshme, d) të dhëna për studime të kryera apo botime në fushën juridike, dh) të dhëna për qëndrimin moral, e) të dhëna për masa disiplinore, ë) të dhëna për aftësi të spikatura organizative dhe menaxhuese, f) çdo të dhënë tjetër, që tregonte epërsi të kandidatit përkatës ndaj kandidatëve të tjerë.²⁹⁸

KLD-ja kishte të drejtë që t'i ngarkonte detyra drejtpërdrejt Kryeinspektorit, si dhe inspektorëve dhe të kërkonte, që ata të përgjigjeshin drejtpërdrejt para tij. Gjithashtu Kryeinspektori për përmbushjen e veprimtarisë së përditshme, përgjigjej para Zëvendëskryetarit. Po ky i fundit mund t'i ngarkonte detyra drejtpërdrejt edhe inspektorëve, të cilët në këto raste përgjigjeshin direkt përpara tij, megjithëse normalisht komunikimi bëhej nëpërmjet kryeinspektorit.²⁹⁹

Si çdo funksionar tjetër, kryeinspektori dhe inspektorët mund të procedoheshin disiplinarisht për shkelje të ligjit dhe të normave të etikës,

294. Rregullorja, neni 1.

295. Rregullorja, neni 3.

296. Rregullorja, neni 2.

297. Rregullorja, nenet 4 dhe 5.

298. Rregullorja, neni 6.

299. Rregullorja, neni 8.

që konsideroheshin shkelje të disiplinës në punë.³⁰⁰ Vetë rregullorja i klasifikonte shkeljet në tri kategori, respektivisht: të lehta, të rënda dhe shumë të rënda.

Konsideroheshin shkelje disiplinore shumë të rënda, i) mosrespektimi me dashje dhe në mënyrë të përsëritur i disiplinës formale në punë, kur kishte sjellë pasoja negative në veprimtarinë e përditshme të Inspektoratit, ii) mosparaqitja e pajustificuar në detyrë për mbi 7 ditë, iii) refuzimi i përsëritur dhe i papërligjur i përmbushjes së urdhrave dhe detyrave të ligjshme, iv) mungesa në vazhdimësi e përkushtimit dhe motivimit në përmbushjen e rregullt të detyrës, v) kryerja me dashje dhe në vazhdimësi, e veprimeve në kundërshtim me përmbushjen e rregullt të detyrës, vi) kryerja e akteve apo sjelljeve ose manifestimi i mungesës së etikës, që diskreditonin rëndë figurën e Kryeinspektorit ose inspektorit apo dhe të Këshillit të Lartë të Drejtësisë.

Rregullorja konsideronte shkelje disiplinore të rënda, i) mosrespektimin në mënyrë të përsëritur të disiplinës formale në punë, kur kishte sjellë krijimin e situatave të papërshtatshme apo të pajustificuara, ii) mosparaqitjen e pajustificuar në detyrë për mbi 3 ditë, iii) refuzimi i pajustificuar i përmbushjes së urdhrave dhe detyrave të ligjshme, iv) mungesa e përkushtimit dhe motivimit në përmbushjen e rregullt të detyrës, v) kryerja e veprimeve në kundërshtim me përmbushjen e rregullt të detyrës, vi) Kryerja e akteve apo sjelljeve ose manifestimi i mungesës së etikës, të një rëndësie më të ulët se ato të parashikuara në nenin 10, pika 2, germa " f ", të kësaj Rregulloreje, që diskreditonin figurën e Kryeinspektorit ose inspektorit apo dhe të Këshillit të Lartë të Drejtësisë.

Konsideroheshin shkelje disiplinore të lehta çdolloj shkelje, që nuk kategorizohej si shumë e rëndë apo e rëndë.³⁰¹

Nismën për iniciimin e një procesi verifikimi e kishte Zëvendëskryetari dhe mund të realizohej nga vetë ai, apo nga një prej anëtarëve të ngarkuar nga Këshilli i Lartë i Drejtësisë. Në rast se ngarkohej një prej anëtarëve, ky i fundit në përfundim të verifikimit duhej të informonte Zëvendëskryetarin për faktet dhe rrethanat e konstatuara, i cili vendoste lidhur me arkivimin e këtij rasti, ose mund të propozonte procedimin disiplinor të Kryeinspektorit apo inspektorit.³⁰²

Procedimi disiplinor mund të fillonte brenda 3 muajve nga data e konstatimit të shkeljes, por jo më vonë se 2 vjet nga data e kryerjes së saj. Zëvendëskryetari kishte të drejtën e propozimit të procedimit disiplinor dhe të masës disiplinore, duke pasur në konsideratë llojin dhe karakterin e shkeljes së kryer apo lejuar.³⁰³

300. Rregullorja neni 9.

301. Rregullorja, neni 10.

302. Rregullorja neni 11.

303. Rregullorja neni 12.

Procedimi disiplinor shqyrtohej nga Këshilli i Lartë i Drejtësisë jo më shpejt se 10 ditë, nga dita kur Kryeinspektori apo inspektori i proceduar ishin njohur me materialet e procedimit. Seanca dëgjimore fillonte me dëgjimin paraprak të Zëvendëskryetarit dhe më pas, sipas rastit të Kryeinspektorit apo inspektorit, që po procedohej disiplinarisht. Këto të fundit kishin të drejtë të mbroreshin vetë, ose me avokat, si dhe të paraqisnin para Këshillit prova, që ata vlerësonin se ishin të nevojshme për të provuar pretendimet e tyre, të cilat i nënshtroheshin shqyrtimit, ashtu si dhe provat e paraqitura në mbështetje të procedimit të tyre disiplinor, duke mos pasur asnjëra prej tyre vlerë të paracaktuar.³⁰⁴

Në përfundim, nëse KLD-ja, vlerësonte se kishte pasur shkelje disiplinore, mund të jepte sipas rastit, këto masa disiplinore: i) vërejtje, ii) vërejtje me paralajmërim dhe iii) shkarkim nga detyra.³⁰⁵ Kjo e fundit mund të jepej vetëm për shkelje disiplinore shumë të rënda, ose kur subjekti ishte ndëshkuar më parë disiplinarisht për shkelje disiplinore të rënda dhe konstatohej përsëri në një procedim të dytë, kryerja përsëri e të njëjtës kategori shkeljeje disiplinore.³⁰⁶ Masa disiplinore parashkruhej me kalimin e 2 vjetëve.³⁰⁷

Në ushtrimin e funksioneve të tij, Inspektorati i KLD-së, verifikonte ankesat e shtetasve dhe të subjekteve të tjera, që i drejtoheshin Këshillit të Lartë të Drejtësisë, apo rasteve të publikuara në media, me qëllim evidentimin e situatave faktike në veprimtarinë e gjyqtarëve konkretë, duke dhënë rekomandime për zgjidhjen e problematikave të konstatuara apo duke përgatitur relacionet përkatëse për veprime të gjyqtarëve, të vlerësuara në kundërshtim me përmbushjen e rregullt të detyrës. Inspektorati gjithashtu verifikonte në çdo rast shqetësimet, apo informacionet e përcjella nga kryetarët e gjykatave, si edhe verifikonte ankesat e shtetasve dhe të subjekteve të tjera, drejtuar ministrit të drejtësisë, të cilat gjykohen prej tij, se duhen ndjekur nga inspektorati dhe përgatiste relacionin shpjegues apo bënte rekomandimet përkatëse. Detyrë e tij mbetej edhe kryerja e verifikimeve me kërkesë të Këshillit të Lartë të Drejtësisë, lidhur me procedimet disiplinore të propozuara nga ministri i drejtësisë dhe në përfundim përgatiste raportin përkatës. Në kuadër të detyrave të tij ishte edhe verifikimi dhe bashkëpunimin me Inspektoratin e Lartë të Deklarimit të Pasurive, çështjet për pasuritë e deklaruar nga gjyqtarët në përputhje me kërkesat e përcaktuara në ligj. Inspektorati verifikonte dhe vinte në dukje çështjet, që lidheshin me pajtueshmërinë e veprimtarisë së gjyqtarëve në përputhje me kërkesat e përcaktuara në ligj, bashkëpunonte me Komisionin e Etikës së Konferencës Gjyqësore

304. Rregullorja, neni 13.

305. Rregullorja, neni 14.

306. Rregullorja, neni 15.

307. Rregullorja, neni 16.

Kombëtare, për çështjet që lidheshin me pajtueshmërinë e sjelljes së gjyqtarëve në përputhje me kërkesat e përcaktuara në ligj, si edhe mund të kryente detyra të tjera, që i caktoheshin nga Këshilli i Lartë i Drejtësisë.³⁰⁸

Në veprimtarinë e tij, Inspektorati udhëhiqej dhe bazohej në parimet e ligjshmërisë, pjesëmarrjes së gjyqtarit në procedurë, nëpërmjet vënies në dijeni, dëgjimit dhe verifikimit të pretendimeve të tij, formalizimit të procedurave, ndalimit të ribërjes së një procedure të trajtuar më parë, prezumimit të pafajësisë, tipizimit të shkeljes, si edhe trajtimit të njëjtë dhe të barabartë.³⁰⁹

Për evidentimin e veprimtarisë së tij, Inspektorati mbante disa regjistra, si ai i ankesave, i inspektimeve të gjyqtarëve, të gjykatave dhe të procedimeve disiplinore. Inspektorati mund të mbante dhe regjistra të tjerë specifikë sipas rregullave të përcaktuara nga Zëvendëskryetari.³¹⁰

Siç u përmend më sipër, një nga detyrat e inspektoratit ishte që të realizonte verifikimet e ankesave ndaj veprimtarisë së gjyqtarëve. Kjo veprimtari përkufizohej, si proces i njohjes dhe konfirmimit të vërtetësisë së pretendimeve apo shqetësimeve për fakte dhe rrethana, që lidhen me veprimtarinë e gjyqtarëve konkretë dhe që realizohej nëpërmjet marrjes, grumbullimit, analizës e ballafaqimit të të dhënave konkrete. Verifikimi i ankesave mund të kryhej, si për veprimtarinë gjyqësore, ashtu dhe për veprimtarinë jashtëgjyqësore të gjyqtarëve. Ankesa mund të shërbente për kryerjen e një inspektimi të përgjithshëm të veprimtarisë së gjyqtarit, vetëm në rastet, kur kjo vendosej nga Këshilli i Lartë i Drejtësisë. Inspektorati nuk mund të mos trajtonte pa shkak një ankesë të marrë.³¹¹

Objekt verifikimi i ankesave mund të ishin: i) faktet apo rrethanat që kishin të bënin me mosfunksionimin normal të zyrës së gjyqtarit, ii) faktet apo rrethanat që mund të konsideroheshin shkelje në referim të detyrave gjyqësore të gjyqtarit, të cilat përgjithësisht kishin të bënin me mosrespektimin formal të ligjit, me mosrespektimin e solemnitetit gjatë gjykimit, me planifikimin dhe organizimin e punës, si dhe me sjelljen e gjyqtarit gjatë apo jashtë gjykimit, që nga ana tjetër kishin ndikuar apo tregonin dukshëm për zvarritje të pajustificuar të procesit, mungesë të etikës profesionale në komunikim, mungesë të kujdesit në arsyetimin ligjor të vendimit gjyqësor, apo për një mënyrë të vepruari me pasoja për palët në procesin gjyqësor, si edhe iii) faktet apo rrethanat që mund të konsideroheshin shkelje, në referim të normave të sjelljes dhe etikës së gjyqtarit, të formalizuara në ligj apo akte të tjera me karakter të përgjithshëm.

Nga ana tjetër nuk përbënin objekt verifikimi i ankesave: i) pretendimet për fakte apo rrethana që mund të zgjidheshin nëpërmjet

308. Rregullorja, neni 21.

309. Rregullorja, neni 22.

310. Rregullorja, neni 54.

311. Rregullorja, neni 23.

kontrollit gjyqësor mbi apelimin gjyqësor të palëve, pra, duke mos përfshirë në objektin e verifikimit ato fakte apo rrethana të parashtruara, që kanë të bëjnë me interpretimin dhe zbatimin e ligjit në një rast konkret nga ana e gjyqtarit, ii) kërkesë/ankesa, që lidheshin me përjashtimin e gjyqtarit nga gjykimi i një çështjeje konkrete, iii) sjelljen në jetën private të gjyqtarit, përveçse kur ajo kishte shkaktuar një jehonë të gjerë në publik, e që lidhej me detyrën e tij dhe që vlerësohej se ishte diskredituese për figurën e gjyqtarit.³¹²

Verifikimi mund të fillonte mbi bazën e një ankese të depozituar pranë Këshillit të Lartë të Drejtësisë, ose mbi bazën e çdo ankese apo shqetësimi tjetër të bërë publik nëpërmjet medias. Ankesat drejtuar Këshillit të Lartë të Drejtësisë mund të depozitoheshin nëpërmjet shërbimit postar ose drejtpërdrejt në Zyrën e Protokollit. Këto të fundit i kalonin menjëherë për trajtim Kryeinspektorit.

Ankesat e depozituara, si dhe ato të bëra publike nëpërmjet mediave, regjistroheshin në Regjistrin e Ankesave, i cili mbahej nga Kryeinspektori dhe duhej të përmbante identitetin e ankuesit, gjykatën apo gjyqtarin ndaj kujt adresoheshin ankesa, lëndën e ankesës, llojin e shkeljes së pretenduar, datën e nxjerrjes së urdhrit të verifikimit, inspektorin e ngarkuar për verifikim, datën e marrjes së ankesës dhe urdhrit të verifikimit nga inspektori, datën e depozitimit të praktikës së verifikimit nga inspektori, mënyrën e përfundimit të trajtimit apo verifikimit.³¹³

Ankesat që i drejtoheshin KLD-së, duhej të bëheshin në formë të shkruar dhe duhej të përmbanin të dhëna të rëndësishme, për fakte dhe rrethana, që mund të përbënin shkak ligjor për ndërmarrjen e rekomandimeve, për zgjidhjen e situatave problematike apo për fillimin e një procedimi disiplinor, mbi të cilat të mund të gjykohej për kryerjen e një verifikimi. Forma e këtij aplikimi përcaktohej nga Këshilli i Lartë i Drejtësisë mbi propozimin e Zëvendëskryetarit, ku domosdoshmërisht duhej të përmbante ankuesin, të identifikuar në mënyrë të plotë, shkeljen apo rrethanat konkrete të pretenduara, kohën e ndodhjes se kësaj shkeljeje, gjykatën apo gjyqtarin konkret, që pretendohesh se kishte konsumuar këtë shkelje. Ankesa, kur ishte rasti, duhej të shoqërohej me dokumente apo burimet provuese të atyre fakteve apo rrethanave të pretenduara. Mungesa e këtyre elementëve sillte si pasojë moskryerjen e veprimeve verifikuese.³¹⁴

Në çdo rast Kryeinspektori, pasi studionte ankesën dhe materialet bashkëngjitur asaj, vlerësonte nëse kishte vend për verifikim. Vendimin e vet, kryeinspektori ia relatonte Zëvendëskryetarit dhe me miratimin e tij urdhëronte arkivimin apo kryerjen e verifikimit të ankesës. Në rastin

312. Rregullorja, neni 24.

313. Rregullorja, neni 25.

314. Rregullorja, neni 26.

kur ankesa vlerësohej e papërshtatshme në formë dhe në përmbajtje dhe urdhërohej arkivimi i saj, ankuesit i kthehej menjëherë përgjigje nga Kryeinspektori, ku parashtroheshin shkaqet dhe arsyet e moskryerjes së verifikimit. Ankesa e ripërsëritur arkivohej pa u verifikuar, përjashtuar rastin kur në ankesën e radhës, parashtroheshin fakte e rrethana të reja të vlefshme për verifikim. Në rastin kur vlerësohej se kishte vend për verifikim të ankesës, Kryeinspektori me urdhër ngarkonte për kryerjen e saj, një apo disa inspektorë. Zëvendëskryetari, kur e vlerësonte të përshtatshme, verifikimin e një ankese mund t'ia ngarkonte personalisht kryeinspektorit.³¹⁵

Duke qenë, siç u pa më sipër, se ekzistonin dy inspektorate ndaj gjyqtarëve, ai i KLD-së dhe ai pranë Ministrisë së Drejtësisë, kërkohej që puna të organizohej në mënyrë të tillë, që të mos dublohej verifikimi i ankesave me Drejtorinë e Inspektimit të Ministrisë së Drejtësisë. Në rastin kur në drejtim të Këshillit të Lartë të Drejtësisë dhe Ministrisë së Drejtësisë paraqitej e njëjta ankesë, që adresohet ndaj veprimtarisë së gjyqtarëve dhe çmohej se kishte vend për verifikim, si rregull verifikimi i saj kryhej nga Inspektorati i Këshillit të Lartë të Drejtësisë. Nëse paraqitej e njëjta ankesë në të dyja këto institucione, por adresonte dhe veprimtarinë e administratës gjyqësore dhe çmohej se kishte vend për verifikim, si rregull ky proces do të duhej të kryhej nga Drejtoria e Inspektimit të Ministrisë së Drejtësisë. Inspektorati i Këshillit të Lartë të Drejtësisë angazhohej, që nëpërmjet procedurave të thjeshtuara, të mundësonte dhënien dhe shkëmbimin e të dhënave të regjistrit të ankesave me Drejtorinë e Inspektimit të Ministrisë së Drejtësisë.³¹⁶

Nëse vendosej se kishte vend për verifikim, atëherë Kryeinspektori nxirrte një akt të quajtur “urdhër verifikimi”, ku duhej të përcaktonte: i) inspektorin apo grupin e inspektorëve, që do të kryente verifikimin, ii) lëndën objekt verifikimi, iii) detyrat e verifikimit, si edhe iv) afatin e kryerjes së verifikimit.³¹⁷ Kryeinspektori, për arsye të përligjura, mund të urdhëronte zëvendësimin e një apo disa inspektorëve nga një procedurë verifikimi. Veprimet e kryera nga inspektori apo inspektorët e zëvendësuar konsideroheshin të vlefshme, nëse arsyeja e përligjur për zëvendësimin e tyre, nuk lidhej drejtpërdrejt me to.³¹⁸

Inspektori, në çdo rast, pavarësisht nga detyrat e lëna në Urdhrin e Verifikimit, do të duhej të verifikonte vërtetësinë e pretendimeve të ngritura nga subjekti ankues, si dhe kryesisht çdo çështje që lidhej me funksionimin apo veprimtarinë normale të gjyqtarit, që ishte e dukshme dhe që mund të konsiderohet nga ligji si shkelje disipline. Në çdo rast

315. Rregullorja, neni 27.

316. Rregullorja, neni 27/a.

317. Rregullorja neni 28.

318. Rregullorja, neni 29.

verifikimi, inspektori duhej të vinte paraprakisht në dijeni kryetarin e gjykatës dhe gjyqtarin përkatës, duke i njohur ata me ankesën dhe Urdhrin e Verifikimit. Përfundimisht, me Urdhër të Zëvendëskryetarit ose Kryeinspektorit, gjyqtari mund të mos njihej me përmbajtjen e ankesës, kur vlerësohej se kjo mund të shkaktonte një situatë të papërshtatshme, por në çdo rast gjyqtarit duhej t'i bëheshin të ditura pretendimet e ankuesit. Në rastin kur konstatohej se ankesa lidhej me një proces gjyqësor që ishte në gjykim e sipër, inspektori duhej të merrte të gjitha masat dhe të bënte të gjitha përpjekjet e duhura, që veprimtaria e tij të mos ndikonte në pavarësinë e gjyqtarit apo gjyqtarëve të asaj çështje konkrete. Verifikimi në këtë rast, kufizohej vetëm për pretendime që lidheshin me zvarritjen e procesit gjyqësor, apo për çështje të etikës së gjyqtarit.³¹⁹

Veprimet verifikuese që kryheshin prej inspektorit, dokumentoheshin në procesverbale, të cilat mund të ishin procesverbal për marrjen e deklarimeve, procesverbal konstatimi, procesverbal këqyrje, etj. Procesverbali duhet të përmbante: i) inspektorin e ngarkuar për verifikim, ii) datën e kryerjes së atij veprimi, iii) rastin objekt verifikimi, iv) objektin e atij veprimi dhe personat pjesëmarrës, v) përmbajtjen e hollësishme të veprimit të kryer, si edhe vi) nënshkrimin në fund të çdo faqeje, të inspektorit dhe të personave pjesëmarrës në veprimin verifikues. Në çdo rast, inspektori duhej të përpilonte një informacion të hollësishëm të rastit të verifikuar, i cili domosdoshmërisht duhet të përmbante i) inspektorin që kishte kryer verifikimin, ii) objektin e verifikimit, iii) pretendimet e ngritura nga subjekti ankues, iv) pretendimet apo arsyetimet e mundshme të gjyqtarit, v) parashtrimin e të dhënave bazë të rastit të verifikuar (momenti i regjistrimit të çështjes, seancën përgatitore, seancat gjyqësore, shkaqet e shtyrjes, momenti i përfundimit të gjykimit, depozitimi i vendimit të arsyetuar në sekretarinë gjyqësore, ankimimi i vendimit, vendimi i gjykatave me të larta dhe përfundimet e tërhequra nga ato), duke përfshirë problematikën e ngritura nga subjekti ankues dhe ato të konstatuara kryesisht, vi) përfundimet e arsyetuara, që dalin lidhur me ekzistencën në rastin konkret të shkeljeve të ligjit, si dhe tërheqja e konkluzioneve të arsyetuara, nëse ato shkelje të lejuara përbëjnë shkelje të disiplinës në kuptim të ligjit dhe vii) propozimin lidhur me trajtimin e mëtejshëm të atij verifikimi.³²⁰

Procedura e verifikimit të ankesës, duke përfshirë edhe dorëzimin e informacionit nga inspektori para Kryeinspektorit, duhej të bëhej jo më tej se 30 ditë nga dita e regjistrimit të saj në Regjistrin e Ankesave. Ky afat mund të shtyhej nga Kryeinspektori, me kërkesën e inspektorit vetëm për shkaqe të përligjura.³²¹

319. Rregullorja, neni 30.

320. Rregullorja, neni 31.

321. Rregullorja, neni 32.

Verifikimi i ankesës mund të përfundonte me arkivimin e rastit, kur nga verifikimi i ankesës nuk konstatohej, apo nuk konfirmoheshin fakte apo rrethana domethënëse për inicimin e një procesi të caktuar, ose kur ato ishin të pamjaftueshme apo të papërshtatshme, duke i kthyer përgjigje subjektit ankues, ku të parashtroheshin rezultatet e verifikimit, si dhe mungesa e shkaqeve dhe e arsyeve për verifikim të mëtejshëm të atij rasti apo ndërmarrjen e iniciativave të tjera. Kur vendosej arkivimi, njoftohej edhe vetë gjyqtari për këtë vendimarrje. Në të kundërt, nëse përftohej material, që mund të sillte përgjegjësi disiplinore për gjyqtarin, atëherë përgatitej relacioni, që i përcillej Ministrit të Drejtësisë nëpërmjet Zëvendëskryetarit, për fillimin e një procedimi disiplinor. Duhet theksuar që rregullorja përcaktonte se mënyra e përfundimit të verifikimit vendosej nga Zëvendëskryetari pas relatimit të rastit nga Kryeinspektori.³²²

Kur ishte rasti, në varësi të mënyrës së përfundimit të verifikimit të ankesës dhe rezultateve të arritura, Inspektorati kryesisht apo me urdhër të Zëvendëskryetarit, përgatiste rekomandime për gjykata apo për gjyqtarë konkretë ose për çdo autoritet tjetër, kur vlerësohej e përshtatshme për zgjidhjen e një situatë jo normale. Gjithashtu, po me urdhër të Zëvendëskryetarit, Inspektorati përgatiste edhe raporte për Këshillin e Lartë të Drejtësisë, për t'i kërkuar urdhërimin e kryerjes së një inspektimi të përgjithshëm apo tematik të veprimtarisë gjyqësore ndaj një gjyqtari konkret, kur nga verifikimi konstatohej apo konfirmohej fakte apo rrethana domethënëse për një veprimtari gjyqësore, jo plotësisht korrekte apo profesionale.

Nëse, në përfundim të procesit të rekomandimit, çmohej se rasti i verifikuar ishte i pamjaftueshëm, apo ajo shkelje e konstatuar nuk ishte thelbësisht e tillë, që të kërkonte nisjen e një procedimi disiplinor, gjyqtarit konkret i tërhiqej vëmendja me shkrim, duke u bërë ajo pjesë përbërëse e dosjes se vlerësimit dhe e përdorshme, vetëm në rastin e vlerësimit profesional dhe etik të tij.³²³

Inspektimi i gjyqtarit bëhej me vendim të Këshillit të Lartë të Drejtësisë,³²⁴ me qëllim njohjen e efektivitetit të veprimtarisë, apo me qëllim evidentimin dhe dokumentimin e shkeljeve disiplinore që mund të ishin kryer të tij.³²⁵ Gjithashtu, ky inspektim mund të ishte i përgjithshëm ose tematik.³²⁶

Inspektimi i gjyqtarit me karakter njohës së veprimtarisë së tij, bëhej mbi bazën e një kalendarit paraprak pune të propozuar nga Zëvendëskryetari,

322. Rregullorja, neni 33.

323. Rregullorja, neni 34.

324. Rregullorja, neni 35.

325. Rregullorja, neni 36.

326. Rregullorja, neni 37.

me synimin që brenda një periudhe 3-vjecare, të inspektoheshin të gjithë gjyqtarët e gjykatave të shkallës së parë dhe të gjykatave të apelit. Ky inspektim përfshinte dhe kontrollin e veprimtarisë për çështjet në gjykim e sipër, por në këtë rast, vetëm nëse respektoheshin afatet e gjykimit e kombinuar me analizimin e ngarkesës në punë.

Inspektimi i gjyqtarit për efekt të evidentimit dhe dokumentimit të shkeljeve disiplinore të tij urdhërohej nga KLD-ja, mbi bazën e propozimit të zëvendëskryetarit, kur në më tepër se një rast të veprimtarisë gjyqësore, nga verifikimet e ankesave ishte arritur në përfundimin, se gjyqtari kishte lejuar ose kryer shkelje apo mosrespektim të dukshëm të ligjit, duke ngritur në këtë mënyrë dyshime për një sjellje ligjore problematike. Tjetër rast i urdhërimit të këtij lloj inspektimi ishte situata kur në përfundim të vlerësimit të aftësive profesionale, gjyqtari vlerësohej i “ paaftë ”. Në këtë rast, inspektimi i gjyqtarit ishte i detyrueshëm. Ky lloj inspektimi vendosej mbi bazën e propozimit të një anëtari të KLD-së, edhe në rastin e procedimit disiplinor të propozuar nga Ministri i Drejtësisë, kur vlerësohej marrja e të dhënave më të plota rreth veprimtarisë së gjyqtarit të proceduar. Rasti i fundit që parashikohej, si shkak për nisjen e këtij lloj inspektimi, më propozimin e çdo anëtari, ishte kur nga inspektimi i gjykatës, arrihej në përfundimin se gjyqtari kishte lejuar ose kryer shkelje apo mosrespektim të dukshëm të ligjit. Ky lloj inspektimi shtrihej përgjatë një periudhe jo më tepër se 3-vjeçare, duke përfshirë dhe kontrollin e veprimtarisë për çështjen në gjykim e sipër, përveç se kur rregullorja parashikonte ndryshe.³²⁷

Për inspektimin e një gjyqtari, Kryeinspektori ngarkonte një apo disa inspektorë të Seksionit të Inspektimit, që në përfundim, pasi verifikonin edhe pretendimet e mundshme me shkrim të gjyqtarit, në varësi të karakterit dhe llojit të inspektimit, përpilonin një informacion me shkrim. Kryerja e inspektimit të gjyqtarit bëhej brenda 30 ditëve nga data e vendimit të Këshillit të Lartë të Drejtësisë. Mbi kërkesë të inspektorit, Zëvendëskryetari mund të shtynte këtë afat vetëm për shkaqe të përligjura. Në realizimin e kësaj procedure, inspektori kishte detyrim që të merrte kontakt me kryetarin e asaj gjykate, ku do të realizohej inspektimi. Gjithashtu, inspektori duhej të merrte në konsideratë edhe të dhënat, që ndodheshin në dosjen personale të gjyqtarit.³²⁸

Në përfundim të inspektimit të gjyqtarit, Inspektorati duhej të përgatiste raportin përkatës, që domosdoshmërisht duhet të përmbante: i) të dhëna statistikore për cilësinë dhe ngarkesën e punës së gjyqtarit, ii) të dhëna për rendimentin në punë të gjyqtarit dhe për respektimin nga ai të afateve të arsyeshme në gjykim, në përputhje me parashikimet e ligjeve procedurale, apo me standardet e përcaktuara nga Këshilli i Lartë

327. Rregullorja, neni 38.

328. Rregullorja, neni 39.

i Drejtësisë, iii) të dhëna për planifikimin dhe organizimin e punës, iv) çdo të dhënë tjetër, që vlerësohet domethënëse për efektivitetin dhe aftësitë e tij profesionale, v) konkluzione rreth efektivitetit të shërbimit gjyqësor të ofruar nga gjyqtari, vi) kur ishte rasti, vërejtje dhe rekomandime për përmirësimin e veprimtarisë së gjyqtarit, vii) nëse ishte e nevojshme, përshkrimin e veprimtarive të gjyqtarit, ku konstatoheshin shkelje të ligjit, që konsideroheshin si shkelje disipline. Ky raport i paraqitej KLD-së nga ana e Zëvendëskryetarit dhe bëhej pjesë përbërëse e dosjes personale të gjyqtarit.³²⁹

Nëse nga inspektimi i gjyqtarit rezultonin dhe raste, apo veprimtari gjyqësore të tjera, ku konstatohej se nga ana e tij ishin lejuar, apo kryer shkelje të ligjit, që të përbënin shkelje të disiplinës, mospërmbushje e rregullt të detyrës, apo pamjaftueshmëri profesionale, Kryeinspektori përgatiste relacionin përkatës, që nëpërmjet Zëvendëskryetarit, i përcillej Ministrit të Drejtësisë për të gjykuar për procedimin disiplinor.³³⁰

Në rastet e procedimeve disiplinore të propozuara nga Ministri i Drejtësisë, mbi bazën e vendimit të Këshillit të Lartë të Drejtësisë, Inspektorati kryente verifikimin e procedimit disiplinor të propozuar dhe pretendimet e ngritura nga ana e gjyqtarit. Procedura e verifikimit të procedimit disiplinor duhej të kryhej brenda 15 ditëve, ku në përfundim, Kryeinspektori përgatiste dhe i paraqiste Zëvendëskryetarit raportin përkatës. Gjithashtu, në rastet, kur KLD-ja vlerësonte nevojën e marrjes së të dhënave më të plota rreth veprimtarisë së gjyqtarit të proceduar, urdhëronte inspektimin e tij, procedurë e cila duhej të kryhej, si rregull brenda 30 ditëve.³³¹

Për verifikimin e pasurisë së deklaruar nga gjyqtarët, Inspektorati vepronte dhe mbante parasysh kërkesat e parashikuara në legjislacionin për parandalimin e konfliktit të interesave, në ushtrimin e funksioneve publike dhe në Memorandumin e Bashkëpunimit dhe Mirëkuptimit, që ishte lidhur në këtë rast midis Këshillit të Lartë të Drejtësisë dhe Inspektoratit të Lartë të Deklarimit të Pasurive. Në rastet kur nga Inspektorati i Lartë i Deklarimit të Pasurive paraqiteshin informacione zyrtare për shkelje të legjislacionit për konfliktin e interesave nga gjyqtarë konkretë, Inspektorati kryente veprimet përkatëse për grumbullimin dhe dokumentimin e rastit disiplinor, ku në përfundim Kryeinspektori përgatiste Relacionin përkatës, që nëpërmjet Zëvendëskryetarit, i dërgohej Ministrit të Drejtësisë për të gjykuar për procedimin disiplinor.³³²

Përsa i përket verifikimit të papajtueshmërisë së veprimtarisë dhe sjelljes me funksionin e gjyqtarit, kjo realizohej bazuar mbi ankesën e

329. Rregullorja, neni 40.

330. Rregullorja, neni 41.

331. Rregullorja, neni 42.

332. Rregullorja, neni 44.

depozituar, apo në bazë të një vendimit të vetë KLD-së. Konsideroheshin veprimtari e papajtueshme me funksionin e gjyqtarit çdo veprimtari e ndaluar në mënyrë të shprehur në ligj. Kur konstatohej ekzistenca e një veprimtarie të papajtueshme me funksionin e gjyqtarit, Kryeinspektori përgatiste relacionin përkatës, që së bashku me materialet e tjera, nëpërmjet Zëvendëskryetarit, i përcillehin Ministrit të Drejtësisë, për të gjykuar për procedimin disiplinor.³³³

Një tjetër lloj inspektimi ishte edhe ai i gjykatave, i cili bëhej mbi bazën e vendimit të Këshillit të Lartë të Drejtësisë. Nëpërmjet këtij lloji inspektimi grumbulloheshin të dhëna, në analizë të të cilave dhe vërejtjeve apo rekomandimeve të bëra në inspektime të mëparshme, evidentohej efektiviteti i këtij institucioni, me qëllim bërjen e vërejtjeve dhe rekomandimeve për përmirësimin e punës në të ardhmen apo marrjen e masave efektive për eliminimin e anomalive të ndeshura.³³⁴ Inspektimet i gjykatave kishte në çdo rast karakter njohës³³⁵ dhe ato mund të ishin të përgjithshme ose tematike.³³⁶ Inicimi i një inspektimi të përgjithshëm apo tematik vendosej, nga Këshilli i Lartë i Drejtësisë, mbi bazën e një kalendari paraprak pune të propozuar nga Zëvendëskryetari, me synimin që brenda një periudhe 2-vjeçare të inspektoheshin të gjitha gjykatat e shkallës së parë dhe gjykatat e apelit. Rast tjetër kur mundej që të vendosej ky lloj inspektimi ishte mbi një situatë problematike të vlerësuar serioze, për të cilën KLD-ja mund të vinte në dijeni nga çdokush prej anëtarëve, apo nga informacionet e ardhura pranë saj. Inspektimi i gjykatës shtrihet përgjatë një periudhe 1-vjeçare, duke përfshirë dhe kontrollin e çështjeve në gjykim e sipër, por në këtë rast, vetëm në aspektin e respektimit të afateve dhe ngarkesës së punës. Përgjatë kësaj, Këshilli i Lartë i Drejtësisë, mund të vendoste që periudha e inspektimit të një gjykate të ishte e ndryshme nga rregulli i përgjithshëm.³³⁷

Për realizimin e inspektimit të gjykatave, Kryeinspektori hartonte planin e inspektimit, që miratohej nga Zëvendëskryetari.³³⁸ Në përfundim të inspektimit, mbi informacionet e inspektorëve, Kryeinspektori përgatiste raportin përkatës, që duhej të përmbante: i) të dhëna mbi organizimin e gjykatës dhe mjaftueshmërinë infrastrukture dhe të personelit gjyqësor e atë ndihmës në gjykatë, ii) të dhëna statistikore në drejtim të ngarkesës dhe shpejtësisë së kryerjes së shërbimeve gjyqësore në atë gjykatë, iii) të dhëna statistikore në drejtim të cilësisë së veprimtarisë të asaj gjykate, iv) të dhëna mbi praktika apo fenomene negative të ndeshura

333. Rregullorja, neni 45.

334. Rregullorja, neni 46.

335. Rregullorja, neni 47.

336. Rregullorja, neni 48.

337. Rregullorja, neni 49.

338. Rregullorja, neni 50.

në veprimtarinë e asaj gjykate, duke përfshirë dhe veprimtarinë gjyqësore të realizuar nga ajo, v) rekomandime për përmirësimin e legjislacionit, organizimit dhe infrastrukturës, në konsideratë të standardeve që duhen synuar apo të përcaktuara nga Këshilli i Lartë i Drejtësisë. Raporti i inspektimit të gjykatës i paraqitet për shqyrtim Këshillit të Lartë të Drejtësisë nga Zëvendëskryetari.³³⁹

Në rastet kur nga raporti i inspektimit konstatoheshin të dhëna, që vinin në dyshim pasjen e aftësive organizuese dhe menaxhuese të drejtuesit të gjykatës, Këshilli i Lartë i Drejtësisë ngarkonte Kryeinspektorin për kryerjen e një vlerësimi të aftësive, në mbështetje të Vendimit të Këshillit “Për funksionet drejtuese të gjykatës”. Në rastet kur nga raporti i inspektimit konstatoheshin të dhëna, që vinin në dyshim pasjen e aftësive profesionale, apo efikasitetin e gjyqtarëve konkretë, Këshilli i Lartë i Drejtësisë ngarkonte Inspektoratin, për kryerjen e një inspektimi të veprimtarisë gjyqësore të tyre, të përgjithshëm apo tematik. Në rastet e identifikimit të dobësive, fenomeneve apo praktikave negative, Këshilli i Lartë i Drejtësisë urdhëronte marrjen e masave për eliminimin e tyre në të ardhmen, ose inicionte nisma për përmirësimin e legjislacionit, të organizimit dhe infrastrukturës së gjykatës.³⁴⁰

Në çdo rast, kur në përfundim të verifikimit ose inspektimit ishin dhënë rekomandime për gjyqtarë apo gjykata, brenda një afati të arsyeshëm, me urdhër të Zëvendëskryetarit, Inspektorati verifikonte zbatimin e tyre. Në përfundim të verifikimeve të këtij karakteri, Zëvendëskryetari informonte Këshillin e Lartë të Drejtësisë me rezultatet e arritura.³⁴¹

Brenda tremujorit të parë të çdo viti, Inspektorati, nëpërmjet Kryeinspektorit, i paraqiste Këshillit të Lartë të Drejtësisë një raport mbi veprimtarinë e tij në vitin paraardhës, në të cilin duhet të gjenin pasqyrim problematikat e trajtuara dhe rezultatet e punës.³⁴²

Nga praktika gjyqësore, rezulton që të jetë ngritur për diskutim, çështja nëse inspektimi mund të niste vetëm nga subjektet që kishin të drejtë të bënin ankesë, apo edhe kryesisht. Përgjigja e Gjykatës së Lartë, ka qenë e drejtpërdrejtë, duke arsyetuar se *“Përsa i përket argumenteve të tjerë të parashtruar nga pala ankuese në ankim, siç është rasti i procedimit disiplinor të gjyqtarëve, ku nga pala ankuese pretendohet se iniciativa për procedim është marrë në kundërshtim me ligjin, nenin 16/1/a të Ligjit nr.8811, datë 17.05.2001 “Për organizimin dhe funksionimin e KLD-së”, pasi në rastin konkret nuk ka asnjë ankesë të asnjë shtetasi apo subjekti që të ketë vënë në lëvizje KLD-në, nuk qëndron. Verifikimi për procedim disiplinor ndaj këtyre gjyqtarëve është iniciuar*

339. Rregullorja, neni 51.

340. Rregullorja, neni 52.

341. Rregullorja, neni 52/a.

342. Rregullorja, neni 55.

dhe realizuar pas ankesave të bëra publike nga media e shkruar dhe ajo vizive. Pikërisht në nenin 21, pika 1 të Rregullores “Për organizimin dhe funksionimin e Inspektoratit të KLD” është e parashikuar, se inspektorati verifikon ankesat e shtetasve dhe subjekteve të tjera, që i drejtohen KLD-së, apo ato të publikuara në media”.³⁴³ Pra, në këtë rast, informacionet e bëra publike shërbejnë për fillimin e një inspektimi disiplinor, pavarësisht se nuk është paraqitur asnjë ankesë formale nga ndonjë subjekt.

Më tej, në jurisprudencën e saj, Gjykata e Lartë, trajtoi edhe mënyrën e zhvillimit të inspektimit, fillimisht nga Inspektorati i KLD-së dhe më pas nga Ministri i Drejtësisë, nga ku rezultoi se “24. Kolegjet e Bashkuara të Gjykatës së Lartë duke iu referuar akteve ligjore dhe nënligjore të cituara më lart, provave të administruara në dosjen gjyqësore të paraqitura nga palët, parashtrimeve dhe kërtimeve të tyre, vlerësojnë të analizojnë më poshtë në këtë vendim veprimet dhe aktet procedurale të realizuara nga institucionet e mësipërme gjatë zhvillimit të procedimit disiplinor ndaj ankuesit, me qëllim kontrollin dhe verifikimin e faktit, nëse këto institucione kanë respektuar apo jo parimin e zhvillimit të një procesi të rregullt ligjor ndaj ankuesit dhe nëse janë shkelur apo jo të drejtat e tij gjatë këtij procedimi.

25. Rezulton se pas inspektimit të kryer nga KLD, pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Durrës (e vënë në lëvizje nga ankesa e Kryetarit të kësaj gjykate, datë 24.09.2009), në datën 08.03.2010 ky organ ka hartuar relacionin përkatës për shkeljet e konstatuara gjatë ushtrimit të veprimtarisë gjyqësore të ankuesit, në lidhje me dorëzimin me vonesë prej tij, të 60 dosjeve gjyqësore (arsyetuar vendimet dhe dorëzuar me vonesë), duke rekomanduar fillimin e procedimit disiplinor ndaj tij. Rezulton që në atë kohë nuk është kryer nga ana e institucioneve përgjegjëse asnjë veprim i mëvonshëm.

26. Pas lajmeve në median e shkruar dhe vizive në lidhje me çështjen penale për të cilën ishte marrë vendimi nr. 98, datë 09.02.2011, siç është shpjeguar më sipër në këtë vendim në pjesën “Rrethanat dhe faktet”, rezulton se nga ana e IKLD³⁴⁴ është lëshuar urdhri i verifikimit datë 14.09.2012 për ushtrimin e funksioneve gjyqësore të gjyqtarëve të Gjykatës së Shkallës së Parë Durrës dhe Gjykatës së Apelit Durrës. Kjo shkresë është lëshuar në bazë të nenit 16 të ligjit nr. 8811, datë 17.05.2001 “Për organizimin dhe funksionimin e KLD”, si dhe nenit 28 dhe 31 të Rregullores “Për organizimin dhe funksionimin e IKLD”.

...

27. Rezulton që ankuesi, nëpërmjet shkresës së datës 17.09.2012, është vënë në dijeni për fillimin e verifikimit të veprimtarisë së tij gjyqësore në lidhje me çështjen e mësipërme (aktinjoftimi i të njëjtës datë mbajtur nga Inspektorët e IKLD, Q. Z., Zh. P., nënshkruar nga ankuesi dhe Kryetari i Gjykata e Rrethit Gjyqësor Durrës), duke respektuar përcaktimet e nenit 16/b të Ligjit nr. 8811, datë 17.05.2001 dhe nenit 30/2 të Rregullores “Për organizimin dhe funksionimin

343. Vendimi nr. 4, datë 07.01.2009 i Kolegjeve të Bashkuara të Gjykatës së Lartë.

344. Inspektorati i Këshillit të Lartë të Drejtësisë.

e IKLD”, që shprehimisht parashikon: “Në çdo rast verifikimi, inspektori vë paraprakisht në dijeni kryetarin e gjykatës dhe gjyqtarin përkatës, duke i njohur ata me ankesën dhe Urdhrin e Verifikimit”.

28. Në datën 19.09.2012, inspektorët e KLD kanë hartuar një raport të titulluar “Informacion”, i cili përmban shkeljet e konstatuara për ankuesin në lidhje me mos arsyetimin dhe mosdorëzimin në kohë të vendimit penal nr. 98, datë 09.02.2011. Në këtë informacion thuhet shprehimisht se inspektorët “nuk kanë pasur mundësi të kontaktonin me z. N. T., pasi ai atë ditë ka munguar për shkaqe shëndetësore, por njoftimi i tij për kryerjen e këtij verifikimi ishte kryer nga ftuesi i gjykatës” (fq. 27 e dokumentit “Informacion”).

29. Rezulton se inspektorët e KLD në kuadrin e këtij kontrolli kanë verifikuar dhe kontrolluar dhe veprimtarinë gjyqësore të dy anëtarëve të tjerë të trupit gjykues që kanë dhënë vendimin nr.98, datë 09.02.2011, si dhe kanë marrë deklaratimet e kryetarit të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Durrës.

30. Në datën 21.09.2012 inspektorët e IKLD kanë hartuar dokumentin “Informacion në vijim”, ku pasi kanë marrë sqarime prej Kryetarit të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Durrës, anëtarët e trupit gjykues dhe kanë verifikuar faktet përkatëse ka rezultuar se: (i) ankuesi ka qenë në vazhdimësi problematik për dorëzimin brenda afateve të arsyeshme të vendimeve gjyqësore; (ii) kryetari i gjykatës për këtë problem ka njoftuar me shkresë KLD; disa herë i është kërkuar ankuesit me shkresë nga kancelarja e gjykatës, dorëzimi i vendimeve të arsyetuara (shkresat citohen në dokumentin “Informacioni në vijim”); (iii) i është tërhequr vëmendje për këtë problem ankuesit disa herë edhe në mbledhjet e mëngjesit, të organizuara më trupën gjyqësore të gjykatës nga ana e Kryetarit të saj; (iv) anëtarët e trupit gjykues që kanë marrë pjesë në çështjen penale në ngarkim të I. Xh., i kanë ofruar ndihmë ankuesit për zbardhjen e vendimit, por ai u ka lënë të besojnë se arsyetimi ka përfunduar dhe dosja është dorëzuar në sekretari.

31. Rezulton se pas kryerjes së veprimeve të mësipërme, bazuar në aktet e përmendura më lart si dhe në relacionin e parë të datës 08.03.2010, IKLD, bazuar në ligjin nr. 8811, datë 17.05.2001 “Për organizimin dhe funksionimin e KLD” neni 16, si dhe Rregullores “Për organizimin dhe funksionimin e IKLD”, neni 31-33, ka hartuar relacionin përfundimtar datë 24.09.2012, i cili së bashku me materialet e tjera i është paraqitur KLD. Në këtë relacion jepen rezultatet e inspektimit të veprimtarisë gjyqësore të ankuesit në lidhje me çështjen penale për të cilën është dhënë vendimi nr. 98, datë 09.02.2011, si dhe shkeljet e përsëritura të ankuesit në lidhje me dorëzimin me vonesë të vendimeve të arsyetuara gjyqësore, të cilat ishin pasqyruar në relacionin e parë, atë të datës 08.03.2010.

32. Pasi është konstatuar nga Kryeinspektorja e KLD-së, se në veprimtarinë e ankuesit provohet të ketë shkelje të ligjit, shkelje këto të cilat, në bazë të nenit 32 të ligjit nr. 9877, datë 18.02.2008 “Për organizimin e pushtetit gjyqësor në Republikën e Shqipërisë”, konsiderohen si “shkelje të disiplinës” është sugjeruar që materialet t’i dërgohen Ministrit të Drejtësisë për të vlerësuar në lidhje me fillimin e procedimit disiplinor ndaj tij.

33. Ky akt është miratuar nga zv. Kryetari i KLD, sipas shënimit në krye të tij dhe me anë të shkresës me nr. 1459 prot., datë 24.09.2012 të KLD, së bashku me materialet e tjera i është dërguar Ministrit të Drejtësisë po në datë 24.09.2012 me nr. protokoll 6026. Rezulton që kryerja e procedurës së mësipërme është bërë në përputhje të plotë me nenin 34/1 të ligjit nr. 9877, datë 18.02.2008, nga ku rezulton se të drejtën për fillimin e procedimit disiplinor ndaj gjyqtarit në KLD e ka ministri i drejtësisë. Ky i fundit e ushtron këtë të drejtë pasi shqyrton raportet e IKLD-së, në lidhje me inspektimet mbi veprimtarinë e gjyqtarëve, sipas rregullave të përcaktuara, si në ligjin e sipërpërmendur, ashtu dhe në aktet nënligjore.

34. Nga aktet e ndodhura dhe të administruara në dosjen gjyqësore rezulton se Ministri i Drejtësisë me shkresat nr. 6026/2 prot., datë 25.09.2012, shkresa nr. 6127/1 prot., datë 04.10.2012 dhe shkresa nr. 6024/4 prot., datë 08.10.2012, i është drejtuar ankuesit duke e njoftuar për parregullsitë e konstatuara nga KLD-ja në veprimtarinë e tij, mbi rezultatet e inspektimit të IKLD-së, si dhe për mundësinë e fillimit të procedimit disiplinor.

35. Rezulton se ankuesi ka marrë dijeni për shkresën e ministrit të drejtësisë nr. 6026/2, prot., datë 25.09.2012. Kjo pasi me shkresën e tij drejtuar ministrit të drejtësisë pa datë, por me nr. prot., hyrës në Ministrinë e Drejtësisë 6026/3, datë 05.10.2012, ai thotë se shkresa nr. 6026/2 i është njoftuar atij, por bashkangjitur shkresës nuk janë dokumentet shoqëruese, që citohen në këtë shkresë.

36. Rezulton në vijim se me shkresën nr. 6024/4 prot., datë 08.10.2012, Ministria e Drejtësisë, pasi citon faktin që ankuesit i janë dërguar disa njoftime për këtë qëllim, urdhëron përsëri t'i vihen në dispozicion kopje të plota të dy relacioneve të IKLD-së dhe i kërkon këtij të fundit, që në rast se ka kundërshtime, pretendime apo prova eventuale në lidhje me sa më sipër, t'i paraqesë ato brenda datës 13.10.2012.

37. Fakti që ankuesi ka marrë dijeni rregullisht për të gjitha veprimet dhe aktet procedurale të kryera nga IKLD-ja, KLD-ja dhe ministri i drejtësisë u pranua prej përfaqësuesit të tij dhe gjatë seancës gjyqësore të zhvilluar para Kolegjeve të Bashkuara të Gjykatës së Lartë, duke konfirmuar dhe njëherë faktin, se nga ana e këtyre organeve janë respektuar me rigorozitet të drejtat e ankuesit, të sanksionuara në nenin 35 të ligjit nr. 9877, datë 18.02.2008, si dhe në Rregulloren "Për organizimin dhe funksionimin e KLD".

38. Rezulton që në datën 26.10.2012, me kërkesën nr. 6127/16, Ministri i Drejtësisë ka kërkuar fillimin e procedimit disiplinor dhe marrjen e masës disiplinore "Shkarkim nga detyra të gjyqtarit N. T."³⁴⁵

Nga arsyetimi i mësipërm, rezulton se rezulton se procedura e inspektimit dhe më pas ajo e procedimit disiplinor ishte kryer në përputhje të plotë me dispozitat ligjore dhe rregulloret përkatëse, që rregullojnë veprimtarinë e Inspektoratit të Këshillit të Lartë të Drejtësisë dhe Ministrisë së Drejtësisë. Kështu, vërtetohej se ankuesi ishte vënë

345. Vendimi nr. 4, datë 07.01.2009 i Kolegjeve të Bashkuara të Gjykatës së Lartë.

në dijeni rregullisht për të gjitha veprimet dhe aktet procedurale të ndërmarra kundrejt tij dhe se atij i është dhënë mundësia për të paraqitur pretendimet e veta. Institucionet përkatëse kishin ndjekur me rigorozitet parimin e zhvillimit të një procesi të rregullt ligjor, duke respektuar të gjitha të drejtat e ankuesit. Ky shembull, i paraqitur më lart, tregon se si duhej të kishte funksionuar procesi i inspektimit në atë kohë.

Ky ligj, në Kreun V, nenet 31 – 34, parashikonte procedimin disiplinor të gjyqtarëve. Sipas këtyre parashikimeve, Ministri i Drejtësisë, përcaktohej si subjekti i vetëm, që vendoste dhe realizonte për procedimin disiplinor të gjyqtarëve.³⁴⁶ Ligji parashikonte se Ministri i Drejtësisë kryente inspektimet e tij, sipas programeve të posaçme tematike ose territoriale, të hartuara kryesisht ose në zbatim të detyrave, që i ishin caktuar nga Këshilli i Lartë i Drejtësisë, në vijim të procesit të verifikimit të ankesave të shtetasve dhe të subjekteve juridike, si dhe sipas të dhënave, për të cilat vihej në dijeni kryesisht, ose nëpërmjet Inspektoratit të Këshillit të Lartë të Drejtësisë.³⁴⁷ Këto parashikime u kundërshtuan si antikushtetuese, por siç u trajtua e evidentua më sipër, ato u konsideruan si kushtetuese nga ana e Gjykatës Kushtetuese, në vendimmarrjen e saj.³⁴⁸

Kur nisej procedura e verifikimit të ankesave apo e inspektimit të gjyqtarit, duhej që ky të vihej në dijeni.³⁴⁹ Në përfundim të hetimit administrativ Ministri i Drejtësisë mund të vendoste mos fillimin e procedimit administrativ duke i shpjeguar KLD-së, edhe motivet për këtë vendimmarrje.³⁵⁰ Përndryshe, nëse kishte materiale të mjaftueshme, në përfundim të inspektimit dhe në bazë të rezultateve të këtij inspektimi, i propozonte KLD-së procedimin e gjyqtarit, duke depozituar edhe dokumentacionin përkatës.³⁵¹ Gjithashtu, kërkesa për procedimin disiplinor, duhej të përmbante edhe propozimin për llojin e masës disiplinore, që gjykohet, se duhet të merret ndaj gjyqtarit të proceduar disiplinarisht.³⁵²

Në rast se ministri i drejtësisë, në fillimin e këtij procedimi disiplinor nuk ishte vënë në lëvizje bazuar në kërkesën e Inspektoratit të KLD-së, atëherë KLD-ja kishte mundësi që t'i ngarkonte këtij inspektorati detyra verifikuese, i cili ishte i detyruar që t'i kryente këto verifikime brenda 15 ditëve, duke dorëzuar raportin përkatës.³⁵³

Verifikimi që duhej të kryente KLD ishte i një rëndësie të madhe, sidomos kur nga ana e subjektit të proceduar, paraqiteshin rrethana,

346. Ligji nr. 8811/2001, neni 31, pika 1.

347. Ligji nr. 8811/2001, neni 31, pika 2.

348. Vendimi nr. 11, datë 11.05.2004 i Gjykatës Kushtetuese.

349. Ligji nr. 8811/2001, neni 32, pika 1.

350. Ligji nr. 8811/2001, neni 31, pika 6.

351. Ligji nr. 8811/2001, neni 31, pika 3.

352. Ligji nr. 8811/2001, neni 31, pika 4.

353. Ligji nr. 8811/2001, neni 31, pika 5.

fakte, provat të tjera apo ngriheshin pretendime të ndryshme. Në këto raste KLD, nuk mundej që t'i injoronte dhe të bazohej vetëm në gjetjet e ministrit të drejtësisë, siç arsyetoi edhe Gjykata e Lartë, në një rast se “17. Kolegjet e Bashkuara të Gjykatës së Lartë e gjejnë me vend të parashtrojnë, se Këshilli i Lartë i Drejtësisë, si organi që zhvillon procedurën disiplinore ndaj gjyqtarit, kishte detyrimin ligjor që të mos kufizohej vetëm në të dhënat e paraqitura nga organi që kishte nisur procedimin. Meqenëse gjatë zhvillimit të kësaj procedure janë paraqitur nga subjekti i interesuar pretendime dhe fakte të tjera, që, sipas tij, kanë ndikuar në shkeljet për të cilat zhvillohet procedimi disiplinor, Këshilli i Lartë i Drejtësisë duhet t'i verifikonte ato.

18. Ky autoritet shtetëror duke vepruar në mbrojtje të interesave publike dhe në të njëjtën kohë, për të mos cenuar të drejtat dhe interesat e ligjshme të subjektit, ndaj të cilit zhvillohej procedura disiplinore, i ka pasur mundësitë ligjore të verifikonte të gjitha faktet në mënyrë që të arrinte në një vendim të drejtë.

19. Marrja dhe verifikimi i të gjitha pretendimeve dhe fakteve, duke përdorur metodat ligjore të të provuarit, lidhen me zbatimin e rregullave që kërkon ligji për marrjen e provave.

19.1. Përdorimi i mjeteve dhe metodave të të provuarit për organin procedues kupton në vetvete të provuarin si një detyrim për të, pasi, për rastin, procedimi disiplinor ka filluar me nismën e tij. Në këto raste organi procedues ka të drejtën dhe detyrimin të kryejë verifikimin e të dhënave, fakteve, sepse ato do të jenë pjesë e arsyetimit të vendimit përfundimtar. Detyrimi për përdorimin e mjeteve të të provuarit lidhet me detyrimin për respektimin me përpikmëri të procedurave ligjore që kërkojnë për nxjerrjen vendimit, formulimin dhe arsyetimin e tij. Në të kundërt, mosrespektimi i tyre ndikon në vlefshmërinë e vendimit dhe e bën atë të cenueshëm, sikurse është vendimi nr. 45, datë 15.04.2014 i Këshillit të Lartë të Drejtësisë i ankimuar.

19.2. Nga shqyrtimi i çështjes në seancë gjyqësore, rezulton se Këshilli i Lartë i Drejtësisë: (i) nuk ka sqaruar plotësisht rrethanat dhe faktet që lidhen me procedimin disiplinor të gjyqtarit A.Ç., objekt gjykimi; (ii) nuk ka zhvilluar një hetim administrativ konform kërkesave të dispozitave të ligjit nr. 9877/2008, të ligjit nr. 8811/2001 dhe të Kodit të Procedurave Administrative, gjë që e ka çuar në një cilësim jo të saktë të fakteve dhe veprimeve që lidhen me të; (iii) konkluzioni i Këshillit të Lartë të Drejtësisë nuk është rrjedhojë e një analize tërësore dhe objektive të provave të marra gjatë zhvillimit të procedurës disiplinore dhe veçanërisht gjatë shqyrtimit të tyre në mbledhjen e datës 15.04.2014.

20. Në vendimin e ankimuar citohen një sërë dispozitash ligjore, por Kolegjet e Bashkuara vlerësojnë, se për rastin konkret citimi i dispozitave ligjore nuk përbën arsyetim të vendimit.

20.1. Arsyetimi përbën një element thelbësor të formës dhe përmbajtjes të një vendimi të Këshillit të Lartë të Drejtësisë dhe ndikon në vlefshmërinë e tij. Arsyetimi duhet të jetë i qartë, të përfshijë argumentimin e bazës ligjore dhe

faktike të tij, si dhe të shmangë alogjizmin (neni 108 i K. Pr. Administrative).

20.2. Inkoherenca dhe kontradiksionet që mbart vendimi i ankimuar, në pjesën arsyetuese të tij, si dhe faktet e rrethanat që janë anashkaluar janë një argument i mjaftueshëm për ta konsideruar vendimin të paarsyetuar dhe për rrjedhojë, të cenueshëm.

21. Në respektim të parimit të drejtësisë, organi vendimmarrës, Këshilli i Lartë i Drejtësisë, duhet të vërtetonte gjendjen reale faktike.

21.1. Në procedimin disiplinor administrativ kërkohet të vërtetohet gjendja e drejtë e çështjes dhe, për këtë qëllim, duhet të vërtetohen të gjitha faktet që kanë të bëjnë dhe që kanë rëndësi për nxjerrjen e një vendimi të ligjshëm dhe të drejtë.

22. Gjithashtu, Kolegjet e Bashkuara vlerësojnë se vendimi nr. 45, datë 15.04.2014 nuk përmban konkretizimin e të gjitha veprimeve procedurale, të domosdoshme për të sheshuar pretendimet e ankuesit dhe as analizën juridike të të gjitha çështjeve të ngritura.

23. Këshilli i Lartë i Drejtësisë nuk ka arsyetuar nëse janë ose jo, veprimet apo mosveprimet me dashje të ankuesit/ gjyqtarit të tilla, që kanë bërë të pamundur kryerjen e detyrave funksionale të tij dhe që vijnë si pasojë e paaftësisë së tij organizative apo për shkaqe të tjera, si ato shëndetësore dhe/ose të ngarkesës së punës.

24. Konstatohet se Këshilli i Lartë i Drejtësisë nuk ka argumentuar, se cilat janë shkaqet e vërteta të shkeljeve, që i atribuohen ankuesit. Pra nuk rezulton, që në vendim të jenë arsyetuar, se mangësitë në veprimtarinë e punës së ankuesit janë rezultat i veprimeve ose mosveprimeve me dashje, që diskreditojnë rëndë pozitën e tij si gjyqtar, apo janë gabime që mund të kenë ardhur si pasojë e gjendjes shëndetësore, apo e ngarkesës së punës.

25. Sqarimi i këtyre rrethanave është i domosdoshëm për shkak se ankuesi është ngarkuar me përgjegjësi, kryesisht për dorëzim të vendimeve tej afatit, konform dispozitave të Kodit të Procedurës Penale dhe të Kodit të Procedurës Civile.

26. Kolegjet e Bashkuara të Gjykatës së Lartë e vërtetojnë se vendimi nr. 45, datë 15.04.2014 i Këshillit të Lartë të Drejtësisë në pjesën arsyetuese të tij është kontradiktor lidhur me shkaqet që formësojnë shkelje shumë të rënda nga ana e gjyqtarit A. Ç.

26.1. Ky këshill, parashtron se "...vonesat e gjyqtarit në arsyetimin dhe dorëzimin e vendimeve gjyqësore, konsiderohen si shkelje disiplinore në kuptim të nenit 32/1/a si dhe të nenit 32/2/c të ligjit nr. 9877, datë 18.02.2008 dhe e ngarkojnë atë me përgjegjësi disiplinore pasi: i) këto vonesa janë të vazhdueshme, të përsëritura dhe të pajustificuara; ii) këto vonesa kanë sjellë pasoja për të drejtat kushtetuese të palëve në gjykim apo për dhënien e drejtësisë; iii) këto vonesa janë jashtë çdo afati të arsyeshëm dhe objektiv; iv) këto vonesa kanë cenuar imazhin e drejtësisë dhe kanë ulur besimin e publikut te drejtësia".

26.2. Nga ana tjetër, është po vetë Këshilli i Lartë i Drejtësisë që ka konstatuar "...se gjyqtari A. Ç., është në pamundësi efektive për të ushtruar normalisht detyrën. Sëmundja i shkakton gjyqtarit paaftësi fizike, e cila domosdoshmërisht

reflektohet në punën e tij, sëmundje e cila ka premisa të qarta, që do të jetë e vazhdueshme duke ndikuar në vijimësi të punës së tij”.

26.3. Pra, ndonëse në vendim pranohet ekzistenca e shkakut shëndetësor lidhur me ecurinë e veprimtarisë së gjyqtarit A. Ç., nuk rezulton që Këshilli të ketë verifikuar, konform dispozitave ligjore të sipërcituara, pretendimin e ankuesit, se shkaku përcaktues i vonesave në arsyetimin dhe dorëzimin e vendimeve gjyqësore ka qenë gjendja e tij jo e mirë shëndetësore, sëmundja e cila pretendohet se sjell pasoja në veprimtarinë konkrete të tij.

27. Verifikimi i këtij pretendimi, brenda kornizës ligjore të hetimit administrativ, dhe analiza juridike e fakteve e provave në tërësinë e tyre, në raport me nenin 147/6 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë dhe dispozitat e tjera ligjore të zbatueshme për rastin konkret, do të nxirrte qartësisht dhe saktësisht arsyet e vonesave, nëse ato janë të tilla, që përbëjnë “akte e sjellje që diskreditojnë rëndë pozitën dhe figurën e gjyqtarit...” apo ndodhemi përpara paaftësisë “mendore e fizike”.

28. Fakti i gjendjes jo të mirë shëndetësore, sikurse u parashtua ut supra, është konstatuar dhe pranuar nga anëtarët e Këshillit, si dhe nga Ministri, që ka iniciuar procedimin disiplinor, disa prej të cilëve kanë parashtuar mungesën e një hetimi më të thellë të këtij fakti.

29. Gjithashtu, evidentohet se Këshilli i Lartë i Drejtësisë nuk i ka dhënë përgjigje pretendimit të ankuesit lidhur me ngarkesën e madhe vjetore me çështje për shqyrtim në raport me gjyqtarët e tjerë, të po së njëjtës gjykatë. Pa përmendur shifra, rezulton se ankuesi për vitin 2012, së bashku me një koleg tjetër, ka pasur numrin më të madh të çështjeve për shqyrtim.

29.1. Në këto rrethana, Këshilli i Lartë i Drejtësisë kishte detyrimin ligjor të verifikonte e analizonte ndikimin ose jo, të ngarkesës së punës në kushtet e gjendjes shëndetësore të ankuesit, për vonesat në arsyetim dhe dorëzim të vendimeve gjyqësore.

30. Po kështu, në vendim parashtrohet si konkluzion, se “Sjellja e gjyqtarit ka diskretituar rëndë pozitën dhe figurën e tij, dhe ka treguar paaftësinë e tij për të përballuar punën e tij të përditshme”, por nuk është treguar e analizuar asnjë fakt, që përbën “paaftësi” në kuptim të nenit 147/6 të Kushtetutës.

31. Në vendim jepen në mënyrë të përgjithshme, me terminologjinë e ligjit, pasojat e arsyetimit dhe dorëzimit me vonesë të vendimeve nga ana e ankuesit, por nuk argumentohen ato.

31.1. Kështu, Këshilli i Lartë i Drejtësisë parashton: “...se vonesat e gjyqtarit në arsyetimin dhe dorëzimin e vendimeve gjyqësore konsiderohen si shkelje disiplinore në kuptim të nenit 32/1/a si dhe nenit 32/2/c të ligjit nr. 9877, datë 18.02.2008 dhe e ngarkojnë atë me përgjegjësi disiplinore pasi: këto vonesa janë të vazhdueshme, të përsëritura dhe të pajustificuara; i) këto vonesa kanë sjellë pasoja për të drejtat kushtetuese të palëve në gjykim apo në dhënien e drejtësisë; ii) këto vonesa janë jashtë çdo afati të arsyeshëm logjik dhe objektiv; iii) këto vonesa kanë cenuar imazhin e drejtësisë dhe kanë ulur besimin e publikut te drejtësia”.

31.2. Kolegjet e Bashkuara vlerësojnë se këto shprehje janë përcaktime të përgjithshme lidhur me pasojat për të drejtat kushtetuese të palëve në gjykim, dhënien e drejtësisë dhe cenimin e imazhit të drejtësisë.

32. Në vendim nuk gjejnë pasqyrim pasojat (faktet dhe/ose rrethanat) konkrete të ardhura nga vonesat në dorëzim të vendimeve gjyqësore të arsyetuar, që përbëjnë, nga njëra anë, diskreditim të pozitës dhe figurës të gjyqtarit dhe, nga ana tjetër, cenim të imazhit të drejtësisë dhe ulje të besimit të publikut te drejtësia e vendimeve të dhëna nga gjyqtari A. Ç., në veçanti dhe të imazhit të drejtësisë në përgjithësi.

33. Kolegjet e Bashkuara të Gjykatës së Lartë sjellin në vëmendje, se në rastet kur merret në shqyrtim veprimtaria e një gjyqtari dhe për më tepër kur ai ngarkohet me përgjegjësi disiplinore, në vendim duhet domosdoshmërisht të argumentohen dhe të arsyetohen jo vetëm faktet dhe provat që mbështesin atë e që përbëjnë shkelje, por duhet të argumentohen dhe të pasqyrohen edhe pasojat konkrete për të drejtat kushtetuese të palëve në gjykim, si dhe cenimin konkret të imazhit të gjyqtarit, që përbën cenim të imazhit të drejtësisë.

34. Për sa më sipër, lidhur me zgjidhjen e çështjes konkrete, Kolegjet e Bashkuara të Gjykatës së Lartë vlerësojnë se vendimi 45, datë 15.04.2014 i Këshillit të Lartë të Drejtësisë, nuk gjen mbështetje në ligj dhe si i tillë duhet të priset dhe meqenëse ndodhemi përpara mungesës së një hetimi administrativ të plotë dhe të gjithanshëm, të vendoset dërgimi i çështjes për rishqyrtim".³⁵⁴

Nga arsyetimi i mësipërm, kuptohet që vendimmarrja e KLD-së ka qenë e pabazuar në ligj dhe e cënueshme, për shkak të mungesës së një hetimi administrativ të plotë dhe të gjithanshëm. Gjykata konstatoi, se procedimi disiplinor ishte zhvilluar pa sqaruar dhe analizuar të gjitha faktet dhe provat e rëndësishme, duke anashkaluar elementë thelbësorë, si ndikimi i gjendjes shëndetësore dhe ngarkesës së punës në shkeljet e pretenduara. Gjithashtu, Gjykata e Lartë vlerësoi se vendimi i KLD-së kishte mangësi të theksuara në arsyetimin e tij, duke mos pasqyruar qartë pasojat konkrete të shkeljeve dhe ndikimin e tyre në të drejtat kushtetuese të palëve apo në imazhin e drejtësisë. Për këto arsye, vendimi u prish dhe çështja u kthye për rishqyrtim, duke nënvizuar nevojën për kryerjen e këtyre veprimeve hetimore disiplinore në mënyrë sa më të plotë, duke respektuar të drejtën për një proces të rregullt ligjor.

Gjyqtari i proceduar kishte të drejtën që të njihej me dokumentacionin e procedimit.³⁵⁵ Në çdo rast, në përfundim të procesit të verifikimit ose të inspektimit, Ministri i Drejtësisë ose Inspektorati i Këshillit të Lartë të Drejtësisë duhej t'i kërkonin gjyqtarit që procedohej, që të paraqiste me shkrim pretendimet e tij, duke qenë të detyruar që t'i pasqyronin në dokumentacionin përfundimtar.³⁵⁶

354. Vendimi nr. 4, datë 13.10.2014 i Kolegjeve të Bashkuara të Gjykatës së Lartë.

355. Ligji nr. 8811/2001, neni 32, pika 2.

356. Ligji nr. 8811/2001, neni 31, pika 7.

Neni 33, i këtij ligji parashikonte më tej, që në mbledhjen e KLD-së do të duhej të thirrej detyrimisht gjyqtari ndaj të cilit do të shqyrtohej marrja e masave disiplinore, i cili kishte të drejtën që të mbrohej edhe me avokat. Njoftimi do të duhej të bëhej në një nga mënyrat që parashikonte “Kodi i Procedurës Administrative”. Mosparaqitja, për shkaqe të paarsyeshme, nuk e pengonte KLD-në, që të shqyrtonte dhe të vendoste për masën.

Në lidhje me këtë parashikim është vënë në diskutim situata, kur nga ana e subjektit që procedohej, paraqiteshin në mënyrë të shpeshtë kërkesa për shtyrje të seancës dëgjimore për arsye shëndetësore. Në lidhje me këtë situatë, në një rast Gjykata e Lartë është shprehur se “47. Kolegjet e Bashkuara të Gjykatës së Lartë e gjejnë të pabazuar pretendimin e ankuesit se KLD, duke vazhduar mbledhjen pa pjesëmarrjen e tij, ka shkelur parimin e procesit të rregullt ligjor, pasi atij nuk i është dhënë mundësia që të dëgjohej në këtë procedim dhe të realizonte të drejtën e tij të mbrojtjes. Rezulton qartë nga shtyrjet e vazhdueshme të mbledhjeve, që ankuesit i është dhënë dhe krijuar mundësia për të marrë pjesë në to, si dhe të ushtrojë të drejtën e tij për një mbrojtje efektive. Ishte ankuesi ai që kishte siguruar KLD-në, që në rast se nuk do të kishte mundësi të paraqitej në mbledhjen e ardhshme, do t’i hapte rrugë shqyrtimit të kërkesës së Ministrit të Drejtësisë, nëpërmjet përfaqësimit të tij me avokat. Dërgimi i avokatit nga ankuesi në mbledhjen e KLD-së, me akt përfaqësimi të limituar (vetëm për paraqitjen e kërkesës së pezullimit të shqyrtimit) dhe jo me një akt të plotë përfaqësimi, në një kohë që ky i fundit ka pasur dijeni të plotë për materialet e procedimit dhe për kërkesën e paraqitur nga Ministri i Drejtësisë, konsiderohet se: ankuesi ka dijeni për procesin, por nuk dëshiron të marrë pjesë në këtë mbledhje (paraqitja e ankuesit në mbledhje nuk është detyrim; detyrim është vetëm njoftimi i tij për mbledhjen), ose se ai ka hequr dorë nga përfaqësimi i tij për pjesën tjetër të procedimit disiplinor, i cili u zhvillua pa pjesëmarrjen e tij.

48. Veprimet e mësipërme të ankuesit nuk kanë sjellë cenimin e parimit të procesit të rregullt ligjor, aq më tepër që ankuesi për shkak të njohurive profesionale që zotëron, njeh shumë mirë rregullat procedurale se si zhvillohet një proces gjyqësor, apo “quasi” gjyqësor, pasojat që vijnë prej tyre, si dhe deri ku shkojnë të drejtat dhe detyrimet e palëve. Palët, siç kanë të drejta, kanë edhe detyrime në procesin gjyqësor ose administrativ. Është tashmë praktikë e konsoliduar, se palët duhet të evitojnë shtyrjet e pajustificuara të procesit apo taktikat për të krijuar vonesa, çka nënkupton, se ato duhet të rezervohen me paraqitjen e kërkesave, që çojnë në zgjatjen e shqyrtimit të çështjes dhe duhet të marrin të gjitha masat për një përfundim sa më të shpejtë të procesit. Është me rëndësi të theksohet se krahas të drejtës që kanë palët “për të marrë pjesë në një proces administrativ/gjyqësor për t’u mbrojtur dhe përfaqësuar”, organi administrativ dhe/ose gjykata kanë detyrimin, që të respektojnë parimin e rëndësishëm “të përfundimit të gjykimit brenda një afati të arsyeshëm”. Të dyja të drejtat janë pjesë përbërëse të procesit të rregullt ligjor dhe duhet të funksionojnë në harmoni me njëra tjetrën.

49. Pretendimi që ankuesi atë ditë ishte i pamundur për të marrë pjesë në mbledhjen e KLD-së, për arsye të gjendjes jo të mirë shëndetësore, nuk cenon aspak parimin e procesit të rregullt ligjor të zhvilluar nga ky institucion, pasi së pari: pranë KLD-së atë ditë nuk është depozituar asnjë dokument, që të vërtetonte një fakt të tillë (vërtetimi nga Spitali Rajonal Durrës, Urgjenca datë 03.12.2013 është paraqitur nga ankuesi në gjykimin para Kolegjeve të Bashkuara të Gjykatës së Lartë); dhe së dyti: përsa kohë mbledhja e KLD-së ishte shtyrë disa herë dhe ankuesi kishte garantuar pjesëmarrjen në këtë mbledhje personalisht, apo nëpërmjet përfaqësuesit të tij, duke e dërguar këtë të fundit, tregon shumë qartë, se ai është përfaqësuar për aq sa dëshironte; atij i ishin dhënë të gjitha mundësitë për t'u përfaqësuar dhe për t'u mbrojtur, të drejta të cilat ai i shfrytëzoi sipas gjykimit të tij.

50. Pas kësaj mënyre të paraqitjes të zgjedhur nga ankuesi, ishte në diskrecionin e KLD-së, që të vendoste të vazhdonte apo jo mbledhjen, pasi kishte verifikuar faktin, që ndaj ankuesit ishin respektuar të gjitha kërkesat ligjore. Sa më sipër, parashikohet qartë, edhe në Ligjin nr.8811, datë 17.05.2001, neni 33, ku shprehimisht thuhet: "Procedimi disiplinor pranë Këshillit të Lartë të Drejtësisë zhvillohet si më poshtë: 1. Në mbledhjen e Këshillit të Lartë të Drejtësisë thirret detyrimisht gjyqtari, ndaj të cilit do të shqyrtohet marrja e masave disiplinore, i cili ka të drejtë të mbrohet edhe me avokat. Njoftimi bëhet në një nga mënyrat, që parashikon "Kodi i Procedurës Administrative". Mosparaqitja, për shkaqe të paarsyeshme nuk e pengon Këshillin e Lartë të Drejtësisë të shqyrtojë dhe të vendosë për masën". "³⁵⁷

Nga pasazhet e mësipërme kuptohet, që vendimmarrja e Këshillit të Lartë të Drejtësisë për të vazhduar shqyrtimin e procedimit disiplinor ndaj gjyqtarit, pavarësisht mungesës së tij fizike në mbledhje, u vlerësua si i drejtë. Ky qëndrim u bazua në faktin, se ankuesi ishte njoftuar rregullisht dhe i ishte dhënë çdo mundësi për të marrë pjesë dhe për t'u përfaqësuar, qoftë personalisht, qoftë përmes një avokati. Mosparaqitja e tij pa justifikime të arsyeshme, si dhe mungesa e një dokumentacioni, që të vërtetonte pengesat shëndetësore, nuk mund të pengonin organin kompetent që të vijonte procedimin brenda afateve të arsyeshme. Gjykata vuri në dukje rëndësinë e balancimit të së drejtës së palës për t'u dëgjuar dhe për t'u mbrojtur me detyrimin e organit administrativ për të siguruar një proces, që duhej të përfundonte brenda një kohe të arsyeshme. Si rrjedhojë, veprimet e KLD-së u cilësuan të ligjshme dhe në përputhje me parimet e procesit të rregullt ligjor.

Përsa i përket zhvillimit të seancës dëgjimore, procedura më pas parashikonte, që në fillim të dëgjohej Ministri i Drejtësisë ose sipas rastit Zëvendëskryetari, i cili i parashtronte KLD-së shkaqet e procedimit. Më pas dëgjohej gjyqtari që procedohej disiplinarisht, të cilit mund t'i bëheshin edhe pyetje nga anëtarët e KLD-së, për të sqaruar çështjet të

357. Vendimi nr. 4, datë 07.01.2009 i Kolegjeve të Bashkuara të Gjykatës së Lartë.

cilat kishin nevojë të qartësoheshin. Diskutimi përfundimtar dhe votimi për marrjen e masave disiplinore, të propozuara nga Ministri i Drejtësisë, bëheshin pa praninë e gjyqtarit që procedohej.

Me reformën e vitit 2014, u përcaktua se shqyrtimi i procedimit disiplinor do të duhej të bëhej brenda një muaji nga data e depozitimit të dokumentacionit përkatës nga Ministri i Drejtësisë, pranë KLD-së³⁵⁸ dhe në qoftë se KLD-ja rrëzonte masën disiplinore të propozuar nga Ministri i Drejtësisë, mund të vendoste edhe për një masë disiplinore më të lehtë.³⁵⁹

Në lidhje me këtë shtesë, pra të përfundimit të shqyrtimit të procedimit disiplinor brenda një muaji nga data e depozitimit të dokumentacionit përkatës nga Ministri i Drejtësisë, pranë KLD-së, në praktikën gjyqësore u shtrua për diskutim, natyra e këtij afati dhe pasoja e kalimit të tij. Gjykata e Lartë në këtë rast, arsyetoi se *“Në lidhje me pretendimin e ankueses se procedimi për dhënien e masës së re disiplinore, duhet të vlerësohet i gjatë dhe si pasojë pa efekte, pasi bëhet fjalë për veprimtarinë kur ankuesja punonte në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Tiranë, bazuar në ligjin nr. 8811, datë 17.05.2001, “Për organizimin dhe funksionimin e Këshillit të Lartë të Drejtësisë”, ku sipas nenit 33, pikës 2/1, “Shqyrtimi i procedimit disiplinor bëhet brenda një muaji nga data e depozitimit të dokumentacionit përkatës nga Ministri i Drejtësisë, pranë Këshillit të Lartë të Drejtësisë”, Kolegjet e Bashkuara vlerësojnë se ky pretendim nuk është i bazuar. Për shkak se kjo kohëzgjatje ka ardhur si rezultat i verifikimit dhe i shqyrtimit të pretendimeve të shumta të ngritura nga ana e ankueses, të cilat kanë kërkuar një hark kohor për t’u ekzaminuar. Për më tepër, ky pretendim nuk qëndron edhe për faktin se, nisur edhe nga interpretimi sistematik i kësaj dispozite ligjore, ajo nuk parashikohet në nenin 32 të këtij ligji, ku në fakt, parashikohen të drejtat e gjyqtarit që procedohet. Efektet e afatit të parashikuar prej kësaj dispozite janë të natyrës organizative dhe jo të natyrës së detyrueshme. Pra, qëllimi i parashikimit të afatit të shqyrtimit të procedimit sipas kësaj dispozite është përshpejtimi i veprimtarisë së shqyrtimit të themelit të kërkesës për procedim disiplinor të gjyqtarit, duke mos parashikuar ndonjë pasojë në rast të kalimit të këtij afati përshpejtues dhe jo sanksionues, pra norma ka për qëllim garantimin e zhvillimit të procedurës brenda një afati sa më të arsyeshëm”*.³⁶⁰

Vendimi i mësipërm, sqaroi mjaft mirë, se afati njëmuajor i parashikuar për shqyrtimin e procedimit disiplinor nga Këshilli i Lartë i Drejtësisë, pas depozitimit të dokumentacionit nga ministri i drejtësisë ishte i natyrës organizative dhe jo një afat prekluziv. Gjykata e Lartë theksoi se qëllimi i kësaj dispozite ishte që të siguronte zhvillimin e procedurës brenda një kohe të arsyeshme dhe të shmangte zvarritjet e panevojshme, por mosrespektimi i këtij afati nuk ndikonte në vlefshmërinë apo legjitimitetin

358. Ligji nr. 101/2014, neni 14.

359. Ligji nr. 101/2014, neni 11.

360. Vendimi nr. 1, datë 05.10.2015 i Kolegjeve të Bashkuara të Gjykatës së Lartë.

e procedimit disiplinor. Në rastin konkret, zgjatja e shqyrtimit, erdhi si rezultat i nevojës për të verifikuar dhe trajtuar pretendimet e shumta të paraqitura nga ankuesja, duke e bërë kohëzgjatjen e procesit të justifikuar dhe në përputhje me parimin e një procesi të rregullt ligjor. Pra, kalimi i këtij afati nuk sillte asnjë pasojë juridike për procedimin disiplinor.

Përsa i përket ankimimit kundër vendimmarrjes së KLD-së, ky ligj, në ndryshim nga ligji për gjyqësorin i vitit 1998, parashikonte se ankimi ndaj vendimit të Këshillit të Lartë të Drejtësisë për shkarkimin nga detyra e gjyqtarit, si dhe për çdo masë tjetër me karakter disiplinor bëhej nga ky i fundit në Gjykatën e Lartë brenda 10 ditëve nga marrja e njoftimit për vendimin e këtij Këshilli.³⁶¹ Ky parashikim u kundërshtua nga Gjykata e Lartë, si një tejkalim të juridiksionit të saj, parashikuara në Kushtetutën e Shqipërisë, sipas të cilit, Gjykata e Lartë shqyrtonte vetëm ankesat kundër masës disiplinore të shkarkimit nga detyra. Në lidhje me këtë rast, Gjykata Kushtetuese, arsyetoi se *“Për rastin në shqyrtim, Gjykata Kushtetuese çmon se merr rëndësi të veçantë analiza që i duhet bërë hierarkisë së normave juridike. Kuptimi normativist bazohet në hierarkinë juridike dhe në supremacinë e normës kushtetuese ndaj akteve më të ulëta, që në doktrinën kushtetuese njihet si parimi i epërsisë (supremacisë) së Kushtetutës. Kushtetuta, si ligji themelor i shtetit, i detyron të gjitha organet e pushtetit publik që t’i ushtrojnë kompetencat e tyre vetëm në kuadër dhe në bazë të normave kushtetuese, që përbën një parim tjetër të rëndësishëm, atë të kushtetutshmërisë funksionale.*

Mbështetur në këto parime, veprimtaria dhe funksionet e të gjitha organeve shtetërore bazohen në Kushtetutë. Janë veprimtaria normëvënëse e organeve të autorizuar nga Kushtetuta, si edhe natyra e përmbajtja e ligjeve dhe e akteve nënligjore që ato nxjerrin, të cilat përcaktojnë edhe pozitën e këtyre akteve në hierarkinë e normave juridike. Nga kjo buron kërkesa dhe parimi, sipas të cilit aktet juridike më të ulëta duhet të jenë në pajtim me aktet juridike më të larta, si në kuptimin formal, ashtu edhe atë material.

Dispozitat e Kushtetutës zbatohen drejtpërsëdrejti, përveç rasteve kur Kushtetuta parashikon ndryshe. Ky është një parim themelor i sanksionuar në nenin 4 pika 3 të Kushtetutës së Republikës të Shqipërisë, sipas të cilit kur rregulli kushtetues parashikohet shprehimisht, ai nuk mund të mënjanohet dhe as të tejkalohet, por duhet të zbatohet drejtpërsëdrejti. Përjashtimi kushtetues, i parashikuar në këtë dispozitë, nënkupton se normat kushtetuese mund edhe të mos gjejnë zbatim drejtpërsëdrejti, kur Kushtetuta ka ngarkuar posaçërisht organet shtetërore përkatëse për të nxjerrë ligjet dhe aktet e tjera nënligjore, me qëllim rregullimin e marrëdhënieve në fusha të ndryshme dhe në përputhje me hierarkinë e normave.

Pra Kushtetuta përmban dispozita, që rregullojnë zbatimin e saj në mënyrë të drejtpërdrejtë ose të tërthortë, duke i krijuar hapësirë ligjvënësit për të vepruar më shumë ose më pak, me përjashtim të rasteve kur vetë Kushtetuta parashikon

361. Ligji nr. 8811/2001, neni 34, pika 1.

ndryshe. Parë nga ky këndvështrim, është Kushtetuta që autorizon ligjvënësin, që duke respektuar konceptet dhe parimet kushtetuese, të caktojë kufijtë e hapësirës rregulluese, nëpërmjet nxjerrjes së normave juridike.

Për t'i dhënë zgjidhje kërkesës së paraqitur, Gjykata Kushtetuese çmon të nevojshme se duhet të përqendrohet te mënyra e formulimit të nenit 147, pikat 4 dhe 6, të Kushtetutës. Sipas pikës 4 të këtij neni: "Këshilli i Lartë i Drejtësisë vendos për transferimin e gjyqtarëve, si dhe për përgjegjësinë e tyre disiplinore sipas ligjit." Formulimi i kësaj dispozite përfshihet në ato raste përjashtimore kur normat kushtetuese nuk mund të zbatohen në mënyrë të drejtpërdrejtë, pasi në to është parashikuar mundësia e rregullimit të marrëdhënies përkatëse me anë të ligjit. Kjo dispozitë e Kushtetutës përmban elementet e një norme referuese, për shkak se mënyrën e transferimit të gjyqtarëve dhe përgjegjësinë e tyre disiplinore ia ka deleguar ligjvënësit. Sipas dispozitës së sipërcituar, ligjvënësit i është dhënë e drejta, që nëpërmjet ligjeve të rregullojnë në mënyrë të hollësishme çështjet që përfshihen vetëm në këto dy drejtime të specifikuara.

Është i ndryshëm formulimi i nenit 147 pika 6, në të cilin rezulton se Kushtetuta nuk e ka autorizuar ligjvënësin, por ka marrë përsipër ta rregullojë vetë, si çështjen e objektit të ankimit, ashtu edhe atë të organit kompetent që do të merret me shqyrtimin e tij. Në këtë mënyrë, kjo normë kushtetuese paraqitet si një dispozitë përjashtimore e kufizuese dhe si e tillë duhet interpretuar në mënyrë strikte. Kushtetuta, pa lënë shteg për mëdyshje, ka parashikuar se vetëm ankimi për masën e shkarkimit nga detyra të Këshillit të Lartë të Drejtësisë shqyrtohet nga Kolegjet e Bashkuara të Gjykatës së Lartë.

Mbështetur në kuptimin që del nga kjo analizë, Gjykata Kushtetuese çmon se neni 34, pika 1 e ligjit nr. 8811, datë 17.05.2001, "Për organizimin dhe funksionimin e Këshillit të Lartë të Drejtësisë", që parashikon të drejtën e ankimit në Gjykatën e Lartë ndaj çdo mase tjetër me karakter disiplinor, përbën tejkalim të përmbajtjes së dispozitës kushtetuese në dy drejtime, në aspektin e zgjerimit të masave të tjera disiplinore dhe në atë të tejkalimit të juridiksionit të Gjykatës së Lartë.

Standardi i pranuar nga Kushtetuta për mbrojtjen e statusit të gjyqtarit përqendrohet për t'u zbatuar ndaj masës së shkarkimit nga detyra të gjyqtarit dhe jo ndaj masave të tjera disiplinore. Masa e shkarkimit, si një masë e rëndë disiplinore, i jep fund karrierës së gjyqtarit dhe për rrjedhojë ka të bëjë në mënyrë të drejtpërdrejtë me statusin kushtetues të tij. Kushtetuta nuk ndalon ndërhyrjen në disiplinimin e gjyqtarëve për ato aspekte që lidhen me ushtrimin e funksionit të tyre. Janë këto arsye, që shpjegojnë përse i është dhënë e drejta Këshillit të Lartë të Drejtësisë, që në bazë të ligjit, të procedojë gjyqtarët dhe të marrë ndaj tyre masa disiplinore. Lloji dhe natyra e masave disiplinore, si dhe procedura e marrjes së tyre janë brenda vullnetit të ligjvënësit, përjashtimisht masës së shkarkimit nga detyra, për të cilën Kushtetuta ka parashikuar një rregullim të veçantë.

Pikërisht këtë rregullim ndryshe, e parashikon neni 147, pika 6 e Kushtetutës, i cili, masën e shkarkimit e ka trajtuar në mënyrë të posaçme dhe

me një garanci më të madhe, e në raport me të gjitha masat e tjera disiplinore, duke e lënë shqyrtimin e saj në kompetencë të Kolegjeve të Bashkuara të Gjykatës së Lartë. Jo pa qëllim Kushtetuta, të drejtën e ankimit për masën e shkarkimit nga detyra, si dhe organin që duhet ta shqyrtojë këtë masë, e ka parashikuar në pikën 6, të nenit 147, duke e veçuar nga pika 4 e tij, e cila lë në diskrecionin e ligjvënësit trajtimin e rasteve të përgjegjesisë disiplinore të gjyqtarëve.

Njëkohësisht, aspekt tjetër i antikushtetutshmërisë së dispozitës ligjore, objekt i këtij gjykimi, është dhënia e një kompetence ligjore Gjykatës së Lartë, kompetencë që del jashtë juridiksionit të saj kushtetues. Në bazë të nenit 147 pika 6 të Kushtetutës, kundër vendimit të shkarkimit, gjyqtari ka të drejtë të ankohet në Kolegjet e Bashkuara të Gjykatës së Lartë. Kushtetuta e ka të përcaktuar juridiksionin e Gjykatës së Lartë. Në nenin 141 të Kushtetutës është parashikuar se kjo gjykatë ka juridiksion fillestar dhe rishikues. Gjithnjë sipas kësaj dispozite, asaj i njihet e drejta e njësimi ose e ndryshimit të praktikës gjyqësore.

Gjykata Kushtetuese nuk shtrihet për shqyrtim, interpretimin e zgjeruar kushtetues të juridiksionit rishikues të Gjykatës së Lartë, të parashikuar në nenin 141, përse kohë që çështjen e ankimit ndaj masës së shkarkimit të gjyqtarëve, si dhe organin që shqyrton një masë të tillë, Kushtetuta e ka parashikuar shprehimisht dhe në mënyrë të posaçme në një dispozitë tjetër.

Gjithashtu, Kushtetuta nuk i ka lënë ndonjë hapësirë ligjvënësit, që në kuptim të fuqizimit të standardit të mbrojtjes së gjyqtarëve, të përfshijë në juridiksionin kushtetues të Gjykatës së Lartë shqyrtimin e ankimit ndaj masave të tjera disiplinore. Kapërcimi i standardit të mbrojtjes së gjyqtarëve nuk mund të përbëjë argument për të tejkaluar juridiksionin kushtetues të këtij organi.

Çështja e standardeve pozitive është një koncept, që përgjithësisht lejohet nga Kushtetuta, por ky nuk mund të ketë shtrirje të pakufizuar, aq më pak për kategorinë e funksionarëve publikë. Neni 17 i Kushtetutës, si dhe qëndrimet e mbajtura nga jurisprudenca gjyqësore pranojnë teorinë e standardit pozitiv kur bëhet fjalë për të drejtat themelore të individit, por jo ndaj zyrtarëve të lartë të shtetit.

Shkarkimi nga detyra i gjyqtarit është një procedurë impeachment, e cila zbatohet për zyrtarë, që ushtrojnë aspekte të sovranitetit shtetëror dhe si e tillë, ajo nuk mund të barazohet me procedurën, që ndiqet për individët e thjeshtë. E drejta për t'iu drejtuar gjykatës përbën një aspekt të të drejtave të çdo individi, por "kjo nuk është e drejtë absolute. Ajo mund të jetë subjekt i kufizimeve të ligjshme."

Sidoqoftë, në këtë drejtim, Kushtetuta ka bërë një hap më tej, se Konventa Evropiane për të Drejtat e Njeriut, duke e shoqëruar masën e shkarkimit të gjyqtarit me garancitë e ankimit në Gjykatën e Lartë. Shtrirja e këtij koncepti edhe për masat e tjera disiplinore bie në kundërshtim me Kushtetutën. Nga ky kuptim, neni 147, pika 6 i Kushtetutës, duke qenë i konceptuar si një dispozitë me karakter përjashtimor, nuk mund të interpretohet në mënyrë zgjeruese.

Mbështetur në këto argumente, neni 34/1 i ligjit "Për organizimin dhe funksionimin e Këshillit të Lartë të Drejtësisë", që zgjeron objektin e ankimit

të gjyqtarëve për masat e tjera disiplinore, si dhe juridiksionin e Gjykatës së Lartë, i ka kapërcyer caqet e vendosura nga Kushtetuta. Përderisa ndodhemi përpara një norme ligjore, që nuk mbështetet në parimet dhe rregullimet e specifikuara kushtetuese, por në tejkalime jashtëkushtetuese si në formë, ashtu edhe në përmbajtje, Gjykata Kushtetuese çmon se është prekur parimi i hierarkisë së normave. Ky është një qëndrim i konsoliduar i Gjykatës Kushtetuese në disa çështje të tjera analoge, në të cilat ka theksuar, se “atë” që nuk ka dashur ta bëjë Kushtetuta, nuk mund ta bëjë ligji. Prandaj nuk mund të pranohet se ajo ka ometuar pa përmendur raste të tilla...”.

Mbi bazën e të gjitha argumenteve të parashtruara më sipër, Gjykata Kushtetuese arrin në përfundimin, se dispozita objekt shqyrtimi duhet shfuqizuar si antikushtetuese, vetëm sa i takon pjesës së saj, që parashikon të drejtën e gjyqtarëve për t’u ankuar edhe ndaj masave të tjera disiplinore në Gjykatën e Lartë”.³⁶²

Me të drejtë, siç rezulton nga arsyetimi i mësipërm, Gjykata Kushtetuese sqaroi se dispozita e ligjit organik të KLD-së, që lejonin gjyqtarët të ankoreshin në Gjykatën e Lartë kundër masave të tjera disiplinore përveç shkarkimit nga detyra ishte në kundërshtim me Kushtetutën e Shqipërisë. Gjykata Kushtetuese theksoi rëndësinë e hierarkisë së normave juridike dhe supremacinë e Kushtetutës mbi aktet ligjore dhe nënligjore. Duke analizuar nenin 147 të Kushtetutës, Gjykata arriti në përfundimin, se juridiksioni i Gjykatës së Lartë në çështjet disiplinore kufizohej vetëm në shqyrtimin e ankimeve për masën e shkarkimit nga detyra dhe jo për të gjitha masat disiplinore që mund të merrte Këshilli i Lartë i Drejtësisë. Gjykata Kushtetuese përcaktoi se shtrirja e së drejtës së ankimit, edhe ndaj masave të tjera disiplinore përbënte një tejkalim të juridiksionit kushtetues të Gjykatës së Lartë dhe për rrjedhojë, dispozita u shfuqizua pjesërisht si antikushtetuese.

Ndodhur në këto kushte, Gjykata e Lartë më pas vendosi pushimin e gjykimit të të gjitha çështjeve që ndodheshin pranë saj dhe që kishin të bënin me vendimmarrjet e KLD-së nëpërmjet të cilave ishin dhënë ndaj disa gjyqtarëve, masa të tjera disiplinore, por jo ajo e shkarkimit nga detyra.³⁶³

362. Vendimi nr. 29, datë 09.11.2005 i Gjykatës Kushtetuese.

363. Shih vendimet nr. 6, datë 08.03.2006; nr. 7, datë 08.03.2006; nr. 10, datë 08.03.2006 dhe nr. 11, datë 08.03.2006 të Kolegjeve të Bashkuara të Gjykatës së Lartë.

KREU IV

PROCEDIMI DISIPLINOR PAS REFORMËS NË DREJTËSI TË VITIT 2016

Sistemi i drejtësisë në Shqipëri ishte subjekt kritikash në raportet³⁶⁴ e organizatave ndërkombëtare për nivel të lartë korrupsioni, promovime ta pabazuara në kriterë objektive dhe meritokraci, përgjegjësi e ulët disiplinore, etj.

Në këtë panoramë, nga ana e Kuvendit u ndërmor një reformë e thellë kushtetuese, ligjore dhe strukturore, me qëllim përmirësimin e sistemit të drejtësisë. Në kuadër të kësaj reforme u miratua ligji nr. 76/2016, i cili amendoi pothuaj tërësisht pjesën e nëntë (Pushteti gjyqësor) dhe pjesën e dhjetë (Prokuroria) të Kushtetutës së Shqipërisë.

Kjo reformë përbën një nga ndërhyrjet më të thella dhe më transformuese në historinë kushtetuese dhe institucionale të vendit tonë. Ajo solli jo vetëm një riorganizim të strukturës gjyqësore dhe të sistemit të prokurorisë, por krijoi edhe një filozofi të re mbi pavarësinë, përgjegjshmërinë dhe integritetin e këtij sistemi.

Në planin institucional ndryshimet kushtetuese krijuan themelet e një arkitekture të re institucionale, të cilat synojnë shkëputjen e gjyqësorit dhe prokurorisë nga ndikimet politike dhe forcimin e ndjeshëm të mekanizmave të kontrollit të brendshëm dhe të jashtëm. Një nga risitë kryesore ishte krijimi i dy organeve të reja kushtetuese: Këshilli i Lartë Gjyqësor (KLGJ)³⁶⁵ dhe Këshilli i Lartë i Prokurorisë (KLP)³⁶⁶. Këto dy organe zëvendësuan Këshillin e Lartë të Drejtësisë përsa i përket pushtetit gjyqësor, si edhe Prokurorin e Përgjithshëm, përsa i përket kompetencave, që kishin të bënin me statusin e prokurorëve, përfshirë emërimet, ngritjet në detyrë, transferimet, vlerësimet dhe masat disiplinore.

Gjithashtu, reforma solli në jetë dy struktura të reja me juridiksion të posaçëm për luftën kundër korrupsionit dhe krimit të organizuar: Gjykata e Posaçme kundër Korrupsionit dhe Krimit të Organizuar³⁶⁷ dhe

364. "Progres-raporti: Reforma në drejtësi, kusht për hapjen e negociatave me BE".
Aksesuar më datë 02.05.2025

365. Kushtetuta, nenet 147 – 147/ç.

366. Kushtetuta, nenet 149 – 149/ç.

367. Kushtetuta, neni 135, pika 2.

Prokuroria e Posaçme, që bashkërisht me Byronë Kombëtare të Hetimit, njihet gjerësisht si SPAK³⁶⁸ (Struktura e Posaçme Kundër Korrupsionit dhe Krimit të Organizuar). Këto organe janë të pajisura me një regjim të veçantë për përzgjedhjen, emërimin dhe mbikëqyrjen e punës së gjyqtarëve dhe prokurorëve, që i përbëjnë ato, përfshirë verifikimin e pasurisë, integritetit dhe kontrollin periodik të llogarive bankare dhe të komunikimeve.

Risia shtrihet edhe në modalitetet e përzgjedhjes së figurave të larta në sistem, si Prokurori i Përgjithshëm,³⁶⁹ apo gjyqtarët e Gjykatës së Lartë,³⁷⁰ ku procedurat janë ndërtuar mbi kriteret objektive, transparencë dhe ndarje kompetencash midis institucioneve të ndryshme, për të shmangur përqendrimin e pushtetit në një dorë të vetme.

Një tjetër institucion i ri dhe me rëndësi të madhe, që u krijua si rezultat i kësaj reforme është Inspektori i Lartë i Drejtësisë (ILD).³⁷¹ Ky organ është përgjegjës për verifikimin e ankesave dhe nisjen e procedurave disiplinore ndaj gjyqtarëve dhe prokurorëve të të gjitha niveleve, si dhe ndaj anëtarëve të KLGJ-së, KLP-së dhe Prokurorit të Përgjithshëm. Inspektori i Lartë i Drejtësisë është gjithashtu përgjegjës për inspektimin institucional të gjykatave dhe të zyrave të prokurorisë. Për herë të parë, u krijua një organ i pavarur hetimor për etikën dhe sjelljen e gjyqtarëve e prokurorëve, i cili vendos një kontroll jashtë strukturës vetëqeverisëse të sistemit. Deri në korrik 2016, kontrolli i magistratëve kryhej nga tre institucione të veçanta: ministri i drejtësisë, Këshilli i Lartë i Drejtësisë (për gjyqtarët) dhe Prokurori i Përgjithshëm (për prokurorët). Me ngritjen e ILD-së, inspektimi gjyqësor u riorganizua në një institucion të vetëm monokratik.

Në lidhje me disiplinën dhe përgjegjësinë, Kushtetuta tashmë parashikon se gjyqtarët dhe prokurorët mund të shkarkohen në rast të shkeljeve të rënda profesionale ose etike, që diskreditojnë pozitën e tyre, apo nëse dënohen për kryerjen e një krimi.³⁷² Këtë parashikim, jurisprudenca e KLGJ e ka konsideruar të vetë zbatueshme, edhe në mungesë të një parashikimi të detajuar ligjor. Kështu, duke qenë se neni 104 i ligjit nr. 96/2016 *“Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve”*, që detajonte këtë parashikim ishte shfuqizuar nga ana e Gjykatës Kushtetuese,³⁷³ Këshilli i Lartë Gjyqësor argumentoi se parashikimi kushtetues ishte drejtpërsëdrejti i zbatueshëm.³⁷⁴ I njëjti qëndrim, por në raport me nenin

368. Kushtetuta, neni 148/dh.

369. Kushtetuta, neni 148/a.

370. Kushtetuta, neni 136.

371. Kushtetuta, nenet 147/d – 147/ë.

372. Kushtetuta, nenet 140 dhe 148/d.

373. Vendimi nr. 34, datë 10.04.2017 i Gjykatës Kushtetuese.

374. Vendimet nr. 529, datë 27.10.2020; nr. 92, datë 17.03.2021; nr. 223, datë 02.06.2021 dhe nr. 462, datë 11.10.2021 të Këshillit të Lartë Gjyqësor.

148/d të Kushtetutës, u mbajt edhe nga Këshilli i Lartë i Prokurorisë.³⁷⁵

Masat disiplinore merren nga KLGJ dhe KLP, sipas një procedure të parashikuar nga ligji, e cila duhet të garantojë të drejtën për një proces të rregullt ligjor.

Normat e reja kushtetuese parashikojnë edhe rolin e Gjykatës Kushtetuese, e cila mbi bazën e kërkesës së paraqitur nga Inspektori i Lartë i Drejtësisë, vendos ose jo për shkarkimin e anëtarëve të Këshillit të Lartë Gjyqësor,³⁷⁶ anëtarëve të Këshillit të Lartë të Prokurorisë, si edhe të Prokurorit të Përgjithshëm.³⁷⁷ Ndërsa gjyqtarët³⁷⁸ dhe prokurorët,³⁷⁹ që janë shkarkuar nga Këshillat respektivë kanë të drejtë ankimi kundër asaj mase në Gjykatën Kushtetuese. Siç do të trajtohet më tej, kundër masave të tjera disiplinore, gjyqtarët dhe prokurorët ankohen në Gjykatën Administrative të Apelit dhe eventualisht, edhe Kolegjin Administrativ të Gjykatës së Lartë.

Megjithatë këto parashikime momentalisht janë të pezulluara, për shkak se nëpërmjet dispozitave tranzitore është përcaktuar, se deri në përfundimin e mandatit të tij, organi kushtetues i ngarkuar me shqyrtimin e të gjitha ankesave të gjyqtarëve dhe prokurorëve është Kolegji i Posaçëm i Apelit,³⁸⁰ organ ky i krijuar kryesisht për të shqyrtuar ankesat e gjyqtarëve, prokurorëve dhe komisionerëve publikë gjatë procesit të rivlerësimit kalimtar.

1. Inspektimi i gjyqtarëve dhe prokurorëve

Reforma kushtetuese e vitit 2016 shënoi një shkëputje nga traditat e vjetra juridike, duke krijuar një institucion të ri kushtetues, i dedikuar vetëm për inspektimin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Shqipëri. Ky organ kushtetues është Inspektori i Lartë i Drejtësisë. Sipas ligjit themelor të vendit Inspektori i Lartë i Drejtësisë është përgjegjës për verifikimin e ankesave, hetimin me nismë të shkeljeve dhe fillimin e procedimit disiplinor ndaj gjyqtarëve dhe prokurorëve të të gjitha niveleve, anëtarëve të Këshillit të Lartë Gjyqësor, anëtarëve të Këshillit të Lartë të Prokurorisë dhe të Prokurorit të Përgjithshëm, sipas procedurës së përcaktuar me ligj. Gjithashtu, Inspektori i Lartë i Drejtësisë është përgjegjës edhe për inspektimin institucional të gjykatave dhe të zyrave të prokurorisë. Inspektori i Lartë i Drejtësisë zgjidhet me tri të pestat e të gjithë anëtarëve

375. Vendimi nr. 81, datë 31.03.2021 i Këshillit të Lartë të Prokurorisë.

376. Kushtetuta, neni 147/c.

377. Kushtetuta, neni 149/c.

378. Kushtetuta, neni 140, pika 4.

379. Kushtetuta, neni 148/d, pika 3.

380. Kushtetuta, neni 179, pika 7.

të Kuvendit, për një periudhë 9-vjeçare, pa të drejtë rizgjedhjeje, nga radhët e juristëve të spikatur, me jo më pak se 15 vjet përvojë pune në profesion, me integritet të lartë moral dhe profesional. Ai nuk duhet të ketë mbajtur funksione politike në administratën publike, ose pozicione drejtuese në parti politike gjatë 10 vjetëve të fundit përpara kandidimit. Inspektori i Lartë i Drejtësisë zgjidhet nga lista e pesë kandidatëve të përzgjedhur dhe renditur mbi bazën e meritave nga Këshilli i Emërimeve në Drejtësi, sipas një procedure transparente dhe publike. Në rast se Kuvendi nuk arrin shumicën prej tri të pestave për asnjë prej kandidatëve, brenda 30 ditëve nga paraqitja e listës, kandidati i renditur i pari shpallet i emëruar. Inspektori i parë i Lartë i Drejtësisë është zgjedhur nga Kuvendi i Shqipërisë me vendimin nr. 2, datë 20 janar 2020.³⁸¹

Ligji themelor kujdeset që t'i japë një trajtim të veçantë, kur përcakton se Inspektori i Lartë të Drejtësisë gëzon statusin e gjyqtarit të Gjykatës së Lartë.³⁸² Si pjesë e statusit të Inspektorit të Lartë të Drejtësisë është edhe elementi i pajtueshmërisë, i cili parashikon se qenia në këtë pozicion nuk pajtohet me asnjë veprimtari tjetër politike ose shtetërore, si dhe veprimtari profesionale që ushtrohet kundrejt pagesës, me përjashtim të aktivitetit mësimdhënës, akademik ose shkencor, sipas ligjit.³⁸³

Me qëllim garantimin më tej të statusit të Inspektorit të Lartë të Drejtësisë, Kushtetuta, përcakton në mënyrë shteruese rastet e mbarimit të mandatit të tij dhe konkretisht a) mbush moshën e pensionit; b) përfundon mandatin 9-vjeçar; c) jep dorëheqjen; ç) shkarkohet sipas parashikimeve kushtetuese; d) vërtetohen kushtet e pazgjedhshmërisë dhe të papajtueshmërisë në ushtrimin e funksionit; dh) vërtetohet fakti i pamundësisë për të ushtruar detyrën. Vërtetimi i njëri prej këtyre rasteve, që passjell mbarimin e mandatit të Inspektorit të Lartë të Drejtësisë deklarohet me vendim të mbledhjes së përbashkët të Këshillit të Lartë Gjyqësor dhe të Këshillit të Lartë të Prokurorisë. Në rastet kur mbush moshën e pensionit apo edhe kur i mbaron mandati nëntë vjeçar, Inspektori i Lartë i Drejtësisë qëndron në detyrë, deri sa të vijë pasardhësi i tij. Kjo bëhet me qëllim që ky pozicion të mos mbetet vakant, në këto dy raste.³⁸⁴

Përsa i përket procedimit disiplinor dhe mundësisë së shkarkimit të Inspektorit të Lartë të Drejtësisë, Kushtetuta parashikon fillimisht rregullin e përgjithshëm se Inspektori i Lartë i Drejtësisë mban përgjegjësi disiplinore, sipas ligjit. Më pas, ligji themelor parashikon se pretendimet lidhur me shkeljet disiplinore të Inspektorit të Lartë të Drejtësisë hetohen nga një komision hetimor i Kuvendit, duke respektuar të drejtën e tij për proces të rregullt. Komisioni hetimor, në rast se konstaton shkelje,

381. Kandidatura fituese mori 98 vota "pro".

382. Kushtetuta, neni 147/d

383. Kushtetuta, neni 147/ë.

384. Kushtetuta, neni 147/dh.

i propozon Gjykatës Kushtetuese shkarkimin e Inspektorit të Lartë të Drejtësisë, sipas ligjit.³⁸⁵

385. Në detajim të këtij parashikimi kushtetues, ligji nr. 115/2016 "Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë", i ndryshuar, parashikon se Kuvendi heton shkeljet e dyshuara disiplinore të Inspektorit të Lartë të Drejtësisë në bazë të rregullave dhe procedurave të parashikuara në ligjin "Për organizimin dhe funksionimin e komisioneve hetimore të Kuvendit" dhe në Rregulloren e Kuvendit. Afati i parashkrimit për fillimin e hetimit të shkeljes disiplinore të Inspektorit të Lartë të Drejtësisë është 5 vjet nga momenti i përfundimit të shkeljes. Pas fillimit të hetimit, afati nuk parashkruhet. Afati i parashkrimit ndërpritet nëse Inspektori i Lartë kryen një shkelje tjetër të të njëjtit lloj brenda këtij afati. Në këtë rast, afati i parashkrimit llogaritet duke filluar nga momenti i përfundimit të shkeljes së re. Nëse shkeljet disiplinore përbëjnë njëkohësisht edhe vepër penale, zbatohet afati i parashkrimit të veprave penale, sipas parashikimeve të Kodit Penal, me kushtin që afati i parashkrimit, i parashikuar në Kodin Penal, të jetë më i gjatë se 5 vjet. Procedimi disiplinor pezullohet nëse për të njëjtat fakte, të kryera nga i njëjti person, ka filluar një procedim gjyqësor penal, civil ose administrativ, gjer në përfundimin e shqyrtimit të çështjes. Vendimi për pezullimin nuk mund të ankimohet. Gjatë periudhës së pezullimit nuk mund të kryhet asnjë veprim i procedurës disiplinore. Pas zhdukjes së shkakut të pezullimit, procedimi disiplinor fillon nga veprimi procedural, që po kryhej në kohën e pezullimit. Në hetimin e shkeljeve disiplinore të Inspektorit të Lartë, Kuvendi merr parasysh faktet e vërtetuara me vendimin e gjykatës. Vendimi përfundimtar i gjykatës në favor të Inspektorit të Lartë nuk përbën pengesë për vazhdimin e procedimit disiplinor nga Kuvendi. Në përfundim të hetimit parlamentar, komisioni hetimor parlamentar merr vendim për pushimin e procedimit disiplinor kur provat janë të pamjaftueshme për të provuar shkeljen disiplinore, kur çështja ka qenë objekt i një procedimi të mëparshëm disiplinor, të mbyllur me vendim përfundimtar, kur çështja është parashkruar dhe kur Inspektori i Lartë nuk është më në detyrë ose i kërkon Gjykatës Kushtetuese shkarkimin e Inspektorit të Lartë të Drejtësisë.

Bazuar në këto parashikime, rezultojnë qartësisht, se në këtë rast, si subjekt iniciues përpara Gjykatës Kushtetuese shfaqet një organ i brendshëm i Kuvendit (dhe jo vetë ky i fundit), i cili i drejtohet Gjykatës Kushtetuese me kërkesë.

Nëse Gjykata Kushtetuese e konsideron të bazuar kërkesën, atëherë ajo e shkarkon Inspektorin e Lartë të Drejtësisë, kur nga ana e tij janë kryer shkelje të rënda profesionale ose etike, të cilat sipas ligjit nr. 115/2016 "Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë", detajohen në a) neglizhencë të rëndë në ushtrimin e detyrave; b) mosrespektim haptazi të ligjit dhe të fakteve në ushtrimin e detyrave, si pasojë e neglizhencës së rëndë dhe të pajustificuar; c) neglizhencë të rëndë në drejtimin e Zyrës së Inspektorit dhe në mbikëqyrjen e veprimtarisë së inspektorëve; ç) kryerja e një veprimtarie, që konsiderohet me ligj e papajtueshme me funksionin zyrtar; d) përhapja, në kundërshtim me ligjin dhe me neglizhencë të rëndë, e informacionit konfidencial të përfutur gjatë ushtrimit të funksionit zyrtar; dh) kryerja e sjelljeve që diskreditojnë rëndë dinjitetin e institucionit, të tilla si përfitimi i padrejtë, në mënyrë të drejtpërdrejtë ose të tërthortë, i dhuratave, favoreve, premtimeve ose trajtimeve preferenciale të çdolloj, të cilat i jepen, qoftë edhe përmes veprimeve të ligjshme, për shkak të funksionit ose si rrjedhojë e ushtrimit të funksionit, shkelje të tjera të ligjit, qoftë edhe të kryera nga pakujdesia, në veçanti ato që lidhen me detyrimin për deklarimin e pasurisë dhe të konfliktit të interesave. Rast tjetër,

Ligji themelor kujdeset gjithashtu, që të përcaktojë edhe një status të veçantë për inspektorët që punojnë në këtë institucion, ku përcakton se ankimet ndaj vendimeve lidhur me masat disiplinore ndaj tyre shqyrtohen nga Gjykata Kushtetuese.³⁸⁶

Detajimi i mëtejshëm i organizimit dhe funksionimit të këtij institucioni bëhet nga ligji nr. 115/2016 *“Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”*, i ndryshuar dhe më konkretisht, Pjesa IV, titulluar *“Inspektori i Lartë i Drejtësisë”*, nenet 193 – 216. Këto dispozita përcaktojnë objektin e veprimtarisë së Inspektorit të Lartë të Drejtësisë, i cili është organi shtetëror përgjegjës për verifikimin e ankesave, hetimin e shkeljeve disiplinore dhe fillimin e procedurave për masat disiplinore ndaj gjyqtarëve dhe prokurorëve të të gjitha niveleve, përfshirë edhe figurat më të larta, si anëtarët e Këshillit të Lartë Gjyqësor, Këshillit të Lartë të Prokurorisë dhe vetë Prokurorin e Përgjithshëm.³⁸⁷ Po në këtë dispozitë përmenden mënyrat se si mund të vihet në lëvizje Inspektori: me ankesë të çdokujt, të Ministrit të Drejtësisë, Prokurorit të Përgjithshëm, anëtarëve të KLGJ-së apo KLP-së, si dhe me iniciativë vetjake kur ekzistojnë të dhëna publike ose rezultate inspektimesh institucionale.³⁸⁸

Një nga kolonat e funksionimit të Inspektorit të Lartë është pavarësia e tij, ku ndalohet çdolloj ndërhyrje, e drejtpërdrejtë apo e tërthortë, në punën e tij hetimore ose inspektuese.³⁸⁹ Kjo pavarësi, si koncept themelor i reformës, shoqërohet nga një rregullim i kujdesshëm i mënyrës së financimit të këtij institucioni. ILD ka një buxhet të veçantë dhe të pavarur nga buxhetet e institucioneve të tjera të drejtësisë dhe është i autorizuar të mbrojë vetë projektbuxhetin e tij në Kuvend.³⁹⁰

Duke detajuar më tej parashikimet kushtetuese për statusin e Inspektorit të Lartë të Drejtësisë, ky ligj parashikon se ai gëzon të njëjtin trajtim financiar, si një gjyqtar i Gjykatës së Lartë.³⁹¹

Në përmbushje të detyrave të tij, Inspektori i Lartë i Drejtësisë ka kompetenca të gjera, që përfshijnë, jo vetëm përfaqësimin institucional të këtij organi, por edhe përgatitjen e planeve vjetore të inspektimit,

për të cilën Gjykata Kushtetuese vendos shkarkimin është situata ku Inspektori i Lartë i Drejtësisë është dënuar me vendim gjyqësor të formës së prerë për kryerjen e një krimi.

Gjykata Kushtetuese mund ta pezullojë Inspektorin e Lartë të Drejtësisë nga detyra kur a) ndaj tij caktohet masa e sigurimit personal “arrest në burg” ose “arrest në shtëpi” për kryerjen e një veprë penale; b) ai merr cilësinë e të pandehurit për një krim të rëndë të kryer me dashje; c) fillon procedimi disiplinor, sipas ligjit.

386. Kushtetuta, neni 147/d, pika 6.

387. Ligji nr. 115/2016, neni 194, pika 1.

388. Ligji nr. 115/2016, neni 194, pikat 2 dhe 3.

389. Ligji nr. 115/2016, neni 196.

390. Ligji nr. 115/2016, neni 197.

391. Ligji nr. 115/2016, neni 198.

lëshimin e udhëzimeve administrative, përgatitjen e raporteve vjetore për Kuvendin, dhe miratimin e projektvendimeve të inspektorëve. Kjo kompetencë është e rregulluar në mënyrë që të sigurojë efektivitet dhe përgjegjësi brenda institucionit të vet, përfshirë edhe mundësinë për delegim kompetencash me shkrim.³⁹²

Njëjtë si për Inspektorin e Lartë, ligji trajton gjerësisht statusin dhe funksionet e inspektorëve të Zyrës së Inspektorit të Lartë të Drejtësisë. Gjysma e tyre duhet të jenë magistratë, të komanduar nga KLGJ ose KLP, ndërsa pjesa tjetër për zgjidhet nga ILD përmes një procedure të hapur e konkurruese. Për secilën kategori vendosen kritere të veçanta për përvojën, integritetin dhe papajtueshmërinë.³⁹³ Magistratët përfitojnë të njëjtin trajtim, si gjyqtarët e Gjykatës së Apelit, ndërsa inspektorët jo magistratë gëzojnë statusin e nëpunësve civilë të kategorisë së lartë.³⁹⁴

Vlerësimi profesional dhe etik i inspektorëve realizohet nga një Komision i veçantë brenda Zyrës, i emërtuar Komisioni i Emërimit dhe Vlerësimit (KEV), i përbërë nga inspektorë që plotësojnë kritere të rrepta për integritet dhe performancë,³⁹⁵ ndërsa masa disiplinore ndaj tyre shqiptohet nga një Komision Disiplinor, gjithashtu i përbërë nga inspektorë të vlerësuar pozitivisht.³⁹⁶ Në ushtrimin e detyrës së tyre, inspektorët gëzojnë akses të plotë në ambientet dhe dokumentacionin e gjykatave dhe prokurorive, si dhe të drejtën për të marrë çdo informacion të nevojshëm për verifikimet apo inspektimet në zhvillim.³⁹⁷

Ligji gjithashtu parashikon funksionimin e administratës së Zyrës së Inspektorit të Lartë, të përbërë nga personel civil nën drejtimin e një Sekretari të Përgjithshëm,³⁹⁸ si dhe përcakton përgjegjësitë për mirëmbajtjen dhe përdorimin e sistemit të teknologjisë së informacionit dhe të dhënave, me qëllim sigurimin e një menaxhimi efikas dhe transparent të çështjeve.³⁹⁹

Nga sa u paraqit më sipër, rezulton se ky ligj vendos një sistem të ri, të detajuar dhe të strukturuar të kontrollit dhe përgjegjësisë brenda sistemit të drejtësisë në Shqipëri. Inspektori i Lartë i Drejtësisë dhe inspektorët e tij përbëjnë një strukturë thelbësore për ndërtimin e një sistemi të besueshëm, të paanshëm dhe të qëndrueshëm gjyqësor dhe prokurorial. Ajo që veçohet në këtë ligj është ndërthurja e pavarësisë me kontrollin efektiv, profesionalizmi me përgjegjësinë, si dhe transparenca

392. Ligji nr. 115/2016, neni 204.

393. Ligji nr. 115/2016, neni 209.

394. Ligji nr. 115/2016, neni 210.

395. Ligji nr. 115/2016, neni 212.

396. Ligji nr. 115/2016, neni 213.

397. Ligji nr. 115/2016, neni 214.

398. Ligji nr. 115/2016, neni 215.

399. Ligji nr. 115/2016, neni 216.

me mekanizmat institucionale të filtrimit dhe ndëshkimit të shkeljeve etike dhe ligjore.

2 Përgjegjësia disiplinore e anëtarëve të Këshillit të Lartë Gjyqësor, të Këshillit të Lartë të Prokurorisë dhe të Prokurorit të Përgjithshëm

Me qëllim rritjen e efektivitetit të reformës në drejtësi, garantimi i integritetit, profesionalizmit dhe përgjegjshmërisë së anëtarëve të institucioneve të qeverisjes së sistemit të drejtësisë është bërë një prej shtyllave themelore të kësaj nisme. Kjo ka kërkuar rregullime të reja kushtetuese dhe ligjore, të cilat jo vetëm ndryshojnë institucionet e drejtësisë, por edhe vendos një sistem përgjegjësie disiplinore ndaj funksionarëve të lartë të drejtësisë, duke përfshirë anëtarët e Këshillit të Lartë Gjyqësor dhe të Këshillit të Lartë të Prokurorisë, si dhe Prokurorin e Përgjithshëm.

Kushtetuta e Shqipërisë, si akti themelor i rendit juridik, për herë të parë në mënyrë të qartë ka përcaktuar dispozita kushtetuese, që rregullojnë përgjegjësinë disiplinore të anëtarëve të këtyre këshillave, si dhe të Prokurorit të Përgjithshëm. Neni 147/c i Kushtetutës, ligji themelor parashikon se anëtari i Këshillit të Lartë Gjyqësor mban përgjegjësi disiplinore dhe se shkarkimi i tij mund të vendoset, vetëm nga Gjykata Kushtetuese, në rast se ai ka kryer shkelje të rënda profesionale ose etike, ose është dënuar me vendim gjyqësor të formës së prerë për kryerjen e një krimi. Po ashtu, masa e pezullimit nga detyra parashikohet si një masë paraprake mbrojtëse në rastet e vendosjes së masës së sigurimit personal “arrest në burg” ose “arrest në shtëpi”, të fitimit të cilësisë së të pandehurit për krime të rënda me dashje, apo kur ka filluar procedimi disiplinor.⁴⁰⁰

Një dispozitë identike gjendet në nenin 149/c të Kushtetutës për Prokurorin e Përgjithshëm dhe për anëtarët e Këshillit të Lartë të Prokurorisë, duke reflektuar të njëjtën logjikë rregulluese për llogaridhënien institucionale dhe individuale. Ky njehsim i parashikimeve kushtetuese tregon për një përpjekje për të ngritur një standard të përbashkët llogaridhënieje për të gjithë ata që ushtrojnë pushtet institucional brenda sistemit të drejtësisë.

Zbatimi i këtij kuadri kushtetues është konkretizuar edhe në nivel ligjor, që pasqyron procedurën disiplinore ndaj anëtarëve të KLGJ-së dhe KLP-së. Legjislacioni parashikon se hetimi i shkeljeve disiplinore të anëtarëve të Këshillit të Lartë Gjyqësor kryhet nga Inspektori i Lartë i

400. Kushtetuta, neni 147/c.

Drejtësisë (ILD), në përputhje me rregullimet ligjore.⁴⁰¹ Në këtë mënyrë, kompetenca hetimore e ILD-së shtrihet edhe ndaj trupës drejtuese të sistemit gjyqësor, duke e vendosur këtë institucion, si një mekanizëm të centralizuar dhe të paanshëm për inicimin dhe zhvillimin e procedurave disiplinore në sistemin e drejtësisë.

Në jurisprudencën e KPA-së është konsideruar përcaktues, fakti që procedimi disiplinor ndaj anëtarëve të KLGJ-së mund të nisë vetëm nga ILD dhe nuk mundet KPA apo ndonjë institucion tjetër të marrë masa kundrejt tyre.⁴⁰²

Pas përfundimit të hetimit, vendimarrja përfundimtare i takon Gjykatës Kushtetuese, e cila zhvillon vetë procedurën disiplinore dhe vendos mbi pezullimin apo shkarkimin e anëtarit në fjalë.⁴⁰³ E njëjta procedurë është e vlefshme, edhe për anëtarët e Këshillit të Lartë të Prokurorisë, sipas nenit 104 të këtij ligji.⁴⁰⁴

Përsa i përket Prokurorit të Përgjithshëm, procedura që ndiqet është e njëjtë, si për prokurorët e tjerë, me ndryshimin e vetëm, që kërkesa paraqitet më pas në Gjykatën Kushtetuese dhe jo pranë Këshillit të Lartë të Prokurorisë.

Një tjetër risi e kësaj reforme është rregullimi i së drejtës së ankimit ndaj vendimeve të ILD-së për arkivimin e ankesës ose mbylljen e hetimit. Kjo kompetencë i është dhënë Gjykatës Kushtetuese, duke e pozicionuar këtë gjykatë, si një garant institucional jo vetëm për ligjshmërinë e ndëshkimit disiplinor, por edhe për ligjshmërinë e mosndëshkimit, për të shmangur çdo devijim nga parimet e objektivitetit dhe transparencës në vendimarrje.⁴⁰⁵

Megjithatë, KPA, që ushtron aktualisht kompetencat e Gjykatës Kushtetuese, në bazë të dispozitave tranzitore kushtetuese, në kundërshtimin e një vendimi arkivimi për një nga anëtarët e KLGJ-së, ka mbajtur qëndrimin, se *“Kolegji për Shqyrtimin Paraprak ka konstatuar se në faqen zyrtare të Këshillit të Lartë Gjyqësor, me vendimin nr. {***}, datë 13.12.2021, të KLGJ-së, është deklaruar mbarimi i mandatit të anëtarit të Këshillit të Lartë Gjyqësor, z. I. T. Ky vendim ka hyrë në fuqi menjëherë, dhe z. I. T., nuk e ushtron më funksionin e tij si anëtar i KLGJ-së, prej datës 13.12.2021.*

Për sa më sipër, Kolegji për Shqyrtimin Paraprak çmon se gjatë shqyrtimit të kërkesës duhet të marrë në konsideratë këtë rrethanë të re, të konstatuar pas regjistrimit të çështjes në Kolegjin e Posaçëm të Apelit.

Kërkuesi i është drejtuar Kolegjit të Posaçëm të Apelit me kërkesën për

401. Ligji nr. 115/2016, neni 6

402. Vendimi nr. 3, datë 20.12.2021 i Kolegjit të Shqyrtimit Paraprak të Kolegjit të Posaçëm të Apelit.

403. Ligji nr. 115/2016, neni 6

404. Ligji nr. 115/2016, neni 104.

405. Ligji nr. 115/2016, nenet 6 dhe 104.

shfuqizimin e vendimit nr. {***} prot., datë 26.05.2021, të Inspektorit të Lartë të Drejtësisë. Në këtë vendim, Inspektori i Lartë i Drejtësisë ka vendosur: 1. Arkivimin pas shqyrtimit fillestar të ankesave të bashkuara të ankuesit, z. E. K., me nr. {***} prot., datë 25.01.2021 dhe nr. {***} prot., datë 12.04.2021 ndaj veprimtarisë së anëtarit të Këshillit të Lartë Gjyqësor, z. I. T.

Në përmbajtje të arsyetimit dhe të vendimmarrjes së Inspektorit të Lartë të Drejtësisë, është shqyrtimi dhe vlerësimi i ankimit të kërkuesit ndaj veprimtarisë së z. I. T., si anëtar i Këshillit të Lartë Gjyqësor.

Kolegji për Shqyrtimin Paraprak vlerëson se, pas përfundimit të mandatit të anëtarit të Këshillit të Lartë Gjyqësor, z. I. T., vendimi nr. {***} prot., datë 26.05.2021, i Inspektorit të Lartë të Drejtësisë është një akt administrativ individual, që i ka pushuar efektet juridike.

Legjislacioni në fuqi (ligji nr. 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe të prokurorëve në Republikën e Shqipërisë” dhe ligji nr. 115/2016 “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”) nuk parashikon shtrirjen e përgjegjësisë disiplinore të një ish-anëtarit të Këshillit të Lartë Gjyqësor, pas përfundimit të mandatit të tij. Në mungesë të një parashikimi ligjor, çdo ankim ndaj veprimtarisë së ish-anëtarit të Këshillit të Lartë Gjyqësor nuk mund të jetë objekt shqyrtimi nga organet e parashikuara në kuadër të juridiksionit disiplinor.

Për sa më sipër, në kushtet kur vendimi i Inspektorit të Lartë të Drejtësisë i ka pushuar efektet e tij, kërkesa e kërkuesit E. K., për shfuqizimin e tij ka mbetur pa objekt, dhe nuk mund të shqyrtohet nga Kolegji i Posaçëm i Apelit.⁴⁰⁶

Këto rregullime të reja institucionale dhe procedurale, pasqyrojnë një ndryshim rrënjësor në mënyrën e konceptimit të llogaridhënies në sistemin e drejtësisë. Më parë, figura të tilla si anëtarët e KLD-së (ish-Këshilli i Lartë i Drejtësisë), por edhe vetë Prokurori i Përgjithshëm ishin subjekt i një përgjegjësie të kufizuar, më procedura shpesh të paqarta. Më rregullimet e reja, duke pasur një ndarje të qartë mes organit hetimor (ILD), organit vendimmarrës (Gjykata Kushtetuese) dhe ligjeve që përcaktojnë standardet e sjelljes dhe të procedurës (ligji për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve) janë vendosur parashikime të reja dhe më të qarta për përgjegjësinë institucionale në sistemin e drejtësisë.

Këto rregullime sigurojnë jo vetëm mbrojtjen e pavarësisë së gjyqtarëve dhe prokurorëve nga ndërhyrjet e jashtme, por edhe vendosjen e një mekanizmi efektiv kontrolli të brendshëm, duke pranuar standardet më të larta të etikës dhe profesionalizmit. Shprehja e kësaj logjike rregulluese është më se e qartë, në detyrimin për të ndjekur procedura të standardizuara dhe në përfshirjen e instancës më të lartë kushtetuese në vendimmarrjen disiplinore, e cila forcon më tej legjitimitetin dhe objektivitetin e procesit.

Ndryshimet e kësaj reforme përbëjnë një shprehje të qartë të

406. Vendimi nr. 5, datë 27.01.2022 të Kolegjit për Shqyrtimin Paraprak të Kolegjit të Posaçëm të Apelit.

përpjekjes për të kaluar nga një model informal dhe i fragmentuar kontrolli disiplinor, drejt një modeli institucional të konsoliduar, transparent dhe të balancuar midis pavarësisë dhe llogaridhënies.

3 Inspektimi disiplinor sipas ligjit nr. 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve”

Reforma kushtetuese dhe ligjore e vitit 2016 barazoi përsëri statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve, të cilat janë me pak ndryshime, pothuaj të njëjta. Këtu përfshihet edhe përgjegjësia e tyre disiplinore. Kështu, ligji themelor i vendit ka të njëjta parashikime për përgjegjësinë disiplinore të gjyqtarëve dhe prokurorëve, duke qenë se parashikon fillimisht se këto dy subjekte mbajnë përgjegjësi disiplinore, sipas ligjit. Është Inspektori i Lartë i Drejtësisë ai që shqyrton, verifikon, heton pretendimet për shkelje disiplinore dhe nëse ka i konstaton si të tilla nga hetimi që kryen, i propozon Këshillit të Lartë Gjyqësor, nëse magjistrati subjekt hetimi është gjyqtar dhe Këshillit të Lartë të Prokurorisë, nëse magjistrati subjekt hetimi është prokuror, masa disiplinore, të cilat sipas ligjit janë gjashtë të tilla: vërejtje konfidenciale, vërejtje publike, ulje e përkohshme e pagës (deri në 40 për qind për një periudhë jo më të gjatë se një vit), ulje në detyrë nga një pozicion më i lartë në një më të ulët, pezullim nga detyra për një periudhë nga tre muaj deri në dy vjet, shkarkim nga detyra.⁴⁰⁷

Këshillat vendosin mbi masën e propozuar nga ILD, duke e pranuar, ndryshuar, ose rrëzuar atë. Magjistratët shkarkohen sipas rastit, nga Këshilli i Lartë Gjyqësor ose i Prokurorisë, kur kryejnë shkelje të rënda profesionale ose etike, që diskreditojnë pozitën dhe figurën e gjyqtarit/prokurorit gjatë ushtrimit të detyrës, ose kur janë dënuar me vendim të formës së prerë për kryerjen e një krimi. Gjyqtari ose prokurori mund të pezullohet nga këshilli respektiv, nëse ndaj tyre caktohet masa e sigurimit personal “arrest në burg” ose “arrest në shtëpi” për kryerjen e një veprë penale, kur marrin cilësinë e të pandehurit për një krim të rëndë të kryer me dashje, si edhe kur fillon procedimi disiplinor, sipas ligjit.⁴⁰⁸

Bazuar në këtë qëllim të ligjvënësit kushtetues, edhe ligjvënësi i zakonshëm, në hartimin e ligjit nr. 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve”, i ndryshuar, vendosi, që edhe procedimi dhe përgjegjësia disiplinore e gjyqtarëve dhe prokurorëve do të jetë e njëjtë.

Përsa i përket procedimit disiplinor, ky ligj që në fillim parashikon disa parime të rëndësishme, që duhet të kihen parasysh nga ILD dhe

407. Ligji nr. 96/2016, neni 105.

408. Kushtetuta, nenet 140 dhe 148/d.

Këshillat⁴⁰⁹ dhe më konkretisht:

a) e drejta për një proces të rregullt, duke përfshirë dhe marrjen e një vendimi brenda një afati të arsyeshëm;

Ky parim është baza e çdo procesi disiplinor. Ai kërkon që çdo magjistrat të ketë të drejtën e informimit për akuzat ndaj tij, të ketë të drejtën e mbrojtjes efektive dhe që çështja të zgjidhet brenda një afati të arsyeshëm. Ky parim është i lidhur ngushtë me të drejtën për gjykim të drejtë dhe të paanshëm, dhe synon të mbrojë magjistratin nga abuzimi me autoritetin publik, por edhe të sigurojë që hetimi disiplinor të mos përdoret si mjet presioni apo ndëshkimi arbitrar.

Në zbatim të këtij parashikimi ka qenë edhe qëndrimi i KLGJ-së, për t'i dhënë kopje të dosjes së procedimit disiplinor një prej subjekteve që po procedohej, i cili për shkak se pretendonte se kishte dhënë dorëheqjen (që ishte miratuar në heshtje sipas tij),⁴¹⁰ si edhe ndodhej në gjendje "arresti me burg", nuk kishte pranuar të njihej me aktet e procedimit. Sipas KLGJ-së në këtë rast "14. Në seancën dëgjimore të datës 20.10.2020, në përmbushje të zbatimit të përshtatshëm dhe të balancuar të parimeve të procedimit disiplinor, të parashikuar në nenin 100, pika 1 të ligjit "Për Statusin", si dhe të garantimit të së drejtës së një procesi të rregullt ligjor, nga ana e Këshillit u procedua me vendosjen në dispozicion të përfaqësuesit të magjistratit Sh. M., të një kopje të të gjitha akteve të depozituar në Këshill, nga ana e Inspektorit. Ky veprim procedural u çmua i domosdoshëm, në kushtet kur magjistrati, gjatë fazës së hetimit, nuk rezultoi të ishte i njohur me raportin e hetimit si dhe me dosjen hetimore, të cilat, për nga ana formale, kanë shënuar dhe fillimin e procedimit disiplinor në ngarkim të tij".⁴¹¹

Ky qëndrim u mbajt edhe në rastin kur vetë magjistrati pretendoi, se nuk ishte njohur me aktet e procedimit disiplinor, gjatë kohës së hetimit administrativ të realizuar nga ILD.⁴¹²

b) parimin e ligjshmërisë, në kuptimin që organi kompetent ka detyrimin të hetojë nëse ka shkaqe të mjaftueshme për të besuar se ka ndodhur një shkelje disiplinore, si dhe parimin e "mos dënimit pa ligj";

Zbatimi i këtij parimi kërkon, që asnjë magjistrat të mos jetë subjekt i procedurave disiplinore, në mungesë të një baze ligjore të qartë dhe të parashikueshme. Ai e ngarkon organin hetimor me detyrimin për të ndërmarrë hetime kur ka indicie të mjaftueshme për një shkelje, duke shmangur kështu veprimet e pabazuara ose të motivuara politikisht apo subjektivisht. ILD e ka specifikuar zbatimin e këtij parimi edhe publikisht. "ILD vlerëson paraprakisht se faktet (veprimet apo mosveprimet e magjistratit), të cilat mund të përbëjnë shkelje disiplinore, sipas kërkesave të ligjit nr. 96/2016

409. Ligji nr. 96/2016, neni 100.

410. Raporti hetimor i inspektorit të Lartë të Drejtësisë, fq. 6.

411. Vendimi nr. 529, datë 27.10.2020 i Këshillit të Lartë Gjyqësor.

412. Vendimi nr. 633, datë 10.12.2020 i Këshillit të Lartë Gjyqësor.

“Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë” të ndryshuar, nuk janë vetëm ato që parashtrohen në bazë të një informacioni publik, por janë ato që analizohen nga Inspektori i Lartë i Drejtësisë, apo vlerësohen në bazë të një procesi verifikimi apo hetimit disiplinor. Në bazë të një informacioni publik mund të paraqiten një tërësi faktesh, të cilat pretendohet se kanë ndodhur dhe që përbëjnë shkelje disiplinore, por Inspektori i Lartë i Drejtësisë, mund të bëjë një cilësim të saktë apo të ndryshëm të fakteve dhe veprimeve, që lidhen me shkeljen disiplinore, pa u lidhur me përcaktimin, që mund të pretendohet në këtë informacion publik” dhe në një rast konkret, me verifikimin e nisur kryesisht, të informacionit të bërë publik në media, lidhur me një ngjarje të rëndë të ndodhur në Tiranë më 1 mars 2023, ku si pasojë e veprimeve të kryera nga një shtetas, i cili ishte liruar me kusht, dhe më pas shkaktoi tre viktima, ILD ka mbasi kreu verifikimet përkatëse, arkivoi çështjen duke arsyetuar, se “Në analizë të dokumentacionit të administruar rezultoi se në lidhje me procedurat ligjore të ndjekura gjatë hetimit, gjykimit apo fazës së ekzekutimit të çështjes penale të regjistruar në vitin 2022, në emër të shtetasit D. H., për kryerjen e veprës penale “Dhunë në familje”, të parashikuar nga neni 130/a i Kodit Penal, si dhe procedurat ligjore të ndjekura gjatë hetimit, gjykimit apo fazës së ekzekutimit të çështjeve të tjera të mundshme penale të regjistruara në emër të shtetasit D. H., nuk konstatohen veprime apo mosveprime të magistratëve, të cilat i krijojnë Inspektorit të Lartë të Drejtësisë, një dyshim të arsyeshëm, i cili justifikon fillimin e hetimit disiplinor sipas kërkesave të nenit 122, pika 1 të ligjit nr. 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar”.⁴¹³

c) parimin e akuzës, në kuptimin që çdo institucion shtetëror ose zyrtar duhet të veprojë kryesisht dhe të paraqesë një ankesë nëse ka prova të mjaftueshme për të besuar që ka ndodhur një shkelje disiplinore;

Ky parim vendos standardin që çdo institucion i ngarkuar me detyrën e kontrollit disiplinor duhet të veprojë me përgjegjësi institucionale dhe të iniciojë një procedurë vetëm kur ekzistojnë prova bindëse të një shkeljeje. Ky parim ndalon hetimet e pabazuara dhe vendos një prag të qartë për të filluar procedurën, duke ruajtur integritetin e procesit dhe duke mbrojtur magistratin nga ekspozimi publik i panevojshëm. Në një rast specifik, Inspektori i Lartë i Drejtësisë e ka arsyetuar publikisht zbatimin e këtij parimi, në përgjigje të deklaratave publike të një përfaqësuesi të pushtetit ekzekutiv, ku ka mbajtur qëndrimin se “ILD konstaton me keqardhje se mosrespektimi i pavarësisë së magistratëve në ushtrimin e detyrës së tyre, por edhe të institucioneve të pavarura të drejtësisë po kthehet në traditë, sa herë që publikisht kërkohet marrja e përgjegjësi.” ... “Zyra e Inspektorit të Lartë të Drejtësisë është e hapur për të pranuar nga çdo institucion ankesa në lidhje me sjelljen e magistratëve. Në rast të konstatimit të sjelljeve të cilat

413. Njoftim për media për arkivim çështje të nisur kryesisht. <https://ild.al/sq/2023/05/16/njoftim-per-media-3/>

*përbëjnë përgjegjësi disiplinore, Inspektori i Lartë i Drejtësisë për sa ka vepruar deri më tani, në rastet kur ka konstatuar sjellje apo akte të cilat përbëjnë shkelje disiplinore ka propozuar marrjen e masave të nevojshme disiplinore”.*⁴¹⁴

ç) parimin e barazisë para ligjit;

Ky parim afirmon se çdo magjistrat, pavarësisht pozicionit, përvojës apo funksionit që ushtron është subjekt i të njëjtave standarde ligjore dhe etike. Ky parim është thelbësor për ruajtjen e besimit të publikut në drejtësi dhe për shmangien e perceptimit të pabarazisë apo privilegjimit në trajtimin e shkeljeve.

KL Gj këtë parashikim e ka trajtuar në aspekt të parimit të barazisë së armëve, ku ka mbajtur qëndrimin, se “14.2 Nga ana tjetër, parimi i barazisë para ligjit nënkupton se çdokush që është palë në proces, duhet të ketë mundësi të barabarta që të paraqesë çështjen e tij dhe se duhet të përcaktohet një ekuilibër i drejtë mes palëve. E drejta për të marrë pjesë në gjykim nuk duhet konsideruar si një e drejtë formale, ku palëve t’u garantohet thjesht prania fizike gjatë procesit, por, përkundrazi, duhet që në radhë të parë legjislacioni procedural dhe më pas organi procedues gjatë gjykimit, t’u japin çdo mundësi të barabarta palëve për të paraqitur argumente dhe prova në mbrojtje të interesave të tyre”.

Arsyetimi i mësipërm i KL Gj-së, megjithëse kërkon të zbatojë parimin e barazisë, duket se nuk ka vend në këtë rast, pasi KL Gj po i referohet parimit të barazisë së armëve, i cili është një nga elementët e së drejtës për një proces të rregullt ligjor. Parimi i barazisë në procedimet disiplinore duhet kuptuar si zgjidhje e njëjtë, për raste të njëjta ose të ngjashme.

d) prezumimin e pafajësisë;

Zbatimi i këtij parimi e vendos barrën e provës mbi autoritetet hetimore dhe kërkon që magjistrati të konsiderohet i pafajshëm, deri në momentin që është provuar faji i tij, me prova të pakundërshtueshme. Ky është një parim universal i së drejtës penale i vendosur nga ligjvënësi, edhe në këtë lloj procedure disiplinore për të garantuar mbrojtjen e individit nga vendimmarrje të nxituara ose të njëanshme.

dh) parimin e dyshimit në favor të magjistratit, subjekt i procedimit disiplinor;

Ky parim është një vijim logjik i parimit të prezumimit të pafajësisë dhe parashikon, që nëse pas përfundimit të hetimeve, mbetet dyshim i arsyeshëm lidhur me fajësinë e magjistratit, ky dyshim duhet të interpretohet në favor të tij. Kjo është një garanci shtesë që ndihmon në ruajtjen e profesionalizmit të hetimit dhe në shmangien e ndëshkimeve të padrejta.

Për ta ilustruar, le të shohim rastin kur ILD e ka zbatuar këtë parim

414. Njoftim për shtyp pas deklaratës së ministrit të brendshëm <https://ild.al/sq/2021/06/28/njoftim-per-shtyp/>

415. Vendimi nr. 529, datë 27.10.2020 i Këshillit të Lartë Gjyqësor.

në procedimin ndaj magistrates E. K., “Nga ana tjetër, nisur nga fakti se pas publikimit në media të videove të publikuara, rrjeti social “TikTok” me llogarinë “...” ku ato janë publikuar është mbyllur, se vetë magistratja subjekt hetimi disiplinor mohoi të jetë ajo autori i publikimit të tyre, aludimi prej saj se këto video mund të jenë ngarkuar nga fëmijët e magistrates ... dhe faktit se këto video janë publikuar në ditë të ndryshme 14, 17 dhe 20 maj, faktit se llogaria e mundshme e hapur nga fëmijët, është mbyllur prej saj, përtej faktit se i bëjnë të pabesueshme deklaratimet e saj, gjithsesi në zbatim të parimit se çdo dyshim shkon në favor të magistratit, vlerësohet se mbetet e paprovuar shkelja e atribuar fillimisht magistrates në vendimin e hetimit disiplinor, e parashikuar në shkronjën “k”, të pikës 9, të Kodit të Etikës Gjyqësor, ajo e përdorimit me vetëpërmbytje të medias dhe rrjeteve sociale”.⁴¹⁶

e) parimin e proporcionalitetit;

Ky parim përcakton se masa disiplinore që mund të merret duhet të jetë e përshtatur me rëndësinë dhe rrethanat e shkeljes. Ai kërkon një balancim të drejtë ndërmjet interesit të sistemit të drejtësisë për të ruajtur etikën dhe nevojës për të mos dëmtuar padrejtësisht karrierën apo dinjitetin e magistratit. Zbatimi i këtij parimi përjashton ndëshkimet, që janë disproporcionale në raport me shkeljen.

ë) parimin e pavarësisë dhe paanësisë së institucioneve disiplinore dhe respektimi për pavarësinë e magistratit;

Ky parim është thelbësor për të garantuar integritetin e procedurës. Ai parashikon që organet disiplinore dhe hetimore të jenë të ndara nga ndikimet e brendshme dhe të jashtme dhe të ushtrojnë funksionin e tyre në mënyrë objektive. Ky parim mbështet vetë thelbin e shtetit të së drejtës, sipas të cilit nuk mund të ketë drejtësi pa një organ që është i paanshëm.

f) parimin e drejtësisë së hapur;

Ky parim ka të bëjë me transparencën e procedurës dhe me të drejtën e publikut për t’u informuar për ecurinë dhe përfundimet e saj. Ky parim forcon besimin e qytetarëve te drejtësia dhe u kujton institucioneve detyrën e llogaridhënies. Megjithatë ai nuk është absolut dhe duhet të balancohet me parime të tjera.

g) parimin e konfidencialitetit dhe të drejtën e jetës private dhe mbrojtjen e të dhënave personale.

Ky parim vendos një kufi ndaj parimit të mëparshëm, atë transparencës, duke mbrojtur magistratin nga ekspozimi publik, për sa kohë akuzat janë të pabazuara ose nuk janë provuar. Ky parim është i lidhur me ruajtjen e dinjitetit dhe të figurës së magistratit dhe kërkon që çdo publikim ose informacion për çështjen të bëhet me kujdes dhe në përputhje me nevojën për ruajtjen e privatësisë dhe të dhënave personale.

Në balancimin ndërmjet drejtësisë së hapur dhe mbrojtjes së konfidencialitetit, parashikohet një detyrim për të marrë në konsideratë,

416. Raport hetimi disiplinor i ILD ndaj magistrates E. K., (2021), fq.13.

si ruajtjen e figurës së magjistratit nga akuzat e pabaza,⁴¹⁷ ashtu edhe rëndësinë e informimit të publikut për rastet e provuara të shkeljes së ligjit, në funksion të forcimit të llogaridhënies dhe besimit në drejtësi.⁴¹⁸ Ky balancim është delikat dhe kërkon nga ILD dhe Këshillat një ndjeshmëri institucionale të lartë ndaj dinamikave të opinionit publik dhe të mbrojtjes së të drejtave individuale. ILD e ka zbatuar në mënyrë të rregullt këtë parim, në praktikën e vet, në të gjitha në komunikimet që ky institucion mban me subjekte të tjera, kur i kërkohet informacion nga media, qytetarë apo institucione. Për ilustrim, një rast konkret “Nga të dhënat e kërkuara për magjistratin..., me detyrë gjyqtar në Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm ..., ju vëmë në dijeni se Inspektori i Lartë i Drejtësisë përgjatë zhvillimit të procedurave administrative i kushton një rëndësi të veçantë të drejtës së informimit të publikut në funksion të administrimit të drejtësisë sipas kërkesave të ligjit nr. 119/2014 “Për të drejtën e informimit” të ndryshuar, por në të njëjtën kohë duhet të garantojë edhe mbrojtjen e integritetit dhe figurën e subjekteve të procedurës administrative, mbrojtjes së interesave ligjore të personave të tretë, si dhe duhet të kujdeset që në kuadër të administrimit të të dhënave apo dokumenteve të mos cenojë funksionimin në vazhdim dhe qëllimin e veprimtarisë së tij, sipas kërkesave të ligjit nr. 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar”.⁴¹⁹

Megjithatë nuk është konsideruar shkelje e këtij parimi, publikimi i informacionit nga organi që kishte kërkuar pranë ILD-së fillimin e hetimit disiplinor, siç rezulton nga arsyetimi vijues se “12.4 Në lidhje me pretendimin e ankueses se Prokurori i Përgjithshëm ka cenuar një nga parimet themelore të procesit disiplinor të garantuar nga neni 100/1, pika “g” i ligjit nr. 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar dhe konkretisht parimin e konfidencialitetit, të së drejtës për jetë private dhe mbrojtjen e të dhënave personale, nëpërmjet publikimit në datën 21.05.2021, në faqen zyrtare në internet të Prokurorisë së Përgjithshme, të njoftimit në lidhje me kërkesën drejtuar Inspektorit të Lartë të Drejtësisë për nisjen e procedurës së inspektimit ndaj saj, për hetimin e shkeljeve individuale të kryera në ushtrimin e detyrës, pasi ishin konstatuar veprime të cilat mund të përbënin zvarritje të rëndë të veprimtarisë procedurale, si dhe shkelje të dispozitave urdhëruese të Kodit të Procedurës Penale, Kolegji vlerëson se një pretendim i tillë nuk cenon bazueshmërinë faktike dhe ligjore të vendimit të Këshillit të Lartë të Prokurorisë objekt ankimi dhe, si rrjedhojë, konsiderohet pa relevancë për vendimmarrjen e Kolegjit”.⁴²⁰

417. Ligji nr. 96/2016, neni 100, pika 2, germa “a”.

418. Ligji nr. 96/2016, neni 100, pika 2, germa “b”.

419. Fragment nga përgjigje dhënë Komisionerit për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale.

420. Vendimi nr. 2 (JD), datë 24.10.2023 i Kolegjit të Posaçëm të Apelit.

Ligji nr. 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve”, i ndryshuar, kujdeset që në nenin 101 të tij të parashikojë shkeljet disiplinore, duke vendosur standardet kryesore për të identifikuar sjelljet, që mund të konsiderohen shkelje disiplinore, si dhe ofron një sërë kriteresh për të vlerësuar peshën dhe karakterin e kësaj përgjegjësie.⁴²¹

Në thelb neni përcakton se një magjistrat mund të përgjigjet disiplinarisht, si për veprime të qëllimshme, ashtu edhe për ato të kryera nga pakujdesia, për sa kohë ato përbëjnë mospërmbyshje të detyrimeve profesionale ose etike. Kjo përfshin jo vetëm sjelljet gjatë ushtrimit të funksionit, por edhe ato jashtë tij, për aq kohë sa ato diskreditojnë figurën e magjistratit ose dëmtojnë besimin e publikut në institucionet e drejtësisë. Dispozita shkon më tej dhe e sanksionon qartë, edhe mos respektimin e fakteve dhe të ligjit gjatë ushtrimit të funksionit si shkelje disiplinore, veçanërisht kur kjo ndodh me dashje ose për shkak të pakujdesisë së rëndë, si dhe në rastet kur magjistrati demonstroi paaftësi të dukshme profesionale.

Kjo dispozitë është projektuar jo vetëm për të ndëshkuar devijimet konkrete, por edhe për të ruajtur integritetin dhe pavarësinë e sistemit të drejtësisë në tërësi. Ajo pasqyron bindjen institucionale, se çdo sjellje që lëkund besimin publik në drejtësinë e pavarur, meriton të shqyrtohet në një këndvështrim disiplinor, duke krijuar një lidhje të drejtpërdrejtë midis etikës individuale të magjistratit dhe besueshmërisë institucionale.

Megjithatë jurisprudenca nuk e ka konsideruar si diskriminim, mos mbajtjen e regjistratit të komunikimeve të brendshme, mbi qarkullimin e shkresave/akteve/materialeve hetimore mes drejtuesit dhe prokurorëve të çështjeve, e ndodhur kjo edhe për arsye të mungesë së personelit dhe transferimit të drejtuesit për një kohë të caktuar.⁴²²

Për të shmangur një qasje mekanike dhe të barabartë ndaj të gjitha llojeve të shkeljeve, ligji në vijim të nenit përcakton edhe një sërë kriteresh,

421. Ligji nr. 96/2016, neni 101: 1. Magjistrati kryen shkelje disiplinore, me dashje ose për shkak të pakujdesisë, kur: a) kryen veprime ose mosveprime, të cilat përbëjnë mospërmbyshje të detyrës, sjellje joprofesionale ose joetike gjatë ushtrimit të funksionit ose jashtë tij, të cilat diskreditojnë pozitën dhe figurën e magjistratit, ose dëmtojnë besimin e publikut në sistemin gjyqësor ose të prokurorisë; b) gjatë ushtrimit të funksionit nuk i referohet ligjit ose fakteve, me dashje ose për shkak të pakujdesisë së rëndë, ose kur ka paaftësi të dukshme profesionale. 2. Kur përcaktohet nëse veprimi, mosveprimi apo sjellja e magjistratit konsiderohet shkelje disiplinore, ose është e lidhur vetëm me veprimtarinë profesionale, merret parasysh: a) shkalla e pakujdesisë; b) shpeshhtësia e kryerjes së veprimit ose mosveprimit apo sjelljes; c) përvoja dhe pozicioni i magjistratit në sistem; ç) dëmtimi, mundësia e shkaktimit të dëmtimit ose shkalla e pasojave që kanë ardhur ose mund të vijnë nga veprimi apo mosveprimi; si dhe d) çdo situatë që është jashtë kontrollit të magjistratit dhe që mund të lidhet me mosfunksionimin e sistemit gjyqësor ose të prokurorisë.

422. Vendimi nr. 31, datë 24.02.2022 i Këshillit të Lartë të Prokurorisë.

që duhet të merren parasysh gjatë procesit të vlerësimit disiplinor. Këto kritere përfshijnë shkallën e pakujdesisë, shpeshhtësinë e sjelljes, përvojën dhe pozitën e magjistratit. Në këtë rast të fundit është konsideruar përvoja e pakët e një magjistrati, si justifikim për vonesën e tij në dorëzimin e akteve në gjykatë, edhe deri në 12 ditë, mbas përfundimit të afateve të paraburgimit.⁴²³

Kriteret e tjera që duhet të merren në konsideratë kanë të bëjnë me dëmin e shkaktuar ose që mund të shkaktohet nga sjellja e magjistratit, si dhe çdo faktor jashtë kontrollit të tij, që mund të ketë ndikuar në veprimin apo mosveprimin.

Respektimi i këtyre kriterëve, e vendos procedurën disiplinore brenda një kuadri të arsyeshëm proporcionaliteti dhe racionaliteti, duke mundësuar që masat të jenë të përshtatura sipas rastit konkret.

Në mënyrë të veçantë, përfshirja e situatave jashtë kontrollit të magjistratit, si faktor zbutës përbën një element progresiv në këtë rregullim, duke e lidhur përgjegjësinë personale me kushtet strukturore të funksionimit të sistemit gjyqësor apo të prokurorisë. Kjo pasqyron një kuptim më të gjerë dhe më të drejtë të kontekstit institucional, duke shmangur fajësimin e padrejtë në situata sistematike. Në lidhje me këtë element të fundit, jurisprudenca ka përcaktuar si rrethana të tilla, ngarkesën shumë e lartë të çështjeve, efektet e pandemisë COVID-19, si edhe efektet e procesit të rivlerësimit kalimtar.⁴²⁴

Në tërësi, neni 101 nuk shërben vetëm si mjet ndëshkues, por si një instrument për të ruajtur dhe forcuar standardet profesionale dhe etike të magjistraturës. Ai balancohet mes rigorozitetit dhe ndjeshmërisë ndaj realiteteve të sistemit, dhe ka një funksion të dyfishtë: parandalues përmes edukimit institucional mbi sjelljen e duhur, dhe korrigjues/ndëshkues përmes mekanizmave të përgjegjësisë. Në çdo raport hetimi të ILD-së, specifikohet qëllimi i masës disiplinore, me arsyetimin vijues se *“Qëllimi thelbësor i masës disiplinore është mbrojtja e interesit publik nëpërmjet deklarimit të përgjegjësisë disiplinore të magjistratit për shkak të shkeljes disiplinore që ai ka kryer dhe marrja e masave aktive për edukimin e magjistratit, nëse një gjë e tillë është e mundur. Në të njëjtën kohë masa disiplinore që caktohet ndaj magjistratit përmbush edhe dy qëllime parandaluese: (i) parandalimin e posaçëm, në kuptimin që magjistrati në të ardhmen të mos kryejë më shkelje disiplinore; dhe (ii) parandalimin e përgjithshëm, në kuptimin që magjistratët e tjerë kuptojnë që një sjellje e papërshtatshme nuk duhet kryer, pasi është e ndëshkueshme me masë disiplinore.”*

Përsa i përket shkeljeve disiplinore që lidhen me ushtrimin e funksionit, ligji nr. 96/2016 *“Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve”*, i ndryshuar, kujdeset që në nenin 102 të japë një listë sa më shteruese

423. Vendimi nr. 31, datë 24.02.2022 i Këshillit të Lartë të Prokurorisë.

424. Vendimi nr. 15, datë 30.01.2025 i Këshillit të Lartë të Prokurorisë.

të këtyre situatave që mund të shfaqen.⁴²⁵ Ky nen synon të përkufizojë

425 Ligji nr. 96/2016, neni 102: 1. Shkelje disiplinore gjatë ushtrimit të funksionit janë, në veçanti, por pa u kufizuar në to, veprimet, mosveprimet ose sjelljet e magjistratit, si më poshtë: a) mosparaqitja e kërkesës për heqje dorë nga procedimi ose gjykimi i çështjes, kur kjo është e detyrueshme, sipas ligjit, nëse magjistrati ka dijeni ose duhet të kishte dijeni të rrethanave të tilla; b) paraqitja e kërkesës për heqje dorë nga procedimi ose gjykimi i çështjes, nëse ky veprim: i) nuk bazohet në shkaqe të parashikuara në ligj; ii) bëhet me qëllim që të krijohen përfitime të padrejta për palët dhe të tretët ose synon shmangien e detyrimit ligjor për shqyrtimin e çështjes apo të krijojë mundësinë që çështja të shqyrtohet nga një magjistrat tjetër; iii) nuk kryhet menjëherë pasi merr dijeni për shkakun; c) ndërhyrja ose ndikimi i padrejtë në ushtrimin e funksionit të një magjistrati tjetër; ç) mospërmblidhja e pajustifikuar ose e përsëritur e funksioneve gjatë gjykimit ose hetimit; d) vonesa të përsëritura ose që sjellin pasoja të rënda apo zvarritje të pajustifikuara të veprimeve dhe/ose akteve procedurale; dh) veprimi, mosveprimi ose sjellja e magjistratit, që sjell përfitime të padrejta ose dëme për palët në një proces gjyqësor ose procedurë hetimore, në kundërshtim me ligjin; e) angazhimi i personave të jashtëm në kryerjen e detyrave që me ligj i takojnë magjistratit ose delegimi i detyrave apo veprimtarive që lidhen me ushtrimin e funksionit të magjistratit; ë) vonesa e përsëritur dhe e pajustifikuar për fillimin e seancës gjyqësore ose zvarritje e hetimeve; f) mungesa e pajustifikuar në detyrë, sipas parashikimeve të këtij ligji, për më shumë se 3 ditë pune në vit; g) shkelja e rëndë ose e përsëritur e dispozitave ligjore dhe nënligjore që rregullojnë organizimin dhe funksionimin e gjykatave ose prokurorisë; gj) moszbatimi pa shkaqe të justifikuara i vendimeve të dhëna nga Këshilli ose refuzimi i zbatimit të masës disiplinore të dhënë ndaj magjistratit; h) mospërmblidhja pa shkaqe të pajustifikuara e detyrimit për të marrë pjesë në programet e trajnimit vazhdues, sipas kushteve dhe kritereve të përcaktuara me ligj; i) mosnjoftimi nga magjistrati i kryetarit dhe Këshillit, si dhe autoriteteve kompetente, sipas ligjit, për ndërhyrjet ose format e tjera të ndikimit nga magjistratët e tjerë, avokatët, funksionarët politikë, funksionarët publikë ose subjektet e tjera; j) shkelja e rregullave të konfidencialitetit dhe të mospërhapjes së informacionit, të parashikuara në legjislacionin në fuqi, për të cilat merr dijeni për shkak të funksionit të magjistratit ose që rezultojnë nga hetimi ose gjykimi, në proces ose i përfunduar; k) pengimi i Këshillit, Inspektorit të Lartë të Drejtësisë apo çdo organi tjetër publik në kryerjen e funksioneve të tij, sipas ligjit; l) mospërmblidhja nga ana e kryetarit e detyrimeve të përcaktuara në ligj, në veçanti detyrat e lidhura me sistemin e menaxhimit të çështjeve; ll) bërja publike e mendimeve që janë dhënë nga vetë magjistrati ose magjistratët e tjerë gjatë procesit që nuk kanë marrë ende formën e një akti të disponueshëm për publikun; m) bërja e deklaratave publike në media për çështjet, me përjashtim të komunikimeve për shtyp të magjistratit brenda kufijve të detyrës së tij; n) mosnjoftimi i Këshillit për ekzistencën e shkaqeve të mbarimit të mandatit; nj) mosnjoftimi i Inspektorit të Lartë të Drejtësisë, nga ana e kryetarit, lidhur me fakte në dijeni të tyre, që mund të përbëjnë shkelje disiplinore të magjistratit; o) mosnjoftimi i Këshillit, nga ana e kryetarit, lidhur me ekzistencën e dyshimit të arsyeshëm, të rasteve të papajtueshmërisë, kufizimeve të funksionit, dhe për çështje, për të cilat ligji parashikon mbarimin e mandatit të magjistratit; p) shkelja e rregullave të papajtueshmërisë ose të parandalimit të konfliktit të interesit, sipas parashikimeve të legjislacionit në fuqi. 2. Sipas parashikimeve të shkronjës "b", të pikës 1, të nenit 101, të këtij ligji, shkeljet disiplinore gjatë ushtrimit të funksionit si magjistrat janë, në veçanti, por pa u kufizuar në to, veprimet, mosveprimet ose sjellja e magjistratit, si më poshtë: a) mosrespektimi i rëndë ose i përsëritur i legjislacionit procedural dhe material ose zbatimi i gabuar i legjislacionit procedural dhe material, kur konstatohet nga një gjykatë më e lartë; b) parashtrimi i shtrembëruar i fakteve dhe

me sjelljet, veprimet apo mosveprimet që bien në kundërshtim me standardet profesionale dhe etike të kërkuara në sistemin e drejtësisë, duke përfunduar përgjegjësinë funksionale të magistratëve.

Në thelb, dispozita ofron një katalog të zgjeruar shkeljesh, që shërbejnë si shembuj të qartë të cenimit të detyrave funksionale. Ato përfshijnë sjellje që komprometojnë paanësinë dhe integritetin e procesit, si mos kërkimi i përjashtimit kur ligji e kërkon, ndërhyrja në punën e kolegëve, vonesa të pajustificuara në procedura apo seanca gjyqësore, shkelje të konfidencialitetit dhe rregullave të solemnitetit, apo shpërdorimi i pozitës për qëllime të padrejta apo përfitim personal. Rëndësia e kësaj dispozite qëndron, jo vetëm në përcaktimin e sjelljeve devijante, por edhe në konfirmimin e rolit të magistratit, si mbajtës i një përgjegjësie publike të veçantë, ku çdo devijim i funksionit përkthehet në cenim të drejtësisë, si vlerë themelore kushtetuese.

Kështu është konsideruar përfitim i padrejtë, mënyra e përlogaritjes së kërkesës për ulje dënimi, duke përfshirë edhe periudhën e paraburgimit. Në këtë rast, u theksua se fakti që mund të kishte një praktikë të përhapur në zbatimin e normave ligjore në këtë mënyrë, nuk do të thoshte që nuk ishim përballë përgjegjësisë disiplinore të magistratëve.⁴²⁶

Dispozita nuk mjaftohet me përkufizimin e jashtëm të shkeljeve, por futet më thellë në natyrën e vendimmarrjes gjyqësore, duke përfshirë edhe aspektin përmbajtësor të akteve gjyqësore, siç është mosrespektimi i rregullave të arsyetimit, shtrembërimi i qëllimshëm i fakteve, kontradikta e hapur mes pjesës arsyetuese dhe asaj urdhëruese të vendimeve apo nxjerrja e vendimeve për motive të padrejta. Këto parashikime synojnë jo vetëm të ruajnë cilësinë tekniko-juridike të vendimeve, por edhe të garantojnë se çdo akt i magistratit reflekton drejtësi reale dhe transparente për palët dhe shoqërinë.

Si një nga shkeljet e parashikuara nga kjo dispozitë është edhe situata kur kemi mosrespektimin e rëndë ose të përsëritur të legjislacionit procedural dhe material, ose zbatimi i gabuar i legjislacionit procedural dhe material, kur konstatohet nga një gjykatë më e lartë. Jurisprudenca ka përcaktuar se në këtë rast, magistrati mban përgjegjësi disiplinore për mënyrën e interpretimit dhe të zbatimit të ligjit, për sa kohë që nga

rrethanave në mënyrë të dukshme në aktet e nxjerrja; c) nxjerrja e akteve të paarsyetuara ose që përmbajnë, në pjesën arsyetuese, vetëm përfundime mbi ligjin e zbatueshëm pa parashtruar rrethanat e faktit, në të gjitha ato raste kur ligji kërkon nxjerrjen e aktit në formën e arsyetuar; ç) nxjerrja e akteve, ku pjesa përshkruese - arsyetuese parashtron rrethana që janë haptazi në kundërshtim me pjesën urdhëruese ose që nuk kanë lidhje me të; d) marrja e vendimeve qëllimisht të paarsyetuara, si rezultat i një interesi personal ose keqdashjes; dh) shkelja e përsëritur ose e rëndë e rregullave të solemnitetit, rregullave të sjelljes në marrëdhëniet me palët, subjektet e tjera të përfshira në proces, me kryetarin, magistratët e tjerë, si dhe me personelin e administratës gjyqësore.

426. Vendimi nr. 267, datë 19.07.2022 i Këshillit të Lartë Gjyqësor.

rrethanat objektive dhe subjektive rezultojn se veprimet e tij mund të kenë qenë të qëllimshme dhe në kundërshtim të hapur dhe flagrant me ligjin apo me praktikën unifikuese të gjykatave më të larta. Në këto raste nuk mundet që të përdoret si justifikim “bindja e brendshme” e magjistratit.⁴²⁷ Kjo dinamikë e bindjes së brendshme është trajtuar edhe në një raport hetimor i ILD ndaj magjistratit M. K., ku është mbajtur qëndrimi se “... detyra e magjistratit duhet ushtruar me drejtësi. Kjo nënkupton se detyrat duhet të përmbushen sipas bindjes së brendshme, bazuar në një vlerësim objektiv të fakteve të provuara përballë zbatimit të saktë të ligjit në fuqi. Detyra duhet të ushtrohet në mënyrë korrekte, që është një kërkesë për të pasur zgjidhje të ndershme, uniforme dhe të qëndrueshme të çështjeve që paraqiten për shqyrtim. Po ashtu, magjistrati duhet të ushtrojë detyrën në mënyrë të kujdesshme, duke marrë masat për të shmangur gabime në vlerësimin e fakteve dhe zbatimin e ligjit. Në këto kushte, arrihet në konkluzionin se veprimet/mosveprimet e magjistratit ... kanë cenuar vlerat themelore të tij, si rrjedhojë, edhe besimin që ai duhet të përcjellë te publiku në përmbushjen e misionit dhe rolit të tij në dhënien e drejtësisë.”⁴²⁸

Brenda këtij parashikimi është përfshirë edhe situata, kur magjistrati ka marrë rol ligjvënës, duke ndryshuar apo shtuar parashikimin e një dispozite ligjore.⁴²⁹ E tillë është konsideruar edhe mosrespektimi i kritereve ligjore për aplikimin e institutit të “Lirimit me kusht”, parashikuar nga neni 64 i Kodit Penal.⁴³⁰

Në mënyrë të ngjashme, neni parashikon si shkelje edhe mosrespektimin e detyrimeve të kryetarëve të gjykatave dhe drejtuesve të prokurorive, si mos njoftimi i Këshillit për situata që lidhen me papajtueshmërinë, fundin e mandatit apo i ILD-së, për shkelje disiplinore të magjistratëve të tjerë.⁴³¹ Ky dimension tregon për përgjegjësinë e shtuar institucionale të kryetarëve dhe drejtuesve dhe lidhjen e ngushtë midis përgjegjësisë individuale dhe menaxhimit të sistemit.

Një aspekt veçanërisht rëndësishëm është edhe ndalimi i bërjes publike të qëndrimeve të shprehura gjatë vendimmarrjes, përpara se ato të marrin formën e një akti përfundimtar. Ky ndalim reflekton nevojën për të mbrojtur procesin e brendshëm të gjykimit nga presioni i jashtëm dhe për të garantuar besimin në pavarësinë e vendimeve. Po ashtu, ndalimi i deklaratave publike mbi çështje gjyqësore jashtë kuadrit institucional ndihmon në shmangien e perceptimit të paragjykit apo përdorimit politik të funksionit.

Një tjetër rast është edhe sjellja etike në lidhje me magjistratët

427. Vendimi nr. 208, datë 18.04.2024 i Këshillit të Lartë Gjyqësor.

428. Raport hetimi disiplinor i ILD ndaj magjistratit M. K., (2020) fq. 26.

429. Vendimi nr. 464, datë 13.10.2021 i Këshillit të Lartë Gjyqësor.

430. Vendimi nr. 633, datë 10.12.2020 i Këshilli të Lartë Gjyqësor.

431. ligji nr. 96/2016, neni 102, pika 1, germa “nj”.

e tjerë, palët, administratën gjyqësore, të prokurorisë etj. Pikërisht sjellje, që përfshijnë veprime të përsëritura joetike dhe presion ndaj gjyqtarëve, deklarime për kallëzime penale ndaj tyre dhe personelit ndihmës, komunikim të papërshtatshëm në prani të palëve dhe sjellje demonstrative, të cilat tregojnë një tendencë për të keqpërdorur funksionin me qëllim imponimi dhe frikësimi, janë konsideruar si shkelje shumë e rëndë disiplinore.⁴³²

Në tërësi, neni 102 përfaqëson një shtyllë qendrore të mekanizmit të disiplinës, duke e lidhur funksionin gjyqësor, jo vetëm me saktësinë teknike dhe përputhshmërinë me ligjin, por edhe me standarde të larta të sjelljes publike, menaxhimit dhe komunikimit institucional. Përmes këtij kuadri, ligji synon jo vetëm ndëshkimin e devijimeve, por edukimin e vazhdueshëm të magistratëve mbi peshën dhe natyrën e funksionit që ata ushtrojnë.

Ligjvënësi ka parashikuar më pas, në neni 103 të ligjit nr. 96/2016 *“Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve”*, i ndryshuar, shkeljet disiplinore të magistratëve jashtë funksionit të tyre.⁴³³ Dispozita sanksionon se edhe sjelljet e kryera në jetën private, të cilat bien ndesh me etikën publike dhe cenojnë integritetin e figurës së magistratit, mund të përbëjnë shkelje disiplinore, për sa kohë ato prekin besimin e publikut në sistemin e drejtësisë.

Në thelb, ligjvënësi ka parashikuar se përgjegjësia etike e magistratit nuk është e kufizuar vetëm në sallën e gjyqit apo zyrën e prokurorisë, por shtrihet edhe në sferën jashtë institucionit, duke pasqyruar pritshmërinë që shoqëria ka ndaj figurës së tij si bartës i një funksioni të lartë publik. Sjellje të tilla përfshijnë, ndër të tjera, shkeljen e rregullave mbi papajtueshmërinë dhe kufizimet e funksionit, përdorimin e pozitës për përfitim personal, ushtrimin e veprimtarive të jashtme pa miratimin

432. Vendimi nr. 1 (JD), datë 20.02.2023 i Kolegjit të Posaçëm të Apelimit.

433. Ligji nr. 96/2016, neni 103: *Shkeljet disiplinore jashtë ushtrimit të funksionit janë, në veçanti, por pa u kufizuar në to, veprimet, mosveprimet ose sjelljet e magistratit, si më poshtë: a) shkelja e rregullave të papajtueshmërisë me funksionin e magistratit ose të kufizimeve për shkak të funksionit, sipas parashikimeve të bëra në nenet 6 dhe 7, të këtij ligji; b) përdorimi i statusit të magistratit, me qëllim krijimin e përfitimeve për vete ose për të tjerët; c) ushtrimi i veprimtarive, me pagesë, jashtë funksionit, pa miratimin paraprak të Këshillit; ç) shoqërimi me persona që janë nën ndjekje penale, janë subjekt të një procedimit penal ose me persona të dënuar dhe të pa rehabilituar, kur nuk kanë lidhje të ngushta gjaku ose ligjore me magistratin ose vendosja e marrëdhënieve të papërshtatshme të biznesit me këta persona; d) përfitimi i padrejtë, në mënyrë të drejtpërdrejtë ose të tërthortë i dhuratave, favoreve, premtimeve ose trajtimeve preferenciale të çfarëdo lloji, të cilat jepen për shkak të funksionit që ushtron ose si rrjedhojë e shfrytëzimit të pozicionit të magistratit, edhe në rastin kur formalizohen me një veprim juridik; dh) raste të tjera të sjelljes që diskrediton pozitën dhe figurën e magistratit dhe dëmton besimin e publikut në sistemin gjyqësor ose të prokurorisë, të kryera jashtë ushtrimit të detyrës.*

e Këshillit, shoqërimin e pajustificuar me persona të inkriminuar, apo pranimin e dhuratave dhe favoreve të papërshtatshme për shkak të funksionit.

Kjo dispozitë përçon idenë se magjistrati nuk gjykohet vetëm për vendimet që jep, por edhe për integritetin dhe mënyrën e të jetuarit, si përfaqësues i një pushteti të pavarur. Një sjellje e papërshtatshme, edhe në rrethana private, mund të diskreditojë pozitën e tij dhe të dëmtojë seriozisht perceptimin e publikut mbi drejtësinë. Për këto arsye, ky parashikim, forcon përgjegjshmërinë morale dhe publike të magjistratit, si një figurë që duhet të përfaqësojë standardet më të larta të sjelljes qytetare dhe institucionale. E thënë më thjesht, një magjistrat duhet të sillet si i tillë gjatë gjithë 24 orëve të çdo dite.

Ligjvënësi ka parashikuar gjithashtu edhe shkeljet disiplinore për shkak të kryerjes së një veprë penale, që janë rregulluar nga neni 104 i ligjit nr. 96/2016 *“Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve”*, i ndryshuar. Sipas kësaj dispozite shkeljet disiplinore për shkak të kryerjes së veprës penale janë veprimet, mosveprimet ose sjelljet, për të cilat magjistrati është dënuar me vendim të formës së prerë për kryerjen e një kundërvajtjeje penale dhe që, sipas natyrës së tyre, diskreditojnë pozitën dhe figurën e magjistratit ose dëmtojnë rëndë besimin e publikut në sistemin gjyqësor ose të prokurorisë, bazuar në faktet dhe rrethanat e pranuar nga gjykata. Shkeljet disiplinore për shkak të kryerjes së një kundërvajtjeje penale janë edhe veprime, mosveprime ose sjelljet, pavarësisht se vepra penale është shuar, ndjekja penale nuk mund të fillojë ose nuk mund të vazhdojë, ose magjistrati është rehabilituar, ose ka përfituar nga falja apo amnistia. Masa disiplinore e shkarkimit nga detyra jepet vetëm nëse dënimi me vendim të formës së prerë është dhënë për kryerjen e një krimi. Në këtë rast, gjatë procedurës disiplinore, parashikimet e këtij ligji zbatohen për aq sa është e nevojshme.

Jurisprudenca ka përcaktuar, se *“Në rastin kur shkelja disiplinore identifikohet me kryerjen e një krimi, për të cilin magjistrati është dënuar me vendim gjyqësor të formës së prerë, ajo konsiderohet aq e rëndësishme sa e bën magjistratin të papërshtatshëm apo të padenjë për të vazhduar ushtrimin e funksionit të tij, në një masë të tillë, ku aplikimi i çdo mase tjetër më të lehtë, është konsideruar nga vetë Kushtetuta dhe ligji se nuk mund të ketë rol edukues. Në këtë rast, masa disiplinore e “Shkarkimit nga detyra” të magjistratit, mbron interesin publik, duke e larguar atë nga detyra dhe duke u kthyer për magjistratin, në një masë me natyrë përjashtuese nga sistemi gjyqësor, me karakter të përhershëm”*.⁴³⁴

Për shkeljet e mësipërme, ligjvënësi ka parashikuar dy kategori masash disiplinore, ato kryesore dhe ato plotësuese. Por për caktimin e tyre janë parashikuar disa kritere, që duhet të ndiqen nga ILD dhe Këshillat. Më konkretisht, neni 115 i ligjit nr. 96/2016 *“Për statusin e gjyqtarëve dhe*

434. Vendimi nr. 268, datë 29.05.2024 i Këshillit të Lartë Gjyqësor.

prokurorëve", i ndryshuar, luan një rol themelor në individualizimin e masës disiplinore që mund të vendoset ndaj një magjistrati, duke përshkruar një seri kriteresh që duhet të merren parasysh nga Këshillat përkatëse.⁴³⁵ Kjo dispozitë kërkon një vlerësim kompleks dhe të balancuar të shkeljes, bazuar në faktorë, si natyra e sjelljes, shkalla e fajësisë, motivi, pasojat dhe sjellja e magjistratit para, gjatë dhe pas hetimit.

Nga analiza e jurisprudencës është theksuar rëndësia e kësaj dispozite, si një mekanizëm për të shmangur penalizimet jo proporcionale dhe për të justifikuar secilën masë, sipas një analize bazuar në kontekstin, se ku dhe kur ka ndodhur shkelja. Një element qendror në këtë kuadër është zbatimi i parimit të proporcionalitetit, të parashikuar shprehimisht në pikën 2 të nenit 115. Ky parim kërkon që masa e dhënë të mos jetë më e rëndë se sa e nevojshme për të adresuar shkeljen. Në rastet ku magjistrati bashkëpunon, pranon përgjegjësinë ose zbut pasojat, jurisprudenca ka treguar tendencën për të konsideruar rrethana lehtësuese dhe për të dhënë masa më të buta, si paralajmërim apo vërejtje publike, në vend të uljes në detyrë apo shkarkimit. Pra, në thelb, neni 115 funksionon si një busull, që orienton institucionet drejt një vlerësimi të drejtë dhe të balancuar të çdo rasti, duke ndihmuar që vendimmarrja të mos jetë arbitrare por e mbështetur në kriterë të qarta dhe të justifikuara. Zbatimi i këtij neni nga ILD, KLGJ, KLP e KPA, përforcon legjitimitetin e sistemit

435 Ligji nr. 96/2016, neni 115: 1. Në caktimin e rëndësisë së shkeljes disiplinore dhe llojit të masës disiplinore, Këshilli merr parasysh këto kriterë: a) llojin dhe rrethanat e shkeljes; b) shkallën e fajësisë dhe motivin; c) pasojat e shkeljes; ç) të dhënat profesionale, të çështjeve disiplinore dhe të dhëna kriminale të magjistratit; d) masën e ndonjë rreziku të shkaktuar nga shkelja disiplinore; dh) çdo rrethanë e rëndësishme që ka lidhje me shkeljen; e) rrethana të lidhura me gjendjen shëndetësore të magjistratit; ë) sjelljen e magjistratit pas kryerjes së shkeljes dhe pas fillimit të hetimit; f) sjelljen e magjistratit gjatë procedimit disiplinor dhe qëndrimin që mban ndaj tij; g) çdo çështje tjetër që Këshilli e konsideron të rëndësishme. 2. Këshilli, kur vendos masën disiplinore: a) duhet të arsyetojë parimin e proporcionalitetit; b) duhet të marrë parasysh çdo rrethanë lehtësuese ose rënduese. 3. Rrethanat lehtësuese, sipas pikës 2, të këtij neni, janë: a) kur magjistrati e kryen shkeljen për herë të parë; b) kur magjistrati ka vepruar nën ndikimin e një pale të tretë, për shkak të besimit ose frikës; c) duke marrë parasysh në tërësi rrethanat e çështjes, shkelja e magjistratit ka pasur ndikim të vogël; ç) kur magjistrati bashkëpunon në hetimin dhe procedimin disiplinor, duke përfshirë dhe rastet kur pranon shkeljen e kryer ose jep informacione që ndihmojnë në hetimin dhe procedimin disiplinor; d) kur magjistrati ka zëvendësuar dëmin e shkaktuar nga shkelja ose ka ndihmuar në mënyrë aktive për të zhdukur ose pakësuar pasojat e saj; dh) koha që ka kaluar që nga kryerja e shkeljes; e) kur ekziston çdo rrethanë tjetër, për të cilën Këshilli çmon se lehtëson shkeljen e kryer. 4. Rrethanat rënduese, sipas pikës 2, të këtij neni, janë: a) kur shkelja kryhet më shumë se një herë, ose kur shkelja është kryer pas dhënies së një mase disiplinore për një shkelje të mëparshme; b) kur shkelja është e vazhdueshme; c) kur shkelja kryhet për shkak të motiveve diskriminuese; ç) kur shkelja kryhet për motive të tjera të dobëta; d) kur nxiten të tjerët për kryer shkelje ose veprime të paligjshme; dh) kur shkelja kryhet duke shfrytëzuar dobësitë ose pozitën e cënueshme të të tjerëve; e) kur ekziston çdo rrethanë tjetër, për të cilën Këshilli çmon se rëndon shkeljen e kryer.

disiplinor, promovon përgjegjshmërinë dhe mbështet objektivin themelor të mbrojtjes së interesit publik, nëpërmjet garantimit të standardeve të integritetit dhe profesionalizmit të magistratëve. ILD e ka të pasqyruar këtë moment në çdo raport hetimor. Për ilustrim *“Në analizë të kriterit “sjellja e magistratit pas kryerjes së shkeljes dhe pas fillimit të hetimit” apo “sjellja e magistratit gjatë procedimit hetimit/procedimit disiplinor dhe qëndrimin që mban ndaj tij”, rezulton se sjellja e magistratit ka qenë jo bashkëpunuese, duke iu referuar faktit të qëndrimin të tij refuzues të hedhjes së nënshkrimit në marrjen e vendimit të shtimit të objektit të hetimit, megjithëse kjo i është bërë e ditur disa herë e ditur nga ana e punonjësve të administratës së zyrës së prokurorisë. Kjo sjellje është vazhdim i të njëjtës sjellje që prokurori ... ka pasur dhe vazhdon të ketë edhe në raport me dokumentacionin/aktet/materialet lidhur me funksionin e tij si prokuror në zyrën e Prokurorisë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor*⁴³⁶ *“Ndërsa në analizë të kriterit “sjellja e magistratit pas kryerjes së shkeljes dhe pas fillimit të hetimit” apo “sjellja e magistratit gjatë procedimit hetimit/procedimit disiplinor dhe qëndrimin që mban ndaj tij”, rezulton se sjellja e magistratit ka qenë bashkëpunuese në kuptimin që ajo ka dërguar parashtrimet e saj brenda afatit të përcaktuar në ligj dhe gjithashtu është paraqitur pranë ILD-së kur është kërkuar pyetja e saj.”*⁴³⁷

Duke iu rikthyer masave disiplinore, përsa i përket masa disiplinore kryesore, ato renditen në nenin 105 dhe detajohen më pas në nenet 106 –111 të ligjit nr. 96/2016 *“Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve”,* i ndryshuar.

Masa e parë disiplinore kryesore e parashikuar është ajo e *“vërejtjes konfidenciale”,* e cila është masë disiplinore jopublike, e njohur vetëm për magistratin ndaj të cilit i jepet, e cila vërteton kryerjen e sjelljes së papërshtatshme të magistratit. Vërejtja konfidenciale përfshihet në dosjen personale të magistratit dhe mbahet parasysh në rastin e kryerjes së shkeljeve të ngjashme disiplinore ose për vlerësimin etik dhe profesional. Vërejtja konfidenciale jepet për shkelje të lehta, në të cilat publiku nuk është përfshirë ose nuk është vënë në dijeni të shkeljes.⁴³⁸

Masa e dytë disiplinore kryesore është ajo e *“vërejtjes publike”,* e cila publike është një formë e masave disiplinore publike, që deklaron publikisht kryerjen e sjelljes së papërshtatshme të magistratit. Vërejtja publike përfshihet në dosjen personale të magistratit. Vërejtja publike jepet për shkelje të lehta, të cilat janë bërë publike.⁴³⁹

Kjo masë është dhënë edhe në raste, kur nga ana e magistratit nuk janë respektuar legjislacioni procedural, por nga analizimi i rrethanave të tjera, nuk rezultonte që të kishte pasur pasoja të rënda, si edhe u mor në

436. Raport hetimi I ILD-së ndaj magistratit Sh. K., fq. 140.

437. Raport hetimi I ILD-së ndaj magistrates A. Xh., fq. 30.

438. Ligji nr. 96/2016, neni 106.

439. Ligji nr. 96/2016, neni 107.

konsideratë edhe eksperiencia e magjistratit.⁴⁴⁰ Aplikimi i kësaj mase është vendosur, edhe në rastin kur shkelja e kryer nga magjistrati konsistonte në faktin, që kishte përpiluar kërkesën për gjykim për pushimin e procedimit penal, por nuk kishte dërguar aktet në gjykatë dhe nuk i kishte komunikuar trashëgimtarëve të viktimës mbylljen e hetimeve. Ky veprim u realizua vetëm 7 muaj më vonë. ILD në atë rast, mori në konsideratë përvojën e pakët të magjistrates së re në detyrë, veprim të paqëllimshëm, bashkëpunimin e magjistrates gjatë hetimit disiplinor dhe e konsideroi shkelje të lehtë, por në kushtet kur rasti ishte bërë publik në media vizive e të shkruar, u propozua dhënia e masës “Vërejtje publike”, që KLP e konsideroi të drejtë dhe e pranoi. Rast tjetër të dhënies së kësaj mase ka qenë situata, kur një prokuror nuk kishte nxjerrë për një kohë të gjatë urdhrin për ekzekutimin e një vendimi gjyqësor, por kjo shkelje kishte ndodhur si rezultat i qenies së vetëm një prokurori në sektorin e ekzekutimeve, pa asnjë personel mbështetës, si sekretari apo oficerë të policisë gjyqësore.⁴⁴¹ Tjetër rast i aplikimit të kësaj mase disiplinore ka qenë kur një prokuror, nuk zbatoi vendimet e gjykatës, që kishte urdhëruar kryerjen e hetimeve shtesë. Në këtë rast u vlerësua se ndodheshim përballë një rasti të izoluar, dhe nga Këshilli u morën në konsideratë ngarkesa e prokurorit, pasojat e pandemisë COVID-19, si edhe efektet e procesit të rivlerësimit kalimtar.⁴⁴² Kjo masë është dhënë, edhe në raste kur nga ana e magjistratit nuk është respektuar legjislacioni procedural, por nga analizimi i rrethanave të tjera, nuk rezultonte që të kishte pasur pasoja të rënda, si edhe u mor në konsideratë edhe mosha e magjistratit.⁴⁴³

Masa e tretë disiplinore kryesore është *“ulja e përkohshme e pagës”*, bazuar në të cilën, Këshilli mund të vendosë që të ulë përkohësisht pagën e magjistratit deri në 40 për qind, bazuar në kriteret e përcaktuara në nenin 115 të ligjit nr. 96/2016 *“Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve”*, i ndryshuar, për një periudhë jo më të gjatë se një vit. Në mënyrë alternative, Këshilli përkatës, mund të vendosë edhe gjobë, në masë të barabartë me uljen e përkohshme të pagës, duke vlerësuar rëndësinë e çështjes dhe të gjitha rrethanat e saj. Ulja e përkohshme e pagës jepet në tre raste dhe konkretisht a) kur magjistratit i është dhënë vërejtje konfidenciale ose vërejtje publike për shkelje disiplinore të mëparshme; b) kur masat më të lehta disiplinore janë të papërshtatshme për rrethanat e shkeljes disiplinore; c) kur rrethanat e shkeljes nuk përbëjnë shkelje disiplinore shumë të rënda dhe nuk është e përshtatshme një masë disiplinore më e rëndë.⁴⁴⁴

440. Vendimi nr. 464, datë 13.10.2021 i Këshillit të Lartë Gjyqësor.

441. Vendimi nr. 228, datë 29.10.2024 i Këshillit të Lartë të Prokurorisë.

442. Vendimi nr. 15, datë 30.01.2025 i Këshillit të Lartë të Prokurorisë.

443. Vendimi nr. 464, datë 13.10.2021 i Këshillit të Lartë Gjyqësor.

444. Ligji nr. 96/2016, neni 108.

Rezulton se kjo masë është dhënë kur një drejtues prokurorie kishte marrë çështje nga prokurorja e gatshme dhe kishte përdorur fjalor jo etik ndaj saj.⁴⁴⁵ Në 11 raste ILD ka propozuar vendosjen e kësaj mase në të dy Këshillat, por që në disa raste është caktuar si masë më e lehtë në raport me masën e kërkuar nga ILD.

Masa e katërt disiplinore kryesore është *“ulja në detyrë”*, sipas së cilës mund të shfaqet në formën e uljes së magjistratit nga një gjykatë më e lartë në një gjykatë më të ulët, ose nga një pozicion në gjykatën e posaçme për gjykimin e veprave penale të korrupsionit dhe krimit të organizuar ose në Prokurorinë e Posaçme në një gjykatë të juridiksionit të përgjithshëm ose në një prokurori tjetër. Kjo masë disiplinore jepet në këto rastin kur shkelja e kryer nga magjistrati është e rëndë, ose kur magjistrati shfaq sjellje, që evidentojnë se aftësitë e tij nuk janë të përshtatshme për gjykatën më të lartë ose gjykatën e specializuar, ndërkohë që shkelja nuk e bën magjistratin të papërshtatshëm për të ushtruar funksionin e tij si magjistrat. Në rast uljeje në detyrë magjistrati merr pagën e pozicionit të ulur në detyrë.⁴⁴⁶

Masa e pestë disiplinore kryesore është *“pezullim nga detyra”*, në bazë të së cilës realizohet pezullimi nga detyra e magjistratit, me të drejtën për të marrë pagën minimale për një periudhë nga tre muaj deri në dy vjet. Ajo jepet vetëm në dy raste, ku *së pari* shkelja e kryer nga magjistrati është e shumë e rëndë, ose kur Këshilli çmon, se pavarësisht se natyra dhe rrethanat e kryerjes së shkeljes nuk e bëjnë magjistratin të papërshtatshëm ose të padenjë për të ushtruar funksionin, rëndësia e shkeljes dhe dëmi që i shkaktohet imazhit të magjistratit kërkojnë që magjistrati të pezullohet për një kohë të caktuar.⁴⁴⁷

Kjo masë rezulton që të jetë zbatuar nëpërmjet marrëveshjes së përbashkët të pranimit të shkeljes, që konsistonte në sjellje të parregullta, ku në përfundim është dakordësuar dhe pastaj konfirmuar dhënia e masës *“pezullimit nga detyra me të drejtën për të marrë pagën minimale për një periudhë kohore për 6 muaj”*.⁴⁴⁸ Një tjetër rast, ka qenë kur janë konsideruar shkelje praktikave gjyqësore të vendosura nga gjykata e apelit e juridiksionit ku përfshihet gjykata, ku gjyqtari ka ushtruar funksionin në kohën e dhënies së vendimit, sjellja jo vazhduese e magjistratit në zbatim të këtyre praktikave në kundërshtim me ligjin, e konkretizuar vetëm në dhënien e vendimit gjyqësor objekt procedimi, si dhe pasojën faktike që ka sjellë vendimi në raport me masën e dënimit të të dënuarit, si dhe ndikimin e këtij vendimi në llojin e përfitimeve që mund të rrjedhin për këtë të dënuar në të ardhmen, ku përfundimisht është vendosur masa e

445. Vendimi nr. 65, datë 10.04.2025 i Këshillit të Lartë të Prokurorisë.

446. Ligji nr. 96/2016, neni 109.

447. Ligji nr. 96/2016, neni 110.

448. Vendimi nr. 6, datë 17.01.2022 i Këshillit të Lartë Gjyqësor.

pezullimit për tre muaj.⁴⁴⁹ Në disa raste të tjera, një magjistrati iu caktua masa e pezullimit nga detyra për 3 muaj; dy magjistratëve të tjerë për 6 muaj, ndërsa ILD ka propozuar në dy procedime të ndryshme, dy masa pezullimi nga detyra për 2 vjet ndaj të njëjtit magjistrat, procedimi për të cilin u mbyll nga KLGJ pas shkarkimit të tij nga KPA.

Masa e gjashtë disiplinore kryesore dhe më ekstremja, është ajo e *“Shkarkimit nga detyra”*, e cila jepet si masë disiplinore, së pari ku vlerësohet se shkelja është shumë e rëndë dhe kur Këshilli çmon se natyra dhe rrethanat e kryerjes së shkeljes e bëjnë magjistratin të papërshtatshëm ose të padenjë për të ushtruar funksionin e tij, për shkak të dënimit për kryerjen e një krimi, për shkak të paafetësisë së rëndë dhe të dukshme, ose për shkak të një sjelljeje që kryhet të paktën me pakujdesi të rëndë, dhe që shkel haptazi vlerat themelore të sistemit gjyqësor dhe të prokurorisë. Ligjvënësi është kujdesur të parashikojë edhe një rrethanë të veçantë për magjistratët e gjykatave apo prokurorive të posaçme. Sipas këtij parashikimi, në rastin kur magjistrati i gjykatës së posaçme për gjykimin e veprave penale të korrupsionit dhe krimit të organizuar ose i Prokurorisë së Posaçme përhap informacion sensitiv, si nga pakujdesia e rëndë, ose me dashje, ose kur kryen shkelje tjetër të rëndë, atij i jepet masa disiplinore e shkarkimit.⁴⁵⁰

Kjo masë është zbatuar nga Këshilli i Lartë Gjyqësor, sipas propozimeve të raporteve hetimore të ILD-së, në rastin kur gjyqtari ka qenë dënuar me vendim gjyqësor të formës së prerë,⁴⁵¹ si edhe për mos respektim të kushteve për lirin me kusht të të dënuarve.⁴⁵² Përsa i përket Këshillit të Lartë të Prokurorisë, ky i fundit e ka zbatuar këtë masë të propozuar nga Inspektori i Lartë i Drejtësisë, për shkeljen e rregullave, që kanë të bëjnë me shqyrtimin e kërkesave për lirin me kusht dhe mos ushtrimin e ankesave në këto raste,⁴⁵³ kur nga magjistrati është shfaqur neglizhencë, mosveprime, vonesa dhe lënien e shumë procedimeve pa trajtim e zgjidhje përfundimtare,⁴⁵⁴ apo kur magjistrati është dënuar, me vendim gjyqësor të formës së prerë, për kryerjen e një veprë penale.⁴⁵⁵

Siç u përmend më sipër, ligjvënësi, krahas masave disiplinore kryesore ka parashikuar edhe masat disiplinore plotësuese, në nenet

449. Vendimi nr. 267, datë 19.07.2022 i Këshillit të Lartë Gjyqësor.

450. Ligji nr. 96/2016, neni 111.

451. Vendimet nr. 529, datë 27.10.2020; nr. 223, datë 02.06.2021; nr. 462, datë 11.10.2021; nr. 180, datë 09.04.2024 dhe nr. 268 datë 29.05.2024 të Këshillit të Lartë Gjyqësor.

452. Vendimet nr. 663, datë 10.12.2020 dhe nr. 92, datë 17.03.2021 të Këshillit të Lartë Gjyqësor.

453. Vendimi nr. 81, datë 31.03.2021 i Këshillit të Lartë të Prokurorisë.

454. Vendimi nr. 20, datë 31.01.2022 i Këshillit të Lartë të Prokurorisë.

455. Vendimi nr. 31, datë 30.01.2023 dhe nr. 284, datë 17.07.2023 të Këshillit të Lartë të Prokurorisë.

112–114 të ligjit nr. 96/2016 *“Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve”*, i ndryshuar, të cilat përbëjnë një instrument të rëndësishëm ndihmës për Këshillin e Lartë Gjyqësor dhe Këshillin e Lartë të Prokurorisë, që synojnë jo thjesht ndëshkimin, por korrigjimin dhe mirëfunksionimin e sistemit gjyqësor dhe atij të prokurorisë. Ndryshe nga masat kryesore disiplinore, që kanë për qëllim ndëshkimin proporcional të një sjelljeje të papërshtatshme, masat plotësuese janë të lidhura ngushtë me nevojën për përmirësim profesional dhe organizativ, në funksion të ruajtjes së besimit publik dhe cilësisë së shërbimit të drejtësisë.⁴⁵⁶ Deri në realizimin e këtij punimi, rezulton që të ketë vetëm një rast, kur është dhënë një masë disiplinore plotësuese nga Këshilli i Lartë i Prokurorisë, referuar propozimit të ardhur nga Inspektori i Lartë i Drejtësisë, ku më konkretisht Këshilli, ka arsyetuar se *“293. Duke iu referuar dispozitave të nenit 112, pika 2, dhe nenit 114 të ligjit nr. 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve”, i ndryshuar, Këshilli ka të drejtë të vendosë largimin nga detyra të drejtuesit kur, pas analizimit të rrethanave të çështjes, rezulton se sjellja ose mosveprimi i magjistratit ka minuar besimin e nevojshëm që pozicioni i drejtuesit duhet të gëzojë brenda trupës së prokurorëve, organeve të tjera institucionale dhe opinionit publik. Masa në fjalë është e veçantë, sepse synon të ruajë pavarësinë,*

456. Sipas nenit 112, ligji ruan mundësinë, që së bashku me masat disiplinore më pak të rënda (si paralajmërimi, vërejtja, ulja në detyrë etj.), të vendosen edhe masa shtesë me karakter korrigjues. Dy prej këtyre masave janë ndjekja e detyrueshme e trajnimeve profesionale dhe largimi nga detyra e kryetarit.

Masa e parë plotësuese është rregulluar në mënyrë të detajuar në nenin 113, synon ndërhyrjen përmes formimit profesional të magjistratit, kur shkelja nuk është aq e rëndë sa të justifikojë shkarkimin ose pezullimin, por tregon për mangësi serioze në njohuritë, qëndrimin profesional ose zbatimin e praktikës gjyqësore. Këshilli, në këto raste, përcakton përmbajtjen dhe kohëzgjatjen e programit të trajnimit, duke synuar që sjellja e gabuar të korrigjohet nëpërmjet edukimit dhe jo thjesht përmes ndëshkimit.

Masa e dytë plotësuese, është e parashikuar në nenin 114 dhe u jep Këshillave kompetencën, që në rastet kur shkeljet lidhen me ushtrimin e funksioneve drejtuese, të largojnë magjistratin nga pozita e drejtuesit dhe ta rikthejnë në pozicionin e zakonshëm, si gjyqtar apo prokuror. Kjo masë nuk nënkupton domosdoshmërisht papërshtatshmëri për të qenë magjistrat, por thjesht e bën të pamundur ose të pajustificuar vijimin e funksioneve drejtuese për shkak të keq menaxhimit, sjelljeve të papërshtatshme në pozita udhëheqëse, apo dështimit për të përfaqësuar standardin moral dhe institucional që pozita e kryetarit kërkon.

Në lidhje me këtë masë të fundit, Këshilli i Lartë i Prokurorisë, duke e zbatuar atë në një rast, ka mbajtur qëndrimin se *“292. Masat plotësuese nuk kanë qëllim vetveten por ato ndërhyjnë aty ku shkelja ndikon drejtpërdrejt në mënyrën e ushtrimit të funksioneve të specializuara ose të rëndësishme, si funksioni i drejtuesit të një organi të prokurorisë. Në këtë kontekst, largimi nga detyra e drejtuesit është një masë që nuk ndikon në cenimin e statusit të magjistratit në thelb, por përcakton se ai nuk mund të vazhdojë të ushtrojë më funksione të karakterit drejtues, për shkak të mosmbajtjes së standardeve të nevojshme për këtë rol.*

paanshmërinë, eficiencën dhe standardin e lartë moral dhe profesional të drejtimit të organit të prokurorisë.

294. Largimi nga detyra e drejtuesit nuk përbën një ndëshkim të zakonshëm, por një ndërhyrje që synon mbrojtjen e integritetit të institucionit. Ai vendoset në ato raste kur, megjithëse nuk është e nevojshme shkarkimi nga funksioni i magjistratit, vazhdimi i këtij magjistrati në një pozicion drejtues do të ishte në kundërshtim me kërkesat që shoqëria dhe sistemi i drejtësisë presin nga funksionarët e lartë të drejtësisë.

295. Në rastin konkret të magjistratit K. Ll., nga të dhënat e grumbulluara gjatë hetimit disiplinor dhe nga analiza e provave, rezulton se sjellja e tij, si drejtues i Prokurorisë pranë Gjykatës së Juridiksionit të Përgjithshëm Sarandë, nuk i ka përmbushur pritshmëritë e funksionit drejtues. Konkretisht, mënyra e menaxhimit të gatishmërisë dhe shpërndarjes së çështjeve, marrëdhëniet institucionale me trupën e prokurorëve, si dhe trajtimi i veçantë dhe jo konform standardeve i prokurores që është ankuar, evidentuan mungesë të kujdesit, të objektivitetit dhe të një drejtimi të ndërtuar mbi bazën e barazisë dhe respektit për detyrimet institucionale.

296. Këshilli vlerëson se këto sjellje nuk përbëjnë thjesht shkelje të karakterit individual, por reflektojnë cenim të standardeve të drejtimit institucional, duke sjellë si pasojë një humbje të besimit të domosdoshëm që duhet të ekzistojë ndërmjet drejtuesit dhe trupës së prokurorëve që ai drejton.

297. Në këtë kuptim, Këshilli çmon se është i justifikuar jo vetëm vendosja e një mase disiplinore kryesore, por edhe dhënia e masës plotësuese të largimit nga detyra e kryetarit, si një mekanizëm për të rikthyer standardet e drejtimit institucional dhe për të garantuar që drejtimi i një organi të akuzës të ushtrohet nga persona që gëzojnë integritet, paanshmëri dhe aftësi të spikatura organizative.

298. Për këtë arsye, dhe në përputhje me nenin 114 të ligjit nr. 96/2016, masa disiplinore plotësuese e largimit nga detyra e kryetarit konsiderohet e drejtë, proporcionale dhe në përputhje me natyrën e shkeljeve të konstatuara në këtë rast.

299. Këshilli thekson se ky pozicion përbën figurën më të lartë në nivel lokal apo të posaçëm të organit të akuzës dhe ka një ndikim të drejtpërdrejtë në besimin e publikut në sistemin e drejtësisë. Drejtuesi i Prokurorisë nuk është thjesht një menaxher i institucionit që ai drejton, por është figura përfaqësuese, e cila mban përgjegjësi për organizimin, efikasitetin dhe transparencën e zyrës së prokurorisë, është përgjegjës për ruajtjen e standardeve etike dhe ligjore, si brenda institucionit edhe në marrëdhënie me të tretët, si dhe është nën vëzhgim të vazhdueshëm nga media dhe publiku.

300. Disa forma të sjelljes që çojnë në cenim të besimit të publikut përfshijnë:

- Ndërhyrje në ndarjen e çështjeve, përmes shmangies së shortit apo caktimit selektiv të prokurorëve;
- Ndërhyrje në vendimmarrjen e prokurorëve për çështje konkrete, veçanërisht në raste të ndjeshme publikisht;

- Trajtim i pabarabartë apo denigrues ndaj prokurorëve, që krijon përplasje të brendshme dhe ekspozon mungesën e paanshmërisë.
- Deklarata publike jo etike që prekin integritetin e institucionit etj.

301. Nëse drejtuesi shfaq ndonjë nga sjelljet e mësipërme ose kryen veprime që vijnë në kundërshtim me integritetin profesional dhe normat e sjelljes, që ai duhet të ketë brenda dhe jashtë zyrës së prokurorisë që përfaqëson, atëherë dëmi që i shkaktohet figurës së prokurorisë është i rëndë dhe cenohet besimi i publikut tek drejtësia.

302. Këshilli i Lartë i Prokurorisë vëren se, konflikti ndërmjet drejtuesit dhe magjistrates B. S., ka marrë përmasa të gjera tashmë pasi në dijeni të tij janë oficerë të policisë gjyqësorë, administrata e prokurorisë, komisarati i policisë Sarandë, Prokuroria dhe Gjykata Gjirokastrë, ILD dhe KLP, pra nuk është një konflikt i çastit, që është mbyllur aty për aty, por ka zgjatur në kohë dhe ka përfshirë shumë subjekte. Për këtë arsye, Këshilli i Lartë i Prokurorisë vlerëson se, edhe propozimi i ILD për dhënien e masës disiplinore plotësuese “Largim nga detyra e kryetarit” e parashikuar nga neni 112, pika 2, shkronja “b” i ligjit nr. 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve”, i ndryshuar, qëndron, për arsye se, pasja e dy masave disiplinore në fuqi dhe situatat konfliktuale me magjistraten B. S., gjatë periudhës 2023-2024, nuk i përshtaten pozicionit si “Drejtues i Zyrës së Prokurorisë”.⁴⁵⁷

Nga arsyetimi i mësipërm, kuptohet se Këshilli i Lartë i Prokurorisë mbajti qëndrimin ligjor, se masa disiplinore plotësuese e largimit nga detyra e drejtuesit nuk është një ndëshkim i zakonshëm, por një ndërhyrje e domosdoshme për të mbrojtur integritetin e institucionit, në rastet kur sjellja e magjistratit në pozita drejtuese minon standardet e paanshmërisë, objektivitetit dhe besimit të brendshëm dhe publik ndaj funksionit drejtues. Në rastin konkret, mënyra e menaxhimit institucional, raportet e tensionuara dhe sjelljet e përsëritura përjashtuese dhe jo etike ndaj një magjistrateje dhe trupës së prokurorëve, përbënin një devijim serioz nga standardet e kërkuara për një drejtues dhe justifikuan dhënien e kësaj mase. Sipas Këshillit, kjo masë ishte proporcionale dhe e përligjur për të rikthyer standardin e drejtimit dhe për të ruajtur besimin në një sistem drejtësie të pavarur dhe profesionale.

Në thelb, këto masa plotësuese shërbejnë për të ruajtur balancën midis nevojës për integritet dhe nevojës për zhvillim të vazhdueshëm të sistemit të drejtësisë. Ato japin mundësinë për ndërhyrje të shkallëzuar dhe proporcionale, pa shkuar drejtpërdrejt në sanksione të rënda dhe përjashtuese, duke përqafuar një filozofi moderne disiplinore që shkon përtej ndëshkimit: atë të përmirësimit, ndërtimit të kapaciteteve dhe drejtimit të qëndrueshëm institucional. Kjo qasje reflekton gjithashtu qëllimin e ligjvënësit për të nxitur cilësi dhe vetërregullim brenda sistemit të drejtësisë, si themel i besimit qytetar dhe profesionalizmit të magjistratëve.

457. Vendimi nr. 65, datë 10.04.2025 i Këshillit të Lartë të Prokurorisë.

3.1 Hetimi disiplinor

Në kreun II, të pjesës, ligjvënësi, në nenet 117 – 137 të ligjit nr. 96/2016 *“Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve”*, i ndryshuar, ka rregulluar procedurën hetimore. Që një procedurë e tillë të nisë, ligji njeh dy mënyra për vënien në lëvizje të ILD-së, ku e para është nëpërmjet paraqitjes së një ankese dhe e dyta kryesisht, nga vetë Inspektori i Lartë i Drejtësisë.

Përsa i përket mënyrës së parë, neni 199 i këtij ligji parashikon së pari, se Inspektori i Lartë i Drejtësisë shqyrton ankesat e paraqitura nga çdo person fizik ose juridik. Në jurisprudencën e tij, Këshilli i Lartë i Prokurorisë është detyruar që t’i japë përgjigje pretendimit të ngritur nga një magjistrat që po procedohej, se magjistrati që kishte paraqitur ankesën, nuk mundej që të konsiderohej si “person fizik” dhe për rrjedhojë ILD nuk duhej të ishte vënë në lëvizje. Këshilli, duke e rrëzuar këtë pretendim argumentoi se togfjalëshi “çdo person fizik”, i përdorur në nenin 119, pika 1 të ligjit nr. 96/2016, përfshin edhe vetë magjistratët. Kjo për arsye se magjistrati, si individ me personalitet juridik, është njëkohësisht edhe person fizik dhe si i tillë gëzon të drejtën për të paraqitur ankesë, në veçanti nëse është i prekur drejtpërdrejt në ushtrimin e funksioneve apo të drejtave të tij. Ligji nuk vendos asnjë kufizim për kategorinë e personave fizikë, që mund të ankohen pranë ILD-së dhe për këtë arsye përjashtimi i magjistratëve do të përbënte një interpretim arbitrar, pa mbështetje në tekstin e normës. Për më tepër, në rastet kur informacioni i përcjellë prej një magjistrati shërben si indicie për fillimin e një hetimi, ajo çka ka rëndësi është përmbajtja e informacionit dhe jo cilësia formale e ankuesit.⁴⁵⁸

Ligji parashikon në mënyrë të shprehur, edhe detyrimin për disa subjekte të tjera publike, që në rastet kur ka të dhëna të besueshme, se një magjistrat ka kryer shkelje disiplinore, të paraqesin ankesa tek Inspektori i Lartë i Drejtësisë. Këto subjekte janë Ministri i Drejtësisë, një anëtar i vetëm i Këshillit të Lartë Gjyqësor, apo të Këshillit të Lartë të Prokurorisë, si edhe kryetari i gjykatës ose drejtuesi i prokurorisë. Ky parashikim nuk e lë në diskrecionin e këtyre subjekteve mundësinë për të paraqitur apo jo ankim pranë ILD-së, por krijon një detyrim ligjor kundrejt tyre.⁴⁵⁹

Këto subjekte mund ta paraqesin ankesën e tyre personalisht, me postë të rregullt, postë elektronike ose faks.⁴⁶⁰ Ligji parashikon që ankesa duhet të përmbajë prova dhe burime të dhënash për faktet dhe rrethanat e pretenduara.⁴⁶¹ Pra ankesat duhet të jenë serioze në përmbajtje dhe të mbështeten në prova. Me qëllim lehtësimin e paraqitjes së ankesave,

458. Vendimi nr. 65, datë 10.04.2025 i Këshillit të Lartë të Prokurorisë.

459. Ligji nr. 96/2016, neni 119, pika 2.

460. Ligji nr. 96/2016, neni 119, pika 5.

461. Ligji nr. 96/2016, neni 119, pika 7.

ligji e detyron Inspektorin e Lartë të Drejtësisë që të publikojë modelin e formularit të ankesës në faqen e tij zyrtare.⁴⁶² Vetë ILD ka krijuar lehtësi, që paraqitja e një ankese me formular tip, të bëhet edhe online përmes faqes së internetit të institucionit.⁴⁶³

Ankesa, e cila paraqitet në formë të shkruar dhe përmban a) gjeneralitetet dhe adresën e ankuesit, si dhe nëse ankuesi kërkon konfidencialitetin e identitetit të tij; b) përshkrim të rrethanave të faktit që pretendohen të kenë ndodhur; c) emrin dhe mbiemrin e magjistratit, gjykatën ose prokurorinë në të cilën magjistrati ka ushtruar funksionin, në kohën kur ka ndodhur shkelja e pretenduar, d) Nëse shkelja e pretenduar ka ndodhur brenda 5 viteve nga momenti i dorëzimit të ankesës.⁴⁶⁴

Në praktikë është shfaqur situata, kur ankesa ishte paraqitur nga subjekt publik (ministri i drejtësisë), i cili në ankesën e tij kishte parashtruar edhe masën disiplinore, që ky subjekt pretendonte se duhej të merrej. Kjo mundësi nuk parashikohet nga ligji dhe u parashtrua si një formë ndikimi si për ILD-në ashtu edhe për KLGJ-në. Por, ky pretendim u konsiderua si i pabazuar, nga Kolegji i Posaçëm i Apelimit, pasi vetëm ky fakt nuk mundet që të konsiderohet ndikim për veprimtarinë e organeve kushtetuese, nëse kjo nuk shoqërohet me prova të tjera, që provojnë një ndikim real mbi këto institucione. Paraqitja e kërkesës për llojin e masës nuk e bën dhe ankesën të pavlefshme, pasi mbetet në vlerësimin e ILD-së, se çfarë masë disiplinore do të propozojë dhe e Këshillit përkatës se çfarë mase do të vendosë në fund.⁴⁶⁵

Inspektori i Lartë i Drejtësisë ka detyrimin të shqyrtojë ankesat, përveç atyre anonime. Ankuesi ka të drejtë të kërkojë ruajtjen e konfidencialitetit. Inspektori i Lartë i Drejtësisë i konfirmon ankuesit marrjen e ankesës brenda pesë ditëve nga marrja e saj. Inspektori i Lartë i Drejtësisë i njofton ankuesin vendimin për arkivimin e ankesës, për fillimin hetimit, shtimin ose ndryshimin e objektit të tij, si dhe mbylljen e hetimit, brenda pesë ditëve nga marrja e vendimit përkatës. Ankuesi ka të drejtë të ankimojë vendimet për arkivimin dhe mbylljen e hetimit.⁴⁶⁶

462. Ligji nr. 96/2016, neni 119, pika 8.

463. Në faqen e internetit të ILD, tek rubrika “*Si pranohen ankesat*”, rifreskohet me raste konkrete orientuese për ankuesit mbi kushtet ligjore të pranueshmërisë së ankesës, ecurinë e saj, arkivimin, ankimin e deri tek hetimi e procedimi disiplinor, me një ilustrim grafik të të gjithë rrugëtimit, që ndjek një ankesë në ILD. Në faqe gjendet një formular tip ankese, me udhëzimet përkatëse për plotësimin e tij, një model tip i plotësuar orientues, si dhe katër mënyra dërgimi pranë Inspektorit të Lartë të Drejtësisë: përmes celularit ose kompjuterit, me e-mail, me postë ose fizikisht në institucion. Ankuesi mund të përzgjedhë vetë formën që preferon për dërgimin e ankesës.

464. Ligji nr. 96/2016, neni 120, pika 2.

465. Vendimi nr. 3, datë 07.12.2022 i Kolegjit të Posaçëm të Apelimit.

466. Ligji nr. 96/2016, neni 119, pika 4.

Tërheqja e ankesës nga ankuesi nuk sjell arkivimin e ankesës, nëse Inspektori i Lartë i Drejtësisë vlerëson që pretendimi ka shkaqe të mjaftueshme për kryerjen e hetimit me iniciativën e tij, si dhe nuk sjell mbylljen e një hetimi të filluar.⁴⁶⁷

Nisja e një kësaj procedure kushtëzohet në radhë të parë, nga ekzistenca e disa afateve parashkrimi. Ky institut i sanksionuar në nenin 117 të ligjit nr. 96/2016 *“Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve”*, i ndryshuar, përbën një element të rëndësishëm të sigurisë juridike dhe të mbrojtjes nga ndjekjet e pakufizuara në kohë ndaj magistratëve për sjellje të mundshme të dënueshme në aspektin disiplinor, për të cilin jurisprudenca ka mbajtur qëndrimin se *“14.6.1 ... Kolegji vlerëson se parashkrimi si një institut juridik, i cili sjell si pasojë humbjen e së drejtës për ndjekjen disiplinore të magistratit, është parashikuar si një nga kriteret e pranueshmërisë së ankesës nga ana e ILD-së në nenin 120 të ligjit nr. 96/2016 dhe lidhet me institutin e parashkrimit të procesit disiplinor, parashikuar në pikën 1 të nenit 117 të po këtij ligji”*.⁴⁶⁸ Pra, në thelb, afati i parashkrimit synon të garantojë qëndrueshmërinë e marrëdhënies së magistratit me funksionin e tij dhe të parandalojë cenimin e sigurisë juridike, duke lejuar që ndjekja disiplinore të mund të ushtrohet vetëm brenda një afati të arsyeshëm nga momenti i kryerjes së saj.

Neni 117 e rregullon në mënyrë të detajuar këtë institucion, duke përcaktuar se çdo shkelje disiplinore parashkruhet brenda pesë viteve, nga momenti i kryerjes së saj. Ky është rregulli i përgjithshëm, i cili përjashton verifikimin ose hetimin e shkeljeve të pretenduara pas këtij afati. Si pasojë, Inspektori i Lartë i Drejtësisë nuk është i autorizuar të veprojë mbi një ankesë ose informacion, që i është vënë në dispozicion, kur shkelja e pretenduar ka kaluar tashmë në fazën e parashkrimit. Ligjvënësi ka përcaktuar qartë, se afati i parashkrimit fillon të rrjedhë nga momenti i kryerjes së shkeljes, pavarësisht kohës kur ajo zbulohet, apo kur bëhet objekt shqyrtimi institucional.

Megjithatë nga rregulli i mësipërm, norma ligjore parashikon edhe situata përjashtimore, ku rasti i parë është në formën e shtyrjes së afatit, në rastet kur brenda periudhës pesëvjeçare, magistrati kryen një tjetër shkelje disiplinore të së njëjtës natyrë. Në këtë rast, afati i parashkrimit zgjatet deri në një vit shtesë, duke synuar të mbrojë integritetin e procesit hetimor dhe të evitojë shmangien e përgjegjësisë, nëpërmjet përsëritjes së sjelljeve të ngjashme brenda një kohe të shkurtër.

Qëllimi i këtij parashikimi duket se është që të disiplinohë situatat kur shkelja e pretenduar është e vazhdueshme. Pikërisht për ta ndëshkuar këtë lloj shkelje në tërësinë e saj është parashikuar edhe shtyrja me një vit e afatit të parashkrimit. Nga ana tjetër organet disiplinore nuk

467. Ligj nr. 96/2016, neni 119, pika 6.

468. Vendimi nr. 1 (JD), datë 20.02.2023 i Kolegjit të Posaçëm të Apelimit.

mundet që të pretendojnë, që duke qenë shkelja disiplinore e pretenduar e vazhdueshme, atëherë afati i parashkrimit nuk do të konsiderohet se ka filluar të ecë. Përkundrazi, mënyra si është formuluar dispozita tregon, që për të njëjtën lloj sjelljeje të magjistratit, pavarësisht se është e përsëritur dhe e vazhdueshme në kohë, fillimi i afatit të parashkrimit do të duhet të konsiderohet momenti kur ka ndodhur shkelja e parë e pretenduar dhe ky afat mund të zgjatet me vetëm një vit, tej afatit të përgjithshëm 5 vjeçar.

Përfundimi i dytë janë rastet kur shkelja disiplinore përbën njëkohësisht edhe vepër penale, ku norma juridike tenton që të barazojë afatin e parashkrimit në hetimin administrativ dhe disiplinor, me afatin e parashkrimit të ndjekjes penale. Më konkretisht norma parashikon se kur Kodi Penal parashikon afate parashkrimi më të gjata se pesë vjet, atëherë zbatohet afati më i gjatë penal. Pra, nëse vepra penale parashkruhet më pak se 5 vjet, atëherë do të zbatohet afati ligjor i parashkrimit të ligjit nr. 96/2016 *“Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve”*, i ndryshuar. Nëse afati i parashkrimit në Kodin Penal është më i gjatë se 5 vjet, atëherë ky afat do të zbatohet edhe për procedimin administrativ dhe disiplinor. Qëllimi i këtij përfundimi, është që të sigurojë, që shkeljet me rrezikshmëri të lartë dhe që lidhen me veprime të natyrës penale, të mos mbeten të pandëshkuara për shkak të një kufizimi formal ligjor.

Kjo situatë është trajtuar edhe nga jurisprudenca e KLGJ, e cila ka mbajtur qëndrimin se, *“13.1.1 Sipas parashikimeve të nenit 117 të ligjit “Për statusin”, shkelja disiplinore parashkruhet brenda pesë vjetëve. Pavarësisht këtij parashikimi, për shkeljen disiplinore, e cila përbën dhe vepër penale, afatet e parashkrimit përlllogariten sipas dispozitave të Kodit Penal, nëse në këtë Kod parashikohen afate parashkrimi më të gjata se pesë vjet. Sipas të dhënave në dosjen hetimore dhe në raportin e hetimit, rezultoi se shkelja disiplinore e pretenduar përbente njëkohësisht dhe vepër penale, sipas nenit 319/ç të Kodit Penal, nën i cili parashikon dënimin me burgim nga tre deri në dhjetë vjet. Duke pasur në konsideratë datën e fillimit të hetimit disiplinor dhe afatin e parashkrimit për shkeljen disiplinore të pretenduar, i cili është 10 vjet, referuar parashikimeve të nenit 66/1 të Kodit Penal, fillimi i hetimit disiplinor me iniciativë, u konstatua se është vendosur nga Inspektori brenda këtij afati parashkrimi”*.⁴⁶⁹

Në përfundim, qëllimi i dispozitave për parashkrimin në të drejtën disiplinore është të garantojnë ekuilibrin ndërmjet nevojës për të ndëshkuar sjelljet e papërshtatshme të magjistratëve dhe nevojës për të respektuar të drejtën e tyre për siguri juridike, duke e kufizuar në kohë ndjekjen e përgjegjësisë. Ligji vendos një kufi të përgjithshëm dhe të qartë pesë vjeçar, i cili, në rrethana të veçanta, mund të zgjatet në një vit

469. Vendimi nr. 529, datë 27.10.2020 i Këshillit të Lartë Gjyqësor. Shih edhe vendimet nr. 199/2, datë 12.05.2021, nr. 223, datë 02.06.2021 dhe nr. 462, datë 11.10.2021 të Këshillit të Lartë Gjyqësor.

ose të zëvendësohet nga afati i parashkrimit të ndjekjes penale në rastet e shkeljeve, që kanë edhe karakter penal. Ky mekanizëm i ndërlidhur shërben si garanci për ligjshmërinë e hetimit disiplinor dhe ruajtjen e besimit në proceset disiplinore.

Me qëllim që procedura hetimore të ecë brenda afateve të arsyeshme, ligjvënësi, në nenin 118 të ligjit nr. 96/2016 *“Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve”*, i ndryshuar, ka parashikuar disa afate në ngarkim të Inspektorit të Lartë të Drejtësisë. Këto afate përbëjnë një element thelbësor në kuadrin e garancive formale dhe substanciale të procesit disiplinor ndaj magjistratëve, duke vendosur kufij kohorë brenda të cilëve Inspektori i Lartë i Drejtësisë, si rregull, duhet të ushtrojë kompetencat e tij, në lidhje me shqyrtimin e ankesave dhe kryerjen e hetimit disiplinor. Qëllimi i këtyre afateve është të garantohet zhvillimi i një procedure të rregullt, të parashikueshme dhe pa vonesa të pajustificuara, në funksion të respektimit të të drejtave të magjistratit të hetuar dhe të interesit publik për një sistem drejtësie efikas e të përgjegjshëm.

Në dallim nga neni 117, cituar më sipër, i cili rregullon afatet e parashkrimit material të ndjekjes disiplinore, pra, kufizimin objektiv kohor për ndjekjen e një sjelljeje të caktuar të kaluar, neni 118 rregullon afatet formale të procedurës administrative disiplinore. Këto janë afate të brendshme, që kufizojnë kohën që i duhet ILD-së, për të vepruar në secilën fazë të procesit, pas marrjes së informacionit apo ankesës dhe vendimit për fillimin e hetimit disiplinor.

Më konkretisht kjo dispozitë parashikon katër afate të ndryshme, ku i pari është *“afati 3-mujor për shqyrtimin e ankesës”*, i cili fillon të ecë nga momenti i marrjes së ankesës nga ILD-ja dhe si rregull, brenda këtij afati inspektori duhet të vendosë, nëse do të arkivojë ankesën apo do të fillojë hetimin për shkeljen e pretenduar. Ky afat është shërben si tregues për të ndaluar zvarritjen e shqyrtimit të ankesave të paraqitura dhe për të respektuar të drejtën e subjektit ankues për një përgjigje në kohë.

Megjithatë, tejkalimi i këtij afati nuk është konsideruar problematik nga jurisprudenca, e cila duke i dhënë përgjigje pretendime të ngritura, ka mbajtur qëndrimin se *“Së pari, nisur nga parimi i hetimit kryesisht sipas parashikimeve të nenit 77 të ligjit nr. 44/2015, ILD-ja ka diskrecion të vendosë se çfarë është e nevojshme për t’u shqyrtuar në funksion të vlerësimit të fakteve dhe rrethanave që do t’i nënshtrohen hetimit disiplinor për zgjidhjen e çështjes. Në referim të datave të ankesave për të cilat ka filluar hetimi disiplinor, respektimi i afatit 3-mujor do të përjashtonte nga shqyrtimi ankesën e regjistruar më datë 08.03.2021, me pasojë të mundshme përsëritjen e procedurave që do të duhej të ndiqte ILD-ja, për rrjedhojë me ndikim në eficiencën dhe efektivitetin e zhvillimit të procedimit administrativ.*

Së dyti, neni 109, germa *“b”* i ligjit nr. 44/2015 nuk bën dallim mbi dispozitat e detyrueshme për procedurën administrative, duke paraparë që në

parim të gjitha rregullat e parashikuara kanë të njëjtën rëndësi. Humbja e afatit procedural 3-mujor të përcaktuar nga ligji për arkivimin e kërkesës apo fillimin e procedimit disiplinor, nuk ka sjellë pasojë në përkeqësimin e pozitës së magjistratit e, për rrjedhojë, të ketë cenuar të drejtat e tij të ligjshme dhe as të ketë ndikuar në rezultatin substancial të procedurës, prej tij nuk është ushtruar ankim ndaj këtij vendimi dhe në seancë dëgjimore nuk është pretenduar për ndonjë pasojë të ardhur. Nga ana tjetër, Kolegji evidenton se procedura administrative ka ndjekur kursin e saj normal dhe është përmbyllur me vendimmarrje të ILD-së në një afat më të shkurtër se afati i përcaktuar në ligj. Ligji nr. 96/2016, në nenin 138, paragrafi 4, parashikon se: Këshilli shqyrton të gjithë faktorët që kanë rëndësi për çështjen dhe, në kuptim të kësaj dispozite, nuk merr relevancë shqyrtimi i humbjes së një afati ligjor për shkaqe objektive dhe pa pasoja për palën apo për zhvillimin e procedurës, përkundrejt faktit të përmbylljes së procedurës së hetimit disiplinor në një afat më të shkurtër se ai ligjor”.⁴⁷⁰

Siç rezulton nga ky arsyetim, konkludohet se afati 3-mujor i parashikuar në pikën 1, të nenit 118 të ligjit nr. 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve”, i ndryshuar, ka natyrë organizative, orientuese dhe jo sanksionuese, duke shërbyer si standard për zhvillimin e një procedure efikase dhe në kohë të arsyeshme, por pa sjellë pavlefshmëri të aktit, apo cenim të vlefshmërisë së hetimit në rast tejkalimi. Për aq kohë sa nuk ka pasur pasoja konkrete në pozitat e magjistratit dhe procedura ka ndjekur rrjedhë të rregullt, humbja e këtij afati nuk konsiderohet shkelje, që cenon ligjshmërinë e procesit disiplinor.

Afati tjetër i parashikuara nga norma ligjore është “afati 6-mujor për përfundimin e hetimit”. Pas marrjes së vendimit për fillimin e hetimit disiplinor, ILD ka detyrimin brenda 6 muajve të marrë një vendim për mbylljen e hetimit ose për përfundimin e raportit të hetimit, duke e paraqitur këtë të fundit në një nga Këshillat kompetentë (KLGJ ose KLP). Ky afat llogaritet nga dita kur është marrë vendimi për fillimin e hetimit dhe jo nga momenti i depozitimit të ankesës apo nga momenti i kryerjes së shkeljes së pretenduar.

Në lidhje me respektimin e këtij afati, në jurisprudencë është arsyetuar se “12.4.1. Lidhur me këtë pretendim, Kolegji konstaton se, me vendimin nr. {***}, (JD), datë 16.07.2020, Inspektori i Lartë i Drejtësisë ka vendosur fillimin e hetimit disiplinor ndaj magjistratit B.M., në të cilin është përcaktuar afati 4-mujor për kryerjen e hetimit disiplinor dhe hartimin e raportit. Me vendimin nr. {***}, (JD), datë 11.11.2020, Inspektori i Lartë i Drejtësisë, pas kërkesës së Inspektorese së çështjes, ka vendosur zgjatjen e afatit të hetimit disiplinor me dy muaj të tjerë, vendim i cili i është njoftuar magjistratit B.M., si dhe përfaqësuesve të tyre ligjorë me shkresën nr. {***}, (JD), datë 11.11.2020. Kolegji vëren se vendimi për zgjatjen e hetimit disiplinor, ka mbështetje ligjore nenin 92 të Kodit të Procedurave Administrative, nen i cili nuk bën përjashtim për rastet e zgjatjes

470. Vendimi nr. 1 (JD), datë 20.02.2023 i Kolegjit të Posaçëm të Apelimit.

së afatit të hetimeve administrative, aq më tepër që neni 92 i K. Pr. A. është pjesë e kreut që trajton përfundimin e procedurës administrative, kapitull i cili nuk bën një ndarje ndërmjet procedurave të nisura kryesisht dhe atyre të nisura me kërkesë. Në përfundim, rezulton se ILD-ja e ka respektuar afatin 6-mujor të hetimit disiplinor të parashikuar në nenin 118 të ligjit nr. 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, përpos sa më sipër, zgjatja e hetimeve nuk ka sjellë asnjë pasojë për ankuesin, përkundrazi i ka dhënë atij më shumë kohë që të përgatisë mbrojtjen para këtyre organeve në kuadër të procedimit disiplinor”.⁴⁷¹

Referuar kësaj vendimmarrjeje rezulton se afati 6-mujor për përfundimin e hetimit është me elastike, duke lejuar që hetimi të ndahet në afate më të shkurtra dhe të zgjatet brenda kufirit total 6-mujor, për sa kohë kjo bëhet me vendim të arsyetuar dhe në përputhje me parashikimet e nenit 92 të Kodit të Procedurave Administrative. Mosrespektimi i këtij afati nuk sjell pavlefshmëri të procedurës, sidomos kur nuk ka pasoja për magjistratin dhe kur procedura është zhvilluar në mënyrë të drejtë dhe efektive.

Ligjvënësi është munduar që të mos tregohet i ngurtë dhe të lejojë zgjatjen e afatit të mësipërm, duke parashikuar “afatin shtesë prej 3 muajsh”. Ky është një afat i zgjatshëm vetëm në raste të veçanta dhe për arsye të justifikuara, siç janë kompleksiteti i çështjes, shtimi apo ndryshimi i objektit të hetimit, ose sëmundja/pamundësia e magjistratit për të marrë pjesë në procedurë. Ky afat është diskrecional, por i kufizuar dhe i motivuar dhe në çdo rast nuk mund të tejkalojë kufirin 3-mujor të zgjatjes.

Ligjvënësi ka parashikuar edhe “rihapjen e hetimit pas përfundimit të afateve”, si një mjet për ndjekjen e shkeljeve të pretenduara ndaj një magjistrati. Edhe pse parimi është që procedura duhet të mbyllet brenda afateve të mësipërme, ligji lejon riçeljen e hetimit vetëm nëse dalin prova të reja, që e justifikojnë përdorimin e kësaj mundësie, por me kushtin që të mos jenë tejkaluar afatet e parashkrimit të përcaktuara në nenin 117 të ligjit nr. 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve”, i ndryshuar. Kjo ndërlikohet ndërmjet afateve procedurale (neni 118) dhe atyre materiale (neni 117) krijon një sistem të dyfishtë garancish, ku nuk mjafton vetëm që veprimi i ILD të jetë brenda kohës së parashikuar për hetimin, por edhe që shkelja të mos jetë parashkruar objektivisht në kuptimin disiplinor ose penal.

Për më tepër, neni 118 i jep magjistratit një mjet ankimor, nëse ILD nuk respekton afatet e përcaktuara më sipër, duke e lejuar atë që të ankohet pranë Këshillit përkatës. Kjo dispozitë rrit llogaridhënien e ILD-së dhe garanton mbrojtjen e magjistratit nga procedura të zvarritura apo të papërcaktuara në kohë. Në këto raste, secili Këshill mund të disponojë

471. Vendim nr. 1 (JD), datë 30.05.2022 i Kolegjit të Posaçëm të Apelit.

duke vendosur afate, brenda së cilave ILD-ja duhet të kryejë veprimet e saj, ose edhe të urdhërojë mbylljen e hetimit.

Në përfundim, afatet procedurale të parashikuara për ILD-në nuk janë thjesht teknikalitete, por garanci procedurale, që synojnë të ruajnë ekuilibrin ndërmjet efektivitetit të hetimit disiplinor dhe të drejtave të mbrojtjes të magjistratit. Ndërsa neni 117 vendos kufijtë e përgjegjësisë disiplinore në kohë (parashkrimi), neni 118 sanksionon mënyrën dhe kohëzgjatjen, me të cilën kjo përgjegjësi mund të ndiqet në praktikë nga organi hetues disiplinor. Këto dispozita të harmonizuara janë kyçe për respektimin e shtetit të së drejtës në fushën e disiplinës së magjistratëve.

Në përrupthje më sa më sipër, ankesa pranohet nëse a) paraqitet në formën e përcaktuar, sipas parashikimeve ligjore; b) i referohet fakteve që kanë ndodhur brenda afatit të parashkrimit për hetimin disiplinor; c) nuk përmban elemente abuzive, nuk është haptazi e pabazuar ose e përsëritur nga i njëjti ankues; ç) bëhet ndaj sjelljes së magjistratit, i cili ka qenë në detyrë në kohën kur shkelja e pretenduar ka ndodhur; d) bëhet ndaj sjelljes së magjistratit, të parashikuar si shkelje disiplinore nga ligji në fuqi në kohën kur shkelja e pretenduar ka ndodhur; dh) bëhet ndaj sjelljes së magjistratit që, nëse provohet se është kryer, përbën shkelje disiplinore të parashikuar nga ligji.⁴⁷²

Inspektori i Lartë i Drejtësisë shqyrton fillimisht nëse ankesa është ose jo e pranueshme, sipas kërkesave dhe kriterëve të trajtuara më sipër dhe pas shqyrtimit fillestar të ankesës, bën verifikimin e saj e më tej, mund të vendosë në tre mënyra, ku e para është që të arkivojë ankesën, pasi nuk përmbush një ose më shumë kriterë të parashikuara më sipër,⁴⁷³ e dyta ta verifikojë atë dhe mënyra e tretë, të nisë një hetim disiplinor. Në rastin kur vendoset të arkivohet ankesa, vendimi për arkivimin i njoftohet ankuesit dhe magjistratit brenda afatit të parashikuar në pikën 4, të nenit 119, të këtij ligji. Ankuesi ka të drejtë të ankimojnë këtë vendim në Këshillin përkatës, brenda një jave nga data e marrjes së vendimit të arsyetuar.⁴⁷⁴

Mundësia e dytë që ka ILD-ja është që të verifikojë ankesën.⁴⁷⁵ Kjo mundësi zbatohet nëse Inspektori i Lartë i Drejtësisë konstaton se në ankesë nuk ka informacion të qartë dhe për këtë arsye verifikon nëse ka fakte të mjaftueshme, që të justifikojnë fillimin e hetimit. Ai mund t'i kërkojë ankuesit të paraqesë dokumente shtesë, ose të japë shpjegime për mënyrën dhe rrethanat, në të cilat ka ndodhur shkelja e pretenduar. Gjithashtu Inspektori i Lartë i Drejtësisë mund të marrë çdo informacion tjetër nga Këshilli, Gjykata ose Prokuroria përkatëse. Pas këtyre veprimeve,

472. Ligji nr. 96/2016, neni 120, pika 1.

473. Ligji nr. 96/2016, neni 121, pikat 1 dhe 2, germa "a".

474. Ligji nr. 96/2016, neni 121, pika 3.

475. Ligji nr. 96/2016, neni 121, pika 2, germa "b".

në rast se nuk ka fakte të mjaftueshme për të justifikuar fillimin e hetimit, ankesa arkivohet. Vendimi i arsyetuar për arkivimin e ankësës i njoftohet ankuesit dhe magjistratit ndaj të cilit është paraqitur ankesa. Ankuesi ka të drejtë të ankimojë këtë vendim në Këshillin përkatës, brenda një jave nga marrja e njoftimit të vendimit të arsyetuar.⁴⁷⁶

Mundësia e tretë është ajo e fillimit të hetimit disiplinor.⁴⁷⁷ Inspektori i Lartë i Drejtësisë fillon hetimin disiplinor, nëse ka dyshime të arsyeshme se shkelja mund të jetë kryer, bazuar në faktet dhe provat e mbledhura, që justifikojnë fillimin e hetimit. Nga praktika e ILD-së rezulton se kur shkelja e pretenduar lidhet me çështje në proces në gjykatë ose në prokurori, hetimi duhet të jetë i tillë, që të mos cenohet pavarësinë e magjistratit në gjykimin dhe hetimin e tyre dhe të mos konsiderohet si ndërhyrje. Në një rast të tillë Inspektori i Lartë i Drejtësisë pezullon hetimet, por nëse shkelja e pretenduar ka të bëjë me fakte që nuk lidhen me ato për të cilat do të vendoset nga hetimi penal ose procesi penal, civil ose administrativ vazhdon me hetimin.⁴⁷⁸

Vendimi i arsyetuar për fillimin e hetimit i njoftohet ankuesit, magjistratit, Këshillit respektiv dhe duhet të përmbajë të paktën: a) emrin e inspektorëve të ngarkuar me hetimin; b) objektin e hetimit, duke treguar shkeljen e dyshuar; c) parashtrimin e rrethanave të faktit të pretenduara; ç) provat e mbledhura; d) periudhën kohore përkatëse për hetimin; dh) parashtrimin e të drejtave të magjistratit në lidhje me hetimin disiplinor, si dhe të drejtën e magjistratit dhe të ankuesit për të dorëzuar parashtrësë dhe dokumente mbështetëse, brenda tre javëve nga marrja e vendimit. Në këto raste jurisprudenca ka theksuar, se vetë magjistrati duhet të jetë aktiv duke paraqitur kërkesë dhe argumentuar, se cilat prova duhet dhe mund të merren nga ILD-ja.⁴⁷⁹ Në rastet kur shkelja ka të bëjë me sjellje

476. Ligji nr. 96/2016, neni 122.

477. Ligji nr. 96/2016, neni 121, pika 2, germa "c".

478. Ligji nr. 96/2016, neni 130.

479. Vendim nr. 2 (JD), datë 24.10.2023 i Kolegjit të Posaçëm të Apelimit: 12.1.2 Në vlerësim të sa më sipër, Kolegji çmon se pretendimi i magjistrates për mosmarrjen e provave kryesisht të kërkuara ILD-së gjatë hetimit disiplinor, nuk bazohet në fakte, sa kohë rezultoi që dy prej pesë urdhrave për të cilët ngrihet ky pretendim, janë bërë pjesë e fashikullit të hetimit disiplinor dhe kanë qenë në dispozicion edhe të KLP-së, në funksion të vendimmarrjes së saj në kuadër të procedimit disiplinor të nisur ndaj magjistrates. Ndërkohë që, sa u takon tre urdhrave të tjerë, të depozituar për herë të parë në Kolegj, së bashku me ankimin e ushtruar ndaj vendimit të KLP-së nr. 20, (JD), datë 31.01.2023, nuk rezultoi që ata të jenë kërkuar të merren në cilësinë e provës, apo lidhur me ta të jetë refuzuar marrja si provë nga ana e ILD-së apo KLP-së. Në këto kushte, Kolegji, duke mbajtur në konsideratë edhe faktin se akti i njoftimit nga ana e Inspektorit të Lartë të Drejtësisë lidhur me vendimin e këtij të fundit nr. {***} prot., (JD), datë 28.08.2021, "Për fillimin e hetimit disiplinor ndaj magjistrates B. Z., me detyrë prokurore pranë [...] ka respektuar kërkesat ligjore të përcaktuara në nenin 123, pika 3, germa "dh" të ligjit nr. 96/2016, i ndryshuar, duke i bërë të ditur magjistrates B. Z., të drejtat e

ose veprime të përsëritura, objekti i hetimit përmban sjelljet e magjistratit në rastet e tjera, në lidhje me të njëjtën situatë brenda periudhës kohore të përcaktuar në vendimin për fillimin e hetimit, në mënyrë që të verifikohet nëse janë vërejtur sjellje të tilla apo të përsëritura.⁴⁸⁰

Mundësia tjetër e fillimit të një hetimi disiplinor është *kryesisht*, me iniciativën e Inspektorit të Lartë të Drejtësisë. Në këtë rast hetimi fillon bazuar në të dhëna thelbësore mbi fakte, që rezultojnë nga burime të besueshme, mbi bazën e të cilave lind dyshimi i arsyeshëm se shkelja mund të jetë kryer. Informacionet që përftohen nga media ose nga ankues anonimë mund të shërbejnë si indicie për të filluar një hetim kryesisht, nëse përmbushen kriteret e pranueshmërisë së ankesës, që paraqesin subjektet e ndryshme, të trajtuar më sipër. Inspektori i Lartë i Drejtësisë vendos me vendim të arsyetuar për fillimin e hetimit me iniciativën e tij, duke parashtruar rrethanat faktike të verifikueshme, duke marrë dhe vendimin përkatës me të dhënat e trajtuar më sipër.⁴⁸¹

Kjo e drejtë për të nisur hetimin disiplinor kryesisht është pranuar edhe nga jurisprudenca, e cila ka mbajtur qëndrimin se *“12.3 Lidhur me pretendimin e magjistratit se ky hetim nuk duhej të fillonte, pasi ligji material ia kufizon fillimin e kësaj procedure, pasi veprimtaria objekt gjykimi nuk konsiderohet shkelje nga ligji material nr. 96/2016, Kolegji vlerëson se pretendimi i magjistratit nuk qëndron, pasi fillimi i procedurës hetimore të kryer nga ILD-ja është i parashikuar në nenin 124 të ligjit nr. 96/2016, ku përcaktohet se Inspektori i Lartë i Drejtësisë fillon hetimin me iniciativën e tij, bazuar në të dhëna thelbësore mbi fakte që rezultojnë nga burime të besueshme, mbi bazën e të cilave lind dyshimi i arsyeshëm se shkelja mund të jetë kryer. Informacionet që përftohen nga media ose nga ankues anonimë mund të shërbejnë si indicie për të filluar një hetim kryesisht nëse përmbushen kriteret e parashikuara në nenin 120, pika 1, shkronjat “b”, “ç”, “d” dhe “dh”. Pra, Inspektori i Lartë i Drejtësisë ka pasur të gjithë kompetencën dhe bazën ligjore për të nisur procedimin disiplinor ndaj ankuesit B. M.”*⁴⁸²

Megjithëse, nuk parashikohej fillimisht nga ligji nr. 96/2016 *“Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve”*, i ndryshuar, legjislacioni i mëparshëm mbi organizimin gjyqësor e parashikonte mundësinë e verifikimit të pasurisë, në një procedurë disiplinore, siç edhe e kemi cituar më sipër. Për këtë arsye, me reformën e vitit 2020, u shtua edhe neni 124/1 titulluar *“Verifikimi i pasurisë dhe figurës”*. Sipas kësaj dispozite Inspektori i Lartë i Drejtësisë, brenda një jave nga vendimi për fillimin e hetimeve,

saj gjatë kësaj procedure, ndër to edhe të drejtën për të dorëzuar parashitresa dhe dokumente mbështetëse, e çmoi pretendimin e saj për mos marrjen e provave kryesisht të kërkuara ILD-së gjatë hetimit disiplinor, të pabazuar në fakte.

480. Ligji nr. 96/2016, neni 123.

481. Ligji nr. 96/2016, neni 124.

482. Vendim nr. 1 (JD), datë 30.05.2022 i Kolegjit të Posaçëm të Apelit.

sipas rasteve të mësipërme, qoftë me ankesë, qoftë edhe me iniciativë, kërkon informacion nga Inspektorati i Lartë i Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive dhe Konfliktit të Interesave, prokuroria, Policia e Shtetit, organet e administratës tatimore dhe doganore, inteligjenca financiare, Byroja Kombëtare e Hetimit, shërbimet shtetërore informative, nga çdo organ disiplinor që ka mbikëqyrur disiplinën në marrëdhëniet e punës të magjistratit, si dhe çdo institucion tjetër kompetent për verifikimin e pasurisë dhe të figurës në lidhje me çdo shkelje tjetër disiplinore. Inspektori i Lartë i Drejtësisë mund të kërkojë informacion shtesë nga këto institucione, si dhe nga çdo institucion tjetër publik apo subjekt privat. Çdo institucion publik apo subjekt privat duhet të përmbushë kërkesat e Inspektorit të Lartë të Drejtësisë për informacion, dokumentacion, ose materiale të tjera në lidhje me një hetim, brenda afatit ligjor të arsyeshëm të përcaktuar nga Inspektori i Lartë i Drejtësisë në kërkesën e tij, me përjashtim të rasteve të kufizuara me ligj. Inspektori i Lartë i Drejtësisë në rast se nga verifikimi i pasurisë dhe figurës rezulton se ka dyshime të arsyeshme për kryerjen e ndonjë shkeljeje tjetër disiplinore, përveç rastit kur shkelja përbën vepër penale, merr vendim për të shtuar ose ndryshuar objektin e hetimit.⁴⁸³ Nga këto parashikime rezulton se verifikimi i pasurisë dhe i figurës, mund të bëhet vetëm, pasi më parë është marrë vendimi për fillimin e hetimit disiplinor. Nëse nga gjetjet që rezultojnë elementë, që tregojnë për konsumim të ndonjë vepre penale, atëherë ILD është e detyruar të bëjë kallëzim. Nëse nga këto verifikime rezultojnë gjetje, që tregojnë për shkelje të tjera disiplinore, atëherë ILD shton ose ndryshon objektin e hetimit disiplinor

Në rastin e mësipërm, por edhe në raste të tjera, që nuk kanë të bëjnë me verifikimin e pasurisë dhe të figurës gjatë hetimit disiplinor, ngrihen dyshime të arsyeshme se ka ndodhur një shkelje tjetër, Inspektori i Lartë i Drejtësisë merr vendim për të shtuar ose ndryshuar objektin e hetimit. Në këto raste ILD vepron me iniciativën e vet dhe vendimmarrja e tij do të duhet që të përmbajë, për aq sa është e mundur, të dhënat dhe elementët që kërkohen për rastet kur vendoset fillimi i hetimit disiplinor, që kemi trajtuar më sipër.⁴⁸⁴

Gjatë kësaj procedure, Inspektori i Lartë i Drejtësisë vendos pezullimin e hetimit disiplinor, kur është duke u zhvilluar hetim penal ose një proces gjyqësor penal, administrativ ose civil nëse plotësohen dy kushte, ku *së pari* njëra nga palët në këto procese është magjistrati, që po hetohet disiplinarisht dhe *së dyti* shkelja e dyshuar lidhet me të njëjtat fakte, për të cilat do të merret vendimi.⁴⁸⁵ Këto dy kushte nuk mund të trajtohen si rrethana alternative, pasi secila prej tyre e marrë veçmas, nuk

483. Ligji nr. 96/2016, neni 124/1.

484. Ligji nr. 96/2016, neni 125.

485. Ligji nr. 96/2016, neni 126, pika 1.

përmbush qëllimin e plotë të pezullimit. Qëllimi i ligjvënësit nuk është thjesht të pezullojë një hetim disiplinor për shkak të ekzistencës së një procesi tjetër gjyqësor ku magjistrati është palë, por të shmangë rrezikun e vendimmarrjes së parakohshme apo të vendimeve të ndryshme, por në konflikt me njëri-tjetrin dhe që mbështeten mbi të njëjtën bazë faktike.

Nëse do të mjaftonte vetëm kushti i parë, që magjistrati është palë në një proces tjetër, pezullimi si institut do të mund të përdorej si një instrument formal për shtyrjen apo bllokimin e hetimit disiplinor, edhe kur fakti që shqyrtohet nuk ka lidhje me atë proces. Nga ana tjetër, nëse do të merrej si i mjaftueshëm vetëm fakti, që shkela ka lidhje me të njëjtat rrethana, por magjistrati nuk është palë në atë proces, atëherë do të mungonte elementi i rrezikut të konfliktit procedural apo të shkeljes së të drejtës së mbrojtjes, që është thelbësor për pezullimin.

Vetëm bashkimi i të dyja kriterëve, pra që magjistrati është palë në një proces tjetër dhe që procesi ka të njëjtën bazë faktike me hetimin disiplinor, justifikon ndërprerjen e përkohshme të hetimit, pasi vetëm në këtë konfigurim ekziston rreziku i cenimit të parimit të *“non bis in idem”* (jo e njëjta gjë dy herë), i konfliktit midis vendimeve të ndryshme apo i ndikimit të një procesi, në thelbin e një procesi tjetër.

Për pasojë formulimi ligjor që kërkon përmbushjen e këtyre dy kushteve njëkohësisht, nuk është i rastësishëm, por ndërton një standard të dyfishtë garantues, i cili kërkon ekzistencën kumulative të të dyja kushteve, duke i shërbyer balancës ndërmjet të drejtës për mbrojtje të magjistratit dhe interesit publik për ndjekjen e shpejtë dhe efektive të përgjegjësisë së tij disiplinore.

Ligji parashikon se hetimi pezullohet deri në dhënien e vendimit të formës së prerë të institucionit kompetent. Ankuesi, magjistrati, gjykata, prokuroria dhe secili prej Këshillave njoftohen me shkrim për vendimin e pezullimit. Gjykata, prokuroria e interesuar ose institucione të tjera, i dërgojnë Inspektorit të Lartë të Drejtësisë pa vonesë, çdo vendim që merret gjatë hetimit dhe procesit përkatës. Inspektori i Lartë i Drejtësisë i referohet vetëm fakteve mbi të cilat bazohet vendimi i formës së prerë i gjykatës. Vendimi i formës së prerë i gjykatës në favor të magjistratit nuk pengon hetimin nga Inspektori i Lartë i Drejtësisë për të përcaktuar përgjegjësinë disiplinore të magjistratit. Me qëllim që pezullimi si institut, të mos shërbejë për shmangien nga përgjegjësia disiplinore e magjistratit, ligji parashikon që pezullimi i hetimeve ndërpret afatet e parashkrimit për Inspektorin e Lartë të Drejtësisë. Kjo vendimarrje është në diskrecionin e ILD-së dhe nuk ankimohet.⁴⁸⁶

Në çdo fazë të procedurës së hetimit, Inspektori i Lartë i Drejtësisë informon Këshillin përkatës, lidhur me faktet që sjellin pezullim të detyrueshëm të magjistratit, ose mund të kërkojë vetë pezullimin e

486. Ligji nr. 96/2016, neni 126, pikat 2 – 6.

magjistratit, sipas parashikimeve ligjore që do të trajtohen në vijim.⁴⁸⁷

Gjatë fazës së hetimit disiplinor, Inspektori i Lartë i Drejtësisë bashkon procedimet, në rastet kur konstaton se ankesat ose hetimet e filluara u referohen të njëjtave fakte ose të njëjtit magjistrat.⁴⁸⁸ Jurisprudenca, për këtë parashikim është shprehur se ajo mbulon çdo situatë, përfshirë edhe kur faktet e ndryshme për të njëjtin magjistrat, vijnë në forma të ndryshme, si nga ankesat apo inspektimet tematike. Më konkretisht, Kolegji i Posaçëm i Apelit ka mbajtur qëndrimin se “32.4 Në këto kushte, Kolegji çmon se pavarësisht se hetimi disiplinor mund të ketë filluar me ankesë të një prej subjekteve që e kanë këtë të drejtë, legjislacioni nuk e përjashton rastin që dhe Inspektori i Lartë i Drejtësisë, bazuar në të dhëna dhe prova të mëtejshme të bashkohet me iniciativë për fillimin e hetimit. Në nenin 128 të ligjit nr. 96/2016 parashikohet se: “Inspektori i Lartë i Drejtësisë bashkon procedimet, në rastet kur konstaton se ankesat ose hetimet e filluara u referohen të njëjtave fakte ose të njëjtit magjistrat”. Përdorimi i të dhënave që vijnë jo vetëm nga ankesa e Ministrit të Drejtësisë, por edhe nga rezultatet e inspektimit tematik, nuk konsiderohet se shkel ndonjë të drejtë të magjistratit, përderisa, për të gjitha gjetjet ai i nënshtrohet hetimit disiplinor, përgjatë të cilit ai gëzon të gjithë të drejtat e parashikuara nga ligji. Kolegji vlerëson se ligji ka lënë në diskrecion të ILD-së, se mbi ç’bazë do të nisë hetimin disiplinor, duke pasur si qëllim që ky organ të ushtrojë të gjithë kompetencat e tij ligjore për të garantuar evidentimin dhe ndjekjen disiplinore të magjistratëve, të cilët rezultojnë se shkelin ligjin përgjatë veprimtarisë së tyre”.⁴⁸⁹

Gjatë hetimit disiplinor magjistrati është palë në proces, që nga momenti i fillimit të hetimit dhe i garantohet aksesit në dosjen e hetimit, në atë masë që është në përputhje me objektin e hetimit. Inspektori i Lartë i Drejtësisë mund të kërkojë nga magjistrati informacion, dokumente ose çdo provë që është e nevojshme për hetimin. Inspektori i Lartë i Drejtësisë i njofton magjistratit të interesuar ose përfaqësuesit të tij, vendimin për arkivimin e ankesës, për fillimin hetimit, shtimin ose ndryshimin e objektit të tij, si dhe mbylljen e hetimit, brenda pesë ditëve nga marrja e vendimit përkatës.⁴⁹⁰

Këto të drejta të magjistratit dhe detyrimet që rëndojnë mbi ILD-në gjatë hetimit disiplinor janë shtrirë edhe në detyrimin për të dorëzuar raportin e hetimit, në rastet kur paraqitet kërkesa për procedim disiplinor, siç ka arsyetuar jurisprudenca se “34.3 Lidhur me sa më sipër, Kolegji tërheq vëmendjen se pavarësisht se dispozitat e ligjit nr. 96/2016 nuk parashikojnë shprehimisht detyrimin e ILD-së për të vënë në dispozicion të magjistratit Raportin e Hetimit, në nenin 129, pika 1 të ligjit është parashikuar

487. Ligji nr. 96/2016, neni 127.

488. Ligji nr. 96/2016, neni 128.

489. Vendim nr. 3 (JD), datë 07.12.2022 i Kolegjit të Posaçëm të Apelit.

490. Ligji nr. 96/2016, neni 129.

se magjistratit, si palë në proces, i garantohet aksesimi në dosjen e hetimit, që nga momenti i fillimit të hetimit dhe në atë masë që është në përputhje me objektin e hetimit. Njohja e magjistratit me dosjen e hetimit, pra, me të gjithë provat dhe dokumentacionin mbi të cilin justifikohet fillimi i hetimit dhe propozohet marrja e masës disiplinore, është me rëndësi në kuadër të respektimit të barazisë së armëve në një proces të rregullt ligjor. Edhe Raporti i Hetimit, pavarësisht mungesës së detyrimit ligjor eksplicit për njoftimin e tij, si pjesë e dokumentacionit të hetimit dhe si akti përfundimtar duhet t'i njoftohet magjistratit, i cili ka të drejtë të njihet me rezultatet e procesit të hetimit ndaj tij për realizimin e një mbrojtjeje efektive në vazhdim të procedimit disiplinor".⁴⁹¹

Përsa i përket ecurisë së hetimit disiplinor, legjislacioni i njeh të drejtën Inspektorit të Lartë të Drejtësisë që të thërrasë dëshmitarë dhe mbledhë të dhëna, dokumente dhe prova nga gjykata, prokuroria, institucione publike apo subjekte private, dëshmitarë dhe/ose magjistrati, si edhe të ndërmarrë veprime të nevojshme për të hetuar dhe përcaktuar nëse shkelja e pretenduar ka ndodhur. Kur shkelja e pretenduar lidhet me çështje në proces në gjykatë ose në prokurori, hetimi duhet të jetë i tillë, që të mos cenohet pavarësinë e magjistratit në gjykimin dhe hetimin e tyre dhe të mos konsiderohet si ndërhyrje. Në një rast të tillë Inspektori i Lartë i Drejtësisë pezullon hetimet, por nëse shkelja e pretenduar ka të bëjë me fakte që nuk lidhen me ato për të cilat do të vendoset nga hetimi penal ose procesi penal, civil ose administrativ vazhdon me hetimin.⁴⁹²

Ligji është kujdesur që të rregullojë edhe mënyrën e marrjes në pyetje të magjistratit, dëshmitarëve ose personave të tjerë paraqet rëndësi për hetimin. Në këto raste ILD i njofton ata lidhur me kohën dhe vendin e seancës së marrjes në pyetje dhe ka për detyrë të sigurojë që seanca e marrjes në pyetje të regjistrohet në audio, duke respektuar kriteret vijuese, a) personi që merret në pyetje duhet të informohet se seanca përkatëse do të regjistrohet në audio; b) regjistrimi duhet të përmbajë gjeneralitetet e personave që janë thirrur për t'u pyetur; c) në rast ndërprerjeje të seancës së marrjes në pyetje, përpara se regjistrimi audio të përfundojë, regjistrohet ora, shkaku i ndërprerjes, si dhe ora e rifillimit të seancës; ç) në përfundim të seancës, personi i marrë në pyetje mund të saktësojë çdo gjë që ka deklaruar, si dhe të shtojë gjithçka që vlerëson. Më kërkesën e personit të marrë në pyetje, regjistrimi dëgjohet, si dhe regjistrohen korrigjimet dhe shpjegimet e tij në lidhje me deklaratimet e mëparshme. Në mbarim të seancës së marrjes në pyetje, regjistrohet ora e përfundimit të saj. Regjistrimi audio i seancës së marrjes në pyetje duhet të përmbledhet në procesverbal, si dhe mund të transkribohet. Magjistrati nënshkruan procesverbalin e marrjes në pyetje, si dhe transkriptimin e regjistrimit audio nëse është bërë i mundur. Regjistrimi audio, transkriptimi i tij,

491. Vendim nr. 3 (JD), datë 07.12.2022 i Kolegjit të Posaçëm të Apelit

492. Ligji nr. 96/2016, neni 130.

nëse është bërë i mundur, si dhe procesverbali i seancës së marrjes në pyetje bëhen pjesë e dosjes.⁴⁹³

Për marrjen e provave që ndodhen në institucione të tjera, ligji parashikon që çdo organ publik, person fizik ose juridik duhet të zbatojë kërkesat e Inspektorit të Lartë të Drejtësisë për marrje informacioni, dokumente ose prova të tjera që lidhen me hetimin, brenda afateve kohore të arsyeshme, të përcaktuara nga inspektori në kërkesën e tij, me përjashtim të rasteve kur dhënia e tyre është e kufizuar me ligj. Nëse gjatë hetimit disiplinor të magjistratit ekzistojnë nevoja thelbësore dhe specifike për të marrë dokumente, informacione, regjistrime telefonike ose prova të tjera, të cilat mbrohen nga garancitë për konfidencialitet ose mbrojtjen e të dhënave personale, Inspektori i Lartë i Drejtësisë mund t'i kërkojë Gjykatës së Posaçme për gjykimin e veprave penale të korrupsionit dhe krimit të organizuar, lëshimin e një urdhri për dhënien e informacionit të kërkuar për magjistratin. Kërkesa duhet të përmbajë ekzistencën e dyshimit të arsyeshëm se magjistrati ka kryer shkeljen, si dhe se informacioni i kërkuar është thelbësor për të përcaktuar nëse shkelja ka ndodhur. Inspektori i Lartë i Drejtësisë përsërit kërkesën, në rastin kur personi ose subjekti, të cilit i drejtohet kjo kërkesë, nuk e përmbush atë brenda afatit të caktuar, duke informuar në rastin e personit juridik edhe drejtuesin e tij. Në rastin kur personi ose subjekti, të cilit i drejtohet kjo kërkesë, nuk përmbush kërkesën e përsëritur brenda afatit të caktuar, Inspektori i Lartë i Drejtësisë mund të vendosë gjobë deri në 100 000 lekë, si dhe njofton organin përgjegjës disiplinor. Urdhri për vendosjen e gjobës është titull ekzekutiv. Shërbimi përmbarimor ngarkohet me ekzekutimin e vendimit përkatës. Kundër vendimit për gjobitje, mund të ushtrohet ankim në Këshillin përkatës brenda 24 orëve nga marrja dijeni e tij.⁴⁹⁴ Siç mund të konstatohet ky afat është shumë i shkurtër, por synon që të garantojë efektivitetin e procedurës hetimore që ndjek ILD.

Më tej legjislacioni në fuqi parashikon, që çdo veprim hetimor i kryer nga ILD duhet të dokumentohet në mënyrë të detajuar me procesverbal, i cili përmban të dhëna të identifikueshme si emri i inspektorit, data e veprimit, objektin dhe subjektin e veprimit, pjesëmarrësit, përshkrimin e veprimit dhe nënshkrimet përkatëse.⁴⁹⁵ Në përfundim të hetimit, ILD harton raportin e hetimit, i cili duhet të përfshijë, jo vetëm përmbledhjen e veprimeve të kryera dhe deklaratat e marra, por edhe analizën ligjore të fakteve, vlerësimin e provave dhe propozimin për mbyllje apo për fillimin e procedimit disiplinor me caktimin e masës disiplinore.⁴⁹⁶

Legjislacioni rregullon edhe mbylljen formale të hetimit, në rastet kur

493. Ligji nr. 96/2016, neni 131.

494. Ligji nr. 96/2016, neni 132.

495. Ligji nr. 96/2016, neni 133, pikat 1 – 2.

496. Ligji nr. 96/2016, neni 133, pika 3.

pretendimet janë të pabazuara ose provat e mbledhura nuk mbështesin fillimin e një procedimi disiplinor. Ligji përshkruan rastet konkrete kur hetimi duhet të mbyllet, si mungesa e provave të mjaftueshme, çështja është gjykuar më parë, ka kaluar afati i parashkrimit, magjistrati ka humbur statusin ose ka ndërruar jetë.⁴⁹⁷ Vendimi i ILD-së për mbylljen e hetimit duhet të jetë i arsyetuar dhe t'u njoftohet palëve, përfshirë magjistratin, ankuesin dhe Këshillin përkatës, duke sanksionuar edhe të drejtën e ankuesit për ankim brenda një jave.⁴⁹⁸

Ligji parashikon gjithashtu një rregull specifik për rastet kur magjistrati del në pension, ku kërkohet hartimi i një raporti përmblyllës informues, i cili përmban përmbledhje të pretendimeve për shkeljen disiplinore, provat e mbledhura dhe konkluzionet, por nuk vijohet me procedimin disiplinor.⁴⁹⁹ Së fundmi, faktet që nuk ngrihen në nivel shkeljeje disiplinore, por që kanë vlerë për qëllime të procesit të vlerësimit etik apo profesional, duhet t'i dërgohen Këshillit përkatës për vlerësim të mëtejshëm të magjistratit.⁵⁰⁰

Gjatë kësaj faze, ligjvënësi i ka krijuar një mundësi magjistratit, që të arrijë në marrëveshje me Inspektorin e Lartë të Drejtësisë. Ky akt i quajtur "Marrëveshja e përbashkët e pranimi", e parashikuar nga neni 135 i ligjit nr. 96/2016 "*Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve*", i ndryshuar, përfaqëson një instrument procedural vullnetar, i cili i mundëson Inspektorit të Lartë të Drejtësisë dhe magjistratit, që në çdo moment të hetimit ose procedimit disiplinor, të bien dakord për njohjen e shkeljes disiplinore dhe për masën disiplinore, që do të zbatohet ndaj magjistratit. Ky mekanizëm ka si synim përshpejtimin, racionalizimin dhe efikasitetin e këtij procesi, si dhe shmangien e një procesi disiplinor të gjatë e formal, kur palët pranojnë fakte dhe vlerësimet e bëra pa kundërshtime.

Kjo marrëveshje hartohet me shkrim, nënshkruhet nga të dyja palët dhe duhet të përfshijë detyrimisht një përmbledhje të fakteve dhe shkeljes së pranuar; masën disiplinore të propozuar; si dhe një deklaratë të vetëdijshme të magjistratit se marrëveshja kërkon miratim nga Këshilli përkatës.⁵⁰¹ Pra, siç rezulton, kjo marrëveshje nuk ka efekt të drejtpërdrejtë, por duhet të miratohet, sipas rastit, nga Këshilli i Lartë Gjyqësor, ose Këshilli i Lartë i Prokurorisë, i cili verifikon në mënyrë të pavarur, nëse marrëveshja është nënshkruar rregullisht dhe përmban të gjitha elementët formalë; nëse magjistrati e ka kuptuar përmbajtjen dhe ka shprehur vullnetin e lirë për të, si edhe nëse masa disiplinore

497. Ligji nr. 96/2016, neni 134, pika 1.

498. Ligji nr. 96/2016, neni 134, pika 2.

499. Ligji nr. 96/2016, neni 134, pika 3.

500. Ligji nr. 96/2016, neni 134, pika 4.

501. Ligji nr. 96/2016, neni 135, pika 4.

është në përputhje me dispozitat ligjore.⁵⁰² Qëllimi i këtij verifikimi është i dyfishtë, ku nga njëra anë, që magistratët të mos pranojnë fajësi për shkelje të ndryshme të pretenduara, pa vullnetin e tyre të lirë, por nga ana tjetër edhe të mos i shpëtojnë përgjegjësisë disiplinore, kur ajo është e rëndë, duke lidhur pikërisht marrëveshje me ILD dhe duke pranuar fajësinë, por ndëshkime më të lehta, në raport me shkeljen e kryer.

Secili prej Këshillave ka të drejtë të refuzojë marrëveshjen, nëse konstatohet mungesë e kushteve të mësipërme, ose kur ajo rezulton në mospërputhje me provat e çështjes, apo kur dyshohet se është arritur nën presion, apo në mënyrë jo të sinqertë.⁵⁰³

Referuar praktikës së krijuar, rezulton në një rast se marrëveshja u hartua rregullisht nga palët, duke përfshirë të gjitha elementët formalë dhe deklaratimet e qarta të vullnetit të lirë të magistrates E. K.⁵⁰⁴ Masa e dakordësuar, pezullimi nga detyra për 6 muaj me të drejtë page minimale, u vlerësua si në përputhje me ligjin, me natyrën e shkeljes dhe me kriteret e tjera të neneve 110 dhe 115 të ligjit nr. 96/2016 *“Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve”*, i ndryshuar. Këshilli i Lartë Gjyqësor verifikoi se nuk kishte kundërshtim mes provave dhe deklaratimeve të magistrates, si dhe që marrëveshja nuk ishte produkt presioni, për pasojë e miratoi marrëveshjen dhe ajo mori formën e një vendimi të formës së prerë.⁵⁰⁵

Për natyrën e kësaj marrëveshje, Kolegji i Posaçëm i Apelit ka

502. Ligji nr. 96/2016, neni 135, pika 5.

503. Ligji nr. 96/2016, neni 135, pika 6.

504. Sipas raportit hetimor, Inspektori i Lartë i Drejtësisë duke mbajtur në konsideratë një sërë rrethanash, të cilat nuk kanë ekzistuar gjatë zhvillimit të procedimit disiplinor fillestar, të cilat diktojnë dakordësimin dhe nënshkrimin e marrëveshjes së përbashkët të pranimit ndërmjet magistrates E. K., dhe Inspektorit të Lartë të Drejtësisë, si: 1. Paraqitjen e kërkesës nga ana e magistrates subjekt hetimi disiplinor për dakordësimin dhe nënshkrimin e marrëveshjes së përbashkët të pranimit sipas kërkesave të nenit 135 të ligjit nr. 96/2016 *“Për statusin e gjyqtarëve dhe të prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”*, i ndryshuar; 2. Pranimin nga ana e magistrates subjekt hetimi disiplinor të kryerjes së shkeljes disiplinore parashikuar nga neni 103, paragrafi 1, germa “dh” të ligjit nr. 96/2016, *“Për statusin e gjyqtarëve dhe të prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”*, të ndryshuar, si dhe shkelje të Kodit të Etikës Gjyqësore të miratuar nga Këshilli i Lartë Gjyqësor me vendimin nr. 171, datë 22.04.2021, Seksionit “C”, *“Parimi i integritetit”*, gjerat “a” dhe “b”, Seksioni “Ç”, *“Parimi i sjelljes së hijshme dhe me vetëpërmbytje”*, pika 9, germa “c”; 3. Shprehjen e pëlqimit dhe dakordësimin e marrëveshjes së përbashkët të pranimit ndërmjet magistrates E. K., dhe Inspektorit të Lartë të Drejtësisë lidhur me rrethanat e faktit, llojin e shkeljes disiplinore, rëndësisë së shkeljes disiplinore, apo llojin e masës së disiplinore;

Ka vendosur nënshkrimin e marrëveshjes së përbashkët të pranimit e cila përmban të gjithë elementët e nevojshëm të parashikuara në pikën 4, të nenit 135 të ligjit nr. 96/2016 *“Për statusin e gjyqtarëve dhe të prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”*, i ndryshuar.

505. Vendimi nr. 6, datë 17.01.2022 i Këshillit të Lartë Gjyqësor.

mbajtur qëndrimin, se “30.7 Nga përmbajtja e dispozitës, si dhe përfshirja e saj në kreun për procedurat hetimore, rezulton se marrëveshja e përbashkët e pranimit është një procedurë që mundësohet kryesisht gjatë fazës së hetimit disiplinor. Edhe parashikimi në pikën 9, të nenit 135 të ligjit nr. 96/2016, e lidh refuzimin e kësaj marrëveshjeje, në kuadrin e veprimeve që kryhen gjatë hetimit disiplinor. Roli i KLGJ-së në këtë fazë, është ai i “certifikuesit” të kësaj marrëveshjeje, pasi ka vlerësuar përmbushjen e kriterëve formale dhe ligjore. Por parashikimi në pikën 1, të nenit 135 – në çdo kohë mund të dakordësojnë marrëveshjen – në një interpretim të zgjeruar, mundëson që me dakordësinë të dy palëve, kjo marrëveshje të lidhet dhe në faza të mëvonshme, gjatë procedimit disiplinor.

30.8 Për sa i përket formalizimit të kërkesës për marrëveshje, Kolegji çmon se nga pala kërkuese e marrëveshjes, nga ankuesja dhe përfaqësuesi i saj ligjor, duhet të ishte vepruar në drejtim të paraqitjes së një kërkesë zyrtare me shkrim ndaj ILD-së, në përmbajtje të së cilës, sipas elementeve të parashikuara në nenin 135, pika 4 të ligjit nr. 96/2016, të kishte një përmbledhje të fakteve dhe shkeljeve që pranohen nga magjistratja, qëndrimin për këto shkelje, si dhe propozimin e masës disiplinore. Pavarësisht fazës procedurale në të cilën ndodhej shqyrtimi i çështjes, ankuesja dhe përfaqësuesi i saj ligjor duhej t’i drejtoheshin paralelisht me një kërkesë formale ILD-së për paraqitjen e propozimit për marrëveshje. Duke mos vepruar vetë në drejtim të formalizimit të kërkesës, ankuesja nuk mund të pretendojë mosrespektimin e hapave proceduralë dhe mungesën e etikës së raporteve midis palëve në proces, në mospranimin e kërkesës së saj për marrëveshje.

30.9 Në konkluzion të sa më sipër, Kolegji vlerëson se pretendimi i ankuseses, se duke mos iu marrë në konsideratë kërkesa për marrëveshje, i është cenuar standardi i procesit të rregullt, është i pabazuar. Marrëveshja e pranimit është një mundësi që ligji i jep magjistratit për të thjeshtuar procedimin disiplinor ndaj tij, me qëllim zhvillimin e një procedure administrative sa më të shpejtë dhe efektive. Por marrëveshja e përbashkët e pranimit gjithashtu, është një akt që kërkon dhe reflekton vullnetin e të dy palëve, të ILD-së dhe të magjistratit. Mungesa e dakordësisë për marrëveshje nuk prek të drejtat e magjistratit në drejtim të cenimit të standardeve të procesit të rregullt të magjistratit, për sa kohë që procesi i rregullt garantohet në të gjitha elementet e tij, gjatë gjithë fazave të hetimit dhe procedimit disiplinor. Gjithashtu, Kolegji sjell në vëmendje se realizimi i marrëveshjes midis palëve nuk sjell shmangien nga përgjegjësia disiplinore të magjistratit, pasi kushtet e marrëveshjes përcaktohen në përputhje me parimin e proporcionalitetit, si dhe duke respektuar parashikimet e ligjit nr. 96/2016”.⁵⁰⁶

Nga arsyetimi i mësipërm kuptohet, që përdorimi i këtij instrumenti është një mundësi që i jepet magjistratit, por jo një detyrim për ILD dhe Këshillat. Gjithashtu ky instrument, megjithëse i takon fazës së hetimit disiplinor, nuk ka asnjë pengesë që të zbatohet edhe në fazën e procedimit disiplinor.

506 Vendim nr. 2 (JD), datë 31.05.2022 i Kolegjit të Posaçëm të Apelit.

Si përfundim, marrëveshja e përbashkët e pranimit përbën një rrugë për të përmbyllur një proces disiplinor me një rezultat të dakordësuar, duke ruajtur standarde të larta ligjshmërie, vullneti të lirë dhe proporcionaliteti. Secili prej Këshillave mban rolin thelbësor të garantuesit të ligjshmërisë dhe objektivitetit të këtij mekanizmi.

Marrëveshja e përshkruar më sipër përbën një përjashtim nga ecuria, që duhet të ndjekë procesi, sipas së cilit kur ILD-ja konstaton shkelje, vijon më paraqitjen e kërkesës për procedim disiplinor. Megjithatë kur gjatë procedimit disiplinor lindin dyshime të arsyeshme për një shkelje tjetër, të ndryshme nga ajo për të cilën është iniciuar hetimi, atëherë i kërkon Këshillit ku ka paraqitur kërkesën, që të ndërpresë procedimin disiplinor, duke i kthyer praktikën ILD-së. Në këtë rast, ILD-ja rifillon hetimin disiplinor dhe vendos për shtimin ose ndryshimin e objektit të hetimit, kryen hetimin e nevojshëm dhe paraqet raportin e hetimit të mëtejshëm, pranë Këshillit përkatës, brenda një muaji nga ndërprerja e procedimit. Në alternativë, kur nuk është e nevojshme kryerja e hetimeve të mëtejshme, pasi të ketë marrë mendimin e palëve, i kërkon Këshillit përkatës, që të shtojë ose ndryshojë objektin e hetimit. Një tjetër mundësi është që vetë Këshilli përkatës, ku është paraqitur kërkesa për procedim disiplinor të konstatojë vetë këtë situatë dhe të disponojë në një nga dy mënyrat e përshkruara më sipër.⁵⁰⁷

Ligji gjithashtu kërkon edhe krijimin dhe administrimin e një sistemi të menaxhimit të çështjeve nga ILD-ja, që synon garantimin e një procesi transparent dhe të gjurmueshëm për çdo fazë të hetimit disiplinor. Sistemi duhet të përmbajë të dhëna identifikuese për magjistratin dhe ankuesin, objektin dhe ecurinë e hetimit, vendimmarrjet përkatëse dhe informacion mbi vendimin përfundimtar disiplinor. Për funksionimin e këtij sistemi, ILD-ja miraton dispozita të hollësishme që përcaktojnë formatin, kategoritë e të dhënave, rregullat e ruajtjes dhe aksesit, si dhe kufijtë midis informacionit publik dhe atij, që është i aksesueshëm vetëm për magjistratin nën hetim. Në çdo rast, përpunimi i të dhënave bëhet në përputhje me legjislacionin për mbrojtjen e të dhënave personale.⁵⁰⁸

3.2 Procedimi disiplinor

Me përfundimin e hetimit disiplinor, Inspektori i Lartë i Drejtësisë, nëse ka dyshime të arsyeshme që magjistrati ka kryer shkelje disiplinore, e përfundon hetimin disiplinor me një raport, ku kërkon procedim disiplinor, duke paraqitur raportin e hetimit në KLGJ apo KLP sipas rastit, së bashku me dosjen hetimore. Duket se ligjvënësi ka zgjedhur një terminologji tjetër për të përshkruar këtë fazë. Kur kërkesa paraqitet

507 Ligji nr. 96/2016, neni 136.

508. Ligji nr. 96/2016, neni 137.

pranë Këshillave, atëherë jemi në fazën e procedimit disiplinor, ku si rregull, ILD-ja nuk kryen më veprime të caktuara, nëse nuk i kërkojnë nga ana e Këshillit.

Me paraqitjen e kërkesës nga ILD, çdo Këshill kryen disa veprime paraprake. Veprimi i parë është me karakter verifikues dhe shërben për të vlerësuar nëse procedimi disiplinor mundet që të vijojë apo ka ndalime ligjore. Kështu, sipas parashikimeve ligjore Këshilli vendos mbylljen e procedimit disiplinor pa zhvilluar seancë dëgjimore, nëse *së pari*, shkelja disiplinore ishte parashikuar në kohën kur ka filluar hetimi. Rasti tjetër i mbylljes së procedimit disiplinor është respektimi i institutit të gjësë së gjykuar, të cilin ligjvënësi e ka parashikuar edhe për procedimet disiplinore, administrative për magjistratët, pra nëse çështja ka qenë objekt i procedimit disiplinor, që është zgjidhur më parë me vendim të formës së prerë.⁵⁰⁹

Në analizën e tij mbi efektet e përfundimit të statusit të magjistratit në kushtet e ndërthurjes së procedurave të rivlerësimit dhe të përgjegjësisë disiplinore, Këshilli i Lartë Gjyqësor ka sqaruar, se në rastin konkret të një ish-magjistrati, mbarimi i statusit të tij për shkak të dorëheqjes gjatë procesit të rivlerësimit kalimtar përjashton mundësinë e vijimit të procedurës disiplinore sipas ligjit nr. 96/2016 *“Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve”*, i ndryshuar.

Në këtë rast ish-magjistrati, i cili ishte subjekt i procesit të rivlerësimit kalimtar në bazë të nenit 179, germa “b” të Kushtetutës dhe nenit 3, pika 16 të ligjit nr. 84/2016 *“Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve”*, paraqiti dorëheqjen nga detyra para përfundimit të procesit. Si pasojë, Këshilli i Lartë Gjyqësor vendosi deklarin e mbarimit të statusit të tij dhe njoftoi Komisionin e Pavarur të Kualifikimit. Ky i fundit, me vendim të mëvonshëm, ndërpreu procesin e rivlerësimit dhe bazuar në Kushtetutë dhe legjislacionin për rivlerësimin kalimtar, i ndaloi subjektit të drejtën për t’u riemëruar në funksione të tjera publike për një periudhë 15-vjeçare.

Në këtë kuadër, Këshilli vërejt, se për sa kohë mbarimi i statusit është konstatuar nëpërmjet një procedure të posaçme kushtetuese, nuk ekziston më baza juridike për të zhvilluar një procedim disiplinor sipas ligjit nr. 96/2016 *“Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve”*, i ndryshuar. Kjo për arsye se zbatimi i dispozitave disiplinore është i lidhur ngushtësisht me ekzistencën e statusit të magjistratit, i cili në këtë rast nuk ekziston më. Por gjithashtu Këshilli i Lartë Gjyqësor, e konsideroi këtë vendimmarrje të organeve të rivlerësimit kalimtar, si të formës së prerë. Përfundimisht, Këshilli argumentoi se në sistemin kushtetues dhe ligjor aktual, nuk ka asnjë bazë që të lejojë rishikimin ose rivendosjen për së dyti të një masë që është vendosur në mënyrë të formës së prerë, duke iu referuar nenit

509. Ligji nr. 96/2016, neni 139.

67 të ligjit nr. 84/2016 “Për rivlerësimin kalimtar”, i cili parashikon vetëm mundësinë e rivendosjes në afat të ankimit, dhe jo rihapjen ose rishikimin e vendimeve përfundimtare.⁵¹⁰

Në këtë rast, rezulton se KPK, kishte vendosur ndërprerjen e këtij procedimit të rivlerësimit kalimtar ndaj këtij magjistrati, bazuar në dorëheqjen që kishte miratuar Këshilli i Lartë Gjyqësor. KLGJ, këtë vendimmarrje të KPK e ka konsideruar si një “masë disiplinore” pasi ish magjistrati tani konsiderohet i larguar nga sistemi.⁵¹¹

Megjithatë, pavarësisht se dorëheqja e magjistratit është një nga shkaqet që sjell mbarimin e statusit të magjistratit,⁵¹² ligjvënësi ka parashikuar, që nëse kjo dorëheqje jepet pas depozitimit të kërkesës për fillimin e procedimit disiplinor paraqitja dhe eventualisht pranimi i saj nuk ndalon fillimin ose vazhdimin e procedimit disiplinor.

Në jurisprudencën e tij lidhur me efektet e dorëheqjes së magjistratit në kushtet e përgjegjësisë disiplinore, Këshilli i Lartë Gjyqësor ka mbajtur qëndrimin se paraqitja e kërkesës për dorëheqje nuk pengon as fillimin dhe as vazhdimin e hetimit apo procedimit disiplinor ndaj një magjistrati, kur ekzistojnë rrethana që përbëjnë shkak të drejtpërdrejtë për shkarkim sipas Kushtetutës.⁵¹³

Ajo që tërheq vëmendjen në këtë arsyetim është fakti që megjithëse kërkesa për dorëheqje ishte depozituar me kohë, KLGJ nuk ndërmori asnjë veprim, duke pritur që të konstituohej organi procedues, Inspektori i Lartë i Drejtësisë, i cili në momentin e paraqitjes së dorëheqjes, megjithëse parashikohej nga Kushtetuta dhe legjislacioni në fuqi, nuk ishte krijuar ende. Ky qëndrim është mbajtur edhe në jurisprudencën vijuese të KLGJ-së.⁵¹⁴

Si rast i fundit, por edhe ekstrem, i mbylljes së procedimit disiplinor nga Këshillat, ligji parashikon rastin, kur raporti i hetimit, që shoqëron kërkesën për fillimin e procedimit disiplinor është depozituar pa u arsyetuar. Në këto raste, ligjvënësi, nuk i ka dhënë mundësi apo diskrecion Këshillave, që të mund t’i kërkojnë ILD-së plotësimin e kësaj të mete, por është kategorik kur kërkon mbylljen e procedimit disiplinor.

510. Vendimi nr. 199/2, datë 12.05.2021 i Këshillit të Lartë Gjyqësor.

511. Vendimi nr. 529, datë 27.10.2020 i Këshillit të Lartë Gjyqësor.

512. Ligji nr. 96/2016, neni 65: 1. Magjistrati mund të kërkojë mbarimin e statusit, nëpërmjet paraqitjes së dorëheqjes para Këshillit përkatës. 2. Dorëheqja duhet të jetë me shkrim dhe nuk është e nevojshme të jetë e arsyetuar. Dorëheqja jep efektet në fund të muajit pasardhës, nga dita kur Këshilli merr deklarinë me shkrim të dorëheqjes. Mbarimi i statusit të magjistratit deklarohet me vendim të Këshillit jo më vonë se dy javë nga mbarimi i statusit. 3. Në raste të justifikuara, me kërkesë të motivuar dhe me miratim të Këshillit, dorëheqja mund të japë efekte përpara kohës së përcaktuar në pikën 2 të këtij neni.

513. Vendimi nr. 529, datë 27.10.2020 i Këshillit të Lartë Gjyqësor.

514. Vendimin nr. 223, datë 02.06.2021 i Këshillit të Lartë Gjyqësor.

Ligji kërkon në mënyrë kategorike, që kur Këshilli mbyll procedimin disiplinor, ai duhet të dalë me vendim të arsyetuar me shkrim, ku të analizohen në mënyrë të detajuar shkaqet e mbylljes, vendim i cili i njoftohet edhe palëve në këtë procedurë.⁵¹⁵

Në rast se konstatohet se nuk jemi përpara rasteve që kërkojnë mbylljen e procedimit disiplinor, por duhet të vijohet me mbajtjen e një seance dëgjimore, secili prej Këshillave, vijon me veprime të tjera, që kanë të bëjnë me përcaktimin e datës për seancën dëgjimore, e cila duhet të jetë brenda një muaji nga dita e marrjes së dosjes nga Inspektori i Lartë i Drejtësisë, si edhe njofton palët për datën e seancës dëgjimore, të paktën 15 ditë para saj⁵¹⁶. Siç mund të konstatohet, ligjvënësi, me qëllim që procedura disiplinore të jetë efektive, ka përcaktuar edhe afate për Këshillat, brenda së cilave, ato duhet të veprojnë. Këto afate edhe mund të zgjaten, deri në dy muaj, për shkaqe të rëndësishme, të cilat duhet të bëhen publike. Këtë situatë mund ta ilustrojmë me rastin e procedimit disiplinor ndaj magjistratit Sh. K., ku KLP kërkoi 2 muaj kohë, për shkak të materialit voluminoz hetimor të paraqitur nga ILD.

Në lidhje me respektimin e afateve të vendosura në Ligjin nr.96/2016 *“Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve”, i ndryshuar, jurisprudenca ka arsyetuar se “14.3.1 Nga ana tjetër, Kolegji evidenton se procedura administrative ka ndjekur kursin e saj normal dhe është përmbyllur me vendimmarrje të ILD-së në një afat më të shkurtër se afati i përcaktuar në ligj. Ligji 96/2016, në nenin 138, paragrafi 4, parashikon se: Këshilli shqyrton të gjithë faktorët që kanë rëndësi për çështjen dhe në kuptim të kësaj dispozite, nuk merr relevancë shqyrtimi i humbjes së një afati ligjor për shkaqe objektive dhe pa pasoja për palën apo për zhvillimin e procedurës, përkundrajt faktit të përmbylljes së procedurës së hetimit disiplinor në një afat më të shkurtër se ai ligjor”.*⁵¹⁷ Pra, sipas këtij qëndrimi, respektimi i këtyre afateve, nuk kërkohet në mënyrë rigoroze, mjafton që të mos ketë cenuar të drejtat procedurale të palëve. Pra qasja gjyqësore ndaj këtyre afateve, lidhet me pasojat që ato sjellin, të cilat do të duhet të vlerësohen rast pas rasti.

Në seancën dëgjimore, ligji kërkon nga Këshillat, që prej tyre të shqyrtohen të gjithë faktorët që kanë rëndësi për çështjen, duke i njohur mundësinë, që prej tyre të merren edhe prova shtesë, duke përfshirë edhe thirrjen e dëshmitarëve.⁵¹⁸

Marrja e provave shtesë në procedimin disiplinor përbën një instrument të rëndësishëm për sigurimin e një procesi të gjithanshëm dhe të drejtë. Kjo nevojë mund të lindë gjatë debatit midis palëve, ose si rezultat i pyetjeve dhe vërejtjeve të ngritura nga vetë anëtarët e Këshillit.

515. Ligji nr. 96/2016, neni 139.

516. Ligji nr. 96/2016, neni 138/b

517. Vendimi nr. 1 (JD), datë 20.02.2023 i Kolegjit të Posaçëm të Apelit.

518. Ligji nr. 96/2016, neni 138.

Për këtë arsye, vendimi për administrimin e provave shtesë mund të merret ose me iniciativë të vetë Këshillit (kryesisht), ose me kërkesë të palëve të përfshira në procedim.

Megjithatë parimi themelor, që rregullon këtë proces është ai i lidhjes organike midis provës së kërkuar dhe objektit të procedimit disiplinor. Kjo do të thotë, se çdo provë e re që kërkohet të merret duhet të ketë relevancë të drejtpërdrejtë me faktet, që janë objekt shqyrtimi në procedimin disiplinor. Në mungesë të kësaj lidhjeje, kërkesa për prova shtesë duhet të refuzohet.

Si orientim për secilin prej Këshillave, për të vendosur nëse ekspertët do t'i thërrasë vetë, apo do t'i ngarkojë si detyrë ILD-së, si edhe për rastet kur vendoset që të kryhen veprime hetimore të mëtejshme, vlejné parashikimet e Kodit të Procedurave Administrative, përsa i përket ndihmës administrative. Sipas këtij instituti një organi publik, në këtë rast Këshilli që po zhvillon procedimin disiplinor, mund t'i kërkojë ndihmë administrative një organi tjetër publik, në këto raste ILD-ja, për kryerjen e një apo disa veprimeve të nevojshme, në kuadër të një procedure administrative. Këto veprime të tjera të nevojshme përcaktohen ato raste kur *së pari* për arsye të ligjshme, organi kërkues nuk mund t'i kryejë vetë këto veprime, *së dyti* kryerja e veprimeve nga organi kërkues nuk është efektive apo kostot për kryerjen e tyre janë shumë më të larta, në krahasim me koston e kryerjes së tyre nga organi tjetër; *së treti* është e nevojshme njohja me dokumente, fakte, apo mjete të tjera të provës, në administrim të organit tjetër.⁵¹⁹ Megjithëse të tre këto raste, mund të zbatohen në kuadër të një procedimi disiplinor, rasti më i mundshëm që mund të gjejë më shpesh aplikim është rasti i dytë, që lidhet me efektivitetin apo me kostot e kryerjes së këtyre veprimeve, të cilat mund të kryhen më mirë nga vetë ILD. Në këtë rast Këshilli ia ngarkon këtë detyrë këtij institucioni, i cili, ndryshe nga parashikimet e Kodit të Procedurave Administrative,⁵²⁰ nuk mundet që ta refuzojë.

Mund të ndodhë që ndaj të njëjtit magjistrat, nga ana e ILD-së të jenë paraqitur, dy apo më shumë kërkesa për fillimin e procedimit disiplinor. Në këto raste, me qëllim zhvillimin sa më efektiv të procedimeve disiplinore, ligjvënësi ka parashikuar edhe mundësinë që këto procedime të bashkohen dhe të vlerësohen së bashku nga Këshilli përkatës.⁵²¹ Ky parashikim, është i lidhur dhe rrjedhë i zbatimit të parimit të “deburokratizimit dhe i eficiencës”, parashikuar nga Kodi i Procedurave Administrative.⁵²²

519. Kodi i Procedurave Administrative, neni 71.

520. Kodi i Procedurave Administrative, neni 72.

521. Ligji nr. 96/2016, neni 140, pika 1.

522. Kodi i Procedurave Administrative, neni 18: 1. *Procedura administrative nuk i nënshtrohet ndonjë forme të caktuar, me përjashtim të rasteve kur parashikohet ndryshe*

Kusht kryesor për zbatimin e kësaj mundësie është që procedimet disiplinore duhet që *së pari* t'u referohen të njëjtave fakte dhe *së dyti*, t'i referohen të njëjtit magjistrat. Ndërkohë që kushti i dytë është i qartë dhe kërkon që kërkesat e ndryshme për procedim disiplinor të jenë paraqitura ndaj të njëjtit magjistrat, pra jo ndaj magistratëve të ndryshëm, përse i përket kushtit të parë, që të kemi bashkim të procedimeve disiplinore, dispozita kërkon që kërkesat për procedime disiplinore të jenë mbështetur në të njëjtat fakte. Kjo mundësi parashikohet edhe nga Kodi i procedurave Administrative, si një nga veprimet paraprake që duhet të bëhen në këto raste.⁵²³ Termi “fakt”, nuk përkufizohet nga ana e legjislacionit për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve, si edhe nga ana e Kodit të Procedurave Administrative. Përkufizimin e tij ligjor e gjejmë në Kodin e Procedurës Civile, i cili, në nenin 7 të tij, parashikon se *“Fakt quhet çdo sjellje e njeriut, ngjarje shoqërore ose fenomen i natyrës, të cilit ligji i ngarkon një pasojë juridike”*. Bazuar në këtë formulim ligjor, në mënyrë që ky kush duhet të plotësohet duhet domosdoshmërisht, që kërkesat e ndryshme për procedim disiplinor t'i referohen të njëjtës sjellje të magistratit. Nga praktika e Këshillave, nuk ka rezultuar raste të bashkimit të procedimeve disiplinore, megjithatë ka pasur disa raste me më shumë se një kërkesë për procedim ndaj të njëjtit magjistrat. Kështu, në KLGJ janë paraqitur nga ILD, 3 kërkesa për procedim disiplinor ndaj të njëjtit gjyqtar, në kohë të ndryshme dhe në gjykata të ndryshme ku kishte shërbyer, për shkelje të ngjashme. Po, pranë KLGJ-së, rezulton se janë paraqitur dy kërkesa në vite të ndryshme për të njëjtin magjistrat. Një situatë e ngjashme është shfaqur edhe në KLP, ku janë paraqitur dy kërkesa ndaj të njëjtit magjistrat, po me periudha të ndryshme dhe të kryera në pozicione të ndryshme, që kishte pasur magistrati në fjalë.⁵²⁴

Një tjetër rast interesant, që parashikohet si mundësi e bashkimit të procedimeve disiplinore është edhe rasti, kur një gjyqtar ose një prokuror është përfshirë në të njëjtën shkelje, atëherë Këshillat mund të vendosin

nga ligji. 2. Procedura administrative zhvillohet sa më shpejt të jetë e mundur, por jo më vonë se afati kohor i parashikuar me ligj për të, me sa më pak kosto për organin publik dhe për palët, në mënyrë që të arrihet çfarë është e nevojshme për një rezultat të ligjshëm.

523. Kodi i Procedurave Administrative, neni 65, germa “ç”: *Në fillim të procedurës administrative, organi publik kryen verifikimet e mëposhtme: ... ç) nëse kërkesa e një pale për fillimin e një procedure administrative mund të shqyrtohen së bashku me kërkesat e palëve të tjera, nëse bazohet në të njëjtat fakte dhe bazë ligjore.*

524. Shih vendimin nr. 15, datë 30.01.2025 të Këshillit të Lartë të Prokurorisë, që bën fjalë për procedimin disiplinor ndaj një magistrati për kohën kur ai kishte qenë prokuror në Prokurorinë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Vlorë dhe vendimin nr. 65, datë 10.04.2025, të Këshillit të Lartë të Prokurorisë, ku trajtohet procedimi disiplinor ndaj të njëjtit magjistrat, por si drejtues i Prokurorisë, pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Sarandë.

bashkimin e procedimeve. Duke qenë se kemi të bëjmë me magjistratë të ndryshëm, ku organ kompetent janë edhe Këshilla të ndryshëm, ligji kërkon, që këto organe të miratojnë rregulla të përbashkëta për bashkimin e procedimeve,⁵²⁵ të cilat deri më sot, nuk rezultojnë që të jenë hartuar dhe miratuar. Duke analizuar praktikën e të dyja Këshillave, rezultojnë se ka pasur mundësi që kjo dispozitë të gjejë zbatim dhe më konkretisht në rastin e procedimit të dy magjistratëve me detyrë gjyqtar dhe prokuror, që u proceduan për shkeljet disiplinore të konstatuara në shqyrtimin e ankesave për “lirim me kusht”, por që këto dy procedime nuk rezultojnë të jenë bashkuar.⁵²⁶ Të dy u proceduan nga secili Këshill me të njëjtën masë disiplinore të propozuar nga ILD, “shkarkim nga detyra”.

Pasi ILD e njofton magjistratin subjekt hetimi disiplinor mbi vendimmarrjen e Inspektorit të Lartë të Drejtësisë mbi përfundimin e hetimit disiplinor ndaj tij dhe i përcjell Këshillit përkatës raportin hetimor dhe dokumentacionin e administruar gjatë hetimit, ligji detyron secilin Këshill, që kur vijon me procedimin disiplinor, duhet që të njoftojë magjistratin, se ndaj tij ka filluar procedim disiplinor, si edhe njëkohësisht duhet që t’i bëjë të ditur të drejtat që ai ka në këtë procedim dhe që janë, e drejta për të paraqitur një parashkrim me shkrim në afatin e caktuar, e drejta për të marrë pjesë në seancë dëgjimore, e drejta për të thirrur dëshmitarë, që mund të dëshmojnë fakte me interes për çështjen, e drejta për të paraqitur dokumente, e drejta për të marrë masa të tjera për paraqitjen e provave në mbështetje të mbrojtjes së tij, e drejta për t’u përfaqësuar, sipas parashkrimeve në Kodin e Procedurave Administrative, e drejta për kompensimin e shpenzimeve të arsyeshme ligjore të tij/saj, në raste kur nuk vendoset masë disiplinore.

Të drejtat e mësipërme të magjistratit, nuk e pengojnë Këshillin, që kur e vlerëson, t’i kërkojë magjistratit të paraqesë të dhëna, dokumente ose çdo lloj prove, si dhe të marrë pjesë në seancë dëgjimore dhe/ose të përfaqësohet me avokat mbrojtës.

Duke qenë se gjatë një procedimi disiplinor mund të merren edhe shumë vendime të ndërmjetme, që kanë si qëllim mbarëvajtjen e procesit, ligji parashikon se palët kanë të drejtë të njoftohen për çdo vendim të Këshillit, brenda 5 ditëve nga marrja e tij.⁵²⁷

Ligji parashikon zhvillimin e detyrueshëm të një seancë dëgjimore publike. Nisur nga funksionet e rëndësishme që ushtrojnë magjistratët, si edhe për të ruajtur prestigjin dhe pavarësinë e tyre, ligji e ka mënjeluar mundësinë e zhvillimit të procedimit disiplinor, pa mbajtur një seancë dëgjimore, duke mos njohur në këtë rast, mundësinë tjetër që parashikon

525. Ligji nr. 96/2016, neni 140, pika 2.

526. Shih vendimin nr. 92, datë 17.03.2021 të Këshillit të Lartë Gjyqësor dhe vendimin nr. 81, datë 31.03.2021 të Këshillit të Lartë të Prokurorisë.

527. Ligji nr. 96/2016, neni 141.

Kodi i Procedurave Administrative, për të përjashtuar palët nga kjo e drejtë.⁵²⁸

Procedimi disiplinor ndaj një magjistrati mbart gjithmonë një interes publik. Pra, publiku ka të drejtën që të informohet, nëse magjistratët e kanë kryer apo jo në rregull detyrën e tyre. Për këtë arsye ligji parashikon se seanca dëgjimore për procedimet disiplinore është publike. Megjithatë ky rregull nuk është absolut dhe mund të kufizohet, pra, seanca dëgjimore mund të zhvillohet me dyer të mbyllura, në rastet kur publiciteti i seancës mund të dëmtojë moralin e shoqërisë ose mund të bëjë publike të dhëna sekrete në interes të sigurisë kombëtare, nëse kjo kërkohet nga autoritetet kompetente, kur është e nevojshme të mbrohet e drejta e jetës private, të mbrohen të dhënat personale të magjistratit ose një personi tjetër, si edhe kur nga publiku ka shfaqje, që prishin zhvillimin normal të seancës dëgjimore. Në 5 vitet e veprimtarisë së Inspektorit të Lartë të Drejtësisë ka pasur vetëm një rast, kur seancat dëgjimore për procedimin disiplinor të një magjistrati janë bërë të mbyllura për publikun, që ka ndodhur për një procedim të zhvilluar pranë Këshillit të Lartë të Prokurorisë.⁵²⁹

Në seancën dëgjimore, si rregull procedohet fillimisht me dëgjimin e parashtrës nga ILD, që paraqet argumentet, se shkelja disiplinore është kryer dhe propozon masën disiplinore që duhet të merret dhe më pas vijon me magjistratin ose përfaqësuesin e tij, që paraqesin argumentet mbrojtëse. Me qëllim që seancat dëgjimore të jenë efektive, ligji parashikon që përmbajtja e parashtrimeve me shkrim, nuk përsëritet gjatë seancës dëgjimore.⁵³⁰

Nëse gjatë zhvillimit të seancës dëgjimore, me kërkesë të palëve apo kryesisht vlerësohet marrja e provave shtesë, atëherë mund të vendoset shtyrja e seancës dëgjimore, por gjithmonë, jo më shumë se një muaj.⁵³¹

Kur nga debati që mund të zhvillohet gjatë procedimit disiplinor, nga provat e paraqitura, apo ato që merren shtesë, secili prej Këshillave, çmon se çështja nuk mund të zgjidhet në mënyrë të drejtë dhe të rregullt, pa marrë në shqyrtim një ose disa pretendime të tjera për shkeljen disiplinore ndaj të njëjtit magjistrat, ka të drejtë që të urdhërojë Inspektorin e Lartë të Drejtësisë të ndryshojë ose të shtojë objektin e procedimit disiplinor, në

528. Kodi i Procedurave Administrative, neni 89: *Procedura administrative mund të mbyllet pa njoftuar dhe pa i dhënë mundësinë palës për t'u dëgjuar, vetëm në rastet e mëposhtme: a) marrja e vendimit përfundimtar është urgjente, për shkak të dëmit që mund t'i shkaktohet për shkak të vonesës interesit publik; b) palët kanë paraqitur para-prakisht mendimet, komentet dhe shpjegimet e plota gjatë procedurës administrative; c) gjatë zhvillimit të procedurës administrative rezulton qartë se vendimi do të jetë tërësisht në favor të palës; ç) në një procedurë administrative që bazohet në një procedurë konkurruese publike; ose kur d) është parashikuar shprehimisht me ligj.*

529. Vendimi nr. 65, datë 10.04.2025 i Këshillit të Lartë të Prokurorisë.

530. Ligji nr. 96/2016, neni 142.

531. Ligji nr. 96/2016, neni 143.

përputhje me këtë ligj, si dhe të hetojë këto pretendime të tjera, të paktën brenda afatit njëmuor. Një tjetër mundësi, nëse nuk është i nevojshëm një hetim shtesë është që Këshilli të vendosë mbi pretendimet e ndryshuara ose të shtuara, pasi të ketë dëgjuar palët në procedim.⁵³² Kjo mundësi nuk përjashton edhe të drejtën e ILD-së, që të kërkojë vetë ndryshimin e apo shtimin e objektit të procedimit disiplinor, sipas parashikimeve të këtij ligji, siç është trajtuar dhe më sipër. Por në këtë rast është Këshilli respektiv, që ka vlerësuar për ndryshimin apo shtimin e objektit të hetimit, ILD është e detyruar të veprojë sipas vendimarrjes së Këshillave.

Gjatë zhvillimit të procedimit disiplinor mund të ndodhë që Këshillat, si edhe ILD-ja, të gjenden përballë procedimeve të tjera. Në këto raste, Këshillat kanë të drejtën, që duke u bazuar në shkaqet ligjore të parashikuara nga neni 126 i ligjit, që rregullon statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve, të vendosin pezullimin e hetimit disiplinor në rrethana të posaçme kur konstatohet se është duke u zhvilluar një hetim penal ose një proces gjyqësor penal, administrativ ose civil, në të cilin magjistrati është palë, ose kur shkelja e dyshuar lidhet me të njëjtat fakte, që janë objekt i këtij procesi.⁵³³

Megjithëse Inspektori i Lartë i Drejtësisë, është shprehur kundër,⁵³⁴

532. Ligji nr. 96/2016, neni 144.

533. Ligji nr. 96/2016, neni 145; Rregullore e KLP mbi funksionimin e komisionit disiplinor në zhvillimin e procedurave disiplinore ndaj prokurorëve, neni 35/1; Rregullore "Për procedurat disiplinore në Këshillin e Lartë Gjyqësor" neni 40/1.

534. Procesverbal i mbledhjes së Këshillit të Lartë Gjyqësor, Tiranë, më 16.09.2021 (Pika 5) fq. 56-57: "Në rastin konkret, për sa konstatohet edhe nga përmbajtja e vendimit nr. {...}, datë 30 prill 2021 të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit për kriterin e vlerësimit të znj. {...}, nëpërmjet dy procedimeve disiplinore, nuk bëhet fjalë për të njëjtat fakte lidhur me shkeljen disiplinore ndaj magjistrates {...}. Në mbështetje të nenit 145 dhe 126 të ligjit 96/2016, pezullimi i procedimit mund të kryhet kur është duke u zhvilluar një hetim penal ose proces gjyqësor penal administrativ ose civil, ku njëra nga palët është magjistrati si dhe shkelja e dyshuar lidhet me të njëjtat fakte, për të cilat do të merret vendimi. Në faqen 31 të vendimit nr. {...}, arsyetohet se: "Trupi gjykues, duke marrë në konsideratë faktin se subjekti nuk është paraqitur për të ushtruar detyrën e gjyqtarës pranë Gjykatës së Apelit Tiranë, që nga data 01.04.2020, si dhe nisur nga parashikimi ligjor për sa i përket periudhës së rivlerësimit, vlerëson se shkelja disiplinore lidhur me etikën, e ndodhur pas kësaj periudhe është kompetencë vlerësimi e KLGJ-së." Në rastin konkret, pezullimi i procedimit disiplinor nuk rezulton të jetë mjet procedural për zgjidhjen e një sërë çështjesh, të cilat mund të lindin nga marrëdhënia e varësisë ose paragykueshmërisë që ekziston midis dy procedimeve disiplinore. Këto dy procedime disiplinore nuk janë të ndërlidhur me njëri-tjetrin, si dhe mënyra e disponimit apo vendimarrjes nga ana e organeve të rivlerësimit, nuk ndikon drejtpërdrejt mbi mënyrën e zgjidhjes së procedimit disiplinor, për të cilin po zhvillojmë debatin aktualisht. Ekzistenca e një procedimi tjetër disiplinor, sipas dispozitave të ligjit nr. 84/2016, me objekt krejt të ndryshëm nga procedimi disiplinor aktual dhe mbi fakte të ndryshme, nuk përbën parakusht për trajtimin e çështjeve të cilat do të trajtohen në procedimin disiplinor, i cili po zhvillohet aktualisht në KLGJ. Për sa kohë magjistratja {...}, subjekti i procedimit disiplinor, ka statusin e magjistratit, si dhe propozimi nga ana e ILD-së të masës "Sh-

praktika e Këshillave e ka shtrirë zbatueshmërinë e këtyre dispozitave, edhe në kur ndaj një magjistrati po zhvillohej paralelisht edhe procesi i rivlerësimit kalimtar. Rasti i parë kur ka ndodhur një pezullim i tillë, i takon Këshillit të Lartë Gjyqësor, i cili interpretoi dispozitat e nenit 145 të ligjit nr. 96/2016 *“Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve”*, i ndryshuar, duke bërë një analizë të hollësishme të raporteve ndërmjet procedimit disiplinor dhe procesit të rivlerësimit. KLGJ arsyetoi, se ndonëse procesi i rivlerësimit nuk është parashikuar shprehimisht në nenin 126 të këtij ligji, si një nga rastet që kërkojnë pezullimin e hetimit disiplinor, natyra e tij si një masë kushtetuese e përkohshme dhe e jashtëzakonshme imponon një trajtim të veçantë. Në këtë kuadër, Këshilli vlerësoi se procesi i rivlerësimit kalimtar përbën një proces administrativ me ndikim të drejtpërdrejtë në statusin e magjistratit dhe rrjedhimisht, edhe në mundësinë për të vijuar ose jo me procedimin disiplinor. Në rastin konkret, duke qenë se magjistrati që ishte shkarkuar nga KPK dhe ndaj vendimit ishte ushtruar ankim, Këshilli theksoi se mbajtja ose jo e statusit të magjistratit përbën një parakusht ligjor për vijimin e shqyrtimit disiplinor. Nëse statusi i magjistratit humbiste me vendim përfundimtar, procedimi disiplinor nuk kishte më objekt. Në të kundërt, me rënien e shkakut të pezullimit (nëse vendimi i shkarkimit ndryshohej), procedimi disiplinor rifillonte. KLGJ vuri në dukje se ekzistenca e procedimeve të ndara dhe të pavarura (rivlerësimi dhe përgjegjësia disiplinore) nga organe të ndryshme, si dhe mungesa e një mekanizmi të parashikuar për bashkimin e tyre, justifikonte nevojën për pezullim. Po ashtu, theksoi se Ligji për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve, nuk lejon zhvillimin paralel të disa procedimeve disiplinore ndaj një magjistrati për të njëjtat fakte dhe se pezullimi nuk pengon asnjëherë vijimin e procesit disiplinor nëse statusi i magjistratit ruhet. Në përfundim, KLGJ konkludoi, se pezullimi i procedimit disiplinor në këto rrethana ishte i justifikuar ligjërisht dhe i domosdoshëm për të respektuar parimet e sigurisë juridike, efektivitetit të procesit dhe ruajtjes së funksionit të sistemit të drejtësisë.⁵³⁵

E rëndësishme, për të garantuar të drejtën për një proces të rregullt ligjor, është që veçanërisht në rrëzimin e kërkesave procedurale apo të mospranimit të marrjes së provave të reja, Këshillat, duhet të japin arsyet përkatëse për këtë vendimmarrje.⁵³⁶

karkim nga detyra”, e cila mund të jetë e ndryshme me vendimmarrjen e Këshillit apo masa e dhënë nga ana e organeve të rivlerësimit me një vendim jo të formës së prerë objekt ankimi, nuk mund të diktojë ecurinë e këtij procedimi disiplinor”.

535. Vendimi nr. 463, datë 11.10.2021 i Këshillit të Lartë Gjyqësor.

536. Vendim nr. 3 (JD), datë 07.12.2022 i Kolegjit të Posaçëm të Apelimit: 41.2 *Nga përmbajtja e vendimit, rezulton se KLGJ-ja, brenda diskrecionit që ka si organ kushtetues-administrativ, në përputhje me nenin 146 të ligjit nr. 96/2016, duke vlerësuar kërkesat e ankuesit, ka vendosur dhe argumentuar mospranimin e tyre. Mungesa e plotësisë së argumentit të pretenduar prej ankuesit, lidhet sipas Kolegjit, me vlerësimin*

Ligji nr. 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve”, i ndryshuar, parashikon në nenin 116 e “masat për shmangien e vonesave”. Ky parashikim edhe pse duket i përqendruar në aspektin procedural të procesit disiplinor, në thelb është një dispozitë që synon të mbrojë integritetin dhe eficiencën e procedurave disiplinore kundrejt magjistratëve, duke vendosur mekanizma për të shmangur vonesat dhe pengesat e panevojshme gjatë zhvillimit të tyre. Ai reflekton një qasje të matur dhe proporcionale ndaj dy aspekteve që lidhen me garantimin e të drejtave të magjistratit në procesin disiplinor dhe ruajtjen e autoritetit të procedurës përmes sanksioneve të arsyeshme ndaj sjelljeve penguese apo abuzive.

Në pikën 1, të kësaj dispozite ligji parashikon se në rastet kur magjistrati nuk paraqitet në seancë, zhvillimi i procedimit disiplinor mund të bazohet në dispozitat përkatëse të Kodit të Procedurës Penale, në veçanti nenin 351 që rregullon zhvillimin e procesit në mungesë, për aq sa këto rregulla janë të zbatueshme në kontekstin disiplinor. Kjo dispozitë garanton se procedimi nuk mbetet pezull për shkak të mungesës së magjistratit, por siguron që të gjitha mundësitë për pjesëmarrje të jenë respektuar në mënyrë të plotë.

Në jurisprudencën e Këshillit të Lartë Gjyqësor, veçanërisht në vendimin nr. 92, datë 17.03.2021, kjo dispozitë ka gjetur zbatim konkret në çështjen ndaj një magjistrateje, e cila ndodhej në masën “arrest me burg” për akuza penale. Në atë rast, Këshilli, në përputhje me nenin 116 të ligjit nr. 96/2016 dhe nenin 351 të Kodit të Procedurës Penale, kërkoi nga autoritetet e paraburgimit që të garantonin pjesëmarrjen e saj në seancën dëgjimore. Pas marrjes së deklaratës me shkrim të magjistrates për përfaqësim përmes avokatit të saj, Këshilli vlerësoi se të gjitha kërkesat ligjore për njoftim dhe mundësi mbrojtjeje ishin përmbushur. Në seancën pasuese, edhe pse u kërkua shtyrja e procedimit për të mundësuar pjesëmarrjen personale të magjistrates, Këshilli e rrëzoi kërkesën duke vlerësuar se ishin respektuar të gjitha të drejtat e saj procedurale dhe se mungesa e saj ishte e qëllimshme dhe e vullnetshme. Në këtë mënyrë, KLGJ i dha kuptim praktik kësaj dispozite, duke siguruar vazhdimësinë e procesit dhe duke shmangur abuzimin me të drejtën për të vonuar procedurat.

Ndërkohë, pika 2 i nenit 116 përqendrohet te sjelljet, që me dashje pengojnë zhvillimin normal të procedimit. Kjo pikë parashikon që autoritetet disiplinore mund të paralajmërojnë dhe më pas të dënojnë me gjobë deri në 100 000 lekë çdo magjistrat, dëshmitar, ekspert apo

që ka bërë KLGJ-ja rast pas rasti, të tërësisë së kërkesave të paraqitura nga ankuesi përgjatë procedimit disiplinor, si dhe me rëndësinë që kanë pasur këto kërkesa për zgjidhjen në themel të çështjes objekt shqyrtimi. Ndërsa konstatohet se vendimi i mësipërm i KLGJ-së është i shoqëruar me argumentet e konsideruara prej organit në një nivel që nuk e bëjnë vendimin të paarsyetuar, Kolegji konkludon se është i pabazuar pretendimi i ankuesit se në përmbajtjen e vendimit të KLGJ-së nuk ekziston i pasqyruar dhe nuk është dhënë asnjë argument se përse kërkesat e tij janë rrëzuar.

përkthyes, që cenon dinjitetin e trupës proceduese apo ndërmerr veprime, që kanë si synim zvarritjen e procesit. Më tej, nëse sjellja vazhdon, ajo mund të çojë edhe në fillimin e hetimit disiplinor apo penal. Kjo dispozitë është e rëndësishme për të ruajtur autoritetin e procesit dhe për të parandaluar që procesi disiplinor të shndërrohet në një mjet taktik nga ana e subjekteve për të shmangur përgjegjësinë e tyre. Nuk ka pasur zbatim të mekanizmave ligjorë në Këshilla, edhe pse në një rast, një magjistrat ndaj të cilit ILD kishte çuar tri kërkesa për procedim disiplinor në KLGJ, me anë të raporteve mjekësore, magjistrati, shtyu 8 seanca dëgjimore për procedimin e parë, 4 seanca për procedimin e dytë dhe 4 seanca për procedimin e tretë të tij, përmes paraqitjes së raporteve mjekësore.

Përfaqësuesit e ILD-së kanë kërkuar gjatë seancave dëgjimore, që për shkak të mospjesëmarrjes së magjistratit, të caktohej një avokat kryesisht për të mbrojtur të drejtat e tij, me qëllim që të mundësohej vijimi i procedurës, e paralelisht një vlerësim i gjendjes së magjistratit. Në seancën e 8-të të shtyrë, përfaqësuesit e ILD-së evidentuan se KLGJ nuk ka marrë ende vendim lidhur me kërkesat e paraqitura prej tyre. *“Qëndrimi ynë si institucion është ai që kemi mbajtur edhe në seancat e kaluara, duam që ky procedim i nisur të jetë efektiv dhe ezaurues në varësi të rezultateve, që do të dalin pasi të kryhet aktimi i një mbrojtësi/përfaqësuesi në bazë të Kodit të Procedurës Administrative dhe më pas vijimi me dokumentacionin/shqyrtimin e atyre gjetjeve që ka ILD-ja. Megjithatë, ne i qëndrojmë në mënyrë respektuese pa diskutim vendimit që është marrë tashmë edhe për vlerësimin e gjendjes profesionale të magjistratit {...}.”⁵³⁷*

Në këto kushte ne i qëndrojmë kërkesave të paraqitura edhe më parë përpara Këshillit, pasi pamundësia objektive për t’u paraqitur në proces nga zoti {...} ka qenë e vazhdueshme dhe për këtë shkak ne kërkojmë sërish që të caktohet një përfaqësues ligjor, referuar nenit 36, pika 3, shkronja “c”, e Kodit të Procedurës Administrative.⁵³⁸

Në mbledhjen e datës 19.07.2023, KLGJ pasi evidentoi nga dokumentacioni shëndetësor, magjistrati përfitoi invaliditet të plotë, vendosi pezullimin e të tre procedimeve disiplinore për një periudhë 1-vjeçare (procedimin disiplinor nr. 3/2022, procedimin disiplinor nr. 1/2023 dhe nr. 2/2023). Pak ditë më vonë, më 28.07.2023, Komisioni i Pavarur i Kualifikimit,⁵³⁹ e shkarkoi nga detyra magjistratin në fjalë, që njësoj nuk ishte paraqitur në seancat edhe në këtë institucion dhe Këshilli përkatës e përfundoi procedimin disiplinor pa vendim përfundimtar.

537. Procesverbal i mbledhjes së Këshillit të Lartë Gjyqësor, më datë 21.06.2023 (Pikat, 1, 2, 3), fq. 6.

538. Procesverbal i mbledhjes së Këshillit të Lartë Gjyqësor datë 19.07.2023 (Pikat, 1, 2, 3) fq. 6.

539. Vendimi i KPK nr. 692, datë 28.07.2023.

Pas administrimit dhe shqyrtimit të fakteve dhe provave të paraqitura, Këshillat mund të vendosin në dy mënyra, ku mundësia e parë është rrëzimi i kërkesës për procedim disiplinor, duke konstatuar se faktet e pretenduara nuk kanë ndodhur ose nuk përbëjnë shkelje disiplinore, ose së dyti, të pranojnë kërkesën dhe të vendosin një ose më shumë masa disiplinore ndaj magjistratit.

Për vendimmarrjen e tyre, Këshillat nuk janë të lidhur me propozimin e bërë nga Inspektori i Lartë i Drejtësisë për llojin dhe masën e sanksionit disiplinor. Ato kanë lirinë të vendosin në mënyrë të pavarur, por duke arsyetuar në mënyrë shteruese qëndrimin e tyre. Vendimi përfundimtar duhet të jepet me shkrim dhe të jetë i motivuar, duke u shpallur brenda një afati maksimal prej dy javësh nga përfundimi i seancës së shqyrtimit.⁵⁴⁰

3.3 E drejta e ankimit për vendimet disiplinore

Me marrjen e vendimit përfundimtar nga ana e Këshillave, e drejta në fuqi parashikon në nivele të ndryshme të drejtën për ankim. Në nivel kushtetues, parashikohet e drejta për ankim të gjyqtarëve dhe prokurorëve vetëm kundër një mase disiplinore, asaj të shkarkimit dhe ky ankim ushtrohet në Gjykatën Kushtetuese.⁵⁴¹

Nga ana tjetër vetë ligji nr. 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve”, i ndryshuar, në nenin 147 të tij parashikon vetëm se “1. Magjistrati ka të drejtë të ankimojë vendimin për masë disiplinore në gjykatën kompetente. 2. Inspektori i Lartë i Drejtësisë ka të drejtë të ankimojë çdo vendim të Këshillit për çështjet disiplinore në gjykatën kompetente”. Pra, ligji kufizohet vetëm në dhënien e së drejtës së ankimit për të dyja palët në procedurën administrative disiplinore, kundër vendimit të Këshillave.

Për ta plotësuar këtë kuadër është e nevojshme që t’i referohemi edhe ligjit nr. 115/2016 “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”, i ndryshuar, i cili, përsa i përket akteve të Këshillit të Lartë Gjyqësor, në nenin 100, pika 1 të tij, parashikon se “Ndaj aktit administrativ individual të Këshillit mund të bëhet ankim, brenda 15 ditëve nga data e njoftimit, në Gjykatën Administrative të Apelit, përveçse kur parashikohet ndryshe në ligj. Aktet administrative individuale që vendosin masa disiplinore mbi gjyqtarët ankimohen në Gjykatën Kushtetuese”. Në mënyrë krejt identike për Këshillin e Lartë të Prokurorisë, po ky ligj në nenin 192, pika 1 të tij parashikon se “Ndaj aktit administrativ individual të Këshillit mund të bëhet ankim, brenda 15 ditëve nga data e njoftimit, në Gjykatën Administrative të Apelit, përveçse kur parashikohet ndryshe në ligj. Aktet administrative individuale që vendosin masa disiplinore mbi prokurorët ankimohen në Gjykatën Kushtetuese”. Nga të dhënat e publikuara rezulton se janë 5 ankime të bëra në KPA, nga

540. Ligji nr. 96/2016, neni 146.

541. Kushtetuta, nenet 140, pika 4 dhe 148/d, pika 3.

3 prokurorë e 2 gjyqtarë, që kanë ankimuar masën “shkarkim nga detyra” të propozuar nga ILD e të pranuar nga KLP e KLGJ, të cilat janë rrëzuar nga Kolegji i Posaçëm i Apelimit, duke konkluduar se masat disiplinore “shkarkim nga detyra” dhënë ndaj këtyre magjistratëve ishin proporcionale me rëndësinë e shkeljeve të kryera prej tyre, duke konfirmuar kështu standardet e punës së ILD-së e më tej të Këshillave.

Rezulton se këto dispozita, apo edhe të tjera nuk kufizojnë të drejtën e ankimit të magjistratëve ndaj masave të tjera disiplinore. Për këtë arsye, bazuar në të drejtën e aksesit në gjykatë, si element i së drejtës për një proces të rregull ligjor, parashikuar nga neni 42 i Kushtetutës, rezulton se ato mund të ankohen gjyqësisht, edhe kundrejt masave të tjera disiplinore.

Megjithatë këtu ka nevojë për një sqarim, pasi ligji nr. 115/2016 “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”, i ndryshuar, në nenet 100, pika 1 dhe 192, pika 1, parashikon në mënyrë të përgjithshme, ankimin kundër masave disiplinore (pra në shumës) në Gjykatën Kushtetuese, kurse vetë Kushtetuta, në nenet 140, pika 4 dhe 148/d, pika 3, parashikon që në Gjykatën Kushtetuese, mund të ankimohet vetëm masa disiplinore e shkarkimit. Pra dukshëm kemi një tejkalim të parashikimeve kushtetuese, nga ana e ligjit.

Siç u trajtua e më sipër, kjo situatë ka rezultuar në mënyrë të ngjashme edhe më parë, ku neni 147, pika 7 e Kushtetutës, përpara reformës së vitit 2016, parashikonte që gjyqtarët, kundër masës së shkarkimit kishin të drejtë që të ankoheshin në Kolegjet e Bashkuara të Gjykatës së Lartë. Nga ana tjetër sipas ligjit nr. 8436, datë 28.12.1998 “Për organizimin e pushtetit gjyqësor”, neni 42, pika 6, parashikohej, që gjyqtarët mund të ankoheshin në Kolegjet e Bashkuara të Gjykatës së Lartë, kundër çdo lloji mase disiplinore që mund të kishin marrë, kundrejt tyre, Këshilli i Lartë i Drejtësisë. Pikërisht këtë zgjerim të juridiksionit të Gjykatës së Lartë, nga ana e ligjvënësit, Gjykata Kushtetuese, me vendimin e saj nr. 3, datë 20.02.2006, vendosi shfuqizimin e saj, si të papajtueshme me Kushtetutën.

Ndodhur në këto kushte rezulton se situata mund të zgjidhet në dy mënyra, ku e para dhe më tradicionalja do të kërkonte që ky parashikim të kundërshtohet përsëri në Gjykatën Kushtetuese, e cila bazuar në gjuhën e qartë të tekstit të Kushtetutës, si edhe në jurisprudencën e saj të shfuqizonte këto parashikime ligjore si antikushtetuese.

Mënyra e dytë do të ishte ajo e interpretimit pajtues, ku duke interpretuar këto dispozita në tërësinë e tyre, në përputhje edhe me jurisprudencën e Gjykatës Kushtetuese dhe duke qenë masat disiplinore, akte administrative me natyrë individuale, atëherë lejohet që kundër të gjitha masave disiplinore, me përjashtim të masës disiplinore të shkarkimit, magjistratët mundet dhe duhet të ankohen në Gjykatën Administrative të Apelit dhe eventualisht, nëpërmjet rekursit që mund të

bëjnë palët mund të shqyrtohen edhe nga Kolegji Administrativ i Gjykatës së Lartë. Nëse palët justifikojnë plotësimin e kërkesave kushtetuese dhe ligjore, atëherë nëpërmjet ankimit kushtetues individual mund të venë në lëvizje edhe Gjykatën Kushtetuese.

Kurse përsa i përket masës disiplinore të shkarkimit, duke qenë se ajo parashikohet drejtpërsëdrejti nga Kushtetuta, ankimi i saj bëhet në Gjykatën Kushtetuese. Mesa duket ligjvënësi ka vendosur që kjo masë disiplinore duke pasur karakter ekstrem, pasi shuan statusin e magjistratit, të shqyrtohet nga instanca më e lartë kushtetuese në vend, e lidhur kjo edhe me statusin kushtetues që gëzojnë gjyqtarët dhe prokurorët.

Përsa i përket afatit, në çdo rast, ai do të duhet të jetë 15-ditor dhe fillon nga momenti që vendimi i arsyetuar i njoftohet palëve.

Në këndvështrimin kushtetues, edhe parashikimi i pikës 2, të nenit 147 të ligjit nr. 96/2016 *“Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve”*, i ndryshuar, i njeh gjithashtu Inspektorit të Lartë të Drejtësisë të drejtën për të ankimuar në gjykatë vendimet e Këshillave lidhur me masat disiplinore.

Megjithatë parashikimet e mësipërme, nuk janë të zbatueshme, për momentin dhe deri në përfundimin e këtij studimi, pasi ligjvënësi kushtetues, me reformën e vitit 2016 në nenin 179, pika 7 e Kushtetutës ka parashikuar që *“Gjatë mandatit të tyre nëntëvjeçar gjyqtarët e Kolegjit të Apelimit, sipas nenit 179/b, kanë juridiksion disiplinor ndaj gjyqtarëve të Gjykatës Kushtetuese, anëtarëve të Këshillit të Lartë Gjyqësor, anëtarëve të Këshillit të Lartë të Prokurorisë, Prokurorit të Përgjithshëm dhe Inspektorit të Lartë të Drejtësisë. Kolegji i Apelimit shqyrton ankimet ndaj vendimeve të Këshillit të Lartë Gjyqësor, Këshillit të Lartë të Prokurorisë dhe Inspektorit të Lartë të Drejtësisë për vendosjen e masave disiplinore, përkatësisht ndaj gjyqtarëve, prokurorëve dhe inspektorëve të tjerë”*.

Kolegji i Posaçëm i Apelimit, është një institucion kushtetues, ku parashikimi, organizimi dhe funksionimi i tij rregullohet nga nenet 179, pika 7, 179/b, pikat 5, 6, 8 dhe 9 të Kushtetutës, si edhe nga nenet “b”, “c”, “ç”, “ë” dhe “f” të aneksit të Kushtetutës. Referuar këtyre dispozitave jemi përpara një organi të posaçëm, me mandat 9-vjeçar, që si funksion kryesor ka shqyrtimin e ankesave gjatë procesit të rivlerësimit kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve. Megjithatë, ligjvënësi kushtetues e ka ngarkuar edhe për të shqyrtuar gjatë ekzistencës së tij, masat disiplinore që merren kundrejt funksionarëve të ndryshëm të sistemit të drejtësisë, ku përfshihen edhe masat disiplinore, që japin këshillat kundrejt magjistratëve.

Përsa i përket të drejtës së ankimit, pranë këtij institucioni, këto parashikime janë analizuar nga vetë KPA, e cila ka mbajtur qëndrimin se *“3.2.8 Në analizë të këtyre dy dispozitave, arrijmë në konkluzionin se me gjykatë kompetente për shqyrtimin e ankimeve të magjistratit/prokurorit, në rastin e*

marrjes ndaj tij të masave disiplinore nga këshilli, është Gjykata Kushtetuese. Në vijim të këtij arsytimi, në zbatim të nenit 5, pika 3 të ligjit nr. 84/2016 “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, i cili parashikon: “[...ç Kolegji i Posaçëm i Apelimit, gjatë mandatit të tij, në përputhje me Kushtetutën, ligjin “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese” dhe legjislacionin që rregullon çështjet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë, ka juridiksion të shqyrtojë: [...ç ankimet kundër vendimeve të Këshillit të Lartë Gjyqësor, Këshillit të Lartë të Prokurorisë dhe Inspektoratit të Lartë të Drejtësisë për vendosjen e masave disiplinore ndaj gjyqtarëve, prokurorëve dhe inspektorëve të tjerë.” - arrihet në konkluzionin se Kolegji i Posaçëm i Apelimit do të jetë gjykata kompetente që do të shqyrtojë ankimet ndaj vendimeve të këshillave për marrjen e masave disiplinore ndaj magistratëve gjatë gjithë mandatit të tij 9 (nëntë) vjeçar, duke përfshirë këtu të gjitha llojet e masave disiplinore të parashikuara nga neni 105 i ligjit nr. 96/2016”.⁵⁴²

Përsa i përket procedurës që duhet të ndjekë, KPA-ja, ky organ është shprehur se “3.1.2. ... Për shkak të këtij parashikimi, Kolegji vlerëson se procedura e shqyrtimit të të gjitha ankesave apo kërkesave të paraqitura e të regjistruara në Kolegjin e Posaçëm të Apelimit në kuadër të Juridiksionit të tij Disiplinor, të parashikuar nga Kushtetuta, do të gjykohej në zbatim të normave të ligjit për “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese”, për sa i përket natyrës e procedurës së gjykimit, duke e konsideruar atë si një gjykim kushtetues, të ndryshëm për nga natyra me gjykimin që Kolegji i Posaçëm i Apelimit bën në rastet kur ai gjykon sipas Juridiksionit të tij Rivlerësues, gjykim i cili ka tiparet e një procesi që ndërthur natyrën administrative me elementet kushtetuese. 3.1.3 Në këto kushte, Kolegji i shqyrtimit paraprak të ankesës, objekt i këtij gjykimi, do të ndjekë në këtë proces zbatimin e nenit 31 të ligjit nr. 8577, datë 10.02.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese”, sipas përcaktimeve të të cilit gjykimit kushtetues të një çështjeje në seancë plenare i paraprin shqyrtimi paraprak i kërkesë/ankesës nga një kolegji i shqyrtimit paraprak në të cilin bën pjesë edhe relatori i çështjes. Ky kolegji verifikon paraprakisht kriteret e përgjithshme të parashikuara në nenet 31 e 31/a të ligjit nr. 8577, datë 10.02.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese”, të ndryshuar, si edhe kriteret e posaçme të parashikuara në nenet 71 dhe 71/a të po këtij ligji që lidhen me shqyrtimin e ankimit individual. Verifikimi i këtyre kriterëve konsiderohet prej këtij Kolegji si hapi i parë që duhet të ndërmerret para se çështja e Juridiksionit Disiplinor t’i nënshtrohet një gjykimi në themel të cilin duhet ta kryejë seanca plenare e Kolegjit të Posaçëm të Apelimit, e përbërë nga të gjithë gjyqtarët e saj”.⁵⁴³

Gjithashtu, jurisprudenca ka sqaruar situatën, kur subjekti ndaj të cilit është marrë masë disiplinore nuk paraqitet, megjithëse ka marrë dijeni rregullisht, sipas arsytimit vijues “27. Kolegji i Posaçëm i Apelimit

542. Vendimi nr. 2 (JD), datë 21.06.2018 i Kolegjit të Posaçëm të Apelimit.

543. Vendimi nr. 2 (JD), datë 21.06.2018 i Kolegjit të Posaçëm të Apelimit.

konstaton se kërkuksi T. D., edhe pse ka pasur dijeni për shqyrtimin e çështjes në Kolegj, që prej kalimit të saj për kompetencë nga Gjykata e Apelit Administrativ, nuk ka paraqitur kërkesën apo parashtrime me shkrim në lidhje me objektin e gjyqimit dhe pretendimet e tij. Kërkuksi është njoftuar dhe ka marrë dijeni rregullisht për zhvillimin e seancës plenare publike, por nuk është paraqitur dhe nuk ka depozituar kërkesë për shtyrjen e seancës për ndonjë shkak të arsyeshëm. Kolegji, në vijim të situatës faktike si më sipër, çmon se kërkuksi, me mosparaqitjen, ka demonstruar mungesën e vullnetit të tij për t'ia nënshtruar gjyqimin e kësaj çështjeje juridiksionit kushtetues të Kolegjit të Posaçëm të Apelit, për pasojë ky vlerësim i parë lidhur edhe me mungesën e një akti formal drejtuar Kolegjit, i shpjeguar më lart se ka ndodhur për shkaqe të ndërvarura nga zgjedhjet procedurale të subjektit dhe vendimit të Gjykatës së Apelit Administrativ, e çon Kolegjin në përfundimin se situata faktike e përshkruar duhet të trajtohet si një heqje dorë nga kërkesa, në kuptim të parashikimit në nenin 31/b, pika 1 të ligjit nr. 8577/2000. 28. Duke vlerësuar çështjen në këtë mënyrë, në zbatim të nenit 31/b, pika 1 të ligjit nr. 8577/2000, i cili parashikon se: Kërkuksi mund të heqë dorë nga kërkesa përpara fillimit të shqyrtimit të saj nga Gjykata Kushtetuese. Në këtë rast, Gjykata Kushtetuese vendos pushimin e gjyqimit të çështjes, Kolegji arrin në përfundimin se gjyqimi i kësaj çështjeje pranë Kolegjit të Posaçëm të Apelit duhet të pushohet”.⁵⁴⁴

Siç mund të analizohet, KPA, në këto raste ndjek procedurat që parashikon ligji nr. 8577, datë 10.02.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese”, i ndryshuar. Duke qenë se edhe vetë ky institucion është krijuar si një dhomë e veçantë e kësaj Gjykate. Nga ana tjetër, tejkalimi i afatit të paraqitjes së ankimit në këtë institucion, ose mos shfaqja e interesit, duke preferuar ndjekjen e rrugës ankimore pranë sistemit gjyqësor të zakonshëm, shoqërohet me humbjen e kësaj të drejtë në mënyrë përfundimtare.

Duhet theksuar se përsa i përket afatit ankimor, ai mbetet përsëri 15 ditë, afat që fillon nga momenti i njoftimit të vendimit sipas parashikimeve të nenit 100, pika 1 dhe 192, pika 1 të ligjit nr. 115/2016 “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”, i ndryshuar.

544. Vendimi nr. 1 (JD), datë 20.07.2020 i Kolegjit të Posaçëm të Apelit.

ANEKS
DOKUMENTE AUTENTIKE TË ARKIVIT TË
SHTETIT MBI PROCESIN DISIPLINOR E ORGANIZIMIN E
DREJTËSISË

Neni 54. Gjyqtaret nuk mund te bajne tregti dhe nuk munden me marre pjese ne administraten e q'do shoqnie tregtare.

Neni 55. Gjyqtaret eksepsionisht pushohen kur me ligje te posaqme suprimohet gjyqi dhe ngushtohet qarku gjyqesuer.

Pjesa e III.

Transferimi i Gjyqtareve.

Neni 56. Gjyqtaret e q'do rangut sikuer u tregue dhe ne nenin 54 te kesaj ligje jane te pa tundeshme dhe nuk transferohen pa deshire por vendimin e komisis per zgjedhjen e gjyqtarevet disiplinisht ose per arrsyje administrative te forta, mund te degradohen.

Transferohen gjyqtaret ne rastin qi mblidhen me nji vend dy gjyqtare te aferme ne gjak gjer ne shkalle te katerte, ose jane Baxha-nak, dhander, vjeher, kunat.

Pjesa e V.

Lavderim e gradim i Gjyqtarve.

Neni 57. Ne mbarim te q'do vjetit Ministria e Drejtesies tue marre para syeshe statistikat e raportat e inspektorit dhe hetimet tjera po te shohi se gjyqtaret i kan krye detyret e tyne si mbas ligjave vepruese, u dergon nga nji leter levdat tue ju shenue keto dhe ne jeteshkrimin e tyne.

Neni 58. Gradimi i gjyqtarve bahet si kus asht tregue ne nenin 68 te kesaj ligje, tu ju marre para syeshe zotesija e mirresjellija e tyne. Gradimi bahet tue ndjek radhen e rangut.

Pjesa e V.

Ndeshkimi disiplinuar i Gjyqtarve.

Neni 59. Gjyqtaret jane te detyruem te vazhdojne rregullisht ne detyre e te mos cenojne detyren me as nji mendyre; gjith ashtu jane te shtrenguem te ruajne e te mos cenojne dinjitetin gjyqesuer mbrenda e jashta zyres.

Neni 60. Denimet disiplinore jane keto :

- a) Qortim me shkrim.
- b) te premunit e nji sasis se rroges deri dy muej.
- c) Te zbritunit e grades.
- d) Pushimi definitiv nga puna.

Neni 61. Denimet disiplinisht te sipertreguem zbatohen si mbas randesis te veprave te gjyqtarve.

./.

- 9 -
- Neni 62. Pranimi i miqve ne zyre asht i ndaluen. Ata gjyqtare qe veprojne kundra kesaje dispozite meritojne ndeshkim disiplinuer.
- Neni 63. Ndashkimet disiplinore shenohen ne jeteshkrimin e te denumeve.
- Neni 64. Ata qe degradohen disiplinisht s'kan te drejte te marrin shpenxime udhtimi.
- Neni 65. Prokurorat jane te detyruem te lajmerojne pa vones Ministrin e Drejtesies per fajet disiplinore te lemuna ne qarkun e tyre; ne qofte se ata i mungojne kesaj detyre, denohen dhe ata si mbas randesies te fajit.
- Neni 66. Gjyqtaret jane te detyruem te bajne sekret veprimet e mbrendshme te zyles qe nuk prjedhin botnisht.
- Neni 67. Kuer nji gjyqtare i prishen prej gjykates ma te nalte ma teper se gjysme e shumes absolute te gjykimeve te tija, ose shuma e te prishurave dhe e atyne qe s'ka' posibilitet per eksekutim kalojne gjysen e shumes te gjykimeve, Ministria e Drejtesies merr masat disiplinore ndaj atij gjyqtari dhe e pushon nga detyra.

Pjesa e VI.

Hierarkia e Gjyqtarve.

- Neni 68. Hierarkia e gjyqtarve asht si tregohet ma poshte :
- 1) Kryesekretare-Nd.Gjyqtare e Gjyqeve Shk.I.re.
 - 2) Kryesekretar-Nd.Gjyqtar e Apelit.
 - 3) Ndihmes antare e Gjyqevet Apelit.
 - 4) Gjyqtaret hetues.
 - 5) Gjyqtaret e Shk.I.re.
 - 6) Antaret e Apelit.
 - 7) Prokurorat e Apelit.
 - 8) Nd.Antari i Diktimit.
 - 9) Kryetarët e Apelit.
 - 10) Ndihmesi i Kryeprokurorit (ne ket grade asht dhe Inspektori i Drejtesies.
 - 11) Antaret e Gjyqit Diktimit.
 - 12) Kryeprokurori.
 - 13) Kryetarët e Gjyqit te Diktimit.

./.

Viti 1925/ Ligja mbi Rivumjen ne zbatim t' Organizimit të mëparshëm të Gjykatave. Në nenet 59, 60 dhe 61 ky ligj flet për llojet e dënimeve disiplinore për gjyqtarët dhe raportet e Inspektorit të Drejtësisë

SHËNJA TË TABELLËS SË SHËNIMEVE TË POSAÇME

Shënjë urgjenti D : Urgjent PU : Pjesërisht urgjent LC : Differencë KPA : Përgjigje pagueme (fakt o fanga) PC : Telegram me biletim PCP : Lajmim-marrje telegrafike PCP : Lajmim-marrje postare PS : Me shprehje ELT : Telegram Letre (regj. Evropian) NLT : Telegram Letre-aste (korrre)	PR : I parashituri post KP : Ekspres i pagueme MP : Me dritë e vete TR : Telegram-restant GP : Post-restant i parashituri TMA : Telegram me shprehje detyrues CTA : Njohuri gjithë detyrues DLT : Telegram Letre-dite (korrre)	Vula datore Marrësi i kësaj shënimeje duhet të e njohë me shprehje datën dhe orën, ndryshe humbet të drejtën e reklamimit për anë të gabet vorendi si dorëzimi.
---	---	---

U marrë me _____ orë _____
 prej _____
 Marrësi _____

Mbretëria e Shqipëtarëve

Shteti nuk pranon asnjë përgjigjeje civile të
 shkaktuarë prej shënimin telegrafik.

Cilësi	Per	Prej	NUMURI	Data	Orë	Shënime të qëllueshme
			4			

*Varë Roca, Mustafa Kosova, Hasan Zyngjeli,
 Mustafa Teli, Hasan Zyngjeli, Spiro A. Mustafaj,
 Gëzim Haxhiu, Shugjet Beja, Mustafa Nani,
 Gëzim Balla, Beyazet Selim, Mustafa Balla,
 Gëzim Gëvama, Adem Balla, Mustafa Lela,
 Spiro Kallço, Boshnjak Ballshijani,
 Feride Spiro, Kosta Papa, Zari Ruzhici,
 Telemak Manastirliu, Vangel Manastirliu, Petros Hoxha,
 Halil Bashiri, Tahiri Bashiri, Skender Igjoni,
 Harhi Sheli, Haradamo Gerdë Tahiri Halami.*

Mod. No. 201 Shqipëria "NIKAJ" Tiranë

SHËNJA TË TABELLËS SË SHËNIMEVE TË POSAÇME

Shënjë urgjenti D : Urgjent PU : Pjesërisht urgjent LC : Differencë KPA : Përgjigje pagueme (fakt o fanga) PC : Telegram me biletim PCP : Lajmim-marrje telegrafike PCP : Lajmim-marrje postare PS : Me shprehje ELT : Telegram Letre (regj. Evropian) NLT : Telegram Letre-aste (korrre)	PR : I parashituri post KP : Ekspres i pagueme MP : Me dritë e vete TR : Telegram-restant GP : Post-restant i parashituri TMA : Telegram me shprehje detyrues CTA : Njohuri gjithë detyrues DLT : Telegram Letre-dite (korrre)	Vula datore Marrësi i kësaj shënimeje duhet të e njohë me shprehje datën dhe orën, ndryshe humbet të drejtën e reklamimit për anë të gabet vorendi si dorëzimi.
---	---	---

U marrë me _____ orë _____
 prej _____
 Marrësi _____

Mbretëria e Shqipëtarëve


Shteti nuk pranon asnjë përgjigjeje civile të
 shkaktuarë prej shënimin telegrafik.

Cilësi	Per	Prej	NUMURI	Data	Orë	Shënime të qëllueshme
			2			


*te prefekturës së rrethit të mirditës e mirditës
 me dhe shprehjeje të mirditës e mirditës
 vortet me faktet dhe konsekuencat për
 het halle të përgjithshme me shprehje
 care fature të të mirditës e mirditës
 me modestie e me shprehje të lartës
 e lartësime prej mirditës të e lartës
 mirditës e mirditës i jone i mirditës
 i gjithë Shqipëtarëve =
 Varëja e Gëzim Balla*

Mod. No. 201 Shqipëria "NIKAJ" Tiranë

Shkëputur nga dosja me numër 1634, e vitit 1936. Shfaqen format e ankesës së asaj kohe, të cilat i drejtoheshin Mbretënisë së Shqiptarëve



Shkresë dërguar kryeinspektoriës së Oborrit Mbretënuer. Shkëputur nga dosja me nr. 205 e vitit 1932.



Dokumenti origjinal i Kanonit të Zhurisë i vitit 1913, akti i parë për organizimin dhe funksionimin e gjykatave në sistemin gjyqësor shqiptar, përshkruar në dosjen me nr. 233.

BIBLIOGRAFIA

Libra

- Aurela Anastasi, *“Historia e të drejtës kushtetuese në Shqipëri, 1912 – 1939”*, Shtëpia Botuese “Dajti 2000”, Tiranë 2018.
- Antonin Scalia dhe Bryan A. Garner, *“Reading law – The interpretation of the legal texts”*, Thomson/west, 2012.

Kumtesa

- Kristinka Jançe dhe Ilirjana Nano, *“Jurisprudenca e Këshillit të Shtetit mbi legjislacionin osman”*, botuar në aktet e Konferencës Shkencore Kombëtare, “Këshilli i Shtetit për zhvillimin e së drejtës në Shqipëri (1929-1944)”, nën përkujdesjen e Aurela Anastasi dhe Erind Merkuri, organizuar më datë 22.11.2022, nga Fakulteti i Drejtësisë i Universitetit të Tiranës, Tiranë 2024.
- Aurela Anastasi, *“Gjykata e Diktimit në përsiatjet për kontroll kushtetues”*, botuar në aktet e Konferencës Kombëtare, me temë “Praktika gjyqësore e Gjykatës së Lartë, nga identiteti kombëtar tek vlerat universale”, organizuar me datë 10.5.2023, me rastin e 110 vjetorit të krijimit të Gjykatës së Lartë, Tiranë 2023.

Raporte, Opinione, Komentar

- Progres-raporti: Reforma në drejtësi, kusht për hapjen e negociatave me BE (2015).
- Raport hetimi disiplinor i ILD ndaj magjstrates E. K. (2021).
- Raport hetimi disiplinor i ILD ndaj magjstratit M. K. (2020).
- Raport hetimi i ILD ndaj magjstratit Sh. K.
- Raport hetimi i ILD-së ndaj magjstrates A. Xh.

Jurisprudencë

Jurisprudencë e hershme

- Vendimi nr. 1, datë 11.04.1925 i Trupit Hetimor të Gjykatës së Diktimit.
- Vendimi nr. 58, datë 23.05.1933 i Seksionit të Drejtësisë dhe të Administratës, miratuar me Vendimin nr. 162, datë 30.05.1933 i Mbledhjes së Përgjithshme të Këshillit të Shtetit.

Gjykata Kushtetuese

- Vendimi nr. 12, datë 28.10.1992 i Gjykatës Kushtetuese.
- Vendimi nr. 2, datë 25.02.1994 i Gjykatës Kushtetuese.
- Vendimi nr. 8, datë 03.11.1994 i Gjykatës Kushtetuese.
- Vendimi nr. 1, datë 19.01.1995 i Gjykatës Kushtetuese.
- Vendimi nr. 12, datë 21.09.1995 i Gjykatës Kushtetuese.
- Vendimi nr. 2, datë 14.02.1996 i Gjykatës Kushtetuese.
- Vendimi nr. 15, datë 03.06.1997 i Gjykatës Kushtetuese.
- Vendimi nr. 18, datë 18.04.2000 i Gjykatës Kushtetuese.
- Vendimi nr. 29, datë 30.04.2001 i Gjykatës Kushtetuese.
- Vendimi nr. 25, datë 13.02.2002 i Gjykatës Kushtetuese.
- Vendimi nr. 75, datë 19.04.2002 i Gjykatës Kushtetuese.
- Vendimi nr. 11, datë 02.04.2003 i Gjykatës Kushtetuese.
- Vendimi nr. 11, datë 11.05.2004 i Gjykatës Kushtetuese.
- Vendimi nr. 12, datë 17.06.2004 i Gjykatës Kushtetuese.
- Vendimi nr. 17, datë 12.11.2004 i Gjykatës Kushtetuese.
- Vendimi nr. 29, datë 09.11.2005 i Gjykatës Kushtetuese.
- Vendimi nr. 3, datë 20.02.2006 i Gjykatës Kushtetuese.
- Vendimi nr. 16, datë 27.04.2007 i Gjykatës Kushtetuese.
- Vendimi nr. 21, datë 07.06.2007 i Gjykatës Kushtetuese.
- Vendimi nr. 34, datë 10.04.2017 i Gjykatës Kushtetuese.

Gjykata e Lartë

Kolegjet e Bashkuara

- Vendimi nr. 1291, datë 23.03.1999 i Kolegjeve të Bashkuara të Gjykatës së Lartë.
- Vendimi nr. 729, datë 29.06.1999 i Kolegjeve të Bashkuara të Gjykatës së Lartë.
- Vendimi nr. 572, datë 29.06.1999 i Kolegjeve të Bashkuara të Gjykatës së Lartë.

- Vendimi nr. 672, datë 29.06.1999 i Kolegjeve të Bashkuara të Gjykatës së Lartë.
- Vendimi nr. 793, datë 14.07.1999 i Kolegjeve të Bashkuara të Gjykatës së Lartë.
- Vendimi nr. 959, datë 29.07.1999 i Kolegjeve të Bashkuara të Gjykatës së Lartë.
- Vendimi nr. 690, datë 29.07.1999 i Kolegjeve të Bashkuara të Gjykatës së Lartë.
- Vendimi nr. 1054, datë 28.09.1999 i Kolegjeve të Bashkuara të Gjykatës së Lartë.
- Vendimi nr. 1095, datë 08.12.1999 i Kolegjeve të Bashkuara të Gjykatës së Lartë.
- Vendimi nr. 16, datë 13.02.2000 i Kolegjeve të Bashkuara të Gjykatës së Lartë.
- Vendimi nr. 656, datë 17.02.2000 i Kolegjeve të Bashkuara të Gjykatës së Lartë.
- Vendimi nr. 438, datë 21.02.2000 i Kolegjeve të Bashkuara të Gjykatës së Lartë.
- Vendimi nr. 627, datë 06.04.2000 i Kolegjeve të Bashkuara të Gjykatës së Lartë.
- Vendimi nr. 10, datë 13.02.2001 i Kolegjeve të Bashkuara të Gjykatës së Lartë.
- Vendimi nr. 15, datë 13.02.2001 i Kolegjeve të Bashkuara të Gjykatës së Lartë.
- Vendimi nr. 17, datë 13.02.2001 i Kolegjeve të Bashkuara të Gjykatës së Lartë.
- Vendimi nr. 19, datë 13.02.2001 i Kolegjeve të Bashkuara të Gjykatës së Lartë.
- Vendimi nr. 25, datë 04.04.2001 i Kolegjeve të Bashkuara të Gjykatës së Lartë.
- Vendimi nr. 27, datë 04.04.2001 i Kolegjeve të Bashkuara të Gjykatës së Lartë.
- Vendimi nr. 61, datë 27.06.2001 i Kolegjeve të Bashkuara të Gjykatës së Lartë.
- Vendimi nr. 73, datë 27.06.2001 i Kolegjeve të Bashkuara të Gjykatës së Lartë.
- Vendimi nr. 77, datë 27.06.2001 i Kolegjeve të Bashkuara të Gjykatës së Lartë.
- Vendimi nr. 86, datë 27.06.2001 i Kolegjeve të Bashkuara të Gjykatës së Lartë.
- Vendimi nr. 1, datë 16.01.2002 i Kolegjeve të Bashkuara të Gjykatës së Lartë.

- Vendimi nr. 83, datë 18.12.2002 i Kolegjeve të Bashkuara të Gjykatës së Lartë.
- Vendimi nr. 85, datë 20.11.2002 i Kolegjeve të Bashkuara të Gjykatës së Lartë.
- Vendimi nr. 88, datë 18.11.2002 i Kolegjeve të Bashkuara të Gjykatës së Lartë.
- Vendimi nr. 89, datë 11.11.2002 i Kolegjeve të Bashkuara të Gjykatës së Lartë.
- Vendimi nr. 13, datë 27.01.2003 i Kolegjeve të Bashkuara të Gjykatës së Lartë.
- Vendimi nr. 33, datë 26.09.2003 i Kolegjeve të Bashkuara të Gjykatës së Lartë.
- Vendimi nr. 30, datë 31.03.2003 i Kolegjeve të Bashkuara të Gjykatës së Lartë.
- Vendimi nr. 15, datë 29.06.2004 i Kolegjeve të Bashkuara të Gjykatës së Lartë.
- Vendimi nr. 6, datë 08.03.2006 i Kolegjeve të Bashkuara të Gjykatës së Lartë.
- Vendimi nr. 7, datë 08.03.2006 i Kolegjeve të Bashkuara të Gjykatës së Lartë.
- Vendimi nr. 10, datë 08.03.2006 i Kolegjeve të Bashkuara të Gjykatës së Lartë.
- Vendimi nr. 11, datë 08.03.2006 i Kolegjeve të Bashkuara të Gjykatës së Lartë.
- Vendimi nr. 12, datë 08.03.2006 i Kolegjeve të Bashkuara të Gjykatës së Lartë.
- Vendimi nr. 9, datë 11.09.2007 i Kolegjeve të Bashkuara të Gjykatës së Lartë.
- Vendimi nr. 11, datë 11.09.2007 i Kolegjeve të Bashkuara të Gjykatës së Lartë.
- Vendimi nr. 4, datë 07.01.2009 i Kolegjeve të Bashkuara të Gjykatës së Lartë.
- Vendimi nr. 4, datë 13.10.2014 i Kolegjeve të Bashkuara të Gjykatës së Lartë.
- Vendimi nr. 1, datë 05.10.2015 i Kolegjeve të Bashkuara të Gjykatës së Lartë.

Kolegji Administrativ

- Vendimi nr. 00-2017-2277 (799), datë 17.10.2017 i Kolegjit Administrativ të Gjykatës së Lartë.
- Vendimi nr. 00-2021-3, datë 11.01.2021 i Kolegjit Administrativ

të Gjykatës së Lartë.

- Vendimi nr. 00-2024-1235 (74), datë 26.02.2024 i Kolegjit Administrativ të Gjykatës së Lartë.

Kolegji Civil

- Vendimi nr. 214, datë 08.02.2005 i Kolegjit Civil të Gjykatës së Lartë.
- Vendimi nr. 668, datë 01.06.2006 i Kolegjit Civil të Gjykatës së Lartë.
- Vendimi nr. 00-2011-2060 (495), datë 03.11.2011 i Kolegjit Civil të Gjykatës së Lartë.

Këshilli i Lartë Gjyqësor

- Vendimi nr. 529, datë 27.10.2020 i Këshillit të Lartë Gjyqësor.
- Vendimi nr. 633, datë 10.12.2020 i Këshillit të Lartë Gjyqësor.
- Vendimi nr. 92, datë 17.03.2021 i Këshillit të Lartë Gjyqësor.
- Vendimi nr. 199/2, datë 12.05.2021 i Këshillit të Lartë Gjyqësor.
- Vendimi nr. 223, datë 02.06.2021 i Këshillit të Lartë Gjyqësor.
- Vendimi nr. 462, datë 11.10.2021 i Këshillit të Lartë Gjyqësor.
- Vendimi nr. 463, datë 11.10.2021 i Këshillit të Lartë Gjyqësor.
- Vendimi nr. 464, datë 13.10.2021 i Këshillit të Lartë Gjyqësor.
- Vendimi nr. 6, datë 17.01.2022 i Këshillit të Lartë Gjyqësor.
- Vendimi nr. 267, datë 19.07.2022 i Këshillit të Lartë Gjyqësor.
- Vendimi nr. 180, datë 09.04.2024 i Këshillit të Lartë Gjyqësor.
- Vendimi nr. 208, datë 18.04.2024 i Këshillit të Lartë Gjyqësor.
- Vendimi nr. 268, datë 29.05.2024 i Këshillit të Lartë Gjyqësor.

Këshilli i Lartë i Prokurorisë

- Vendimi nr. 81, datë 31.03.2021 i Këshillit të Lartë të Prokurorisë.
- Vendimi nr. 31, datë 24.02.2022 i Këshillit të Lartë të Prokurorisë.
- Vendimi nr. 284, datë 17.07.2023 i Këshillit të Lartë të Prokurorisë.
- Vendimi nr. 228, datë 29.10.2024 i Këshillit të Lartë të Prokurorisë.
- Vendimi nr. 15, datë 30.01.2025 i Këshillit të Lartë të Prokurorisë.
- Vendimi nr. 65, datë 10.04.2025 i Këshillit të Lartë të Prokurorisë.

Kolegji i Posaçëm i Apelimit

Vendimi nr. 2 (JD), datë 21.06.2018 i Kolegjit të Posaçëm të Apelimit.
Vendimi nr. 1 (JD), datë 20.07.2020 i Kolegjit të Posaçëm të Apelimit.
Vendimi nr. 3, datë 20.12.2021 i Kolegjit të Shqyrtimit Paraprak të Kolegjit të Posaçëm të Apelimit.

Vendimi nr. 5, datë 27.01.2022 i Kolegjit të Shqyrtimit Paraprak të Kolegjit të Posaçëm të Apelimit.

Vendimi nr. 1 (JD), datë 30.05.2022 i Kolegjit të Posaçëm të Apelimit.

Vendim nr. 2 (JD), datë 31.05.2022 i Kolegjit të Posaçëm të Apelimit.

Vendimi nr. 3, datë 07.12.2022 i Kolegjit të Posaçëm të Apelimit.

Vendimi nr. 1 (JD), datë 20.02.2023 i Kolegjit të Posaçëm të Apelimit.

Vendimi nr. 2 (JD), datë 24.10.2023 i Kolegjit të Posaçëm të Apelimit.

Vendimi nr. 692, datë 28.07.2023 i Komisionit të Pavarur të Kualifikimit.

Vendimi nr. 3 (JD), datë 15.12.2023 i Kolegjit të Posaçëm të Apelimit.

Legjislacion dhe rregullore

- Ligji i Gjykatave “Nizamiye”, i datës 27 Jumada al-Thani 1296 (27 qershor 1879).
- Shtesë e ligjit të Gjykatave “Nizamiye”, datë 29 Sha’ban 1304 (17 maj 1888).
- “Kanuni i Jurisë”, datë 23 maj 1913.
- “Kanuni i Gjykatave të Drejtësisë të Shqipërisë”, datë 4 qershor 1914.
- Ligji mbi gjyqësorin, (1919).
- Ligji mbi gjyqësorin, (1921)
- Zgjanimi i Statutit të Lushnjës (1922).
- Statuti Themeltar i Republikës Shqiptare (1925).
- Dekret-Ligji “Mbi organizimin e drejtësisë”, datë 02.05.1925.
- Statuti Themeltar i Mbretërisë Shqiptare (1928).
- Ligji “Mbi organizimin e Drejtësisë”, datë 02.02.1929.
- Ligji “Mbi organizimin e Këshillit të Shtetit”, datë 19.03.1929.
- Statuti Themeltar i Mbretërisë Shqiptare (1939).
- Statuti i Republikës Popullore të Shqipërisë (1946).
- Ligji nr. 275, datë 13.08.1946 “Mbi organizimin gjyqësor”
- Ligji nr. 4406, datë 24.06.1968 “Mbi organizimin gjyqësor”.
- Ligji nr. 5506, datë 28.12.1976 “Kushtetuta e Republikës Popullore Socialiste e Shqipërisë”.
- Ligji nr. 6298, datë 27.03.1981 “Për prokurorinë”.
- Dekreti nr. 7174, datë 20.11.1987 “Për organizimin gjyqësor”.
- Ligji nr. 7491, datë 29.04.1991 “Për dispozitat kryesore kushtetuese”.

- Ligji nr. 7561, datë 29.04.1992 “Organizimi i drejtësisë dhe i Gjykatës Kushtetuese”.
- Ligji nr. 7574, datë 24.06.1992 “Për organizimin e drejtësisë dhe disa ndryshime në kodet e procedurave penale e civile”.
- Ligji nr. 8265, datë 18.12.1997 “Për organizimin e drejtësisë”.
- Ligji nr. 8436, datë 28.12.1998 “Për organizimin e pushtetit gjyqësor”.
- Ligji nr. 8811, datë 17.05.2002 “Për Organizimin dhe Funksionimin e Këshillit të Lartë të Drejtësisë”.
- Ligji nr. 8678, datë 14.05.2001 “Për organizimin dhe funksionimin e Ministrisë së Drejtësisë”.
- Ligji nr. 8737, datë 12.02.2001 “Për organizimin dhe funksionimin e prokurorisë”.
- Rregullorja për organizimin dhe funksionimin e Inspektoratit të Këshillit të Lartë të Drejtësisë (2006).
- Ligji nr. 8417, datë 21.10.1998 “Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar.
- Ligji nr. 44/2015 “Kodi i Procedurave Administrative”.
- Ligji nr. 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve”, i ndryshuar.
- Ligji nr. 115/2016 “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë” i ndryshuar.

Arkivi Qendror Shtetëror

- AQSH, F. 149, Viti 1935, D. VI-520.
- AQSH, F. 155, V. 1913-1918, D. 37.
- AQSH, F. 155, V. 1913-1918, D. 38.
- AQSH, F. 155, V. 1913-1918, D. 233.
- AQSH, F. 155, V. 1925, D. I-131.
- AQSH, F. 156, V. 1926, D. 742.

Website

- <https://ild.al/sq/2021/06/28/njoftim-per-shtyp/>
- <https://ild.al/sq/2023/05/16/njoftim-per-media-3/>

Të tjera

- Procesverbal i mbledhjes së Këshillit të Lartë Gjyqësor, më 21.06.2023.
- Procesverbal i mbledhjes së Këshillit të Lartë Gjyqësor, më 19.07.2023.

CIP Katalogimi në botim BK Tiranë

Mërkuri, Erind

Historik i përgjithshëm i procesit disiplinor ndaj
magjistratëve në Shqipëri : (1912-2025) / Erind
Merkuri ; red. Arianisa Laze. - Tiranë : Morava, 2025.
300 f. ; 17 x 24 cm.

ISBN 9789928314895

1.Drejtësia 2.Gjykata 3.Drejtimi

(Administrimi) 4.Historia 5.Dokumente 6.Shqipëri

347.9(496.5) "1912/2025"

ISBN 978-9928-314-89-5

